



**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
“FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË”
TË USHTRUAR NË BASHKINË VLORË**

Tiranë 2023

📖 PËRMBAJTJA:

NR	EMËRTIMI I KAPITUJVE	FAQE
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4 – 32
1.	<i>Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....</i>	4 – 5
2.	<i>Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve</i>	5 – 28
3.	<i>Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit</i>	28 – 32
II	HYRJA	32 – 36
	a. <i>Titulli.....</i>	
	b. <i>Marrësi.....</i>	
	c. <i>Objektivat dhe qëllimi.....</i>	
	d. <i>Identifikimi i çështjes.....</i>	
	e. <i>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....</i>	
	f. <i>Përgjegjësitë e Audituesve.....</i>	
	g. <i>Kriteret e vlerësimit</i>	
	h. <i>Standardet e auditimit.....</i>	
	i. <i>Metodat e auditimi</i>	
	j. <i>Dokumenti i auditimit.....</i>	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	36 – 350
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	36 – 36
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	36 -350
2.1.	<i>Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe auditin brendshëm.....</i>	36 – 48
2.1.2	<i>Mbi auditimin e brendshëm.....</i>	48 – 53
2.2	<i>Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.....</i>	53 – 76
2.2.6	<i>Menaxhimin e të ardhurave, mbi arkëtimin dhe përdorimin e tyre.....</i>	76 – 180
2.3	<i>Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022.....</i>	180 – 202
2.4.	<i>Mbi zbatimin e procedurave të prokurimit</i>	202 – 247
2.4.4	<i>Mbi zbatimin e kontratave.....</i>	247 – 258
2.5	<i>Mbi planifikim dhe zhvillim e territorit.....</i>	258 – 284
2.6	<i>Mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV.....</i>	284 – 294
2.7.	<i>Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi fundit.....</i>	294 – 302
2.8.	<i>Mbi Auditimin e Aseteve</i>	302 – 324
2.9.	<i>Të ndryshme të dala nga auditimit.....</i>	324 - 344
IV.	GJETJE DHE REKOMANDIMI.....	344 – 433

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e vijim KLSH*), në periudhën nga data 15.11.2022 deri në datë 14.7.2023, realizoi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të veprimtarisë ekonomike dhe financiare të subjektit Bashkia Vlorë, për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2022, duke u përqendruar kryesisht në organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese, planifikimin, hartimin dhe realizimin e buxhetit; realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat e tarifave vendore; auditimin me zgjedhje i transaksioneve financiare, hartimin e pasqyrave financiare viti 2022, zbatimin e procedurave për dhënien e lejeve të ndërtimit, veprimtarinë e IMTV, si dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, etj.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti (me zgjedhje), për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë periudhës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit financiar dhe i përputhshmërisë në KLSH, Rregullorja Funksionimit Organizativ dhe Administrativ të KLSH, Rregullorja e Procedurave të Auditimit, Kodi i Etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kriterëve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase, si verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.

Gjetjet e këtij auditimi janë të karakterit organizativ, shpërblim dëmi, mungesë të të ardhurave dhe të përdorimit jo me efektivitet, eficensë dhe ekonomikitet (3-E) të fondeve publike të realizuara nga të ardhurat e veta dhe grandet e deleguara nga buxheti i shtetit dhe jo vetem, i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të Audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Bazuar në rezultatet e auditimit të Bashkisë Vlorë për periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 31.12.2022, grupi i auditimit konkludon në një opinion, të ***opinion të modifikuar me rezervë*** për aspektin financiar (pasqyrat financiare viti 2022), ndërsa për aspektin e përputhshmërisë për të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022, konkludon me ***opinion i kundërt***.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 5 drejtimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

I.1. Përshkrim i shkurtër i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
1	<p>Nga auditimi i tabelave të realizimit të tregueseve të buxhetit u konstatua se niveli i realizimeve për vitin 2021 është në masën 66 % dhe për vitin 2022 është në masën 65 % . Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Vlorë në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Gjithashtu, Bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) gjë e cila ndodh, por që nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës. Shpjegimet nga Drejtoria ekonomike për këtë diferencë midis planifikimit dhe realizimit jepen me mungesën e realizimit të të të ardhurave. Nga ana tjetër konstatohet se nuk ka korrigjim të planit vjetor të buxhetit, në varësi të pritshmërisë dhe realizimit faktik gjatë vitit buxhetor, në mënyrë që të ngushtohet diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve. Bazuar në nenin 47 - Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, i ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ku thuhet: “ Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore bën një analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, edhe propozimet përkatëse për ndryshimin e vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, që ka miratuar buxhetin e vitit. Procedura e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve të vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore është e njëjtë me atë të vendimit për miratimin e buxhetit vjetor”, gjykojmë se duke parë trendin e realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, buxhetet e planifikuar mund të ishin korrigjuar, duke ju përshtatur realizimit faktik si të viteve të mëparshme, ashtu edhe të periudhës së vitit buxhetor. Në këtë mënyrë realizimi faktik i</p>	I mesëm	Pika 2 e RPA	<p>Drejtoria e Financë/ Buxhet Bashkia Vlorë, të marrë masa që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet. - Planifikimi i procedurave për investime/ shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave dhe jo të planifikimit, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (faturave të palikujduara), në fund të periudhës, duke planifikuar ato shërbim dhe investime më të domosdoshme për nevojat e Bashkisë Vlorë. - Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	shpenzimeve do të ishte si vlerë më afër planifikimit. Gjithashtu në nenin 5 i ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, përcaktohet se në hartimin e buxhetit vjetor duhet bazuar në të ardhurat dhe shpenzimet faktike të viteve të mëparshëm			
2	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga drejtorja e financës në lidhje me planin të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura rezultoi se detyrimi i mbetur në dhjetor 2020 është në shumën 246,000 mijë lekë dhe shuma e parashkuar për shlyerje përgjatë tre viteve është sipas planit për vitin 2021 në shumën 212,745 mijë lekë për vitin 2022 në shumën 120,000 mijë lekë.</p> <p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtorja e Financës dhe e Buxheti vërehet se gjatë vitit 2021 janë shlyer 750,329 mijë lekë nga 212,745 mijë lekë të parashkuara. Duke iu referuar planit të shlyerjes së stokut të detyrimeve të prapambetura për vitin 2022, nuk është përcaktuar detyrimi i mbetur Detyrimi në fillim të vitit i mbartur nga viti 2021, dhe nuk është parashkuar shlyerja e detyrimit që duhet të shlyej gjatë vitit 2022.</p> <p>Për sa më sipër rezultoi se marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”,</p> <p>Auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin afatit 60-ditor të paraqitjes në Degën e Thesarit Vlorë të urdhërshpenzimit me dokumentacionin shoqërues nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 01/01/2021– 31/12/2021 janë faturat e pa likuiduara janë 37 fatura 1 faturë për investime për subjektin A. ShPK faturë nr. 28 datë 27.07.2021 për vlerën 6,347,911 lekë dhe 36 fatura për shpenzime operative në vlerën 103,820,677 lekë. Pasqyruar në Aneksin nr. 11. Për vitin 2022 u konstatua se për periudhën 01/01/2022– 31/12/2022 janë 7 fatura të pa likuiduar nga të cilat për investime në vlerën 7,218,763 lekë dhe Faturat e pa likuiduara për</p>	I mesëm	Pika 2 e RPA	Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorja e Financës/ Buxhet Bashkia Vlorë, të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 60 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Gjithashtu të merren masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitet e mëparshme.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>shpenzime operative në vlerën 681,124 lekë pasqyruar në <i>Aneksin nr. 12</i>. Gjithashtu nga Bashkia Vlorë (Drejtoria e Financë/Buxhet), ka edhe fatura të cilat nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë, duke kryer pagesa pjesore të tyre, e cila ka si shkak mungesën e fondeve nga realizmi i të ardhurave vendore. Për periudhën 01/01/2021 – 31/12/2022, paraqiten gjithsej 13 fatura me vlerë 165,694,990 lekë, nga e cila: për vitin 2021 paraqiten 9 fatura me vlerë 148,964,705 lekë, për vitin 2022 paraqiten 5 fatura me vlerë 16,730,285 lekë. sipas <i>Aneksit nr. 6 dhe Aneksit nr. 10</i>. Sa i përket likujdimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, konstatohet se nuk respektohet rradha e likujdimit të tyre, pra fatura e parë likujdohet më parë.</p>			
3	<p>Referuar tabelave <i>1 dhe 2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit</i>, konstatohet se për disa taksa dhe tarifa, realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa taksa dhe tarifa të tjera realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve, e cila kryesisht vjen për shkak të mos identifikimit të faktorëve të cilët ndikojnë në planifikimin jo të saktë, gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Vlorë, që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme, në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të bëhet mbi baza sa më reale, për të mos shkaktuar deficit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve, etj, në dëm të interesave të publikut. Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit konstaton që metodologjia e përdorur nga DAV-ja për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmërinë lidhur me të ardhurat e veta të Bashkisë. Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër për periudhën nën auditim konkretisht për vitin 2021 realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Vlorë, paraqitet në masën 69 %, nga 1,410,692 mijë lekë të parashikuara janë</p>	I mesëm	Pika 2.6 e RPA	<p>Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoritë e tjera që merren me menaxhimin dhe ndjekjen e të ardhurave, të marrin masa për një planifikim sa më të saktë të të ardhurave vendore në raport me mundësitë reale të Bashkisë Vlorë, duke mos krijuar diferenca të theksuara në zëra të veçantë si në mos realizime dhe në realizime, si dhe të shmang mbi planifikimin e tyre për të shmangur në maksimum zhvillimin e procedurave pa fonde.</p> <p>Drejtoritë duhet të rakordojnë me njëra tjetrën me qëllim rritjen e nivelit të arkëtimit por edhe për një planifikim sa më real të të ardhurave.</p> <p>Kryetari i Bashkisë Vlorë të riorganizojë strukturën e Drejtorisë së të Ardhurave, në mënyrë të atillë që cdo burim të ardhurash të jetë i strukturuar në këtë drejtori, pasi janë disa drejtori që arkëtojnë të ardhura duke krijuar kështu mundësinë e rrjedhjes së të ardhurave për tu arkëtuar dhe planifikuar.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>realizuar 977,764 mijë lekë (minus 432,928 mijë lekë). Për vitin 2022 paraqitet në masën 87.2% nga 1,399,948 mijë lekë janë realizuar 1,220,873 mijë lekë (minus 179,075 mijë lekë). Në qoftë se analizojmë të dhënat e tabelës më sipër vërehet se të ardhurat që kanë një tejkallim të realizimit në nivele të larta janë të ardhurat nga taksat e ndara që nuk vilen nga DAV.</p>			
4	<p>Për vitin 2020 me VKB nr. 88, datë 24.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë ” dhe për vitin 2021 me VKB nr. 79, datë 02.12.2021 “Për disa ndryshime në VKB-në nr. 88, datë 24.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë ”, janë miratuar tarifat, struktura dhe procedura për ndjekjen e tarifës së hapësirës publike për qëllime biznesi plazh, si vijon: <i>-Për zënien e hapësirave publike në plazhin e Nartës dhe Plazhin e vjetër me tarifë 400 lekë/m²/sezon</i> <i>-Për zënien e hapësirave publike në për të gjithë plazhet e tjerë përveç pikës 1 me tarifë 500 lekë/m²/sezon.</i> Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Vlorë nuk është ngritur komisioni i menaxhimit të stacioneve të plazhit, në kundërshtim me Kapitullin II, pika a/2. Referuar të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe Drejtoria e Financë Buxhet Bashkia Vlorë, rezulton se: a- Përgjatë sezonit turistik të vitit 2021 ushtrojnë aktivitet “shfrytëzim të hapësirave për stacione plazhi”, me afat 1, 2 dhe 5 vjeçare, por pa lidhur kontratë me bashkinë Vlorë, gjithsej: . 55 subjekte me afat 1-vjeçar.. 90 subjekte me afat 2 dhe 5-vjeçar. Shuma totale e mbledhur përgjatë sezonit turistik nga subjektet është prej 32,339,160 lekë për një sipërfaqe prej 83388 m². b- Përgjatë sezonit turistik të vitit 2022 ushtrojnë aktivitet “shfrytëzim të hapësirave për stacione plazhi”, me afat 1, 2 dhe 5 vjeçare, por pa lidhur kontratë me bashkinë Vlorë 98 subjekte me afat 1-vjeçar. 89 subjekte me afat 2-5-vjeçar. Shuma totale e mbledhur përgjatë sezonit turistik nga subjektet e plazheve është arkëtuar një vlerë prej 38,906,336 lekë për sipërfaqen gjithsej prej 101647 m².</p>	I lartë	Pika 2.6 e RPA	<p>Kryetari i Bashkisë Vlorë, të marrë masa për: - Ngritjen e Strukturës Përgjegjëse të Menaxhimit të Stacioneve të plazhit dhe jo në dorë të një individi. - Në bashkëpunim me Strukturën Përgjegjëse të Menaxhimit të Stacioneve të plazhit, të mos lidhë ose japë me qira sipërfaqe më shumë se sa është miratuar nga AKB dhe GTSHA. - Në bashkëpunim me Strukturën Përgjegjëse të Menaxhimit të Stacioneve të plazhit, të mos lëshojë mandate pagesë dhe lidh kontratë për sipërfaqe plazhi ndajë subjekteve të cilat kanë parregullsi në dokumentacionin ligjorë të paraqitur dhe konflikt për sipërfaqet e plazhit.</p> <p>13.2. Rekomandimi: Topografi i njësisë vendore në cdo rast të dhënies së hapësirave të plazhit të hartoj procesverbalin sipas koordinatave për cdo Stacion plazhi të shoqëruar kjo me planvendosjen të miratuar.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>Nga të dhënat e mësipërme evidentohet fakti se nga viti 2021 në vitin 2022 kemi një rritje të vlerës së arkëtimeve për vlerën 6,567,176 lekë (38,906,336 – 32,339,160), e cila vjen pasi kemi rritje të sipërfaqes së dhënë me qira nga viti 2021 në vitin 2022 për sipërfaqen prej 18,259 m² (101647 – 83388).</p> <p>Nga kryqëzimi i të dhënave të miratuara nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB) dhe sipërfaqeve faktike të faturuara të shoqëruar me lista nga Drejtoria e Aseteve, rezulton se ka mospërputhje për sipërfaqen 57265 m², ku sipas AKB sipërfaqja është 44382 m², ndërsa sipas Bashkisë sipërfaqja e dhënë për qira është 101647 m², pra nga bashkia janë dhënë sipërfaqe plazhi më shumë se ato të miratuara nga AKB.</p> <p>Për asnjë nga vitet objekt auditimi (2021-2022), nga ana e ish- Kryetarit të Bashkisë Vlorë z. D. L. nuk janë nënshkruar kontratat e miratuara nga AKB, kjo me pretendimin se stacionet e plazhit për të cilat janë lidhur kontratat kanë konflikte midis individëve dhe se për një pjesë të plazhit (vazhdim lungomares), nga qeveria janë parashikuar investime për ndërhyrje dhe nuk duhej dhënë dhe miratuar plazhe 2 dhe 5 vjeçare. Për asnjë rast nga Bashkia Vlorë (topografi), nuk janë ndarë me procesverbal në terren koordinatat për stacionet e plazhit, si dhe planvendosjen e miratuar.</p>			
5	<p>Në auditimin në dokumentacionin bashkëshoqërues të dhënies me qera të hapësirave të plazhit, u krye kampionimi në të gjitha dosjet që disponon Drejtoria e Menaxhimit të Pronave Publike dhe Aseteve Bashkia Vlorë, të cilat kanë kryer pagesa hapësirë për stacion plazhi për vitet 2021-2022, nga ku konstatohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të gjitha dosjet nuk kishin të depozituar kopjen e kontratës së lidhur ndërmjet AKB, subjektit posedues të plazhit dhe Bashkia Vlorë. - Mos depozitimi në dosje i vërtetimit mbi pagesën e taksave lokale nga DTTV Bashkia Vlorë dhe detyrimeve fiskale nga DPTR Vlorë dhe jo vetëm, si dhe vërtetimi që nuk është në ndjekje penale, veprime në kundërshtim me shkronja (d, dh) të pikës 3 e nenit 5 të VKM nr. 171/2019, datë 27/03/2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së sezonit turistik”, me ndryshime. - Mos depozitimi në dosje planvendosjen, kjo për të mundësuar madhësinë e parcelës dhe pozicionimin e çadrave për largësinë ndërmjet tyre, bregut dhe pjesës së plazhit publik në raste ku ato janë pranë, 	I mesëm	Pika 2.6 RPA	<p>Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Strukturën Përgjegjëse të Menaxhimit të Stacioneve të plazhit, të marri masa për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nënshkrimin e të gjitha kontratave të miratuara nga AKB për sipërfaqen që subjektet kërkojnë, por gjithmonë sipërfaqja nuk duhet të jetë më e madhe se sipërfaqja e miratuar nga AKB. - Në cdo dosje duhet të jenë të depozituara vërtetimi mbi pagesën e taksave (vendore dhe të përgjithshme), planvendosjen mbi madhësinë e parcelës dhe pozicionimin e çadrave me largësi të barazlaguara ndërmjet njëra tjetrës dhe bregur, aktkontrolltet për verifikimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme dhe respektimin e 20% të plazheve publike, dokumenti mbi detyrimin për plotësimin e masave të sigurisë dhe të kushteve të higjienës, si dhe harta me treguesit kryesorë për sipërfaqen e kontraktuar, marrëveshja e noterizuar me vrojtuesit e plazhit e vlefshme

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>veprime në kundërshtim me shkronjat (a, b,c) të pikës 1 e nenit 6 të VKM nr. 171/2019, datë 27/03/2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë s sezonit turistik”, me ndryshime.</p> <p>- Mungon procesverbali mbi dorëzimin e sipërfaqes së kontraktuar, në kundërshtim me VKM nr. 171/2019, datë 27/03/2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë sezonit turistik”, i ndryshuar me VKM nr. 1172, datë 24/12/2022.</p> <p>- Mungojnë dokumenti mbi detyrimin për plotësimin e masave të sigurisë dhe të kushteve të higjienës, si dhe harta me treguesit kryesorë për sipërfaqen e kontraktuar.</p> <p>- Për aktivitetin e vitit 2021, në asnjë rast, pjesë e dosjes nuk ishin aktet e kontrollit për verifikimin në terren nëse sipërfaqet që shfrytëzohen janë në përputhje me sipërfaqet e kontraktuara, si dhe nëse është ruajtur raporti 80% sipërfaqe e shfrytëzueshme dhe 20 % sipërfaqe në përdorim publik, si dhe mungonin procesverbalet e monitorimit të kontratave për plotësimin e kushteve të kontratave si dhe kriteret ligjore që duhet të plotësojnë stacionet e plazhit, kjo pasi dhe kontratat nuk ishin të nënshkruara.</p> <p>Ndërsa për vitin 2022 kishte aktkontrolle, por ato ishin vetëm për verifikimin e sipërfaqes në shfrytëzim me atë të paguar por jo për element të tjerë që përmban VKM 171/2019 me ndryshime. Pra ky dokumentacion mungonte, edhe pse qiramarrës ishin po të njëjtët subjekte në të njëjtat zona të plazhit, të cilët e kanë detyrim ligjor paraqitjen e akteve të Monitorimit të kryera nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe Inspektorati përgjegjës në momentin e rinovimit të kontratave. Po kështu edhe komisionet e ngritura me urdhër të Titullarit për çdo vit për verifikime në terren nuk kanë funksionuar.</p> <p>- Në asnjë nga dosjet e audituara për vitin 2021-2022 nuk ishte e depozituar marrëveshja e noterizuar me vrojtuesit e plazhit e vlefshme kjo për gjithë kohën e shfrytëzimit, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 171/2019, datë 27/03/2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë sezonit turistik”, i ndryshuar me VKM nr. 1172, datë 24/12/2022</p>			<p>kjo për gjithë kohën e shfrytëzimit, si dhe procesverbali mbi dorëzimin e sipërfaqes së kontraktuar.</p> <p>- Plotësimin e dosjes me dokumentacionit e plotë ligjorë sipas kërkesave të VKM nr. 1172, datë 24.12.2020 ndryshuar me VKM nr. 827, datë 24/12/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 171, datë 27.3.2019, të këshillit të ministrave, “për miratimin e rregullores ‘për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit””.</p>
6	Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 202 “ <i>Studime kërkime</i> ” sipas Formatit nr.7/b “ <i>Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)</i> ”,	I mesëm	Pika 3 e RPA	Drejtoria e Financës Bashkia Vlorë të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite nga ish-Njësitë Vendore, që i

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>paraqiten në të njëjtën vlerë si në mbyllje dhe në çelje të vitit ushtrimorë 2022 për vlerën 115,857,512 lekë. Konstatohet se për 52 projekt-studime për investime të kryera gjatë viteve, nuk është bërë i mundur shpërndarja e investimeve sipas llojit të aktiveve materiale, ku për projektet e vënë në zbatim pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme, për vlerat duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së projekteve si vlerë e shtuar e çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Gjithashtu vlera prej 9,812,760 lekë, e emërtuar “<i>Të tjera</i>”, nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson.</p>			<p>janë bashkuar nga reforma territoriale për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare për vlerën 9,812,760 lekë e emërtuar “<i>Të tjera</i>” dhe të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik. Për projektet e vëna në zbatim të llogarisë 202 “Studime projekte”, të bëhet sistemimet përkatëse duke debituar llogaritë e aktiveve dhe kredituar llogarinë 2022.</p>
7	<p>Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 212 “<i>Ndërtesa Konstruksione</i>” sipas Formatit nr. 7/b “<i>Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)</i>”, paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,419,596,938 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 1,450,591,607 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 212 “<i>Ndërtesa Konstruksione</i>” konstatohet se, kjo llogari është e analizuar sipas vlerës së investimeve të kryer, duke mos ia shtuar vlerën e rikonstruksionit vlerës së ndërtesës dhe emetuar si artikuj kontabël më vete më vete vlerat e rikonstruksionit. Gjithashtu në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 21 artikuj aktive materiale në vlerën 139,985,242 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit të llogarive 213 “<i>Rrugë, rrjete, vepra ujore</i>” në vlerën 83,080,542 lekë, llog. 210 “<i>Toka, Troje, Terrene</i>” në vlerën 56,904,700 lekë.</p>	I mesëm	Pika 3 e RPA	<p>Drejtoria e Financës në Bashkinë Vlorë, të marrë masa për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 212 “<i>Ndërtesa konstruksione</i>”, duke shtuar vlerën e shpenzimeve për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre. - Të kryejë zberthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite të paanalizuara dhe për 21 artikuj kontabël në vlerën 139,985,242 lekë, si dhe të bëjë sistemimet duke pakësuar inventarin e kësaj llogarie dhe shtuar inventarin e llog. 213 “<i>Rrugë, rrjete, vepra ujore</i>” në vlerën 83,080,542 lekë, llog. 210 “<i>Toka, Troje, Terrene</i>” në vlerën 56,904,700 lekë.
8	<p>Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) për vitin buxhetor 2022 paraqitet në vlerën 6,099,533,096 lekë, me të gjitha shtesat/pakësime për çdo lloj grup aktivi. Inventari kontabël i aktiveve materiale gjendje në llogaritë 210 “<i>Toka, Troje, Terrene</i>” është në vlerën 111,833,518 lekë; llogaria 211 “<i>Pyje, Plantacione</i>” në vlerën 272 lekë, llogaria 212 “<i>Ndërtesa Konstruksione</i>” në vlerën 1,450,591,607 lekë, llogaria 213 “<i>Rrugë, rrjete, vepra ujore</i>” në vlerën 4,273,830,858 lekë; llogaria 214 “<i>Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune</i>” në vlerën 263,274,841 lekë. Në këto llogari nuk është i qartë përcaktimet e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për</p>	I mesëm	Pika 3 e RPA	<p>Drejtoria e Financës Bashkia Vlorë të marrë masa për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Analizimin e llog. 210 “<i>Toka, Troje, Terrene</i>” është në vlerën 111,833,518 lekë; llog. 211 “<i>Pyje, Plantacione</i>” në vlerën 272 lekë, llog. 212 “<i>Ndërtesa Konstruksione</i>” në vlerën 1,450,591,607 lekë, llog. 213 “<i>Rrugë, rrjete, vepra ujore</i>” në vlerën 4,273,830,858 lekë; llog. 214 “<i>Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune</i>” në vlerën 263,274,841 lekë, në përcaktimin e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për artikull, të vlerës së plotë të çdo aktivi, nga vlera fillestare dhe shtesat gjatë viteve.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>artikull, duke mos përcaktuar vlerën e plotë të çdo aktivi, e cila duhet të përfshijë vlerën fillestare dhe shtesat gjatë viteve të secilit aktiv.</p> <p><u>Në këto inventarë kontabël janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv.</u></p> <p>Gjithashtu për këto aktive mungojnë kartelat kontabël apo regjistri historik me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.</p>			<p>- Të hapen kartelat kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.</p>
9	<p>Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 10 (dhjetë) raste nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë distancat urbane nga trupi i rrugës së propozuar, distancat urbane midis ndërtimeve, distancat urbane ndërtesë – kufi prone, lartësia maksimale e lejuar e matur me metra dhe numër katesh, përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapësira publike, aksesit për në pronë, lartësia minimale e lejuar për katin përdhe, mangësi në projektin arkitektonik, intensiteti i ndërtimit.</p>	I mesëm	Pika 5 e RPA	<p>Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë të marrë masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në legjislacionin dhe rregulloret mbi të cilat ky institucion funksionon, të kërkohen të kryhen të gjitha ndryshimet e nevojshme mbi projektet ndërtimore deri në përputhjen e plotë sipas ligjit, në të kundërt, të mos miratohet asnjë leje ndërtimi që nuk i plotëson të gjitha kondicionet urbane të parashikuara.</p>
10	<p>Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 5 (pesë) raste nuk janë respektuar përcaktimet ligjore në lidhje me kontributin që sektori privat duhet të ofrojë përkundërt fondit publik të banesave sociale, me mungesën e kontratës midis palëve për evidentimin e sipërfaqes së përfituar, si dhe me kontributin e përfituar nga subjektet të cilat kanë përdorur të drejtën e ndërtimit me intensitet me kusht, këto në kundërshtim me Ligjin 22/2018 “Për strehim social”, datë 03.05.2018, Neni 19, pika 1.</p>	I mesëm	Pika 5 e RPA	<p>Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë të marrë masa për përfitimin e kontributit që sektori privat duhet të ofrojë përkundërt fondit publik të banesave sociale sipas parashikimeve ligjore, hartimin e kontratave midis palëve përpara miratimit të lejes së ndërtimit, si dhe të marrë masat që ky përfitim të jetë i barabartë me vlerën e shitjes, për ato raste kur kontributi nuk përfitohet si sipërfaqe e banueshme, por si investim publik.</p>
11	<p>Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 12 (dymbëdhjetë) raste të audituara, projekti ndërtimor nuk është i plotë, si dhe mungon dokumentacioni shoqëruar, siç janë mangësi në rilevimin topografik, mangësi në projektet ndërtimore dhe relacionet teknike të tyre, oponenta teknike, licencat profesionale të hartuesve të projekteve, deklaratat e përgjegjësive profesionale, polica e sigurimit të përgjegjësive profesionale,</p>	I mesëm	Pika 5 e RPA	<p>Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë të marrë të gjitha masat për të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi, si dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi me mangësi të tilla. DPKZHT</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>mangësi në dokumentacioni që vërteton statusin aktiv të subjekteve, projekti ndërtimor në formatin DWG. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, më konkretisht me “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 10, Neni 15, Neni 41; VKM nr.457,datë 29.6.2022; VKM nr. 1162, datë 24.12.2020.</p>			<p>dhe Bashkia Vlorë të marri masa për të kontrolluar të gjithë dokumentacionin e dorëzuar mbi saktësinë dhe plotësinë e tij.</p>
12	<p>Referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, rezulton se IMTV dhe DPKZHT, si dy strukturat përgjegjëse për zhvillimin e kontrolluar të territorit dhe mbrojtjen e tij, nuk kanë kryer detyrat e tyre funksionale duke lejuar fillimin e ndërtimit të një objekti banimi dhjetë kate <u>përpara miratimit të lejes së ndërtimit</u>, më konkretisht për objektin me leje ndërtimi të miratuar me vendim nr. 687, nr. 3293/1 prot; datë 04.10.2022 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për "Objekt banimi dhe shërbimi me 3 dhe 10 kate mbi tokë dhe papafingo, me 1 kat nën tokë" me adresë rr. “Gjergj Kastrioti”, Vlorë, me subjekt zhvillues “F. I.” ShPK. Nga auditimi u konstatua se ky objekt është pajisur me leje ndërtimi pasi ka filluar ndërtimin, më konkretisht, leja e ndërtimit për objektin në fjalë është miratuar në datën 04.10.2022. Nga këqyrja e fotografimit satelitor të periudhës Gusht 2021, si dhe nga verifikimi në terren, vihet re se objekti ka qenë në fazë ndërtimi. Pra, subjekti zhvillues e ka filluar ndërtimin e objektit pa marrë miratimin e autoriteti përgjegjës, në këtë rast Bashkia Vlorë, kjo në shkelje të Nenit 39 të Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar. Zhvilluesi ka aplikuar për miratimin e njoftimit të fillimit të punimeve në datën 04.04.2023 dhe është miratuar në datën 13.04.2023. Nga kontrolli në terren, konstatohet se objekti është në ndërtim, në katin e 5 teknik, në fazën e karabinasë.</p>	I lartë	Pika 6 e RPA	<p>Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), Bashkia Vlorë të marrë masa për të mos lejuar asnjë ndërtim të zhvillohet në kushtet e mungesës së lejes së ndërtimit të miratuar nga Autoriteti Kontraktor. IMTV duhet të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin nën juridiksionin e Bashkisë Vlorë në mënyrë periodike, sipas zonave të inspektimit të inspektorëve dhe planeve mujore të punës, të hartuara nga kryeinspektori, me qëllim parandalimin e zhvillimit të objekteve të kundërligjshëm, të papajisur me leje ndërtimi të miratuar.</p>
13	<p>Bashkia Vlorë, DPKZHT dhe zyra juridike nuk kanë ndërmarrë të gjithë hapat dhe masat për mbrojtjen e tyre, si dhe mbrojtjen e territorit nën juridiksionin e tyre, përpara gjykatës administrative dhe asaj të apelit, pasi nuk kanë evidentuar faktin se objekti i propozuar shkel çdo kondicion urban në lidhje me distancat me pallatin nr. 887, objekt i cili ka qenë i ndërtuara përpara se subjekti “H.” ShPK të aplikonte për herë të parë për pajisje me leje ndërtimi; nuk kanë evidentuar faktin se pallati nr. 887 është dëmtuar fillimisht nga ndërtimi i Ç. C., duke i reduktuar ¼ e objektit, pa asnjë projekt ose dokumentacion; nuk</p>	I lartë	Pika 6 e RPA	<p>Bashkia Vlorë, për çdo rast të ngjashëm, kur miratimi i lejeve të ndërtimit kërkohet të kryhet me vendim të gjykatës administrative, të marrë masa për të evidentuar gjatë mbrojtjes së saj në gjykatë të gjitha ndryshimet e parametrave urban dhe të gjendjes ekzistuese, në funksion të miratimit të këtyre lejeve ndërtimi, sipas kondicioneve të reja urbane, në zbatim të kuadrin rregullator në fuqi.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>kanë evidentuar faktin se subjekti “H.” ShPK nuk ka pasur marrëveshje me të gjithë pronarët e pallatit nr. 887, (znj. T. H. pretendon se nuk ka firmos kurrë ndonjë marrëveshje me subjektin në fjalë), duke qenë se ky pallat nuk është marrë në konsideratë gjatë projektimit dhe procedurës së aplikimit për leje ndërtimi; nuk kanë evidentuar faktin se objekti i propozuar zhvillohet mbi një rrugë ekzistuese, duke krijuar një tunel për të lejuar kalimin e makinave, kjo në kundërshtim me legjislacionin e zhvillimit të territorit, atë të shfuqizuar dhe atë në fuqi. Edhe pse trualli ku pretendohet të zhvillohet objekti është në pronësi të zhvilluesit, Bashkia Vlorë duhet të kishte ndjekur procedurën e shpronësimit përkundrejt “H.” ShPK, si ka vepruar në rastin e pallatit nr. 887. Edhe në këtë rast është vepruar me 2 standarte; Bashkia Vlorë dhe zyra juridike nuk e kanë ankimuar rastin në rekurs, pranë Gjykatës Kushtetuese, siç ligji e parashikon.</p>			
14	<p>Në Bashkinë Vlorë asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë dhe Njësive Administrative që përmbledh kjo Bashki nuk janë inventarizuar si dhe nuk janë marrë në dorëzim, nga titullari institucionit dhe strukturat përkatëse, nuk është vepruar sipas VKM-së, nr.500 datë 14.8.2001“<i>Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore</i>”, të pikave 9,10,11 dhe 22”, që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ku Bashkitë ishin të detyruara të paraqisnin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që kërkonin t’u transferoheshin. Për bashkinë Vlorë lista e pronave është miratuar me VKM nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” dhe VKM përkatëse. Në total Bashkia ka gjithsej rreth 4,415 pasuri që i janë transferuar Bashkisë Vlorë dhe nuk është dërguar asnjë pronë për t’u certifikuar .</p> <p>-Nga Bashkia Vlorë, nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së Vlorë, mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm te personat e tretë që kanë pësuar këto pasuri, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive.</p> <p>Gjithashtu konstatohet se inventari i pasurive të paluajtshme të Bashkisë Vlorë është i pa përditësuar, në kundërshtim me nenin 37 të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në</p>	I mesëm	Pika 8 e RPA	<p>Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me drejtorinë përkatëse, të marrin masat të ngrejë grupet e punës, për të përcaktuar në misionin dhe detyrat e saj mbi administrimin e aseteve, si dhe struktura e ngarkuar për ndjekjen e tyre dhe inventarizimin e pronave përkatëse, gjithashtu të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre <u>brenda 18 muajve</u> nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.</p> <p>-Procedura e përditësimit mbështetet në verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren dhe verifikimit juridik, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së.</p> <p>-Bashkia ti kërkojë ASHK-së, informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligji”.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	Republikën e Shqipërisë”, mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore të pa përditësuara.			
15	Në 2 (dy) raste nga auditimit i zbatimit të rregullave të prokurimit publik, respektivisht në tenderin me objekt “ <i>Blerje Kompjuterë Desktop, Workstation, Printer AIO, Laptop Praktik</i> ” me fitues OE “PC. S” ShPK me ofertë në vlerën 1,620,000 lekë dhe tenderin me objekt “ <i>Pëmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara</i> ” me fitues BOE “N. 1934” & “G.” SHPK me ofertë në vlerën 3,454,244 lekë, u konstatua parregullsi në vlerësimin e kualifikimit të operatorëve ekonomik nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), duke shpallur fitues OE “PC. S” ShPK dhe BOE “N. 1934” & “G.” ShPK ” në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar dhe, ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.	I lartë	Pika 4 e RPA	Bashkia Vlorë, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të gjitha kriterëve të DT të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publike.
16	Në 5 (pesë) procedura prokurimi nga auditimit i zbatimit të rregullave të prokurimit publik mbi zbatimin e Kriterëve të Përgjithshme dhe të veçanta në DST, respektivisht në prokurimin me objekt “ <i>Blerje Kompjuterë Desktop, Workstation, Printer AIO, Laptop Praktik</i> ” me fitues OE “PC. S” ShPK me ofertë në vlerën 1,620,000 lekë, në prokurimin me objekt “Ndërrhyrje riparimi në çerdhe, kopshte dhe shkolla të Bashkisë Vlorë” me fitues BOE “L.” & “J.” ShPK me ofertë 2,281,625 lekë, në prokurimin me objekt “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara” me fitues BOE “N. 1934” & “G.” ShPK me ofertë 3,454,244 lekë, në prokurimin me objekt “Strukturë me pilota për përforsim skarpati pas Godinës së Bashkisë” me fitues OE “I.” ShPK me ofertë 8,395,118 lekë, në prokurimin me objekt “Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë” me fitues OE “Sh. 07” ShPK me ofertë 18,000,000 lekë, u konstatua se në 11 (njëmbëdhjetë) raste Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë dhe Njësia e Prokurimit, kanë kryer procedura prokurimi pa argumentuar kriteret për kualifikim (kapacitetet teknike) dhe pa respektuar rregullat e	I lartë	Pika 4 e RPA	Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë, Njësia e Prokurimit, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e kriterëve saktë teknikisht dhe ligjërish, duke i dokumentuar në një proces verbal, në përputhje me procedurën e zhvilluar, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikën e zhvillimit të procedurave me një OE, me qëllim përdorimin e fondeve publike me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	procedurave të prokurimit publik, hartimit të DST, të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, kriterëve teknike duke mos respektuar kërkesat e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.			
17	Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Furnizim vendosje pajisje për ndriçimin rrugor”, me vlerë 8,548,019 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “S.” ShPK, rezultuan diferenca në volume për zërin e punimeve: “Gërmim themele e plinta b>2m, ekskavator me goma 0.25 m ³ , shkarkim tokë”, “FV Brez b/a C16/20, h=8m”, “Heqje dhe vendosje Pllaka betoni në trotuar për kanale të tublit të kabllit”, “Prishje shtresë betoni 20 cm në trotuar...” të zbatuara në rrugët “At Kristo Negovani”, “Janaq Kilica”, “Misto Mele”, “Pilo B.” dhe “Fiqirete Musta” në Bashkinë Vlorë, në vlerën 932,798 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 8893 prot; 05.08.2022 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë dhe OE “S.” ShPK	I lartë	Pika 4.4 e RPA	Titullari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën 932,798 lekë pa TVSh nga “S.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 8893 prot; 05.08.2022, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
18	Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë”, me vlerë 13,418,547.6 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “B. X” ShPK, rezultuan diferenca në volume për zërin e punimeve: “Shtresë stabilizanti t=10cm”, “Shtresë binderi me granil gur kave, 4 cm, me makineri” dhe “Shtresë asfaltobeton me granil gur kave, 4 cm, me makineri”, në vlerën 500,000 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 8409 prot; 26.05.2021 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë dhe OE “B. X” ShPK.	I lartë	Pika 4.4 e RPA	Titullari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën 500,000 lekë pa TVSh nga “B. X” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 8409 prot; 26.05.2021, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
19	Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Ndërtim i ujësjellësit në rrugën Transballkanike Vlorë”, me vlerë 166,940,070 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “Sh. 07” ShPK, rezultuan diferenca në volume për zërin e punimeve: “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , në vlerën 190,050 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 9412 prot; datë 21.10.2020 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë dhe shoqërisë “Sh. 07”	I lartë	Pika 4.4 e RPA	Drejtorja e Financës & Kontabilitetit Bashkia Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën 190,050 lekë pa TVSh nga “Sh. 07” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 9412 prot; datë 21.10.2020, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	ShPK			
20	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Strukturë me pilota për përforcim skarpiti pas godinës së Bashkia Vlorë”, me vlerë 10,074,142 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “I.” ShPK, rezultuan diferenca në volume për zërat e punimeve: “Zëri 12 (An) Betonim Pilotash C/25/30”, “Zëri 3 (2.130/1) Mure b/a t=21-30 cm, h=4m C/25/30”, “Zëri 4 (An-01) Veshje pilotash me membranë beton”, si dhe penalitetete për punime jashtë afatit të kontratës, në vlerën 220,945 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 7619 prot, datë 04.07.2022 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë dhe shoqërisë “I.” ShPK.</p>	I lartë	Pika 4.4 e RPA	<p>Titullari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën 220,945 lekë pa TVSh nga “I.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7619 prot, datë 04.07.2022, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.</p>
21	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + Sistem ngrohje”, me vlerë 44,489,454 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “C.” ShPK u konstatua se, nga AK Bashkia Vlorë nuk ka pasur pengesë për disponimin e kantierit dhe asnjë kërkesë të ligjshme të kontraktorit për të justifikuar mos zbatimin e afatit të përfundimit të punimeve sipas kontratës së sipërmarrjes. Duke qenë se ndërmjet kontraktorit shoqërisë “C.” ShPK dhe Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë <u>nuk është miratuar asnjë shtyrje e afatit të kontratës</u>, pra nuk është kryer asnjë Amendim i Kontratës bazë me nr. 1808 prot; datë 01.03.2019 për objektin “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + sistem ngrohje”, sipas pikës 33.2 të nenit 33 “Vonesa në zbatim dhe zgjatja e afatit”, Autoritetit Kontraktor i lind e drejta që të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim sipas klauzolave të nenit 34 “Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve” të kontratës, pika 34.1, shkronja (c), ku theksohet: “Për kontratat me periudhë zbatimi mbi 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës korresponduake të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës”.</p> <p>-Duke pasur parasysh se punimet e ndërtimit duhet të ishin përfunduar në datën 01.06.2019 dhe kanë kaluar 1,505 ditë nga data kur duhet të kishte përfunduar ndërtimi i investimit [214 ditë për vitin 2019; 366 ditë për vitin 2020; 365 ditë për vitin 2021; 365 ditë për vitin 2022 dhe 195 ditë për vitin 2023]</p>	I lartë	Pika 4.4 e RPA	<p>Bashkia Vlorë të kërkojë, ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e shumë 15,415,728 lekë TVSH nga shoqëria sipërmarrëse “C.” ShPK, si penalitet për punime të pakryera, parashikuar në afatet e kontratës nr. 1808 prot; datë 01.03.2019, me objekt “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + Sistem ngrohje”.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>nga palët e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes me nr. 1808 prot; datë 01.03.2019, nuk janë përmbushur kushtet e kësaj kontrate.</p> <p><u>Llogaritja e penalitetit:</u> Vlera e penalitetit nga llogaritja deri në momentin e dorëzimit të këtij akt-konstatimi, në datën 14.07.2023 për shoqërinë “C.” ShPK, rezulton 15,415,728 lekë me TVSH = [(44,489,454 (vlera e kontratës) – 3,517,418) x 25% x 1,505 ditë vonesë x 1/1000.</p> <p>Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1808 prot; datë 01.03.2019 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë dhe shoqërisë “C.” ShPK.</p> <p>- Palët, sipërmarrësi i punimeve shoqëria “C.” ShPK dhe, investitori/zhvilluesi Bashkia Vlorë, si nënshkruesit e kontratës, kanë dështuar në realizimin e kontratës me objekt: “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + sistem ngrohje” me nr. 1808 prot; datë 01.03.2019.</p> <p>Palët, duhej të kishin zbatuar:</p> <p>- Pikën 46.2 të Nenin 46 (Zgjidhja e mosmarrëveshjeve) të kontratës me nr. 1808 prot; datë 01.03.2019, ku thuhet: “Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë”.</p> <p>- Pikën 22 të kontratës për mbikëqyrje punimesh “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + Sistem ngrohje” me nr. 2110 prot; datë 21.03.2019, të lidhur ndërmjet Bashkisë Vlorë, përfaqësuar nga Kryetari, z. D. L. dhe shoqërisë “H. & SK. 11” ShPK e përfaqësuar nga ing. F. B., ku thuhet: “Për çdo mos marrëveshje palët duhet t’i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve”.</p> <p>- Pikën 22 të kontratës për mbikëqyrje punimesh “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + Sistem ngrohje” me nr. 8341 prot; datë 25.07.2022, të lidhur ndërmjet Bashkisë Vlorë, përfaqësuar nga Kryetari Z. D. L. dhe shoqërisë “R. 95” ShPK e përfaqësuar nga znj. R. N., ku thuhet: “Për çdo mosmarrëveshje palët duhet t’i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve”.</p>			
22	Referuar të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vlorë,	I lartë	Pika 4.4 e	Kryetari i Bashkisë Vlorë nëpërmjet Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të iniciojë

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>rezultoi se tarifa e ujitjes për vitin 2021 dhe vitin 2022 është në vlerën 3,983 mijë lekë, ndërsa realizimi i saj është 0%. Duke iu referuar VKB-së nr. 88 prot; datë 24.12.2020 i ndryshuar me VKB nr. 79 prot; datë 02.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë” tarifa për shërbimin e ujitjes llogaritet në vlerën 2,500 lekë/ha për çdo ujitje dhe struktura përgjegjëse për llogaritjen dhe vjeljen e saj është Ndërmarrja e Shërbimeve Publike (NSHP), Sektori i Ujitjes dhe Kullimit.</p> <p>Sipas dokumentacionit i vënë dispozicion pranë grupit të auditimit nga NSHP (<i>Spektori i Ujitjes dhe Kullimit</i>), rezulton së menaxhimi i kësaj tarife bëhet nga Organizatat e Përdorimit të Ujit (OPU). Aktualisht në territorin e Bashkisë Vlorë operojnë pesë OPU me vendndodhje në Lllakatund, Babicë, Kallafet, Llogara dhe Panaja. Kryetarët e OPU-ve pajisen nga NSHP, Sektori i Ujitjes dhe Kullimit me mandat arkëtime me qëllim prerjen e faturave për fermerët në momentin e marrjes së shërbimit.</p> <p>Nga shuma totale e mbledhur sipas librit të arkës i cili është administruar nga vetë OPU-të, rezulton se janë arkëtuar të ardhura nga tarifa e shërbimit të ujitjes në vlerën 847,600 lekë, vlerë e cila është e pa argumentuar duke marrë shkas nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga sektori i ujitjes i cili është jo bindës nga forma juridike . Gjithashtu rezulton se nga krahasimi i mandateve të pagesës me librin e arkës në disa raste janë aplikuar tarifa për 2 shërbime për ujitje dhe pagesa është llogaritur për 1 shërbim ujitje në të gjitha rastet specifikohet lloji shërbimit ujitje, konkretisht janë aplikuar me faturim të gabuar 99 raste me vlerë 198,300 lekë të paraqitura në aneksin nr. 1.</p> <p>Nga të dhënat të që janë vënë në dispozicion pranë grupit të auditimit nga sektori i ujitjes konkretisht libri i arkës dhe mandatet e pagesës të dy këto dokumente të pa formatizuara, rezulton se vlera prej 847,600 lekë nuk ka kaluar në asnjë nga strukturat e kontabilitetit të Bashkisë Vlorë ose NSHP Bashkia Vlorë prej 1,045,900 lekë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Bashkisë Vlorë.</p> <p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Bordit të kullimit sektori i ujitjes, është mbajtur procesverbal me nr. 660 prot; datë 01.12.2021 nga NSHP bordi i kullimit mbajtur nga F. Xh., me detyrë ish-përgjegjës i Sektorit të Ujitjes, ing. A. L., dhe specialistes M. Z., mbi rivlerësimin e sipërfaqeve të</p>		RPA	<p>në mision auditit në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë, mbi menaxhimin e tarifës së ujitjes për periudhën 2020 – 2023.</p> <p>Të shtohen burimet njerëzore pranë sektorit të ujitjes me qëllim që menaxhimi i shërbimit të ujitjes dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës të kryhet nga vetë Ndërmarrja Shërbimeve Publike. Të kryhen rakordimet ndërmjet strukturave , për të ardhurat e vjela nga shërbimi i ujitjes, ndërmjet sektorit të ujitjes dhe Drejtorisë së Financës së NSHP Bashkia Vlorë.</p> <p>Kryetari i Bashkisë Vlorë analizojnë situatën e krijuar dhe të nxjerrin përgjegjësitë administrative e ligjore ndaj personave përgjegjës që kanë shkaktuar efekt negativ financiar në shumën 19,830,420 lekë, duke kërkuar arkëtimin e vlerës në buxhet për periudhën 2021-2022 dhe jo vetëm.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>ujitura nga O.P.U-të në Bashkinë e Vlorës për vitin 2021. Sipas procesverbalit të mbajtur, sipërfaqe e planifikuar është për 750 hektar dhe sipërfaqe e ujitur e raportuar është 140 hektar, diferenca është 610 hektar ose në vlerën prej 1,525,000 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë.</p> <p>Gjithashtu nga dokumenti i vënë në dispozicion nga ana NSHP bordi i kullimit sektori i ujitjes rezulton se është lidhur akt-marrëveshje (kontratë përdorimi) me nr. 125 prot; datë 28.05.2018, akt-marrëveshje e lidhur nga drejtori i NSHP z. G. Sh. dhe kryetari i OPU Kallafet, z. L. Sh., rezulton se akt-marrëveshja konsiston në dokument e fotokopje, jo dokument origjinal i akt -marrëveshjes, nga ana formale e akt-marrëveshjes rezulton se është nënshkruar në fotokopjen e dokumentit nga Kryetari i OPU z. L. Sh., ndërsa nga ana e ish-Drejtorit të NSHP rezulton firmë dhe vulë fotokopje, gjë e cila nuk është në përputhje sipas kodit të procedurave administrative. Përsa i përket akt-marrëveshjes me nr. 125 prot; datë 28.05.2018, me OPU Panaja, rezulton se akt-marrëveshja është firmosur vetëm nga ana e ish-Drejtorit të NSHP z. G. Sh. dhe jo nga pala tjetër e kryetarit të OPU Panaja, z. L. M., marrëveshje e cila duhet të jetë e nënshkruar nga të dyja palët.</p> <p>Akt-marrëveshja me nr. 125 prot; datë 28.05.2018, e lidhur midis Kryetarit të OPU Babicë, z. S. M. dhe ish-Drejtorit z. G. Sh., rezulton të jetë firmosur nga ana e kryetarit OPU Babicë mbi fotokopjen e akt-marrëveshjes si në rastin e akt-marrëveshjes me OPU Kallafet. Ka funksionuar në të njëjtën mënyrë është ndjekur e njëjta metodologji edhe për akt marrëveshjen me nr. 125 prot; datë 28.05.2018, e lidhur ndërmjet kryetarit të OPU Llogara, z. H. I. dhe ish-Drejtorit të NSHP z. G. Sh., ku nënshkrimi nga ana e kryetarit të OPU Llogara, z. H. I., rezulton te jetë nënshkruar mbi fotokopje të akt- marrëveshjes, dokument i cili nga ana formale nuk përputhet me përcaktimet e kodit të procedurave administrative. Përsa i përket OPU Llakatund, duke iu referuar dokumenteve të vëna në dispozicion, nuk rezulton të jetë lidhur akt-marrëveshje. Nga auditimi arrihet në konkluzion se akt-marrëveshjet e nënshkruara nga palët nuk i plotësojnë elementët e sigurisë të një akti administrativ pasi nënshkrimi në fotokopjen e tij nuk vërteton origjinalitetin e një akti administrativ.</p> <p>Veprime në kundërshtim me VKB-së nr. 88 prot; datë 24.12.2020, i ndryshuar, me VKB nr.79 prot;</p>			

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	02.12.2021, pika 5. Në kundërshtim me Ligjin nr. 24/2017, datë 09.03.2017, “Për Administrimin e Ujitjes dhe Kullimit”; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 4, pika 26, “Dokument financiar” është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumenti elektronik rregullohet me Ligjin nr. 10273, datë 29.4.2010 “Për dokumentin elektronik”.			
23	Nga auditimi rezulton se, qytetarët/individët që kanë përfituar legalizimin e sipërfaqeve të caktuara nuk kanë paguar rregullisht detyrimin ndaj Bashkisë Vlorë për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Përkatesisht për vitin 2021 nuk kanë paguar detyrimin 434 qytetarë me vlerë totale 13,284,459 lekë, ndërsa nuk kanë paguar ende detyrimin 1371 individë/qytetarë për sipërfaqet e legalizuara përpara vitit 2021 (2015-2020) me vlerë totale 41,994,742 lekë. Në total vlera e detyrimeve nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton në 66,356,042 lekë për 2185 objekte të legalizuara, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Vlorë. Rezulton se nga asnjë strukturë e Bashkisë Vlorë nuk është marrë asnjë masë për të rritur nivelin e pagesave lidhur me këtë taksë. Gjithashtu, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit nuk dërgon në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit informacion lidhur me detyrimet që kanë ndaj Bashkisë qytetarët që kanë përfituar nga procesi i legalizimit. Si rezultat këto detyrime nuk janë të kontabilizuara. Të dhëna lidhur me numrin e debitorëve nuk dërgohen as në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore Sektorit i Borxhit i cili nuk ka informacion lidhur me numrin e debitorëve për taksën e ndikimit në infrastrukturë si dhe vlerën progresive të borxhit.	I lartë	Pika 2.6 e RPA	Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e të Ardhurave mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 2185 personave në vlerën 66,356,042 lekë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Bashkia Vlorë nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të bashkëpunojë me Drejtorinë Rajonale të ASHK Dega Vlorë për të gjithë subjekte që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e legalizimit nga ndërtimet informale, të kërkohet mos lëshimi i lejes së legalizimit dhe në rast të dhënies të kërkohet vendosje barrë sigurie deri në kryerjen e pagesave për taksën e ndërtimit
24	Nga auditimi konstatohet se detyrimi që familjet kanë për taksën e tokës bujqësore në Bashkinë Vlorë	I lartë	Pika 2.6 e RPA	Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>është borxhe i krijuar gjatë vitit 2021 në vlerën 28,499,682 ndërsa borxhi progresiv më datë 31.12.2021 është 239,572,808 lekë. Borxhi i krijuar gjatë vitit 2022 është 27,574,416 dhe borxhi progresiv me datë , 31.12,2022 është 261,840,252 lekë, e cila përbënë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë. Referuar të dhënave të tabelave të mësipërme rezultojnë se debitorët e taksës së tokës kanë ardhur duke u rritur, çka tregon se puna e Sektorit të Menaxhimit të Tokës dhe e NJA-ve nuk është në nivelet e duhura, pasi ka munguar përgjegjësia dhe vëmendja e duhur për vjeljen e taksës së tokës, gjë të cilën e tregon niveli i lartë i debitorëve nga viti në vit. Vlera e detyrimit për debitorët e tokës bujqësore në asnjë nga Njësitë Administrative nuk është e kontabilizuar dhe e mbajtur sipas standardeve të kontabilitetit, duke mos pasqyruar situatën reale.</p>			<p>Sektorin e Menaxhimit të Tokës në Drejtorinë e Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrimit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK dhe Qarku Vlorë), të nxjerrin njoftim detyrimet për familjet me sipërfaqe 15,666 ha lënë jashtë skemës së pagesës së taksës së tokës bujqësore për vitet 2021 dhe 2022, për vlerën 261,840,252 lekë.</p> <p>Të kryhet rakordimi i regjistrave të fermerëve që përdorin tokën bujqësore, midis Sektorin e Menaxhimit të Tokës në Drejtorinë e Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve dhe inspektorëve të Drejtorisë së të Ardhurave Vendore në Njësitë Administrative dhe këto regjistra që ndjekin agronomët e njësitë administrative, t’ju jepet forma ligjore duke u ndërtuar regjistri me detyrimet që nga momenti i lindjes së të drejtës për përdorimin e tokë bujqësore, përfshirë këtu edhe kamatëvonesat të llogaritura sipas Ligjit për procedurat tatimore. Drejtoria e të Ardhurave Vendore të njoftojë me njoftim vlerësimi të gjithë fermerët/individët debitorë për taksën e tokës bujqësore, mbasi këto të dhënë të jenë dorëzuar nga agronomët e DPPMA.</p>
25	<p>Nga auditimi rezultojnë se deri më datë 31.12.2020 Ujësllësi ka patur detyrime ndaj Bashkisë në vlerën 111,321,816 lekë. Gjatë vitit 2021 niveli i arkëtimit për taksën e banesës është 98,874,399 lekë ndërsa për tarifën e pastrimit / gjelbërimit / ndriçimit është 102,767,072 lekë, në total 201,641,471 lekë. Në këto vlera arkëtimesh janë të përfshira edhe detyrime të familjeve për vitet përpara vitit 2021. Nga të dhënat që administrojnë UK Vlorë nuk është e mundur të ndahet vlera e arkëtimit që i përket vitit 2021, si rrjedhojë vlera e arkëtimit është progresive. Detyrimet që Ujësllësi ka ndaj Bashkisë janë në vlerën 306,914,041 lekë (111,321,816 të mbartura + 195,592,225 viti 2021). Gjatë vitit 2021 shuma e kaluar nga Ujësllësi ndaj Bashkisë është 210,475,773 lekë dhe detyrimet progresive që</p>	I lartë	Pika 2.6 e RPA	<p>Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, Bashkia Vlorë, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për rishikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me UK sha Vlorë për një menaxhim më të mirë të taksave e tarifave nga abonentët familjarë, si dhe të kërkojë në rrugë ligjore e administrative arkëtimin e vlerës së detyrimit të arkëtuar nga UK sha Vlorë por të palikujduara në llogarinë e Bashkisë për vlerën 97,523,383 lekë.</p> <p>Në cdo rast të mos derdhjes së detyrimeve të arkëtuara nga UK sha Vlorë apo të pa mbledhura (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjatëmbajtjen e Agjentit Tatimorë me 50% të shumës së plotë të</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>Ujësjetllësi ka kundrejt Bashkisë Vlorë më datë 31.12.2021 janë 96,438,269 lekë.</p> <p>Nga auditimi rezulton se deri më datë 31.12.2021 Ujësjetllësi ka patur detyrime ndaj Bashkisë në vlerën 96,438,269 lekë. Gjatë vitit 2022 niveli i arkëtimeve nga UK Vlorë për taksën e banesës është 107,345,721 lekë ndërsa për tarifat e pastrimit/gjelbërimit/ndriçimit është 108,929,489 lekë, në total 216,275,210 lekë. Në këto vlera arkëtimeve janë të përfshira edhe detyrime të familjeve për vitet përpara vitit 2022. Nga të dhënat që administron UK Vlorë nuk është e mundur të ndahet vlera e arkëtimeve që i përket vitit 2022, si rrjedhojë vlera e arkëtimeve është progresive. Detyrimet që Ujësjetllësi ka ndaj Bashkisë janë në vlerën 306,225,416 lekë (96,438,269 të mbartura + 209,787,147 viti 2021). Gjatë vitit 2022 shuma e kaluar nga Ujësjetllësi ndaj Bashkisë është 208,702,033 lekë dhe detyrimet progresive që Ujësjetllësi ka kundrejt Bashkisë Vlorë më datë 31.12.2022 janë 97,523,383 lekë.</p>			<p>taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.</p> <p>Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Rajoneve dhe të Njësive Administrative, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore si edhe të hartohet regjistri i familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim rritjen e të ardhurave.</p>
26	<p>Referuar strukturës së DAV Bashkia Vlorë, konstatohet se menaxhimi i borxhit bëhet nga Sektori i Menaxhimit të borxhit i përbërë nga 2 inspektor.</p> <p>Nga auditimi i të dhënave, rezulton se gjendja e debitorëve në fund të periudhës 31.12.2022 paraqitet në vlerën 768,711 mijë lekë kjo për 52767 subjekte.</p> <p>Referuar të dhënave, konstatohet se niveli i borxhit nga një periudhë në tjetër vjen në rritje si në numër subjektësh po ashtu dhe në vlera, kështu nga viti 2021 në vitin 2022 ky nivel është rritur për vlerën 22,835,138 lekë, si dhe numër i subjekteve 1056 subjekte.</p> <p>Gjithashtu dhe niveli i arkëtimeve paraqitet me ulje në vlerën 11,616 mijë lekë. Ku për vitin 2021 është arkëtuar vlera 94,826 mijë lekë të debisë së vitit 2020 për vlerën 376,873 mijë lekë ose 25% dhe për vitin 2022 është arkëtuar vlera 83,210 mijë lekë të vlerës së detyrimeve të vitit 2021 ose 20.8%.</p> <p>Ndërsa në total duke marrë në konsideratë dhe debitorët familjarë, kjo diferencë është akoma më e madhe për shumën 116,585 mijë lekë për 21268 subjekte/abonentët familjarë, për vitet 2021/2022.</p> <p><u>Totali i debisë për bashkinë Vlorë është 59.1% e planit të taksave e tarifave vendore dhe 33.4% e planit të buxhetit. Pra këto të dhëna tregojnë se vlera e detyrimeve debitorë është në nivel shumë të larta, ku peshën kryesore e zënë debitorët familjar në</u></p>	I lartë	Pika 2.6 e RPA	<p>Bashkisë Vlorë, si Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit, Drejtorinë Juridike, Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit, të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve debitorë në vlerën 768,711,442 lekë kjo për 52767 subjekte/abonent familjare, për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit të keq që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.</p> <p>Kryetari i Bashkisë Vlorë të marrë masa për rritjen e numrit të inspektorëve në sektorin e menaxhimit të borxhit si një sektor shumë i rëndësishëm arkëtimin e të ardhurave në buxhetin e Bashkisë.</p> <p>Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrin masa për ndryshimin e Rregullores së brendshme të Bashkisë Vlorë, ku të përcaktohen qartë Drejtoritë/ Sektorët që do merren me menaxhimin e të ardhurave që rrjedhin nga subjektet fizik/juridike/abonentë familjarë (nëpërmjet agjentëve)/kontratat e qirave të asetëve, tokave bujqësore, subjekteve që shfrytëzojnë karriera, si dhe të gjitha</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p><u>shumën 369,758 mijë lekë ose 48% e totalit të detyrimeve.</u></p> <p>Referuar të dhënave, vlerën më të lartë të borxhit e zënë debitorët e moshës mbi 5 vite për vlerën 222,551 mijë lekë ose <u>55.7%</u> e ndjekur nga borxh i keq (pa shpresë arkëtimi) për <u>1285</u> subjekte me vlerë 123,506 mijë lekë ose 30% e totalit të debitorëve për taksat/tarifa vendore.</p> <p>Gjithashtu, nga të dhënat e disponueshme, konstatohet se për periudhën objekt auditimi, ka dhe subjekte të cilat janë me status pasiv ose të çregjistruar nga QKB, por që nuk kanë bërë të mundur likuidimin e detyrimeve për taksat e tarifat vendore. Kështu për vitin 2021 janë <u>3541</u> subjekte me vlerë 264,443 mijë lekë ose <u>70.2%</u> totali të detyrimeve nga taksat/tarifat vendore dhe për vitin 2022 janë <u>3127</u> subjekte me vlerë 238,347 mijë lekë ose <u>59.7%</u> e totalit të detyrimeve nga taksat/tarifat vendore.</p> <p>Referuar dokumentacionit të paraqitur nga DAV Bashkia Vlorë për vitet 2021/2022 dhe kundërshtive të subjektit, rezulton se nga kjo administratë (Sektori i borxhit), janë ndërmarrë këto hapa për vjeljen e debitorëve, konkretisht:</p> <p><u>Për vitin 2021</u> kemi patur objekt pune 5142 debitore me shume 376,837,175 lekë, nga këto subjekte:</p> <p>Për 4323 debitore = 1230 debitore për vitin 2021 + 3093 debitore për periudhën 2011-2020 me shumë totale 307,045,135 lekë janë kryer procedurat e borxhit, ndërsa për 819 debitorë me shumë 6,385,824 lekë nuk janë bërë procedurat e borxhit, pasi jane debitore me vlere nën 1,000 lekë (<i>procedure që nuk justifikon shpenzimet kancelarie, duke patur parasysh se për një subjekt duhen dërguar me poste rreth 16 praktika shkresore</i>).</p> <p>Pra numri i masave të marrë nga sektori borxhit është ne masën 84 % te nr. total të debitorëve .</p> <p><u>Për vitin 2022</u> kemi patur objekt pune 6190 debitore me shume 398,953,004 lekë, nga këto subjekte:</p> <p>Për 5272 debitore = 1587 debitore për vitin 2022 + 3685 debitore për periudhën 2011-2021 me shumë 392,479,247 lekë, janë kryer procedurat e borxhit, ndërsa për 918 debitorë me shumë 6.473757 lekë, nuk janë bërë procedurat e borxhit, pasi jane debitore me vlere nën 1000 lekë (<i>procedure që nuk justifikon shpenzimet kancelarie, duke patur parasysh se për një subjekt duhen dërguar me poste rreth 16 praktika shkresore</i>).</p>			aktivitet që burojnë të ardhura për bashkinë.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>Pra numri i masave të marre nga sektori ynë është në masën 85.2 % të nr. total të debitorëve.</p> <p>Duke vlerësuar riskun e praktikave të menaxhimit të borxhit u përzgjedhën disa raste për auditimin e procedurave që janë kryer, <i>rezultoi se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Për Institucionet shtetërore, të identifikuar si debitorë është ndjekur vetëm procedura e nxjerrjes së Njoftimit për Pagesë të Detyrimeve Tatimore dhe nuk është vazhduar me asnjë procedurë tjetër. - Nuk gjen zbatim ndryshimi ligjor i nenit 89¹ i ligjit të procedurave tatimore. - Nuk janë ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar kallëzim penal bazuar në nenin 181 “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar. 			
27	<p>Referuar të dhënave të përcjellë nga AKB me posten elektronike zyrtare datë 7.7.2023 me të dhënat e disponuara dhe vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, rezulton se për vitin 2021 dhe vitin 2022 kanë ushtruar aktivitet duke kryer dhe pagesat e sipërfaqeve të plazhit, disa subjekte të cilat nuk janë konfirmuar nga Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve (GTSHA) dhe AKB, <u>pra janë lëshuar mandat pagesa për subjekte të pamiratuara në AKB</u>, veprime këto në shkëlqje të VKM nr. 1172, datë 24/12/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 171, datë 27/03/2019 “Për miratimin e rregullores, për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacioneve të plazhit”, pika 5 dhe 10. Konkretisht për vitin 2021 janë 51 persona të cilat kanë kryer pagesë për stacione plazhi, por të pamiratuara në AKB. Ndërsa për vitin 2022 janë 50 persona të cilat kanë kryer pagesë për stacione plazhi, por të pamiratuara në AKB.</p>	I lartë	Pika 2.6 e RPA	<p>Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Strukturën Përgjegjëse të Menaxhimit të Stacioneve të plazhit dhe Drejtorinë e të Ardhurave Vendore Bashkia Vlorë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në arkëtimin e vlerës 14,178,600 lekë, si ardhur e munguar, nga e cila:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlera 6,258,100 lekë për 27 subjekte të vitit 2021, si diferencë midisi mandate pagesave të lëshuara nga bashkia dhe pagesave të kryera nga subjekti. - Vlera 5,888,000 lekë për 25 subjekte të vitit 2022, si diferencë midisi mandate pagesave të lëshuara nga bashkia dhe pagesave të kryera nga subjekti. <p>Vlera 2,032,500 lekë për 12 subjekte, si diferencë sipërfaqe midisi asaj të kontraktuar dhe sipërfaqes së konstatuar nga kontrolli në terren.</p>

¹; “ Në funksion të mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit, administrata tatimore mund të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume **jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar**, por jo më shumë se detyrimi tatimor, për të cilin ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, për llogari të detyrimeve tatimore të pashlyera të tatimpaguesit”

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>Nga përpunimi i të dhënave është evidentuar se për 54 subjekte tarifa e qirasë së Stacionit të plazhit nuk është sipas mandatpagesave, kjo për vlerën 12,146,100 lekë, e ardhur e munguar, ku për vitin 2021 janë 27 subjekte me vlerë 6,258,100 lekë dhe për vitin 2022 për 25 subjekte me vlerë 5,888,000 lekë.</p> <p>Për vitin 2021 janë 38 subjekte dhe në vitin 2022 janë 32 subjekt, janë lëshuar fatura pagesë për sipërfaqen së plazhit pa bërë me parë pagesën e taksave lokale dhe paraqitur vërtetim përkatës.</p> <p>Nga auditimi i dokumente të paraqitur, rezulton se sipas verifikimit në terren të kryer nga grupet e punës ngritur me urdhëron nr. 72, datë 02/04/2022 (prot 3416), të Kryetarit të Bashkisë është evidentuar se disa subjekte shfrytëzoni më shumë sipërfaqe se ajo e miratuar si nga AKB dhe nga Bashkia Vlorë, <u>por që nga Bashkia Vlorë (personat përgjegjës), nuk është bërë i mundur llogaritja e tarifës për sipërfaqen shtesë të shfrytëzuar, kjo për 12 subjekte me vlerë 2,032,500 lekë e cila konsiderohet të ardhura të munguara për bashkinë Vlorë.</u></p>			
28	<p>Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në një rast nuk janë respektuar përcaktimet ligjore në lidhje me kontributin që sektori privat duhet të ofrojë përkundrejt fondit publik të banesave sociale, për ato raste kur subjekti zhvillues është përdorues i të drejtës së zhvillimit me Intensitet Ndërtimi me Kusht. Nga shfrytëzimi i kësaj të drejte nga ana e subjektit zhvillues “F. I.” ShPK, Bashkia Vlorë do të duhej të përfitonte një sipërfaqe prej 299.86 m² (me vlerë shitjeje 299.86 m² * 61.800 lekë/m² = <u>18.531.348 lekë</u>). Palët kanë rënë dakort që ky përfitim të merret si investim publik, më konkretisht, si investim për rehabilitimin e rrugës “Xher Rashimi”. Sipas marrëveshjes midis Bashkisë Vlorë dhe subjektit zhvillues “F. I.” ShPK, datë 04.04.2022, nr. 2145/1 prot; DPKZHT ka përpiluar projektin për rehabilitimin e rrugës, duke e preventivuar atë më vlerë totale prej <u>8.633.559 lekë</u>. Rezulton se vlera e shitjes së sipërfaqes së sipërfaqes së përfituar nga Bashkia Vlorë është më e madhe se vlera e preventivuar për rrugën “Xher Rashimi”, më konkretisht, diferenca është 9.897.789 lekë, vlerë e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Vlorë.</p>	I lartë	Pika 5 e RPA	Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, të marrë masa për të rivlerësuar kontratën me subjektin zhvillues “F. I.” ShPK, për " <i>Objekt banimi dhe shërbimi me 3 dhe 10 kate mbi tokë dhe papafingo, me 1 kat nën tokë</i> " me adresë rr. " <i>Gjergj Kastrioti</i> ", Vlorë, subjekt i cili ka përdorur të drejtën e ndërtimit me Intensitet me Kusht. Bashkia Vlorë të ballafaqojnë vlerën e shitjes së sipërfaqes së përfituar me vlerë tregu me preventivin e investimit për të cilin palët kanë rënë dakort ndërmjet tyre, si dhe të marrin të gjitha masat për të bërë të mundur arkëtimin e vlerës prej 9,897,789 lekë .

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
29	<p>Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 3 (tre) raste të audituara, përlllogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është kryer e saktë, si dhe një njërin prej këtyre rasteve, ka mangësi në dokumentacion. Në një rast, më konkretisht për objektin "Godinë banimi dhe shërbimi 8 kate + papafingo me 1 kat nëntokë, në rrugën 'Ibrahim Avdullai', Bashkia Vlorë" me subjekt zhvillues "A. K." ShPK dhe z. F. H., taksa e ndikimit në infrastrukturë është përlllogaritur me vlerë të munguar prej <u>12.670.221 lekë</u>. Në një rast tjetër, për "Kompleks me funksion hoteleri dhe shtëpi të dyta, me 5 kate dhe 1 kat nën tokë", me adresë Radhimë, Vlorë, me subjekt zhvillues "I. & AG C." ShPK, taksa e ndikimit në infrastrukturë është përlllogaritur me vlerë të munguar prej <u>446.758 lekë</u>, gjithashtu në këtë rast nuk është ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve mandat-pagesa e TNI-së, sipas përlllogaritjes së Bashkisë Vlorë, me vlerë prej <u>11.210.000 lekë</u>. Në një rast tjetër, për "Objekt banimi dhe shërbimesh me hoteleri dhe pishina 6-8 kate, me 2 kate nën tokë", me adresë rr. "Llambro Rexho", Vlorë, me subjekt zhvillues "T.M.Z.B" ShPK, taksa e ndikimit në infrastrukturë është përlllogaritur për një objekt me funksion miks banim, shërbim dhe hoteleri, me vlerë 16,500,516 lekë, kur në këtë objekt nuk evidentohet pjesa takuese me funksion hoteleri, përlllogaritje e cila jep një vlerë më të vogël të TNI-së. Nëse do të bëhet përlllogaritja për këtë objekt, duke e konsideruar të gjithin me funksion banim dhe shërbime, vlera e saktë e TNI-së do të ishte 31.956.532,6 lekë. Diferenca prej 15.456.017,1 lekë përbën të ardhur të munguar institucionin e Bashkisë Vlorë. Gjetjet e konstatuara më sipër janë në kundërshtim me Ligjin 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Neni 46.</p>	I lartë	Pika 5 e RPA	<p>Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës <u>12,670,221 lekë</u>, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti zhvillues "A. K." ShPK dhe z. F. H.</p> <p>Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës <u>446,758 lekë</u>, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti zhvillues "I. & AG C." ShPK.</p> <p>Gjithashtu, Bashkia Vlorë duhet të vendosi në dispozicion të grupit të auditimit mandat-pagesën e vlerës prej <u>11,210,000 lekë</u>, vlerë të cilën Bashkia Vlorë pretendon se është paguar nga subjekti zhvillues, në të kundërt, edhe kjo vlerë do të konsiderohet e papaguar dhe e ardhur e munguar.</p> <p>Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të marrë të gjitha masat për të monitoruar zhvillimin e "Objekt banimi dhe shërbimesh me hoteleri dhe pishina 6-8 kate, me 2 kate nën tokë", me adresë rr. "Llambro Rexho", Vlorë, me subjekt zhvillues "T.M.Z.B" ShPK, sipas funksioneve të përcaktuara në projektin ndërtimor, si dhe të informojë grupin e auditimit kur ky subjekt të aplikojë për pajisje me çertifikatë përdorimi. Në rast se ky subjekt nuk siguron përfshirjen e shërbimit hoteleri brenda objektit në zhvillim, Bashkia Vlorë të marrë të gjitha masat për arkëtimin e vlerës prej <u>15,456,017 lekë</u>, e cila do të konsiderohet e ardhur e munguar.</p>

I.2. Konkluzion i Përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit

- Në përfundim të auditimit të pasqyrave financiare (bilance) të vitit 2022, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një ***opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes***, për llogaritë vjetore të Bashkisë Vlorë, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura.

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.07.2021 – 31.12.2022, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), kanë rezultuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, si në aplikimin e kriterëve të paargumentuara me tipologjinë e procedurës, po ashtu dhe në shpalljen fitues të OE/BOE të cilët nuk janë në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK.

Gjithashtu:

- Në mos menaxhimin e mirë të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, si në planifikim dhe arkëtim, duke evidentuar të ardhura të munguara me vlerë **1,369,491 mijë lekë**, nga e cila **768,711 mijë lekë** borxh tatimorë dhe **610,978,440 mijë lekë** mungesë të ardhurash.

- Në zbatimin e kontratave të punëve publike, janë konstatuar parregullsi në afatin e zbatimit të kontratave dhe zbatimit të punimeve, duke evidentuar një dëmi ekonomik në vlerën **19,830,420 lekë**.

- Në mos llogaritjen e saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë për subjektet të pajisur me leje ndërtimi për vlerën **38,471 mijë lekë**. Gjithashtu në dhënien e lejeve të ndërtimit janë konstatuar shkelje në lidhje distancat, dokumentacionin teknik/ligjor, etj.

- Në mos marrjen e masave për regjistrimin e pronave të bashkisë kaluar me VKM në pronësi të saje.

Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt akordimin me thesarin, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre, duke prekur zonat e llogarive, 600-paga; 202- Studime dhe kërkime; 401-408-Furnitorë e llogari të lidhura me to; 467-Kreditorë të ndryshëm; 602-shpenzime operative; 215-Mjete transporti; 218-Inventar ekonomik; 32-Objekte inventari dhe 230- 231-investime, të cilat në gjykimin e grupit të auditimit të KLSH janë materiale dhe të përhapura, bazë për dhënien e ***një opinionit të kundërt***, në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.

OPINIONI AUDITIMIT

a. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:

Grupi i auditimit auditoi pasqyrat financiare të Bashkisë Vlorë, për vitin ushtrimor 2022, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

“Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Vlorë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në

gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit “të modifikuar me rezervë”.

Baza për opinionin:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik dhe Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit”, pjesë e Raportit Përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura.

Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme për dhënien e opinionit tonë (ISA 700-ISSAI 1700). Gjithashtu, dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 45,512 mijë lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2022, si dhe anomalitë e mëposhtme:

- **52** projekt-studime për investime të kryera gjatë viteve për vlerën 115,857,512 lekë, nuk është bërë i mundur shpërndarja sipas llojit të aktiveve materiale, ku për projektet e vënë në zbatim pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme, për vlerat duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së projekteve si vlerë e shtuar e çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve.

Gjithashtu vlera prej **9,812,760 lekë** e emërtuar “Të tjera”, nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson.

- Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” konstatohet se janë kontabilizuar gabim **21** artikuj aktive materiale në vlerën 139,985,242 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në vlerën 83,080,542 lekë, llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” në vlerën 56,904,700 lekë.

- Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*”, konstatohet se janë kontabilizuar gabim **31** artikuj aktive materiale në vlerën 76,464,190 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 202 “*Studime e kërkime*” në vlerën 887,760 lekë, llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” në vlerën 42,144,484 lekë, llog. 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” në vlerën 22,735,016 lekë, llog. 214 “*Instalime teknike makineri e paisje*” në vlerën 10,696,930 lekë. Gjithashtu vlera prej **37,387,815** lekë e emërtuar “Të tjera”, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson.

4. Llogaria 466 “*Kreditorë për mjetet në ruajtje*”, në pasqyrat financiare paraqitet në vlerën kontabël 65,660,528 lekë e rakorduar me Degën e Thesarit. Sipas analizës së kësaj llogarie, kjo llogari për vitin 2022 është shtuar për **22** objekte për vlerën 6,655,526 lekë, dhe është pakësuar në **16** objekte për vlerën 3,595,838 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë ngurtësuar fonde për vlerën 62,600,940 lekë të cilat i përkasin ngurtësimeve të garancinë të punimeve për periudhën 2021 e para, të cilave u ka

kaluar afati i garancisë. Bashkia Vlorë nga ana e sajë nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për c'bllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre për interes publik.

Opinionin mbi përputhshmërinë për periudhën 01.07.2021 – 31.12.2022.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Vlorë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një “opinionit të kundërt”.

Baza për opinionin

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.07.2021 – 31.12.2022, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), kanë rezultuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, si në aplikimin e kriterëve të paargumentuara me tipologjinë e procedurës, po ashtu dhe në shpalljen fitues të OE/BOE të cilët nuk janë në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK.

Gjithashtu:

- Në mos menaxhimin e mirë të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, si në planifikim dhe arkëtim, duke evidentuar të ardhura të munguara me vlerë **1,369,491 mijë lekë**, nga e cila **768,711 mijë lekë** borxh tatimorë dhe **600,780 mijë lekë** mungesë të ardhurash.

- Në zbatimin e kontratave të punëve publike, janë konstatuar parregullsi në afatin e zbatimit të kontratave dhe zbatimit të punimeve, duke evidentuar një dëmi ekonomik në vlerën **19,830,420 lekë**.

- Në mos llogaritjen e saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë për subjektet të pajisur me leje ndërtimi për vlerën **38,471 mijë lekë**. Gjithashtu në dhënien e lejeve të ndërtimit janë konstatuar shkelje në lidhje distancat, dokumentacionin teknik/ligjor, etj.

- Në mos marrjen e masave për regjistrimin e pronave të Bashkisë kaluar me VKM në pronësi të sajë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Vlorë:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë dhe NSHP, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuar (kriteret e vlerësimit). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullativ në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë dhe NSHP janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin e skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë në vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë në vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1026/1 Prot, datë 15.11.2022, miratuar nga Kryetari i KLSH^{se}, i ndryshuar me nr. 1026/2 Prot, datë 19.12.2022, nr. 1026/3 Prot, datë 13.01.2023, nr. 1026/4 prot; datë 30.01.2023, nr. 1026/5 prot; datë 27.03.2023, 1026/6 prot; datë 09.05.2023, nr 1026/7., nr. 1026/8 prot; datë 19.06.2023, nga data 15.11.2022 deri në datë 14.07.2023, në subjektin Bashkia Vlorë u krye auditimi Financiar për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.07.2021 – 31.12.2022.

Grupi i auditimit përbëhet nga audituesit:

1. **S. M.**, *Përgjegjës Grupi*
2. **P. Xh.**, *Anëtar*
3. **S. D.**, *Anëtar*
4. **V. B.**, *Anëtar*
5. **R. F.**, *Anëtar*
6. **K. Gj.**, *Anëtar*
7. **R. A.**, *Anëtar*

a- Titulli: Auditim financiar dhe përputhshmërie në Bashkinë Vlorë.

b- Marrësi: Bashkia Vlorë.

c- Objekti i auditimit, është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, të transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Në auditimin e përputhshmërisë për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022 synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve,

politikave, kodeve të vendosura apo termave në fushën e prokurimeve publike, në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, në dhënien e lejeve të ndërtimit, në menaxhimin e aseteve, etj.

d- Qëllimi i auditimit, është dhënia e opinionit dhe hartimi i Projekt Raport Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale ose jo dhe në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)².

Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, në mbështetje të ISSAI 1700, ne synojmë të japim opinionin tonë mbi pasqyrat financiare, të shpenzimeve operative dhe investimeve mbi bazën e procedurave të prokurimit të realizuara për to, si dhe menaxhimin e të ardhurave, bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.

e- Identifikimi i çështjes: Ky Raport Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësitë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Vlorë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektesë dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

f- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar. Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjës për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin për auditim e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

g- Përgjegjësitë e Audituesve. Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit dhe menaxhimit të të ardhurave në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryej auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

h- Kriteret e vlerësimit.

- Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

²Në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27/11/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30/06/2015 e ndryshuar;
- ✓ Rregullore e Brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së ndryshuar me nr. 63, datë 22/06/2020;
- ✓ Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- ✓ Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi “Auditimin e përputhshmërisë”, Manualët e Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë, të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit;
- ✓ Ligji nr. 68/2017, datë 27/04/2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”;
- ✓ Ligji nr. 137/2020, datë 16/11/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar dhe aktet normative që e ndryshojnë këto ligje;
- ✓ Udhëzimin i MF nr. 22, datë 30/07/2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar;
- ✓ Udhëzimi i MF nr. 26, datë 27/12/2007, “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006”;
- ✓ Udhëzimi i MF nr. 5, datë 21/02/2022 ” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme“;
- ✓ Ligji nr. 162/2000, datë 23.12.2000 “Për Prokurimin Publik”; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe Udhëzimi i APP nr. 2, datë 24.04.2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”; etj. dhe kuadri rregullues i brendshëm i bashkisë.
- ✓ VKM-së 408, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit “,
- ✓ Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.

h- Standardet e auditimit:

- ✓ ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ✓ ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ✓ ISSAI 4000 "Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë"; si dhe ISSAI 4200;
- ✓ Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- ✓ Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t,
- ✓ INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.
- ✓ Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.

i- Metodatat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit: Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar, në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;

b. *Raportet dhe informacionet* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;

c. *Verifikimi në sistemin elektronik* - me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

d. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në vlerën **45,512 mijë lekë** për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruar nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-ja aplikon³.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e

³ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe së fundi kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësive shpenzuese.

j- Dokumentimi i auditimit: Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

2.1. Informacioni i Përgjithshëm:

Vlora është qytet i lashtë dhe porti jugor i Adriatikut. Sipas regjistrimit të vitit 1999 popullsia e Vlorës është mbi 102.000 banor. Gjiri i Vlorës është i cekët ku thellësia shkon në 5 m pas 1 km larg bregut dhe 10 m pas 2 km larg bregut. Vlora ka një pozicion të favorshëm, në kryqëzimin e rrugëve tokësore, detare dhe ajrore në të gjithë rajonin.

Distanca nga kryeqyteti i vendit, Tirana, është 135 km, ndërkohë që vetëm 72 km e ndajnë nga Italia dhe 77 milje nga Greqia.

Qyteti i Vlorës shtrihet ndërmjet Ujit të Ftohtë dhe Zvërnecit.

Rrafshi mbi të cilin ngrihet qyteti i Vlorës ka lartësi nga 6 m deri në 76 m mbi nivelin e detit dhe përfaqëson një nivel bazë kontinental, ende aktiv.

Ndërsa gjatësia e përgjithshme e vijës bregdetare është 90 km, nga grykëderdhja e Vjosës deri në Karaburun.

Aktualisht, qyteti i Vlorës vazhdon të zgjerohet në të gjitha drejtimet e veçanërisht drejt Bregut të Detit, sidomos drejt Ujit të Ftohtë dhe Jonufrës.

Kushtet gjeomorfologjike midis Nartës dhe Plazhit të Vjetër nuk lejojnë avancimin e shpejtë të qytetit drejt bregdetit. Këtu ndikon ekzistenca e sektorëve moçalor si dhe qëndrueshmëria e dobët e bazamentit të tokës. Njohja e ligjeve natyrore të zhvillimit të zonës bregdetare si dhe ndryshimet e provokuara nga ndërhyrja e njeriut përbëjnë sot një ndër problemet më kryesore për mbrojtjen dhe shfrytëzimin racional të saj.

2.2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

Pika 1 e programit: Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësive. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1 “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”

- Bashkia Vlorë ka miratuar Rregulloren e Brendshme të Bashkisë me Vendimin nr. 101, datë 11.09.2018 ,të Kryetarit të Bashkisë . Njohjen e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi

kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria Juridike, por nuk ka trajnime për këto raste.

-Bashkia Vlorë nuk ka Kod të Etikës, por në nenin 20 e në vijim të Rregullores së Brendshme të kësaj Bashkie , është përfshirë edhe “ Etika për punonjësit e Bashkisë Vlorë dhe kodi i veshjes “. Në lidhje me parimin 2 “Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë përcaktuar që në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të tij.

- Nga drejtoritë ka raporte periodike , mujore , për realizimin e të ardhurave të veta të Bashkisë Vlorë me format të miratuar me Drejtorinë e Tatim Taksave apo Drejtorinë Ekonomike me marrëdhëniet me Degën e Thesarit .

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga 5 njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë, por ka akt rakordime për realizimin e shpenzimeve gjatë muajve.

- Në bazë të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” nenin 19 dhe 29, dhe shkresave përkatëse të Ministrisë së Financave nga Bashkia është plotësuar dhe dërguar pranë Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pranë Ministrisë së Financave“ Pyetësori e vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm ” për vitin 2021 me shkresën nr. 2663 prot, datë 15.03.2022, për vitin 2022 është dërguar në ministrinë e financave raporti vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm dhe pyetësori i vetëvlerësimit me nr. 21765/1 prot datë 24/11/2022. Gjithashtu është nënshkruar dhe deklarata e cilësisë me nr. 2153/1 prot, datë 22/02/2023 nën përgjegjësin e drejtorit të buxhetit dhe financës në mungesë të koordinatorit të riskut i cili ka zgjidhur marrëdhëniet e punës me Bashkinë Vlorë. Titullari i Institucionit merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, nga Auditimi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë së audituese si dhe nga Projekti i Bashkive të Forta.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”.

- Është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti i PBA. *Bashkia Vlorë ka miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 64 , datë 31.08.2017 , miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 1, datë 16.10.2017.* Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

- Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e planit strategjik, nuk rezultoi se janë organizuar takime me palët e treta si me grupet e interesit nëpërmjet degësive me publikun.

- Bashkia Vlorë për periudhën objekt auditimi ka hartuar dhe ka funksionuar me një rregullore të brendshme në përshtatje me strukturën organike, me vendimin nr. 101 , datë 11.09.2018 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë e cila aktualisht është në fuqi. - Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet deri me njëfarë mase me ndryshimet e strukturave organike, pasi mungojnë detyrat dhe përgjegjësitë e Strukturës së Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, të strukturave për funksione të deleguara të atashuar si Sektori i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, (MZSH-së), sektorë këta të cilat nuk janë përfshirë në Rregullore.

Informimi i stafit me rregulloren e re është bërë me adresën zyrtare të emali- it për stafin dhe drejtorinë dhe nuk ka urdhër të veçantë të Kryetarit së Bashkisë. Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet me ndryshimet e strukturave organike.

-Mungon plani strategjik për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilën duhet të përfshiheshin aktivitetet, plan veprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.

- Për periudhën objekt auditimi është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë. Kështu: *Për vitin 2021 struktura është miratuar me Vendim të Titullarit nr 21 datë 16.02.2021 , me 1128 punonjës në plan dhe në fakt 1079 punonjës bashke me institucionet e varësisë dhe funksioneve të deleguara. Pozicione pune të vlerësuara me status të Nënunësit Civil, gjithsej 117 pozicione, nga të cilat 13 pozicione pune janë pozicione të kategorisë se mesme drejtuese, 7 pozicione të kategorisë se ulët drejtuese dhe 97 pozicione të kategorive ekzekutive.*

-Lidhur me largimet dhe emërimet sipas periudhës së audituar.

Periudha	Largimet	Emërimet	Procedura E Ndjekur
VITI 2021	38	46	Në zbatim të legjislacionit sipas natyrës së vendit të punës

Burimi: Drejtoria e burimeve Njerëzore

Për vitin 2022 struktura është miratuar me Vendim të Titullarit nr. 01 datë 10.01.2022 , me 1189 punonjës në plan dhe në fakt 1079 punonjës bashke me institucionet e varësisë dhe funksioneve të deleguara.

Emërimet dhe largimet për vitin 2022

PERIUDHA	Largimet	Emërimet	Procedura e ndjekur
VITI 2022	47	105	Në zbatim të legjislacionit sipas natyrës së vendit të punës

Burimi: Drejtoria e burimeve Njerëzore

Përsa i përket vitit **2021** : Janë larguar nga puna për arsye e daljes në Pension 13 punonjës , Larguar me dëshirë 8 punonjës , Largim për arsye përfundim kontrate 1 punonjës, për mos paraqitje në punë 1 punonjës, ndërruar jetë 1 punonjës. Për vitin **2022** Janë larguar nga puna për arsye e daljes në Pension 1 punonjës , larguar me dëshirë 1 punonjës, dhe për asye përfundim i kontratës 18 punonjës.

Në Bashkinë Vorë, për periudhën deri më 31.12.2021 dhe 31.12.2021 , për arsye të ndryshme, kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës 38 punonjës, dhe jo në çdo rast nga ana punonjësve të larguar kanë dorëzuar punën me procesverbal. Këto veprime nuk garantojnë ruajtjen dhe transmetimin informacionit dhe bazës së të dhënave të krijuara në institucion, por ndërprerje të saj dhe rrjedhimisht ndikojnë në performancën e institucionit. Punonjësit e rinj të marrë rishtas në punë, përballen me vështirësinë e mungesës së informacionit të duhur, duke mos e njohur si duhet situatën e periudhës së paraardhësve të tyre. Në këtë mënyrë nuk krijohet një vazhdimësi kronologjike e transmetimit të punës së kryer nga një punonjës te tjetri, por ndërprerje e saj, në varësi të shpeshtësisë së ndërrimit të stafit, e cila sjellë edhe pasoja reale në punën e sektorëve përkatës të njësisë vendore. Në institucion nuk ka rregulla të shkruara për veprimet e punonjësve përpara largimit dhe detyrat e strukturave përkatëse të financës dhe burimeve njerëzore në raste të tilla.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

-Udhëzimin e ministrisë së financave nr. 30,datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 13.

- VKM nr. 360, datë 14.07.2000 ”Për lirimimin nga shërbimi civil”, pikat 19, 20 dhe 21 “Dorëzimi i detyrës”

-Ligjin nr. 7961, date 12.07.1995 “Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 25 -Detyrimi i dhënies llogari dhe i kthimit.

- Në Rregulloren e Brendshme janë për çdo Drejtori misioni, objektivat, baza ligjore, përbërja e strukturës, detyrat dhe përgjegjësitë për çdo drejtori, sektor dhe specialist. Ndërsa në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, por jo objektivat për secilin punonjës, Rregullorja e brendshme me nr. 101 prot; datë 11.09.2018 nuk është përditësuar duke sjellë vështirësi në proceset e punës.

- Bashkia Vlorë ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet në të cilën janë paraqitur dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore

- Vlerësimin e punës së strukturës organike, Bashkia e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe nuk ka raporte performance.

Në lidhje me parimin 4 “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”

- Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, por nuk ka një plan vjetor rekrutimi. *Për planin vjetor të pranimit në Bashkinë Vlorë pjesë e shërbimit civil për vitin 2021 “ e kryetarit së Bashkisë Vlorë.* Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale sipas, e cila përmban të dhëna të karakterit teknik, profesional, të dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Dokumentet përkatës që vërteton pohimin e bërë si: çertifikata e gjendjes familjare; diploma e shkollës së lartë, lista e notave; certifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja, të tjera.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme .Nga Bashkia Vlorë është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxheret e programeve dhe kjo tabelë i është dërguar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. Nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit.

- Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:

- Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Përgjegjës i Zyrës së Financës.

Në lidhje me parimin 5 “Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”.

Janë kryer delegime detyrash të cilat janë bërë në bazë të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 59, pika 3 me autorizimet dhe Urdhërat përkatës, kryesisht delegimi i funksioneve në rast të mungesës së nëpunësit autorizues dhe nuk ka raste të delegimit nga nëpunësi zbatues ose drejtorët e drejtorive.

- Në zbatim të ligjit organik të buxhetit, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2019 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimit të MFE nr. 7 , datë 26.02.2021 “ Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021 – 2024 Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhra për ngritjen e GMS:

Për vitin 2021 me shkresën nr. prot. 7632 datë 10.09.2020 ka dalë urdhri i titullarit nr. 197 datë 10.09.2020 “Për ngritjen GMS dhe ekipeve të menaxhimit të programeve”. Me shkresën 3060 prot; datë 08.04.2020 me urdhër urdhër nr. 90. 08.04.2020 ngritur grupi i punës për hartimin PBA – ve me Kryetar grupi është Titullari i Bashkisë (NA). Për vitin 2022 “Për ngritjen GMS me urdhërin nr. 1276 datë prot; 09.02.2022.

- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

-Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar.

- Nuk është dokumentuar procesi i paraqitjes së kërkesave buxhetore sipas programeve të Koordinatorit i GMS-së. Përsa i përket dokumenteve të hartuara është bërë deklarimi se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë: Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore; sistemi i programimit të zbatimit të buxhetit; sistemi i pagesave, sistemi i prokurimeve me vlera të vogla dhe të larta; inventarët e aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese; sistemi i tatim-taksave. Në kapitullin “Vlerësimi i sistemit të MFK” janë përshkruar se sa janë arritur objektivat në fushat prioritare për bashkinë si në sektorin e shërbimeve publike, sektorin e urbanistikës dhe sektorin e tatim-taksave. Si ka ndikuar komponenti i informimit dhe komunikimit me procedurat me rregulloret e hartuara dhe të

realizuara nga kjo njësi në arritjen e objektivave në sektorët më të rëndësishëm të veprimtarisë së bashkisë. Si ka funksionuar komponenti i monitorimit të kontrollit të brendshëm në cilësinë e performancës. Si ka ndikuar veprimtaria e AB në monitorimin e Kontrollit të brendshëm.

Gjithashtu janë paraqitur masat e marra për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe planveprimi për të ardhmen për përmirësimin e performancës organizative dhe financiare të njësisë nga puna për arritjen e synimeve përkatëse të *Drejtorisë së Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit, Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, Drejtorisë Juridike, Burimeve së Njerëzore, Drejtorisë së Zbatimit të Projekteve , Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtorisë së Turizmit , Drejtorisë së Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sportit , Drejtorisë së Shërbimit Social, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit , Njësisë së Auditimit dhe Qendrat Administrative .*

Pjesë e Deklaratës duhet të jetë edhe fakti se si është realizuar ngritja dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej nëpunësit autorizues, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

Kjo duhej realizuar nëpërmjet:

Monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe të rregullshmërinë duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Realizimit të “gjurmës së auditimit” që përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendim-marrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Mbikëqyrjes së ndarjes së detyrave, caktimin e përgjegjësive, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se ajo është kryer sipas parashikimit. Udhëzimeve të dhëna dhe kryerjes së trajnimeve të nevojshme për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe se direktivat e dhëna, të cilat duhet të kuptohen dhe të arrihen nga punonjësit.

I. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6:Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva.

Bashkia Vlorë në hartimin e PBA-ve ka vendosur objektiva si në planet operacionale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikime në investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat kombëtare e sektoriale si dhe me vizionin dhe misionin e njësisë. Këto objektiva bëhen të njohura, duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA në MFE, në këshillin Bashkiak. Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë, por këto mospërputhje janë të vogla. PBA është miratuar me VKB nr. 96 datë 30.12.2022.

Është hartuar regjistri i riskut, ku është bërë identifikimi dhe vlerësimi të risqeve në nivel drejtorie, por jo për të gjitha drejtoritë si dhe janë përcaktuar veprime për të të adresuar mangësitë. Duke mos u ngritur grupi i menaxhimit të riskut dhe i mungesës së veprimtarisë së tij, nuk janë identifikuar e vlerësuar të gjitha risqet e mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut. Përsa i përket koordinatorit të riskut për periudhën objekt auditimi ka dalë urdhër i brendshëm me nr. 105, datë 15.05.2018, ku NA ia ka deleguar Përgjegjësit të Sektorit të Buxhetit z. **V. Z.** specialist në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Sa më sipër konstatohet se, për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t'u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. Këto mosveprime janë në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar ku citohet se: "Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut".

Në lidhje me parimin 7: "Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave".

Në lidhje me parimin 8: "Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrim".

Duke mos pasur një vlerësim të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë riskut për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshira detyrat dhe përgjegjësit e koordinatorit të riskut, dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe gjithëpërfshirës.

Në lidhje me parimin 9: "Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm".

Bashkia Vlorë në politikën dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar apo deleguar e autorizuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara. Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësit e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirës.

II. Komponenti: "Aktivitetet e Kontrollit"

Në lidhje me parimin 10: "Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli"

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë janë përcaktuar krahas detyrave janë identifikuar pak a shumë dhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj.) jo të gjitha aktivitete e kontrollit janë të dokumentuara në formën e hartave të proceseve të punës .

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimit i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Përgjegjësi i financës/Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë (NA).

- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit të komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave,

komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimit të mallit. Ngritja e këtyre komisioneve është parashikuar edhe në nenin 42 të Rregullores së Brendshme

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh.

Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për të janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit materiale. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet i këtyre aktiveve. Aktivitet Afatgjatë nuk janë regjistruara në SIFQ, pasi kjo Bashki akoma nuk është pilot për aplikimin direkt në programin e Qeverisë SIFQ.

Në lidhje me parimin 11:“Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”

- Bashkia Vlorë nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

Sektori i IT, i cili varet nga Drejtori i Sektorit të Burimeve Njerëzore ka vetëm detyra për mirëmbajtjen e sistemit kompjuterik dhe menaxhimin e programeve, dhe merret me instalimin e programeve. Gjithashtu ka përgjegjësi dhe menaxhon Serverin kryesor, duke garantuar sigurinë e sistemit të IT në lidhje me ndryshimet e fjalëkalimeve, firewall-et.

Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up)

Në lidhje me parimin 12:“Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”

- Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, përgjegjësi këto të identifikuar në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë, por mungojnë plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut.

III. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: “Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.

Drejtuesit në Bashkinë Vlorë kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacional, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.

Sistemi i raportimit ofron pjesërisht informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujor dhe vjetor dhe paraqiten pranë Këshillit Bashkiak si dhe në Degën e Thesarit.

- Raportet për detyrimet e konstatuara por të papaguara hartohen çdo muaj dhe paraqiten në degën e thesarit.

- Drejtorja e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit në Bashkinë Vlorë për mbajtjen e kontabilitetit operon me program të vetin të kontabilitetit, pa e dubluar programin SIFQ. Në bazë të këtij

programi kontabilitetit me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria Ekonomike. Ndërsa monitorimi i të ardhurave kryhet me program të veçantë të cilin e menaxhon Sektori i Tatim-Taksave.

Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm

Në lidhje me parimin 15: Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, në nenin 15 “ Bashkëpunimi ndërmjet strukturave të Administratës së Bashkisë”, neni 16 “Marrëdhëniet me Këshillin Bashkiak”, neni 17 “Informacioni dhe komunikimi me median”, neni 18 “Marrëdhëniet me publikun”.

Informacioni që sigurohet nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve i transmetohet Titullarit për çdo muaj, i cili informohet mbi shpenzimet aktuale , të ardhurat e veta të realizuara dhe buxhetin e planifikuar. Informacioni prej drejtuesve dhe përgjegjësve të sektorëve dërgohen çdo javë çdo muaj dhe nëpërmjet analizave të herëpashershëm sigurohet informacion për arritjen e objektivave dhe dëmeve të mundshme.

Të gjithë punonjësit e Bashkisë Vlorë, me statusin e nëpunësit civil , janë të pajisur me e-mail zyrtar.

- Nga Bashkia Vlorë kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, por mungon dokumenti i konsultimit publik.

IV. Komponenti: “Monitorimi”

Në lidhje me parimin 16: “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë pjesërisht raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti .

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit e të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

- Bashkia monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar çdo vit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, *pranë Ministrisë së Financave për vitin 2021 me shkresën nr. 2663 prot. datë 15.03.2022 . Raportet e Monitorimit të zbatimit të buxhetit për periudhën janar- Gusht 2021 është miratuar me shkresën nr. 8307 prot. Datë 24.05.2021. Raporti monitorimit për periudhën janar-prill 2022, nr. 6191 prot; datë 31.05.2022; raporti i monitorimit për periudhën janar-gusht 2022; nr. 11169 prot; datë 04.10.2022; për periudhën janar-dhjetor 2022, me nr. 4065 prot; datë 04.04.2023.*

- Në Bashkinë Vlorë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. *Plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin shoqëron shkresën e sipërcituar dërguar pranë Drejtorisë së Harmonizimit.*

- Në Bashkinë Vlorë aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës si dhe Komiteti i Auditimit.

- Një nga drejtimet e monitorimit kanë të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm.

Auditi i Brendshëm, është angazhuar për ndërmarrjen e masave korrigjuese, nëpërmjet planveprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Në lidhje me parimin 17: “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezentë në mbledhjet periodike me Kryetaren e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

“Mjedisi i kontrollit”

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Nga auditimi rezultoi se GMS nuk ka kryer detyrat si: - Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

-Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme. Jo në çdo rast nga punonjësve e larguar nuk kanë dorëzuar punën me procesverbal. Në institucion nuk ka rregulla të shkruara për veprimet e punonjësve përpara largimit dhe detyrat e strukturave përkatëse të financës dhe burimeve njerëzore në raste të tilla.

“Menaxhimi i Riskut”

-Mungon Urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë riskut për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillen institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. Këto mosveprime

janë në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar ku citohet se: “Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut”.

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Vlorë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (*back-up*) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT, pasi një punonjës kontrollon të gjitha fazat e funksionimit të IT si instalimin e softuerit, programimin e testimit etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të IT të miratuar nga Kryetari si dhe nuk ka qenë fushë drejtimi auditimi nga AB.

“Informimi dhe komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj.- Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. Nga Bashkia Vlorë kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, por mungon dokumenti i konsultimit publik.

“Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi: **z. D. L.**, Kryetar i Bashkisë Vlorë; **z. D. Z.**, drejtor i Financës dhe i Buxhetit, Bashkia Vlorë; **z. T. Z.**, ish-drejtor i Financës dhe i Buxhetit, Bashkia Vlorë; **z. V. Z.**, ish-specialist në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit; **znj. L. B.**, drejtoreshë e Burimeve Njerëzore.

Titulli i gjetjes: Mangësi në funksionimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, duke sjellë fenomenin që sistemet e kontrollit nuk kanë funksionuar plotësisht.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

“Mjedisi i kontrollit”

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Nga auditimi rezulton se GMS nuk ka kryer detyrat si: - Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

-Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme. Jo në çdo rast nga punonjësve e larguar nuk kanë dorëzuar punën me procesverbal. Në institucion nuk ka rregulla të shkruara për veprimet e punonjësve përpara largimit dhe detyrat e strukturave përkatëse të financës dhe burimeve njerëzore në raste të tilla.

“Menaxhimi i Riskut”

-Mungon Urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë riskut për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. Këto mosveprime janë në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar ku citohet se: “Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut”.

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Vlorë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (*back-up*) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT, pasi një punonjës kontrollon të gjitha fazat e funksionimit të IT si instalimin e softuerit, programimin e testimit etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të IT të miratuar nga Kryetari si dhe nuk ka qenë fushë drejtimi auditimi nga AB.

“Informimi dhe komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj.- Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. Nga Bashkia Vlorë kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, por mungon dokumenti i konsultimit publik.

“Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar. Manualit të MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë Vlorë.

Ndikimi/Efekti: Mosnjohje e plotë dhe sa duhet i koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” nga niveli i lartë drejtues i kriterëve të MFK, duke sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Shkaku: Mungesa e trajnimeve të dedikuara për gjithë stafin në drejtim të njohjes së dispozitave të MFK dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Vlorë, me atributet e Kryetarit të GMS e të Nëpunësit Autorizues si dhe Koordinatorit i Riskut, të marrë masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të kryejë investime në programe kompjuterike të liçencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët te programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosijen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Rekomandimi: Në mënyrë që të parandalohen rastet e mos dorëzimit të detyrës nga punonjësi kur ai ndërpret marrëdhëniet e punës, nga titullari të vendosen rregulla të brendshme të shkruara për këtë qëllim: të hartohet urdhër i veçantë apo të shtohet në rregulloren e brendshme dhe për këtë të njihen të gjithë punonjësit. Në këto rregulla të përcaktohet detyrimi që ka punonjësi për dorëzimin e aktiveve që ka në inventar dhe të gjithë punës së kryer, dosjeve shkresore, dokumentacionit elektronik, e gjithçka të krijuar nga punonjësi gjatë qëndrimit të tij në detyrë, e cila duhet të konsiderohet “pronë e institucionit”. Gjithashtu të përcaktohen edhe detyrimet e strukturave përkatëse të institucionit për këtë qëllim: sektori i shërbimeve, burimeve njerëzore, financës, etj. Nga ana e strukturave të Bashkisë Vlorë të merren masa për përditësimin ose ndryshimin e rregulloreve të brendshme.

Nënpika 1.2 e programit: Organizimi i Njësisë së AB dhe vlerësimi i veprimtarisë.

Në bazë të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik”, është krijuar njësi e Auditit të Brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditit të Brendshëm duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr. 1100, i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm. Ky sektor përgjatë periudhës 2020-2021, është organizuar dhe ka funksionuar në

zbatim të VKB nr. 85, datë 24.12.2020, dhe ka pasur numër punonjësish përkatësisht, 3 për vitin 2020 (duke përfshirë edhe drejtuesin e njësisë së auditimit), 3 për vitin 2021. Sipas Tabelës 1.

-Struktura e Auditit të Brendshëm me të dhënat sipas tabelës

Tabela. 1

Nr	Nga data e krijimit deri me 31.12.2021	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi ne pune	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime te vijeshme
	Për vitin 2021						
1.	L. G.	Pergjegjese	UT Fakulteti i Ekonomikse, master ne kontabilitet	14	14	2011	Po
2.	E. Gj.	Inspektore auditit	UV Fakulteti i Ekonomikse, master ne administrim publik	14	12	2013	Po
3.	L. D.	Insektore auditit	UV Fakulteti i Drejtësisë	24	10	2015	po

Burimi : Bashkia Vlorë (Drejtorja e Auditit Të brendshëm).

Struktura e auditit te brendshëm nuk ka pasur ndryshime për vitin 2022. Me vendim nr. 185 datë 28.06.2022 të kryetarit të Bashkisë Vlorë përgjegjëse e komanduar E. Gj.

Nga auditimi i dokumentacionit për periudhën objekt auditimi për vitin 2021 lidhur me planet strategjike dhe planet vjetore , periudha e raportimit dhe karta e auditit të brendshëm rezulton si më poshtë :

Planet Strategjikë dhe Vjetorë të NJAB të Bashkisë Vlorë janë përcjellë në Ministrinë e Financave brenda afateve të përcaktuara në Ligjin 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, në “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Për vitin 2021 është miratuar nga Titullari i Bashkisë me shkresën nr. 8466/1 dt. 14.10.2020 plani vjetor dhe ai strategjik për vitet 2021-2023 të veprimtarisë së Auditit të Brendshëm dhe me i është dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave. Plani strategjim 2022-2024 dhe plani vjetor 2022 i njësisë së auditit të brendshëm i rishikuar me nr. 1377/1 prot datë, 21.02.2022.

Plani vjetor për vitin 2021 ka ndryshuar me shkresën nr.11013 date 01.10.2021.

Për vitin 2021 janë planifikuar 9 angazhime auditimi dhe janë realizuar 8 auditime.

Raportimi: Për veprimtarinë e NJAB në Bashkisë Vlorë për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike. Janë hartuar dhe dërguar në NJQHAB te MFE raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB, përkatësisht për vitin 2021 me shkresën nr. 173/1 prot; datë 11.02.2021. Për veprimtarinë e NJAB në Bashkisë Vlorë për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike. Janë hartuar dhe dërguar në NJQHAB te MFE raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB, përkatësisht për vitin 2022 me shkresën nr 963/1 prot datë 10.02.2023.

Karta e AB: NJAB në mbështetje të Urdhrit nr. 100, datë 25.10.2016 të MF “Për miratimin e Manualit të AB në sektorin publik” ka hartuar “Kartën e AB në sektorin publik” në Bashkinë Vlorë e cila është miratuar nga titullari me shkresën nr.10845 prot , datë 20.12.2018.

Për vitin 2021 janë planifikuar 9 dhe janë realizuar realizuar 8 Auditime, si më poshtë vijon:

1-Drejtorja e Mbrojtjes dhe Shpëtimit nga Zjarri

2-Sektori i Pyjeve dhe Kullotave

- 3-Teatri "Petro Marko"
- 4-Qendra Zhvillimit PAK
- 5-Ndërmarrja e Shërbimeve Publike
- 6-Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social
- 7- Drejtoria e Pronave Publike
- 8- Detyrimet e prapambetura

Për vitin 2021 janë planifikuar 9 (nëntë) auditime dhe janë realizuar 8 auditime nga të cilat janë realizuar 2 (dy) auditime përputhshmërie, dhe janë realizuar 6 (Gjashtë) auditime të kombinuara, të pasqyruara në Tabelën nr. 2.

Tabela nr. 2

Nr	Periudha	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga te realizuarat, sipas llojit				
				Perputhshmëri	Financiar	Kombinuar	Performace	Tjera
1	Viti 2021	9	8	2	-	6	-	-

Burimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Auditit të brendshëm.

- Rekomandimet e kryera në vitin 2021.

Nga të cilat 10 rekomandime janë dhënë për Drejtorinë e Mbrojtjes nga Zjarri. Për Drejtorinë e Ndhmës Sociale është dhënë 1 (një) rekomandim, për Sektorin e Pyjeve janë dhënë 6 (gjashtë) rekomandime, për teatrin "Petro Marko" janë dhënë 5 (pesë) rekomandime, Qendra e Zhvillimit PAK 5 (pesë) rekomandime, Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve 2 (dy) rekomandime, për NSHP janë dhënë 22 rekomandime, sipas të dhënave të shprehura në Tabelën A3

-Të dhënat sipas raportimit të shprehura në Tabelën A3

Tabela A3

Nr	Periudha	Të dhëna sipas raportimit				Sipas Raportimit			
		Rekomandime Te Shprehura Ne Numër				Rekomandime Te Shprehura Ne Vlerë (Shpërblim Demi)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar	Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
1	Viti 2021	51	16	35	-	-			
TOTALI									

Burimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Auditit të Brendshëm.

Nga auditimi i raportimit të vitit 2021, konstatojmë se janë dhënë 51 rekomandime gjithsej. Rekomandimet janë pranuar të gjitha, prej të cilave 16 rekomandime janë zbatuar, dhe 35 janë në poqes zbatimi.

-Për vitin 2022 janë planifikuar 9 dhe janë realizuar realizuar 9 auditime, si më poshtë.

Tabela A4

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditim e ta planifikuara	Auditime te realizuara	Nga te realizuarat, sipas llojit				
				Përputhshmëri	Financiar	Kombinuar	Performance	Tjera
1	Viti 2022	9	9	1	-	7	-	1

Burimi :Bashkia Vlorë (Drejtoria e Auditit të Brendshëm)

Realizimi i angazhimeve NJAB për auditimet në vitin 2022

1. Auditim lidhur me zbatimin e rekomandimeve
2. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV)
3. Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike
4. Njësia Administrative Qendër
5. Njësia Administrative Orikum
6. Njësia Administrative Novoselë
7. Njësia Administrative Shushicë
8. Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit
9. Qendra e Kulturës

Janë planifikuar 9 (nëntë) auditime dhe janë realizuar 9 (nëntë) auditime, 7 (shtatë) auditime të kombinuara, 1 (një) auditim performance dhe 1 (një) të tjera.

Tabela A5

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar	Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
1	Viti 2022	31	22	9	-	-			
TOTALI									

Burimi : *Bashkia Vlorë Drejtoria e Auditit të Brendshëm*

Përsa i përket rekomandimeve të shprehura në numër janë dhënë gjithsej 31 rekomandime, janë zbatuar 22 rekomandime, 9 rekomandime janë në proces.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura u konstatua se përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, “Manuali i Auditimit të Brendshëm” (MAB). Rezulton se në fillim të vitit janë hartuar deklaratat e pavarësisë, për çdo rast të angazhimit të auditimit janë bërë njoftimet për fillimin e angazhimit të auditimit si dhe autorizimet përkatëse me protokoll të veçantë, si dhe për çdo auditim janë hartuar deklaratat e pavarësisë. Është zhvilluar takimi i hapur prezantues dhe ai përmbyllës, janë hartuar pyetësorët e vlerësimit të përgjithshëm të riskut dhe të fushës që është audituar, si dhe është bërë inventari i dosjeve me dokumentet përkatëse. Hartimi i projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit.

Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të MF “Për miratimin e Manualit të AB në sektorin publik” kapitulli IV, pika 4.1.1 “planifikimi i një angazhimi auditimi”; kapitulli VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”, pika 6.1 “Niveli i dokumentimit”; Kapitulli VII, “Sigurimi i cilësisë së punës të AB”, pika 7.1.1 “Vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet nga vetë NJAB”,

Në lidhje me vlerësimin e brendshëm të cilësisë që kryhet nga vetë NjAB konstatohet se anekset “Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë” dhe “vetëvlerësimin periodik” nuk janë plotësuar sipas përcaktimeve në pikën 7.1.1 në Kapitullin VII të MAB, të cilat nuk mbulojnë në të gjitha fazat e auditimit si dhe i mungon komponenti i tretë “Reagimet e subjektit të audituar”. “Për Auditin e Brendshëm Publik”.-Në Programin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, nuk ka të përcaktuar Indikatorët e matjes së performancës, gjë që ka kushtëzuar hartimin e raporteve specifike të vlerësimit të performancës dhe si rrjedhim adresimin e rekomandimeve për përmirësim, duke munguar raportimi tek Titullari për këtë procedurë. Rezulton se nuk është kryer

procedura sigurimi i cilësisë.-Nuk ka gjurmë, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar (e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim. Gjithashtu në disa dosje të auditimit mungon Memo e planifikimit, pra Projekt Drafti i programit të auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit. Mungon dokumenti i miratimit të kodit të etikës për audituesit e brendshëm në sektorin publik. Në auditimin e pasqyrave financiare nuk jepet vlerësim mbi vërtetësinë / saktësinë e gjendjes aktuale të paraqitjes së pasqyrave financiare dhe përcaktimin e riskut, materialiteti dhënie e opinionit të sigurisë së arsyeshme mbi pasqyrat financiare. AB në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe ka dhënë vlerësime për sistemin e kontrollit të brendshëm vetëm në auditimet në institucionet e varësisë dhe jo për Drejtoritë e Aparatit të Bashkisë, duke u shprehur në të njëjtin format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara, si më poshtë: “a.-Kontrolli brendshëm. në këtë ndërmarrje funksionon mirë. Ekziston një ndërthurje e punëve ndërmjet hallkave dhe sektorëve për një funksionim normal të ndërmarrjes. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm u realizua duke analizuar komponentë e tij si:1.Ambienti i kontrollit të brendshëm; 2.Vlerësimi i riskut; 3.Aktiviteti i kontrollit operacional; 4.Sistemi i informacionit dhe komunikimit; 5.Monitorimin.-Përgjithësisht mbikëqyrja funksionon sipas hierarkisë së strukturës, ndarjes së detyrave, përgjegjësiqe qe kanë të bëjnë me vendimmarrjen, kontrollin, vendosjen dhe zbatimin e linjave të raportimit, të niveleve specialist. Përgjegjës sektori, Drejtor ndërmarrje.-funksionon ndarja e detyrave në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për dy ose më shumë funksione.-sistemi i dy nënshkrimeve është i vendosur për çdo veprim që ka të bëjë me kryerjen e pagesave ose ndonjë veprimi tjetër që kërkon nënshkrimin e nëpunësit autorizues dhe atij zbatues.

-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm”.Përsa i përket Auditimeve të planifikuara për vitin 2021 dhe për vitin 2022, rezulton se nuk janë planifikuar auditime të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, siç janë prokurorimet publike, Taksat dhe tarfiat vendore apo Drejtoria e Financës Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, pasi planet vjetore nuk janë hartuar bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, veprime në kundërshtim me nenin nr. 5 dhe nr. 6 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

<p>Titulli i gjetjes: Mangësi në lidhje me organizimin dhe funksionin e Sektorit të Auditin e Brendshëm.</p>

Situata: Në lidhje me vlerësimin e brendshëm të cilësisë që kryhet nga vetë NjAB konstatohet se anekset “Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë” dhe “vetëvlerësimin periodik” nuk janë plotësuar sipas përcaktimeve në pikën 7.1.1 në Kapitullin VII të MAB, të cilat nuk mbulojnë në të gjitha fazat e auditimit si dhe i mungon komponenti i tretë “Reagimet e subjektit të audituar”. “Për Auditin e Brendshëm Publik”.

-Në Programin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, nuk ka të përcaktuar Indikatorët e matjes së performancës, gjë që ka kushtëzuar hartimin e raporteve specifike të vlerësimit të performancës dhe si rrjedhim adresimin e rekomandimeve për përmirësim, duke munguar raportimi tek Titullari për këtë procedurë. Rezulton se nuk është kryer procedura sigurimi i cilësisë.-Nuk ka gjurmë, nuk

dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar (e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim. Gjithashtu në disa dosje të auditimit mungon Memo e planifikimit, pra Projekt Drafti i programit të auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit. Mungon dokumenti i miratimit të kodit të etikës për audituesit e brendshëm në sektorin publik. Në auditimin e pasqyrave financiare nuk jepet vlerësim mbi vërtetësinë / saktësinë e gjendjes aktuale të paraqitjes së pasqyrave financiare dhe përcaktimin e riskut, materialiteti dhënien e opinionit të sigurisë së arsyeshme mbi pasqyrat financiare. AB në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe ka dhënë vlerësime për sistemin e kontrollit të brendshëm vetëm në auditimet në institucionet e varësisë dhe jo për Drejtoritë e Aparatit të Bashkisë, duke u shprehur në të njëjtin format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara, si më poshtë: “a.-Kontrolli brendshëm. në këtë ndërmarrje funksionon mirë. Ekziston një ndërthurje e punëve ndërmjet hallkave dhe sektorëve për një funksionim normal të ndërmarrjes. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm u realizua duke analizuar komponentë e tij si: 1. Ambienti i kontrollit të brendshëm; 2. Vlerësimi i riskut; 3. Aktiviteti i kontrollit operacional; 4. Sistemi i informacionit dhe komunikimit; 5. Monitorimin.-Përgjithësisht mbikëqyrja funksionon sipas hierarkisë së strukturës, ndarjes së detyrave, përgjegjësive që kanë të bëjnë me vendimmarrjen, kontrollin, vendosjen dhe zbatimin e linjave të raportimit, të niveleve specialist. Përgjegjës sektori, Drejtor ndërmarrje.-funksionon ndarja e detyrave në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për dy ose më shumë funksione.-sistemi i dy nënshkrimeve është i vendosur për çdo veprim që ka të bëjë me kryerjen e pagesave ose ndonjë veprimi tjetër që kërkon nënshkrimin e nëpunësit autorizues dhe atij zbatues.

-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm”.Përsa i përket Auditimit të planifikuara për vitin 2021 dhe për vitin 2022, rezulton se nuk janë planifikuar auditime të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, siç janë prokurorimet publike, Taksat dhe tarifat vendore apo Drejtoria e Financës Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, pasi planet vjetore nuk janë hartuar bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, veprime në kundërshtim me nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Kriteri: Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 ”Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” nenin 12 dhe neni 14 pika iv, Manuali i AB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të AB në sektorin publik”Kapitullin VII pika 2.4.1, 2.4.2, pikën 7.1.1, kapitulli IV pikat 4.1.7 - 4.1.12 kapitulli IV pika 4.1.1, pika 4.1.12; kapitulli VI, pika 6.1; Kapitulli VII, pika 7.1.1.

Ndikimi/Efekti: Nuk jep siguri të arsyeshme për objektivat e përcaktuara nga Institucioni. Nuk pasqyrojnë aktivitetin e drejtorive me risk të lartë si Financa, Taksat apo Prokurimet.

Shkaku: Nga neglizhenca, dhe mos përmbushja e angazhimeve për auditim sipas planifikimit të bërë.

Rëndësia: E Mesme

Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Vlorë, të marrë masa për realizimin e të gjitha proceseve në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. Në raportet e auditimit të kryhen teste substanciale dhe analitike, në mënyrë që në fushat me risk të lartë auditimet të jenë

të thelluara, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit nëpërmjet formulimit të qartë të gjetjeve. Veprimtaria e AB të funksionojë si veprimtari, që mbështet menaxhimin e kësaj njësie vendore për arritjen objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën. Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të merren masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse ti jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave.

Pika 2 e programit: Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit për vitin 2022

Nga auditimi i procedurave të PBA-ve për vitet 2021-2023 dhe vitet 2022-2024 u konstatua se përgjithësisht janë realizuar fazat e përgatitjes buxhetore.

PBA për periudhën 2021-2023 është miratuar në Këshillin Bashkiak me Vendim nr. 95 datë 28.12.2020 “Për miratimin e Buxhetit Afatmesëm Përfundimtar 2021-2023”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë më shkresën nr. 12442/1, datë 11.01.2021. PBA për periudhën 2022-2024 është miratuar në Këshillin Bashkiak me Vendim nr. 55 datë 30.09.2021 “Për miratimin e Buxhetit Afatmesëm Përfundimtar 2022-2024”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë më shkresën nr.999/4 prot datë 10.01.2022.

Nga auditimi i procesit të hartimit të PBA-së dhe dokumentimit të hapave të ndjekura rezulton se:

1. Është grumbulluar informacion për vitin 2021 nga institucionet e varësisë si dhe nga strukturat brenda Bashkisë lidhur me nevojat që ato kanë;
 2. Për hartimin e PBA-së 2021-2023 është ngritur grupi i punës me Urdhrin e Titullarit nr. 90, datë 08.04.2020 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e buxhetit afatmesëm 2021-2023”;
 3. Në urdhër është përcaktuar edhe grupi i punës që do të angazhohet për secilin program;
 4. Tavanet buxhetore janë miratuar me shkresën nr. 3060 Prot, datë 08.04.2021, nr 2616/1 prot
- Nga auditimi i procesit të hartimit të PBA-së dhe dokumentimit të hapave të ndjekura rezulton se:
- Nuk është paraqitur në Këshillin Bashkiak Projekt dokumenti i parë i PBA-së, i cili duhet të paraqitet në KB dhe të miratohet nga ky i fundit brenda datës 30 qershor 2020;

Nuk rezulton që dokumenti i parë i PBA-së të jetë publikuar në afatet e përcaktuara brenda datës 5 korrik të vitit 2020;

Nga auditimi i formatit të PBA-së së miratuar me Vendim nr. 95, datë 28.12.2020 dhe Vendim nr. 55 datë 30.09.2021 rezulton se në hartimin e tij nuk janë plotësuar të gjitha formatet e përcaktuara në Udhëzimin e MFE nr. 10, datë 28.02.2020 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023”. Dhe udhëzim nr.7. datë 26.02.2021“Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024” Përkatësisht janë plotësuar vetëm formatet F 1-2-12-13-14 dhe Formatit C3 ndërkohë nuk janë plotësuar të gjitha Formatet e tjera të grupit F, nuk janë plotësuar formatet B1 dhe B2 “Numri i punonjësve” si dhe Formatit C 6 “Lista emërore e projekteve të investimeve”.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, nenet 36,37,38,39 si dhe përcaktimet e Udhëzimit nr. 10, datë 28.02.2020 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023”, pikat 4,5,7,10,12,13,24,Dhe udhëzim nr.7. datë 26.02.2021“Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”.

Titulli i gjetjes: Mangësi në dokumentacioni e përgatitjes së PBA-ve.

Situata: Nga auditimi i procesit të hartimit të PBA-së dhe dokumentimit të hapave të ndjekura rezultoi se:

-Nuk është paraqitur në Këshillin Bashkiak Projekt dokumenti i parë i PBA-së, i cili duhet të paraqitet në KB dhe të miratohet nga ky i fundit brenda datës 30 qershor 2020;;

Nga auditimi i formatit të PBA-së së miratuar me Vendim nr. 95, datë 28.12.2020 dhe Vendim nr. 55 datë 30.09.2021 rezultoi se në hartimin e tij nuk janë plotësuar të gjitha formatet e përcaktuara në Udhëzimin e MFE nr. 10, datë 28.02.2020 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023”. Dhe udhëzim nr.7. datë 26.02.2021“Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024” Përkatesisht janë plotësuar vetëm formatet F 1-2-12-13-14 dhe Formatit C3 ndërkohë nuk janë plotësuar të gjitha Formatet e tjera të grupit F, nuk janë plotësuar formatet B1 dhe B2 “Numri i punonjësve” si dhe Formatit C 6 “Lista emërore e projekteve të investimeve”.

Kriteri: Ligji nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, nenet 36,37,38,39 si dhe përcaktimet e Udhëzimit nr. 10, datë 28.02.2020 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023”, pikat 4,5,7,10,12,13,24,Dhe udhëzim nr.7. datë 26.02.2021“Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”.

Shkaku: Mos zbatimi dhe mos njohje i kuadrit ligjor.

Efekti: Duke mos sjellë një hartim të saktë të përgatitjes të PBA-së

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike të marrin masa për dokumentimin e të gjitha fazave të PBA-së, të bëhen raportimet sipas afatave të përcaktuara, si dhe të plotësohen formatet sikurse parashikoet në udhëzim.

Nga subjekti i audituar, Bashkia Vlorë, mbi projekt raportin nr. 1026/28 prot; datë 28.09.2023, janë paraqitur kundërshti nga z. T. Z. me shkresën nr. 11597 prot; datë 27.10.2023, në cilësinë ish - Drejtorit të Financës dhe Kontabilitetit, Bashkia Vlorë, i cili ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimi i subjektit:

Nga studimi i materialit të dërguar nga Drejtoria Juridike e Bashkisë Vlorë me shkresën 12194, datë 11.10.2023 në lidhje me “Projekt Raport Auditimi nr.1026/1, datë 25.11.2022 ”, unë nënpunësi zbatues T. Z. me detyrë ish Drejtor I Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit për periudhën e vitit 2021 si vit ku unë kam mbuluar këtë drejtori, parashiroj komentet dhe shpjegimet e mia në lidhje me “Auditim mbi planifikimin,zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit”si me poshte: Nga këto komunikime del qartë arsyeja pse nuk janë zbatuar pikat e ligjit dhe udhëzimeve të

dala në zbatim të këtij ligji.Ministria e Financës dhe Ekonomisë nuk ka bërë komentet brenda afatit ligjor datë 20.06.2020 për shkak të pandemisë Covid 19 (vërtetuar në e-mail-et më lart). Më poshtë në material theksohet se PBA-ja e miratuar me VKB nr. 95 datë 28.12.2020, rezultoi se në hartimin e tij nuk janë plotësuar të gjitha formatet e përcaktuara në Udhëzimin e MFE nr.10 datë 28.02.2020 për përgatitjen e PBA 2021-2023. Formularit B1 dhe B2 numri i punonjësve është i plotësuar sipas formularit.Nuk e di se cfarë ju ka dorzuar audituesve zoti Z. si

DFKT-it aktual .Këto formular po jua paraqes në këtë material dhe mund ta verifikoni në kopjen e

dërguar MFE. Më posht po I paraqes këto dy formate B1 dhe B2. Komentet e mia si sekretar i GMS-së për këtë pikë janë: -Audituesit para se të arrijnë në delegimin e përgjegjësishë duhet t'i referohen urdhërit të titullarit nr. 90 datë 08.04.2020 për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Buxhetit afatmesëm 2021-2023 ku dhe audituesit i janë referuar në faqen 27 pika 2 dhe 3 në paragrafin e fundit të faqes, ku në urdhër është përcaktuar edhe grupi i punës që do të angazhohet për secilin program. Sekretari i GMS-së në zbatim të këtij udhëzimi ka paraqitur sipas pikës 4 tavanet buxhetore, të miratuara me vendim të Këshillit të Bashkisë. Sipas pikës 7 ashtu sic e përcakton edhe urdhri nr. 90 :dt.08.04.2020 7. Drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programeve (EMP), paraqesin kërkesat buxhetore dhe kërkesat buxhetore shitesë sipas programit të Kordinatori i GMS, brenda muajit prill 2020. Pjesë e kërkesave buxhetore duhet të jenë edhe objektiva për arritjen e barazisë gjinore,si dhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë në komunitetin e tyre pakica rome dhe egjiptiane objektiva për integrimin e tyre në komunitet. Duke u nisur nga urdhri dhe kjo pikë e udhëzimit në GMS nga drejtuesit e ekipit të menaxhimit të cdo programi, kanë ardhur ato material që janë paraqitur për miratim në Këshillin e Bashkisë dhe i janë nisur MF.

Oëndrimi i grupit të auditimit:

Përsa i përket pretendimet tuaj sqarojmë se: Lidhur me formatet B1 dhe B2 si dhe për dokumentacionin e PBA i cili nuk është dërguar në ministri brënda afateve, merren në konsideratë dhe do të reflektohen në material, përsa i përket të gjithë formateve të klasës F, si dhe Formatit C6 “ Lista emërore e projekteve të investimeve” nuk shoqërohet me dokument justifikues. Përsa i përket tavanëve Buxhetore dhe pikave të tjera në të cilat pretendoni, grupi i auditimit nuk është shprehur lidhur me atë cfarë kundërshtoni.

- Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2021 dhe 2022

Buxheti i vitit 2021 është miratuar në Këshillin Bashkiak si dhe është konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarku Vlorë, buxheti është miratuar me Vendim të KB nr. 94 datë 28.12.2020 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 1242/1 Prot. datë 11.01.2021 konkretisht pasqyra në vijim: Buxheti për periudhën 2022 është miratuar në Këshillin Bashkiak me Vendim nr. 55 datë 30.09.2021”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë më shkresën nr.999/4 prot datë 10.01.2022. Duke iu referuar Tabelave Rezulton se buxheti i vitit 2021 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 2,371,373 mijë lekë. Në planin faktik të buxhetit 2021 në krahasim me PBA 2021-2023, nuk ka diferenca. Duke iu referuara tabelave rezulton se buxheti i vitit 2022 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 2.858.088 mijë lekë.

Tabela nr. B/1: Planifikimi i buxhetit për vitin 2021, Bashkia Vlorë dhe institucionet e varësisë

Planifikimi i të ardhurave 2021		Planifikimi i shpenzimeve 2021	
Burimi i të ardhurave	Vlera në 000/ lekë	Emërtimi i zërave	Vlera në 000/ lekë
Të ardhurat e veta	1,410,692	Art. 600 Paga	774,707
Të ardhurat nga granti i pakushtëzuar	548,229	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shënd.	128,143
Të ardhurat nga transferata speciale	412,452	Art.602 Shpenzime operative	928,605
		Art. 609 Fondi i mbr.civile+Fondi rezervë	89,099
		Art. 166,651,604, 606	36,566
		Art. 603 Futbolli, Ujësjellës	45,780
		Art. 231 Investime	368,473
TOTALI TE ARDHURAVE	2,371,373	TOTALI SHPENZIMEVE	2,371,373

Burimi: Bashkia Vlorë

Tabela nr.B/2: Pasqyra e planit të buxhetit krahasuar me PBA për vitin 2021

Nr.	Emërtimi	Plani i Buxhetit 2021	Plani i vitit 2021 në PBA
1	Shpenzime personeli (600, 601)	902,850	902,850
2	Shpenzime korrente (602,604,606,609)	1,100,050	1,100,050
3	Shpenzime investimi (231)	368,473	368,473
Totali		2,371,373	2,371,373

Burimi: Bashkia Vlorë

Tabela B/3 Planifikimi i buxhetit për vitin 2022, Bashkia Vlorë dhe institucionet e varësisë

Planifikimi i të ardhurave 2022		Planifikimi i shpenzimeve 2022	
Burimi i të ardhurave	Vlera në 000/ lekë	Emërtimi i zërave	Vlera në 000/ lekë
Të ardhura të planifikuara për vitin 2022	1.399.948	Art. 600 Paga	884.086
Te ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm e të planifikuara për shpenzim për vitin 2021	198.164	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shend.	149.905
Total të ardhurat e veta	1.598.562	Art.602 Shpenzime operative	1.128.232
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar.	164.859	Art.604 Transferime korrente te brendshme	10.151
Të ardhura të trashëguara nga granti i kushtëzuar (transferua specifike 600, 601, 602 etj.).	100.143	606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	20.815
		Art.603 Shpenzime operative	31.177
		651 Inters kredie	3.567
		166 Pricipal Krdie	20.175
Grant i ri i çelur për llogari të vitit 2022	565.117	Art.230-231 Investime	518.626
Transfertë specifike e çelur për llogari të vitit 2022	429.407	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	91.354
Total të ardhura nga transfertat e buxhetit te shtetit	1.259526		
TOTALI TE ARDHURAVE	2.858.088	TOTALI SHPENZIMEVE	2,858.088

Burimi: Bashkia Vlorë

Tabela B/4 Pasqyra e planit të buxhetit krahasuar me PBA për vitin 2022

Nr.	Emërtimi	Plani i Buxhetit 2022	Plani i vitit 2022 në PBA
1	Shpenzime personeli (600, 601)	1,033,991	1,033,991
2	Shpenzime korrente (602,603,604,606,609)	1,305,471	1,305,471
3	Shpenzime investimi (231)	518,626	518,626
Totali		2.858.088	2.858.088

Burimi: Bashkia Vlorë

- Celja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizmit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

- Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Vlorë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuar sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara. Gjatë viteve

janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/ paksime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.

Nga auditimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Vlorë, konstatohet se buxheti vjetor ka pësuar ndryshime gjatë vitit, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Vlorë. - Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve, por kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës. - Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Duke iu referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës u audituan ndryshimet e bëra në buxhet ku rezultoi se: Për vitin 2021 në planifikimin e të ardhurave janë bërë 2 ndryshime shtesë në buxhet në vlerën 204,341 mijë lekë. Në planifikimin e shpenzimeve për vitin 2021 janë bërë 4 ndryshime shtesë në buxhet në vlerën 204,341 mijë lekë. Përsa i përket ndryshimeve në planifikim e të ardhurave për vitin 2022 janë bërë 2 ndryshime shtesë në buxhet në vlerën 463,616 mijë lekë. Në planifikimi i shpenzimeve për vitin 2022 janë bërë 8 ndryshime shtesë në buxhet në vlerën 463,616 mijë lekë. Të ardhurat dhe shpenzimet përfundimtare e ndryshimeve të buxhetit gjatë vitit 2021 të miratuara janë në shumën 2,575,714 mijë lekë. Të ardhurat dhe shpenzimet përfundimtare e ndryshimeve të buxhetit gjatë vitit 2022 të miratuara janë në shumën 2,858,088 mijë lekë.

Ndryshimet buxhetore gjatë vitit ushtrimor 2021 dhe vitit 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. B/5: Pasqyra e ndryshimeve të buxhetit gjatë vitit 2021, Bashkia Vlorë dhe institucionet e varësisë viti 2021 (000/ lekë)

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2021				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2021			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë, miratuar me VKB	Vlera në 000/lekë	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë miratuar me VKB	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)
	1	2	1+2		3	4	3+4
Të ardhura të planifikuara për vitin 2021	1,410,692		1,410,692	Art. 600 Paga	774,707	30,736	805,443
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe të planifikuara për shpenzim për vitin 2021		85,504	85,504	Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	128,143	6,086	134,229
Total të ardhurat e veta	1,410,692	85,504	1,496,196	Art. 602 Shpenzime operative	1,002,751	59,316	1,062,067
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar		51,690	51,690	Art. 604 Transferime korrente të brendshme	4,000		4,000
Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifike		67,147	67,147	Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	4,200		4,200
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2021	548,229		548,229	Art. 230-231 Investime	368,473	108,203	476,676
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2021	412,452		412,452	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	89,099		89,099
Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit të shtetit	960,681	118,837	1,079,518				

TOTALI TE ARDHURAVE	2,371,373	204,341	2,575,714	TOTALI SHPENZIMEVE	2,371,373	204,341	2,575,714
---------------------	-----------	---------	-----------	--------------------	-----------	---------	-----------

Burimi: Bashkia Vlorë qendra ekonomike

Tabela B/6 Pasqyra e ndryshimeve të buxhetit gjatë vitit 2022, Bashkia Vlorë dhe institucionet e varësisë Viti 2022 (000/ lekë)

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2022				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2022			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB 1	Buxheti shtesë, miratuar me VKB 2	Vlera në 000/lekë 1+2	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB 3	Buxheti shtesë miratuar me VKB 4	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë) 3+4
Të ardhura të planifikuara për vitin 2022	1.399.948		1.399.948	Art. 600 Paga	859.599	24.487	884.086
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe të planifikuara për shpenzim për vitin 2021		198.614	198.614	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	141.377	8.528	149.905
Total të ardhurat e veta	1.399.948	198.614	1.598.562	Art.602 Shpenzime operative	875.544	252.688	1.128.232
				Art.603 Shpenzime operative	31.177		31.177
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar	565.117		565.117	Art.604 Transferime korrente të brendshme	9.950	201	10.151
Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifike	429.407		429.407	Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	2.500	18.315	20.815
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2021		164.859	164.859	Art. 230-231 Investime	376.141	142.485	518.626
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2021		100.143	100.143	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	76.182	15.172	91.354
Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit te shtetit	994.524	265.002	1.259.526	651 Inters kredie	3.567		3.567
				166 Pricipal Krdie	18.435	1.740	20.175
TOTALI TE ARDHURAVE	2.394.472	463.616	2.858.088	TOTALI SHPENZIMEVE	2.394.472	463.616	2.858.088

Burimi :Bashkia Vlorë, qendra ekonomike

- Saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Vlorë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Gjatë vitit 2021 dhe vitit 2022 janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Vlorë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar të realizuar me Vendim të KB, ose të diktuar nga Transferta e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara, u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin është respektuar disiplina buxhetore.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. B/7: Pasqyra e buxhetit përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Vlorë, për vitin 2021 000/ lekë

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Vlorë, për vitin 2021, në mijë lekë				
Nr.	Përshkrimi i shpenzimeve	Plani 2021	Fakti 2021	Realizimi në %
1	Artikulli - 600 Paga	805.443	697.218	87

2	Artikulli - 601Sig. shoqërore &shend	134.229	114.360	85
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	1.062.067	659.569	62
4	Artikulli – 604 Transferita korrente te brendshme	4.000	3.962	99
5	Artikulli – 606 Transferime tek buxhetet familjare (Ndihma ek. Dhe PAK)	4.200	1.447	34
6	Artikulli – 609	89.099		0
7	Artikulli - 230 Projekte			
8	Artikulli - 231 Investime	476.676	230.800	48
	TOTAL viti 2021	2.575.714	1.707.356	66

Burimi: Bashkia Vlorë

Tabëla B/8 Pasqyra e buxhetit përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Vlorë, për vitin 2022 000/ lekë

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Vlorë, për vitin 2022, në mijë lekë				
Nr.	Përshkrimi i shpenzimeve	Plani 2022	Fakti 2022	Realizimi në %
1	Artikulli - 600 Paga	884.086	733.625	83
2	Artikulli - 601Sig. shoqërore &shend	149.905	121.718	81
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	1.128.232	812.358	72
4	Artikulli - 603	31.177	4.365	14
5	Artikulli - 604 Transferita korrente te brendshme	10.151	8.403	83
6	Artikulli - 606 Transferime tek buxhetet familjare (Ndihma ek. dhe PAK)	20.815	18.925	91
7	Artikulli - 230 Projekte ⁴			
8	Artikulli - 231 Investime	518.626	150.895	29
9	Artikulli - 651 Inters Kredie	3.567	1.227	34
10	Artikulli – 166 Kredi	20.175	20.079	99
11	Artikulli - 609	91.354	0	
	TOTAL viti 2022	2.858.088	1.871.595	65

Burimi: Bashkia Vlorë

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit varjon: Për vitin 2021 paraqitet i realizuar 1.707.356 mijë lekë nga 2.575.714 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 66%.

Në këtë masë realizimi ka ndikuar niveli i realizimit në zërat e buxhetit si vijon:

Për viti 2021 Shpenzimet për paga dhe sigurime Art. 600-601 janë realizuar 811,578 mijë lekë nga 939,672 mijë lekë të planifikuara ose në masën 86.3 %. Realizimi në këtë nivel për këto zëra shpenzimesh ka ardhur nga mos plotësimi i plotë i organikës. Shpenzimet operative Art. 602 është realizuar 659,569 mijë lekë nga 1,062,067 mijë lekë ose në masën 62 %. Ky mosrealizim ka ardhur si pasojë e mos likuidimit të shërbimit të pastrimit të qytetit. Shpenzimet për investime Art. 231 janë realizuar 230,800 mijë lekë nga 476,676 mijë lekë të planifikuara ose në masën prej 48%. Realizimi në këtë nivel për këto zëra shpenzimesh ka ardhur kryesisht nga mos realizimi i kryerjes së procedurave të prokurorimit në kohë. Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme Tabelab/8, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2021 paraqitet i realizuar 1,871,595 mijë lekë nga 2,858,635 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 65%. Në këtë masë realizimi ka ndikuar niveli i realizimit në zërat e buxhetit si vijon: Viti 2022 Shpenzimet për paga dhe sigurime Art. 600-601 janë realizuar 855,343 mijë lekë nga 1,033,991 mijë lekë të planifikuara ose në masën

83%. Realizimi në këtë nivel për këto zëra shpenzimesh ka ardhur nga mos plotësimi i plotë i organikës. Shpenzimet operative Art. 602 është realizuar 812.358 mijë lekë nga 1.128.232 mijë lekë ose në masën 72 %. Ky mosrealizim ka ardhur si pasojë e mos likuidimit të shërbimit të pastrimit të qytetit. Shpenzimet për investime Art. 231 janë realizuar 150.895 mijë lekë nga 518.626 mijë lekë të planifikuara ose në masën prej 29 %. Realizimi në këtë nivel për këto zëra shpenzimesh ka ardhur kryesisht nga mos realizimi i kryerjes së procedurave të prokurimit në kohë. Buxheti për vitin 2021 realizuar në masën 66%, për vitin 2021 dhe 65% për vitin 2022 .Këto mos realizime kanë ardhur si rezultat i vonesave në prokurime dhe në lidhje kontratash, apo realizime të vogla të të ardhurave të planifikuara. Mosrealizimet në programet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë tregon se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale. Peshën specifike me të madhe në buxhet nga të ardhurat e veta për vitin 2021 ndaj totalit e zënë ndihma ekonomike dhe PAK në masën 190.3 % ndjekur nga artikulli 231 në masën 110.4%. dhe shpenzimet operative 79.6%. Peshën specifike me të madhe në buxhet .Për vitin 2022 ndaj totalit e zënë shpenzimet operative në masën 55 % ndihma ekonomike dhe PAK në masën 54 % ndjekur nga artikulli 231 në masën 99 %. Tregues të cilat paraqiten në tabelat e mëposhtme.

Nga auditimi i tabelave të realizimit të tregueseve të buxhetit u konstatua se niveli i realizimeve për vitin 2021 është në masën 66 % dhe për vitin 2022 është në masën 65 % . Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Vlorë në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Gjithashtu, Bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) gjë e cila ndodh, por që nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës. Shpjegimet nga Drejtoria ekonomike për këtë diferencë midis planifikimit dhe realizimit jepen me mungesën e realizimit të të ardhurave. Nga ana tjetër konstatohet se nuk ka korrigjim të planit vjetor të buxhetit, në varësi të pritshmërisë dhe realizimit faktik gjatë vitit buxhetor, në mënyrë që të ngushtohet diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve. Bazuar në nenin 47 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, i ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ku thuhet: “ Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore bën një analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, edhe propozimet përkatëse për ndryshimin e vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, që ka miratuar buxhetin e vitit. Procedura e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve të vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore është e njëjtë me atë të vendimit për miratimin e buxhetit vjetor”, gjykojmë se duke parë trendin e realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, buxhetet e planifikuar mund të ishin korrigjuar, duke ju përshtatur realizimit faktik si të viteve të mëparshme, ashtu edhe të periudhës së vitit buxhetor. Në këtë mënyrë realizimi faktik i shpenzimeve do të ishte si vlerë më afër planifikimit. Gjithashtu në nenin 5 i ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, përcaktohet se në hartimin e buxhetit vjetor duhet bazuar në të ardhurat dhe shpenzimet faktike të viteve të mëparshëm.

Tabela nr. B/9: Pasqyra mbi peshën e shpenzimeve të mbuluara nga të ardhurat e veta Bashkia Vlorë viti 2021

Nr	Emërtimi	Fakt	Mbuluar Nga Të Ardhurat E Veta	Mbuluar Nga Të Ardhurat E Veta %
1	Artikulli - 600 Paga	516,683	98,774	19.1
2	Artikulli - 601 Sig. Shoqërore & Shëndetësore	84,434	4,867	5.8
3	Artikulli - 602 Shpenzime Operative	511,135	406,883	79.6
4	Artikulli - 604 Transferta Korrente Të Brendshme	3,962	38	1.0
5	Artikulli - 606 Transferime Tek Buxhetet Familjare (Ndihma Ek. Dhe PAK)	1,447	2,753	190.3
6	Artikulli - 231 Investime	211,255	233,305	110.4
	Totali	1,328,916	746,620	56.2

Burimi: Bashkia Vlorë, përpunoi grupi i auditimit.

Tabela nr. B/10: Pasqyra mbi peshën e shpenzimeve të mbuluara nga të ardhurat e veta Bashkia Vlorë viti 2022.

Nr	Emërtimi	Fakt	Mbuluar Nga Të Ardhurat E Veta	Mbuluar Nga Të Ardhurat E Veta %
1	Artikulli - 600 Paga	733.625	205.413	28
2	Artikulli - 601 Sig. Shoqërore & Shëndetësore	121.718	37.254	30
3	Artikulli - 602 Shpenzime Operative	812.358	449.433	55
4	Artikulli - 604 Transferta Korrente Të Brendshme	8.403	8.403	1.0
5	Artikulli - 606 Transferime Tek Buxhetet Familjare (Ndihma Ek. Dhe PAK)	18.925	10.204	54
6	Artikulli - 231 Investime	150.895	149.913	99
	Totali	1,845,924	860,620	47

Burimi: Bashkia Vlorë, përpunoi grupi i auditimit.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës

Në fillim të vitit 2021 fondi rezervë dhe i kontigjencës është planifikuar në masën 89,099 lekë. Ky fond nuk është shpenzuar gjatë vitit 2021.

Në fillim të vitit 2022 fondi rezervë dhe i kondegjencës është planifikuar 91,354 lekë dhe ky fond nuk është shpenzuar gjatë vitit.

Titulli i gjetjes: Planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli pa garantimin e fondeve për kryerjen e tyre.

Situata: Nga auditimi i tabelave të realizimit të tregueseve të buxhetit u konstatua se niveli i realizimeve për vitin 2021 është në masën 66 % dhe për vitin 2022 është në masën 65 % . Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Vlorë në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Gjithashtu, Bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) gjë e cila ndodh, por që nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës. Shpjegimet nga Drejtoria ekonomike për këtë diferencë midis planifikimit dhe realizimit jepen me mungesën e realizimit të të ardhurave. Nga ana tjetër konstatohet se nuk ka korrigjim të planit vjetor të buxhetit, në varësi të pritshmërisë dhe realizimit faktik gjatë vitit buxhetor, në mënyrë që të ngushtohet diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve.

Bazuar në nenin 47 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, i ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ku thuhet: “ Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore bën një analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, edhe propozimet përkatëse për ndryshimin e vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, që ka miratuar buxhetin e vitit. Procedura e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve të vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore është e njëjtë me atë të vendimit për miratimin e buxhetit vjetor”, gjykojmë se duke parë trendin e realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, buxhetet e planifikuar mund të ishin korrigjuar, duke ju përshtatur realizimit faktik si të viteve të mëparshme, ashtu edhe të periudhës së vitit buxhetor. Në këtë mënyrë realizimi faktik i shpenzimeve do të ishte si vlerë më afër planifikimit. Gjithashtu në nenin 5 i ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, përcaktohet se në hartimin e buxhetit vjetor duhet bazuar në të ardhurat dhe shpenzimet faktike të viteve të mëparshëm.

Kriteri: Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe nenin 47 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, nenet 50 - 51 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; nenet 79 -80 -81, të udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime, si dhe pika 1 e nenit 4 dhe neni 76 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Shkaku: Planifikim i procedurave të prokurimeve për mallra/ shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke i planifikuar ato në raport me planin dhe jo me faktin, ku sipas ë dhënave të Drejtorisë së Taksave realizimi i të ardhurave për asnjërin nga periudhat nuk paraqitet me realizim.

Efekti: Si rezultat i planifikimit të procedurave pa siguruar burimin e tyre, i cili vjen nga të ardhurat, mbështetja e tyre në planin e të ardhura kur ky plan nuk realizohet dhe mos parashikimi i faturave të palikujduara, çojnë në rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Vlorë, të marrë masa që:

- Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.
- Planifikimi i procedurave për investime/ shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave dhe jo të planifikimit, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (faturave të palikujduara), në fund të periudhës, duke planifikuar ato shërbim dhe investime më të domosdoshme për nevojat e Bashkisë Vlorë.
- Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

Nga subjekti i audituar, Bashkia Vlorë mbi projekt raportin nr. 1026/28 prot; datë 28.09.2023, janë paraqitur kundërshti nga z. T. Z. me shkresën nr. 11597 prot; datë 27.10.2023, në cilësinë ish -

Drejtorit të Financës dhe Kontabilitetit, Bashkia Vlorë, i cili ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimi i subjektit:

Ne lidhje me gjetjen e mësipërme janë dorëzuar kundërshtimet si më poshtë, nga punonjësi T. Z.. Në Projekt Raport në faqen 34 audituesit theksojnë se Bashkia Vlorë në fillim të vitit buxhetor ka planifikuar procedurat e prokurimit publik duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifave vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuar ku thekson më poshtë se Drejtoria Ekonomike për këto diferenca midis planifikimit dhe realizimit ka dhënë shpjegimin se diferenca ka ardhur nga mungesa e realizimit të të ardhurave dhe nga ana tjetër nuk ka korrigjim të planit vjetor të buxhetit. Për këtë ish DFBK-it për buxhetin e audituar të vitit 2021 shpreh argumentat e tij kundra këtij konkluzioni dhe nuk ka dhënë për këtë periudhë auditimi shpjegim për diferencat e ndodhura. Për të argumentuar për sa thashë më lart, i referohem nenit 47- Rishikim i zbatimit të buxhetit vendor, i ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë. Konkluzioni im (ish DFBK-it) është : planifikimet për procedurat e prokurimit publik në fillim të vitit 2021 janë plotësisht të argumentuara duke u nisur nga plani real i të ardhurave të planifikuara sipas legjislacionit në fuqi dhe korrigjimet gjatë vitit bëhen duke u mbështetur po nga ky legjislacion dhe nuk bëhen duke mos bërë analiza dhe nxjerrë përgjegjësi për shkaqet e mosrealizimit të të ardhurave të ligjshme. Duhet të bazohet në nenin 46 të ligjit 68/2017 , gjë të cilën në këtë vit jo vetëm që nuk ka bërë asnjë analizë me drejtuesit e ekipeve të programeve ,por e ka penguar realizimin e kësaj gjëje, ku unë si nënpunës autorizues do të jap faktet e mëposhtme të dokumentuara dhe që duhet të analizohen nga grupi i auditimit përgjegjës të secilit, ashtu sic e përcakton udhëzimi nr.1 datë 02.04.2014 cituar më lart për përgjegjësitë e gjithësecilit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Duke marrë shkas nga pretendimi juaj, grupi i auditimit thekson se një planifikim real duhet të mbështetet në realizimin faktik të viteve të fundit, në ngarkesën fiskale apo në numrin e taksa paguesve, në paketën fiskale si dhe të bëhen analiza mbi përqindjen e realizimit me qëllim të zvogëlohen diferencat midis planifikimit dhe realizimit. Duke mos vepruar në këtë mënyrë kjo sjellë Planifikim jo efektiv të procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli pa garantimin e fondeve për kryerjen e tyre.

Përsa i përket kundërshtimit tuaj theksojmë se nuk është në koherencë me gjetjen dhe me parashikimet e ligjeve, pikën (a) të nenit 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe nenin 47 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, nenet 50 - 51 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; nenet 79 -80 -81, të udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime, si dhe pika 1 e nenit 4 dhe neni 76 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) gjë e cila ndodh, por që nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

Me fondet e vitit buxhetor 2021 dhe vitit 2022 , janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të pa likuiduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përbaluara me fondet e veta.

Detyrimet e pa likuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës “Detyrimet e prapambetura”, sipas llojeve të detyrimeve të grupuara në raportin vjetor të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Tabela nr. B/11: Raportimi në MFE i detyrimeve të prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2021.
000 lekë

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit 2021 i mbartur nga viti 2020 (në 000 lekë)	Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021 (në 000 lekë)	Total detyrime (në lekë)	Shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2021 (në 000 lekë)	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2021 (në 000 lekë)
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
Investime	49,875	167,728	217,603	211,255	6,348
Vendime gjyqësore		15,980	15,980	15,980	
Mallra dhe shërbime	175,979	419,137	595,116	511,135	99,961
Kredi	20,889		20,889	11,959	8,930
Totali	246,743	602,845	849,588	750,329	115,239

Burimi: Bashkia Vlorë, qendra ekonomike

Tabela nr. B/12: Raportimi në MFE i detyrimeve të prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2022.
000 lekë

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur nga viti 2021 (në 000 lekë)	Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 (në lekë)	Total detyrime (në 000 lekë)	Shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2022 (në 000 lekë)	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2022 (në 000 lekë)
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
Investime	6.348	210.506	216.854	150.895	65.959
Vendime gjyqësore					
Mallra dhe shërbime	108.891	750.713	859.604	812.249	47.355
.....					
Totali	115.239	961.219	1.076.458	963.144	113.314

Burimi: Bashkia Vlorë, qendra ekonomike

Bashkia Vlorë ka dërguar në MFE raportimin e detyrimeve të prapambetura për vitin 2021, paraqitur në tabelën e mësipërme. Rezulton se detyrimet në mbyllje të vitit 2021 janë në shumën 115,239 mijë lekë. Për vitin 2022 nga analiza e detyrimeve të prapambetura për vitin 2022, rezulton që, në fund të vitit 2022 rezultojnë detyrime të prapambetura në vlerën 113.314 mijë lekë. Këto detyrime janë të krijuara që nga vitet 2011. Sipas zërave mallra ,shërbime dhe investime.

Detyrimet të prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2022 bashkë me institucionet e varësisë janë të raportuara në MFE janë të rakorduara me Degën e Thesarit Vlorë. Raportimi në degën e thesarit është bërë sipas udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga drejtoria financës dhe e buxhetit rezulton se për vitin 2021 nga analiza e detyrimeve të prapambetura për vitin 2021, të paraqitura në rezultat që, në fund të vitit 2021 është e pa likuiduar vlera 115,239 mijë lekë. Këto detyrime janë të krijuara që nga vitet 2011. Sipas zërave mallra ,shërbime dhe investime, kredi.

- Detyrimet e pa likuidura për investime dhe kredi për vitin 2021:

- Rikonstrukcione “A.” ShPK me vlerë detyrimi 6.347.911 lekë
- Kredia në vlerën 8.930.189 lekë
- Në total detyrime në vlerën 15.278.100 lekë të pasqyruara në aneksin nr. 3 bashkëlidhur.

Detyrimet e pa likuidura për mallra dhe shërbime viti 2021.

Ng auditimi rezultoi se faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2021 për mallra dhe shërbime jnaë në vlerën 99.961.366 lekë bashkëlidhur në aneksin nr. 4.

Duke iu referuara anekseve përkatëse vërehet se detyrimet e prapambetura janë të akumuluar para vitit 2021.

Analiza dhe shlyerja e detyrimeve për vendimet gjyqësore.

Detyrimet e prapambetura për vendimet gjyqësore sipas vitit të krijimit, objektit të padisë, likuidimeve të kryera, gjendjet në fund për vitin 2021 paraqiten në Aneksin nr. 5.

Nga auditimi i dokumentacionit për detyrime për vendime gjyqësore, rezulton se nga Bashkia Vlorë janë krijuar detyrime të prapambetura në vlerën 15,980,087 lekë dhe këto detyrime janë likuiduar në vitin 2021.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga drejtoria financës dhe e buxhetit rezulton se për vitin viti 2022: nga analiza e detyrimeve të prapambetura, në fund të vitit 2022 është e pa likuiduar vlera 113.314 mijë lekë. Detyrimet të prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2022 bashkë me institucionet e varësisë.

Disa nga analizat e sipas zërave viti 2022:

Detyrimet e pa likuidura për investime dhe kredi për vitin 2022.

Nga auditimi rezultoi se faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2022 për investimet janë në vlerën 65,959,393 lekë.

Detyrimet e pa likuidura për mallra dhe shërbime viti 2022.

Nga auditimi rezultoi se faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2022 për mallra dhe shërbime janë në vlerën 47,354,915 lekë. Bashkëlidhur në aneksin nr. 8.

Duke iu referuara anekseve përkatëse vërehet se detyrimet e prapambetura janë të akumuluar para vitit 2022.

- Analiza dhe shlyerja e detyrimeve për vendimet gjyqësore.

Detyrimet e prapambetura për vendimet gjyqësore sipas vitit të krijimit, objektit të padisë, likuidimeve të kryera, gjendjet në fund për vitin 2022 paraqiten në Aneksin nr. 9.

Nga auditimi i dokumentacionit për detyrime për vendime gjyqësore, rezulton se nga Bashkia Vlorë janë krijuar detyrime të prapambetura nga vitet në vlerën 9.921.6321 lekë dhe këto detyrime janë likuiduar në vitin 2022. Nga auditimi i dokumentacionit për detyrimet ndaj vendimeve

gjyqësore, u konstatua se nuk ka pasur vendime gjyqësore të palikuiduara për marrëdhëniet e punës dhe detyrimet kontraktuale.

- Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga drejtorja e financës në lidhje me planin të shshlyerjes së detyrimeve të prapambetura rezulton se detyrimi i mbetur ne dhjetor 2020 është në shumën 246,000 mijë lekë dhe shuma e parashikuar për shlyerje përgjatë tre viteve është sipas planit për vitin 2021 në shumën 212,745 mijë lekë për vitin 2022 në shumën 120,000 mijë lekë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtorja e Financës dhe e Buxheti vërehet se gjatë vitit 2021 janë shlyer 750,329 mijë lekë nga 212,745 mijë lekë të parashikuara. Duke iu referuar planit të shlyerjes së stokut të detyrimeve të prapambetura për vitin 2022, nuk është përcaktuar detyrimi i mbetur Detyrimi në fillim të vitit i mbartur nga viti 2021, dhe nuk është parashikuar shlyerja e detyrimit që duhet të shlyej gjatë vitit 2022.

Për sa më sipër rezulton se marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”.

- Faturat e palikuiduara brenda afatit 60 ditor.

Auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin afatit 60-ditor të paraqitjes në Degën e Thesarit Vlorë të urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 01/01/2021–31/12/2021 janë faturat e pa likuiduara janë 37 fatura 1 faturë për investime për subjektin A. ShPK faturë nr. 28 datë 27.07.2021 për vlerën 6,347,911 lekë dhe 36 fatura për shpenzime operative në vlerën 103,820,677 lekë. Pasqyruar në *Aneksin nr. 11*. Për vitin 2022 u konstatua se për periudhën 01/01/2022 - 31/12/2022 janë 7 fatura të pa likuidura nga te cilat për investime në vlerën 7,218,763 lekë dhe Faturat e pa likuiduara për shpenzime operative në vlerën 681,124 lekë pasqyruar në *Aneksin nr. 12*.

Gjithashtu nga Bashkia Vlorë (Drejtorja e Financës/Buxhet), ka edhe fatura të cilat nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë, duke kryer pagesa pjesore të tyre, e cila ka si shkak mungesën e fondeve nga realizmi i të ardhurave vendore. Për periudhën 01/01/2021 – 31/12/2022, paraqiten gjithsej 13 fatura me vlerë 165,694,990 lekë, nga e cila: për vitin 2021 paraqiten 9 fatura me vlerë 148,964,705 lekë, për vitin 2022 paraqiten 5 fatura me vlerë 16,730,285 lekë. sipas *Aneksit nr. 6* dhe *Aneksit nr. 10*.

Sa i përket likuidimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, konstatohet se nuk respektohet rradha e likuidimit të tyre, pra fatura e parë likuidohet më parë.

Titulli i gjetjes : Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura dhe raportimi i tij në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë si dhe marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion. Fatura të pa likuiduara brenda afatit 30 ditor, duke krijuar në fund të vitit buxhetor detyrime të prapambetura.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga drejtorja e financës në lidhje me planin të shshlyerjes së detyrimeve të prapambetura rezulton se detyrimi i mbetur ne dhjetor

2020 është në shumën 246,000 mijë lekë dhe shuma e parashikuar për shlyerje përgjatë tre viteve është sipas planit për vitin 2021 në shumën 212,745 mijë lekë për vitin 2022 në shumën 120,000 mijë lekë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe e Buxheti vërehet se gjatë vitit 2021 janë shlyer 750,329 mijë lekë nga 212,745 mijë lekë të parashikuara. Duke iu referuar planit të shlyerjes së stokut të detyrimeve të prapambetura për vitin 2022, nuk është përcaktuar detyrimi i mbetur Detyrimi në fillim të vitit i mbartur nga viti 2021, dhe nuk është parashikuar shlyerja e detyrimit që duhet të shlyej gjatë vitit 2022.

Për sa më sipër rezulton se marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”.

Auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin afatit 60-ditor të paraqitjes në Degën e Thesarit Vlorë të urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 01/01/2021–31/12/2021 janë faturat e pa likuiduara janë 37 fatura 1 faturë për investime për subjektin A. ShPK faturë nr. 28 datë 27.07.2021 për vlerën 6,347,911 lekë dhe 36 fatura për shpenzime operative në vlerën 103,820,677 lekë. Pasqyruar në *Aneksin nr. 11*. Për vitin 2022 u konstatua se për periudhën 01/01/2022–31/12/2022 janë 7 fatura të pa likuidura nga te cilat për investime në vlerën 7,218,763 lekë dhe Faturat e pa likuiduara për shpenzime operative në vlerën 681,124 lekë pasqyruar në *Aneksin nr. 12*.

Gjithashtu nga Bashkia Vlorë (Drejtoria e Financë/Buxhet), ka edhe fatura të cilat nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë, duke kryer pagesa pjesore të tyre, e cila ka si shkak mungesën e fondeve nga realizmi i të ardhurave vendore. Për periudhën 01/01/2021 – 31/12/2022, paraqiten gjithsej 13 fatura me vlerë 165,694,990 lekë, nga e cila: për vitin 2021 paraqiten 9 fatura me vlerë 148,964,705 lekë, për vitin 2022 paraqiten 5 fatura me vlerë 16,730,285 lekë. sipas *Aneksit nr. 6* dhe *Aneksit nr. 10*.

Sa i përket likuidimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, konstatohet se nuk respektohet rradha e likuidimit të tyre, pra fatura e parë likujdohet më parë.

Kriteri: Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës

Efekti: Mospasqyrimi real i stokut të detyrimeve të prapambetura, mos likuidim i faturave brenda afatit 30 ditor.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtoria e Financë/ Buxhet Bashkia Vlorë, të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 60 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit

të detyrimeve të reja prapambetura. Gjithashtu të merren masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitet e mëparshme.

Nga subjekti i audituar, Bashkia Vlorë, mbi projekt raportin nr. 1026/28 prot; datë 28.09.2023, janë paraqitur kundërshti nga z. T. Z. me shkresën nr. 11597 prot; datë 27.10.2023, në cilësinë ish - Drejtorit të Financës dhe Kontabilitetit, Bashkia Vlorë, i cili ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimi subjektiv:

Për sa i përket rekomandimit të bërë në faqen 36 “Për vlerësimin e risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likujduara” dhe sidomos ato të pa likujduara brenda afatit 30 ditor (fq.39) komentoj dhe shpjegoj se ish DFBK-it në buxhetin e vitit 2021 i ka planifikuar faturat e pa likujduara dhe i ka likujduar ato duke ndjekur radhën e regjistrimit si detyrim i kontabilizuar, ketu përjashtoj ato fatura që nënpunësi autorizues nuk i firmoste pa dhënë asnjë shkak të mosfirmosjes së tyre , permend këtu faturat e pa likujduara të FPM-së (ruajtja e objekteve private) dhe firmës së pastrimit (firma “D.” ShPK) që nuk i firmoste asnjë situacion apo faturë mujore. Për këtë ish DFBK-it si nënpunës zbatues po ju vendos në dispozicion shkresën nr.11933 prot; datë 27.09.2021, ku prefektit të qarkut i është kthyer përgjigje për detyrimet e pashlyera deri në 31.08.2021. Audituesit të lexojnë shënimin që bën nënpunësi autorizues për mos likuidimin e faturave të subjektit FPM edhe pse sipas akteve të rakordimit me thesarin, Bashkia ka patur gjendje kreditore për cdo fund muaji jo më pak se 100 milion lekë. Mbi bazën e kësaj të nxjerr dhe përgjegjësinë e stokut të këtij borxhi (cila është përgjegjësia e nënpunësit zbatues në këtë rast ish DFBK-it dhe cila është përgjegjësia e nënpunësit autorizues në këtë rast ish kryetari.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Duke analizuar me kujdes qëndrimin tuaj për pretendimet që keni lidhur me nivelin e faturave të palikujduara, qoftë ato të pa likujduara brenda afatit 30 ditor apo 60 ditor, nga ana juaj nuk janë përcjell ato dokumente, ku të vërtetojnë pagesat e tyre sipas afateve aq me teper rradhën e pagesave. Duke iu referuar planit të shlyerjes së stokut të detyrimeve të prapambetura për vitin 2022, nuk është përcaktuar detyrimi i mbetur, detyrimi në fillim të vitit i mbartur nga viti 2021, dhe nuk është parashikuar shlyerja e detyrimit që duhet të shlyej gjatë vitit 2022. Grupi i auditimit saktësisht i është referuar bazës ligjore më lart ku autoriteti kontraktor duhej ta kishte në referencë gjatë procedurave sipas rastit.

- Celja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Me miratimin e buxhetit vjetor janë miratuar dhe projektet për investime. Investimet kryesisht janë me burim financimi nga transfertat e pakushtëzuar, të ardhurat e veta të Bashkisë Vlorë.

Në vitin 2021 për realizimin e investimeve janë përdorur fondet e Bashkisë nga të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar në, rehabilitim ujësjellësi, sistemim riasfaltim, rikonstruksion rrugësh dhe lagjesh, dhe blerje materiale të ndryshme. Për vitin 2021 janë planifikuar fonde për investime në shumën 476,676 mijë lekë dhe janë realizuar në masën 230,800 mijë lekë ose në masën 48%. Detyrimet për investime, për vitin 2021 është mbartur nga viti 2020 është 49,875 mijë lekë. Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2021 është 167,728 mijë lekë, totali i detyrimeve është në vlerën 217,063 mijë lekë, shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2021 është në vlerën 215,255 mijë lekë dhe detyrimet në fund të vitit 2021 janë 6,348 lekë. Përsa i përket detyrimet për mallra dhe shërbime, detyrimi në fillim të vitit 2021, është i mbartur nga viti 2020 në vlerën 175,979 mijë lekë. Detyrimi

i krijuar në 2021 është në vlerën 419,137 lekë, totali i detyrimeve është në vlerën 595,166 lekë, shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2021 është 11.959 lekë mbetja e detyrimit në fund të vitit 2021 është 8,930 mijë lekë. Detyrimi për kredi për vitit 2021 i mbartur nga viti 2020 është 20,889 lekë. Totali i detyrimeve është në vlerën 20,889 mijë lekë, shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2021 është në vlerën 11,959 mijë lekë dhe detyrimet në fund të vitit 2021 janë 8,930 mijë lekë objektet e investimeve me të dhënat analitike për datën dhe vlerën e kontratës, si dhe likuidimet e tyre paraqiten sipas anekseve.

Në vitin 2022 për realizimin e investimeve janë përdorur fondet e Bashkisë nga të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar në, rehabilitim ujësjellësi, sistemim riasfaltim, rikonstruksion rrugësh dhe lagjesh, dhe blerje materiale të ndryshme. Për vitin 2022 janë planifikuar fonde për investime në shumën 518,626 mijë lekë dhe janë realizuar në masën 230,800 mijë lekë ose në masën 48 % . Detyrimet për investime, për vitin 2022 është mbartur nga viti 2021 është 6.348 mijë lekë. Detyrimi i krijuar në 2022 është në vlerën 210,506 lekë, totali i detyrimeve është në vlerën 216,854 lekë, shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2022 është 150,895 mijë lekë dhe mbetja e detyrimit gjatë vitit 2022 është në vlerën 65,959 mije lekë. Detyrimi për mallra dhe shërbime për vitit 2022 i mbartur nga viti 2021 është në vlerën 108.891 mijë lekë, detyrimi i krijuar gjatë vitit 2022 është në vlerën 750,713 mijë lekë dhe në total detyrime janë në masën 859, 604 mijë lekë , shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2022 është në vlerën 812,249 mijë lekë mbetja e detyrimeve në fund të periudhës është në vlerën 47,355 mijë lekë.

- Burimet e financimit të buxhetit vjetor

Tabela nr. B/13: Realizimi i buxhetit total (Bashkia + Institucionet e varësisë) për vitin 2021 sipas burimit të financimit.

Nr.	Emërtimi	2021		
		Plan	Fakt	Real.%
1	Paga 600	805,443	697,218	86.5
a	Grant i kushtëzuar	202,044	201,568	99.7
b	Grant i pakushtëzuar + transfertat specifike	337,273	306,519	91
c	Të ardhura	266,126	189,131	71
2	Sigurime shoqërore 601	134,229	114,360	85
a	Grant i kushtëzuar	32,749	32,649	99.7
b	Grant i pakushtëzuar + transfertat specifike	56,872	50,601	89
c	Të ardhura	44,608	31,110	69.7
3	Shpenzime Operative 602,603 .651,166	1,062,067	659,569	62
a	Grant i kushtëzuar	318,477	197,652	62
b	Grant i pakushtëzuar + transfertat specifike	55,918	35,716	63.8
c	Të ardhura	687,672	426,201	62
4	Transferta korrente të brendshme 604	4,000	3,962	99
a	Grant i kushtëzuar			
b	Grant i pakushtëzuar + transfertat specifike			
c	Të ardhura	4,000	3,962	99
5	Nd. Ekonomike 606	4,200	1,447	34
a	Grant i kushtëzuar			
b	Grant i pakushtëzuar + transfertat specifike			
c	Të ardhura	4,200	1,447	34.5
6	Investime 231	476,676	230,800	48
I	Buxheti i bashkisë (Grant + të ardhura)			
a	Grant i pakushtëzuar + transfertat specifike	39,364	4,173	10.6
b	Të ardhura	437,312	226,627	51.8
II	Ministritë e linjës + FZHR			
7	Emergjencia 609	89,099	0	
a	Grant i kushtëzuar	21,649	0	

Nr.	Emërtimi	2021		
		Plan	Fakt	Real.%
b	Grant i pakushtëzuar + transferta specifike	15,172	0	
c	Të ardhura	52,278	0	
	Bashkia	2,575,714	1,707,356	66%

Burimi: Bashkia Vlorë

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se me të ardhurat e veta kjo bashki përballon në fakt për vitin 2021

- Shpenzimet në artikullin 600 “paga e shpërblime” në masën 71% .
- Shpenzimet në artikullin 601 “kontributin për sigurime shoqërore e shëndetësore” në masën 69.7 %.
- Shpenzimet në artikullin 602 “shpenzime operative për mallra e shërbime” në masën 62 %.
- Shpenzimet në artikullin 230-231 “investime” në masën 51.8 %.

Referuar burimit të financimit, shpenzimet buxhetore në total janë përballuar:

Për vitin 2021, nga të ardhurat e veta në shumën 878,478 mijë lekë ose në masën 51 %, nga transferta e pakushtëzuar dhe transferta specifike në shumën 397,009 mijë lekë ose në masën 23.2 %. Nga Granti i kushtëzuar 431,869 mijë lekë ose në masën 25.2 %.

Tabela nr. B/14: Realizimi i buxhetit total (Bashkia + Institucionet e varësisë) për vitin 2022 sipas burimit të financimit. 000 lekë

Nr.	Emërtimi	2022		
		Plan	Fakt	Real.%
1	Paga 600	884,086	733,625	
a	Grant i kushtëzuar	220,447	206,387	94
b	Grant i pakushtëzuar + transferta specifike	352,164	321,826	91
c	Të ardhura	311,475	205,412	66
2	Sigurime shoqërore 601	149,905	121,718	81
a	Grant i kushtëzuar	35,309	31,261	89
b	Grant i pakushtëzuar + transferta specifike	62,908	53,202	85
c	Të ardhura	51,688	37,255	72
3	Shpenzime Operative 602	1,128,232	812,358	72
a	Grant i kushtëzuar	448,274	327,077	73
b	Grant i pakushtëzuar + transferta specifike	45,574	35,847	79
c	Të ardhura	634,384	449,434	71
4	inters kredi 651	3,567	1,227	34
a	Grant i kushtëzuar	189	189	100
b	Grant i pakushtëzuar + transferta specifike			
c	Të ardhura	3,378	1,038	31
5	kredi 166	20,175	20,079	100
a	Grant i kushtëzuar	3,152	3,152	100
b	Grant i pakushtëzuar + transferta specifike			
c	Të ardhura	17,023	16,927	99
6	Shpenzime Operative 603	31,177	4,365	14
a	Grant i kushtëzuar			
b	Grant i pakushtëzuar + transferta specifike			
c	Të ardhura	31,177	4,365	14
7	Transferta korrente të brendshme 604	10,151	8,403	83
a	Grant i kushtëzuar	0	0	
b	Grant i pakushtëzuar + transferta specifike	0	0	

Nr.	Emërtimi	2022		
		Plan	Fakt	Real.%
c	Të ardhura	10,151	8,403	83
8	Nd. Ekonomike 606	20,815	18,925	91
a	Grant i kushtëzuar	820	820	100
b	Grant i pakushtëzuar + transferta specifike	8,120	7,900	97
c	Të ardhura	11,875	10,205	86
9	Investime 230-231	518,626	150,895	29
I	Buxheti i bashkisë (Grant + të ardhura)			
a	Grant i pakushtëzuar + transferta specifike	36,057	983	3
b	Të ardhura	482,569	149,912	31
II	Ministritë e linjës + FZHR			
10	Emergjencia 609	91,354	0	0
a	Grant i kushtëzuar	22,605	0	0
b	Grant i pakushtëzuar + transferta specifike	15,172	0	0
c	Të ardhura	53,577	0	0
	Bashkia	2,858,088	1,871,595	65

Burimi: Bashkia Vlorë

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se **me të ardhurat e veta** kjo bashki përballon në fakt për vitin 2022.

- Shpenzimet në artikullin 600 “paga e shpërblime” në masën 66% .
- Shpenzimet në artikullin 601 “kontributin për sigurime shoqërore e shëndetësore” në masën 72%.
- Shpenzimet në artikullin 602 “shpenzime operative për mallra e shërbime” në masën 71 %.
- Shpenzimet në artikullin 230-231 “investime” në masën 29 %.

Referuar burimit të financimit, shpenzimet buxhetore në total janë përballuar:

Për vitin 2022, nga të ardhurat e veta në shumën 882,951 mijë lekë ose në masën 47 %, nga transferta e pakushtëzuar dhe transferta specifike në shumën 419,758 mijë lekë ose në masën 22.4 %. Nga Granti i kushtëzuar 568,886 mijë lekë ose në masën 30 %.

Tabela B/15 Vështirësia financiare Viti 2021

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	8,930,189		
a	Hua afatgjatë	8,930,189		
b	Hua afatshkurtër	0		
II	Detyrime (a+b+c)	106,308,900		4.48%
a	Shpenzime korrente	99,960,989		
a.1	Mallra dhe shërbime	99,800,365		
a.2	Paga dhe sigurime			
a.3	Të tjera	160,624		
b	Shpenzime kapitale	6,347,911		
b.1	Institucione buxhetore	6,347,911		
c	Vendime gjyqësore	0		
c.1	Marrëdhënie pune			
c.2	Mallra dhe Shërbime			

	Totali (I+II)	115,239,089	2,371,373,000	4.86%
--	----------------------	-------------	---------------	-------

Burimi: Bashkia Vlorë

Tabela B/16 Vështirësia financiare Viti 2022

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	2,410,460		
a	Hua sftatgjatë	2,410,460		
a,1	Principali	2,410,460		
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	110,903,848		5.93%
a	Shpenzime korrente	44,944,455		
a,1	Mallra dhe shërbime	44,944,455		
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera			
b	Shenzime kapitale	65,959,393		
b,1	Insitucione buxhetore	65,959,393		
b,2	Subjekte private			
c	Vendime gjyqësore	0		
c,1	Marrëdhënie pune			
c,2	Mallra dhe shërbime			
c,3	Investime			
c,4	Të tjera			
				%
III	Totali (I+II)	113,314,308	1,871,195,018	6.06%

Burimi: Bashkia Vlorë

Vështirësia financiare e Bashkisë Vlorë është llogaritur referuar përcaktimeve të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, kreu XI “Vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre”, neni 55. Referuar pikës 1 të nenit “Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet me probleme financiare kur në një muaj të caktuar të vitit buxhetor konstatohen vonesa prej më shumë se 30 ditësh në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta dhe kur detyrimet e konstatuara dhe të papaguara përbëjnë 15% të shpenzimeve vjetore të miratuara”. Nga të dhënat e audituara në Bashkinë Vlorë dhe të paraqitura në tabelën më sipër vlera e detyrimeve të prapambetura në Bashkinë Vlorë më 31.12.2021 është 4.86%. Vlera e detyrimeve të prapambetura në Bashkinë Vlorë më 31.12.2022 është 6.06 %.

- Raportet e Monitorimit

Për vitin 2021 nga Bashkia Vlorë janë përgatitur 3 raporte për monitorimin e procesit të zbatimit të buxhetit. Raporti i monitorimit për periudhën janar-prill 2021 nr. 8307 Prot, datë 24.05.2021,

raporti i monitorimit për periudhën janar-gusht 2021 si dhe raporti i monitorimit nr. 2663/2 Prot, datë 15.03.2022 për periudhën janar-dhjetor 2021. Për vitin 2022 nga Bashkia Vlorë janë përgatitur 3 raporte për monitorimin e procesit të zbatimit të buxhetit. Raporti monitorimit për periudhën janar-prill 2022 nr.6191 prot datë 3105.2022, raporti i monitorimit për periudhën janar – gusht 2022 nr. 11169, datë 04.10.2022. për periudhën janar- Dhjetor 2022 me nr. 4065 datë 04.04.2023.

Nga auditimi rezulton se, raportet e monitorimit janë paraqitur në Këshillin Bashkiak në zbatim të përcaktimeve ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48. Kryetari i Bashkisë Vlorë nuk ka miratuar rregullat specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Raportet e monitorimit nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 “Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë”, të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore". Raportet e monitorimit nuk janë të plota pasi nuk janë plotësuar të gjitha anekset sipas kërkesave të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, Aneksi nr. 1 “Raporti i shpenzimeve sipas programeve”, Aneksi nr. 2 “Raporti i shpenzimeve të programeve sipas artikujve buxhetorë”, Aneksi nr. 3 "Raporti i realizimit të produkteve të programit", Aneksi nr. 4 "Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit” dhe Aneksi nr. 5 "Projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe me financim të huaj". Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", pika 10, 48, 59.

Konkluzion i përgjithshëm:

Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2021 u konstatua se:

Viti :2021

1. Fondet buxhetore janë realizuar në shumën 1,871,595 mijë lekë nga 2,858,088 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 65%. Pra kemi një realizim jo dhe aq të kënaqshëm të fondeve të programuara, ku në mos realizimin e tyre kanë ndikuar niveli i realizimit në zërat e buxhetit si vijon :

- Shpenzimet për paga dhe sigurime Art. 600-601 janë realizuar 811,578 mijë lekë nga 939,672 mijë lekë të planifikuara ose në masën 86.3 %. Realizimi në këtë nivel për këto zëra shpenzimesh ka ardhur nga mos plotësimi i plotë i organikës.

- Shpenzimet operative Art. 602 është realizuar 659,569 mijë lekë nga 1,062,067 mijë lekë ose në masën 62 %. Ky mosrealizim ka ardhur si pasojë e mos likuidimit të shërbimit të pastrimit të qytetit.

Shpenzimet për investime Art. 231 janë realizuar 230,800 mijë lekë nga 476,676 mijë lekë të planifikuara ose në masën prej 48%. Realizimi në këtë nivel për këto zëra shpenzimesh ka ardhur kryesisht nga mos realizimi i kryerjes së procedurave të prokurorimit në kohë.

Bashkia Vlorë ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në vlera relativisht të konsiderueshme, ku në fund të vitit 2020 janë në vlerën 246,743 mijë lekë, dhe në fund të vitit 2021 janë në vlerën 115,239 mijë lekë.

Nga analiza e detyrimeve të prapambetura për vitin 2021, të paraqitura në Anekset përkatëse rezulton që, në fund të vitit 2021 është e pa likuiduar vlera 115,239 mijë lekë lekë. Këto detyrime janë të krijuara që nga vitet 2011. Sipas zërave mallra, shërbime dhe investime.

2. Detyrimet e pa likujdura për investime dhe kredi për vitin 2021:

- Rikonstrukcione "A." ShPK me vlerë detyrimi 6.347.911 lekë
- Kredia në vlerën 8.930.189 lekë
- Në total detyrime në vlerën 15.278.100 lekë të pasqyruara në *Aneksin nr. 3*, bashkëlidhur.

Detyrimet e pa likujdura për mallra dhe shërbime viti 2021.

Nga auditimi rezultoi se faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2021 për mallra dhe shërbime jnaë në vlerën 99.961.366 lekë bashkëlidhur në *Aneksin nr. 4*.

3. Analiza dhe shlyerja e detyrimeve për vendimet gjyqësore.

Detyrimet e prapambetura për vendimet gjyqësore sipas vitit të krijimit, objektit të padisë, likuidimeve të kryera, gjendjet në fund për vitin 2021 paraqiten në *Aneksin nr. 5*.

Nga auditimi i dokumentacionit për detyrime për vendime gjyqësore, rezulton se nga Bashkia Vlorë janë krijuar detyrime të prapambetura nga vitet në vlerën 15,980,087 lekë . dhe këto detyrime janë likuajduar në vitin 2021.

4. Referuar treguesve të të ardhurave të realizuara, konstatohet se financimi i buxhetit vjetor 2021 është bërë në masën prej 66 %.

Viti: 2022

5. Fondet buxhetore janë realizuar në shumën 1,707,356 mijë lekë nga 2,575,714 mijë lekë të planifikuara, ose në masën **65%**. Pra kemi një realizim jo dhe aq të kënaqshëm të fondeve të programuara, ku në mos realizimin e tyre kanë ndikuar niveli i realizimit në zërat e buxhetit si vijon :

- Shpenzimet për paga dhe sigurime Art. 600-601 janë realizuar 811,578 mijë lekë nga 993,991 mijë lekë ose në masën 81.6%. Realizimi në këtë nivel për këto zëra shpenzimesh ka ardhur nga mos plotësimi i plotë i organikës.

- Shpenzimet operative Art. 602 është realizuar 812,358 mijë lekë nga 1,128,232 mijë lekë ose në masën 72%. Ky mosrealizim ka ardhur si pasojë e mos likuidimit të shërbimit të pastrimit të qytetit.

- Shpenzimet për investime Art. 231 janë realizuar 150,895 mijë lekë nga 518,626 mijë lekë të planifikuara ose në masën prej 29 %. Realizimi në këtë nivel për këto zëra shpenzimesh ka ardhur kryesisht nga mos realizimi i kryerjes së procedurave të prokurorimit në kohë.

Nga analiza e detyrimeve të prapambetura për vitin 2022, rezulton që, në fund të vitit 2022 është e pa likuiduar vlera 113.314 mijë lekë. Këto detyrime janë të krijuara që nga vitet 2011. Sipas zërave mallra ,shërbime dhe investime.

6. Detyrimet e pa likujdura për investime dhe kredi për vitin 2022.

Nga auditimi rezultoi se faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2022 për investimet janë në vlerën 65,959,393 lekë. Në total:

Detyrimet e pa likujdura për mallra dhe shërbime viti 2022.

Nga auditimi rezultoi se faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2022 për mallra dhe shërbime janë në vlerën 47,354,915 lekë.

7. Analiza dhe shlyerja e detyrimeve për vendimet gjyqësore.

Detyrimet e prapambetura për vendimet gjyqësore sipas vitit të krijimit, objektit të padisë, likuidimeve të kryera, gjendjet në fund për vitin 2022 paraqiten në *Aneksin nr. 9*.

Nga auditimi i dokumentacionit për detyrime për vendime gjyqësore, rezulton se nga Bashkia Vlorë janë krijuar detyrime të prapambetura nga vitet në vlerën 9.921.6321 lekë dhe këto detyrime janë likuajduar në vitin 2022.

Referuar treguesve të të ardhurave të realizuara, konstatohet se financimi i buxhetit vjetor 2022 është bërë në masën prej 65%.

Nga subjekti i audituar, Bashkia Vlorë, mbi projekt raportin nr. 1026/28 prot; datë 28.09.2023, janë paraqitur kundërshti nga z. T. Z. me shkresën nr. 11597 prot; datë 27.10.2023, në cilësinë ish - drejtorit të financës dhe kontabilitetit, Bashkia Vlorë, i cili ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimi i subjektit:

Në faqen nr.45 Raportet e Monitorimit për vitin 2021 theksohet nga audituesit se kryetari i Bashkisë Vlorë nuk ka miratuar rregullat specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Raportet e monitorimit nuk janë hartuar nëpërputhje me kërkesat e shtojcës 2 etj etj në vazhdimësi. Për këtë komentoj dhe shpjegoj se për vitin 2021 për raportet e monitorimit ish DFBK-it si nënpunës zbatues ka qenë i përjashtuar nga nënpunësi urdhërues dhe për këtë nënpunësit urdhërues i kam bërë disa shkresa kundërshtuese, pasi ai po vepronte në kundërshtim me legjislacioni në fuqi. Kundërshtitë e mia u “finalizuan” me transferimin në mënyrë të jashtëligjshme në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit në momentin kur DFBK-it si nënpunës zbatues duhet të raportonte përpara nënpunësit autorizues për gjithë veprimtarinë 1 vjecare të realizimit të buxhetit të vitit 2021. Për të vërtetuar çfarë thashë më lart po ju vendos në dispozicion disa nga shkresat që kam mundur ti kem si kopje . Të gjitha këto shkresa ndodhen në protokollin e Bashkisë. Po i përmend këto shkresa dhe po i bashkangjis këtij raporti që audituesit në raportin përfundimtar të përcaktojnë masat individuale për nënpunësin zbatues dhe atë autorizues. Shkresa Nr. 1590 datë 16.02.2022 analizën e punës 1-vjecare të drejtorisë ku paraqes domosdoshmërinë e bërë pjesë kësaj analize nga të gjitha drejtoritë (nga drejtuesit e programeve me pjesëmarrjen e kryetarit të bashkisë).Pas kësaj analize të protokolluar kryetari në mënyrë të pakuptimtë, anashkalon në cdo takim DFBK-it edhe pse është përgjegjës kryesor në monitorimin dhe zbatimin e buxhetit (nënpunësi zbatues). Një ditë më vonë, kryetari nxjerr urdhrin Nr.23 datë 17.02.2022 “Mbi ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e analizës së Bashkisë Vlorë për vitin 2021”, ku DFBK-it është i pari në urdhër dhe i përjashtuar në cdo takim të analizave të bëra nga kryetari.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në përgjigje të pretendimit tuaj theksojmë se, grupi i auditimit është shprehur vetëm lidhur me pjesën se raportet e monitorimit nuk janë hartuar në përputhje me Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48. Pra janë audituar raportet e monitorimit për vitet 2021 dhe 2022, ku kanë rezultuar në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi. Konkretisht nuk janë plotësuar Aneksi nr. 1 “Raporti i shpenzimeve sipas programeve”, Aneksi nr. 2 “Raporti i shpenzimeve të programeve sipas artikujve buxhetorë”, Aneksi nr. 3 "Raporti i realizimit të produkteve të programit", Aneksi nr. 4 "Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit" dhe Aneksi nr. 5 "Projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe me financim të huaj".

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: **z. D. L., me detyrë ish - Kryetar i Bashkisë Vlorë; z. T. Z., me detyrë ish - Drejtor i Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, për vitin 2021; z. D. Z., me detyrë drejtor i Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, i komanduar për**

vitin 2022; **z. V. Z.**, me detyrë ish - përgjegjës në Sektorin e Buxhetit dhe Regjistrimit të të Ardhurave.

Nënpika 2.6 e programit: Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënie me qira të aseteve dhe arkëtimi i detyrimeve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Struktura e Bashkisë Vlorë për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2021, është miratuar me Vendimin e Kryetarit datë 01.11.2021 dhe vendim nr. 21 prot; datë 16.02.2021. Drejtorja e të Ardhurave Vendore (këtu e vijim DAV), ka patur në përbërjen e saj **35** punonjës, 1 drejtor, 1 përgjegjës sektori dhe 33 specialistë / inspektor / operator për taksat dhe tarifatat vendore.

Për vitin 2022, Struktura e Bashkisë Vlorë është miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 1, 01.10.2022 dhe vendim nr. 09, datë 22.02.2022. Drejtorja e të Ardhurave Vendore (DAV), ka patur në përbërjen e saj **41** punonjës, 1 drejtor, 1 përgjegjës sektori dhe 39 specialistë / inspektor / operator për taksat dhe tarifatat vendore.

- Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:

Për vitin 2021 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Vlorë është miratuar me VKB - në nr.88, datë 24.12.2020 “Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë nr. 1235/1 prot; datë 31.12.2020.

Tabela nr.1: Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave në Bashkinë Vlorë, viti 2021 (në 000 lekë)

Nr.	Lloji i taksës dhe tarifës	Viti 2021		
		Plan	Fakt	%
I	Të ardhura nga taksat vendore			
1	Taksë për kalimin e se drejtës se pronësisë	30,000	27,905	93%
2	Taksë e automjeteve të përdorura	67,000	70,475	105%
3	Taksa e biznesit të vogël (Tatim i Thjeshtuar)	18,500	12,137	66%
4	Taksë e pasurisë së paluajtshme (ndërtesat+toka)			
4.1	Taksë pasurie e paluajtshme ndërtesa	247,571	191,418	77%
4.2	Taksë pasurie e paluajtshme tokë bujqësore	42,455	13,562	32%
5	Taksë trualli	17,349	12,212	70%
6	Taksë e fjetjes në hotel	20,580	14,915	72%
7	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	285,490	180,941	63%
8	Taksë table + reklame	6,773	11,709	173%
9	Taksë parkimi	1,686	2,038	121%
10	Taksa mbi të ardhurat personale	8,000	32,133	402%
II	Të ardhurat nga tarifatat vendore			
1	Tarifë për zënie e hapësirave publike			
1.1	Tarifë tregu	7,282	7,659	105%
1.2	Tarifë e zënies së hapësirave publike	74,780	75,299	101%
2	Tarifë vjetore për pastrimin/ndriçim/gjelbërim	231,468	186,280	80%
3	Tarifë shërbimi për subjektet me aktivitet ndërtimi	18,690	7,621	41%

Nr.	Lloji i taksës dhe tarifës	Viti 2021		
		Plan	Fakt	%
4	Tarifë për leje dhe shërbim veterinar	1,800	220	12%
5	Tarifë për shërbime të tjera nga pushteti vendor	8,684	10,968	128%
6	Tarifë për leje dhe certifikata transporti	10,980	5,693	52%
7	Tarifa e Ujitjes	3,983		0%
III	Të ardhura të tjera			
1	Të ardhura nga qiratë (mjete+godinë+tokë)	41,325	1,730	4%
2	Të ardhura nga aplikimi i gjobave dhe debitorë	177,750	100,077	56%
3	Të ardhura nga kopshtet, çerdhet dhe shkollat	20,826	11,397	55%
4.1	Të ardhura nga teatri “Petro Marko”	550	351	64%
4.2	Të ardhura nga Qendra Kulturore	1,575	659	42%
4.3	Të ardhura nga sportet	595		0%
4.4	Të ardhura nga Ndërmarrja Shërbimeve Publike	300		0%
4.5	Të ardhura nga pullat	700	365	52%
5	Projekte	64,000		0%
	TOTALI I TË ARDHURAVE	1,410,692	977,764	69%

Burimi: Bashkia Vlorë Drejtoria e të Ardhurave Vendore

Gjatë vitit 2022, për ndjekjen e të ardhurave drejtoria është bazuar në VKB-në nr. 79, datë 02.12.2021 dhe shkresa nr. 15882/2 prot; datë 20.12.2021 e Prefektit të Qarkut Vlorë, “Shprehja e ligjshmërisë së VKB-së nr. 79, datë 02.12.2021”.

Tabela nr.2

Nr.	EMERTIMI	Viti 2022		
		Plan	Fakt	%
I	Te ardhura nga taksat vendore			
1	Takse për kalimin e se drejtës se pronësisë	30,000	30,438	101%
2	Takse e automjeteve te përdorura	75,600	76,413	101%
3	Taksa e biznesit te vogël (Tatim i Thjeshtuar)	18,000	18,000	100%
4	Takse e pasurisë se paluajtshme (ndërtesat+toka)			
4.1	Takse pasurie e paluajtshme ndërtesa	250,732	192,756	77%
4.2	Takse pasurie e paluajtshme toke bujqësore	38,758	14,819	38%
5	Takse trualli	12,371	12,202	99%
6	Takse e fjetjes ne hotel	18,743	19,033	102%
7	Taksa e ndikimit ne infrastrukture	298,853	365,142	122%
8	Takse table + reklame	11,000	17,784	162%
9	Takse parkimi	1,900	2,689	142%
10	Taksa mbi te ardhurat Personale	11,000	20,417	186%
II	Te ardhurat nga tarifate vendore			
1	Tarife për zënien e hapësirave publike			
1.1	Tarife tregu	5,640	6,640	118%
1.2	Tarife e zënies se hapësirave publike	78,996	94,529	120%
2	Tarife vjetore për pastrimin urban+ndriçim+gjelbërim	235,284	208,113	88%
3	Tarife shërbimi për subjektet me aktivitet ndërtimi	14,164	9,334	66%
4	Tarife për leje dhe shërbim veterinar	-	-	0%
5	Tarife për shërbime te tjera nga pushteti vendor	5,033	5,705	113%
6	Tarife për leje dhe certifikata transporti	8,520	12,123	142%
7	Tarifa e Ujitjes	3,983	-	0%
III	Te ardhura te tjera			
1	Te ardhura nga qiratë (mjete+godine+toke)	41,325	7,083	17%
2	Te ardhura nga aplikimi i gjobave dhe debitorë	148,300	92,365	62%
3	Te ardhura nga kopshtet, çerdhet dhe shkollat	20,826	13,637	65%

Nr.	EMERTIMI	Viti 2022		
4	Te ardhura nga institucionet vartëse			
4.1	Te ardhura nga teatri “Petro Marko”	550	403	73%
4.2	Te ardhura nga Qendra Kulturore	1,550	1,030	66%
4.3	Te ardhura nga Shumesportet	595	0	0%
4.4	Te ardhura nga ndërmarrja Shërbimeve Publike	300	0	0%
4.5	Te ardhura nga pullat	700	218	31%
5	Projekte	67,225		0%
6	Mjete ne ruajtje			
IV	TOTALI I TE ARDHURAVE (Taksa Tarifa)	1,399,948	1,220,873	87.2%

Burimi: Bashkia Vlorë Drejtoria e të Ardhurave Vendore

Ajo që konstatohet nga auditimi i të dhënave është se në menaxhimin e të ardhurave, Bashkia Vlorë, janë të angazhuara disa struktura, konkretisht:

- 1. Drejtoria e të Ardhura Vendore** ka përgjegjësi vetëm për disa nga taksat dhe tarifat vendore të bizneseve, si dhe menaxhon borxhin tatimor të krijuar nga mos pagesa e detyrimeve nga subjektet fizikë/juridike për taksat dhe tarifat që kjo drejtori ndjek;
- 2. Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit** është përgjegjëse për menaxhimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja dhe për legalizimet;
- 3. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Vlorë**, luan rolin e agentit tatimor të Bashkisë Vlorë për faturimin dhe arkëtimin e tarifave familjare për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrim, ndriçim, gjelbërim;
- 4. Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve**, menaxhon arkëtimin e taksës së parkimit të automjeteve. Gjithashtu, menaxhon, ndjek detyrimin për pajisjen me autorizim të karburanteve;
- 5. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Sektori i Ujitjes dhe Kullimit**, menaxhon arkëtimin e tarifës së shërbimit të ujitjes;
- 6. Drejtori / institucione / ndërmarrje në varësi** të ndryshme gjithashtu kanë përgjegjësi për arkëtimin e tarifave të ndryshme të cilat paguhen përpara shërbimit (bileta apo fatura shërbimi).

Titulli gjetjes: Mangësi në programimin e të ardhurave dhe veprimet e kontabilizimit.

Situata: Referuar Tabelave 1 dhe 2, sa më sipër, konstatohet se për disa taksa dhe tarifa, realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa taksa dhe tarifa të tjera realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve, e cila kryesisht vjen për shkak të mos identifikimit të faktorëve të cilët ndikojnë në planifikimin jo të saktë, gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Vlorë, që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme, në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të bëhet mbi baza sa më reale, për të mos shkaktuar deficit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve, etj., në dëm të interesave të publikut.

Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit konstaton që metodologjia e përdorur nga DAV-ja për planifikimin e taksave

dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmëritë lidhur me të ardhurat e veta të Bashkisë, konkretisht për vitin 2021 realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Vlorë, paraqitet në masën 69 %, ose nga vlera 1,410,692 mijë lekë të parashikuara janë realizuar vlera 977,764 mijë lekë (*minus 432,928 mijë lekë*). Për vitin 2022 paraqitet në masën 87.2% ose nga vlera 1,399,948 mijë lekë janë realizuar vlera 1,220,873 mijë lekë (*minus 179,075 mijë lekë*). Duke analizuar të dhënat e tabelës më sipër vërehet se të ardhurat që kanë një tejkalim të realizimit në nivele të larta janë të ardhurat nga taksat e ndara që nuk ndiqen nga DAV.

Në taksat dhe tarifave që përgjegjësinë për vjeljen e kanë strukturat e bashkisë nivelet e realizimit variojnë nga 0% (tarifa e ujitjes, të ardhura nga sportet) në 128% (tarifa për shërbime të ndryshme nga pushteti vendor).

Disa nga realizimet paraqitet shumë mbi planin ose nën planin :

Takse tabele + reklame për vitin 2021: Është realizuar 11,709 mijë lekë nga 6,773 mijë lekë të planifikuara ose në masën 162 %.

Taksë pasurie e paluajtshme tokë bujqësore për vitin 2021 :është realizuar 14,819 mijë lekë nga 42,455 mijë lekë ose në masën 38 %.

Tarifë tregu për vitin 2022: Është realizuar 6,640 mijë lekë nga 5,640 mijë lekë të planifikuara ose në masën 118 %.

Tarife e zënies së hapësirave publike: Është realizuar nga 94,529 mijë lekë nga 78,996 nga ose në masën 120%.

Drejtoria e të Ardhurave Vendore, kryen procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave për 6 taksa dhe 2 tarifa për biznesin. Për këto të ardhura akt-rakordimet janë kryer nga specialistja e kontabilitetit të DAV **znj. Xh. K.** me specialisten **znj. E. K.** që evidenton dhe kryen akt-rakordimet me degën e Thesarit Vlorë, për të ardhurat në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit në Aparatin e Bashkisë Vlorë. Debitorët për subjektet të pa regjistruara në QKB, nga ana DAV mbahen ekstra-kontabël, në një program Excel, referuar ditarit të të ardhurave të mbajtur nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe bëhet rakordimi mujor me dy drejtoritë.

Duke krahasuar 2 tabelat plan - fakt me akt - rakordimet me thesarin rezulton se këto tabela nuk rakordojnë për disa zëra si p.sh.:

- Taksa e parkimit: Për vitin 2021 është realizuar në shumën 2,038 mijë lekë nga 1,686 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 121%, për vitin 2022 është realizuar në shumën 2,689 mijë lekë nga 1,900 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 142%. Po ti referohem akt – rakordimit me thesarin taksa e parkimit për vitin 2021 është 2,037 mijë lekë.

- Taksa e hapësirave publike: për vitin 2021 është realizuar 75,299 mijë lekë nga 74 780 mijë lekë të planifikuara ose në masën 120 %. Nga akt- rakordimi rezulton se është 50,687 mijë lekë. Për vitin 2022 është realizuar 54,529 mijë lekë nga 78,996 mijë lekë ose në masën 120 %. Sipas akt – rakordimit është 62,431 mijë lekë. Kjo tarifë lidhur me tregjet është faturuar dhe arkëtuar pa u lidhur marrëveshjeve ndërmjet subjekteve dhe bashkisë në kundërshtim me VKB nr. 88, datë 24.12.2020 të miratimit të paketave fiskale, pika 1 “Tarifa për zënien e hapësirave publike” nën-pika b “Tarifa për tregjet e Bashkisë Vlorë.

- Taksa ndikimit në infrastrukturë: Për vitin 2021 është realizuar 180,941 mijë lekë nga 285,940 mijë lekë ose në masën 122 %. Nga akt-rakordimi me thesarin është 254,784 mijë lekë.

Për vitin 2022 është realizuar 365,142 mijë lekë dhe është realizuar 298,853 mijë lekë ose në masën 122 %. Nga akt - rakordimi i mbajtur me degën e thesarit rezulton se është 363,928 mijë lekë.

- Taksa e Pastrimit: Për vitin 2022 taksa e pastrimit është realizuar 208,113 mijë lekë nga 235,284 të planifikuara ose në masën 88 %. Nga akt - rakordimi me degën e thesarit rezulton 207,970 mijë lekë.

Kriteri: Ligji nr. 9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5 “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 54/c “Raportimi financiar”, Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018, Kreu IV ” pika 200, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Rregullorja e Brendshme nr.101 datë 11.09.2018.

Ndikimi/Efekti: Mosplanifikimi jo-mirë i argumentuar dhe mbi mundësitë reale, çojnë bashkinë në marrjen e angazhimeve për realizimin e procedurave të prokurimit për shpenzime/blerje mallrash dhe investime, ku nga mos realizimi çon në mos zbatim të kontratës dhe lënien e faturave të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore dhe rritjen e nivelit të kreditorëve (fatura të palikujduara), në mbyllje të vitit ushtrimorë.

Shkaku: Keqmenaxhim dhe mos njohje e situatës nga strukturat përgjegjëse.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi 1: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoritë e tjera që merren me menaxhimin dhe ndjekjen e të ardhurave, të marrin masa për një planifikim sa më të saktë të të ardhurave vendore në raport me mundësitë reale të Bashkisë Vlorë, duke mos krijuar diferenca të theksuara në zëra të veçantë si në mos realizime dhe në realizime, si dhe të shmang mbi planifikimin e tyre për të shmangur në maksimum zhvillimin e procedurave pa fonde.

Drejtoritë duhet të rakordojnë me njëra tjetrën me qëllim rritjen e nivelit të arkëtimit por edhe për një planifikim sa më real të të ardhurave.

Rekomandimi 2: Kryetari i Bashkisë Vlorë të riorganizojë strukturën e Drejtorisë së të Ardhurave, në mënyrë të atillë që cdo burim të ardhurash të jetë i strukturuar në këtë drejtori, pasi janë disa drejtori që arkëtojnë të ardhura duke krijuar kështu mundësinë e rrjedhjes së të ardhurave për tu arkëtuar dhe planifikuar.

Nga subjekti i audituar, Bashkia Vlorë, mbi projekt raportin nr. 1026/28 prot; datë 28.09.2023, janë paraqitur kundërshti nga znj. A. Sh. me shkresën nr. 11597 prot; datë 27.10.2023, në cilësinë e Drejtorit të të Ardhurave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Vlorë, e cila ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimi i Subjektit:

Në lidhje me këtë gjetje theksoj se nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore kryhet kontabilizimi i të ardhurave që ndjek kjo drejtori bazuar në vendimet e Këshillit të Bashkisë “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në bashkinë Vlorë” për secilin vit 2021 dhe 2022 që ndjek DAV, të cilat janë si më poshtë:

- Taksat vendore që ndjek DAV

1 Takse pasurie e paluajtshme ndërtesa biznes

2 Takse trualli

3 Takse e fjetjes ne hotel

4 Takse table + reklame

- Tarifat vendore që ndjek DAV

1 Tarife për zënien e hapësirave publike

2 Tarife tregu

3 Tarife e zënies së hapësirave publike biznes

4 Tarife vjetore për pastrimin urban+ndriçim+gjelbërim (biznes)

Që të gjej zbatim rekomandimi lënë nga ana juaj për këtë gjetje, duhet që të ardhurat që arkëtohen për llogari të Bashkisë Vlorë të kontabilizohen të gjitha në këtë drejtori, por sikurse citohet edhe nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet që struktura e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore të jetë e ndërtuar në mënyrë të atillë që cdo burim të ardhurash të jetë e strukturuar në këtë drejtori, pasi janë disa drejtori që arkëtojnë të ardhura, duke krijuar kështu mundësinë e rrjedhjes së të ardhurave për tu arkëtuar dhe planifikuar. Gjithashtu të ardhurat që cdo drejtori mbledh duhet të rakordohen ndërmjet specialistes së të ardhurave në Drejtorinë e Financës , Buxhetit dhe Kontabilitetit në bashkinë Vlorë, pasi referuar rregullores së brendshme të Bashkisë Vlorë, është kjo struktura që rakordon të ardhurat e bashkisë, sikurse ndodh me rakordimin e bërë me këtë sektor për të ardhurat që ndjek Drejtorinë e të Ardhurave Vendore.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në përgjigje të kundërshtimit tuaj theksojmë se, në vazhdimësi të rekomandimit grupi i auditimit sjellë në vëmendje se rekomandimi i dhënë, është i formuluar në mënyrë të tillë në ndihmë të DAV duke orientuar çdo drejtori që të rakordojnë me njëra tjetrën me qëllim rritjen e nivelit të arkëtimit por edhe për një planifikim sa më real të të ardhurave.

- Detyrimet nga subjektet fizikë/juridikë

Për qytetin dhe çdo njësi administrative është krijuar në mënyrë manuale dhe elektronike regjistri për taksat dhe tarifave vendore për subjektet private dhe familjarët, si më poshtë:

1. Regjistri Elektronik për Bizneset në formatin Excel.

2. Regjistri Elektronik për taksën e Tokës në formatin Excel.

3. Regjistri Elektronik për Popullatën në formatin Excel.

Gjithashtu, regjistrat janë hartuar dhe funksionojnë edhe në formë manuale, konform me formatin përkatës të miratuar nga Ministria e Financave. Bizneset që ushtrojnë aktivitetet në Bashkinë Vlorë janë përmbledhur në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 9: Numri i bizneseve në Bashkinë Vlorë më datë 31.12.2021

Nr.	Lloji Biznesit	Gjendja Në fillim sipas V.K.B-së nr. 94, datë 28.12.2020	Regjistrime të reja gjatë vitit 2021	Mbyllur aktivitete gjatë vitit 2021	Gjendja në fund të vitit 2021
1	Biznesi vogël viti 2021	4235	784	841	4777
2	Biznesi i madh viti 2021	1089	38	82	1103
(1+2)	Gjithsej viti 2021	5324	822	923	5880

Burimi: Bashkia Vlorë

Nga të dhënat e mësipërme shikojmë se për vitin 2021 në Bashkinë Vlorë janë hapur 784 biznese të vogla, 38 biznese të mëdha, dhe janë mbyllur 82 biznese të mëdha dhe 841 të vogla.

Tabela nr. 10 Numri i bizneseve në Bashkinë Vlorë më datë 31.12.2022

Nr.	Iloji Biznesit	gjendja Në fillim sipas V.K.B-së nr. 4, date 31.01.2022	Regjistrime Reja gjatë vitit 2022	Mbyllur Aktiviteti Gjatë vitit 2022	Gjendja në fund të vitit 2022
1	Biznesi vogël 2022	4777	702	883	5103
2	Biznes i madh 2022	1103	117	108	1087
(1+2)	Gjithsej 2022	5880	819	991	6190

Burimi: Bashkia Vlorë

Nga të dhënat e mësipërme shikojmë se për vitin 2022 në Bashkinë Vlorë janë hapur 702 biznese të vogla, 117 biznese të mëdha, dhe janë mbyllur 108 biznese të mëdha dhe 883 të vogla.

Me shkresën nr. 2260 prot; datë 22.02.2023, Drejtorja e të Ardhurave Vendore ka dërguar borxhin tatimor progresiv në Drejtorinë e Financave, në vlerën totale prej 403,655,427 lekë. Nga auditimi rezulton se vlera progresive është vetëm për detyrime nga biznesi i madh, biznesi i vogël dhe debitorët individ për qëllime biznesi.

Titulli gjetjes: Procedurat e ndjekura për arkëtimin e të ardhurave nga taksa e infrastrukturës të ndërtimeve informale që ndodhen në territorin e Bashkisë Vlorë.

Situata: Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi, e cila menaxhohet nga Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet e reja konstatohet se, nga legalizimet e bëra ndër vite nuk kanë paguar detyrimin në periudhën 2015-2020 për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ALUIZNI gjithsej 1371 individë/qytetarë për sipërfaqet e legalizuara me vlerë totale të detyrimeve **41,994,742 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Vlorë.**

Për vitin 2021, janë legalizuar gjithsej 843 objekte me vlerë totale të detyrimit për t'u paguar 30,171,536 lekë. Nga auditimi rezulton se, kanë paguar detyrimet 409 qytetarë/individë me vlerë 16,887,077 lekë dhe janë debitorë ndaj bashkisë **434 qytetarë me vlerë totale 13,284,459 lekë, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Vlorë.**

Për vitin 2022, janë legalizuar gjithsej 660 objekte me vlerë totale të detyrimit për t'u paguar 20,051,666 lekë. Nga auditimi rezulton se, kanë paguar detyrimet 280 qytetarë/individë me vlerë 8,974,825 lekë dhe janë debitorë ndaj bashkisë **380 qytetarë me vlerë totale 11,076,841 lekë, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Vlorë.**

Tabela nr. 3: Detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet 2015-2022

Viti	Numri	Vlera
2015	26	639,709
2016	242	6,230,630
2017	430	15,674,135
2018	296	8,949,989
2019	137	3,761,598
2020	240	6,738,681
2021	434	13,284,459

Viti	Numri	Vlera
2015	26	639,709
2016	242	6,230,630
Totali	1805(2015-2021)	55,279,201
2022	380	11,076,841
Totali progresiv	2185	66,356,042

Burimi: Bashkia Vlorë, përpunoi grupi i auditimit

Nga auditimi rezulton se, qytetarët / individët që kanë përfituar legalizimin e sipërfaqeve të caktuara nuk kanë paguar rregullisht detyrimin ndaj Bashkisë Vlorë për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Përkatësisht për vitin 2021 nuk kanë paguar detyrimin 434 qytetarë me vlerë totale 13,284,459 lekë, ndërsa nuk kanë paguar ende detyrimin 1371 individë/qytetarë për sipërfaqet e legalizuara përpara vitit 2021 (2015-2020) me vlerë totale 41,994,742 lekë.

Në total vlera e detyrimeve nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton në **66,356,042 lekë për 2185 objekte të legalizuara, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Vlorë.**

Asnjë nga strukturat e Bashkisë Vlorë nuk janë marrë masa për të rritur nivelin e pagesave lidhur me këtë taksë. Gjithashtu, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit nuk dërgon në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit informacion lidhur me detyrimet që kanë ndaj bashkisë qytetarët që kanë përfituar nga procesi i legalizimit. Si rezultat këto detyrime nuk janë të kontabilizuara. Të dhëna lidhur me numrin e debitorëve nuk dërgohen as në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore/Sektori i Borxhit i cili nuk ka informacion lidhur me numrin e debitorëve për taksën e ndikimit në infrastrukturë si dhe vlerën progresive të borxhit.

Kriteri: Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5, si dhe VKB-së nr. 88, datë 24.12.2020 i ndryshuar me VKB nr. 79 datë 02.12.2021 “Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë nr. 1235/1 Prot; datë 31.12.2020.

Ndikimi/Efekti: Në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore në vlerën **66,356,042 lekë** nga mospagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë, veprime të cilat ngarkohem me përgjegjësi: **z. J. Ç.** me detyrë ish - Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit për vitin 2021, dhe për vitin 2022, **z. Z. S.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

Shkaku: Mos bashkëpunim me ALUIZNI-in Vlorë dhe mos marrja e masave për parandalimin e dhënies së lejeve të legalizimit pa paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e të Ardhurave mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **2185** personave në vlerën **66,356,042 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen.

Rekomandimi: Bashkia Vlorë nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të bashkëpunojë me Drejtorinë Rajonale të ASHK Dega Vlorë për të gjithë subjekte që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e legalizimit nga ndërtimet informale, të kërkohet mos lëshimi i lejes së legalizimit dhe në rast të dhënies të kërkohet vendosje barrë sigurie deri në kryerjen e pagesave për taksën e ndërtimit.

Nga subjekti i audituar, Bashkia Vlorë, mbi projekt raportin nr. 1026/28 prot; datë 28.09.2023, janë paraqitur kundërshti nga znj. A. Sh. me shkresën nr. 11597 prot; datë 27.10.2023 në cilësinë e Drejtorit të të ardhurave dhe tarifave vendore, Bashkia Vlorë, e cila ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimi i Subjektit:

Në lidhje me këtë gjetje, theksoj se rekomandimi i lënë nga ana juaj nuk gjen zbatim nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore pasi sikurse theksohet edhe nga ana juaj në materialin e lënë nga ju, referuar V.K.B-së nr. 79, datë 2.12.2021 i ndryshuar, kjo taksë ndiqet nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, sot Drejtoria e Urbanistikës. Këto detyrime të cilat ju i keni nxjerrë gjatë auditimit të kryer nga ana juaj, nuk janë detyrime të kontabilizuara në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe në këto kushte nuk ka se si DAV të nxjerrë njoftim vlerësime për këta 2185 persona të cilat janë me detyrime në vlerën 66.356.042 lekë të lindura nga drejtori tjetër. Gjetja juaj është e drejtë për faktin se të ardhurat duhet të mblidhen nga një strukturë por sot në bashkinë Vlorë ka disa drejtori të cilat arkëtojnë të ardhura për buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në përgjigje të kundërshtimit tuaj theksojmë se përsa i përket situatës së sipërpërmendur grupi i auditimit i referohet Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, me qëllim që të rrisë bashkëpunimin me drejtoritë përkatëse dhe duke iu vënë në dispozicion të dhënë sa më të sakta, sikurse dhe përcaktohet në rekomandimi.

Titulli gjetjes: Keqmenaxhim mbi procedurat e ndjekura të planifikimit, arkëtimit të taksës së tokës bujqësore.

Situata: Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, Aneksi 1, si më poshtë:

Tabela nr.4: Vlera e taksës së tokës bujqësore në lekë/hektar/vit

Kategoria e tokës bujqësore	Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas Ligjit (lekë/ha/vit)
I	5,600
II	4,900
III	4,200
IV	3,600
V	3,000
VI	2,400
VII-X	1,800

Me VKB-në nr. 88 prot; datë 24.12.2020 dhe VKB nr. 79 datë 02.12.2021 “Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”, janë miratuar nën kategorizimet për taksën e tokës bujqësore të cilat ndryshojnë nga një njësi administrative në tjetrën dhe po ashtu brenda njësisive administrative sipas fshatrave. Referuar VKB-së nr. 88 prot; datë 24.12.2020 i ndryshuar me VKB nr. 79 datë 02.12.2021, përgjegjësini për vjeljen e kësaj takse e kanë specialistët e DAV në NJA si dhe Sektori i Menaxhimit të Tokës Bujqësore për

qytetin. Gjithashtu, në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr. 229 prot; datë 17.09.2021 për ndjekjen e procedurave për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore në Bashkinë Vlorë ngarkohen specialistët dhe inspektorët e terrenit në çdo njësi administrative. Nga auditimi i të dhënave të grumbulluara nga secila njësi administrative rezulton se: Nuk ka koordinim nga një strukturë në Bashki e cila të grumbullojë informacionin për debitorët e taksës së tokës bujqësore nga NJA dhe në përfundim të vitit këto të dhëna të përpunohen dhe të jenë në nivel bashkie si dhe të jenë pjesë e borxhit tatimor.

Tabela nr.5: Të dhëna për tokën bujqësore në Bashkinë Vlorë

Nr.	Njësitë Administrative	Sipërfaqe tokë bujqësore (ha)	Tokë e ndarë me AMTP	Tokë në pronësi të bashkisë (ha)	Tokë e dhënë me qira nga sip. në pronësi (ha)
1	Vlorë	434	434	0	0
2	Orikum	2932.38	2831.88	100.5	0
3	Novoselë	6524	5784	739	211
4	Qendër	5271.23	4171.7	1099.53	55.9
5	Shushicë	2845	2445	400	87.64
	Totali	18,006.61	15,666.58	2,339.03	354.54

Referuar të dhënave të mësipërme në Bashkinë Vlorë sipërfaqja e tokës bujqësore është 18,006.61 ha. Nga kjo sipërfaqe janë ndarë me AMTP 15,666.58 ha e cila është dhe sipërfaqja për të cilën familjet që e kanë në pronësi kanë detyrimin për taksën e tokës bujqësore.

Tabela nr.6: Detyrimi për taksën e tokës bujqësore

Nr.	Njësitë Administrative	Nr. Familjeve që tatonen	Plan viti 2021	Borxh i krijuar gjatë vitit 2021		Borxhi progresiv 31.12.2021		Borxhi i krijuar 2022		Progresiv 31.12.2022	
				Nr. Familjeve	Vlera	Nr. Familjeve	Vlera	Nr. Familjeve	Vlera	Nr. Familjeve	Vlera
1	Vlorë	1100	950,400	-	881,212	2051	1,687,042	1058	574,448	2113	1,455,660
2	Orikum	1889	7,155,600	1518	5,282,954	1,624	33,586,415	-	5,385,208	1514	38,971,623
3	Novoselë	3230	13,196,200	2720	9,810,748	2,720	80,272,873	2632	11,284,267	3560	90,113,998
4	Qendër	3168	13,193,400	2523	9,690,768	2,404	89,498,478	-	7,230,493	2463	96,728,971
5	Shushicë	2240	7,600,000	2240	2,834,000	937	34,528,000	2240	3,100,000	2240	34,570,000
	Totali	11627	42,095,600	-	28,499,682	9736	239,572,808	-	27,574,416	11890	261,840,252

Nga auditimi konstatohet se detyrimi që familjet kanë për taksën e tokës bujqësore në Bashkinë Vlorë është borxhe i krijuar gjatë vitit 2021 në vlerën 28,499,682 ndërsa borxhi progresiv më datë 31.12.2021 është 239,572,808 lekë. Borxhi i krijuar gjatë vitit 2022 është 27,574,416 dhe borxhi progresiv me datë, 31.12.2022 është **261,840,252 lekë**, e cila përbënë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë. Referuar të dhënave të tabelave të mësipërme rezulton se debitorët e taksës së tokës kanë ardhur duke u rritur, çka tregon se puna e Sektorit të Menaxhimit të Tokës dhe e NJA-ve nuk është në nivelet e duhura, pasi ka munguar përgjegjësia dhe vëmendja e duhur për vjeljen e taksës së tokës, gjë të cilën e tregon niveli i lartë i debitorëve nga viti në vit. Vlera e detyrimit për debinë e tokës bujqësore në asnjë nga Njësitë Administrative nuk është e kontabilizuar dhe e mbajtur sipas standardeve të kontabilitetit, duke mos pasqyruar situatën reale. **Për mos marrjen e masave të mjaftueshme për arkëtimin e taksës së tokës dhe rakordimit ndërmjet strukturave, Ngarkohen me përgjegjësi Drejtor Drejtorisë së Pronave Publike dhe**

Menaxhimit të Aseteve, znj. S. H.

Për mos marrjen e masave të mjaftueshme për arkëtimin e taksës së tokës për vitin 2021 sipas urdhrimit të kryetarit me nr. 229 datë 17.09.2021 ngarkohen me përgjegjësi specialistët agronom dhe inspektorët e terrenin në NJA si vijon: **R. L., A. Xh., J. J., S. B., M. P., A. H., M. L., N. B., Th. Q., K. Sh., B. A., S. H., M. K.**, administratorë të njësive administrative (pika 3 e urdhrimit).

Kriteri: VKB-në nr. 88 prot; datë 24.12.2020 i ndryshuar VKB nr. 79 datë 02.12., me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 24, me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10. ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3, pikat 9 dhe 10.

Ndikimi/Efekti: Ulje në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore vlera prej **261,840,252 lekë**

Shkaku: Keqmenaxhim dhe mos marrja e masave për ndjekjen e debitorëve nga strukturat përgjegjëse.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi 1: Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Sektorin e Menaxhimit të Tokës në Drejtorinë e Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrimit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK dhe Qarku Vlorë), të nxjerrin njoftim detyrimet për familjet me sipërfaqe 15,666 ha lënë jashtë skemës së pagesës së taksës së tokës bujqësore për vitet 2021 dhe 2022, për vlerën **261,840,252 lekë**.

Rekomandimi 2: Të kryhet rakordimi i regjistrave të fermerëve që përdorin tokën bujqësore, midis Sektorin e Menaxhimit të Tokës në Drejtorinë e Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve dhe inspektorëve të Drejtorisë së të Ardhurave Vendore në Njësitë Administrative dhe këto regjistra që ndjekin agronomët e njësive administrative, t’ju jepet forma ligjore duke u ndërtuar regjistri me detyrimet që nga momenti i lindjes së të drejtës për përdorimin e tokë bujqësore, përfshirë këtu edhe kamatëvonesat të llogaritura sipas Ligjit për procedurat tatimore. Drejtoria e të Ardhurave Vendore të njoftojë me njoftim vlerësimi të gjithë fermerët/individët debitorë për taksën e tokës bujqësore, mbasi këto të dhënë të jenë dorëzuar nga agronomët e DPPMA.

Nga subjekti i audituar, Bashkia Vlorë, mbi projekt raportin nr. 1026/28 prot; datë 28.09.2023, janë paraqitur kundërshti nga z. Th. Q., G. F., inspektor i taksave NJA Qendër, dhe R. L. me shkresën nr. 11597 prot; datë 27.10.2023, në cilësinë e specialistit agronom, Bashkia Vlorë, të cilët ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimi i subjektit:

Në pozicionin e punës me emërtesën “Specialist Agronom” në Drejtorin e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve të Bashkisë Vlorë , jam njohur me metodikën e ndjekur për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore në Qershor të vitit 2021, pasi para kësaj date këtë procedura e kryente kolegja M. T., e cila ka dal në pension. Jam informuar që nuk ka patur ndryshime në raport me VKB-në nr.88 prot; datë 24.12.2020 për nivelin e taksimit për njësi të sipërfaqes së tokës sipas zonave kadastrale. Referuar metodologjisë së ndjekur për arkëtimin e kësaj takes është vepruar si është gjetur nga punonjësi i mëparshëm, pra në momentin që personat përfitues vinin për të marr

informacione ose procedura në raport me tokën bujqësore , u është vënë në dispozicion fatura për pagesën e taksës së tokës , duke e interpretuar detyrim ligjor pagesën e kësaj takse. Për subjektet që nuk janë drejtuar pranë kësaj zyre për procedura për tokën bujqësore , nuk kemi patur mundësi njoftimi, për arsye të mungesës së një adrese të cdo përfituesi, apo trashëgimtari të trashëgimlënësve , pronar/përdorues të tokës bujqësore. Aktualisht , nuk ka një udhëzim rakordimi për taksën e tokës që kjo taksë në nivel Bashkie të rakordohet nga DPPMA e Bashkisë Vlorë. Gjithashtu, nuk ka një rakordim me ASHK, DV – Vlorë për transaksionet e kryera për tokën bujqësore , transaksione të cilat do të ndryshonin edhe personin që taksohet për tokën bujqësore. Në këto kushte, do të ishte përgjegjësi e imja si specialist nëse unë do të kisha neglizhuar për prerjen e faturave të taksës së tokës për subjektet që janë paraqitur në zyrë për shërbime të ndryshme në raport me tokën bujqësore.

- Sa me sipër ka paraqitur observacion z. G. F.: Në mbështetje të shkresës suaj nr .12122 date 11.10.2023 ne lidhje me projekt portin e KLSH ju informoj si vijon. Ne mbështetje të detyrës që ka inspektori I taksave ne NJA .Qendër ka bere ne e mënyrë periodike njoftimin e te gjithë fermerëve per detyrimet qe kane per taksen tokës bujqësore duke bere njoftime publike dhe te cdo fermer sipas fshatrave e te gjitha takimet e kryera me kryetaret e fshatrave është ngritur problemi i detyrimeve duke dhënë informacionin përkatëse. Ne këto takime është konkluduar se mosrealizimi taksës bujqësore vjen -Mospajisjen e fermerëve me certifikata pronësie – Emigracioni Gjendja ekonomike e ulet. Per sa me sipër nuk është përgjegjësia e inspektorit mosrealizimi i taksës bujqësore.

- Sa me sipër ka paraqitur observacion z. R. L.: I mbajtur sot, në datë 17.10.2023, ne lidhje me Keqmenaxhim mbi procedurat e ndjekura planifikimit, arkëtimin të taksës së tokës bujqësore" mbasi jam njohur me akt-konstatimin e Grupit Auditues Nr. 34 dhe kam dorëzuar Observacionin nr 8696/7 prot dt.21.7 .2023,mbas njohjes me shkresën tuaj me Nr 12122 prot dt.11.10.2023 Ju sqarojmë se në lidhje me pikën "Taksa e Tokës bujqësore" Mbi verifikimin nga grupi auditues për taksën e tokës bujqësore ku për Njësinë Administrative Oriku borxhi krijuar progresiv deri në 2022 është në vlerën 38,971.623 lekë, borxh ky I krijuar ndër vite për arsye të mëposhtme: Taksa e tokës ka mosrealizim:

1.Problematik kryesore është pajisja me dokumentacion e personave të trajtuar me tokë në certifikatën e 1.8.1991 pasi toka me AMTP është marrë në emër të kryefamiljarit i cili nuk jeton dhe pagesa është një hallke shumë e vështirë. 2.Mosrealizimi për taksën e tokës Oriku vjen si pasojë e ish-punonjësve të Ndërmarrjes bujqësore që kanë përfituar tokë në Përdorim me ish pronarët që kanë certifikatë pronësie mbi këtë tokë, kjo nuk pranohet nga punonjësit të cilët e kanë dhe e administron. Mosbashkëpunimi ndërinstytucional midis Bashkisë dhe ASHK për orientimin e detyrimeve ndaj personave që ju takon pronësia.Kopetenc kjo e zyrës së aseteve e cila mbasi ka në dispozicion ndryshimet përkatëse dërgon zyrës së taksave proces-verbalin me ndryshimet në planin vjetor për cdo fermer. Pavarësisht për arkëtimin e taksës së tokës është bashkëpunuar me kryetarët e fshatrave, janë njoftuar zyrtarisht të gjitha familjet debitore për tokën (bashkëlidhur një kopje njoftimi për një individ "njoftime të cilat janë dërguar të gjithë fermerëve debitorë, kopje observacioni dërguar grupit Auditues) ,nuk ju ofrohet nga ana e Njësisë asnjë shërbim kërkuar nga ana e tyre.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në përgjigje të kundërshtimeve tuaja të paraqitura më lart nga punonjësit e sipërpërmendur janë vënë në pah shumë problematika të cilat kanë ndikuar në mos zbatimin e urdhrit nr.229 datë

17.09.2021 , të cilat nuk shoqërohen me dokumente tekniko-ligjor ku të provojnë të kundërtën e urdhrin të kryetarit të Bashkisë urdhër nr. 229 datë 17.09.2021.

Nga subjekti i audituar, Bashkia Vlorë, mbi projekt raportin nr. 1026/28 prot; datë 28.09.2023, janë paraqitur kundërshti nga znj. D. N., me shkresën nr. 11597 prot; datë 27.10.2023, në cilësinë e specialistes së pranimit, Bashkia Vlorë, e cila ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimi i subjektit :

Jam vendosur në urdhër të brendshëm me nr. 229, datë 17.09.2021, për ndjekjen e kontabilizimit të pagesave të pagesave të taksës së tokës bujqësore. Me marrjen në dijeni të urdhrin kam kërkuar dorëzimin sipas njësive administrative , me qëllim që të vijoja me hedhjen e pagesave në mënyrë të rregullt. Ky urdhër nuk ka gjetur kurrë zbatim pasi specialistët agronom dhe inspektorët e terrenit nuk kanë dorëzuar regjistrin ku të hidhja pagesat. Unë si specialiste i kam kërkuar në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet emailit zyrtar , për të dorëzuar regjistrat dhe deri më sot nuk kam marrë , përgjigje pavarësisht se kam vendosur në dijeni dhe kryetarët e njësive administrative dhe kryetarin e Bashkisë Vlorë. E maillet e dërguara E- maili i datës 11,10,2021 i datës 01.12.2021, i datës 12.01.2022, i datës 13.01.2022, i datës 04.05.2022,i datës 12.01.2023. për këtë arsye unë si nënpunëse civile kam marrë masat e nevojshme për aq sa kompetencë kam për të bërë të mundur zbatimin e këtij urdhëri. Bashkëngjitur dërguar e- maillet me kërkesat e sipërpërmendura.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Përsa ngarkoheni në urdhër , pretendimi juaj merret në konsideratë, pasi pretendimi juaj është i pasqyruar me punë konkrete, lidhur me korrespondencën e mbajtur me kërkesat e dërguara dhe të ridërguar, për aq sa kompetencë ka patur detyra juaj.

- Agjentët Tatimorë

1. UK sha Vlorë është përcaktuar si Agjent Tatimor sipas VKB-në nr. 88 prot; datë 24.12.2020 i ndryshuar me VKB nr. 79 datë 02.12.2021 Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore” ku Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit është e ngarkuar për rakordimin e arkëtimeve për taksat e kategorisë “familjarë” për “taksën e ndërtesës” dhe “tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit” Duhet theksuar se Bashkia Vlorë, nuk ka krijuar një bazë të dhënash për banesat, (qoftë edhe duke përdorur bazën e të dhënave të UK sha Vlorë) apo edhe duke detyruar ZVRPP-në për vënien në dispozicion të regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme sipas dispozitave të Nenit 20 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nga ku të evidentoheshin personat/familjet të cilët zotërojnë 1 banesë ose më shumë se një ndërtesë banimi, pasi niveli i taksës së ndërtesave të banimit është dyfishi i nivelit të taksës për kategorinë e cila ka vetëm një banesë.

2. Për taksën vjetore të mjeteve të përdorura, nga Agjenti Tatimor “Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor (DRTRR)”.

Nga rakordimet e bëra me këtë drejtori, realizimi i të ardhurave nga taksa e mjeteve të përdorura për vitin 2021 është 70,475 mijë lekë, ose 105 % e planit, për vitin 2022 është 76,413 mijë lekë ose 101 % e paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Në 000 lekë

Viti	Planifikimi	Fakti	Realizimi në %
2021	67,000	70,475	105%
2022	75,600	76,413	101%

Burimi : Drejtoria Financës

3.Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, nga Agjenti Tatimor “Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë (DRT)”, në zbatim të Ligjit nr. 181 datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”” dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 32 datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar të Biznesit të vogël”.

Sektori i Agjentëve Tatimorë kryen rakordimin e të ardhurave të realizuara. Parashikimi dhe realizimi në vlerë dhe në përqindje për vitet 2021 dhe 2022 paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Në 000 lekë

Viti	Planifikimi	Fakti	Realizimi në %
2021	18,500	12,136	65.6%
2022	18,000	2,001	12%

Burimi :Drejtoria Financës

-Për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, nga Agjenti Tatimor “Agjencia Shtetërore e Kadastrës Rajonale Vlorë”(ASHK) ose ish-ZVRPP Vlorë), në zbatim të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe VKB nr.100, datë 22.12.2017, i ndryshuar dhe VKB nr.88 datë 24.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore” i ndryshuar me VKB nr. 79 prot; 02.12.2021. Nga rakordimet e bëra nga Sektori i Agjentëve Tatimorë me ZVRPP-në Vlorë, realizimi i të ardhurave nga taksat e kalimit të pronësisë për vitin 2021, është 27,905 mijë lekë ose 93 % e planit, për vitin 2022 është 30,438 mijë lekë ose 101 %, të paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Në 000 lekë

Viti	Planifikimi	Fakti	Realizimi në %
2021	30,000	27,905	93%
2022	30,000	30,438	101%

Burimi :Drejtoria Financës

- Për rentën minerare, nga Agjenti Tatimor “Drejtoria e Financave Vendore” në MFE Derdhja nga Drejtoria e Financave Vendore” në MFE e pjesës takuese të taksës kombëtare “rentë minerare” që rezulton nga veprimtaria e gurëve në territorin e Bashkisë Vlorë në bazë të nenit 4 pika 4 të Ligjit 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare të ndryshuar, të Udhëzimit nr.26, datë 04.09.2008 “Për taksat kombëtare”. Realizimi i të ardhurave nga renta minerare për vitin 2021 është 2,243 mijë lekë, për vitin 2022 është 386 mijë lekë.

Për rentën minerare nuk është bërë planifikim nga ana e Bashkisë ndërkohë fakti është sipas shpërndarjes nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Financave Vendore.

Në 000 lekë

Viti	Planifikimi	Fakti	Realizimi në %
2021		2243	
2022		386	

Burimi :Drejtoria Financës

- Në lidhje me procedurën e mbajtjes së akteve të rakordimit me agjentët tatimorë, u konstatuan sa më poshtë:

-Akt-rakordimet janë mbajtur vetëm me UK sha Vlorë sipas formatit të miratuar, por në disa raste

nuk janë protokolluar. Rakordimet japin informacion vetëm për sasinë e arkëtimeve dhe përqindjen përkatëse, pa pasur asnjë të dhënë statistikore në bazë të së cilës të bëhen llogaritjet dhe të vlerësohet niveli i mbledhjes së të ardhurave.

-Pjesa më e rëndësishme e të ardhurave që vilen me agjentët tatimorë është Ujësjetës-Kanalizime, i cili vjel taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimit. Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me Agjentin Tatimor, por ka një shumë të madhe debitorësh, e cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse. -Bashkia Vlorë nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Vlorë, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pambledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pambledhura apo të shmangura, sipas përcaktimeve në nenin 117 të Ligjit 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore”, ku parashikohet se “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”.

Ndërsa me asnjë nga agjentët e tjerë tatimorë nuk janë mbajtur akte rakordimi, pasi derdhjet nga këto institucione bëhen nëpërmjet Degës së Thesarit.

-Nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe kontabilitetit, Bashkisë Vlorë, nuk disponohet asnjë e dhënë statistikore për numër e subjekteve tatimpaguese dhe detaje të tjera në lidhje me kategoritë e tatimpaguesve, në mënyrë që jo vetëm të llogariten detyrimet në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, por këto të dhëna të përdoren për planifikimin real të këtyre të ardhurave si edhe për llogaritjen dhe evidentimin e detyrimeve të tjera respektive për subjektet/individët tatimpagues të shmangur nga agjentët tatimorë. Mungesa e të dhënave ka sjellë pamundësinë e kontrollit të taksave/tarifave të cilat mbledhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, rrjedhimisht mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Vlorë.

-Nga Bashkia Vlorë, nuk janë bërë përpjekje të mjaftueshme për të njoftuar subjektet/individët debitorë dhe për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara, kryesisht për periudhën 2021 - 2022. Kjo situatë ka ardhur si mungesë e bashkërendimit të punës ndërmjet institucioneve dhe Bashkisë Vlorë.

- **Taksat dhe tarifat familjare**

Ujësjetës Kanalizime SH.A Vlorë është agjent tatimor për vjeljen e taksave dhe tarifave të Bashkisë Vlorë. Nëpërmjet këtij agjenti tatimor Bashkia Vlorë vjel nga qytetarët taksën e banesës dhe tarifat e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit.

Tabela nr. 7: Taksat dhe tarifa familjare që mbledhen nga UK Vlorë për vitin 2021

VITI 2021	Numri i Kontratave Taksë Banese	Numri i Kontratave Taksë Gjelbërim, Pastrim, Ndriçim	Taksë Banese Vlera	Taksë Gjelbërim, Pastrim, Ndriçim Vlera	Totali
Faturim	41,301	41,110	120,797,981	126,483,184	247,281,165
Arkëtim	21,081	20,774	98,874,399	102,767,072	201,641,471
Diferenca	(20,220)	(20,336)	(21,923,582)	(23,716,112)	(45,639,694)

Burimi: UK Vlorë

Tabela nr.8: Taksat dhe tarifa familjare që mbledhen nga UK Vlorë për vitin 2022

VITI 2022	Numri i Kontratave Taksë Banese	Numri i Kontratave Taksë Gjellërim, Pastrim, Ndriçim	Taksë Banese Vlera	Taksë Gjellërim, Pastrim, Ndriçim Vlera	Totali
Faturim	42,254	42,021	122,361,564	128,159,725	250,521,289
Arkëtim	32,436	32,356	108,929,700	105,037,163	213,966,863
Diferenca	(9,818)	(9,665)	(13,431,864)	(23,122,562)	(36,554,426)

Burimi: UK Vlorë

Nga auditimi rezulton se deri më datë 31.12.2020 Ujësjetllësi ka patur detyrime ndaj bashkisë në vlerën 111,321,816 lekë. Gjatë vitit 2021 niveli i arkëtimeve për taksën e banesës është 98,874,399 lekë ndërsa për tarifën e pastrimit/gjellërimit/ndriçimit është 102,767,072 lekë, në total 201,641,471 lekë. Në këto vlera arkëtimeve janë të përfshira edhe detyrime të familjeve për vitet përpara vitit 2021. Nga të dhënat që administrojnë UK Vlorë nuk është e mundur të ndahet vlera e arkëtimeve që i përket vitit 2021, si rrjedhojë vlera e arkëtimeve është progresive. Detyrimet që Ujësjetllësi ka ndaj bashkisë janë në vlerën 306,914,041 lekë (111,321,816 të mbartura + 195,592,225 viti 2021). Gjatë vitit 2021 shuma e kaluar nga Ujësjetllësi ndaj bashkisë është 210,475,773 lekë dhe **detyrimet progresive që Ujësjetllësi ka kundrejt Bashkisë Vlorë më datë 31.12.2021 janë 96,438,269 lekë.**

Nga auditimi rezulton se deri më datë 31.12.2021 Ujësjetllësi ka patur detyrime ndaj bashkisë në vlerën **96,438,269 lekë**. Gjatë vitit 2022 niveli i arkëtimeve nga UK Vlorë për taksën e banesës është 107,345,721 lekë ndërsa për tarifën e pastrimit/gjellërimit/ndriçimit është 108,929,489 lekë, në total **216,275,210 lekë**. Në këto vlera arkëtimeve janë të përfshira edhe detyrime të familjeve për vitet përpara vitit 2022. Nga të dhënat që administrojnë UK Vlorë nuk është e mundur të ndahet vlera e arkëtimeve që i përket vitit 2022, si rrjedhojë vlera e arkëtimeve është progresive. Detyrimet që Ujësjetllësi ka ndaj bashkisë janë në vlerën **306,225,416 lekë (96,438,269 të mbartura + 209,787,147 viti 2021)**. Gjatë vitit 2022 shuma e kaluar nga Ujësjetllësi ndaj bashkisë është 208,702,033 lekë dhe **detyrimet progresive që Ujësjetllësi ka kundrejt Bashkisë Vlorë më datë 31.12.2022 janë 97,523,383 lekë.**

Për periudhën e auditimit rezulton se ka një akt marrëveshje midis Bashkisë Vlorë dhe UK Vlorë me qëllim rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të palëve lidhur me vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifën nga tatim paguesit familjarë. Marrëveshje me nr.13330 prot; datë 22.12.2022 Bashkia Vlorë, dhe nr.3380 prot; datë 20.12.2022 UK është lidhur marrëveshja e bashkëpunimit për agjentin tatimorë midis palëve . Nga auditimi vërehet se në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion strukturat e Bashkisë Vlorë, si rezultat i menaxhimit të këtyre taksave dhe tarifa nga UK Vlorë, Bashkia Vlorë nuk ka informacion se sa është numri dhe vlera progresive e debitorëve për taksën e banesës dhe tarifën e pastrimit, gjellërimit dhe ndriçimit më datë 31.12.2021, për tatimpaguesit familjarë që menaxhohen nëpërmjet agjentit tatimor UK Vlorë. Në qoftë se do të referohemi të dhënave në tabelën më sipër vërehet se për vitin 2021 numri i familjeve debitorë për Taksën e Banesës është 20,220 që përbën 49 % të numrit të faturimeve. Për Taksën e Gjellërim, Pastrim, Ndriçim numri i familjeve debitor është 20,336 që përbën 49 % të faturimeve. Për vitin 2022 numri i familjeve debitorë për Taksën e Banesës është 9,818 që përbën 23% të numrit të faturimeve. Për Taksën e Gjellërim, Pastrim, Ndriçim numri i familjeve debitorë është 9,665 që përbën 23 % të faturimeve, Shoqëria “Ujësjetllës–Kanalizime” sha” Vlorë, duke e

vendosur në faturën e ujit të ndarë në mënyrë të barabartë për çdo muaj te vitit ushtrimor. Në mbledhjen e kësaj takse, kjo ndërmarrje do të luajë rolin e agjentit tatimor duke përfituruar 3% të shumës së arkëtuar.

- Ngarkohen për mbledhjen e kësaj takse sipas VKB nr.88 prot; datë 24.12.2020 dhe VKB nr. 79 prot; datë 02.12.2021 pika 8. Për Njësitë Administrative të Bashkisë, Administratorët e njërive, së bashku me kryetarët e fshatit, për banesat te cilat nuk janë te lidhura me rrjetin e Ujësjetllësit, taksa e banesës do te faturohet dhe do te mblidhet nga Shoqëria “Ujësjetllës –Kanalizime” sha” Vlorë.- Administratoret e Njërive Administrative, se bashku me Kryetarin e Fshatit te evidentojnë familjet që nuk janë te lidhur me rrjetin e Ujësjetllësit. Listat e përditësuara do te dorëzohen pranë Drejtorisë se ardhurave vendore, Bashkia Vlore” me qëllim krijimin e një regjistrit për rakordim në lidhje me arkëtimin e kësaj takse. Duke ju referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga Bashkia Vlorë dhe informacioneve të grumbulluara arrihet në konkluzion: se rezulton të jetë lidhur një akt marrëveshje me nr. 3330 prot; datë 22.11.2022 midis Kryetarit të Bashkisë Vlorë dhe ujësjetllës kanalizime. Sipas VKB nr. 88 prot; datë 24.12.2020 dhe VKB nr. 79 prot; datë 02.12.2021 pika 8, si rrjedhojë nuk ekziston një regjistër i hartuar nga DAV me të dhënat për tarifet familjare, gjithashtu nga administratorët e njërive administrative nuk është arritur evidentimi i familjeve që nuk janë të lidhur me UK Vlorë me qëllim përditësimin e të dhënave për tarifet familjare në kundërshtim me VKB nr.88 prot; datë 24.12.2020 pika 3/e dhe VKB nr. 79 prot; datë 02.12.2021 pika 2/e, procedurë e ndjekur është në kundërshtim me pika 7 e nenit 4, të Ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi për mbledhjen e kësaj takse sipas VKB nr. 88 datë 24.12.2020 dhe VKB nr. 79 datë 02.12.2021 pika 1 nënpika 8: Administratorët e Rajonit nr. 1, **z. A. Ç.** (vitet 2021-2022); Administratorët e Rajonit nr. 2, **z. O. R.** (viti 2021-2022); **z. A. L.**, me detyrë Administrator Rajoni nr. 3; **znj. A. L.**, me detyrë Administrator Rajoni nr. 4; **znj. B. Ç.**, me detyrë Administrator Rajoni nr. 5; **z. S. H.**, me detyrë Administrator në NJA Orikum (për vitet 2021-2022); **znj. M. K.**, me detyrë Administratore në NJA Qendër, **z. K. Sh.** me detyrë Administrator në NJA Novoselë; **z. B. A.**, me detyrë Administrator në NJA Shushicë.

<p>Titulli gjetjes: Procedurat për arkëtimin e taksës së ndërtesës dhe tarifës së pastrim-gjelbërim-ndriçimit nga abonentët familjar, mos ndjekja nga Agjenti tatimor UK, dhe mungesa e Bashkëpunimit me Bashkinë Vlorë.</p>

Situata: Nga auditimi rezulton se deri më datë 31.12.2020 UK sh.a. Vlorë ka patur detyrime ndaj bashkisë në vlerën 111,321,816 lekë. Gjatë vitit 2021 niveli i arkëtimeve për taksën e banesës është 98,874,399 lekë ndërsa për tarifet e pastrimit/gjelbërimin/ndriçimit është 102,767,072 lekë, në total 201,641,471 lekë. Në këto vlera arkëtimeve janë të përfshira edhe detyrime të familjeve për vitet përpara vitit 2021. Nga të dhënat që administron UK Vlorë nuk është e mundur të ndahet vlera e arkëtimeve që i përket vitit 2021, si rrjedhojë vlera e arkëtimeve është progresive. Detyrimet që Ujësjetllësi ka ndaj bashkisë janë në vlerën 306,914,041 lekë (111,321,816 të mbartura + 195,592,225 viti 2021). Gjatë vitit 2021 shuma e kaluar nga Ujësjetllësi ndaj bashkisë është 210,475,773 lekë dhe detyrimet progresive që Ujësjetllësi ka kundrejt Bashkisë Vlorë më datë 31.12.2021 janë 96,438,269 lekë.

Nga auditimi rezulton se deri më datë 31.12.2021 Ujësjetllësi ka patur detyrime ndaj bashkisë në vlerën 96,438,269 lekë. Gjatë vitit 2022 niveli i arkëtimeve nga UK Vlorë për taksën e banesës

është 107,345,721 lekë ndërsa për tarifatat e pastrimit/gjelbërimit/ndriçimit është 108,929,489 lekë, në total 216,275,210 lekë. Në këto vlera arkëtimesh janë të përfshira edhe detyrime të familjeve për vitet përpara vitit 2022. Nga të dhënat që administrojnë UK Vlorë nuk është e mundur të ndahet vlera e arkëtimit që i përket vitit 2022, si rrjedhojë vlera e arkëtimit është progresive. Detyrimet që Ujësjetllësi ka ndaj bashkisë janë në vlerën 306,225,416 lekë (96,438,269 të mbartura + 209,787,147 viti 2021). Gjatë vitit 2022 shuma e kaluar nga Ujësjetllësi ndaj bashkisë është 208,702,033 lekë dhe detyrimet progresive që Ujësjetllësi ka kundrejt Bashkisë Vlorë më datë 31.12.2022 janë 97,523,383 lekë.

Për periudhën e auditimit rezulton se ka një akt marrëveshje midis Bashkisë Vlorë dhe UK Vlorë me qëllim rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të palëve lidhur me vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat nga tatim paguesit familjarë. Marrëveshje me nr.13330 prot; datë 22.1.2022 Bashkia Vlorë, dhe nr.3380 prot; datë 20.12.22 UK është lidhur marrëveshja e bashkëpunimit për agjentin tatimorë midis palëve . Nga auditimi vërehet se në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion strukturat e Bashkisë Vlorë, si rezultat i menaxhimit të këtyre taksave dhe tarifa nga UK Vlorë, Bashkia Vlorë nuk ka informacion se sa është numri dhe vlera progresive e debitorëve për taksën e banesës dhe tarifatat e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit më datë 31.12.2021, për tatimpaguesit familjarë që menaxhohen nëpërmjet agjentit tatimor UK Vlorë. Në qoftë se do ti referohemi të dhënave në tabelën më sipër vërehet se për vitin 2021 numri i familjeve debitorë për Taksën e Banesës është 20,220 që përbën 49 % të numrit të faturimeve. Për Taksën e Gjelbërimit, Pastrim, Ndriçim numri i familjeve debitor është 20,336 që përbën 49 % të faturimeve. Për vitin 2022 numri i familjeve debitorë për Taksën e Banesës është 9,818 që përbën 23% të numrit të faturimeve. Për Taksën e Gjelbërimit, Pastrim, Ndriçim numri i familjeve debitorë është 9,665 që përbën 23 % të faturimeve, Shoqëria “Ujësjetllës–Kanalizime” sha Vlorë, duke e vendosur në faturën e ujit të ndarë në mënyrë të barabartë për çdo muaj të vitit ushtrimor. Në mbledhjen e kësaj takse, kjo ndërmarrje do të luajë rolin e agjentit tatimor duke përfituar 3% të shumës së arkëtuar. - Ngarkohen për mbledhjen e kësaj takse sipas VKB nr.88 prot; datë 24.12.2020 dhe VKB nr. 79 prot; datë 02.12.2021 pika 8. *Për Njësitë Administrative të Bashkisë, Administratorët e njëjësive*, së bashku me kryetarët e fshatit, për banesat të cilat nuk janë të lidhura me rrjetin e Ujësjetllësit, taksa e banesës do të faturohet dhe do të mbledhet nga Shoqëria “Ujësjetllës –Kanalizime” sha” Vlorë.- Administratoret e Njëjësive Administrative, së bashku me Kryetarin e Fshatit të evidentojnë familjet që nuk janë të lidhura me rrjetin e Ujësjetllësit. Listat e përditësuara do të dorëzohen pranë Drejtorisë së ardhurave vendore, Bashkia Vlore” me qëllim krijimin e një regjistrit për rakordim në lidhje me arkëtimin e kësaj takse. Duke ju referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga Bashkia Vlorë dhe informacioneve të grumbulluara arrihet në konkluzion: se rezulton të jetë lidhur një akt marrëveshje me nr. 3330 prot; datë 22.11.2022 midis Kryetarit të Bashkisë Vlorë dhe ujësjetllës kanalizime. Sipas VKB nr. 88 prot; datë 24.12.2020 dhe VKB nr. 79 prot; datë 02.12.2021 pika 8, si rrjedhojë nuk ekziston një regjistër i hartuar nga DAV me të dhënat për tarifatat familjare, gjithashtu nga administratorët e njëjësive administrative nuk është arritur evidencimi i familjeve që nuk janë të lidhura me UK Vlorë me qëllim përditësimin e të dhënave për tarifatat familjare në kundërshtim me VKB nr.88 prot; datë 24.12.2020 pika 3/e dhe VKB nr. 79 prot; datë 02.12.2021 pika 2/e, procedurë e ndjekur është në kundërshtim me pika 7 e nenit 4, të Ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4 pika 7, ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i

ndryshuar, nenet 70 dhe 117, VKB nr.88 prot; datë 24.12.2020 pika 3/e dhe VKB nr. 79 prot; datë 02.12.2021 pika 2/e.

Ndikimi/Efekti: Ulje e të ardhurave për taksa e tarifa vendore në vlerën **97,523,383 lekë**.

Shkaku: Nga UK sha nuk janë marrë masa për arkëtimin e vlerës debitorë si dhe nga Bashkia Vlorë nuk është marrë masë për gjorbitjen në masën 50% të vlerës së pa arkëtuar të agjentit tatimor UK sha. Mungesa e të dhënave nga Administratorët e Rajoneve dhe Njësive Administrative, të cilët nuk kanë evidentuar familjet që nuk janë të lidhur me rrjetin e Ujësjesit, duke mos përditësuar listat e familjarëve që duhet të paguajnë taksat.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi 1: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e të Ardhurave Vendore Bashkia Vlorë, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për rishikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me UK sha Vlorë për një menaxhim më të mirë të taksave e tarifave nga abonentët familjarë, si dhe të kërkojë në rrugë ligjore e administrative arkëtimin e vlerës së detyrimit të arkëtuar nga UK sha Vlorë por të palikujduara në llogarinë e bashkisë për vlerën **97,523,383 lekë**.

Në cdo rast të mos derdhjes së detyrimeve të arkëtuara nga UK sha Vlorë apo të pa mbledhura (*të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj*), të fillojë procedurat për gjorbitjen e Agjentit Tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Rekomandimi 1: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Rajoneve dhe të Njësive Administrative, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore si edhe të hartohet regjistri i familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim rritjen e të ardhurave.

Nga subjekti i audituar, Bashkia Vlorë, mbi projekt raportin nr. 1026/28 prot; datë 28.09.2023, janë paraqitur kundërshti nga znj. B. Ç. me shkresën nr. 11597 prot; datë 27.10.2023, në cilësinë e administratores së Rajonit nr. 5, Bashkia Vlorë, e cila ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimi i subjektit:

Duke qenë se për mbledhjen e taksës është ngarkuar Shoqëria Ujësjesit - Kanalizime sh.a., pranë Rajonit Nr.5 nuk ka asnjë relacion mbi banesat të cilat që nuk janë lidhur me rrjetin Ujësjesit nga ky agjent tatimor, duke qenë se është gjithashtu detyrë funksionale konstatimi i këtyre banesave. Shoqëria "Ujësjesit - Kanalizime" sh.a. Vlorë, kundrejt rolit si agjent tatimor, duhet të kryej verifikimin e abonentëve të saj dhe jo, duke bashkërenduar punën dhe me Rajone ose Njësitë Administrative. Për më tepër, sipas VKB nr.88 prot; datë 24.12.2020 dhe VKB nr.79, datë 02.12.2021 pika 87. Për njësitë Administrative të bashkive dhe Administratorët e njësive, së bashku me kryetarët e fshatit, dëshirojmë të qartësojmë se në Rajonin Nr.5 nuk ka kryetar fshati. Për sa më sipër, kundërshtojmë ngarkesën me përgjegjësi për Administratorin e Rajonit Nr.5 znj. B. Ç.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Përsa na keni kundërshtuar theksojmë se: Në VKB-në nr. 79, datë 02.12.2021 dhe VKB nr.88 prot; datë 24.12.2020, thuhet qartë se: *Për Njësitë Administrative të Bashkisë, Administratorët e njësive, së bashku me kryetarët e fshatit, për banesat të cilat nuk janë të lidhura me rrjetin e Ujësjesit, taksa e banesës do të faturohet dhe do të mbledhet nga Shoqëria "Ujësjesit -Kanalizime" sha"*

Vlorë.- Administratoret e Njësive Administrative, se bashku me Kryetarin e Fshatit te evidentojnë familjet që nuk janë te lidhur me rrjetin e Ujësjetllësit. Listat e përditësuara do te dorëzohen pranë Drejtorisë se ardhurave vendore, Bashkia Vlorë” me qellim krijimin e një regjistrit për rakordim në lidhje me arkëtimin e kësaj takse.

Nga subjekti i audituar, Bashkia Vlorë, mbi projekt raportin nr. 1026/28 prot; datë 28.09.2023, janë paraqitur kundërshti nga z. A. Ç., me shkresën nr. 11597 prot; datë 27.10.2023, në cilësinë e administratorit të Rajonit nr. 1, Bashkia Vlorë, i cili ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimi i subjektit:

Duke ju referuar shkresës suaj me nr. 12125 prot ne datë 11/10/2023 në lidhje me auditimin e kryer ne Bashkinë Vlorë mbi gjetjet dhe rekomandimet përkatëse nga ana jonë rezulton se Agjenti tatimor i ngarkuar per konstatimin verifikimin dhe mbledhjen e taksës është Shoqëria "UKV" sha .Ne rajonin tone nuk kemi asnjë relacion ne lidhje verifikimin per banesat që kanë ose jo lidhje kontratash dhe vjelja apo jo e taksës se banesës dhe asnjë kërkesë bashkërendimi nga ana e UKV Dhe bazuar në këtë shpjegim përgjegjësia është e Agjentit Tatimor.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Përsa i përket pretendimit se është e agjentit tatimor në këtë rast UK sha nuk qëndron së në VKB nr. 79, datë 02.12.2021 dhe VKB nr.88 prot; datë 24.12.2020 specifikohet qartë se agjenti tatimor është përgjegjës për abonentët që kanë kontratë me UK.

- Tarifa e shërbimit pastrim/ndriçim/gjelbërim për subjektet që ushtrojnë aktivitet në transportin e mallrave, pasagjerëve, mjeteve të peshkimit dhe transportit detar për pasagjerët.

Titulli gjetjes: Mbi tarifën e shërbimit pastrim/ndriçim/gjelbërim për subjektet që ushtrojnë aktivitet në transportin e mallrave, pasagjerëve, mjeteve të peshkimit dhe transportit detar për pasagjerët.

Situata: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e të ardhurave dhe tarifave vendore Bashkia Vlorë, lidhur me subjektet që ushtrojnë aktivitet në transportin e mallrave, pasagjerëve, mjeteve të peshkimit dhe transportit detar për pasagjerët rezultoi se: Për vitin 2021 kanë ushtruar veprimtarin ne territorin e Bashkisë Vlorë 974 subjekte në total, nga të cilat 144 subjekte janë debitorë dhe nuk kanë paguar tarifën për Pastrim / Ndriçim / Gjelbërim në vlerën prej 924,583 lekë.

Për vitin 2022 kanë ushtruar veprimtarinë në territorin e Bashkisë Vlorë 800 subjekte në total, nga të cilët 61 subjekte janë debitorë dhe nuk kanë paguar Tarifën për Pastrim/Gjelbërim /Ndriçim në vlerën prej 555,250 lekë. Nga të dhënat e audituara rezulton se për vitin 2021 dhe vitin 2022 janë debitorë një numër prej 205 subjektësh në vlerën prej **1,479,833** lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë. Nga ana e Drejtorisë së të ardhurave dhe tarifave Vendore me shkresën nr.8189 Datë 19.07.2022 është kërkuar kërkesë për bashkëpunim Policisë Bashkiake dhe mbështetje për subjektet debitorë me aktivitet transporti. Ngarkohet për mbledhjen e kësaj tarife Drejtoria e të Ardhurave Vendore sipas VKB nr. 79 prot; Datë 02.12.2021 pikat

(2.a,2.b,2.c,2.d) faqe 17. Nga auditimi arrihet në konkluzion se nuk janë marrë masat e duhura për vjeljen e kësaj tarife. Debitorët e pasqyruar në anekset 3 dhe 4 *Bashkëlidhur Burimi i të dhënave specialisti i IT DAV.*

Kriteri: VKB nr. 79 prot; Datë 02.12.2021 pikat (2.a,2.b,2.c,2.d) faqe 17.

Ndikimi/Efekti: Ulje në nivelin e të ardhurave për tarifa vendore në vlerën **1,479,833 lekë.**

Shkaku: Keqmenaxhim dhe mos marrja e masave për ndjekjen e debitorëve nga strukturat përgjegjëse.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Vlorë, të nxjerrjen njoftim-vlerësimin e detyrimeve për tarifën e shërbimit pastrim/ndriçim/gjellbërim për subjektet që ushtrojnë aktivitetin në transportin e mallrave me vlerë debitorë **1,479,833 lekë**, si dhe të ndjek të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës.

- Lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit

Grupi i auditimit auditori dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi përkatësisht:

- Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me Ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 20/pika 2;

- VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 2/9 “Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera”.

Referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se, në territorin e Bashkisë Vlorë për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 43 subjekte. *Subjekte të paraqitura në tabelën nr. 13 të akt konstatimit nr. 34.*

Tabela nr. 13: Subjektet që ushtrojnë aktivitet në shitjen e lëndëve djegëse me pakicë të cilët nuk kanë paguar detyrimin dhe nuk janë të pajisur me autorizimet përkatëse.

Nr.	Subjekti	Adresa	Autorizime fillon-mbaron	Niveli tarifës sipas VKM nr. 344	Pagesë deri në vitin 31.12.2021	Pagesë gjatë vitit 2022	Pagesa gjatë vitit 2023	Detyrime për t'u paguar për autorizimin
1	A.	L.11 Janari	2019-2024	1 000 000				1,000,000
2	B.&S.	L.Pavaresia	2019-2024	1 000 000				1,000,000
3	A.	L.15 Tetori	17.05.2020-17.05.2025	1 000 000				1,000,000
4	E.-E.	L.Partizani	2019-2024	1 000 000				1,000,000
5	R. C.	L.11 Janari	06.11.2017-05.11.2022	1 000 000	1 000 000			1,000,000
6	A. & B. 2018	Skrofotine	2019-2024	1 000 000	200 000			800,000

Nr.	Subjekti	Adresa	Autorizime fillon-mbaron	Niveli tarifës sipas VKM nr. 344	Pagesë deri në vitin 31.12.2021	Pagesë gjatë vitit 2022	Pagesa gjatë vitit 2023	Detyrime për t'u paguar për autorizimin
					v.2019			
7	Sh. O. 2017	Novosele	23.5.2019-23.05.2020 2019-2024	1 000 000	200 000 v.2019			800,000
8	D. T.	Dukat Fshat	2019-2024	1 000 000				1,000,000
9	A.	Bestrove	2019-2024	1 000 000				1,000,000
10	E. - 88	Babice Madhe	17.01.2020-16.01.2021 2020-2025	1 000 000	200 000 v.2020		800,000	-
11	V.	Sherisht	2019-2024	1 000 000				1,000,000
12	J. 2000	Sherisht	2019-2024	1 000 000				1,000,000
13	V.	I. Imaji	2019-2024	1.000.000	200.000		600,000	200,000
14	J. P.	Llakatund	2019-2024	1 000 000				1,000,000
	TOTALI							11,800,000

Burimi: Bashkia Vlorë drejtoria e infrastrukturës

Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre dhe referuar evidencave të mbajtura në lidhje me arkëtimin e tarifave vendore, konstatohet se në territorin e Bashkisë Vlorë operojnë 13 subjekte me stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në mungesë të autorizimit të licencimit për ushtrim aktiviteti. Këto subjekte nuk kanë aplikuar në Bashki për pajisjen dhe përsëritjen e licencave nga Bashkia Vlorë, rrjedhimisht **nuk është bërë pagesa e detyrimit ligjor prej 11,800,000 lekë i cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë**. Subjekti A. & B. 2018 ka bërë pagesë vetëm për vitin 2020-2021 në vlerën prej 200,000 lekë. Subjekti Sh. O. 2017 ka bërë pagesë për vitin 2019-2020 në vlerën prej 200,000 lekë, Subjektin E. - 88 ka bërë pagesë për vitin 2020-2021 në vlerën prej 200,000 lekë, ndërsa ka likujtuar vlerën prej 800,000 më datë 02.05.2023. Në total në bashkinë Vlorë ushtrojnë aktivitetin e tyre 43 (dyzet e tre) subjekte nga të cilat 22 (njëzet e dy) subjekte janë të pajisur me lincencat përkatëse dhe kanë paguar detyrimin për 5 (pesë) vite, 8 (tetë) subjekte kanë paguar tarifën prej 1,000,000 por nuk janë të pajisur me licencë duke mos paraqitur dokumentacion pranë Bashkisë Vlorë, 13 subjekte nuk kanë paguar detyrimin dhe nuk janë të pajisur me licencë.

Përsa i përket 8 subjekteve të cilët janë të pasqyruar në **aneksin nr.1** të cilët kanë paguar tarifën por nuk janë të pajisur me licencë bie në kundërshtim me Ligjin - Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me Ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4 “Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme”, VKM nr.344 datë 19.4.2017 pika “6.1 Në rast se personi juridik nuk riparaqet dokumentacionin e kërkuar, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, autoriteti licencues në parashikimet ligjore ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për bllokimin e aktivitetit tregtar, deri në riparaqitjen e dokumentacionit të plotë nga ana e personit juridik, për pajisjen e tij me licencë për tregtimin me pakicë të

karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.”

Nga Bashkia Vlorë nuk është vazhduar ndjekja e procedurave në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial dhe në Institucionet e tjera përkatëse deri në bllokimin e veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të hidrokarbureve.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore, përkatësisht:

- Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me Ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4 “Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme”, neni 15... Stacionet e shitjes së karburanteve lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë pajisur nga organi kompetent me autorizimin përkatës, sipas këtij ligji...”, neni 20-Autorizimet pika 2, “Autorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat “ç” dhe “d” të nenit 11⁵, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë **deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje**”; neni 15.1 dhe 15.2 : konkretisht 15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë. 15.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet e licencuara dhe vendndodhjen e pikave të depozitimit apo të tregtimit, në mënyrë që këto të fundit të kontrollojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi.”

- VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3 “*Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga organet e qeverisjes vendore*”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: **z. Z. S.**, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Investimeve Publike; **znj. M. M.**, në cilësinë e specialistes së transportit.

<p>Titulli gjetjes: Menaxhimi i të ardhurave nga taksa e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë.</p>
--

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre dhe referuar evidencave të mbajtura në lidhje me arkëtimin e tarifave vendore, konstatohet se

në territorin e Bashkisë Vlorë operojnë **13** subjekte me stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në mungesë të autorizimit të liçencimit për ushtrim aktiviteti. Këto subjekte nuk kanë aplikuar në Bashki për pajisjen dhe përsëritjen e liçencave nga Bashkia Vlorë, rrjedhimisht *nuk është bërë pagesa e detyrimit ligjor prej 11,800,000 lekë i cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë*. Subjekti A. & B. 2018 ka bërë pagesë vetëm për vitin 2020-2021 në vlerën prej 200,000 lekë; Subjekti Sh. O. 2017 ka bërë pagesë për vitin 2019-2020 në vlerën prej 200,000 lekë; Subjekti E. - 88 ka bërë pagesë për vitin 2020-2021 në vlerën prej 200,000 lekë, ndërsa ka likuaduar vlerën prej 800,000 më datë 02.05.2023. Në total në bashkinë Vlorë ushtrojnë aktivitetin e tyre 43 (dyzet e tre) subjekte nga të cilat 22 (njëzet e dy) subjekte janë të pajisur me lincencat përkatëse dhe kanë paguar detyrimin për 5 (pesë) vite, 8 (tetë) subjekte kanë paguar tarifën prej 1,000,000 por nuk janë të pajisur me licencë duke mos paraqitur dokumentacion pranë Bashkisë Vlorë, 13 subjekte nuk kanë paguar detyrimin dhe nuk janë të pajisur me licencë.

Përsa i përket 8 subjekteve të cilët janë të pasqyruar në *Aneksin nr.1*, bashkëlidhur akt konstatimit nr. 34, të cilët kanë paguar tarifën por nuk janë të pajisur me licencë bie në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me Ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4 “Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme”, VKM nr.344 datë 19.4.2017 pika “6.1 Në rast se personi juridik nuk riparaqet dokumentacionin e kërkuar, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, autoriteti licencues në parashikimet ligjore ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për bllokimin e aktivitetit tregtar, deri në riparaqitjen e dokumentacionit të plotë nga ana e personit juridik, për pajisjen e tij me licencë për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.”

Nga Bashkia Vlorë nuk është vazhduar ndjekja e procedurave në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial dhe në Institucionet e tjera përkatëse deri në bllokimin e veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa liçencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të hidrokarbureve.

Kriteri: VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar me VKM nr. 344 datë 19.04.2017 kapitulli II, pika 1; germa “b”, pikat 9, 15.1 dhe 15.2 Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me Ligjin nr. 71/2014.

Ndikimi/Efekti: Në uljen e të ardhurave për taksa e tarifa vendore në **vlerën prej 11,800,000 lekë**.

Shkaku: Mos kryerja e një pune të mjaftueshme dhe mos ndjekja e procedurave në bashkëpunim me institucionet përkatëse për mbylljen e aktivitetit të subjekteve që nuk rinovojnë licencën.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Vlorë, nëpërmjet Drejtorisë së Investimeve Publike, Strehimit dhe Transportit, të marrë masa që të pajisë subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajra lubrifikante dhe lëndë djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojë tarifatat për **13** subjektet që nuk kanë bërë

pagesa për pajisje me autorizime, për diferencën debitorë prej **11,800,000** lekë.

Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të tyre.

- Auditimi i procedurave të kryera për arkëtimin e të ardhurave nga tarifës së pastrim-gjelbërim-ndriçimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në bazë lelesh ndërtimi dhe investime me fonde publike në territorin e Bashkisë Vlorë.

Lidhur me subjektet që janë shpallur fitues nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duke fituar të drejtën të kryejnë punime në territorin e Bashkisë Vlore mbi pagesën e detyrimeve të këtyre subjekteve për taksat dhe tarifave vendore për periudhën e ushtrimit të aktiviteti. Në zbatim të V.K.B-së nr. 88, datë 24.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”, bazuar në informacionin e dhënë nga Njësia e Prokurimit me shkresën nr. 13045/1 prot; datë 29.09.2021 është kryer vlerësimi i subjekteve për tarifën e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit si më poshtë: për vitin 2021 kanë kryer punime në territorin e Bashkisë Vlorë 9 subjekte të cilët kanë paguar detyrimin për tarifën e pastrim, ndriçim, dhe gjelbërim. Të pasqyruara në Tabelën nr. 14.

Tabela nr.14: Subjektet që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Vlorë, viti 2021.

Nr.	Objekti i kontratës së prokurimit	Subjekti	Nr. Kontrate	Date	Vlera me TVSh	Afati kontratës	Tarife pastrim ndriçim gjelbërim	Paguar
1	Rehabilitimi dhe riasfaltimi i disa akseve rrugore ne qytetin e Vlorës	K.M.K	5323	08.04.2021	19,251,750	2 muaj	5000	5000
2	Rikonstruksion i disa akseve rrugore te Bashkisë Vlore fII	B. - X	8409	31.05.2021	13,418,547	1 muaj	2500	2500
3	Ndërtimi i murit mbajtës dhe pastrimi I kanalit KUL ne lagjen Karabash	L.	7502	07.05.2021	4,111,660	2 muaj	6666.67	6666.67
4	Rikonstruksion i Ujësjiellit ne fshatrat e Njesisë Administrative Novosele	G. 2 + Rr. G.	9182	09.06.2021	874,700,215	18 muaj	67500	67500
5	Rikualifikim urban ne Njesine Administrative Qendër	Sh. 07	9904	25.06.2021	6,000,000	2 muaj	5000	5000
6	Riasfaltim i disa rrugëve Ne fshatin Poro, Njësia Administrative Novosele	C. AM + S. AB	4660	25.03.2021	3,329,952	7 dite	2500	2500
7	Rehabilitimi dhe riasfaltimi i rrugës Llakatund - Beshisht	A. + AL A.	7828	11.05.2021	57,142,175	1 muaj	3333.33	3333.33
8	Rikonstruksion i rrugës Panaja - Oshime	A.	5142	06.04.2021	15,547,968	15 dite	3333.33	3333.33
9	Nderhyrje riparimi ne shkollën "4 Heronjte"	2 N.	9710	22.06.2021	1,596,900	1 muaj	2500	2500

Burimi : Bashkia Vlorë DAV

Tabela nr.15: Subjektet që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Vlorë, viti 2022.

Nr.	Objekti	Operatori ekonomik fitues	Vlera e Kontratës me TVSH	Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit	Tarfi gjelbërimi Pastrimi ndriçimi	detyrimi
1	Rikonstruksioni i Urës Qe Lidh Fshatin Llakatund me Fshatrat Picar Armen Bashkia Selenice	Xh. S.	18000000.00	11.08.22	10,000	10,000
2	Investime ne infrastrukturën e shkollave, kopshteve e çerdheve	AL-C.	57150.00	18/4/2022	50,000	50,000
3	Riparimi dhe Lyrja e Zyrës se Shërbimeve ne Bashki	T.	2.154.600	6/24/2022	50,000	50,000
4	Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëri dhe të pa favorizuara	N. 1934	3.320.973	29.08.2022	50,000	50,000
5	Rehabilitim i interseksionit rrugor të aksit kryesor me rrugën Shaban Demiraj	A.-2A C.	2.928.600	17.10.2022	50,000	50,000
6	Rikonstruksion i rrugës se fshatit Kerkove	Sh. 07	21.600.000	11.08.2022	50,000	50,000
7	Rikonstruksion i tualeteve te shkollës 9 vjeçare "J. M."	N. 2000	3.222.288	7/18/2022	50,000	50,000
8	Rikualifikim i bllokut të banesave kufizuar nga Bulevardi "Cameria", Rruga"Pelivan L.", Rruga "Kujtim Beqiri", Rruga "Piro Sava	A.	4.358.688	19.10.2022	50,000	50,000
9	Strukture me pilota për sistemim skarpati pas Godinës se Bashkisë	I.	10.074.141	23.05.2022	50,000	50,000
10	Rikonstruksioni i Shkollës Teli Ndini	4 A C.	543000.00	29/09/2022 0	50,000	50,000
	Totali					460,000

Burimi : Bashkia Vlorë përpunuar nga grupi i auditimit.

Për vitin **2022**, nuk janë raportuar pranë drejtorisë së të ardhurave dhe tarifave vendore lidhur me subjektet që janë shpallur fitues nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave që kanë fituar të drejtën të kryejnë punime në territorin e Bashkisë Vlore mbi pagesën e detyrimeve të këtyre subjekteve për taksat dhe tarifave vendore për periudhën e ushtrimit të aktivitetit. *Tabela nr.15*

Nga auditimi rezulton se, Kanë kryer punime në territorin e Bashkisë Vlorë 10 subjekte te cilat nuk kanë paguar detyrimin për tarifën pastrim/ ndriçim/gjelbërim në vlerën **460,000 lekë**. Situata e mësipërme është krijuar si rrjedhojë e mosraportimit pranë DAV-së Bashkia Vlorë, të lejeve të infrastrukturës dhe dokumentacionin mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit, nga DPKZHT, por edhe nga mungesa e informacionit lidhur me dërgimin e listës së operatorëve ekonomik me aktivitet ndërtimi, fitues të procedurave të prokurimit publik pranë Bashkisë Vlorë. Nga auditimi dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DAV vërehet një mos koordinim ndërmjet strukturave apo drejtorive përkatëse në Bashkinë Vlorë përsa i përket raportimit pranë DAV-së. Lidhur me detyrimet qe ka secila drejtori ku rezulton se :1-Drejtorja e urbanistikës edhe pas kërkesave për informacion të DAV-së konkretisht shkresës nr.735 prot; datë 25.01.2022, shkresën nr.11712., prot datë 18.02.2022, shkresën nr.6394 prot; datë 03.06.2022 nuk ka raportuar detyrimet për vitet përkatëse. Drejtorja e të ardhurave vendore me shkresën nr.1147 prot;datë 10.10.2022 ka dërguar shkresën kërkesë për bashkëpunim dhe vëmendje nga drejtorja e urbanistikës, drejtorja Juridike

dhe njësia e prokurimit në zbatim të VKB-së nr. 79 prot; për disa ndryshime në VKB nr.88 datë 24.12.2020 “ Për miratimin e taksave dhe tarifave Vendore në Bashkinë Vlorë”. Gjithashtu drejtuar drejtorisë së urbanistikës me shkresën nr.10778 prot; datë 26.09.2022 kërkesë e përsëritur për informacion “ Mbi subjektet që janë pajisur me leje zhvillimi/ndërtimi. Në mënyrë të vazhdueshme është kërkuar nga ana e DAV-së që nga strukturat e përmendura më lart të japin informacion apo të dhëna lidhur me subjektet me aktivitet ndërtimi të cilët pajisen me leje ndërtimi/zhvillimi apo me kontrata për punë publike, me qëllim vlerësimin tatimor për tarifën e Pastrim/ndriçim/gjelbërimi. 2-Drejtoria Juridike, Njësia e prokurimit edhe pas shkresës nr. 735 prot; datë 25.01.2022 nuk ka dërguar listën për vitin 2022 pranë DAV-së Vlorë lidhur me operatorët ekonomik të cilët janë fitues të procedurave të prokurimit dhe kanë kryer punime ndërtimi, duke sjellë mungesë të dhënash lidhur me këtë veprimtari, si pasojë në vlerën debitorë prej **460,000 lekësh e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë**. Grupi i auditimit ka kërkuar pranë Drejtorisë së Planifikimit, Kontrolli dhe Zhvillimit të Territorit për subjektet të cilët janë pajisur me leje ndërtimi për vitet periudhë auditimi 2021 dhe 2022 pasi nuk kishte raportuar pranë Drejtorisë së të Ardhurave dhe Tarifave Vendore . Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DPKZHT pranë grupit të auditimit i është kërkuar DAV-së informacion lidhur me subjekt të cilët janë pajisur me leje ndërtimi për vitin 2021 dhe për vitin 2022. Nga të dhënat që janë vënë në dispozicion pranë grupit të auditimit nga ana e DAV-së rezulton se për vitin 2021 janë pajisur me leje ndërtimi dhe kanë njoftuar për fillimin e punimeve 38 subjekte dhe kanë ushtruar veprimtarin e tyre pranë territorit të Bashkisë Vlorë, nga të cilët 33 subjekte nuk kanë paguar tarifën e pastrimit/gjelbërimit/ ndriçimit në vlerën 900,000 lekë . Për vitin 2022 janë pajisur me leje ndërtimi 44 subjekte dhe kanë ushtruar veprimtarinë e tyre pranë territorit të Bashkisë Vlorë, nga të cilët 44 subjekte nuk kanë paguar tarifën e pastrimit/gjelbërimit/ndriçimit në vlerën 1,800,000 lekë. Për periudhën nën auditim konkretisht për vitet 2021 dhe vitin 2022 rezultojnë 82 subjekte debitorë në vlerën **2,700,000 e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë**. Duke iu referuar VKB-së nr.79 prot; datë 02.12.2021 për disa ndryshime në VKB nr. 88 prot; datë 24.12.2020 “ Për taksat dhe tarifat vendore Vlorë” ku specifikohet se për efekt të procedurave tatimore, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimi të Territorit dhe Njësia e Prokurimit e cila është sektor në varësi të Drejtorisë Juridike, sipas Rregullores së Brendshme, me Vendim nr. 101 prot; datë 11.09.2018, në Bashkinë Vlorë ngarkohen të njoftojnë DAV-në për subjektet apo individët që pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi apo subjekte me leje ndërtimi për investime publike në Bashkinë Vlorë. Nga auditimi rezulton se Drejtoria e DPKZHT nuk ka dërguar listat e subjekteve me leje ndërtimi/zhvillimi. Nga DAV kanë dalë vazhdimisht urdhra pune për inspektorët e terrenit, me qëllim evidentimin e kantierëve të ndërtimit sipas rajoneve /njësive administrative, me qëllim për t'i shërbyer specialistëve të pranimit për ngarkesën e detyrimit tatimor, në zbatim të VKB së nr.79, datë 02.12.2021 për disa ndryshime në VKB-në nr. 88 prot; datë 24.12.2020, “Për taksat dhe tarifat vendore Vlorë”. Gjithashtu ka dalë urdhri i kryetarit të Bashkisë nr. 316 prot; datë 10.12.2021 për ndarjen e grupit të punës në sektorin e terrenit sipas rajoneve, urdhër nr.4 datë 14.01.2022 për një ndryshim në urdhrin nr.316 datë 10.12.2021 për ndarjen e grupeve të punës në sektorin e terrenit. Përsa i përket mbledhjes se kësaj tarife ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave dhe Tarifave Vendore, konkretisht pika 2 e VKB nr. 79., prot 02.12.2021 (2.a,2.b,2.c,2.d). Situata e krijuar vjen dhe si rezultat nga puna e pa mjaftueshme nga inspektorët e terrenit lidhur ushtrimin e kontrolleve për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në Bashkinë Vlorë. Subjektet debitorë të pasqyruara në *Anekset nr.8 dhe 9*.

Veprime në kundërshtim VKB nr.88 datë 24.12.2020 për disa ndryshime në VKB-së nr. 79 prot; datë 02.12.2021“ Për miratimin e taksave dhe tarifave Vendore në Bashkinë Vlorë”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: **z. J. Ç.**, ish-Drejtor i DPKZHT; **z. Z. S.**, Drejtor i DPKZHT për vitin 2022; **z. D. Z.**, ish-Drejtor Juridik, Njësia e Prokurimit. Për mos veprime ngarkohen dhe inspektorët e terrenit sipas urdhërve të kryetarit, **z. I. M.**, inspektor terreni, **z. D. I.**, inspektor terreni; **z. M. L.**, inspektor terreni; **z. A. L.**, me detyrë specialist kontrolli në terren; **z. E. P.**, inspektor terreni NJA Qendër; **z. A. Rr.**, inspektor terreni Rajoni 2 dhe 3; **z. F. B.**, njësia Orikum; **znj. A. Sh.**, inspektore terreni Rajoni 5; **z. E. F.**, inspektor terreni NJA Shushicë; **z. G. S.**, inspektor terreni NJA qendër; **z. A. A.**, inspektor terreni Rajoni 3; **z. K. Sh.**, inspektor terreni Rajoni 3; **z. G. A.**, inspektor terreni Rajoni 2; **z. E. A.**, inspektor terreni Rajoni nr.2; **z. M. Ll.**, inspektor terreni Rajoni nr. 1 dhe 4; **z. A. B.**, inspektor terreni Rajoni 5; **z. K. C.**, inspektor terreni Rajoni 3; **znj. R. L.**, ish-inspektore terreni rajoni 3; **z. A. B.**, inspektor terreni Rajoni 1 dhe 4.

Titulli gjetjes: Procedurat e kryera për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në bazë lelesh ndërtimi dhe investime me fonde publike në territorin e Bashkisë Vlorë.

Situata: Nga auditimi rezulton se, kanë kryer punime në territorin e Bashkisë Vlorë 10 subjekte të cilat nuk kanë paguar detyrimin për tarifën pastrim / ndriçim / gjelbërim në vlerën **460,000 lekë**. Situata e mësipërme është krijuar si rrjedhojë e mosraportimit pranë DAV-së Bashkia Vlorë, të lejeve të infrastrukturës dhe dokumentacionin mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit, nga Drejtoria e DPKZHT, por edhe nga mungesa e informacionit lidhur me dërgimin e listës së operatorëve ekonomik me aktivitet ndërtimi, fitues të procedurave të prokurimit publik pranë Bashkisë Vlorë. Nga auditimi dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DAV vërehet një mos koordinim ndërmjet strukturave apo drejtorive përkatëse në Bashkinë Vlorë përsa i përket raportimit pranë DAV-së. Lidhur me detyrimet që ka secila drejtori ku rezulton se :1-Drejtoria e urbanistikës edhe pas kërkesave për informacion të DAV-së konkretisht shkresës nr.735 prot; datë 25.01.2022, shkresën nr.11712., prot datë 18.02.2022, shkresën nr.6394 prot; datë 03.06.2022 nuk ka raportuar detyrimet për vitet përkatëse. Drejtoria e të ardhurave vendore me shkresën nr.1147 prot;datë 10.10.2022 ka dërguar shkresën kërkesë për bashkëpunim dhe vëmendje nga drejtoria e urbanistikës, drejtoria Juridike dhe njësia e prokurimit në zbatim të VKB-së nr. 79 prot; për disa ndryshime në VKB nr.88 datë 24.12.2020 “ Për miratimin e taksave dhe tarifave Vendore në Bashkinë Vlorë”. Gjithashtu drejtuar drejtorisë së urbanistikës me shkresën nr.10778 prot; datë 26.09.2022 kërkesë e përsëritur për informacion “ Mbi subjektet që janë pajisur me leje zhvillimi/ndërtimi. Në mënyrë të vazhdueshme është kërkuar nga ana e DAV-së që nga strukturat e përmendura më lart të japin informacion apo të të dhëna lidhur me subjektet me aktivitet ndërtimi të cilët pajisen me leje ndërtimi/zhvillimi apo me kontrata për punë publike, me qëllim vlerësimin tatimor për tarifën e Pastrim / ndriçim / gjelbërimi. 2-Drejtoria Juridike, Njësia e Prokurimit edhe pas shkresës nr. 735 prot; datë 25.01.2022 nuk ka dërguar listën për vitin 2022 pranë DAV-së Vlorë lidhur me operatorët ekonomik të cilët janë fitues të procedurave të prokurimit dhe kanë kryer punime ndërtimi, duke sjellë mungesë të dhënash lidhur me këtë veprimtari, si pasojë në vlerën debitorë prej **460,000 lekësh e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë**. Grupi i auditimit ka kërkuar pranë Drejtorisë së DPKZHT për subjektet të cilët

janë pajisur me leje ndërtimi për vitet periudhë auditimi 2021 dhe 2022 pasi nuk kishte raportuar pranë Drejtorisë së të Ardhurave dhe Tarifave Vendore . Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DPKZHT pranë grupit të auditimit i është kërkuar DAV-së informacion lidhur me subjekt të cilët janë pajisur me leje ndërtimi për vitin 2021 dhe për vitin 2022. Nga të dhënat që janë vënë në dispozicion pranë grupit të auditimit nga ana e DAV-së rezulton se për vitin 2021 janë pajisur me leje ndërtimi dhe kanë njoftuar për fillimin e punimeve 38 subjekte dhe kanë ushtruar veprimtarinë e tyre pranë territorit të Bashkisë Vlorë, nga të cilët 33 subjekte nuk kanë paguar tarifën e pastrimit/gjelbërimit/ ndriçimit në vlerën 900,000 lekë . Për vitin 2022 janë pajisur me leje ndërtimi 44 subjekte dhe kanë ushtruar veprimtarinë e tyre pranë territorit të Bashkisë Vlorë, nga të cilët 44 subjekte nuk kanë paguar tarifën e pastrimit / gjelbërimit / ndriçimit në vlerën 1,800,000 lekë. Për periudhën nën auditim konkretisht për vitet 2021 dhe vitin 2022 rezultojnë 82 subjekte debitorë në vlerën **2,700,000 e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë**. Duke iu referuar VKB-së nr.79 prot; datë 02.12.2021 për disa ndryshime në VKB nr. 88 prot; datë 24.12.2020 “ Për taksat dhe tarifavat vendore Vlorë” ku specifikohet se për efekt të procedurave tatimore, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimi të Territorit dhe Njësia e Prokurimit e cila është sektor në varësi të Drejtorisë Juridike sipas Rregullores së Brendshme me Vendim nr.101 prot; datë 11.09.2018, në Bashkinë Vlorë ngarkohen të njoftojnë DAV-në për subjektet apo individët që pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi apo subjekte me leje ndërtimi për investime publike në Bashkinë Vlorë.

Nga auditimi rezulton se DPKZHT nuk ka dërguar listat e subjekteve me leje ndërtimi/zhvillimi. Nga DAV kanë dalë vazhdimisht urdhra pune për inspektorët e terrenit, me qëllim evidentimin e kantierëve të ndërtimit sipas rajoneve /njësive administrative, me qëllim për ti shërbyer specialistëve të pranimit për ngarkesën e detyrimit tatimor, në zbatim të V.K.B së nr.79 datë 02.12.2021 për disa ndryshime në V.K.B-në nr. 88 prot; datë 24.12.2020 “ Për taksat dhe tarifavat vendore Vlorë”. Gjithashtu ka dalë urdhri i kryetarit të Bashkisë nr. 316 prot; datë 10.12.2021 për ndarjen e grupit të punës në sektorin e terrenit sipas rajoneve, urdhër nr.4 datë 14.01.2022 për një ndryshim në urdhrin nr.316 datë 10.12.2021 për ndarjen e grupeve të punës në sektorin e terrenit. Përsa i përket mbledhjes se kësaj tarife ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave dhe Tarifave Vendore, konkretisht pika 2 e VKB nr. 79., prot 02.12.2021 (2.a,2.b,2.c,2.d). Situata e krijuar vjen dhe si rezultat nga puna e pa mjaftueshme nga inspektorët e terrenit lidhur ushtrimin e kontroleve për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në Bashkinë Vlorë. Subjektet debitorë të pasqyruara në *Anekset nr.8 dhe 9*.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreu VII, neni 35, V.K.B së nr.79 datë 02.12.2021 për disa ndryshime në VKB - në nr. 88 prot; datë 24.12.2020 “ Për taksat dhe tarifavat vendore Vlorë”.

Ndikimi/Efekti: Në uljen e të ardhurave për taksa e tarifa vendore në **vlerën prej 2,700,000 lekë**.

Shkaku: Mos marrja e masave për ndjekjen dhe arkëtimin e të ardhurave nga strukturat përgjegjëse.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë nëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Njësinë e Prokurimit të saktësojë listat e bizneseve të ndërtimit që kanë qenë zbatuese të lejeve të ndërtimit dhe të projekteve të investimeve të prokuruar për vitet 2021-2022, që kanë seli jashtë territorit të Bashkisë Vlorë dhe Njësive Administrative dhe që ushtrojnë

aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, të nxjerrin njoftim detyrimin për tarifën e pastrim-gjellbërim-ndriçimit dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës së kësaj tarife prej **2,700,000 lekë**.

Nga subjekti i audituar, Bashkia Vlorë, mbi projekt raportin nr. 1026/28 prot; datë 28.09.2023, janë paraqitur kundërshti nga z. A. Rr. me shkresën nr. 11597 prot; datë 27.10.2023, në cilësinë e inspektorit të terrenit, Bashkia Vlorë, i cili ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimi Subjektit:

Në mbështetje të shkresës suaj me Nr.12176 Prot; datë 11.10.2023 “Në lidhje me Raport Auditimin nr.1026/1, datë 25.11.2022”, për titulli i gjetjes: Auditim i procedurave të kryera për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa pastrim gjellbërim ndriçim për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në bazë lejesh ndërtimi dhe investime me fonde publike (fq 71-77) ju informojmë se në lidhje me këtë gjetje nga rekomandimi i lënë nga ana e audituesit të KLSH- së, sikurse theksohet edhe V.K.B-së nr.79, datë 02.12.202 i ndryshuar, janë Drejtoria e Urbanistikës dhe Njësisë së Prokurimit strukturat që duhet të përcjellin të dhënat për subjektet që pajisen me leje ndërtimi apo përfitojnë punë publike me fondet e shtetit. Edhe pse Drejtoria e të Ardhurave Vendor e ka kryer korrespondencën me këto drejtori, duke ju kërkuar vazhdimisht të dhëna për këto subjekte, ka munguar bashkëpunimi me ta. Vlerësimi i subjekteve që janë evidentuar në terren nga inspektorët e terrenit është kryer në të gjitha rastet, por jo në çdo rast DAV ka dijeni për lejet që jep Bashkia Vlorë, strukturat e ngarkuara me ligj. Lista me leje ndërtimi sipas anekseve numër 8 dhe 9 përfshin leje punimesh zbatimi për banesa dhe shtëpi private në të cilat nuk kemi patur informacione. Përsa kohë nuk jemi njoftuar, nuk mbajmë përgjegjësi për detyrat që na janë ngarkuar në këtë urdhër.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në përgjigje të kundërshtimit tuaj theksojmë se :Detyrat në urdhër janë të mirpërcaktuara, nga na juaj nuk na është vënë në dispozicion asnjë dokument justifikues ku ti vërtetojë ato çfarë ju pretendoni. Për më tepër detyrat e inspektorëve të terrenit janë të qarta në rregulloren e brendshme nr. 101 prot; datë 11.09.2018.

Nga subjekti i audituar, Bashkia Vlorë, mbi projekt raportin nr. 1026/28 prot; datë 28.09.2023, janë paraqitur kundërshti nga znj. A. Sh., me shkresën nr. 11597 prot; datë 27.10.2023, në cilësinë e Drejtorit të Taksave dhe Tarifave, Bashkia Vlorë, e cila ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimi i subjektit :

Në lidhje me këtë gjetje, theksoj se rekomandimi i lënë nga ana juaj, sikurse theksohet edhe V.K.B-së nr. 79, datë 02.12.2021 i ndryshuar, janë Drejtoria e Urbanistikës dhe Njësisë së Prokurimit struktura që duhet të përcjellë të dhënat për subjektet të cilat pajisen me leje ndërtimi apo përfitojnë punë publike me fondet e shtetit. Edhe pse Drejtoria e të Ardhurave Vendore ka kryer korrespondencën zyrtare me këto drejtori, duke ju kërkuar vazhdimisht të dhën për këto subjekte, ka munguar bashkëpunimi me ta. Vlerësimi i subjekteve që janë evidentuar në terren nga inspektorët e terrenit është kryer në të gjitha rastet, por jo në cdo rast DAV ka dijeni për lejet që jep Bashkia Vlorë , strukturat e ngarkuara me ligj. Këto detyrime të cilat ju i keni nxjerrë gjatë auditimit të kryer nga ana juaj, nuk janë detyrime të kontabilizuara në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe në këto kushte nuk ka se si DAV të nxjerrë njoftim vlerësime për këta subjekte të cilat janë me detyrime në vlerën 2.700.000 lekë të lindura nga struktura të tjera. Drejtoria e të

Ardhurave Vendore këto subjekte i ka vlerësuar në bazë të V.K.B nr. 79, datë 02.12.2021 për detyrimet tatimore që ndjek kjo drejtori. Pra listat me subjektet në vlerën e mësipërme hartohen nga Drejtoria e Urbanistikës dhe Njësia e Prokurimit në bashkinë Vlorë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Duke iu referuar pretendimit tuaj theksojmë se , rekomandimi i dhënë i drejtohet Drejtorisë e Planifikimit të Territorit dhe Njesisë së Prokurimit dhe jo DAV-së. Janë këto drejtori që duhet të ndjekin hapat sikurse janë dhënë në rekomandim.

Nga subjekti i audituar, Bashkia Vlorë, mbi projekt raportin nr. 1026/28 prot; datë 28.09.2023, janë paraqitur kundërshti nga z. A. B., E. A., G. A., K. Sh., I. M., A. L., A. B., A. Sh., me shkresën nr. 11597 prot; datë 27.10.2023 në cilësinë e inspektorëve të terrenit, Bashkia Vlorë, të cilët kanë bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimi i Subjektit:

Sa me sipër ka paraqitur observacionet z. A. B.:

Gjatë vitit 2021 unë nuk kam qenë në urdhrat e punës për verifikim të kantiereve të ndërtimit. Gjatë vitit 2022 sipas urdhrat të punës për verifikim të kantiereve të ndërtimit janë bërë verifikimet në teren dhe janë verifikuar disa kantiere ndërtimi, pjesa tjetër nga lista prej 44 subjekte ose janë pjesë e rajone të tjera ose janë punime banesash private të cilat nuk evidentohen në terren. Këta subjekte janë faturuar dhe vlerësuar dhe nga specialistja e pranimi dhe kanë shlyer detyrimet. Problematikat e ngritura nga ana juaj na ndihmon në përmirësimin e punës tonë dhe në përmbushjen e objektivave për të arritur realizimin e planeve të DAV-se ju falënderojmë për sugjerimet tuaja.

-Sa me sipër ka paraqitur observacionet E. A. dhe G. A.:

Gjatë ushtrimit të detyrës tonë si inspektor terreni bazuar në urdhrat e brendshëm lidhur me planet e punës kemi përmbushur të gjitha detyrat që na janë ngarkuar. Lejet e ndërtimi sipas anekseve 8 dhe 9 ndahen në dy pjesë: Leje punimesh të evidentuara nga ana jone si me poshtë (mbajtur akte-kontrolli respektive Leje punimesh dhe zbatimesh për banesa dhe shtëpi private banimi për të cilat nuk mund të evidentohen në terren. Gjate vitit 2021 dhe 2022 janë evidentuar kantiere ndërtimi të cilat janë dorëzuar tek specialisti e pranimi për vlerësim tatimor të shoqëruara me foto dhe akte kontrolli. Këto kantiere ndërtimi janë faturuar dhe likuiduar detyrimet tatimore. Lidhur me aneksin nr. 8 dhe nr.9, lejet e ndërtimit për punime publike janë evidentuar të gjitha ndërsa pjesa tjetër përket lejeve të zbatimit për banesat private dhe apaktamente që nuk janë objekte dhe detyra jonë. Në rregulloren e Bashkisë Vlorë neni 108 pika c detyra e inspektorit të terrenit është të kryej kontrole të vazhdueshme dhe mban përgjegjësi për evidentimin e aktivitetit të subjekteve në teren ,ndryshimin e vendodhjes së tyre ,si dhe elementë të tjerë që ndikojnë në të ardhurat e Bashkisë nisur nga kjo detyra jonë është kryer me korrektësi dhe rigorozitet. Bashkëngjitur aktet e kontrollit të viteve 2021-2022-2023.

-Sa me sipër ka paraqitur observacionet K. Sh.:

Lejet e ndërtimi sipas anekseve 8 dhe 9 ndahen në dy pjesë: Leje punimesh të evidentuara nga ana jone si me poshtë (mbajtur akte kontrolli respektive Leje punimesh dhe zbatimesh për banesa dhe shtëpi private banimi për të cilat nuk mund të evidentohen në terren Gjate vitit 2021 janë evidentuar 6 kantiere ndërtimi të cilat janë dorëzuar tek specialisti e pranimi për vlerësim tatimor dhe janë paguar dhe detyrimet tatimore. Në vitin 2022 rajoni 3 është ndare në rajonin 3A dhe 3B,

ku janë evidentuar ne rajonin 3B 3 kantiere ndërtimi. Lista me leje ndërtimi sipas ankesave numër 8 dhe 9 përfshin dhe leje punimesh zbatimi per banesa dhe shtëpi private te cilat nuk jane objekt kontrolli nga ana jone.

- Sa me sipër ka paraqitur observacionet I. M., A. L., A. B., G. A., A. Sh.:

Gjatë ushtrimit te detyrës tonë si inspektor terreni bazuar ne urdhrat e brendshëm lidhur me planet e punës kemi përmbushur të gjitha detyrat që na janë ngarkuar. Gjatë vitit 2021 sipas urdhrat të punës për verifikim te kantierëve të ndërtimit janë bere verifikimet në teren dhe janë konstatuar 5 (pesë) kantier ndërtimi në rajonin nr.5. Lejet e ndërtimi sipas anekseve 8 dhe 9 ndahen ne dy pjese: e Leje punimesh të evidentuara nga ana jone si me poshtë (mbajtur akte kontrolli respektive)Leje punimesh dhe zbatimesh për banesa dhe shtëpi private banimi për të cilat nuk mund të evidentohen në terren. Mbështetur në "Aneksin nr.8 6, ku pasqyrohen subjektet të cilët janë pajisur me leje ndërtimi për vitin 2021 ju bëj me dije se nga lista prej 33 subjekte 2 subjekte janë evidentuar nga ana jonë në rajonin 5 dhe konkretisht: 1. "F." ShPK, lidhur me punimet e z. N. N.; 2. "F." ShPK, lidhur me punimet e z. T. K. Këta subjekte janë faturuar dhe vlerësuar dhe nga specialistja e pranimit dhe kanë shlyer detyrimet. Bashkëlidhur shkresat përkatëse dorëzuar në protokollin brendshëm te DAV-se. Gjatë vitit 2022 sipas urdhrat të punës për verifikim te kantierëve të ndërtimit janë bere verifikimet në teren dhe janë konstatuar 2 (dy) kantier ndërtimi në rajonin nr. 5 Mbështetur në Aneksin nr.9, ku pasqyrohen subjektet të cilët janë pajisur me leje ndërtimi për vitin 2022 ju bëj me dije se nga lista prej 44 subjekte 2 subjekte janë evidentuar nga ana jonë dhe në rajonin 5 dhe konkretisht: "E. K." ShPK, evidentuar ne 11.03.2022 me akt kontrolli nr. 605 'Punime te sheshi Bashkisë' evidentuar me akt kontrolli 1251 date 29.04.2022. Këta subjekte janë faturuar dhe vlerësuar dhe nga specialistja e pranimit dhe kanë shlyer detyrimet.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në përgjigje të kundërshtimeve tuaja theksojmë se Pretendimet si më lart nuk merren në konsideratë, pikë së pari lidhur me pretendimin se pjesa e pa evidentuar nga ana inspektorëve të terrenit i përkasin lejeve të zbatimit për banesat private dhe apartamente, është pretendim i pa mbështetur në dokumentacion ligjorë, pasi natyra e punimeve të kryera janë punime të cilët kanë kontraktuar subjekte Firmë ndërtimi e cila konsiderohet punë publike në territorin (terrenin) e Bashkisë Vlorë . Përsa i përket pretendimit që në rregulloren e brendshme nr. 101 prot;datë 11.09.2018 neni 108 pika c ku thuhet se, detyra e inspektorit në terren është të evidentojë aktivitetin e subjekteve në terren nuk qëndron, pasi po në pikën c te nenit 108 thuhet se inspektorët e terrenit kryejnë kontrole të vazhdueshme dhe mban përgjegjësi për evidentimin e aktivitetit të subjekteve në terren, ndryshimin e vendodhjes së tyre, si dhe elementë të tjerë që ndikojnë në të ardhurat e Bashkisë, lista prej 40 subjekte debitore ndikon direkt në të ardhurat e Bashkisë Vlorë. Nëse i referohemi rregullores neni "108 pika m", ku thuhet se inspektori i terrenit zbaton detyra të tjera të përkohshme të ngarkuara nga eprorët, siç janë urdhrat e kryetarit të cituara në akt konstatim dhe në Projekt Raport. Gjithashtu në "pikën I" të nenit 108 ku thuhet se inspektorët e terrenit mbi bazën e informacioneve te mësipërme te marre ne mënyrë te përditshme, ndërton regjistrin e përkohshëm si një mjet për të mbajtur në mbikëqyrje dinamiken e ndryshimeve në terren. Pretendimet nga ana juaj janë shoqëruar vetëm me disa akt- kontrole, të cilët nuk kanë lidhje me natyrën e gjetjes nga grupi i auditimit, pra për situatën e përmendur më lart nuk ekziston asnjë dokumentacion ligjor ku të provojë të kundërtën.

- Gjobat e Policisë Bashkiake

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e financës qendra ekonomike rezulton se, për vitin 2021 dhe vitin 2022 janë vendosur 203 gjoba nga ana e policisë Bashkiake në vlerën prej 604,000 lekë. Nga informacionet e grumbulluara dhe komunikimi verbal me drejtorinë e financës dhe qendrën ekonomike të Bashkisë Vlorë janë shprehur se nuk janë bërë rakordime ndërmjet policisë Bashkiake dhe drejtorisë së Financës së Bashkisë Vlorë, pra vlerat e përmendura më lart rezultojnë të pa kontabilizuar. Për vitin 2021 dhe vitin 2022 sipas korrespondencës së postës me drejtorinë e financës qendrën ekonomike rezulton të mos kenë paguar gjobat të vendosura nga policia Bashkiake 28 subjekte në vlerën 157,000 lekë. Nga dokumentacioni i vënë paraprakisht nga policia Bashkiake rezultojnë të dhëna vetëm për vitin 2022, të dhëna të cilat sipas rastit nuk përputhen me të dhënat e drejtorisë së financës, kjo situatë vjen si pasojë e mos rakordimeve ndërmjet strukturave të Bashkisë Vlorë dhe policisë Bashkiake. Gjithashtu sipas kërkesës për dokumentacion nga grupit të auditimit, janë në vënë në dispozicion blloqet e gjobave, të cilët tërhiqen pranë qendrës ekonomike, dhe administrohen nga policët Bashkiak. Nga verifikimi blloqeve rezulton se janë 50 subjekte të cilët nuk kanë paguar gjobat në vlerën 337,000 lekë vlerë e cila i shtohet vlerës së raportuar nga drejtoria e financës e cila në total është **490,700 lekë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë**. Një tjetër fakt vlen për tu theksuar është se nga ana e policisë Bashkiake kryesisht policët e policisë Bashkiake, në disa raste të konstatimeve për kundërvajtësit sipas shkeljeve apo marrjes së masës me gjobë, kundërvajtësi paguan gjobën në vend tek polici Bashkiak e më pas ky i fundit, kryen pagesën në qendrën ekonomike sipas rastit. Nuk ekziston dokumentacion, një rregullore, apo një urdhër që justifikon mënyrën e të vepruarit nga ana e punonjëseve të policisë Bashkiak. Mënyra se si është vepruar për rastet e përmendura më lart, nuk garanton një proces transparent për sa kohë i gjithë procesi është i pa monitoruar në terren, dhe pagesa në disa raste është kryer dorazi. Disa nga mandat arkëtimet të cilat provojnë se pagesat janë bërë nga punonjësit e policisë pranë qendrës ekonomike janë konkretisht mandat arkëtimi me nr.9 datë 22.11.2022 arkëtuar nga punonjësi i policisë B. L., mandat arkëtimi nr. 10 datë 22.11.2022, mandat arkëtimi i arkëtuar nga punonjësi A. A., mandat arkëtimi nr.11 datë 22.11.2022. Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake, nuk rezulton të jenë marrë asnjë masë për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake. Në kundërshtim Neni 13 në Ligjin nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar. Pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. Gjobat e policisë Bashkiake të pasqyruara burim i të dhënave sipas qendrës ekonomike në *Aneksin nr.5. Bashkëlidhur akt- konstatimit nr.34.*

Tabela nr.16: Debitorët nxjerrë nga blloqet e policisë Bashkiake

Nr.	Nr. Serial	Emër Mbiemër	Data	Lloji Kundërvajtjes	Debitor
1	1830	P. M.	11/08/2022	Mbetje Urbane Jasht Kontenjereve	20000
2	1832	E. Gj.	20/10/2022	Zenie Hapsire Publike	5000
3	1833	N. P.	20/10/2022	Zenie Haps Publike Trotuar	5000
4	1834	K. F.	26/05/2022	Hedhje Mbetjtjesh	5000
5	1835	N.	31/05/2022	Hedhje Jasht Kontenierit Mbetje	5000
6	1851	E. O.	05/03/2022	Zënie Hap.Publike	5000
7	34482	Xh. Sh.	14/10/2022	Ndotje Hap. Publike	20000
8	34295	B. M.	06/12/2021	Qëndrim Me Deren Hapur	5000
9	34296	Dh. J.	06/12/2021	Qëndrim Me Deren Hapur	5000

Nr.	Nr. Serial	Emër Mbiemër	Data	Lloji Kundërvajtjes	Debitor
10	34297	R. B.	06/12/2021	Qëndrim Me Deren Hapur	5000
11	34298	N. R.	06/12/2021	Qëndrim Me Deren Hapur	5000
12	34300	A. C.	09/03/2022	Parkim I Gabuar	3000
13	1998	K. L.	06/12/2021	Qëndrim Në Vende Të Pamerituara	1000
14	1999	A. S.	06/12/2021	Qëndrim Me Derën Hapur	5000
15	2000	K. A.	06/12/2021	Qëndrim Me Derën Hapur	5000
16	2001	A. Xh.	06/12/2021	Qëndrim Me Derën Hapur	5000
17	2002	V. K.	06/12/2021	Qëndrim Me Derën Hapur	5000
18	2003	T. K.	06/12/2021	Qëndrim Me Derën Hapur	5000
19	2004	R. B.	20/12/2021	Parkim I Gabuar	1000
20	2005	M. L.	30/12/2022	Ndotje Hap. Publike	10000
21	2006	N. A.	06/01/2022	Parkim I Gabuar	1000
22	2007	V. H.	06/01/2022	Parkim I Gabuar	1000
23	2008	E. B.	18/01/2022	Parkim I Gabuar	1000
24	2009	F. L.	05/02/2022	Parkim I Gabuar	1000
25	2010	J. P.	05/04/2022	Parkim I Gabuar	1000
26	2011	D. K.	05/08/2022	Bllokim Rruge	1000
27	2012	F. M.	22/08/2022	Qarkullim Korsia Bicikletave	1000
28	2013	A. K.	20/10/2022	Parkim I Gabuar	1000
29	2014	E. Ll.	21/10/2022	Zënie Hap.Publike	1000
30	2015	E. L.	11/11/2022	Kullot Bageti Ne Piken E Mbetjeve Urbane	10000
31	1676	L. D.	13/08/2022	Mos Hedhje Mbeturinash Ne Vende T Miratuar	5000
32	1677	H. P.	13/08/2022	Mos Hedhje Mbeturinash Ne Vende T Miratuar	20000
33	1678	B. J.	13/08/2022	Mos Hedhje Mbeturinash Ne Vende T Miratuar	20000
34	1679	K. K.	19/09/2022	Zaptuar Hapsirat Publike	5000
35	2080	P. J.	24/11/2022	Parkim I Gabuar	1000
36	607	V. M.	15/11/2022	Hedhje Mbetjesh Jashte Zonave T Miratuara	20000
37	2681	A. L.	11.03.2022	Shfrytzim Hapsirash Para Bisnesit	1000
38	2682	Sh. H.	08/06/2022	Sfrytzim Hapsirash Paar Bisnesit	5000
39	34226	H. L.	01.03.2022	Nuk paraqet dok. për zënie të hapësirës publike	10000
40	34227	I. V.	04.03.2022	Ka Nxjerr Pemë Në Rruge Pa Leje	10000
41	11881	E. M.	09.01.2022	Dëmtim I Infrastrukturës	10000
42	1882	E. ShPK	07/06/2021	Lidhje E Pa Miratuar Në Rrjetin Ujësjes	10000
43	1883	I. B.	23/12/2021	Parkim I Gabuar	1000
44	1885	O. Sh.	20/02/2022	Zënie E Hapësirës Së Përbashkët	15000
45	1887	N. S.	26/02/2022	Zënie E Hapësirës Publike	10000
46	1888	L.Q.	26/02/2022	Zënie E Hapësirës Publike	10000
47	1889	M. Xh.	26/02/2022	Zënie E Hapësirës Publike	10000
48	1890	Xh. S.	15/08/2022	Zënie E Hapësirës Publike	10000
49	1891	A. ShPK	20/08/2022	Zënie E Hapësirës Publike	10000
50	1892	I. G.	20/08/2022	Zënie E Hapësirës Publike	10000
Totali					337,000

Burimi: Policia Bashkiake blloqet e gjobave përpunuar nga grupi i auditimit.

Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi, **znj. K. Q.**, ish - specialiste për marrëdhëniet me thesarin për periudhën 2021; **znj. E. K.**, specialiste për marrëdhëniet me thesarin për vitin 2022, **z. M. M.**, Kryeinspektor i Policisë Bashkiake.

Titulli gjetjes: Mbi Gjobat e policisë bashkiake

Situata: Nga verifikimi blloqeve rezulton se janë 50 subjekte të cilët nuk kanë paguar gjobat në vlerën 337,000 lekë vlerë e cila i shtohet vlerës së raportuar nga drejtoria e financës e cila në total është **490,700 lekë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë**. Një tjetër fakt vlen për tu theksuar është se nga ana e policisë Bashkiake kryesisht policët e policisë Bashkiake, në disa raste të konstatimeve për kundërvajtësit sipas shkeljeve apo marrjes së masës me gjobë, kundërvajtësi paguan gjobën në vend tek polici Bashkiak e më pas ky i fundit, kryen pagesën në qendrën ekonomike sipas rastit. Nuk ekziston dokumentacion, një rregullore, apo një urdhër që justifikon mënyrën e të vepruarit nga ana e punonjëseve të policisë Bashkiak. Mënyra se si është vepruar për rastet e përmendura më lart, nuk garanton një proces transparent për sa kohë i gjithë procesi është i pa monitoruar në terren, dhe pagesa në disa raste është kryer dorazi. Disa nga mandat arkëtimet të cilat provojnë se pagesat janë bërë nga punonjësit e policisë pranë qendrës ekonomike janë konkretisht mandat arkëtimi me nr.9 datë 22.11.2022 arkëtuar nga punonjësi i policisë B. L., mandat arkëtimi nr. 10 datë 22.11.2022, mandat arkëtimi i arkëtuar nga punonjësi A. A., mandat arkëtimi nr.11 datë 22.11.2022. Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake, nuk rezulton të jenë marrë asnjë masë për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake.

Kriteri: Në kundërshtim Neni 13 në Ligjin nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar. Pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. Gjobat e policisë Bashkiake të pasqyruara burim i të dhënave sipas qendrës ekonomike në *Aneksin nr.5. bashkëlidhur Raportit Përfundimtar*.

Ndikimi/Efekti: Ulje e nivelit të të ardhurave në vlerën 490,700 lekë.

Shkaku: Mos njohje kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e DAV Bashkia Vlorë, të kryejnë rakordime me policinë Bashkiake për kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës së gjobave të Policisë Bashkiake në vlerën **490,700 lekë**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët.

Të mos kryen pagesa dorazi ndërmjet kundërvajtësit dhe punonjësve të policisë Bashkiake, por të bashkëpunohet me Filialin e Postës, me akt- marrëveshje si agjent tatimor për vjeljen e të ardhurave nga gjobat e policisë Bashkiake.

Rekomandimi: Drejtoria e Auditit Bashkia Vlorë, të marrë mision auditimi mbi veprimtarinë e Policisë Bashkiake për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2023, mbi inventarizimin e blloqeve të gjobave të marrë dhe dorëzuar në Drejtorinë e Financës, të krahasimit të gjobave të kontabilizuara, vlerës së arkëtuara dhe aplikuara në blloqet e gjobave për këtë periudhë auditimi.

Nga subjekti i audituar, Bashkia Vlorë, mbi akt-konstatimin nr. 34, datë 14.07.2023, janë paraqitur kundërshti nga z. M. M., me e-mail-in e datës 08.08.2023, në cilësinë e Kryeinspektorit të Policisë Bashkiake, Bashkia Vlorë, i cili ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimi i Subjektit:

Së pari, e konsideroj ndihmë gjithçka shkruhet për Policinë Bashkiake. Së dyti, rakordimi për gjobat e vendosura deri në tetor 2022, është bërë rregullisht me specialisten për marrëdhënie me thesarin znj. E. K. Së treti vjelja e gjobave në dorë nga Policët Bashkiakë ka qenë një praktikë që në krijimin e Policisë Bashkiake kjo lidhet me vështirësinë e vjeljes së gjobave për mjetet lëvizëse me motor, pasi nuk jemi në sistemin e vjeljes së gjobave, si është Policia Bashkiake e Tiranës. Edhe Qarkullimi Rrugor i Policisë së Shtetit, për mjete me targa të huaja, vjeljen e gjobës e bënë Polici Rrugorë në dorë pikërisht për pamundësinë e vjeljes në mënyra të tjera. Megjithatë për të evidentuar këtë problematikë u bë aktmarrëveshja me Postën Shqiptare për të lehtësuar qytetarët për pagesën e gjobës, pasi pagesa në Qendrën Ekonomike haste shumë vështirësi për qytetarët, kjo aktmarrëveshje u ndërpre në tetor të 2022 dhe vështirësitë e vjeljes së gjobave u shtuan si më parë. Së katërti në funksion të vjeljes së gjobave u inicuar nga ana jonë në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.80 datë.02.12.2021, neni 18, ku parashikohet që vjelja e gjobave për individë të bëhet nga Ujësjetës Kanalizime sha Vlorë dhe për subjektet tregtare nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore të Bashkisë. Kemi përcjellë rregullisht në këto Drejtori, gjobat e vendosura, brenda afateve të përcaktuara, kemi kërkuar jo një herë prej tyre informacion për vjeljen e gjobave, por duhet se me gjithë qëllimin e mirë të këtij vendimi të Këshillit Bashkiak vjelja e gjobave nuk është realizuar në pritshmëritë që kishim. Mbi 90% të debitorëve i përkasin mos vjeljes së gjobave nga këto dy Drejtori.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në përgjigje të pretendimit tuaj theksojmë se, duke iu referuar situatës më lart në të cilën ju shpreheni, observacioni nuk merret në konsideratë përsa kohë të gjitha kundërshtitë nga ana juaj nuk janë të mbështetura në dokumente justifikues.

Nga subjekti i audituar, Bashkia Vlorë, mbi projekt raportin nr. 1026/28 prot; datë 28.09.2023, janë paraqitur kundërshti nga znj A. Sh. me shkresën nr. 11597 prot; datë 27.10.2023, në cilësinë e Drejtorit të Taksave dhe tarifave, Bashkia Vlorë, e cila ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me këtë gjetje, theksoj se rekomandimi i lënë nga ana juaj, duhet të ndiqet nga struktura e Policisë Bashkiake. Drejtoria e të Ardhurave në cdo rast ndjek arkëtimin e detyrimeve të policisë bashkiake, kur ato përcillen zyrtarisht në këtë drejtori. Rakordimi i të ardhurave që arkëtohen për Bashkinë Vlorë ndiqen nga Drejtoria e Financës , Buxhetit dhe Kontabilitetit, pasi në strukturën e kësaj drejtori ka një specialist të ardhurash për rakordimin me Degën e Thesarit Vlorë dhe drejtoritë apo njësitë vartëse. Vlera prej 490.700 lekë do të ndiqet nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore vetëm mbasi të dërgohen nga Policia Bashkiake zyrtarisht, pasi janë detyrime të cilat i ndjek kjo strukturë në bazë të gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara prej tyre.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në përgjigje të pretendimit tuaj theksojmë se rekomandimi lidhur me rakordimet ndërmjet dy drejtorive, bëhet fjalë pasi nga ana e Policisë Bashkiake në vijim të dërgohen listat e përditësuara të debitorëve nga gjobat e Policisë Bashkiake.

Tarifa për leje Autorizime dhe autorizime të lëshuara nga administrata e Bashkisë dhe njësitë Administrative .

Duke iu referuara VKB nr. 79 prot; datë 02,12,2021 për një ndryshimin në VKB nr.88 datë 24,12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”, vërehet

se në seksionin e tarifave vendore pika 6, nënpika 10, specifikohet se niveli i tarifës për pajisjen me autorizim të subjekteve me veprimtari lavash është 10,000 lekë. Për dhënien e këtyre autorizimeve ngarkohet Drejtoria e infrastrukturës dhe e zbatimit të projekteve. Nga komunikimi verbal me specialistët e Drejtorisë së infrastrukturës dhe e zbatimit të projekteve, të cilët janë shprehur lidhur me autorizimet për subjektet me veprimtari lavazh, se nuk është pajisur asnjë subjekt me autorizimet përkatëse. Nga të dhënat vëna në dispozicion nga drejtoria e të ardhurave specialisti i IT rezulton se për vitin 2021 ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Bashkisë Vlorë 15 (pesëmbëdhjetë) subjekte me statusin aktiv me veprimtari lavazh nga të cilët nuk janë pajisur me autorizimin dhe nuk kanë paguar tarifën prej 10,000 lekësh, pra në një vlerë debitorë prej 150,000 lekësh. Për vitin 2022 ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Bashkisë Vlorë 12 subjekte me veprimtari lavazh të cilat nuk janë pajisur me autorizimin nga ana e Drejtorisë e infrastrukturës dhe e zbatimit të projekteve, dhe pa paguar tarifën prej 10,000 lekësh, rezulton një vlerë debitorë prej 120,000 lekë. Nga të dhënat e vëna në dispozicion pranë grupit të auditimit rezulton se për vitin 2021 dhe vitin 2022 nga mos pajisja me autorizim dhe mos pagesa e tarifës nga subjektet që ushtrojnë veprimtarinë lavazh kemi të bëjmë me një vlerë debitorë prej **270,000 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë**. Situata e sipër përmendur vjen si pasojë e mos zbatimit të VKB nr. 79 prot; datë 02,12,2021 për një ndryshim në VKB nr.88 Datë 24.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”, pika 6, nënpika 10. Subjektet debitorë të pasqyruara në *Anekset 6 dhe 7. Bashkëlidhur në akt- konstatimin nr.34*.

Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi, **z. Z. S.**, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Infrastrukturës dhe e Projekteve.

Titulli gjetjes: Mbi Tarifa për leje Autorizime dhe autorizime të lëshuara nga administrata e bashkisë dhe njësitë Administrative.

Situata: Nga të dhënat vëna në dispozicion nga drejtoria e të ardhurave specialisti i IT rezulton se për vitin 2021 ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Bashkisë Vlorë 15 subjekte me statusin aktiv me veprimtari lavazh nga të cilët nuk janë pajisur me autorizimin dhe nuk kanë paguar tarifën prej 10,000 lekësh, pra në një vlerë debitorë prej 150,000 lekësh. Për vitin 2022 ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Bashkisë Vlorë 12 subjekte me veprimtari lavazh të cilat nuk janë pajisur me autorizimin nga ana e Drejtorisë e infrastrukturës dhe e zbatimit të projekteve, dhe pa paguar tarifën prej 10,000 lekësh, rezulton një vlerë debitorë prej 120,000 lekë. Nga të dhënat e vëna në dispozicion pranë grupit të auditimit rezulton se për vitin 2021 dhe vitin 2022 nga mos pajisja me autorizim dhe mos pagesa e tarifës nga subjektet që ushtrojnë veprimtarinë lavazh kemi të bëjmë me një vlerë debitorë prej **270,000 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë**. Situata e sipër përmendur vjen si pasojë e mos zbatimit të VKB nr. 79 prot; datë 02,12,2021 për një ndryshim në VKB nr.88 Datë 24.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”, pika 6, nënpika 10. Subjektet debitorë të pasqyruara në *Anekset 6 dhe 7. Bashkëlidhur në akt- konstatimin nr.34*.

Kriteri: VKB nr. 79 prot; datë 02,12,2021 për një ndryshim në VKB nr.88 Datë 24.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”, pika 6, nënpika 10.

Ndikimi/Efekti: Ulje e nivelit të të ardhurave në vlerën 490,700 lekë.

Shkaku: Mos njohje kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe e Zbatimit të Projekteve në bashkëpunim me IMTV Bashkia Vlorë, të marrë masa për të pajisur subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre si “Lavazh”, pranë territorit të Bashkisë Vlorë me leje përkatëse, si dhe në bashkëpunim me strukturat e tjera të Bashkisë Vlorë të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **270,000 lekë**.

Nga subjekti i audituar, Bashkia Vlorë, mbi projekt raportin nr. 1026/28 prot; datë 28.09.2023, janë paraqitur kundërshti nga znj A. Sh. me shkresën nr. 11597 prot; datë 27.10.2023, në cilësinë e Drejtorit të Taksave dhe Tarifave, Bashkia Vlorë, e cila ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimi i Subjektit:

Në lidhje me këtë gjetje, theksoj se rekomandimi i lënë nga ana juaj nuk gjen zbatim nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore pasi sikurse theksohet edhe nga ana juaj në materialin e lënë nga ju, referuar V.K.B-së nr. 79, datë 2.12.2023 i ndryshuar , kjo tarifë ndiqet nga Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve. Këto detyrime të cilat ju i keni nxjerrë gjatë auditimit të kryer nga ana juaj, nuk janë detyrime të kontabilizuara në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe në këto kushte nuk ka se si DAV të nxjerrë njoftim vlerësime për këta subjekte të cilat janë me detyrime në vlerën 270.000 lekë të lindura nga drejtori të tjera. Drejtoria e të Ardhurave Vendore këto subjekte i ka vlerësuar me detyrime të cilat ndjek kjo drejtori bazuar në vendimet e Këshillit të Bashkisë, cituar më lart. Gjetja juaj është e drejtë për faktin se të ardhurat duhet të mblidhen nga një strukturë por sot në bashkinë Vlorë ka disa drejtori të cilat arkëtojnë të ardhura për buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në përgjigje të kundërshtimit tuaj theksojmë se, përsa i përket Pretendimit tuaj lidhur me rekomandimin adresuar DAV-së merret në konsideratë dhe do të reflektohet në material.

Mbi Tarifa e depozitimit të mbetjeve urbane e të ngurta nga të tretët në vendgrumbullimin e mbetjeve.

Duke iu referuar VKB nr.79 prot; datë 02.12.2021 për një ndryshim në VKB nr. 88 prot; Datë 24.12.2021 për miratimin e paketës fiskale për taksat dhe tarifat vendore, vërehet se në faqen 19, pika 6, nën-pika 5, është përcaktuar niveli tarifës për depozitimin e mbetjeve 100 lekë/m³, sipas nën-pikës 5 përcaktuar në VKB nr.79 prot; datë 02.12.2021, për dhënien e autorizimit për vend depozitimin e mbetjeve inerte ngarkohet Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit lidhur me tarifën e depozitimit të mbetjeve urbane e të ngurta nga të tretët në vendgrumbullimin e mbetjeve rezultoi se : Kanë njoftuar për fillimin e punimeve 33 subjekte të cilët janë të pajisur me leje ndërtimi ku 7 nga subjektet i përkasin zërit transport për depozitimit të mbetjeve sipas preventivit. Nga llogaritja e grupit të auditimit lidhur me tarifën sipas VKB-së nr.79 prot; datë 02.12.2021 për një ndryshim në VKB nr. 88 prot; datë. 24.12.2020 rezulton se janë 7 subjekte për vitin 2021 të cilët nuk kanë paguar tarifën në vlerën prej **1,755,800 lekë**. Përsa i përket viti 2022 kanë njoftuar për fillimin e punimeve 44 subjekte të cilët janë të pajisur me leje ndërtimi ku 12 nga subjektet i përkasin zërit transport për depozitimit të mbetjeve sipas preventivit

të cilët nuk kanë paguar tarifën në vlerën prej **6,771,270 lekë**. Nga auditimi arrihet në konkluzion se për vitin 2021 dhe vitin 2022 janë 77 subjekte të cilët kanë njoftuar për fillimin e punimeve, ku 19 prej tyre janë debitorë për Zërin transport sipas preventivit m³. Sipas komunikimit verbal me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të cilat janë shprehur se subjektet nuk janë njoftuar për pagesën e tarifës dhe nuk kanë paguar tarifën sikurse përcaktohet në VKB nr.79 prot; datë 02.12.2021, duke sjellë kështu **të ardhura të munguara në vlerën 8,527,070 lekë**. Nga të dhënat e vëna në dispozicion rezulton se nga ana Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit rezulton se nuk janë marrë masa për zbatimin e VKB-së nr.79 prot; datë 02.12.2021, konkretisht veprime në kundërshtim me VKB nr.79 prot; datë 02.12.2021 me faqen 19 pika 6 nënpika 5 është përcaktuar niveli tarifës për depozitimin e mbetjeve 100 lekë/m³.

Tabela nr.17: Lista e subjekteve debitorë për tarifën e depozitimit për vitin 2021

Nr.	Emërtimi I Zhvilluesit	Leje Ndërtimi		Subjekti Ndërtues	Sip. Trualli M ²	Sip. Ndërtim M ²	Zëri Transport Sipas Preventivit 100 lekë/ M ³	Debitorë
		Nr.	Date					
1	A.	529	14/07/2021	A. ShPK	1028	4684,3	3700	370,000
2	S. A.	583	13/10/2020	S. ShPK	472,5	775,42	1120	112,000
3	A.	578	09/10/2020	A.R.E	566	2474,2	3500	350,000
4	B. M.	467	06/08/2020	M. K.	8660	1067,5	779	77,900
5	A. R.	23	28/07/2020	S. P. ShPK	351,1	1513	1224	122,400
6	M. C. S.	436	11/06/2021	A. C.	10570	1321,3	440	44,000
7	E. B. A.	535/7	13/07/2022	H. G.	6094	29827,83	6795	679,500
Totali								1,755,800

Burimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të territorit përpunuar nga grupi i auditimit.

Tabela nr.18: Lista e subjekteve debitorë për tarifën e depozitimit për vitin 2022

Nr.	Emërtimi I Zhvilluesit	Leje Ndërtimi		Subjekti Ndërtues	Sip. Trualli M ²	Sip. Ndërtim M ²	Zëri Transport Sipas Preventivit 100lekë/ M ³	Debitorë
		Nr.	Date					
1	O. A.	607	11/08/2021	T:M:Z:B	8086	1871	7695,7	769,570
2	H.-P.	885	31/12/2021	H.-P.	3500	4884	13500	1,350,000
3	TM.Z.B	83	04/02/2022	TM.Z.B	3396	8450	3782	378,200
4	A. Sh.	579	02/09/2022	L. 2020	477,8	923,4	1000	100,000
5	H.-P.	22	10/06/2021	H.-P.	10234,72	9846	Leje E Miratuar Ne KKT 11500	1,150,000
6	T. K.	762	07/11/2022	T. K.	910	788,3	575	57,500
7	I. AG C.	826	17/11/2022	I. AG C.	5000	8840	5000	500,000
8	J. H.	275	20/04/2022	A. K.	2385	302,1	315	31,500
9	M.	776	09/11/2022	M.	7026,97	13960	11500	1,150,000
10	S. F. G.	854	17/12/2021	A. ShPK	17390	1896,8	1400	140,000
11	R. G. K.	29	16/03/2022	R. G.	3800	6867,6	Leje E Miratuar Ne KKT 2445	244,500
12	R. G. K.	30	16/03/2022	R. G.	9815	19539,5	Leje E Miratuar Ne KKT 9000	900,000
Totali								6,771,270

Burimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të territorit përpunuar nga grupi i auditimit.

Për veprime dhe mosveprime ngarkohen me përgjegjësi, **z. J. Ç.**, me detyrë ish - Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit; **z. Z. S.**, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

Titulli gjetjes: Mbi tarifën e depozitimit të mbetjeve urbane e të ngurta nga të tretët në vendgrumbullimin e mbetjeve.

Situata: Nga auditimi arrihet në konkluzion se për vitin 2021 dhe vitin 2022 janë **77** subjekte të cilët kanë njoftuar për fillimin e punimeve, ku **19** prej tyre janë debitorë për Zërin transport sipas preventivit m³. Sipas komunikimit verbal me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të cilat janë shprehur se subjektet nuk janë njoftuar për pagesën e tarifës dhe nuk kanë paguar tarifën sikurse përcaktohet në VKB nr.79 prot; datë 02.12.2021, duke sjellë kështu **të ardhura të munguara në vlerën 8,527,070 lekë**. Nga të dhënat e vëna në dispozicion rezulton se nga ana Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit rezulton se nuk janë marrë masa për zbatimin e VKB-së nr.79 prot; datë 02.12.2021, konkretisht veprime në kundërshtim me VKB nr.79 prot; datë 02.12.2021 me faqen 19 pika 6 nën-pika 5 është përcaktuar niveli tarifës për depozitimin e mbetjeve 100 lekë/m³.

Kriteri: VKB-së nr.79 prot; datë 02.12.2021 për një ndryshim në VKB nr. 88 prot; datë 24.12.2020 .

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Vlorë në vlerën **8,527,070 lekë**.

Shkaku: Mos njohje kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me IMTV dhe Drejtorinë e të Ardhurave, Bashkia Vlorë, të marrin masa për evidentimin dhe nxjerrjen e njoftim vlerësimeve në shumën **8,527,070 lekë**, të 19 subjekteve debitorë për tarifën e mbetjeve urbane, si dhe të ndiqen të gjitha rrugët administrative për arkëtimin. Kryetari i Bashkisë të ngrejë urdhër pune për monitorimin në terren lidhur me këtë veprimtari.

Nga subjekti i audituar, Bashkia Vlorë, mbi projekt raportin nr. 1026/28 prot; datë 28.09.2023, janë paraqitur kundërshti nga znj A. Sh. me shkresën nr. 11597 prot; datë 27.10.2023 në cilësinë e Drejtorit të Taksave dhe Tarifave, Bashkia Vlorë, e cila ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimi i Subjektit:

Në lidhje me këtë gjetje, theksoj se rekomandimi i lënë nga ana juaj nuk gjen zbatim nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore pasi sikurse theksohet edhe nga ana juaj në materialin e lënë nga ju, referuar V.K.B-së nr. 79, datë 2.12.2023 i ndryshuar, kjo tarifë ndiqet nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të territorit, sot Drejtoria e Urbanistikës. Këto detyrime të cilat ju i keni nxjerrë gjatë auditimit të kryer nga ana juaj, nuk janë detyrime të kontabilizuara në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe në këto kushte nuk ka se si DAV të nxjerrë njoftim vlerësime për këta subjekte të cilat janë me detyrime në vlerën 8.527.070 lekë të lindura nga drejtori të tjera. Gjetja juaj është e drejtë për faktin se të ardhurat duhet të mbliidhen nga një strukturë por sot në bashkinë Vlorë ka disa drejtori të cilat arkëtojnë të ardhura për buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në përgjigje të kundërshtimit tuaj theksojmë se, përsa i përket Pretendimit tuaj lidhur me rekomandimin adresuar DAV-së merret në konsideratë dhe do të reflektohet në material.

Mbi të ardhurat e krijuara nga kontrata për dhënien me qira të objektit “Parku i lojërave të qytetit Vlorë”.

Kontrata fillestare është lidhur midis palëve, Ministria e Ekonomisë, përfaqësuar nga **z. G. Gj.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike në Ministri, bazuar në autorizimin e Ministrit nr. 1568/1 datë 28.5.2002, cilësuar si “Qiradhënës” dhe **z. B. B.**, administrator i shoqërisë “I.” ShPK, të cilësuar si “Qiramarrës”, në prani të noteres zyrës së noterisë Tiranë, znj. E. K., me nr. 2946 Rep dhe nr. 154 Kol, datë 4 Qershor 2002. Sipas kësaj kontrate (neni 1), sipërfaqja e dhënë me qira përcaktohet 16112 m², nga e cila 28 m² nën objekt, me kohëzgjatje (neni 3), për një periudhë 10 vjet, duke hyrë në fuqi nga data e nënshkrimit të saj. Detyrimi mujor (neni 6, pika 1) është në vlerën prej 107,413 lekë/muaj dhe për objektin 28 USD në muaj.

Më datë 3.7.2013 është lidhur Aneks Kontratë, me palët kontraktuese M. përfaqësuar nga z. G. M., Drejtor i Përgjithshëm i Ofrimit të Shërbimeve në Ministri, sipas autorizimit të Ministrit nr. 5033/1 datë 1.7.2013, në cilësinë e Qiradhënësit dhe Shoqëria “I. 1” ShPK, me seli në Vlorë, përfaqësuar nga znj. N. L., në cilësinë e Qiramarrësit, në të cilën thuhet se:

- Me kërkesë të Bashkisë Vlorë nr. 1381/1 të datës 21.05.2013 “Për rilogaritjen e sipërfaqes së objektit të kontratës së qirasë nr. 2496 rep., nr. 154 kol, datë 04.06.2002 dhe mbështetur në VKM nr.529 ,datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” Në kontratën e qirasë nr.2496 rep., nr. 154 kol, datë 04.06.2002 dhe anekset e saj, të lidhur me Shoqërinë “I. 1” ShPK, Vlorë, për objektin “Parku i Lojërave të Qytetit Vlorë” në administrim të Bashkisë Vlorë, të bëhen ndryshimet e mëposhtme: Neni 1 “Objekti i kontratës” të ndryshohet si vijon: “Qiradhënësi jep me qira pasurinë “Parku i Lojërave i Qytetit Vlorë” me sipërfaqe totale 11.890 m², prej nga 28 m² janë sipërfaqe ndërtese dhe 11.862 m² janë sipërfaqe funksionale, sipas genplanit të bashkëlidhur kësaj kontrate” Neni 3 “Kohëzgjatja” riformulohet si vijon: ”Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë 20 (njëzet) vjet duke filluar nga data e nënshkrimit të saj”, duke zgjatur afatin e vlefshmërisë se kontratës nga 10 vjet në 20 vjet. Neni 6 “Pagesa e qirasë” riformulohet si vijon: 6.1 “Qiramarrësi” detyrohet ti paguaj “Qiradhënësit” detyrimin mujor në vlerën 360,060 lekë/muaj. Vlera e detyrimit mujor të qirasë do të ndryshojë kur Qiramarrësi plotëson kushtet për treguesit e investimit dhe punësimin të të realizuar në nivelet që parashikohen në Kapitullin IV të VKM nr.529 datë 08.06.2011. Pra është ulur sipërfaqja në përdorim nga 16112 m² në 11890 m², si pasojë e zbritjes së sipërfaqeve në matje, sipërfaqeve të rrugëve dhe lulishteve brenda objektit, duke e parcelizuar padrejtësisht atë. Vlera e qirasë është përllogaritur nga 11.890 m² sipërfaqe totale në përdorim 11.862 m² janë sipërfaqe trualli funksional x 30 lekë/m²= 355,360 lekë/muaj dhe 28 m² sipërfaqe ndërtese x 150 lekë/m² = 4,200 lekë/muaj, në total tarifa e qirasë mujore duhet të ishte 360,060 lekë/muaj. Me VKB nr. 60, datë 27.10.2016, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 3002, datë 10.11.2016, si i ligjshëm është miratuar ndryshimi i sipërfaqes funksionale të Parkut të Lojërave të Qytetit të Vlorës, të kontratës nr. 2964 rep / 450 kol, datë 04.06.2002. Ky ndryshim është bërë referuar matjeve të kryera në terren nga grupi i punës, nga ku ka rezultuar se subjekti “I. 1” ShPK në fakt ka në përdorim sipërfaqen prej **14960 m²**, kjo e evidentuar në procesverbalin e datës 27.01.2016 bashkë me plan vendosje, të nënshkruar edhe nga përfaqësuesi i subjektit znj. N. L., (sip. për të cilën ka rënë dakord). Vendimi i Këshillit Bashkiak, nuk është shprehur për periudhën e shtrirjes së efekteve, siç thuhet në projekt-vendim nga data 03.07.2013. Nisur nga kontrata fillestare bazë e datës 4 Qershor 2002, rezulton se, në nenin 6 “Pagesa e qirasë” në pikën 6.2 përcaktohet: ”Ndryshimet në legjislacion të vlerës truallit do të pasqyrohen në këtë kontratë në vlerën e qirasë mujore për sipërfaqe funksionale”. Gjithashtu sipas pikës 6.5 të Aneks

Kontratës, datë 1 Korrik 2005 me përmbajtje: “Pas datës 4.6.2012 (datë e përfundimit të kontratës fillestare me afat 10 vjet) tarifa e qirasë do të aplikohet sipas akteve ligjore në fuqi” Pra vlera e kontratës duhet të ndryshonte gjatë gjithë periudhës, për çdo rast të ndryshimit legjislaionit. Kështu sipas VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016, Kapitullit III, “Tarifat dhe vlera dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë”, pikat 1/b⁶, vlera e qirasë për truallin funksional është 40 lekë/m² e cila rezulton nga shumëzimi i vlerës dysheme e tarifës së qirasë mujore 200 lekë/m² të ndërtesës për qytetin e Vlorës x 20/100 e kësaj vlere. Pra, tarifa e qirasë mujore për m² truall funksional ka ndryshuar dhe është 40 lekë/m² dhe jo më 30 lekë/m². Gjithashtu tarifa e qirasë mujore për m² ndërtesë në qytetin e Vlorës ka ndryshuar dhe është 200 lekë/m² dhe jo më 150 lekë/m². Referuar VKB nr. 60, datë 27.10.2016, nga Bashkia Vlorë në bashkëpunim me MZHETTS për periudhën nën auditim rezulton se nuk është amenduar kontrata e datës 04.06.2002, për të bërë të mundur ndryshimin e kushteve të kontratës për pagesën e qirasë sipas sipërfaqes së re të konstatuar nga matjet faktike të kryera në terren në dakortësi me qiramarrësin, si dhe të ndryshimeve të tarifës së qirasë për m² truall funksional nga ndryshimi i legjislaionit, duke përcaktuar edhe periudhën e fillimit të detyrimit. Me ndryshimin e sipërfaqes faktike 14960 m², që subjekti ka në përdorim (me qira), çmimi përlllogaritet në vlerën 453,027 lekë/muaj (sipas vlerave të përlllogaritur nga MZHETT), tarifë të cilën subjekti duhej të paguaj pas matjeve faktike të kryera në terren mbi sipërfaqen e shfrytëzueshme (Tetor 2016). Kështu nga 14.960 m² sipërfaqe totale në përdorim 14.932 m² janë sipërfaqe trualli funksional x 40 lekë/m²= 597,280 lekë/muaj dhe 28 m² sipërfaqe ndërtesë x 200lekë/m² = 5,600 lekë/muaj, në total tarifa e qirasë mujore duhet të ishte 602,880 lekë/muaj. Përlllogaritja referuar pagesave dhe detyrimit real më hollësisht paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.1

Muajt	Viti 2021		Viti 2022		Shuma		Diferenca për t'u arkëtuar
	Detyrimi	Paguar	Detyrimi	Paguar	Detyrimi	Paguar	
JANAR	602,880	360,060	602,880	360,060	1,205,760	720,120	485,640
SHKURT	602,880	360,060	602,880	360,060	1,205,760	720,120	485,640
MARS	602,880	360,060	602,880	360,060	1,205,760	720,120	485,460
PRILL	602,880	360,060	602,880	360,060	1,205,760	720,120	485,460
MAJ	602,880	360,060	602,880	360,060	1,205,760	720,120	485,460
QERSHOR	602,880	360,060	602,880	360,060	1,205,760	720,120	485,460
KORRIK	602,880	360,060	602,880	360,060	1,205,760	720,120	485,460
GUSHT	602,880	360,060	602,880	360,060	1,205,760	720,120	485,460
SHTATOR	602,880	360,060	602,880	360,060	1,205,760	720,120	485,460
TETOR	602,880	360,060	602,880	360,060	1,205,760	720,120	485,460
NENTOR	602,880	360,060	602,880	360,060	1,205,760	720,120	485,460
DHJETOR	602,880	360,060	602,880	360,060	1,205,760	720,120	485,460
Shuma	7,234,560	4,320,720	7,234,560	4,320,720	14,469,120	8,641,440	5,827,680

Burimi: Drejtoria e financës përpunuar nga grupi i auditimit.

Në hartimin dhe zbatimin e kontratës së dhënies me qira të objektit “Parku i lojërave të qytetit Vlorë”, u konstatuan shkelje ligjore si më poshtë:

Nga auditimi i mëparshëm, ka rezultuar si e ardhur e munguar mbi zbatimin e kontratave së dhënies me qira të objektit “Parku i lojërave të qytetit Vlorë” deri më datë 30.06.2021 në vlerën **10,198,440 lekë**. Është arkëtuar më pak për periudhën 01.01 2021 – 31.12.2022, shuma **5,827,680 lekë**, përbën të ardhur të munguar me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe MZHTETTS, sipas përqindjeve, referuar procesverbalit të mbajtur nga administrata e Bashkisë Vlorë mbi saktësimin e sipërfaqes në shfrytëzim që subjekti ka si dhe tarifave të ndryshuara me VKM nr. 992, datë 9.12.2015 “Për disa ndryshime në VKM nr.54 datë 5.2.2014”. Nuk është marrë parasysh ndryshimi i tarifës së qirasë me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, me ndryshime.

Nuk është zbatuar pika 6.3 e kontratës, pasi vlera e garancisë së kontratës nuk është derdhur nga qiramarrësi dhe nuk është ngurtësuar në emër të Bashkisë Vlorë, deri në përfundim të kontratës”. Nisur nga përcaktimet e kontratës fillestare në nenin 7 “Zgjidhja e kontratës” pika 7.2 germa “c” përcaktohet se kontrata mund të zgjidhet para afatit, kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate, veprim që nuk është kryer nga Bashkia Vlorë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se kontrata ka përfunduar në qershor të vitit 2022, pagesa mujore vazhdon të kryhet nga subjekti “I.” ShPK në vlerën 360,060 lekë për çdo muaj. Duke iu referuar VKB-së 60 datë 27.10.2016 pika 2 e VKB-së, ku specifikohet se të miratojë sipërfaqen prej 14960 m² në funksion të Parkut të Lojërave të qytetit të Vlorës, sipas matjeve faktike të kryera në terren, bashkëlidhur planvendosja përkatëse. Gjithashtu po ti referohemi pikës 3 të këtij vendimi ku është shprehur se ky vendim ti dërgohet për kompetencë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe sipërmarrjes, për vijimin e mëtejshëm të procedurave ligjore. Duke iu referuar pikës 4 të VKB-së ku shkruhet se për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vlorë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion Nga Drejtoria e Aseteve rezulton se nuk është mbajtur korrespondenca sikurse përcaktohet në VKB-së nr.60 datë 27.10.2016.

Gjithashtu po ti referohemi pikës 3 të këtij vendimi ku është shprehur se ky vendim ti dërgohet për kompetencë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik , Turizmit, Tregtisë dhe sipërmarrjes , për vijimin e mëtejshëm të procedurave ligjore . Duke iu referuar pikës 4 të VKB-së ku shkruhet se për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vlorë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion Nga Drejtoria e Aseteve rezulton se nuk është mbajtur korrespondenca sikurse përcaktohet në VKB-së nr.60 datë 27.10.2016.

Gjithashtu, Bashkia Vlorë nuk ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve sipas Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 205, datë 25.10.2022, përcjellë me shkresën nr. 462/10 prot; datë 31.10.2022, konkretisht për:

- Evidentimin e të gjitha arkëtive nga qiraja e kontratës për “Parkun e lojërave të qytetit Vlorë” nga momenti i lidhjes së kontratës deri më datë 31.12.2010;
- Lidhur me pasuritë nr. 28/611 dhe nr. 28/614, të cilat janë pjesë e “Parkut të lojërave të qytetit Vlorë”, dhe sipas certifikatave të pronësisë Bashkia Vlorë nuk është pronare, të evitohen veprimet juridike për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi to;
- Mos marrja në konsideratë e këtyre rekomandimeve, ka sjell vijimin e paligjshmërisë së kontratës ndërmjet Bashkisë Vlorë dhe subjektit “I.” ShPK, duke sjellë rritjen e të ardhurave të munguara

shprehur më sipër.

Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohet me përgjegjësi: **z. D. L.**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Vlorë.

Titulli gjetjes: Mbi të ardhurat e krijuara nga kontrata për dhënien me qira të objektit “Parku i lojërave të qytetit Vlorë”.

Situata: Në hartimin dhe zbatimin e kontratës së dhënies me qira të objektit “Parku i lojërave të qytetit Vlorë”, u konstatuan shkelje ligjore si më poshtë:

- Është arkëtuar më pak për periudhën 01.01 2021 – 31.12.2022, shuma 5,827,680 lekë, përbën të ardhur të munguar me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe MZHTETTS, sipas përqindjeve, referuar procesverbalit të mbajtur nga administrata e Bashkisë Vlorë mbi saktësimin e sipërfaqes në shfrytëzim që subjekti ka si dhe tarifave të ndryshuara me VKM nr. 992, datë 9.12.2015 “Për disa ndryshime në VKM nr.54 datë 5.2.2014”.

- Nuk është marrë parasysh ndryshimi i tarifës së qirasë me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, me ndryshime.

- Nuk është zbatuar pika 6.3 e kontratës, pasi vlera e garancisë së kontratës nuk është derdhur nga qiramarrësi dhe nuk është ngurtësuar në emër të Bashkisë Vlorë, deri në përfundim të kontratës”.

- Nisur nga përcaktimet e kontratës fillestare në nenin 7 “Zgjidhja e kontratës” pika 7.2 germa “c” përcaktohet se kontrata mund të zgjidhet para afatit, kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate, veprim që nuk është kryer nga Bashkia Vlorë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se kontrata ka përfunduar në qershor të vitit 2022, pagesa mujore vazhdon të kryhet nga subjekti “I.” ShPK në vlerën 360,060 lekë për çdo muaj.

Duke iu referuar VKB-së 60 datë 27.10.2016 pika 2 e VKB-së, ku specifikohet se të miratohet sipërfaqen prej 14960 m² në funksion të Parkut Të Lojërave të qytetit të Vlorës, sipas matjeve faktike të kryera në terren, bashkëlidhur planvendosjen përkatëse. Gjithashtu po ti referohemi pikës 3 të këtij vendimi ku është shprehur se ky vendim ti dërgohet për kompetencë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe sipërmarrjes, për vijimin e mëtejshëm të procedurave ligjore . Duke iu referuar pikës 4 të VKB-së ku shkruhet se për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vlorë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion Nga Drejtoria e Aseteve rezulton se nuk është mbajtur korrespondenca sikurse përcaktohet në VKB-së nr.60 datë 27.10.2016.

Kriteri: VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016, Kapitulli III, “Tarifat dhe vlera dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfi-teozë”, pikat 5 Kreu VI pika 2 dhe 6 aneks-kontrata e datës 04.06. 2002, ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” Pjesa V, Kreu I, neni 678.

Ndikimi/Efekti: Ulje në nivelin e të ardhurave në vlerën 5,827,680 lekë, paguar më pak nga qiramarrësi “I: I” ShPK.

Shkaku: Është ulur tarifa e qirasë në objektin e aneks kontratës së datës 03.07.2013, si pasojë e zbritjes së sipërfaqes së dhënë me qira nga sipërfaqja që shfrytëzohet në fakt dhe mosaplikim i ndryshimit ligjor të tarifave të qirasë për truall funksional dhe sipërfaqe objekti.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi 1: Kryetari i Bashkisë të ngrejë një grup pune me specialist të fushës nga Drejtoria e të Ardhurave vendore, Drejtoria e Aseteve dhe Drejtoria Juridike Bashkia Vlorë, për analizimin e situatën e krijuar nga mos pagesa e qirasë së objektit “**Parku i lojërave të qytetit Vlorë**”, si dhe të ndiqen të gjitha rrugët administrative për arkëtimin e vlerës e cila përbën efekt negativ financiarë progresive **në shumën 16,026,120 lekë**, për mos përcaktimin e pagesës sipas sipërfaqes së re të konstatuar nga matjet faktike të kryera në terren, si dhe mos aplikimin e tarifave të reja të qirasë/m² duke favorizuar subjektin “**I. I**” **ShPK**.

Të përllogaritet në vijimësi pagesa mujore për subjektin “**I. I**” **ShPK** referuar matjeve faktike 14.960 m² sipas përcaktimeve në VKB nr. 60, datë 27.10.2016.

Brenda datës 30.3.2024

Rekomandimi 2: Kryetari i Bashkisë Vlorë, të marrë masa të menjëhershme për zbatimin rekomandimeve të dërguara më shkresën nr. 462 prot; datë 31.10.2022, që lidhen me kontratën ndërmjet **Bashkisë Vlorë** dhe subjektit “**I.**” **ShPK**.

Menjëherë

Nga subjekti i audituar, Bashkia Vlorë, mbi projekt raportin nr. 1026/28 prot; datë 28.09.2023, janë paraqitur kundërshti nga znj. S. H. me shkresën nr. 11597 prot; datë 27.10.2023, në cilësinë e Drejtorit të Aseteve, Bashkia Vlorë, e cila ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimi i subjektit:

Në përgjigje suajës nr. 12204 prot; datë 11.10.2023, protokolluar pranë Bashkisë në lidhje me Projekt Raport Auditimin nr.1026/1, datë 25.11.2022, në lidhje me titullin e gjetjes “Mbi të ardhurat e krijuara nga kontrata për dhënie me qera të objektit “Parku i Lojërave” ju duhet të drejtoheni personave përgjegjës që kanë konceptuar projekt-vendimin nr. 60, datë 27.10.2016.

Pasi me shkresën nr. 5675/1 prot; datë 30.05.2022 në cilësinë e drejtorit të DPPMA-së që prej vitit 2020 nga DPPMA nuk është kryer asnjë procedurë në lidhje me këtë dosje dhe me çështjen objekt auditimi.

Qëndrimi Grupit të auditimit:

Në përgjigje të asaj çfarë ju pretendoni theksojmë që grupi i auditimit i është referuar VKB-së nr.60 datë 27.10.2016, sipas pikave që përcaktohen në këtë vendim.

- TARIFA E UJITJES

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelat 1 dhe tabela 2 bashkëlidhur akt- konstatimit nr.34, e vënë në dispozicion Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vlorë, rezultoi se për tarifën e ujitjes për vitin 2021 dhe vitin 2022 është në vlerën 3,983 mijë lekë, ndërsa realizimi i saj është 0%. Duke iu referuar VKB-së nr. 88 prot; datë 24.12.2020 i ndryshuar me VKB nr. 79 prot; datë 02.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë” tarifa për shërbimin e ujitjes llogaritet në vlerën 2,500 lekë/ha për çdo ujitje dhe struktura përgjegjëse për llogaritjen dhe vjeljen e saj është Ndërmarrja e Shërbimeve Publike (NSHP), Sektori i Ujitjes dhe Kullimit. Nga auditimi i dokumentacionit i vënë dispozicion pranë grupit të auditimit nga NSHP, Sektori i Ujitjes dhe Kullimit rezulton së menaxhimi i kësaj tarife bëhet nga Organizatat e Përdorimit të Ujit (OPU). Aktualisht në territorin e Bashkisë Vlorë operojnë pesë OPU me vendndodhje në Llakatund, Babicë, Kallafet, Llogara dhe Panaja. Kryetarët e OPU-ve pajisen nga NSHP, Sektori i Ujitjes dhe Kullimit me mandat arkëtime me qëllim prerjen e faturave

për fermerët në momentin e marrjes së shërbimit. Nga të dhënat e paraqitura rezulton se NSHP Bordi i kullimit me shkresën lënda: informacion “Ujitja 2021” e cila nuk rezulton te ketë marrë numër protokolli dhe datë ku thuhet se për vitin 2021 janë arkëtuar në total 362,500 lekë (OPU Babicë 24,500 dhe OPU Llakatund 338,000), ndërsa nuk ka arkëtime nga OPU-të e Llogarasë, Panajasë dhe Kallafetit. Këto të ardhura të administruara nga OPU-të përdoren po nga Kryetarët e OPU-ve të cilët bëjnë dhe prerjen e faturave dhe mbledhjen e pagesave nga fermerët që përdorin ujin për ujitje. Kryetarët e OPU-ve paraqiten në Sektorin e Ujitjes dhe Kullimit në NSHP rast pas rasti duke dorëzuar mandat arkëtimet lidhur me nivelin e të ardhurave si dhe duke dorëzuar disa proces verbale të hartuara dhe të firmosura po nga ato lidhur me shpenzimin e vlerës së të ardhurave të siguruara. Këto proces verbale janë të hartuara me shkrim dore dhe nuk shoqërohen me asnjë faturë të rregullt e cila të shpreh vërtitësin lidhur me blerjen e artikujve që Kryetarët e OPU-ve pretendojnë se kanë blerë me të ardhurat që kanë arkëtuar nga ofrimi i shërbimit të ujitjes për fermerët. Pra, likuidimet nuk janë shoqëruar pranë sektorit të ujitjes me dokumente te sakta tekniko ligjor.

Për vitin 2021: Duke iu referuar Librit të arkës i cili disponohet nga NSHP sektori i ujitjes i menaxhuar nga vetë OPU-të i cili është vënë në dispozicion pranë grupit të auditimi i cili nuk është i formatizuar në hartimin e tij dhe mënyra e mbajtjes së të dhënave. Nga të dhënat rezulton se për vitin 2021 lidhur me OPU Babicë janë paraqitur pranë arkës së NSHP në sektorin e ujitjes deri më 29.07.2021 ku sipas librit të arkës në mënyrë analitike, është arkëtuar vlera prej 12.500 lekë për 5 (dynym) e llogaritur për 5 hektar për secilin subjekt është llogaritur me 2,500 lekë për hektar sipas VKB-së nr. 88, datë 24.12.2020 i ndryshuar VKB nr.79 prot;datë 02.12.2021 ku tarifa e ujitjes llogaritet në vlerën 2,500 lekë hektar për çdo ujitje . Gjithashtu nga OPU Babicë deri në datë 20.09.2021 janë arkëtuar 4.8 Ha në vlerën 12,000 lekë. Përsa i përket OPU Llakatund për një periudhë nga data 01.06.2021-01.08.2021 janë arkëtuar 338,000 lekë për 135.2 ha . Nga auditimi rezulton se në disa raste ka mangësi në aplikimin e tarifës ku në librin e arkës nuk korrespondon vlera e arkëtuar dhe shërbimi për hektar, theksohet se aplikimi për tarifën shërbimit e ujitjes jo në çdo rast është aplikuar me tarifën 2,500 lekë për hektar/ për çdo ujitje sipas VKB-së nr. 88 prot; datë 24.12.2020 i ndryshuar me VKB nr.79 prot;02.12.2021.

Viti 2022:

Nga auditimi rezulton se është vepruar në të njëjtën linjë si në vitin 2021, ku për OPU kallafat sipas librit të arkës të vënë në dispozicion nga NSHP sektori i ujitjes sipas OPU kallafat për periudhën 10.06.2022-20.08.2022 ka arkëtuar 26,750 mijë lekë për 10.7 hektar për periudhën 20.08.2022 është arkëtuar vlera prej 30,750 lekë për 6 Ha. OPU Llakatund gjithashtu ka ndjekur metodën si është përmendur dhe më lartë deri në datën 03.08.2022 ku sipas librit të arkës i cili është vetë menaxhuar prej tyre ka arkëtuar vlerën prej 385,300 mijë lekë për 147 hektar. OPU Babicë duke iu referuar librit të arkës rezulton se janë arkëtuar 42,300 lekë për 14.1 hektarë.

Nga auditimi konstatohet se nga shuma totale e mbledhur nga libri i arkës i cili është administruar nga vetë OPU-të rezulton se janë arkëtuar të ardhura nga tarifa e shërbimit të ujitjes në vlerën **847,600 lekë** vlerë e cila është e pa argumentuar duke marrë shkas nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga sektori i ujitjes i cili është jo bindës nga forma juridike. Gjithashtu rezulton se nga krahasimi i mandateve të pagesës me librin e arkës në disa raste janë aplikuar tarifa për 2 shërbime për ujitje dhe pagesa është llogaritur për 1 shërbim ujitje në të gjitha rastet specifikohet lloji shërbimit ujitje, konkretisht janë aplikuar me faturim të gabuar 99 raste me vlerë **198,300 lekë** të paraqitura **në aneksin nr.1.1** Nga të dhënat të që janë vënë në dispozicion pranë grupit të auditimit nga sektori i ujitjes konkretisht libri i arkës dhe mandatet e pagesës të dy këto dokumente të pa

formatizuar rezulton vlere prej 847,600 lekë e cila nuk ka kaluar në asnjë nga strukturat e kontabilitetit të Bashkisë Vlorë + 198,300 lekë = **1,045,900 lekë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Bashkisë Vlorë**. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Bordit të kullimit sektori i ujitjes, është mbajtur procesverbal me nr. 660 prot; datë 01.12.2021 nga NSHP bordi i kullimit proces verbal i mbajtur nga z. F. Xh. përgjegjës i sektorit të ujitjes, ing. A. L., dhe specialistes znj. M. Z., mbi rivlerësimin e sipërfaqeve të ujitura nga OPU-të në Bashkinë e Vlorës për vitin 2021. Ku sipas procesverbalit të mbajtur nga ana e NSHP bordi i kullimit ku shprehet se, OPU Llakatund ka shfrytëzuar afërsisht 4-5 hektar të punuar. Nga rivlerësimi dhe puna në terren sipas procesverbalit diferenca është 130 hektar sasia gjithsej është 265 hektar qe duhet të ishin raportuar Pranë Bordit të Kullimit. Rezervuari Kallafet: ka raportuar 0 shërbim të kryer, duhet të ishin raportuar 30 hektar. Rezervuari Babicë nga rivlerësimi rezulton se duhet të ishin vaditur 60 hektar dhe janë raportuar 5 hektar, rivlerësimi konsiston në 55 hektar sipas Sektorit të ujitjes. Rezervuari Panaja është raportuar 0, nga sektori i ujitjes është vlerësuar me 20 hektar. Rezervuari Kanina 1, Kanina 2 është raportuar 0, vlerësuar me 80 hektar. Dukat - Tragjas, vlerësuar në 130 hektar, dhe është raportuar 0. Duke iu referuar procesverbalit me nr. 660 prot; datë 01.12.2021 ku sipërfaqe e planifikuar është për 750 hektar dhe sipërfaqe e ujitur e raportuar është 140 hektar, diferenca është 610 hektar ose në vlerën prej **1,525,000 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë**.

Nga komunikimi verbal me financën e Bashkisë Vlorë lidhur me problematikat e konstatuara, janë shprehur se Bashkia Vlorë nuk regjistron asnjë të ardhur nga tarifa e shërbimit të ujitjes;

Tarifa e shërbimit të ujitjes menaxhohet nga Kryetarët e Organizatave të Përdorimit të Ujit të cilët presin faturat dhe mbledhin të ardhurat nga fermerët që përdorin ujin për ujitje. Të ardhurat e siguruara nuk kalojnë në asnjë strukturë të Bashkisë Vlorë (Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Sektori i Ujitjes dhe Kullimit) por përdoren nga Kryetarët e OPU-ve për blerje artikujsh të ndryshëm duke përdorur si dokumente justifikuese pranë Sektorit të Ujitjes dhe Kullimit vetëm disa proces verbale në formatin A4 të hartuara me shkrim dore dhe të firmosura nga vetë anëtarët e OPU-ve pa asnjë dokument justifikues duke sjellë vështirësi në deshifrimin e tyre. Si rezultat i gjithë procesi i menaxhimit të tarifës së ujitjes nuk është i formatizuar dhe i dokumentuar; Sektori i Ujitjes dhe Kullimit nuk ka regjistër të fermerëve apo dokumentacion tjetër lidhur me përdoruesit e ujit për ujitje, për pagesat e detyruara, tarifën për t'u paguar dhe ato të paguara;

Për vitin 2021 dhe nga pesë OPU që Sektori i Ujitjes dhe Kullimit në NSHP i njeh që operojnë në territorin e Bashkisë Vlorë vetëm dy (OPU Babicë dhe OPU Llakatund) kanë deklaruar që kanë siguruar të ardhura, ndërsa tre OPU (OPU Llogara, OPU Panaja dhe OPU Kallafet) nuk rezulton të kenë prerë fatura për vitin 2021 për përdorimin e ujit për ujitje nga fermerët. Gjithashtu nga dokumenti i vënë në dispozicion nga ana e NSHP bordi i kullimit sektori i ujitjes rezulton se është lidhur akt- marrëveshje (kontratë përdorimi) me nr. 125 prot; datë 28.05.2018, akt-marrëveshje e lidhur nga drejtori i NSHP, z. G. Sh. dhe kryetari i OPU Kallafet, z. L. Sh. rezulton se akt-marrëveshja konsiston në dokumente fotokopje, jo dokument origjinal i akt -marrëveshjes, nga ana formale e akt-marrëveshjes rezulton se është nënshkruar në fotokopjen e dokumentit nga Kryetari i OPU-së, z. L. Sh., ndërsa nga ana e ish drejtorit të NSHP rezulton firmë dhe vulë fotokopje, gjë e cila nuk është në përputhje sipas kodit të procedurave administrative. Përsa i përket akt-marrëveshjes me nr. 125 prot; datë 28.05.2018, me OPU Panaja rezulton se akt-marrëveshja është firmosur vetëm nga ana e ish drejtorit të NSHP, z. G. Sh., dhe jo nga pala tjetër e kryetarit të OPU Panaja, z. L. M., marrëveshja duhet të jetë e nënshkruar nga të dyja palët me anë të nënshkrimit ata shprehin vullnetin e tyre. Akt –marrëveshja me nr. 125 prot; datë

28.05.2018, akt-marrëveshje e lidhur midis Kryetarit të OPU Babicë, z. S. M. dhe ish-Drejtorit, z. G. Sh., akt-marrëveshje e cila rezulton të jetë firmosuar nga ana e kryetarit OPU Babicë mbi fotokopjen e akt-marrëveshjes si në rastin e akt- marrëveshjes me OPU Kallafet. Ka funksionuar në të njëjtën mënyrë është ndjekur e njëjta metodologji edhe për akt marrëveshjen me nr.a125 prot; datë 28.05.2018, e lidhur ndërmjet kryetarit të OPU Llogara, z. H. I. dhe ish-Drejtorit të NSHP, z. G. Sh., ku nënshkrimi nga ana e kryetarit të OPU Llogara, z. H. I. rezulton te jetë nënshkruar mbi fotokopje të akt- marrëveshjes dokument i cili nga ana formale nuk përputhet me përcaktimet e kodit të procedurave administrative. Përsa i përket OPU Llakatund, duke iu referuar dokumenteve të vëna në dispozicion nuk rezulton të jetë lidhur akt-marrëveshje. Nga auditimi arrihet në konkluzion se akt-marrëveshjet e nënshkruara nga palët nuk i plotësojnë elementët e sigurisë të një akti administrativ pasi nënshkrimi në fotokopjen e tij nuk vërteton origjinalitetin e një akti administrative, në kundërshtim me Ligjin 44/2015 kodi i procedurave administrative i republikës së Shqipërisë neni 51,52,107,108,119.

Përsa i përket afateve të përcaktuara në akt-marrëveshje në të gjitha rastet kohëzgjatja e mbajtjes në përdorimin rezulton të jetë lidhur për një periudhë 4 vjeçare, në kundërshtim me Ligjin nr. 24/2017 “Për administrimin e Ujitjes dhe të Kullimit”, neni 8, pika 5. Dhënia në përdorim e infrastrukturës mbi bazën e së drejtës kontraktuale bëhet me marrëveshje me shkrim, në formën e parashikuar, ndërmjet ministrisë/bashkisë dhe cilitdo që i transferohet infrastruktura, për jo më pak se 10 vjet. Në marrëveshje përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës. Menaxhimi i procesit të ujitjes nga OPU nuk është bërë në përputhje me kuadrin ligjor për transferimin e përgjegjësive e menaxhimit të ujitjes tek OPU, sikurse përcaktohet në Ligjin nr. 24/2017 “Për administrimin e Ujitjes dhe të Kullimit”, neni 20 Transferimi i përgjegjësive të ujitjes “1. Bashkia mund t’i transferojë përgjegjësitë e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes, organizatave, brenda zonës së saj të shërbimit, në përputhje me përcaktimet e nenit 8, të këtij ligji. Në këtë rast, tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe tarifa e shërbimit të ujitjes mbledhen nga organizata”. Referuar VKB-së nr. 88 prot; datë 24.12.2020 i ndryshuar me VKB nr. 79 prot; datë 02.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë” kreu II, pika 5, përgjegjëse për arkëtimin e tarifës së ujitjes është Ndërmarrja e Shërbimeve Publike (NSHP), Sektori i Ujitjes dhe Kullimit.

Gjithashtu, nuk ka asnjë dokumentacion që të provojë të ardhura nga tarifa e mirëmbajtjes së infrastrukturës ujore, si dhe nuk ka dokumentacion që kjo tarifë të jetë aplikuar për vitin 2021 dhe vitin 2022 . Referuar VKB-së nr. 88 prot; datë 24.12.2020 dhe VKB nr. 79 prot; datë 02.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”, përgjegjësia për vjeljen e kësaj tarife është e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore ndërkohë që është NSHP/Sektori i Ujitjes dhe Kullimit ai që duhet të menaxhojë edhe këtë tarifë. Sa më sipër nga strukturat e Bashkisë Vlorë, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Sektori i Ujitjes dhe Kullimit është vepruar në kundërshtim me përcaktimet ligjore si vijon: Ligji nr. 24/2017 “Për administrimin e Ujitjes dhe të Kullimit”:

- Neni 17: Tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës “1. Bashkia mbledh tarifën vjetore të mirëmbajtjes për çdo sipërfaqe toke, brenda zonës së saj të shërbimit të ujitjes. ... 2. Tarifa vjetore e mirëmbajtjes i njoftohet, me shkrim, zotëruesit të tokës dhe përllogaritet duke iu referuar madhësisë së sipërfaqes së saj, në përpjesëtim me madhësinë e përgjithshme të zonës së shërbimit të ujitjes. 3. Kjo tarifë përfshin shpenzimet e mirëmbajtjes vjetore të sistemit të ujitjes, shpenzimet

për përgatitjen e këtij sistemi për stinën e ardhshme të ujitjes dhe koston e pastrimit të kanaleve kulluese”;

- **Neni 18:** Tarifa e shërbimit të ujitjes “1. Bashkia vendos një tarifë shërbimi për çdo shpërndarje të ujit për ujitje, në bazë të kërkesës së çdo fermeri. 2. Tarifa e shërbimit të ujitjes llogaritet sipas sipërfaqes së ujitur dhe numrit të ujitjeve ose vëllimit të ujit të përdorur për çdo ujitje apo kohëzgjatjes së ujitjes dhe çmimit për njësi kohe. 3. Tarifa e shërbimit të ujitjes për njësi përlllogaritet duke iu referuar shpenzimeve për shfrytëzimin e sistemit të ujitjes dhe të shpërndarjes së ujit për ujitje, përfshirë çdo shpenzim të bërë për furnizimin e një rezerve të tillë ujore”;

- **Neni 40:** Regjistrat, pika 2. “Çdo bashki/organizatë mban këta regjistra: ... ç) regjistër për sasitë e ujit ose numrin e ujitjeve të përfituara nga anëtarët; d) regjistër për pagesat e detyruara, tarifën për t’u paguar dhe ato të paguara; ... e) regjistër për inspektimet dhe kontrollet e infrastrukturës së ujitjes, si dhe regjistër për inspektimet dhe kontrollet e digës, sipas legjislacionit përkatës”;

- VKB-së nr. 88 prot; datë 24.12.2020 dhe VKB nr. 79 datë 02.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”.

Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohet me përgjegjësi: **z. G. Sh.**, ish-Drejtor i Ndërmarrjes Shërbimeve Publike; **z. E. J.**, ish-Drejtor i Ndërmarrjes Shërbimeve Publike; **z. F. Xh.**, ish-Përgjegjës i Sektorit të Ujitjes.

<p>Titulli gjetjes: Procedurë e ndjekur në kundërshtim me kuadrin rregullator të fushës, mos arkëtim nga të ardhurat e vjela nga shërbimi për tarifën e ujitjes i përcaktuar me VKB nr. 79 prot; datë 02.12.2021 për disa ndryshime në VKB nr. 88 prot; datë 24.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”.</p>

Situata: Nga të dhënat të që janë vënë në dispozicion pranë grupit të auditimit nga sektori i ujitjes konkretisht libri i arkës dhe mandatet e pagesës të dy këto dokumente të pa formatizuar rezultojnë se vlera prej 847,600 lekë e cila nuk ka kaluar në asnjë nga strukturat e kontabilitetit të Bashkisë Vlorë + 198,300 lekë = **1,045,900 lekë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Bashkisë Vlorë.** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Bordit të kullimit sektori i ujitjes, është mbajtur procesverbal me nr. 660 prot; datë 01.12.2021 nga NSHP bordi i kullimit proces verbal i mbajtur nga z. F. Xh. përgjegjës i sektorit të ujitjes, ing. A. L. dhe specialistes M. Z., mbi rivlerësimin e sipërfaqeve të ujitura nga O.P.U-të në Bashkinë e Vlorës për vitin 2021. Ku sipas procesverbalit të mbajtur nga ana e NSHP bordi i kullimit ku shprehet se, O.P.U Llakatund ka shfrytëzuar afërsisht 4 - 5 hektar të punuar. Nga rivlerësimi dhe puna në terren sipas procesverbalit diferenca është 130 hektar sasia gjithsej është 265 hektar që duhet të ishin raportuar pranë Bordit të Kullimit. Rezervuari Kallafet ka raportuar 0 shërbime të kryera, duhet të ishin raportuar 30 hektar. Rezervuari Babicë nga rivlerësimi rezultojnë se duhet të ishin vaditur 60 hektar dhe janë raportuar 5 hektar, rivlerësimi konsiston në 55 hektar sipas Sektorit të Ujitjes, Rezervuari Panaja është raportuar 0, nga Sektori i Ujitjes është vlerësuar me 20 hektar. Rezervuari Kanina 1, Kanina 2 është raportuar 0, vlerësuar me 80 hektar. Dukat - Tragjas, vlerësuar në 130 hektar, dhe është raportuar 0. Duke iu referuar procesverbalit me nr. 660 prot; datë 01.12.2021 ku sipërfaqe e planifikuar është për 750 hektar dhe sipërfaqe e ujitur e raportuar është 140 hektar, diferenca është 610 hektar ose në vlerën prej **1,525,000 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë.**

Nga komunikimi verbal me financën e Bashkisë Vlorë lidhur me problematikat e konstatuara, janë shprehur se Bashkia Vlorë nuk regjistron asnjë të ardhur nga tarifa e shërbimit të ujitjes; Tarifa e shërbimit të ujitjes menaxhohet nga Kryetarët e Organizatave të Përdorimit të Ujit të cilët presin faturat dhe mbledhin të ardhurat nga fermerët që përdorin ujin për ujitje. Të ardhurat e siguruara nuk kalojnë në asnjë strukturë të Bashkisë Vlorë (Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Sektori i Ujitjes dhe Kullimit) por përdoren nga Kryetarët e OPU-ve për blerje artikujsh të ndryshëm duke përdorur si dokumente justifikuese pranë Sektorit të Ujitjes dhe Kullimit vetëm disa proces verbale në formatin A4 të hartuara me shkrim dore dhe të firmosura nga vetë anëtarët e OPU-ve pa asnjë dokument justifikues duke sjellë vështirësi në deshifrimin e tyre. Si rezultat i gjithë procesi i menaxhimit të tarifës së ujitjes nuk është i formatizuar dhe i dokumentuar; Sektori i Ujitjes dhe Kullimit nuk ka regjistër të fermerëve apo dokumentacion tjetër lidhur me përdoruesit e ujit për ujitje, për pagesat e detyruara, tarifat për t'u paguar dhe ato të paguara; Për vitin 2021 dhe nga pesë OPU që Sektori i Ujitjes dhe Kullimit në NSHP i njeh që operojnë në territorin e Bashkisë Vlorë vetëm dy (OPU Babicë dhe OPU Llakatund) kanë deklaruar që kanë siguruar të ardhura, ndërsa tre OPU (OPU Llogara, OPU Panaja dhe OPU Kallafet) nuk rezultojnë të kenë prerë fatura për vitin 2021 për përdorimin e ujit për ujitje nga fermerët. Gjithashtu nga dokumenti i vënë në dispozicion nga ana NSHP bordi i kullimit sektori i ujitjes rezultojnë se është lidhur akt- marrëveshje (kontratë përdorimi) me nr.125., prot datë 28.05.2018 akt-marrëveshje e lidhur nga drejtori i NSHP, z. G. Sh. dhe kryetari i OPU Kallafet, z. L. Sh. rezultojnë se akt-marrëveshja konsiston në dokumente fotokopje, jo dokument origjinal i akt -marrëveshjes, nga ana formale e akt-marrëveshjes rezultojnë se është nënshkruar në fotokopjen e dokumentit nga Kryetari i OPU, z. L. Sh., ndërsa nga ana e ish drejtorit të NSHP rezultojnë firmë dhe vulë fotokopje, gjë e cila nuk është në përputhje sipas kodit të procedurave administrative. Përsa i përket akt-marrëveshjes me nr.125 prot; datë 28.05.2018 me OPU Panaja rezultojnë se akt – marrëveshja është firmosur vetëm nga ana e ish-drejtorit të NSHP, z. G. Sh., dhe jo nga pala tjetër e kryetarit të OPU Panaja, z. L. M., marrëveshja duhet të jetë e nënshkruar nga të dyja palët me anë të nënshkrimit ata shprehin vullnetin e tyre. Akt –marrëveshja me nr. 125 prot; datë 28.05.2018, akt - marrëveshje e lidhur midis Kryetarit të OPU Babicë, z. S. M. dhe ish-drejtorit, z. G. Sh., akt-marrëveshje e cila rezultojnë të jetë firmosuar nga ana e kryetarit OPU Babicë mbi fotokopjen e akt-marrëveshjes si në rastin e akt- marrëveshjes me OPU Kallafet. Ka funksionuar në të njëjtën mënyrë është ndjekur e njëjta metodologji edhe për akt marrëveshjen me nr. 125 prot; datë 28.05.2018, e lidhur ndërmjet kryetarit të OPU Llogara, z. H. I. dhe ish-drejtorit të NSHP, z. G. Sh., ku nënshkrimi nga ana e kryetarit të OPU Llogara, z. H. I. rezultojnë te jetë nënshkruar mbi fotokopje të akt-marrëveshjes dokument i cili nga ana formale nuk përputhet me përcaktimet e kodit të procedurave administrative. Përsa i përket OPU Llakatund duke iu referuar dokumenteve të vëna në dispozicion nuk rezultojnë të jetë lidhur akt-marrëveshje. Nga auditimi arrihet në konkluzion se akt-marrëveshjet e nënshkruara nga palët nuk i plotësojnë elementët e sigurisë të një akti Administrativ pasi nënshkrimi në fotokopjen e tij nuk vërteton origjinalitetin e një akti administrativ.

Kriteri: Veprime në kundërshtim me VKB-së nr. 88 prot; datë 24.12.2020 i ndryshuar me VKB nr.79 prot;02.12.2021, pika 5. Në kundërshtim me Ligjin nr.24/2017 datë 09.03.2017 “ për administrimin e ujitjes dhe kullimit” Ligjin Nr. 10 296, Datë 08.07.2010 I Ndryshuar Me Ligjin Nr. 110/2015, Datë 15.10.2015, “Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin” neni 4 pika 26., “Dokument financiar” është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të

dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumenti elektronik rregullohet me Ligjin nr. 10273, datë 29.4.2010 “Për dokumentin elektronik”.

Ndikimi/Efekti: Mos arkëtim nga të ardhurat e vjela nga shërbimi për tarifën e ujitjes, duke sjellë **1,045,900 lekë** e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Bashkisë Vlorë, dhe vlerën prej 1,525,000 lekë duke sjellë të ardhura të munguara.

Shkaku: Mos njohja e kuadrit rregullatorë të Fushës, dhe mos zbatimi i VKB-së nr. 88 prot; datë 24.12.2020 i ndryshuar me VKB nr.79 prot;02.12.2021.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë nëpërmjet Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të inicojë në mision auditit në Ndërmarrjen e Shërbimeve Bashkia Vlorë, mbi menaxhimin e tarifës së ujitjes për periudhën 2020 – 2023.

Të shtohen burimet njerëzore pranë sektorit të ujitjes me qëllim që menaxhimi i shërbimit të ujitjes dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës të kryhet nga vetë Ndërmarrja Shërbimeve Publike. Të kryhen rakordimet ndërmjet strukturave , për të ardhurat e vjela nga shërbimi i ujitjes, ndërmjet sektorit të ujitjes dhe Drejtorisë së Financës së NSHP Bashkia Vlorë.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Vlorë analizojnë situatën e krijuar dhe të nxjerrin përgjegjësitë administrative e ligjore ndaj personave përgjegjës që kanë shkaktuar efekt negativ financiar në shumën **2,570,900 lekë, duke kërkuar arkëtimin e vlerës në buxhet për periudhën 2021-2022.**

Nga subjekti i audituar, Bashkia Vlorë, mbi projekt raportin nr. 1026/28 prot; datë 28.09.2023, janë paraqitur kundërshti nga znj. A. Sh. me shkresën nr. 11597 prot; datë 27.10.2023, në cilësinë e Drejtorit të Taksave dhe Tarifave, Bashkia Vlorë, e cila ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimi i Subjektit:

Në lidhje me këtë gjetje, theksoj se rekomandimi i lënë nga ana juaj nuk gjen zbatim nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore pasi sikurse theksohet në V.K.B-në nr. 79, datë 2.12.2023 i ndryshuar, kjo tarifë ndiqet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike. Është kjo ndërmarrje e cila kryen rakordimin me degën e Thesarit Vlorë. Në bashkinë Vlorë, drejtoria që kryen akt rakordimet me drejtorinë apo njësitë vartëse të bashkisë është DFBK. Drejtoria e të Ardhurave Vendore nuk ka se si të kryej rakordimin e një tarife të cilën nuk e ndjek dhe nuk e ka të kontabilizuar si detyrim.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në përgjigje të kundërshtimit tuaj theksojmë se, përsa i përket Pretendimit tuaj lidhur me rekomandimin adresuar DAV-së merret në konsideratë dhe do të reflektohet në material.

Auditimi mbi zbatimin dhe ligjshmërinë e veprimeve të kryera në sistemin TAIS nga punonjësit e DTTV-së për regjistrimin e tatimpaguesve, si dhe analizimi i ngarkesave të kryera për taksat dhe tarifat vendore.

Mbi Administrimin e Sistemit TAIS

Bashkia Vlorë ka në përdorim sistemin e administrimit të taksave TAIS (*Tax Administration Information System*), ndërtuar nga kompania Infosoft Business Solutions sh.pk dhe financuar nga USAID. Sistemi është ndërtuar mbi Microsoft Dynamic NAV.

TAIS administron proceset e taksave lokale në Bashkisë Vlorë dhe bën të mundur regjistrimin e të gjithë taksapaguesve në qytetin e Vlorë, gjenerimin e detyrimeve për çdo taksapagues, llogaritjen e kamat vonesave, ndryshimet e domosdoshme për bizneset etj.

Serveri i TAIS është në godinën taksave vendore të Bashkisë. Nga ana kompanisë prodhuese dhe mirëmbajtëse dhe zhvilluese janë hartuar dhe venë në dispozicion të përdoruesve dhe administratoreve Manuali i Përdorimit Taksa_1.5 1” e “Metodika e Filtrimit dhe Personalizimi” si dhe Bllok-skemat e sistemit dhe Diagramat e qarkullimit.

Lista e përdoruesve te sistemit TAIS

Emri I Përdoruesit	Emër Mbiemër	Statusi	Atributi
VLORA-SRV\DN****	D. N.	Aktiv	Full User
VLORA-SRV\LM*****	Ll. M.	Jo Aktiv	Full User
VLORA-SRV\ARR****	A. Rr.	Aktiv	Full User
VLORA-SRV\MPR****	M. P.	Jo Aktiv	Full User
VLORA-SRV\FLL****	F. Ll.	Aktiv	Full User
VLORA-SRV\A.RR****	A. Rr.	Jo Aktiv	Full User
VLORA-SRV\LY*****	L. Y.	Jo Aktiv	Full User
VLORA-SRV\OB***	O. B.	Jo Aktiv	Full User
VLORA-SRV\BH*****	B. H.	Jo Aktiv	Full User
VLORA-SRV\ADMINISTRATOR	Administrator	Aktiv	Full User
VLORA-SRV\XHK*****	Xh. K.	Aktiv	Full User
VLORA-SRV\IBS.SUPPORT	ibs suport	Aktiv	Full User
VLORA-SRV\EP*****	E. P.	Aktiv	Full User
VLORA-SRV\ASH***	A. Sh.	Aktiv	Full User
VLORA-SRV\XK****	Xh. K.	Jo Aktiv	Limited User
VLORA-SRV\B.I*****	B. I.	Aktiv	Full User
VLORA-SRV\D**	D. U.	Aktiv	Full User
VLORA-SRV\E.A****	E. A.	Aktiv	Full User
VLORA-SRV\A*****	A. Sh.	Jo Aktiv	Full User
VLORA-SRV\KM***	K. M.-	Jo Aktiv	Full User
VLORA-SRV\ES*****	E. Sh.	Aktiv	Full User
VLORA-SRV\AD****	A. D.	Aktiv	Full User
VLORA-SRV\EM*****	E. M.	Jo Aktiv	Limited User
VLORA-SRV\HK*****	H. K.	Aktiv	Full User
VLORA-SRV\DK*****	D. K.	Jo Aktiv	Full User
VLORA-SRV\EP****	E. P.	Jo Aktiv	Full User
VLORA-SRV\SUPPORT	IBS Suport	Jo Aktiv	Full User
VLORA-SRV\G.S****	G. S.	Aktiv	Full User
VLORA-SRV\IM*****	I. M.	Jo Aktiv	Full User
VLORA-SRV\IIS*****	D. I.	Jo Aktiv	Full User
VLORA-SRV\RP*****	R. P.	Jo Aktiv	Full User
VLORA-SRV\A.B****	A. B.	Aktiv	Full User
VLORA-SRV\R.L*****	R. L.	Jo Aktiv	Full User
VLORA-SRV\E.N****	E. N.	Aktiv	Full User
VLORA-SRV\EÇ****	E. Ç	Jo Aktiv	Full User
VLORA-SRV\OM****	O. M	Aktiv	Full User
VLORA-SRV\SI*****	S. I.	Jo Aktiv	Full User
VLORA-SRV\A*****.R*****	A. Rr.	Jo Aktiv	Full User

Nga auditimi u konstatua se Bashkia Vlorë nuk disponon një politikë/rregullore të dokumentuar dhe miratuar për procesin e menaxhimit të përdoruesve (*krijimi, fshirja, ndryshimi i roleve/të drejtave, ndryshimi i fjalëkalimeve etj.*) për sistemin TAIS. Nga intervistimi i sistemit IT të Bashkisë është konstatuar se Bashkia Vlorë ndjek një procedurë të dakordësuar verbalisht për

menaxhimin e përdoruesve sipas së cilës, IT i Taksave të Bashkisë merr kërkesat nga punonjësit dhe merr aprovimin tek Drejtori i Taksave Vendore. Pas konfirmimit Specialisti përmes e-mailit komunikon me operatorin ekonomik. Operatori në bazë të kontratës së lidhur është përgjegjës për mirëmbajtjen e sistemit, operatori menaxhon përdoruesin për të cilin ka ardhur kërkesa dhe ja komunikon kredencialet përmes email-it specialistit të cilit i është krijuar user-i. Bashkia Vlorë nuk disponon ndonjë dokumentacion për përcaktimin e administratorëve të sistemeve, nuk janë të dokumentuar dhe nuk ekziston një politikë e miratuar për menaxhimin dhe mbrojtjen e tyre.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”; Neni 27, Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar; VKM Nr. 710, datë 21.08.2013 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”, i ndryshuar.

Bashkia Vlorë nuk ndjek një politikë të përcaktuar për analizimin e gjurmëve të auditimit për veprimet që kryejnë përdoruesit në Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore Në bazën e të dhënave të këtij sistemi ruhen gjurmët e auditimit (audit trail) për veprimet e kryera nga përdoruesit, por nuk ekzistojnë procedura për analizimin e këtyre gjurmëve.

Grupi i auditimit analizoi përmes teknikave CAAT të dhënat të cilat u eksportuan nga baza e të dhënave të sistemit Informatik të DAV, duke pasur si objekt vlerësimin nëse sistemi i informacionit të DAV garanton saktësinë e të dhënave që ruan dhe përpunon dhe parandalon pasaktësitë e mundshme si shkak i gabimeve në plotësim nga ana e përdoruesve të sistemit. Grupi i auditimit u fokusua në analizimin e saktësisë dhe plotësisë teknike të të dhënave dhe nivelin e garancisë që jep sistemi në parandalimin e gabimeve njerëzore në plotësimin e të dhënave në të. Nga auditimi i bazës së të dhënave të Sistemit TAIS rezultoi se ky sistem ka nevojë për përmirësime në drejtim të garantimit të integritetit dhe plotësisë së të dhënave që krijohen, menaxhohen dhe ruhen përmes tyre.

- *Nga filtrimi i tabelave të databasës vlera e kolonës identifikuese nuk është parashikuar të jetë me format të unifikuar.*

- *Useri i SA i databasës së sistemit TAIS nuk ka një password autentifikimi.*

- *Nuk ka raporte të problemeve/ incidenteve dhe aksesit të paautorizuar.*

- *Nuk ka Procedura formale për ruajtjen e dokumenteve, politikat e vazhdimësisë së punës dhe rimëkëmbjes për proceset kritike.*

- *Në sistemin e administrimit të taksave TAIS të Bashkisë Vlorë back-up i DB kryhet manualisht, çdo 1 muaj.*

- *Sistemin e administrimit të taksave TAIS të Bashkisë Vlorë nuk ka plan të miratuar emergjence dhe politika të vazhdimësisë së punës dhe rimëkëmbjes për kritike, backup-i i bazës së të dhënave kryhet në të njëjtin ambient me bazën e të dhënave primare (ambienti i serverëve).*

Konfigurimet aktuale të Sistemit TAIS limtojnë specialistët në kryerjen e veprimeve si:

- *Shfaqjen e Pagesave sipas viteve përkatëse në momentin që ka kaluar viti fiskal.*

- *Shfaqjen e Postimeve të bëra jashtë fatit ligjor, raportet aktuale nuk nxjerr informacionin e kërkuar.*

- *Shfaqjen e Debitit në vitet e kaluara pasi hidhen pagesa të vazhdueshme për zërin debi.*

- Siguria Fizike e pajisjeve Server dhe Network

Siguria e infrastrukturës network në Sistemin e administrimit të taksave TAIS të Bashkisë Vlorë është e kompromentuar si rezultat i mungesës së Active Directory dhe Domain Controller për

menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qëndrueshëm të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet e praktikave me të mira të fushës.

- Ambiente të pa përshtatshme për zhvillimin e infrastrukturës IT

Ambienti fizik i dhomës së rrjetit nuk është në përputhje me praktikave me të mira si dhe standardet e përcaktuara në Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit) përkatësisht:

d. Pika 4.3. Parandalimi i zjarrit.

Dhoma duhet të jetë e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit.

Dhoma duhet të jetë rezistente ndaj zjarrit nëse kabllot dhe sistemet e ftohjes kombinohen në të njëjtën hapësirë sipër tavanit ose nën dysheme.

e. Pika 4.5. Sistemi Elektrik. Instalimi elektrik i dhomës së serverëve nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm.

f. Pika 4.6. Sistemi i Alarmit. Mungon sistemi i alarmit. Duhet të jenë të tillë që të sinjalizojnë problemet me rrymën elektrike, me ambientin fizik, sensor për rrjedhjen e ujit, sensor për parandalimin e dëmtimeve fizike të strukturës së dhomës.

- Mbi verifikimin në sistemin e taksave dhe tarifave vendore (TAIS) të veprimeve të krijuara në lidhje me veprimet e stornimeve (Credit Note).

Nga auditimi i sistemit të taksave dhe tarifave vendore (TAIS) në Bashkinë Vlorë, rezultoi se për periudhën e auditimit nga data 01.01.2021 deri 31.12.2022 janë kryer veprime stornimi (Credit Note) nga specialistët e pranimit/vlerësimit në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifave vendore të subjekteve fizik/juridik të regjistruara në këtë sistem.

Këto veprime stornimi u kryqëzuan me Inventarin e Procesverbaleve për çdo veprim stornimi, nga të cilat rezultoi se për **361 stornime** në sistemin TAIS nuk janë mbajtur procesverbale për **10 Credit Note**.

Sipas urdhrin të Brendshëm nr. 78, datë 08.04.2021 për ngritjen e Komisionit për miratimin e Stornimeve në Sistemin TAIS, specialistët e pranimit duhet të mbajnë procesverbale për çdo Credit Note.

Nga auditimi u konstatua se të gjithë përdoruesit me Atributin full user mund të kryejnë credit Note dhe Stornime në sistem.

Në sistemin TAIS specialistët e pranimit ngarkojnë në formatin PDF Procesverbalet e mbajtura pas stornimit në sistem, nga auditimi u konstatua se hedhja e tyre në sistem ishte fakultative jo e detyrueshme për të gjitha Kredit Notet.

- Mbi konstatimin e parregullsive të veprimeve të krijuara nga specialistët e pranimit në sistemin TAIS

Nga verifikimi i të dhënave në raportet e gjeneruara nga sistemi TAIS u konstatua se ekzistonin raste të konsiderueshme të veprimeve të kryera për ngarkesat me taksa dhe tarifave vendore jashtë periudhave ushtrimore dhe me vonesë në disa raste edhe mbi dy vjet, ndërkohë që këto ngarkesa dhe njoftim vlerësimit/faturimet sipas VKB-ve të miratimit të paketave fiskale, duhet të kryeshin deri në muajin prill të vitit ushtrimor. Për rrjedhojë kjo ka shkaktuar eliminimin e të drejtës së

llogaritjes së kamatëvonesave për detyrimet e papaguara, **përgjegjësi direkte e specialistëve të DAV-së.**

Veprimet e mësipërme nga DAV-së sjellin vështirësi për alokimin e taksave dhe aplikim të kamatëvonesave të panevojshme, duke krijuar një borxh të keq për bashkinë Vlorë dhe çuar drejt të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni nr.4 “Zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin nr.68 “Vlerësimi tatimor”, nenin nr.69 “Njoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën e detyrimit tatimor”, nenin nr.114 “Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit”, si dhe me “Rregulloren e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë”, neni 104 “Drejtori i Drejtorisë së Regjistrimit, vlerësimit tatimor, mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore”, neni 105 “Sektori i pranimit dhe kontabilitetit tatimor”, neni 106 “Detyrat dhe përgjegjësitë e Specialistit të vlerësimit të detyrimit tatimor për biznesin”.

- Mbi konstatimin e parregullsive në veprimet e krijuara nga specialistët e pranimit në sistemin TAIS .

Subjektet e regjistruara të cilat janë konstatuar se ju është bërë vlerësimi tatimor jo në momentin e duhur, kanë rezultuar për arsye të mungesës së dokumentacionit për këto subjekte, po nuk është shmangur kamatëvonesa për detyrimet që arkëtoheshin me vonesë, pasi pas pagesës sistemi gjeneron edhe kamat vonesa. Nga auditimi rezulton se ka subjekte të cilëve njoftim vlerësimi për detyrimet ju ka shkuar jashtë afatit të miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë. Kjo pasojë ka ardhur si shkak i mospasjes së dokumentacionit ligjor edhe pse ju është dërguar njoftim zyrtar me e-mail apo janë kontaktuar edhe nga inspektorët e terrenit të gjitha këto subjekte.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4 “Zbatimi i sistemit tatimor në R.Sh”, ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 68 “Vlerësimi tatimor”, nenin 69 “Njoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën e detyrimit tatimor”, neni 114 “Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit”, si dhe me “Rregulloren e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë”, neni 104 “Drejtori i Drejtorisë së Regjistrimit, vlerësimit tatimor, mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore”, neni 105 “Sektori i pranimit dhe kontabilitetit tatimor”, neni 106 “Detyrat dhe përgjegjësitë e Specialistit të vlerësimit të detyrimit tatimor për biznesin” .

Subjekte të ngarkuara jashtë afatit të caktuar evidentuar dhe në sistemin TAIS

Nr	Kodi	Emri i Subjektit	Përshkrimi	Përshkrimi i aktivitetit	Statusi	Rajoni
1	C12858	E. 2007	Sherbime Komplekse	Biznes I Vogel	Aktiv	R.P2
2	C11701	A. T.	Tregeti Inpute Bujqesore	Tregti Biznes I Vogel	Aktiv	D.N.Q
3	C05210	E.-V.	Firme Ndërtimi	Biznes I Madh	Aktiv	Omr1
4	C12856	S. P.	Firme Ndërtimi	Tregti Biznes I Madh	Aktiv	R.P1
5	C12857	E. M.	Sherbime Informatike/Sh	Sherbim Biznes I Vogel	Aktiv	R.P2
6	C12963	S. F.	Mjet transporti	Biznes i madh	Aktiv	D.nTr
7	C45450	D. B.	Tregti artikujsh ushqimore	Tregti biznes i vogel	Aktiv	R.P.2
8	C13137	B. H.	Mjet transporti	Peshkim shërbim biznes i vogel	Aktiv	D.N.TR

Nr	Kodi	Emri i Subjektit	Përshkrimi	Përshkrimi i aktivitetit	Statusi	Rajoni
9	C01676	G.-Xh. D.	Tregti artikuj te ndryshëm	Tregti Biznes i madh	Aktiv	E_c R.3
10	C12990	F. H.	Servis	Sherbim biznes i vogel	Aktiv	E_CR.3
11	C12892	S. H.	Tregti artikuj ushqimore	Tregti biznes i madh	Aktiv	O.M.r.1
12	C12898	E. Q.	Tregti vajrash	Tregti Biznes i Vogel	Aktiv	O.M.R.4
13	C12922	G. I.	Qendër estetike	Sherbim Biznes i vogel	Aktiv	E_sh.R.5
14	C11678	E. Rr.	Tregti veshjesh	Tregti Biznes i Vogel	Aktiv	E.cr.3
15	C12975	E. H.	Shitblerje automjetesh	Tregti Biznes i Vogel	Aktiv	E.SH.r5
16	C12976	A. M.	Tregti artikujsh ushqimore	Biznes i Vogel	Aktiv	D.N.N
17	C12997	E. B.	Market	Biznes i vogel	Aktiv	H_K
18	C09674	N. D.	Bar kafe	biznes i vogel	Aktiv	H.K
19	C1309	N. D.	Tregti artikuj t ndryshëm	biznesi i vogel	Aktiv	E.C.R
20	C03188	G. L.	Tregti gazi	biznes i vogel	Aktiv	E.SH.R
21	C12864	K. L.	Investitor ndërtimi	Biznes i vogel	Aktiv	R.P2

Gjithashtu nga auditimi i dosjeve fizike (2021-2022), u konstatuan mangësi si më poshtë:

- *Ekzistojnë raste të cilat subjektet edhe pse rezultojn aktive ishin të pa ngarkuara për periudhat ushtrimore objekt auditimi.*
- *Ka raste të cilat subjektet edhe pse rezultojn aktive ishin të pa ngarkuara për periudhat ushtrimore objekt auditimi, pra mungonin njoftim vlerësimet për ngarkesat.*

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: **z. D. L.**, me detyrë ish-Kryetar i Bashkisë Vlorë; **znj. R. P.**, me detyrë specialiste pranim-vlerësimi; **znj. O. M.**, me detyrë specialiste pranim-vlerësimi; **znj. D. N.**, me detyrë specialiste pranim-vlerësimi; **znj. E. C.**, me detyrë specialiste pranim-vlerësimi; **znj. E. Sh.**, me detyrë specialiste pranim-vlerësimi; **znj. H. K.**, me detyrë specialiste pranim-vlerësimi.

Titulli gjetjes: Mungesë e masave organizative dhe teknike në lidhje me sigurinë e të dhënave.

Situata: Nga filtrimi i tabelave të databases vlera e kolonës identifikuese nuk është parashikuar të jetë me format të unifikuar.

- Useri i SA i databasës së sistemit TAIS nuk ka një password autentifikimi.
- Nuk ka raporte të problemeve / incidenteve dhe aksesit të paautorizuar.
- Nuk ka Procedura formale për ruajtjen e dokumenteve, politikat e vazhdimësisë së punës dhe rimëkëmbjes për proceset kritike.
- Në sistemin e administrimit të taksave TAIS të Bashkisë Vlorë back-up i DB kryhet manualisht, çdo 1 muaj.
- Sistemin e administrimit të taksave TAIS të Bashkisë Vlorë nuk ka plan të miratuar emergjence dhe politika të vazhdimësisë së punës dhe rimëkëmbjes për kritike, backup-i i bazës së të dhënave kryhet në të njëjtin ambient me bazën e të dhënave primare (*ambienti i serverëve*).

Kriteri: Ligji 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”; Neni 27, Ligji Nr. 9887, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekt: Risk për ndërhyrje të jashtme, me pasojë dëmtimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Risk për kryerjen e veprimeve në sistem nga persona të paautorizuar.

Risk për mos-evidentimin dhe mos-parandalimin e problematikave që lidhen me sigurinë e të dhënave.

Shkaku: Përgjegjësi e inspektorëve personave përgjegjës në zbatimin e kuadrit ligjorë.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe strukturën e teknologjisë së informacionit Bashkia Vlorë, të marrin masa për:

- Analizimin e hollësishëm të të gjithë përdoruesve aktivë të sistemit TAIS që ka në përdorim Bashkia Vlorë me të drejta në sistem sipas pozicioneve të punës.

- Hartimin dhe miratimin e një politike të mirë dokumentuar për analizimin periodik të gjurmëve të auditimit të veprimeve të kryera në sistemet IT me qëllim evidentimin dhe parandalimin e problematikave të mundshme në lidhje me mirëfunksionimin dhe mirë përdorimin e sistemeve IT.

- Për vendosjen e një fjalëkalimi për userin Administrator të databazes së sistemit TAIS.

- Ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat.

Titulli gjetjes: Mungesë konfigurimesh për përshtatjen e sistemit me nevojat e Subjektit.

Situata: Konfigurimet aktuale të Sistemit TAIS limitojnë specialistët në kryerjen e veprimeve si: Shfaqjen e Pagesave sipas viteve përkatëse në momentin që ka kaluar viti fiskal.

Shfaqjen e Postimeve të bëra jashtë fatit ligjor, raportet aktuale nuk nxjerr informacionin e kërkuar.

Shfaqjen e Debisë në vitet e kaluara pasi hidhen pagesa të vazhdueshme për zërin debi.

Kriteri: Standardet ndërkombëtare të TI dhe praktikat më të mira.

Ndikimi/Efekti: Risk në mos identifikimit të parregullsive që mund të ndodhin në sistem.

Shkaku: Përgjegjësi e inspektorëve personave përgjegjës në zbatimin e kuadrit ligjorë.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Strukturën e Teknologjisë së Informacionit të listojnë mangësitë e sistemit për nxjerrjen e raporteve të nevojshme dhe më pas të komunikojnë me kontraktuesin e mirëmbajtës së sistemit për përmirësimin e funksionaliteteve të sistemit.

Titulli gjetjes: Siguria sistemit të administrimit të taksave TAIS të Bashkisë Vlorë është e kompromentuar si rezultat i mungesës së ambienteve të pa përshtatshme për zhvillimin e infrastrukturës IT.

Situata: Ambienti fizik i dhomës së rrjetit nuk është në përputhje me praktikat më të mira si dhe standardet e përcaktuara në Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit) përkatësisht:

d. Pika 4.3. Parandalimi i zjarrit.

Dhoma duhet të jetë e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit

Dhoma duhet të jetë rezistente ndaj zjarrit nëse kabllot dhe sistemet e ftohjes kombinohen në të njëjtën hapësirë sipër tavanit ose nën dysheme.

e. Pika 4.5. Sistemi Elektrik. Instalimi elektrik i dhomës së serverëve nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm.

f. Pika 4.6. Sistemi i Alarmit. Mungon sistemi i alarmit. Duhet të jenë të tillë që të sinjalizojnë problemet me rrymën elektrike, me ambientin fizik, sensor për rrjedhjen e ujit, sensor për parandalimin e dëmtimeve fizike të strukturës së dhomës.

Kriteri: Garantimi i sigurisë fizike dhe ambientale nuk është në përputhje me kërkesat për siguri dhe me klasifikimin e sensitivitetit të aseteve IT.

Ndikimi/Efekti: Shkelje të sigurisë, humbje të informacionit.

Shkaku: Mos krijimi i ambientit fizik në përputhje me praktikën me të mira si dhe standardet e përcaktuara në udhëzimet e AKSHI-t. Mos zbatim i standardeve e praktikave më të mira të fushës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Kryetari i bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatimeve dhe Tarifave Vendore, Bashkia Vlorë dhe Strukturën e Teknologjisë së Informacionit, të marrë masa për ndërtimin e ambienteve të dhomave të serverave në përputhje me praktikën më të mira si dhe standardet e përcaktuara në bazë të VKM nr. 248, datë 27.04.2007 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” dhe Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK.

Titulli gjetjes: Mbi verifikimin në sistemin e taksave dhe tarifave vendore (TAIS) të veprimeve të krijuara në lidhje me veprimet e stornimeve (Credit Note).

Situata: Nga auditimi i sistemit të taksave dhe tarifave vendore (TAIS) në Bashkinë Vlorë rezultoi se për periudhën e auditimit nga data 01.01.2021 deri 31.12.2022 janë kryer veprime stornimi (Credit Note) nga specialistët e pranimit/vlerësimit në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifave vendore të subjekteve fizik/juridik të regjistruara në këtë sistem.

Këto veprime stornimi u kryqëzuan me procesverbalet e mbajtura për çdo veprim stornimi, nga të cilat rezultoi se nga **361** stornime në sistemin TAIS nuk janë mbajtur procesverbale për **10 stornime**.

Në sistemin TAIS specialistët e pranimit ngarkojnë në formatin PDF procesverbalet e mbajtura pas stornimit në sistem, nga auditimi u konstatua se ngarkimi i tyre në sistem ishte fakultative jo e detyrueshme për të gjitha Kredit Notet.

Kriteri: Në kundërshtim me Urdhri i Brendshëm Nr.78 datë 08.04.2021 për ngritjen e Komisionit për miratimin e Stornimeve në Sistemin TAIS, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni nr. 4/26; Ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”, neni nr. 3; Udhëzimi e MF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 35 “Dokumente të kontabilitetit”, pika nr. 36.

Ndikimi/Efekti: Deformim i detyrimeve financiare pa lënë gjurmë nëpërmjet procesverbaleve

Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit, i ligjit për mbajtjen e dokumenteve elektronike, gjurmës së auditimit, mungesa e një rregullore të brendshme për mbajtjen e procesverbaleve.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Vlorë (*strukturat përgjegjëse*), të marrë masa që ngarkimi i procesverbaleve për stornimet në sistem duhet të jetë e standardizuar për të gjithë procesverbalet dhe të mos lejimin në kryerjen e asnjë stornimi pa dokumentacionin e nevojshëm ligjorë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore Bashkia Vlorë, të marrin masa për:

- Rastet kur për ndryshimin e vlerës financiare (stornim), mungon dokumentacioni shkresor, të nxirren përgjegjësitë dhe të analizohet vlera financiare dhe dëmi i shkaktuar.
- Trajnimin e punonjësve të DTTV-së, me qëllim për të arritur përdorim korrekt, eficient dhe profesional të sistemit TAIS.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar janë paraqitur observacione përcjellë me shkresat nr 122001/1, datë 19.10.2023, nr 12715 datë 20.10.2023, nr 12715/1 datë 20.10.2023, nr.123421/1 datë 25.10.2023, datë 12201/2 datë 20.10.2023, datë 12197/2 datë 20.10.2023.

Pretendimi i subjektit:

Znj. D. N. sqaron se në vitin 2021 unë kam bërë 13 Credit Note secila prej tyre me procesverbal, i cili pasi ka marrë firmën nga eprori është uploaduar direkt në kartelën përkatëse.

Në vitin 2022 kam bërë 10 Credit Note secila prej tyre me procesverbal i cili pasi ka marrë firmën nga eprori është uploaduar direkt në kartelën përkatëse. Për rrjedhojë nuk kam asnjë credit note pa procesverbal i cili nuk është hedhur në sistem.

Znj.E. Sh. sqaron se gjatë periudhës së auditimit 01.01.2022-31-12-2022 kam kryer veprime në sistemin TAIS Stornime(Credit Note) ku të gjitha pa përjashtim janë pajisur me dokumentacionin përkatës pra me Proces Verbal sipas urdhrit Nr.78 datë 08.04.2021.

Pra asnjë Kreditnot nuk është hedhur në sistem në formatin PDF gjë të cilën e verifikoj me foto të sistemit me linket përkatëse. Po theksoj dhe jua kam bërë të ditur eprorëve që linket nuk hapen apo duken në sistem.

Znj. R. P. ka shprehur objeksionet si vijon: Nga data 01.01.2021-31.12.2022 sipas urdhrit të brendshëm Nr.78, datë 08.04.2021 për ngritjen e komisionit për miratimin e Stornimeve në sistemin TAIS specialistët e pranimit duhet të mbajnë procesverbal për çdo Credit Note, ju informoj se nuk kam asnjë Credit Note pa procesverbal, bashkëlidhur fotokopje e çdo stonimi me dokumentacionin justifikues.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Grupi auditimit sqaron se ngarkimi i procesverbaleve në sistem nuk duhet të jetë fakultative, por sistematike për të gjithë punonjësit të cilët kanë akses dhe kryejnë ndryshime në sistem në mënyrë që gjurma e auditimit të jetë e kompletuar.

Titulli gjetjes: Mbi konstatimin e parregullsive të veprimet e krijuara nga specialistët e pranimit në sistemin TAIS.

Situata: Nga verifikimi i të dhënave në raportet e gjeneruara nga sistemi TAIS u konstatua se ekzistonin raste të veprimeve të kryera për ngarkesat me taksa dhe tarifatat vendore jashtë periudhave ushtrimore dhe me vonesë në disa raste edhe mbi dy vjet, ndërkohë që këto ngarkesa

dhe njoftim vlerësimet/faturimet sipas VKB-ve të miratimit të paketave fiskale, duhet të kryheshin deri në muajin prill të vitit ushtrimor. Për rrjedhojë kjo ka shkaktuar eliminimin e të drejtës së llogaritjes së kamatëvonesave për detyrimet e papaguara, përgjegjësi direkte e specialistëve të DAV-së. Sistemi i merr automatikisht kamatat

Veprimet e mësipërme nga DAV-së sjellin vështirësi për alokimin e taksave dhe aplikim të kamatëvonesave të panevojshme, duke krijuar një borxh të keq për bashkinë Vlorë dhe çuar drejt të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë.

Subjekte të ngarkuara jashtë afatit të caktuar evidentuar dhe në sistemin TAIS

Nr	Kodi	Emri i Subjektit	Përshkrimi	Përshkrimi i aktivitetit	Rajoni
1	C12858	E. 2007	Sherbime Komplekse	Biznes I Vogel	R.P2
2	C11701	A. T.	Tregti Inpute Bujqësore	Tregti Biznes I Vogel	D.N.Q
3	C05210	E.-V.	Firme Ndërtimi	Biznes I Madh	Omr 1
4	C12856	S. P.	Firme Ndërtimi	Tregti Biznes I Madh	R.P2
5	C12857	E. M.	Sherbime Informatike/Sh	Sherbim Biznes I Vogel	R.P2
6	C12963	S. F.	Mjet transporti	Biznes i madh	D.nTr
7	C45450	D. B.	Tregti artikujsh ushqimore	Tregti biznes i vogel	R.P.2
8	C13137	B. H.	Mjet transporti	Peshkim shërbim biznes i vogel	D.N.TR
9	C01676	G.-Xh. D	Tregti artikuj te ndryshëm	Tregti Biznes i madh	E_c R.3
10	C12990	F. H.	Servis	Sherbim biznes i vogel	E_CR.3
11	C12892	S: H.	Tregti artikuj ushqimore	Tregti biznes i madh	O.M.r.1
12	C12898	E. Q.	Tregti vajrash	Tregti Biznes i Vogel	O.M.R.4
13	C11678	E. Rr.	Tregti veshjesh	Tregti Biznes i Vogel	E.cr.3
14	C12976	A. M.	Tregti artikujsh ushqimore	Biznes i Vogel	D.N.N
15	C12997	E. B.	Market	Biznes i vogel	H_K
16	C09674	N. D.	Bar kafe	biznes i vogel	H.K
17	C1309	N. D.	Tregti artikuj t ndryshëm	biznesi i vogel	E.C.R
18	C12864	K. L.	Investitor ndërtimi	Biznes i vogel	R.P2

Gjithashtu nga auditimi i dosjeve fizike (2021-2022), u konstatuan raste të cilat subjektet edhe pse rezultinin aktive ishin të pa ngarkuara për periudhat ushtrimore objekt auditimi.

Kriteri: Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni nr. 4 “Zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nr. 68 “Vlerësimi tatimor”, neni nr. 69 “Njoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën e detyrimit tatimor”, neni nr. 114 “Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit”, “Rregullore e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë”, neni 104 “Drejtori i Drejtorisë së Regjistrimit, vlerësimit tatimor, mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore”, neni 105 “Sektori i pranimit dhe kontabilitetit tatimor”, neni 106 “Detyrat dhe përgjegjësitë e Specialistit të vlerësimit të detyrimit tatimor për biznesin”...

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Vlorë, shmangie të detyrimeve financiare duke mos u aplikuar kamatëvonesat, cënim në listën e debitorëve pasi ngarkesat fiskale jashtë periudhës fiskale prekin debinin duke sjellë ndryshime të listës së debitorëve si në vlerë dhe në numër subjektësh.

Shkaku: Mos aplikimi nëpërmjet sistemit TAIS të kamatëvonesave sipas periudhës duke shkelur afatet kohore, mos njohje e plotë e legjislacionit të taksave dhe mos veprim i drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore, mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit, i ligjit për të ardhurat vendore, mos zbatim i rregullores së bashkisë.

Rëndësia:

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, të ngrejë një grup pune për të përlllogaritur efektin e dëmit të shkaktuar çdo biznesi, detyrimi i të cilit është vlerësuar jashtë afateve të përcaktuara nga vendimet e Këshillit të Bashkisë, si dhe të merren masat administrative për çdo specialist që ka kryer vlerësime jashtë afateve ligjore.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: znj. R. P., me detyre specialiste pranim-vlerësimi; **znj. O. M.**, me detyrë specialiste pranim-vlerësimi; **znj. D. N.**, me detyrë specialiste pranim-vlerësimi ; **znj. E. C.**, me detyrë specialiste pranim-vlerësimi ; **znj.E. Sh.**, me detyrë specialiste pranim-vlerësimi; **znj. H. K.**, me detyrë specialiste pranim-vlerësimi.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshti me shkresë nr. 11597, datë 27.10.2023 (prot KLSH nr. 1026/29, datë 3.11.2023) “Mbi Projektraportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Nga specialistja znj. R. P. është kundërshtuar se:

I. Nga data 01.01.2021-31.12.2022 sipas urdhrorit të brendshëm Nr.78, datë 08.04.2021 për ngritjen e komisionit për miratimin e Stornimeve në sistemin TAIS specialistët e pranimit duhet të mbajnë procesverbal për çdo Credit Note, ju informoj se nuk kam asnjë Credit Note pa procesverbal, bashkëlidhur fotokopje e çdo stonimi me dokumentacionin justifikues.

II. “Në lidhje me stornimet (credit note), nga ana e audituesve të KLSH ju është kërkuar çdo specialisti vlerësimi tatimor, të nxjerrë sipas formatit të mëposhtëm... nuk është dhënë asnjë informacion, duke mos bashkëpunuar me audituesit për veprimet e kryera nga ana juaj.” Ju bëj me dije se sikurse është cituar në projekt-raport nuk kam qenë në dijeni të formatit të kërkuar. Gjithashtu për shkak të raportit të barrë lindjes unë nuk kam më akses në sistemin TAIS, dhe asnjë raport nuk mund të përpunohet nga ana ime, vetëm kopjet fizike të procesverbaleve po ju dorëzoj. Në lidhje me auditimin e dosjeve fizike, “dosjet fizike që janë kontrolluar nga audituesi i KLSH-së janë marrë rastësore në ambientet e drejtorisë në praninë tuaj dhe ju është komunikuar parregullsisia e tyre...” Dosjet fizike nuk janë audituar në praninë time gjatë periudhës nga data 01.11.22-03.02.23 që kam qenë prezent në punë. Por pas 06.02.2023-17.02.2023 që unë kam qenë me leje të zakonshme të prapambetur nga viti 2022 (bashkëlidhur shkresa nr.1) dhe nga data 20.02.2023 jam me leje lindje (bashkëlidhur shkresa nr.2). Nga kjo periudhë vlerësimi tatimor, inventari fizik i dosjeve është detyrë e specialistit znj. B. I.

Nga spec. E. Sh., është kundërshtuar se të gjitha veprimet janë kryer me dokumentacion mbështetës, ku asnjë kreditnot nuk është pa PV të pasqyruar në sistem PDF (shoqëruar me foto sistemi). Por siç kamë bërë me dije dhe eprorët e mi, linket e PV nuk hapen apo duken në sistem. Kështu në lidhje me ngarkesën jashtë afateve sqarojë se subjekti “G. I. është paraqitur vetë pranë DAV me dt. 21.2.2022 për të tërhequr detyrimin tatimor. Ky subjekt është hapur dt. 11.12.2020, por nisur nga fakti se DAV nuk është online me QKB, praktika ka ardhur me një muaj vonesë. Faturimi është bërë dt. 21.2.2022. kontrolli terren dt. 3.3.2022.

Subjekti “E. H. nuk është faturuar me vonesë, pasi subjekti ka qenë PASIV në DAV dhe bërë aktiv dt. 29.3.2021. sipas AK nr. 139, dt. 7.10.2021 subjekti është faturuar në vijimësi.

Subjekti “G. L.”. Sipas AK nr. 568, dt. 21.2.2022 subjekti është gjendur në punë dhe bërë aktiv dhe pse tek shënimet e sistemit thuhet nuk ushtron aktivitet. Nga ana jonë për asnjë moment nuk është shmangur kamatëvonesa.

Nga specialistja znj. D. N. është kundërshtuar se:

Sek. Pranimit ka marrë masa për vlerësimin në kohë të subjekteve, duke kërkuar dokumentacion ligjorë nëpërmjet e-mail zyrtarë. Vlerësimi tatimorë është bërë me vonesë pasi dhe dokumentacioni ka ardhur me vonesë nga vetë subjekti ose sek. Kontrollit terren. Vlerësimi tatimorë brenda 5 viteve është në referencë të nenit 73, kreu III të ligjit për procedurat tatimore. Me këtë argument kemi vepruar ndaja subjekteve të pataksuar duke mos lejuar të tillë.

Në lidhje me dosjet e subjekteve ato janë të plota dhe të inventarizuara.

Oëndrim i grupit të KLSH

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

Observacioni i paraqitur pranohen pjesërisht, pasi nga ana juaj nuk është paraqitur asgjë e re nga ato të paraqitura në fazën e akt konstatimeve. Në lidhje me mangësitë në inventarizimin e dosjeve nga grupi përzgjedhja është bërë e rastësishme për cdo inspektor.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar janë paraqitur observacione përcjellë me shkresat nr 122001/1, datë 19.10.2023, nr 12715 datë 20.10.2023, nr 12715/1 prot; datë 20.10.2023, nr.123421/1 prot; datë 25.10.2023, nr. 12201/2 prot; datë 20.10.2023, nr. 12197/2 prot; datë 20.10.2023:

Pretendim i subjektit:

znj. H. K. ka shprehur objeksionet si më poshtë:

Mbi verifikimin në sistemin TAIS nga grupi auditues për subjektet e ngarkuara jashtë periudhave ushtrimore ju bëj me dije se mbas njoftimit me email nga QKB për një subjekt të hapur rishtazi: Subjektit bëhet njoftim zyrtar, njoftim me email ose telefonatë për të paraqitur dokumentacion në lidhje me aktivitetin që ushton për të vazhduar më tej me ngarkesat e detyrimeve në sistem pasi mungesa e dokumentacionit si edhe mungesa e Akt-Kontrollit nga inspektorët e terrenit është pengesë për ngarkesat në sistem:

znj. O. M. ka shprehur objeksionet si më poshtë:

Vlerësimi tatimor me vonesë i subjekteve ka ardhur nga mungesa e dokumentacionit të nevojshëm për llogaritjen e taksës vendore. Duke qenë se nuk mund të nisët vlerësimi tatimor i reduktuar janë bërë kontrole të vazhdueshme tek subjekti deri sa është mbledhur dokumentacioni.

znj. R. P. ka shprehur objeksionet si më poshtë:

Gjithashtu për shkak të raportit të barrë lindjes unë nuk kam më akses në sistemin TAIS, dhe asnjë raport nuk mund të përpunohet nga ana ime, vetëm kopjet fizike të procesverbaleve po ju dorëzoj. Dosjet fizike nuk janë audituar në praninë time gjatë periudhës nga data 01.11.22-03.02.23 që kam qenë prezent në punë. Por pas 06.02.2023-17.02.2023 që unë kam qenë me leje të zakonshme të prapambetur nga viti 2022 (bashkëlidhur shkresa nr.1) dhe nga data 20.02.2023 jam me leje lindje (bashkëlidhur shkresa nr.2).

znj. D. N. ka shprehur objeksionet si më poshtë:

Mbi konstatimin e parregullsive të veprimeve e krijuara specialistet për faturimet jashtë afatit ligjor, ju sqaroj se: Sektori i pranimit ka marrë masa për të kryer vlerësimin tatimor në kohë , duke kërkuar dokumentacionin ligjor nëpërmjet e-mailit zyrtar, ne baze të urdhrave të punës për niptet e rinj. Vlerësimi tatimor është kryer me vonesë pasi dokumentacioni i nevojshëm për të kryer vlerësimin tatimor ka ardhur me vonesë qoftë nga vetë subjekti por dhe nga sektori i terrenit. Sektori i pranimit vlerëson në bazë dokumentacionit justifikues dhe në momentin që nuk e disponon atë nuk mund të bëjë një vlerësim tatimor jo të drejtë.

Oëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit merr pjesërisht në konsideratë observacionet dhe sqaron specialistët e pranimit se në tabelën e mësipërme është pasqyruar vetëm një kampion për subjektet e ngarkuar me vonesë. Nga analizi total i të dhënave të sistemit numri është shumë herë më i lartë, Grupi i auditimit në nxjerrjen e të dhënave është mbështetur në informacionin e marrë nga Sistemi TAIS.

- Mbi auditimin e të ardhurave nga kontratat e stacioneve të plazhit për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022”.

Nga auditimi, rezulton se tarifat, struktura dhe procedura për ndjekjen e tarifës së hapësirës publike për qëllime biznesi plazh, janë miratuar me VKB, respektivisht për vitin 2021 me VKB nr. 88, datë 24.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë ” dhe për vitin 2022 me VKB nr. 79, datë 02.12.2021 “Për disa ndryshime në VKB-në nr. 88, datë 24.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Vlera
1	Për zënien e hapësirave publike në plazhin e Nartës dhe Plazhin e Vjetër	400 lekë/m ²
2	Për zënien e hapësirave publike për të gjithë plazhet e tjerë përveç pikës 1	500 lekë/m ²

Në zbatim të paketës fiskale, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Vlorë, **z. D. L.**, nuk është ngritur komision për menaxhimin e stacioneve të plazhit, veprim i cili është kryer vetëm nga **znj. S. H.** me detyrë Drejtoreshë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, **veprime në kundërshtim me Kapitullin II, pika a/2, ku thuhet se:**

Autorizohet Kryetari i Bashkisë për ngritjen e një Komisioni për përcaktimin e sipërfaqeve të zënies së këtyre hapësirave.

Ky Komision të përcaktojë madhësinë dhe kohën e përdorimit të kësaj sipërfaqe.

Pagesa do të kryhet përpara lidhjes së kontratës apo akt marrëveshjes.

Plazhet publike menaxhohen sipas kërkesave dhe akt marrëveshjeve të lidhura nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve në bashkëpunim me Njësitë Administrative.

- Mbi të ardhurat e realizuara nga zbatimi i kontratave për shfrytëzimin e hapësirave të plazhit dhe pagesa e detyrimeve të subjekteve.

Referuar të dhënave të paraqitura nga **znj. S. H.** me detyrë Drejtoreshë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, rezulton se:

a- Përgjatë sezonit turistik të vitit 2021 ushtrojnë aktivitet “shfrytëzim të hapësirave për stacione plazhi”, me afat 1, 2 dhe 5 vjeçare, **por pa lidhur kontratë me bashkinë Vlorë**, si vijon:

- Kontrata me afat 1-vjeçar janë gjithësej **55** subjekte.
- Kontrata me afat 2 dhe 5-vjeçar janë gjithësej **90** subjekte.
- Sipërfaqe totale e plazhit e dhënë me qira për ushtrimin e aktivitetit stacion plazhi në zonën e Plazhit të Vjetër është **8228** .
- Sipërfaqe totale e plazhit e dhënë me qira për ushtrimin e aktivitetit stacion plazhi në zonën e Jonufër-Plazhi i Ri është **22924**.
- Sipërfaqe totale e plazhit e dhënë me qira për ushtrimin e aktivitetit stacion plazhi në zonën e Orikum-Radhimë është **27530**.

- Sipërfaqe totale e plazhit e dhënë me qira për ushtrimin e aktivitetit stacion plazhi në zonën e Zvërnecit është **24706**.

Shuma totale e mbledhur përgjatë sezonit turistik nga subjektet është vlera **32,339,160 lekë për një sipërfaqe të dhënë me qira gjithsej në shumën 83388 m²**.

b- Përgjatë sezonit turistik të vitit 2022 ushtrojnë aktivitetin “shfrytëzim të hapësirave për stacione plazhi”, me afat 1, 2 dhe 5 vjeçare, **por pa lidhur kontratë me bashkinë Vlorë**

- Kontrata me afat 1-vjeçar janë gjithsej **98** subjekte
- Kontrata me afat 2-5-vjeçar janë gjithsej **89** subjekte.
- Sipërfaqe totale e plazhit e dhënë me qira për ushtrimin e aktivitetit stacion plazhi në zonën e Plazhit të Vjetër është **16534**.
- Sipërfaqe totale e plazhit e dhënë me qira për ushtrimin e aktivitetit stacion plazhi në zonën e Jonufër-Plazhi i Ri është **30169**.
- Sipërfaqe totale e plazhit e dhënë me qira për ushtrimin e aktivitetit stacion plazhi në zonën e Orikum-Radhimë është **34762**.
- Sipërfaqe totale e plazhit e dhënë me qira për ushtrimin e aktivitetit stacion plazhi në zonën e Zvërnecit është **30182**.

Shuma totale e mbledhur përgjatë sezonit turistik nga subjektet e plazheve është arkëtuar një vlerë prej **38,906,336 lekë për sipërfaqen gjithsej të dhënë me qira prej 101647 m²**.

Nga të dhënat e mësipërme evidentohet fakti se nga viti 2021 në vitin 2022 kemi një rritje të vlerës së arkëtimit për vlerën 6,567,176 lekë (38,906,336 – 32,339,160), e cila vjen pasi kemi rritje të sipërfaqes së dhënë me qira prej 18,259 m² (101647 – 83388).

Sipas Drejtorit të Drejtorisë së Menaxhimit të Pronave Publike dhe Aseteve, znj. S. H., diferenca midis dy viteve vjen pasi nga personat posedues kanë në shfrytëzim më shumë sipërfaqe se ajo e miratuar. Por nga kryqëzimi i të dhënave të miratuara nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB) dhe sipërfaqeve faktike të faturuara të shoqëruar me lista nga Drejtoria e Aseteve, rezultojnë se ka mospërputhje për sipërfaqen, ku sipas AKB sipërfaqja e dhënë në përdorim për hapësira plazhi është 44382 m², ndërsa sipas bashkisë kjo sipërfaqe është 101647 m², pra me shumë për një sipërfaqe prej 57265 m².

Nga sa mësipërm nga bashkia janë miratuar më shumë sipërfaqe se sa është miratuar në AKB, veprime në kundërshtim me VKM nr. 171, datë 23.9.2019 për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së Stacionit të plazhit”, i ndryshuar, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi Drejtorinë e Aseteve si drejtoria që është e ngarkuar me menaxhimin e tyre.

Mbi zbatimin dhe rregullshmërinë e procedurave për lidhjen e kontratave për zënie të hapësirave të zonave të plazhit.

Për asnjë nga vitet objekt auditimi (2021-2022), nga ana e Kryetarit të Bashkisë Vlorë, z. D. L., nuk janë nënshkruar kontratat e miratuara nga AKB, kjo me pretendimin se stacionet e plazhit për të cilat janë lidhur kontratat kanë konflikte midis individëve dhe se për një pjesë të plazhit (vazhdim lungomares), nga qeveria janë parashikuar investime për ndërhyrje dhe nuk duhej dhënë dhe miratuar plazhe 2 dhe 5 vjeçare, konkretisht:

Me shkresën nr. 11831/1, datë 02/09/2021 të Kryetarit të Bashkisë adresuar AKB dhe Prefektit Qarku Vlorë është shpjeguar arsyeja e mosnënshtrimit të kontratave, si;

Së pari, konflikti midis personave që shfrytëzojnë plazhe për të cilën është kërkuar dhe takim i

përbashkët me AKB.

Së dyti, dhënia e hapësirave publike me persona me Nipti inekzistente (subjekti “K. S” dhe “T. M.”).

Së treti, si rezultat i rikualifikimit urban (Lungomare 3), segmenti nga tuneli deri tek postblloku Pashalimanit, kontratat janë lidhur për një periudhë 2-5 vjeçare, dhe si do veprohet me këto subjekte që do ju priset vendi i biznesit.

Me shkresën nr. 1408/2 *prot*, datë 17/09/2021 të AKB, në vijim të korrespondencës me Bashkinë Vlorë (shkresa nr. 11831/1 *prot*, datë 02/09/2021), informon se:

Në zbatim të VKM nr. 569, datë 17/07/2019 “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të AKB”, i ndryshuar, VKM nr. 1172, datë 24/12/2020 “për disa ndryshime në VKM nr. 171, datë 23.9.2019 për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së Stacionit të plazhit”, i ndryshuar, AKB ka vijuar me nënshkrimin e kontratave pas miratimit përfundimtar në Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve (GTSHA), sipas formatit të kontratës **dhe në bazë të planvendosjen së parcelave të përgatitura nga vetë njësia vendore (Bashkia Vlorë), duhet të vijoje me nënshkrimin e kontratës në zbatim të nenit 14, pika 8/12/a/b e VKM nr. 1172/2020**, ku thuhet se:

Dorëzimi i hapësirave të plazhit bëhet, si vijon:

a- Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës, topografi i njësive përkatëse të vetëqeverisje vendore ndan me **procesverbal** në terren koordinatat e Stacionit të plazhit dhe njofton Policinë Bashkiake për monitorimin e veprimtarisë.

b- Një kopje e procesverbalit depozitohet pranë zyrës qendrore të AKB, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga momenti i nënshkrimit.

Në lidhje me takimin sqaruar, nga AKB thuhet se nuk është marrë një kërkesë e tillë.

Në lidhje me pretendimet për “Lungomaren 3”, është sqaruar se përcaktimi i afatit të kontratave nuk vendoset nga AKB, por në referencë të VKM nr. 1172/2020, si dhe pas shqyrtimit të GTSHA. Në këto kushte AKB është përgjegjës për nënshkrimin e kontratës me subjektin dhe njësien vendore.

Referuar VKM nr. 1172, datë 24/12/2020 për disa ndryshime në VKM nr. 171, datë 27.3.2019 të KM për miratimin e rregullores..., harta e stacioneve të plazhit sipas tipologjisë së tyre miratohet nga Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik, bazuar në propozimet e njësive vendore (në rastin konkret të Bashkisë Vlorë), respektivisht pika 4 dhe 5 e VKM, ku thuhet se:

Pika 4. Detyrat e Komitetit të menaxhimit të Sezonit Turistik.

a- Miratimi i listës së plazheve dhe i hartës së stacioneve të plazheve, sipas tipologjisë së tyre, si dhe plazheve publike, bazuar në propozimet e njësive vendore, të cilat paisen me numër të veçantë identifikimi, që publikohet në momentin e aplikimit.

b- Monitorimi i mbarëvajtjes së sezonit turistik, si dhe koordinimi ndërstetoril për respektimin e masave dhe të detyrimeve të cdo institucioni përgjegjës, sipas detyrave funksionale respektimin e masave dhe të detyrimeve të cdo institucioni përgjegjës.

Për sa është parashtruar nga vetë Bashkia Vlorë duhej paraqitur pranë Komitetit të Menaxhimit të Sezonit Turistik, problematika e projektit “Lungomare 3”.

Gjithashtu, Bashkia Vlorë, me shkresën nr. 6132/2 *prot*, datë 18.7.2022 i është drejtuar AKB për mos nënshkrim kontratash në referencë të VKM nr. 171/2019, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së sezonit turistik”, të VKM nr. 424, datë 27.5.2020 për një ndryshim në VKM nr. 171/2019, datë 27.3.2019 dhe VKM nr. 1172, datë

24.12.2020 për një ndryshim në VKM nr. 171/2019, datë 27.3.2019, si dhe VKM nr. 827, datë 24/12/2021 për një ndryshim në VKM nr. 171/2019, datë 27.3.2019, pasi janë hasur probleme si rezultat i miratimit të dy ose më shumë subjekteve në të njëjtën parcelë pa marrë mendimin paraprak nga Bashkia Vlorë, si njohëse e territorit.

Gjithashtu në dosje nuk është e depozituar kontrata ku bashkëlidhur duhet të jetë planvendosjen e miratuar, mandat pagesën me sipërfaqet përkatëse dhe kontratën e lidhur midis subjektit privat dhe vrojtuesit të plazhit, **në kundërshtim me pikën 10 germa (iii) të VKM nr. 1172, datë 24/12/2020**, ku thuhet se:

*Pas plotësimit të dokumentacionit shtesë si mësipërm GTSHA miraton në portalin e-Albania aplikimin përkatës dhe AKB njofton menjëherë subjektin dhe NJVV për nënshkrimin e kontratës sipas formatit bashkëlidhur. **Para nënshkrimit të kontratës, subjekti duhet të paraqesë marrëveshjen e noterizuar me vrojtuesin e plazhit (shoqëruar me certifikatë përkatëse të kualifikimit), e vlefshme për gjithë sezonin.***

Në përgjigje të shkresës së Bashkisë Vlorë nr. 6132/2 prot, datë 18/07/20022, AKB me shkresën nr. 1199/1, datë 27/06/2022, sqaron bashkinë Vlorë si vijon:

Bazuar në VKM nr. 171/2019, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë s sezonit turistik”, sqarohet se GTSHA vijon me miratimin përfundimtar të aplikimeve të subjektit për ushtrimin e veprimtarisë **pas procesit të negocimit të subjektit dhe një njësisë vetëqeverisjes vendore (NJVV), duke proceduar më pas me gjenerimin e planvendosjen dhe mandatpagesës nga NJVV, përkatësisht lëshuar nga Bashkia Vlorë. Pra dashur padashur bashkia është bërë pjesë e këtyre parregullsive që ajo vetë pretendon, pasi nëse qëndronte e vërtetë fati që miratimi i plazheve nga AKB janë me probleme, ajo nga ana e sajë (bashkia), nuk duhej të prodhonte (lëshonte), mandat pagesë për pagesën e Statcionit të plazhit, pasi së cilës AKB ka vajuar me procedurat e mëtejshme në miratimin e zonës dhe lidhur kontratën nga ana e sajë (AKB dhe GTSHA), si palë përfitues, konkretisht:**

Neni 10. GTSHA për shqyrtimin e kërkesave ndjek këtë rrugë:

a- Shqyrton dokumentacionin e paraqitur, sipas pikës 9 të këtij neni dhe në rast se konstatohet mungesë apo paqartësi në dokumentacion, njofton menjëherë subjektin nëpërmjet portalit a-Albania për afatin dhe plotësimin e dokumentacionit.

b- Në rast se subjekti nuk i plotëson kriteret sipas pikës 7 të këtij neni dhe/ose dokumentacioni pa kërkesës për plotësim, mbetet i paplotësuar brenda afatit të kërkuar, GTSHA-ja refuzon përfundimisht kërkesën nëpërmjet portalit e-Albania.

c- Nëse subjekti plotëson kriteret e pikës 7 të këtij neni, GTSHA-ja njofton subjektin apo nëpërmjet portalit e-Albania dhe njofton elektronikisht AKB dhe NJVV me qëllim plotësimin e dokumentacionit shtesë, si vijon:

i- Planvendosjen përkatëse për sipërfaqen konkrete të miratuar të Statcionit të plazhit, pas negocimit ndërmjet subjektit të kualifikuar dhe NJVV që do jepet për shfrytëzim si Statcion plazhi, përfshirë dhe brezin e shërbimeve, sipas rastit të miratuar nga të dyja palët.

*ii- Gjenerimin e mandat pagesave vjetore të sipërfaqes së Statcionit të plazhit nga NJVV si palë përfitues, sipas tarifave të miratuara me VKB, **ku të detajohet detyrimi financiar vjetor për përdorimin e sipërfaqes së Statcionit të plazhit dhe për ngritjen e shfrytëzimit e strukturës së shërbimit, sipas rastit, si dhe vërtetimi mbi pagesën nga subjekti.** Në rastin e kontratave disavjeçare, NJVV është përgjegjëse për mbledhjen e detyrimeve të qirasë cdo vit, përpara fillimit të sezonit turistik pasardhës. NJVV njofton zyrtarisht AKB për statusin e detyrimeve nga subjektet me të cilat është lidhur kontrata. **Mos pagesa e detyrimeve është shkak për zgjidhje të kontratës.***

Në zbatim të VKM-së nr. 171/2019, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së sezonit turistik”, me ndryshime, Bashkia Vlorë ka detyrimin ligjorë për nënshkrimin e kontratës dhe ndarjen me procesverbal në terren të koordinatave të Stacionit të plazhit (dokumentacion i cili në dosje e kontratave nuk ekziston), brenda 10 ditëve nga nënshkrimi, respektivisht:

- a- Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës, topografi i njësisë përkatëse të vetëqeverisje vendore ndan me **procesverbal** në terren koordinatat e Stacionit të plazhit dhe njofton Policinë Bashkiake për monitorimin e veprimtarisë.
- b- Një kopje e procesverbalit depozitohet pranë zyrës qendrore të AKB, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga momenti i nënshkrimit.

Në auditimin e ushtruar në dokumentacionin bashkëshoqërues të kontratave të dhënies me qera të hapësirave të plazhit, u krye kampionimi në të gjitha dosjet që disponon Drejtoria e Menaxhimit të Pronave Publike dhe Aseteve Bashkia Vlorë, të cilat kanë kryer pagesa hapësirë për stacion plazhi për vitet 2021-2022, ku u konstatuan këto mangësi:

- Të gjitha dosjet nuk kishin të depozituar kopjen e kontratës së lidhur ndërmjet AKB, subjektit posedues të plazhit dhe Bashkia Vlorë, **gjë e cila e bën të pamundur zbatimin e kushteve të kontratës, si vijon:**

- a- **Zbatimin e nenit 3, pika 3 dhe 4 e kontratës ku thuhet:** 3. Të paktën 6 (gjashtë) muaj para përfundimit të afatit, qiramarrësi i dërgon qiradhënësit një kërkesë për rinovimin e kontratës, duke shoqëruar kërkesën e tij me dokumentacionin e përcaktuar në nenin 12, të rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit, në lidhje me zbatimin e rregullt të kushteve dhe kritereve për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit.
4. Qiradhënësi miraton/refuzon kërkesën e qiramarrësit për rinovimin e kontratës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës të shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
- b- **Zbatimin e nenit 4 pika 1 të kontratës, ku thuhet se Qiradhënësi dorëzon, brenda [•] ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, hapësirën e plazhit të përcaktuar në pikën 1, të saj, të lirë për t'u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet procesverbal i dorëzimit të hapësirës së plazhit që jepet me qira, i cili është pjesë përbërëse e kontratës**
- c- **Zbatimin e nenit 5 pikat:**
3. Qiramarrësi detyrohet të paguajë detyrimin mujor të qirasë brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë. Për çdo ditë vonese do të paguajë një kamatë ditore prej 0.1% të vlerës së qirasë mujore.
6. Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë me nënqira hapësirën e plazhit të marrë me qira sipas kontratës.
7. Qiramarrësi detyrohet të ketë të punësuar vrojtues plazhi përgjatë gjithë sezonit të ushtrimit të veprimtarisë së plazhit.
- d- **Zbatimin e nenit 6 pikat:**
3. Para nënshkrimit të kontratës, qiramarrësi ka paguar garancinë e kontratës, e cila është e barabartë me vlerën e 1 (një) muaji të qirasë, sipas faturës së lëshuar nga qiradhënësi, e cila qëndron e ngurtësuar, në llogarinë përkatëse të qiradhënësit, deri në përfundimin e kësaj kontrate.

- Mos depozitimi në dosje i vërtetimit mbi pagesën e taksave lokale nga DAV Bashkia Vlorë dhe detyrimeve fiskale nga DPTR Vlorë dhe jo vetëm, si dhe vërtetimi që nuk është në ndjekje penale, në kundërshtim me shkronja (d,dh) të pikës 3 e nenit 5 të VKM nr. 171/2019, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së sezonit turistik”, me ndryshime.

Për vitin 2021 nuk ishte depozituar asnjë vërtetim për detyrimet tatimore (mbi pagesën e taksave lokale dhe detyrimeve nga Administrata tatimore Vlorë (DRT Vlorë). Ndërsa për vitin 2022 janë depozituar disa vërtetime, por vetëm nga DAV Bashkia Vlorë, të cilat janë pasqyruar më poshtë

dhe jo nga DRT Vlorë.

- Asnjë nga dosjet e periudhës 2021-2022 **nuk ishin të shoqëruar me planvendosjen**, kjo për të mundësuar madhësinë e parcelës dhe pozicionimin e çadrave për largësinë ndërmjet tyre, bregut dhe pjesës së plazhit publik në raste ku ato janë pranë, veprime në kundërshtim me shkronjat (a, b,c)⁷ të pikës 1 e nenit 6 të VKM nr. 171/2019, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë s sezonit turistik”, me ndryshime.

-**Mungon procesverbali mbi dorëzimin e sipërfaqes së kontraktuar**, në kundërshtim me VKM nr. 171/2019, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë sezonit turistik”, i ndryshuar me VKM nr. 1172, datë 24/12/2022, ku thuhet se:

8. Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. Dorëzimi i hapësirës së plazhit bëhet, si më poshtë vijon:

a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës, topografi i njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore ndan me procesverbal në terren koordinatat e stacionit të plazhit dhe njofton policinë bashkiake për monitorimin e veprimtarisë;

b) një kopje e procesverbalit depozitohet pranë zyrës qendrore të AKB-së brenda 10 (dhjetë) ditëve nga momenti hartimit të tij.”.

-Mungojnë dokumenti mbi detyrimin për plotësimin e masave të sigurisë dhe të kushteve të higjienës, si dhe harta me treguesit kryesorë për sipërfaqen e kontraktuar.

-Për aktivitetin e vitit 2021, në asnjë rast, pjesë e dosjes nuk ishin aktet e kontrollit për verifikimin në terren nëse sipërfaqet që shfrytëzohen janë në përputhje me sipërfaqet e kontraktuara, si dhe nëse është ruajtur raporti 80% sipërfaqe e shfrytëzueshme dhe 20 % sipërfaqe në përdorim publik, si dhe mungonin procesverbalet e monitorimit të kontratave për plotësimin e kushteve të kontratave si dhe kriteret ligjore që duhet të plotësojnë stacionet e plazhit, kjo pasi dhe kontratat nuk ishin të nënshkruara. Ndërsa për vitin 2022 kishte aktkontrolle, por ato ishin vetëm për verifikimin e sipërfaqes në shfrytëzim me atë të paguar por jo për element të tjerë që përmban VKM 171/2019 me ndryshime. Pra ky dokumentacion mungonte, edhe pse qiramarrës ishin po të njëjtët subjekte në të njëjtat zona të plazhit, të cilët e kanë detyrim ligjor paraqitjen e akteve të Monitorimit të kryera nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe Inspektorati përgjegjës në momentin e rinovimit të kontratave. Po kështu edhe komisionet e ngritura me urdhër të Titullarit për çdo vit për verifikime në terren nuk kanë funksionuar.

- Në asnjë nga dosjet e audituara për vitin 2021-2022 nuk ishte e depozituar marrëveshja e noterizuar me vrojtuesit e plazhit e vlefshme kjo për gjithë kohën e shfrytëzimit, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 171/2019, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë sezonit turistik”, i ndryshuar me VKM nr. 1172, datë 24/12/2022, ku thuhet se:

iii. pas plotësimit të dokumentacionit shtesë si më sipër, GTSHA-ja miraton në portalin e-Albania aplikimin përkatës dhe AKB-ja njofton menjëherë subjektin dhe NJVV-në për nënshkrimin e kontratës sipas formatit tip bashkëlidhur

⁷ a) për çadrat dhe ndenjësjet e pushuesve të respektohet një distancë prej të paktën 7.5 (shtatë pikë pesë) m nga vija e bregut të detit, liqenit, lumit;

b) hapësira prej 2.5 (dy pikë pesë) m përpara brezit të parë të çadrave të jetë e lirë për t'u shfrytëzuar nga publiku;

c) hapësira midis çadrave (nga çadra në çadër) nuk duhet të jetë më e vogël se 3 (tre) m në linjë horizontale me vijën e ujit, si dhe jo më e vogël se 2.5 (dy pikë pesë) m në linjë vertikale me vijën e ujit;

këtij vendimi. Para nënshkrimit të kontratës, subjekti duhet të paraqesë marrëveshjen e noterizuar me vrojtuesin e plazhit (shoqëruar me certifikatën përkatëse të kualifikimit), e vlefshme përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës. ç) në përfundim të nënshkrimit të kontratës, subjekti pajiset me certifikatën e përdorimit të stacioneve të plazhit, sipas modelit të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.”.

Nga Drejtoria e Aseteve nuk janë kryer rakordimet me Degën e Financës, nuk janë evidentuar subjektet debitoare për çdo fund viti, nuk janë mbajtur aktrakordimet me DAV për pagesat e kryera nga subjektet dhe detyrimet, veprimet në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu III. Regjistri i Aktiveve dhe Dokumentimi i lëvizjes së tyre, “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” pikat 34, 35 dhe 36 dhe VKB nr.88, datë 24.12.2020 “Për Miratimin e Taksave dhe Tarifave vendore në Territorin e Bashkisë Vlorë”.

Me urdhër nr. 214, datë 05/08/2022 (prot nr. 8882), të Kryetarit të Bashkisë Vlorë është urdhër Policia Bashkiake për ushtrimin e kontrolleve në terren për të gjithë subjekte që ushtrojnë aktivitet me stacioni plazhi, kjo në zbatim të VKM nr. 171/2019, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë sezonit turistik”, i ndryshuar. Gjithashtu urdhri është dhe për Drejtorinë e Aseteve ku në rast të mospërmbushje së kushte të kontratave (kontrata të cilat nuk janë nënshkruar nga bashkia dhe nuk dihet se çfarë do verifikon kjo drejtori), të njoftohet AKB për nisjen e procedurave zgjidhje e kontratave.

Ky urdhër bie ndesh me shkresat e mëparshme, ku nga ana Kryetarit të Bashkia Vlorë është kërkuar AKB mos nënshkrimin e kontratave, pasi ka parregullsi. Në këto kushte vetë bashkia duhet të kishte bërë pezullimin për rastet e evidentuara me shkelje (mbivendosje), dhe mos shpërndarjen e mandatpagesave për sipërfaqen e shfrytëzueshme dhe të vijonte lidhjen e kontratave dhe të mandatpagesave për rastet të cilat konsideroheshin të rregullta.

Me urdhër nr. 72, datë 02/04/2022 (prot 3416), të Kryetarit të Bashkisë është ngritur grupi i punës për menaxhimin e kontratave pas miratimit nga GTSHA. Në grupin e punës janë:

1. Z. G. H., në cilësinë e personit për përgatitjen e genplanit NJA Novosel.
2. Z. A. G., në cilësinë e personit për përgatitjen e genplani NJA Qendër.
3. Z. K. A., në cilësinë e personit për përgatitjen e genplani NJA Vlorë.
4. Z. F. M., në cilësinë e personit për përgatitjen e genplani NJA Orikum.

Në zbatim të po këtij urdhri në bashkëpunim me inspektorët e terrenit të Drejtorisë të të Ardhurave Vlorë (si mëposhtë), do të bëhet verifikimi në terren për cdo subjekt nga data 1 maj – 15 nëntor në lidhje me sipërfaqen faktike të shfrytëzueshme nga subjektet. Grupi është:

1. Z. M. Ll., inspektor terreni për Plazhin e Vjetër.
2. Z. G. A., inspektor terreni për Lungomare – Uje i ftohtë Jonufer.
3. Z. F. B., inspektor terreni për Plazhin Radhimë – Orikum.
4. Z. E. P., inspektor terreni për Plazhin nartë – Zvërnec.
5. Z. G. S., inspektor terreni për Plazhin e Akërnisë

Në përfundim nga grupet sipas pikave 1 dhe 2 pas verifikimeve në terren do përgatitën akt-konstatimet dhe planvendosjen me sipërfaqet faktike të cilat do dorëzohen pranë Drejtorisë së pronave Publike dhe menaxhimit të Aseteve.

Nga verifikimi i dosjeve, konstatohet se janë mbajtur vetëm aktkonstatimi mbi sipërfaqet e shfrytëzueshme ku dhe pas evidentimit të diferencave në +/- nga personat përgjegjës nuk është ndërhyrë për ndryshim. Ndërsa në lidhje me genplani nuk është hartuar dhe depozituar asnjë

dokument. Gjithashtu theksojmë se për vitin 2021 kjo praktike nuk është zbatuar nga Bashkia Vlorë.

- Mbi menaxhimin e kontratave për dhënie në përdorim të hapësirave publike, mënyra e tarifimit dhe pagesës së kontratës së qirasë.

Nga auditimi i kryqëzimit të të dhënave midis regjistrimit të miratuar nga AKB dhe të dhënave të Bashkisë Vlorë mbi pagesat e hapësirave publike të plazhit, nga Sektori i Financës dhe Drejtoria e Aseteve si strukturë që është marrë me menaxhimin e sipërfaqeve të hapësirave për plazhe, rezulton se:

a- Mos përputhja e të dhënave të regjistruara midis AKB dhe Drejtorisë së Aseteve.

Referuar të dhënave të përcjellë nga AKB me posten elektronike zyrtare datë 07/07/2023 me të dhënat e disponuara dhe vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga Drejtoria e Aseteve....., rezulton se si për vitin 2021 dhe për vitin 2022 kanë ushtruar aktivitet duke kryer dhe pagesat e sipërfaqeve të plazhit, disa subjekte të cilat nuk janë konfirmuar nga Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve (GTSHA) dhe AKB, pra janë lëshuar mandat pagesa për subjekte të pa miratuara në AKB, veprime këto në shkelje të VKM nr. 1172, datë 24/12/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 171, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores, për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacioneve të plazhit, pika 5 dhe 10, ku thuhet se:

Pika 5. Si autoritet i shqyrtimit të aplikimeve për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi ngrihet grupi teknik i shqyrtimit të aplikimeve (në vijim “GTSHA”). Ngritja dhe mënyra e funksionimit të GTSHA-së miratohen me urdhër ministri.”

Pika 10. GTSHA-ja, për shqyrtimin e kërkesave, ndjek procedurën e mëposhtme:

a) shqyrton dokumentacionin e paraqitur, sipas pikës 9 të këtij neni dhe, në rast se konstatohet mungesë apo paqartësi dokumentacioni, njofton menjëherë subjektin nëpërmjet portalit e-Albania për afatin dhe plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm;

b) në rast se subjekti nuk i plotëson kriteret sipas pikës 7, të këtij neni, dhe/ose dokumentacioni, pas kërkesës për plotësim, mbetet i paplotësuar brenda afatit të kërkuar, GTSHA-ja refuzon përfundimisht kërkesën nëpërmjet portalit e-Albania;

c) në rast se subjekti i plotëson kriteret sipas pikës 7 të këtij neni dhe dokumentacioni i paraqitur rezulton i plotë, GTSHA-ja njofton subjektin nëpërmjet portalit e-Albania dhe njofton elektronikisht Agjencinë Kombëtare të Bregdetit (në vijim “AKB”) dhe njësinë përkatëse të vetëqeverisjes vendore (në vijim “NJVV”), me qëllim plotësimin e dokumentacionit shtesë, si më poshtë vijon:

i. planvendosjen përkatëse për sipërfaqen konkrete të miratuar të stacionit të plazhit, pas negocimit ndërmjet subjektit të kualifikuar dhe NJVV-së, që do të jepet për shfrytëzim si stacion plazhi, përfshirë edhe brezin e shërbimeve, sipas rastit, e miratuar nga të dyja palët;

ii. gjenerimi i mandatpagesës vjetore të sipërfaqes së stacionit të plazhit, nga ana e NJVV-së si palë përfituese, sipas tarifave vendore në fuqi, ku të detajohet detyrimi financiar vjetor për përdorimin e sipërfaqes së stacionit të plazhit dhe për ngritjen e shfrytëzimit e strukturave të shërbimit, sipas rastit, si dhe vërtetimi i pagesës së kryer nga ana e subjektit. Në rast të kontratave disavjeçare të lidhura sipas këtij neni, NJVV-ja është përgjegjëse për mbledhjen e detyrimeve të qirasë për çdo vit. Përpara fillimit të sezonit turistik të vitit pasardhës, NJVV-ja njofton zyrtarisht AKB-në për statusin e detyrimeve nga ana e subjekteve me të cilat është lidhur kontrata. Mospagesën e detyrimeve vjetore të qirasë përpara sezonit turistik nga ana e subjekteve përfituese përbën shkak për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës;

iii. pas plotësimit të dokumentacionit shtesë si më sipër, GTSHA-ja miraton në portalin e-Albania aplikimin përkatës dhe AKB-ja njofton menjëherë subjektin dhe NJVV-në për nënshkrimin e kontratës sipas formatit tip bashkëlidhur këtij vendimi. Para nënshkrimit të kontratës, subjekti duhet të paraqesë marrëveshjen e noterizuar me vrojtuesin e plazhit (shoqëruar me certifikatën përkatëse të kualifikimit), e vlefshme përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

ç) në përfundim të nënshkrimit të kontratës, subjekti pajiset me certifikatën e përdorimit të stacioneve të plazhit, sipas modelit të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.”

Konkretisht për vitin 2021 janë **51** persona të cilat kanë kryer pagesë për stacione plazhi, por të pamiratuara në AKB.

- *Lista e personave të pamiratuara në AKB dhe me faturë pagesa në bashki, viti 2021*

Nr.	Emri	Mbiemër	Parcela	Sipërfaqe
1	Sh.	A.	Jonufer	500
2	A.	H.	Lungomare	200
3	A.	H.	Orikum	400
4	K.	H.	Radhimë	200
5	K.	Q.	Kalaja	920
6	H.	S.	Orikum	400
7	B.	D.	Radhimë	200
8	A.	Ç.	Akerni	200
9	V.	N.	Plazhi i Vjetër	300
10	M.	H.	Orikum	200
11	A.	D.	Radhimë	200
12	M.	M.	Plazhi i Vjetër	400
13	A.	L.	Radhimë	200
14	T.	B.	Plazh i Ri	600
15	P.	K.	Radhimë	813
16	M.	M.	Orikum	300
17	K.	S.	Radhimë	200
18	S.	M.	Jonufer	50
19	A.	K.	Radhimë	200
20	A.	T.	Plazh i Ri	200
21	D.	B.	Radhimë	200
22	L.	T.	Zvernec	200
23	I.	B.	Plazhi i Vjetër	400
24	S.	D.	Orikum	300
25	L.	B.	Radhimë	200
26	Gj.	D.	Zvernec	200
27	S.	B.	Zvernec	900
28	D.	K.	Zvernec	500
29	V.	B.	Plazh i Ri	600
30	E.	Sh.	Plazhi i Vjetër	200
31	E.	M.	Zvernec	200
32	K.	J.	Plazhi I Ri	200
33	D.	C.	Radhim	200
34	M.	L.	Jonufer	1250
35	F.	A.	Zvernec	250
36	M.	L.	Plazhi i Vjetër	200
37	A.	R.	Radhimë	100
38	M.	N.	Radhimë	200
39	A.	N.	Orikum	200
40	A.	I.	Radhimë	200
41	B.	T.	Plazhi i Vjetër	300
42	D.	K.	Zvernec	200
43	G.	H.	Jonufer	400
44	S.	H.	Akerni	200
45	N.	M.	Radhim	100
46	G.	K.	Orikum	200
47	Sh.	Xh.	Zvernec	200
48	I.	D.	Plazhi i Vjetër	200

Nr.	Emri	Mbiemër	Parcela	Sipërfaqe
49	A.	K.	Plazhi i Vjetër	200
50	G.	M.	Zvernec	200
51	E.	I.	Orikum	100

Konkretisht për vitin 2022 janë **50** persona të cilat kanë kryer pagesë për stacione plazhi, por të pamiratuara në AKB.

- *Lista e personave të pamiratuara në AKB dhe me faturë pagesa në bashki, viti 2022*

Nr.	EMER	MBIEMER	VENDODHJA	SIP.M ² ngarkuar me detyrim nga Bashkia Vlore
1	A.	K.	Plazhi i Vjetër	400
2	A.	K.	Plazhi i Vjetër	300
3	A.	C.	AKERNI	200
4	I.	B.	Plazhi i Vjetër	200
5	M.	L.	Plazhi i Vjetër	200
6	N.	ShPK	Plazhi i Vjetër	300
7	R.	H.	Plazhi i Vjetër	500
8	S.	H.	Plazhi i Vjetër	200
9	E.	I.	Jonufer	165
10	E.	N.	Lungomare	200
11	E.	H.	Lungomare	400
12	F.	H.	Plazh i Ri	300
13	I.	H.	Lungomare	1500
14	K.	Q.	Kalaja	920
15	K.	B.	Lungomare	200
16	K.	S.	Lungomare	400
17	M.	I.	Lungomare	200
18	M.	H.	Lungomare	300
19	Sh.	A.	Jonufer	500
20	S.	M.	Jonufer	50
21	T.	B.	Plazh i Ri	300
22	V.	D.	Jonufer	150
23	A.	B.	Radhimë	200
24	I.	Z.	Radhimë	400
25	K.	SM.	Radhimë	200
26	M.	N.	Radhimë	200
27	L.	R.	Radhimë	200
28	B.	L.	Orikum	100
29	E.	R.	Orikum	200
30	D.	A.	Radhimë	250
31	D.	C.	Radhimë	200
32	N.	M.	Radhimë	100
33	M.	N.	Radhimë	100
34	H.	K.	Radhimë	400
35	Z.	H.	Radhimë	50
36	K.	ShPK	Radhimë	1100
37	D.	A.	Radhimë	400
38	M.	Gj.	Radhimë	700
39	L.	B.	Radhimë	200

Nr.	EMER	MBIEMER	VENDODHJA	SIP.M ² ngarkuar me detyrim nga Bashkia Vlore
40	H.	R.	Radhimë	400
41	S.	L.	Radhimë	400
42	L.	K.	Radhimë	200
43	H.	H.	Radhimë	200
44	E.	N.	Radhimë	120
45	D.	K.	Zvernec	500
46	E.	M.	Zvernec	250
47	E.	R.	Zvernec	200
48	F.	A.	Zvernec	300
49	Gj.	D.	Zvernec	200
50	K.	A.	Zvernec	4000

b- Taksimi i sipërfaqeve për hapësira publike plazh me shumë se ato të miratuara në AKB

Lista e diferencave të vitit 2021

Nr.	EMER	MBIEMER	VENDODHJA	Sip. m ² e miratuar paraprakisht nga GTSHA	Sip. m ² ngarkuar me detyrim nga Bashkia Vlore	Diferenca
a	b	c	e	1	2	3=1-2
1	L.	D.	Plazhi i Vjetër	300	400	100
2	R.	D.	Plazhi i Vjetër	600	1000	400
3	A.	D.	Uji i Ftohte	500	800	300
4	D.	M.	Plazh i Ri	300	450	150
5	F.	Ll.	Plazhi Kalaja	720	1100	380
6	G.	H.	Jonufer	200	400	200
7	I.	H.	Plazh i Ri	400	600	200
8	O.	V.	Jonufer	800	1200	400
9	Sh.	A.	Jonufer	200	500	300
10	A.	H.	Orikum	200	400	200
11	A.	Xh.	Orikum	100	200	100
12	A.	R.	Radhimë	50	100	50
13	A.	Gj.	Radhimë	300	500	200
14	F.	B.	Radhimë	200	220	20
15	I.	Z.	Radhimë	300	400	100
16	K.	Xh.	Radhimë	400	600	200
17	L.	B.	Radhimë	200	400	200
18	M.	M.	Orikum	200	400	200
19	M.	N.	Radhimë	100	200	100
20	R.	T.	Radhimë	100	200	100
21	S.	D.	Orikum	200	300	100
22	T.	Xh.	Orikum	500	800	300
23	B.	P.	Zvernec	100	400	300
24	E.	C.	Zvernec	300	400	100
25	G.	C.	Zvernec	1000	1200	200
26	M.	K.	Zvernec	200	2039	1,839

Lista e diferencave të vitit 2022

Nr.	EMER	MBIEMER	Vendodhje	SIP.M ² nga Bashkia	sip sipas AKB	Me >	Me <
1	A.	S.	Plazh i Ri	900	300	600	
2	A.	T.	Plazh i Ri	200	300		100
3	A.	L.	Plazh i Ri	400	300	100	
4	L.	Xh.	Plazh i Ri	600	560	40	
5	O.	V.	Jonufer	1200	600	600	
6	A.	Gj.	Radhimë	500	200	300	
7	A.	M.	Orikum	400	650	-250	
8	A.	SM.	Radhimë	1319	1266	53	
9	E.	M.	Radhimë	712	352	360	
10	P.	K.	Orikum	800	200	600	
11	H.	K.	Radhimë	400	233	167	
12	D.	K.	Zvernec	400	1556		1156

c- Të dhënat mbi pagesat.

Nga kryqëzimi i të dhënave mbi pagesat të Sektorit të Financës dhe ato të depozituara në dosjet e plazheve sipas Drejtorisë së Aseteve, konstatohet se **54** subjekte nuk dalin me pagesë në financë për vlerën **12,146,100 lekë** për vitet 2021-2022, e cila konsiderohet e ardhur e munguar, nga e cila për vitin 2021 për **27** subjekte me vlerë **6,258,100** dhe për vitin 2022 janë **25** subjekte me vlerë **5,888,000** lekë.

Lista e subjekteve pa pagesë viti 2021

Nr.	EMER	MBIEMER	NIPTI	VENDODHJA	Sip.m ² nga Bashkia Vlore	Çmimi ne lek/m ²	Vlera sipas Aseteve	Pagesa Financë
1	A.	S.	-	Plazh i Ri	900	500	450,000	-
2	A.	B.	-	Plazhi i Vjetër	300	400	120,000	-
3	A.	L.	-	Radhimë	200	500	100,000	-
4	A.	S.	-	Jonufer	300	500	150,000	-
5	A.	Z.	-	Plazh i Ri	1000	500	500,000	-
6	A.	L.	-	Radhimë	200	500	100,000	-
7	A.	D.	-	Radhimë	250	500	125,000	-
8	A.	SM.	-	Radhimë	1319	500	659,500	-
9	B.	S.	-	Zvernec	400	400	160,000	-
10	E.	V.	-	Plazh i Vjetër	200	400	80,000	-
11	E.	H.	-	Lungomare	400	500	200,000	-
12	E.	A.	-	Zvernec	400	400	160,000	-
13	E.	R.	-	Plazhi i Vjetër	1000	400	400,000	-
14	E.	Sh.	-	Plazh i Ri	400	500	200,000	-
15	F.	C.	-	Jonufer	200	500	100,000	-
16	F.	HA.	-	Plazh i Ri	300	500	150,000	-
17	F.	M.	-	Orikum	200	500	100,000	-
18	F.	L.	-	Plazh i Ri	1404	500	702,000	-
19	L.	D.	-	Plazhi i Vjetër	500	400	200,000	-
20	M.	N.	-	Radhimë	100	500	50,000	20,000
21	M.	B.	-	Plazh i Vjetër	504	400	201,600	-
22	N.	B.	-	Plazh i Ri	400	500	200,000	100,000
23	O.	V.	-	Jonufer	1200	500	600,000	-
24	R.	H.	-	Plazh i Vjetër	500	400	200,000	100,000
25	R.	D.	-	Plazh i Vjetër	800	400	320,000	-
26	Sh.	G.	-	Radhimë	200	500	100,000	-
27	T.	B.	-	Plazh i Ri	300	500	150,000	-

Nr.	EMER	MBIEMER	NIPTI	VENDODHJA	Sip.m ² nga Bashkia Vlore	Çmimi ne lek/m ²	Vlera sipas Aseteve	Pagesa Financë
							6,478,100	220,000
		Shuma diferencë					6,258,100	

Lista e subjekteve pa pagesë viti 2022

Nr.	EMER	MBIEMER	VENDODHJA	Sip.m ² sipas bashkisë Vlore	Çmimi ne lek	Vlera papaguar
1	A.	S.	Plazh i Ri	600	500	300,000
2	A.	L.	Radhimë	200	500	100,000
3	A.	S.	Orikum	300	500	150,000
4	A.	Z.	Plazh i Ri	1000	500	500,000
5	A.	L.	Radhimë	200	500	100,000
6	A.	D.	Radhimë	200	500	100,000
7	B.	L.	Plazh i Ri	1404	500	702,000
8	E.	M.	Radhimë	712	500	356,000
9	E.	Sh.	Plazh i Ri	200	500	100,000
10	F.	C.	Jonufer	200	500	100,000
11	F.	HA.	Plazh i Ri	300	500	150,000
12	F.	M.	Zvernec	200	400	80,000
13	Gj.	D.	Zvernec	200	400	80,000
14	H.	M.	Plazhi i Vjetër	400	400	160,000
15	I.	D.	Lungomare	300	500	150,000
16	I.	Z.	Radhimë	400	500	200,000
17	L.	D.	Orikum	800	500	400,000
18	M.	P.	Zvernec	400	400	160,000
19	M.	R.	Radhimë	200	500	100,000
20	N.	B.	Plazh i Ri	200	500	100,000
21	O.	V.	Jonufer	1200	500	600,000
22	T.	Xh.	Orikum	800	500	400,000
23	T.	B.	Plazh i Ri	600	500	300,000
24	V.	B.	Plazh i Ri	600	500	300,000
25	V.	B.	Radhimë	400	500	200,000
						5,888,000

c.1- Nga auditimi i dokumente të paraqitur, rezulton se sipas verifikimit në terren të kryer nga grupet e punës ngritur me urdhëron nr. 72, datë 02/04/2022 (prot 3416), të Kryetarit të Bashkisë është evidentuar se disa subjekte shfrytëzohin më shumë sipërfaqe se ajo e miratuar si nga AKB dhe nga Bashkia Vlorë, por që nga Bashkia Vlorë (personat përgjegjës), nuk është bërë i mundur llogaritja e tarifës për sipërfaqen shtesë të shfrytëzuar, kjo për 12 subjekte me vlerë **2,032,500 lekë** e cila konsiderohet të ardhura të munguara për bashkinë Vlorë, pasqyra:

Nr.	Emër	Mbiemër	Vendndodhje	Sip.m ² e ngarkuar nga bashkia Vlore	Çmimi ne lek/ m ²	Vlera	Pagesa	Sip. sipas terreni	Difere	Vlera papaguar
1	S.	H.	Plazh i Vjetër	230	400	92,000	92,000	1800	1,570	628,000

Nr.	Emër	Mbiemër	Vendndodhje	Sip.m ² e ngarkuar nga bashkia Vlore	Çmimi ne lek/ m ²	Vlera	Pagesa	Sip. sipas terreni	Difere	Vlera papaguar
2	K.	B.	Lungomare	200	500	100,000	100,000	800	600	300,000
3	S.	B.	Plazh i Ri	600	500	300,000	300,000	675	75	37,500
4	A.	L.	Radhimë	200	500	100,000	100,000	220	20	10,000
5	Sh.	G.	Radhimë	200	500	100,000		800	600	300,000
6	B.	L.	Orikum	100	500	50,000	50,000	200	100	50,000
7	L.	L.	Radhim	100	500	50,000	50,000	210	110	55,000
8	D.	A.	Radhimë	400	500	200,000	200,000	700	300	150,000
9	E.	R.	Zvernec	200	20	80,000	80,000	300	100	2,000
10	G.	M.	Zvernec	300	400	120,000	120,000	800	500	200,000
11	G.	H.	Zvernec	200	400	80,000	80,000	850	650	260,000
12	L.	T.	Zvernec	200	400	80,000	80,000	300	100	40,000
										2,032,500

c-2. Evidentohet dhe fakti se për një pjesë të subjekteve, ku për vitin 2021 janë **38** subjekte dhe në vitin 2022 janë **32** subjekt, janë lëshuar fatura pagesë për sipërfaqen së plazhit pa bërë me parë pagesën e taksave lokale dhe paraqitur vërtetim përkatës, konkretisht pasqyrat:

Lista e personave pa pagesë takse viti 2021.

Nr.	EMER	MBIEMER	VENDODHJA
1	A.	Ç.	Akerni
2	E.	R.	Plazh i Vjetër
3	I.	B.	Plazh i Vjetër
4	M.	M.	Plazhi i Vjetër
5	M.	L.	Plazh i Vjetër
6	V.	N.	Plazh i Vjetër
7	A.	Z.	Plazh i Ri
8	A.	C.	Plazh i Ri
9	D.	D.	Jonufer
10	I.	H.	Plazh i Ri
11	K.	Q.	Kalaja
12	M.	L.	Jonufer
13	N.	I. (K.)	Jonufer
14	S.	B.	Plazh i Ri
15	T.	B.	Plazh i Ri
16	V.	B.	Plazh i Ri
17	A.	H.	Orikum
18	A.	C.	Radhimë
19	A.	L.	Radhimë
20	A.	SM.	Radhimë
21	B.	B.	Orikum
22	E.	H.	Radhimë
23	E.	M.	Radhimë
24	G.	K.	Orikum
25	L.	M.	Radhimë
26	M.	R.	Radhimë
27	P.	N.	Orikum
28	T.	Xh.	Orikum
29	V.	B.	Radhimë
30	B.	P.	Zvernec
31	F.	K.	Zvernec
32	G.	C.	Zvernec
33	Gj.	D.	Zvernec
34	L.	C.	Zvernec

Nr.	EMER	MBIEMER	VENDODHJA
35	L.	S.	Zvernec
36	L.	C.	Zvernec
37	S.	B.	Zvernec
38	S.	H.	Akerni

Lista e personave pa pagesë takse viti 2022

Nr.	EMER	MBIEMER	VENDODHJA
1	A.	B.	Plazhi i Vjetër
2	A.	C.	AKERNI
3	E.	R.	Plazhi i Vjetër
4	N.	ShPK	Plazhi i Vjetër
5	R.	H.	Plazhi i Vjetër
6	S.	H.	Plazhi i Vjetër
7	A.	H.	Lungomare
8	A.	Z.	Plazh i Ri
9	E.	I.	Jonufer
10	F.	C.	Jonufer
11	J.	B.	Jonufer
12	K.	Q.	Kalaja
13	T.	D.	Plazh i Ri
14	T.	B.	Plazh i Ri
15	V.	D.	Jonufer
16	A.	P.	Radhimë
17	I.	Z.	Radhimë
18	A.	K.	Radhimë
19	M.	B.	Radhimë
20	M.	M.	Radhimë
21	P.	K.	Radhimë
22	P.	N.	Orikum
23	Sh.	G.	Radhimë
24	B.	SM.	Radhimë
25	A.	C.	Radhimë
26	E.	R.	Orikum
27	H.	K.	Radhimë
28	H.	R.	Radhimë
29	F.	K.	Zvernec
30	G.	C.	Zvernec
31	Gj.	D.	Zvernec
32	L.	C.	zvernec

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbi procedura e dhënies në përdorim të hapësirave të plazhit në sezonin turistik 2021 – 2022, në kundërshtim me VKM nr. 1172, datë 24.12.2020 ndryshuar me VKM nr. 827, datë 24/12/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 171, datë 27.3.2019, të këshillit të ministrave, “për miratimin e rregullores ‘për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, të ndryshuar, përkatësisht nenet 5; 6; 7; 8; 12, duke ngarkuar me përgjegjësi: **z. D. L.**, në funksionin e ish- Kryetarit të Bashkisë Vlorë dhe në cilësinë e palës kontraktore për Bashkinë Vlorë; **znj. S. H.**, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe në cilësinë e kryetares së komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit për lidhjen e kontratave e konfirmimin e tyre, në cilësinë e faturimit të detyrimit dhe ndjekjes e monitorimit të kontratave; **z. K. A.**, me detyrë Specialit në DPKZHT Bashkia Vlorë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshti me shkresë nr. 11597, datë 27.10.2023 (prot KLSH nr. 1026/29, datë 3.11.2023) “Mbi Projektraportin e Auditimit”, nga znj. S. H. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Në lidhje me konstatimin tuaj se është rritur sipërfaqja nga Bashkia Vlorë ju sqarojmë se kjo nuk përbën shkelje të VKM-së 171, datë 27.3.2019 dhe as të VKM nr. 424/2020 e cila ka dal për një ndryshim në VKM-në e mëparshme. Gjithashtu duhet të theksojmë faktin se ju na lini si detyrim në faqen 123 të këtij projekt auditimi si vlerë të pa grumbulluar diferencat midis sipërfaqeve të faturuara dhe sipërfaqeve të shfrytëzuara ku shihet qartë që sipërfaqet e shfrytëzuar janë më të mëdha se sipërfaqet e faturuara mbas miratimit paraparak nga AKB-ja.

Fakti që me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 424/2020, lënë në fuqi me vendimin nr.1172, datë 24.12.2020 Pika 1 dhe vendimin nr. 659, datë.10.10.2022 pika 3/a e cila është e cila cdo vit lihet në fuqi, nuk ka të parashikuar pretendimin tuaj se sipërfaqja mbas negocimit me Bashkinë Vlorë duhet të jetë më e vogël dhe jo më e madhe se ajo për të cilën subjekti është kualifikuar paraparakisht. Pasi subjekti gjithmonë duhet të tarifohet për aq sipërfaqe sa realisht shfrytëzon brenda parcelës që ai ka kryer aplikimin....., ë gjitha sa parashtruar mësipërm gjejnë zbatim në nenin 14 pika 10/b.

2. Në lidhje me mos nënshkrimin e kontratave ashtu siç jemi shprehur dhe gjatë auditimit nuk janë firmosur nga titullari për shkaqet dhe arsytet që ju përmendni ne aktin e konstatimit. Gjithashtu duke u bazuar dhe tek shtojca 3 e VKM-së 424, datë.27.05.2020 “Për një shtesë në vendimin nr.171, datë 27.3.2019, të këshillit të ministrave, “për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” formati zyrtar i kontratës është që në fund nënshkruajnë subjekti përfitues i stacionit të plazhit dhe Drejtori i përgjithshëm I AKB-së dhe jo përfaqësuesi i njësisë së qeverisjes vendore. Formatin e prodhuar nga AKB-ja është në kundërshtim me dispozitat ligjore të shtojcës 3 të VKM-së 424, datë.27.05.2020. Pra, shihet qartë që Bashkia nuk është palë në kontratë por është thjesht subjekt përfitues .

3. Përsa i përket dokumentacionit që ju citoni se duhet të kërkohet nga DPPM nuk është i bazuar pasi VKM-ja 171, datë.27.3.2019 bie në kundërshtim me VKM-në 424 . Dokumentacioni që ju citoni në akt konstatimi duhet të kërkohet nga Bashkia kur autoriteti i vetëm kontraktues ishte Bashkia Vlorë, pra kur kërkesa, dokumentacion dhe kontrata lidhet nga Bashkia Vlorë. Përcaktimet e VKM-së 171, datë.27.3.2019 gjente zbatim deri në vitin 2019. Pasi me miratimin e VKM-së 424, datë.27.05.2020 në nenin 14 pika 8 dhe 9.

Pra, shihet qartë se që me hyrjen në fuqi të VKM-së 424, datë.27.05.2020 ka ndryshuar tërësisht mënyra e aplikimit, dokumentacioni që duhet të kërket dhe plotësoj cdo subjekt për të ushtruar veprimtarinë si stacion plazhi deri tek momenti i lidhjes së kontratës. Gjithashtu dhe kontrata me vrojtuesin e plazhit nuk është dokumentacion i cili duhet të kërkohet nga Bashkia por nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit I cili është institucioni përgjegjës për ushtrimin e kontrollit tek subjektet për masat e sigurisë në stacionet e plazheve. Gjithashtu kontrata me rojen bregdetare është detyrim ligjor që duhet të ngarkohet në sistemin e- Albania në adresë të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit. E njëjta gjë vlen edhe për pjesën e vërtetimeve mbi shlyerjen e detyrimeve vendore dhe tatimore të përgjithshme, pasi të dyja këto dokumente ngarkohen në formatin elektronik e Albania fazën e dytë të aplikimit mbasi subjekti merr miratimin paraparak nga AKB dhe përpara lidhjes së kontratës. Në lidhje me planvendosjen ju sqarojmë se edhe planvendosjen që pajisjet subjekti pasi

kryer pagesën pranë Bashkisë ngarkohen në mënyrë elektronike nga vetë subjekti në fazën e dytë të aplikimit.

4. Në lidhje me listën e personave të cilët janë pajisur me mandat pagese nga Bashkia Vlorë por që nuk janë miratuar nga AKB-ja për sezonin turistik 2021, ju sqarojmë se ky konstatim i kryer nuk qëndron sepse :

a) Duke u bazuar tek e-maili i dt.16.12.2021 i AKB-së të cilin ua kemi dërguar në adresën tuaj elektronike gjatë auditimit pasqyrohen mjaft qartë kontratat me afat 2-5 vjet dhe kontratat 1-vjeçare të lidhura për sezonin turistik 2021.

b) Gjithashtu me shkresën nr.3012 prot, datë.25.11.2022 protokolluar pranë Bashkisë Vlorë me shkresën nr . 13600, datë.01.12.2022 AKB- ja është drejtuar bashkisë për vazhdimin e procedurave ligjore për gjenerimin e faturës së pagesës për subjektet të cilat kanë kontratë 3-5 vjeçare, kontrata të cilat janë lidhur në vitin 2021. Disa subjekte të cilët ju i citoni si të pamiratuara nga AKB.

Ndërkohë për vitin 2021 janë lidhur kontrata me afat 1 vjeçar për subjektet si mëposhtë : A. H., K. Q., K. H., H. S., M. H., P. K., M. M., K. S., A. K., S. D., L. B., Gj. D., S. B., D. K., G. H., Sh. Xh., E. M.

Me miratim paraprak nga AKB-ja për vitin 2021 janë: Sh. A., B. D., A. C., V. N., M. M., S. M., D. B., E. M., G. K., E. I. Gjithashtu subjektet I. B., B. T., A. K., A. C., S. H. dhe I. D., e kanë ushtruar veprimtarinë stacion plazhi në zona të cilat nuk kanë qenë të menaxhuara në vitin 2021 në hartën e stacionit të plazheve përkatësisht në zonat e triportit dhe akërnisë. Por e kanë ushtruar aktivitetin rregullisht sis stacion plazhi që prej vitit 2017. Bashkëlidhur po ju dërgoj emailin dhe shkresën konfirmuese të AKB-së.

Subjekti **S. B.** ka qenë subjekt në vitin 2021 me kontratë 5 vjeçare lidhur për parcelat vl-25 dhe 26 dhe **G. M.** ka qenë subjekt i vitit 2022 me kontratë 1 vjeçare . E njëjta gjë vlen edhe për 2022 pasi të azhurnoheni me dokumentacionin që do ju vendosim në dispozicion në lidhje me kontrata 2-5 vjeçare dhe kontratat 1 vjeçare të lidhura për 2022.

5. Në lidhje me konstatimin se janë **54** subjekte që nuk kanë paguar detyrimin për 2021-2022 ju sqarojmë se ky konstatim nuk qëndron pasi nga derdhjet në thesar dhe rakordimin me përgjegjësen e thesarit na u vendos në dispozicion pasqyra financiare si të cilat janë konfirmuar nga kjo përgjegjëse me shkresën nr.12324/1, datë.25.10.2023 drejtuar DPPMA, lista bashkëlidhur.

Subjekti **R. H.** nuk është subjekt i stacion plazhit i vitit 2021 por i vitit 2022 dhe ka kryer pagesën 200,000 lekë në vitin 2022 në bazë të mandat pagesës lëshuar nga Bashkia Vlorë. Kurse subjekti **N. B.** për vitin 2021 ka lidhur kontratën për 200 m² për një afat 5 vjeçar dhe ka kryer pagesën përkatëse në vlerë 100,000 l/m² dhe jo 200.000 sa keni konstatuar. Bashkëlidhur observacionit po ju dërgoj kopjen e ekstrakteve të subjekteve ku figurojnë dhe emrat e administratorëve nga të cilët është kryer pagesa në llogari të Bashkisë Vlorë.

Subjekti **L. M. dhe L. S.** nuk e kanë ushtruar aktivitetin për shkak të konfliktit që kanë pas me kufitarët e tyre. Bashkëlidhur observacionit po ju dërgojmë vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës Së Parë Vlorë nr.47, datë.30.01.2023 me Paditës L. M. dhe korrespondencën në lidhje me subjektin L. S. për VL-15 në plazhin e Zvërnecit.

6. Në lidhje me detyrimet e DAV-se po ju vendos në dispozicion informacionin e përgatitur nga DAV në lidhje me subjektet që nuk ishin të pajisur me vërtetim për vitin 2021 – 2022. Ky nga përgjigja e kthyer nga kjo drejtori shihet mjaft qartë papërgjegjshmëria e kësaj strukture në mosngarkimin me detyrim të subjekteve që ushtrojnë aktivitetin si stacione plazhi. Detyra e kësaj

drejtorie është identifikimi i cdo subjekti me Nipt që ushtron aktivitetin në territorin e Vlorës. Si mund të kthej përgjigje DAV që nuk e dimë ku ndodhet subjekti ndaj nuk po bëjmë ngarkesën.?? Ndërkohë që në organikën e saj ka më shumë se 20 inspektor terreni të cilët kanë qenë pjesë e urdhrave mbi menaxhimin e stacioneve të plazheve dhe për këtë kanë qenë pjesë e këtyre urdhrave për të kontrolluar nëse subjekte të cilat ushtrojnë veprimtarinë si stacione plazhi . DPPMA nuk mund të pres sa kjo strukturë të identifikoj subjektet dhe më pas ti pajis me vërtetimin për pagesë. Gjithashtu nuk është detyrë funksionale e DPPM-së tu kërkoj subjekteve vërtetimin nga organet tatimore vendore dhe rajonale pasi kjo është detyrë që VKM-ja i ka ngarkuar duke ju referuar arsyetimit në pikën 1 dhe 3 të këtij observacioni. Gjithashtu udhëzimi nr. 30 datë.27.12.2011 dhe VKB-ja nr. 88 /2020 nuk ka të parashikuar që drejtoritë për të vazhduar detyrat funksionale që i ngarkon ligjin duhet të bëjnë më parë grumbullimin e të ardhurave të mbartura të DAV-së pasi ato bëhen pengesë për procedurat e mëtejshme ligjore për pjesën që u takon detyrave të tyre funksionale.

7. Përsa i përket konstatimeve me terrenin do ti marrim në shqyrtim një e nga një si mëposhtë :

- a. Subjekti **S. H.** që ushtron aktivitetin si stacion plazhi në plazhin e vjetër ka paguar $200 \text{ m}^2 \times 500 \text{ L/M}^2 = 80.000$ dhe $600 \text{ m}^2 \times 20 \text{ l/m}^2 = 12000 \text{ l/m}^2$ sipas certifikatës së pronësisë nr.1754561, datë.19.10.2018 të cilën do t'ja bashkëlidhim observacionit pra gjithësej subjekti ka paguar 1000 m^2 . Ndërkohë për sipërfaqen 800 m^2 ka marrë ngarkesën sipas faturës përkatëse në vlerën 320.000
- b. Subjektit **A. S.** ka marr ngarkesën sipas vlerës përkatëse dhe ka kryer pagesën datë 24.10.2023 të cilën ua kemi bashkëlidhur dokumentacionit.
- c. Subjekti **A. T.** e ka kryer pagesën për 300 m^2 për sezonin turistik 2022 për të cilën ka lidhur dhe kontratën të cilën do tua bashkëlidhim këtij observacioni së bashku me dy mandat pagesat e subjektit.
- d. Subjekti **E. I. (P.)** i cili ka lidhur kontratën me pronarin e sipërfaqes truall prej 4131.8 m^2 që përfshin sipërfaqen e plazhit VI-178 me pronar A. L., bashkëlidhur gjithë dokumentacion dhe pagesën për këtë subjekt.
- e. Subjekti **E. N.** ka kryer pagesën në dt.20.10.2023
- f. Subjekti **K. B.** është subjekt që ka marr dijeni për aktin e konstatimit por refuzon pagesën dhe ndaj tij do të merren të gjitha masat administrative duke filluar nga bllokimi i llogarive bankare dhe deri tek hapja e procesit gjyqësor për kërkim shume.
- g. Subjekti **S. B.** është njoftuar për të tërheq detyrimin dhe e ka tërhequr.
- h. Subjekti **A. R.** është njoftuar për të tërheq detyrimin dhe e ka tërhequr.
- i. Subjekti **A. Gj.** për sezonin turistik 2022 ka paguar në total 863 m^2 me dy mandat pagesat përkatëse të datës.11.02.2022 me vlerë totale 314,980 lekë
- j. Subjekti **A. S.** e kreu pagesën për sipërfaqen shtesë në dt.19.10.2023 sipas faturës së pagesës bashkëlidhur.
- k. Subjekti **B. B.** ka kryer pagesën për vitin 2022 për sipërfaqen $2500 \text{ m}^2 \times 500 \text{ l/m}^2$ dhe për sipërfaqen $3200 \text{ m}^2 \times 20 \text{ l/m}^2$ sipas certifikatës së pronësisë nr1598732 , datë. 31.05.2018 bashkëlidhur observacionit.
- l. Subjekti **E. M.** ka marr ngarkesën përkatëse dhe ka kryer edhe pagesën përkatëse me vlerë 18,500 lekë në datë 24.10.2023.
- m. Subjekti **F. B.** është subjekt i cili është ngarkuar për sipërfaqen $200 \text{ m}^2 \times 500 \text{ l/m}^2$ kurse për sipërfaqen $500 \text{ m}^2 \times 20 \text{ l/m}^2$ sipas certifikatës së pronësisë nr.710103, date.22.01.2013, pra totali i sipërfaqes se paguar është 700 m^2 total.

n. Subjekti **K. Gj.** është subjekt i cili është ngarkuar për sipërfaqen $200 \text{ m}^2 \times 500 \text{ l/m}^2 = 100.000 \text{ l}$ kurse për sipërfaqen $960 \text{ m}^2 \times 20 \text{ l/m}^2 = 19200 \text{ l/m}^2$ sipas certifikatës së pronësisë nr.1888643, date.26.04.2019, pra totali i sipërfaqes së paguar është 1160 m^2 total.

o. Subjekti **Sh. G.** ka marrë dijeneri për detyrimet e të dyja viteve për të dyja sezonet turistike 2022 dhe 2023 dhe pritë të kryej pagesën.

p. Subjekti **B. L. dhe L. L.** të dyja këtyre subjekteve u është komunikuar detyrimi në datë .17.10.2023 dhe pritë të kryejnë pagesën .

q. Subjekti **L. F.** e ka përmbushur detyrimin e evidentuar në datë. 20.07.2023 me vlerë 50.000 lekë

r. Subjekti **D. A.** është kryer pagesa nga subjekti **I. K.** në vitin 2023

s. Për subjektin **E. N.** ju sqarojmë se ky subjekt ka certifikata pronësie dhe është tarifuar me 20 l/m^2 për sipërfaqen 600 m^2 pjesë e pasurisë nr.144/2/1 pajisur me certifikatën e pronësisë datë.01.02.2022. Bashkëlidhur observacionit pagesën dhe certifikatën e pronësisë së subjektit **E. F. N.**

t. Kurse për subjektet **E. R., G. M., G. H. dhe L. T.** në Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve nuk kemi asnjë dorëzim akt kontrolli nga grupi i terrenit për këto subjekteve të cilët ushtrojnë aktivitetin në plazhin e Zvërnecit. Nëse ndonjë drejtori tjetër ua ka vendosur në dispozicion ngarkojani asaj strukture që ka dijeneri dhe nuk ka njoftuar DPPMA. Prandaj vlerën e debisë duhet t'ja ngarkoni strukturës që u ka dorëzuar dokumentacionin e këtyre subjekteve pasi nuk ka kryer asnjë veprim për vjeljen e këtij detyrimi dhe nuk ka njoftuar DPPMA-në për këtë detyrim.

Qëndrimi i grupit të KLSH

Për sa observoni në lidhje me mos përputhjen e sipërfaqeve, dhe se nga ana juaj kjo nuk ka sjell të ardhura të munguara, sqarojmë se pretendimi nuk qëndron, pasi nga grupi i KLSH është theksuar se nga bashkia janë dhënë sipërfaqe plazhi më shumë se sa janë miratuar nga AKB, dhe se VKM nr. 424/2020 nuk është argument bindës, pasi kjo VKM është për një ndryshim në VKM nr. 171 dhe është taksative për vitin 2020 si vit i pandemisë.

Në material grupi është shprehur për të dy rastet dhe kur sipërfaqja e shfrytëzueshme dhe lëshuar faturë nga bashkia është më e madhe se ajo e miratuar në AKB, po ashtu dhe në rastin kur sipërfaqja e tarifuar është më e vogël se sipërfaqja e shfrytëzueshme, kjo sipas aktkontrolleve të kryera nga terreni.

Në lidhje me konstatimin tuaj se mosnënshtrimi i kontratave vjen pasi bashkia ka pasur pretendime dhe se në zbatim të VKM nr. 424, datë 27.5.2022, formati zyrtarë është që në fund nënshkruar përfaqësuesi i AKB dhe jo përfaqësuesi i njësi vendore, sqarojmë se nuk qëndron, pasi VKM nr. 424, datë 27.5.2022 së cilës ju i referoheni thuhet se është një shtesë e VKM nr. 171, datë 27.3.2019, dhe përjashtimit për vitin 2020 në kushtet e pandemisë.

I njëjti argument vlen dhe për mos pajisjen me mandat pagese për taksat lokale dhe tatimet e përgjithshme, pasi në referim të VKM nr. 171, datë 27.3.2020, ky dokumentacion duhet në dosjen e subjektit dhe personi përgjegjës në rastin konkret Drejtoria e Aseteve nuk duhet të kishte dhënë mandat pagesë pa marrë vërtetim se nuk kanë detyrime.

Në lidhje me subjektet që cilat kanë kontrata 2 – 5 vjeçare janë marrë në konsideratë nga grupi. Ndërsa subjektet e tjera që nuk plotësojnë këtë kusht nuk janë marrë në konsideratë.

Në lidhje me pretendimin se disa nga subjektet të cilat sipas akt konstatimeve në terren nuk ju është bërë rillogaritja, nga grupi u morën në konsideratë për ato subjekte që kishin mbështetje me dokumentacion. Ndërsa subjektet e tjera për të cilat ju ishte bërë njoftimi por nuk kishin bërë likuidimi ose nuk kanë aktkonstatimi nuk janë marrë në konsideratë dhe mbeten në material.

- Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa ngarkuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Titulli gjetjes: Mbi konstatimin e subjekteve të pa ngarkuara në periudhat ushtrimore objekt auditimit, dhe problematikat e shumta mbi kartelat e paraqitura në sistemin TAIS, të verifikuara nga raporti statistikor i gjeneruar nga sistemi për periudhën 01/01/2021 – 31.12.2022.

Situata: Nga verifikimi dhe analizimi i raporteve të gjeneruara nga sistemi TAIS dhe të dhënave mbi aktkontrollin e ndryshme që inspektorët e terrenit kanë realizuar për periudhat ushtrimore 2021 dhe 2022, në subjekte të ndryshme për taksën e reklamës dhe hapësirat publike, sipërfaqen e ndërtimit, etj, u konstatua se jo të gjitha konstatimet e evidentuara nga inspektorët e kontrollit të terrenit janë të ngarkuara për pagesë në sistemin TAIS për detyrimin tatimorë të munguar dhe padeklaruar në fillim të vitit ushtrimorë. Sipas dokumentacionit (*aktkontrolle dhe sistemit TAIS*), rezulton se në **21** subjekte nga inspektorët e terrenit janë evidentuar sipërfaqe e pataksuar për një vlerë të munguar **838,200 lekë (tabela nr. 1, 2 dhe 3)**.

Kriteri: Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë nr. 79, datë 2.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në bashkinë Vlorë”, i ndryshuar dhe rregullores së Bashkisë Vlorë “Për organizimin dhe funksionimin e strukturave të Bashkisë Vlorë”, neni 106 në të cilin përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e Specialistit të vlerësimit të detyrimit tatimor për biznesin, duke ngarkuar me **përgjegjësi inspektorët e vlerësimit sipas rajoneve znj. R. P. dhe E. Sh.**

Ndikimi/Efekti: Mos kryerja e ngarkesave në sistemin TAIS, të konstatimeve të bërë nga inspektorët e terrenit, janë veprime në paligjshmëri dhe që çojnë në mungesë të ardhura në shumën **838,200 lekë**.

Shkaku: Përgjegjësi e specialisteve të vlerësimit tatimor të dosjeve të cdo subjekti taksapagues, në zbatimin e akteve administrative të përcjella nga inspektorët e kontrollit në terren.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Vlorë (*sektori i vlerësimit*), të marrë të masat për kryerjen e ngarkesës fiskalë sipas aktkontrolleve të inspektorëve të kontrollit dhe jo vetëm, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **838,200 lekë, konkretisht subjektet.**

NR	NIPTI	SUBJEKTI	Vlera pataksuar
1	-	P. Sh.	34,000
2	-	R. B.	70,000
3	-	A. N.	5,000
4	-	P. G.	10,000
5	-	S. M.	5,000
6	-	A. M.	10,000
7	-	E. M.	15,750
8	-	G. L.	15,000
9	-	G. D.	101,250

NR	NIPTI	SUBJEKTI	Vlera pataksuar
10	-	E. Sh.	12,000
11	-	D. S.	12,000
12	-	H. H.	24,000
13	-	K. M.	19,200
14	-	H. A.	24,000
15	-	A. S.	12,000
16	-	H. L.	72,000
17	-	B. M.	153,600
18	-	A. C.	64,000
19	-	K. L.	72,000
20	-	S. M.	18,000
21	-	E. B.	90,000
SHUMA			838,200

Tabela 1:

NR	SUBJEKTI	M ² PER FATURIM		Aktkontrolli		Vlera pataksuar	Inspektori
				Nr.	Datë		
1	P. Sh.	Taksë Tabele	3.4			34,000	E. Sh.
2	R. B.	Taksë Tabele	7.0			70,000	E. Sh.
3	A. N.	Taksë Tabele	0.5			5,000	E. Sh.
4	P. G.	Taksë Tabele	1.0			10,000	E. Sh.
5	S. M.	Taksë Tabele	0.5	615	18.3.2022	5,000	E. Sh.
6	A. M.	Taksë Tabele	1.0	611	16.3.2022	10,000	E. Sh.
7	E. M.	Reklamë e thjeshtë	0.7	940	24.06.2022	15,750	R. P.
8	G. L.	Tabelë me ndriçim	1	2863	01.07.2022	15,000	R. P.
9	G. D.	Reklamë e thjeshtë	4.5	1806	10.08.2022	101,250	R. P.

Tabela 2: Rastet e specialistes së vlerësimit tatimor znj. E. Sh.

Data e Postimit	Tipi i Dokumentit	VAT Registration No	Përshkrim	Vlera Fillestare	Vlera	Pa taksim
1/1/2016	Fatura		Tarifë Shfrytëzimi i Hapësirave Publike	12,000.00	12,000.00	
1/1/2016	Fatura		Taksë Ndërtese	4,500.00	4,500.00	
1/1/2016	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndriçimi, Gjellërimi	10,000.00	10,000.00	
4/13/2016	Pagesa		R. B.	-26,500.00	-26,500.00	
1/1/2017	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndriçimi, Gjellërimi	10,000.00	10,000.00	
1/1/2017	Fatura		Taksë Ndërtese	4,500.00	4,500.00	
4/14/2017	Pagesa		R. B.	-14,500.00	-14,500.00	
1/1/2018	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndriçimi, Gjellërimi	10,000.00	10,000.00	
1/1/2018	Fatura		Taksë Ndërtese	20,400.00	20,400.00	
3/29/2018	Pagesa		R. B.	-30,400.00	-30,400.00	
1/1/2019	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndriçimi, Gjellërimi	10,000.00	10,000.00	
1/1/2019	Fatura		Taksë Ndërtese	12,607.20	12,607.20	
3/29/2019	Pagesa		R. B.	-22,607.20	-22,607.20	
1/1/2020	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndriçimi, Gjellërimi	10,000.00	10,000.00	
1/1/2020	Fatura		Taksë Ndërtese	12,607.20	12,607.20	
4/17/2020	Pagesa		R. B.	-22,607.20	-22,607.20	
1/1/2021	Fatura		Taksë Ndërtese	12,607.20	12,607.20	
1/1/2021	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndriçimi, Gjellërimi	10,000.00	10,000.00	
4/2/2021	Pagesa		P.-C.	-22,607.20	-22,607.20	

Data e Postimit	Tipi i Dokumentit	VAT Registration No	Përshkrim	Vlera Fillestare	Vlera	Pa taksim
6/1/2021	Fatura		Tarifë Shfrytëzimi i Hapësirave Publike	12,000.00	12,000.00	
10/13/2021	Kamatëvonesa		Gjobe 0.06 % ne dite	165.6	165.6	
10/13/2021	Pagesa		P.-C.	-12,000.00	-12,000.00	
1/1/2022	Fatura		Taksë Ndërtese	12,607.20	12,607.20	
1/1/2022	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrichiimi, Gjellberimi	10,000.00	10,000.00	
4/20/2022	Pagesa		P.-C.	-22,772.80	-22,772.80	
1/1/2023	Fatura		Taksë Ndërtese	12,607.20	12,607.20	
1/1/2023	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrichiimi, Gjellberimi	10,000.00	10,000.00	
4/4/2023	Pagesa		POSTA-C.	-22,607.20	-22,607.20	
	1	E. Sh.				12,000
Data e Postimit	Tipi i Dokumentit	VAT Registration No	Përshkrim	Vlera Fillestare	Vlera	
1/1/2019	Fatura		Tarifë Shfrytëzimi i Hapësirave Publike	4,800.00	4,800.00	
7/22/2019	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrichiimi, Gjellberimi	5,000.00	5,000.00	
1/1/2020	Fatura		Tarifë Pastrim, Ndrichim, Gjellberim	12,000.00	12,000.00	
1/1/2020	Fatura		Tarifë Shfrytëzimi i Hapësirave Publike	12,800.00	12,800.00	
1/13/2020	Kamatëvonesa		Gjobe 0.06 % ne dite	76.44	76.44	
1/13/2020	Pagesa		C.	-9,800.00	-9,800.00	
4/14/2020	Pagesa		C.	-12,076.44	-12,076.44	
1/1/2021	Fatura		Tarifë Shfrytëzimi i Hapësirave Publike	12,000.00	12,000.00	
1/1/2021	Fatura		Tarifë Pastrim, Ndrichim, Gjellberim	12,000.00	12,000.00	
6/16/2021	Kamatëvonesa		Gjobe 0.06 % ne dite	1,692.96	1,692.96	
6/16/2021	Pagesa		C.	-12,800.00	-12,800.00	
12/3/2021	Kamatëvonesa		Gjobe 0.06 % ne dite	1,756.80	1,756.80	
12/3/2021	Pagesa		C.	-25,692.96	-25,692.96	
12/3/2021	Pagesa		C.	-1,756.80	-1,756.80	
1/1/2022	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrichiimi, Gjellberimi	10,000.00	10,000.00	
	2	D. S.				12,000
Data e Postimit	Tipi i Dokumentit	VAT Registration No	Përshkrim	Vlera Fillestare	Vlera	
4/9/2019	Fatura		Taksë Ndërtese	8,528.40	8,528.40	
4/9/2019	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrichiimi, Gjellberimi	7,500.00	7,500.00	
9/10/2019	Pagesa		C.	-16,028.40	-16,028.40	
1/1/2020	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrichiimi, Gjellberimi	12,000.00	12,000.00	
1/1/2020	Fatura		Taksë Ndërtese	8,528.40	8,528.40	
5/7/2020	Kamatëvonesa		Gjobe 0.06 % ne dite	209.39	209.39	
5/7/2020	Pagesa		C.	-20,528.40	-20,528.40	
5/7/2020			H. H. Sistemim kamate	-209.39	-209.39	
1/1/2021	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrichiimi, Gjellberimi	10,000.00	10,000.00	
1/1/2021	Fatura		Taksë Ndërtese	8,528.40	8,528.40	
4/21/2021	Kamatëvonesa		Gjobe 0.06 % ne dite	11.12	11.12	
4/21/2021	Pagesa		C.	-18,528.40	-18,528.40	
1/1/2022	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrichiimi, Gjellberimi	10,000.00	10,000.00	
1/1/2022	Fatura		Taksë Ndërtese	5,562.00	5,562.00	
1/1/2023	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrichiimi, Gjellberimi	10,000.00	10,000.00	
1/1/2023	Fatura		Taksë Ndërtese	5,562.00	5,562.00	
	3	H. H.				24,000
Data e Postimit	Tipi i Dokumentit	VAT Registration No	Përshkrim	Vlera Fillestare	Vlera	
3/26/2021	Fatura		Taksë Ndërtese	6,952.50	6,952.50	
3/26/2021	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrichiimi, Gjellberimi	6,666.67	6,666.67	
3/26/2021	Fatura		Tarifë Shfrytëzimi i Hapësirave Publike	16,000.00	16,000.00	
1/1/2022	Fatura		Taksë Ndërtese	8,343.00	8,343.00	
1/1/2022	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrichiimi, Gjellberimi	10,000.00	10,000.00	
12/31/2022	Kamatëvonesa		Gjobe 0.06 % ne dite	6,486.60	6,486.60	
1/1/2023	Fatura		Taksë Ndërtese	8,343.00	8,343.00	
1/1/2023	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrichiimi, Gjellberimi	10,000.00	10,000.00	
	4	K. M.				19,200

Data e Postimit	Tipi i Dokumentit	VAT Registration No	Përshkrim	Vlera Fillestare	Vlera	Pa taksim
Data e Postimit	Tipi i Dokumentit	VAT Registration No	Përshkrim	Vlera Fillestare	Vlera	
3/4/2020	Fatura		Taksa mbi Truallin	600	600	
3/4/2020	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndriçimi, Gjellërimi	6,666.67	6,666.67	
3/4/2020	Fatura		Taksë Ndërtese	2,781.00	2,781.00	
9/18/2020	Pagesa		A.	-10,047.67	-10,047.67	
1/1/2021	Fatura		Taksa mbi Truallin	600	600	
1/1/2021	Fatura		Taksë Ndërtese	2,781.00	2,781.00	
1/1/2021	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndriçimi, Gjellërimi	8,000.00	8,000.00	
1/1/2021	Fatura		Tarifë Shfrytëzimi i Hapësirave Publike	24,000.00	24,000.00	
4/19/2021	Pagesa		A.	-11,381.00	-11,381.00	
8/20/2021	Pagesa		A.	-24,000.00	-24,000.00	
1/1/2022	Fatura		Taksa mbi Truallin	600	600	
1/1/2022	Fatura		Taksë Ndërtese	2,781.00	2,781.00	
1/1/2022	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndriçimi, Gjellërimi	10,000.00	10,000.00	
8/30/2022	Kamatëvonesa		Kamatëvonesa	1,059.78	1,059.78	
8/30/2022	Pagesa		A.	-13,381.00	-13,381.00	
1/1/2023	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndriçimi, Gjellërimi	10,000.00	10,000.00	
1/1/2023	Fatura		Taksë Ndërtese	2,781.00	2,781.00	
1/1/2023	Fatura		Taksa mbi Truallin	600	600	
4/6/2023	Pagesa		A.	-14,440.78	-14,440.78	
	5	H. A.				24,000
Data e Postimit	Tipi i Dokumentit	VAT Registration No	Përshkrim	Vlera Fillestare	Vlera	
3/19/2022	Fatura		Taksë Ndërtese	6,180.00	6,180.00	
3/19/2022	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndriçimi, Gjellërimi	8,333.33	8,333.33	
4/22/2022	Kamatëvonesa		Dok. Rreg.Fin. i Pag. Shtese 25282	17.42	17.42	
4/22/2022	Pagesa		I. B.	-14,513.33	-14,513.33	
1/1/2023	Fatura		Taksë Ndërtese	7,416.00	7,416.00	
1/1/2023	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndriçimi, Gjellërimi	10,000.00	10,000.00	
	6	A. S.				12,000
						103,200

Tabela nr. 3: Rastet e specialistes së vlerësimit tatimor znj. R. P.

Data e Postimit	Tipi i Dokumentit	VAT Registration No	Përshkrim	Vlera Fillestare	Vlera	Vlera e Mbetur	Vlera qe mungon
1/1/2022	Fatura		Taksë Ndërtese	22,248	22,248	0	
1/1/2022	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndriçimi, Gjellërimi	12,500	12,500	0	
4/20/2022	Pagesa		A.	-34,748	-34,748	0	
	1	H. L.					72,000
Data e Postimit	Tipi i Dokumentit	VAT Registration No	Përshkrim	Vlera Fillestare	Vlera	Vlera e Mbetur	
10/1/2021	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndriçimi, Gjellërimi	2,000	2,000	0	
10/1/2021	Fatura		Taksë Ndërtese	1,483	1,483	0	
10/27/2021	Pagesa		C.	-3,483	-3,483	0	
4/11/2022	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndriçimi, Gjellërimi	15,000	15,000	0	
1/1/2023	Fatura		Taksë Ndërtese	7,045	7,045	7,045	
1/1/2023	Fatura		Tarifë Shfrytëzimi i Hapësirave Publike	153,600	153,600	153,600	
4/25/2023	Kamatëvonesa		Kamatëvonesa	3,306	3,306	3,306	
4/25/2023	Pagesa		O. B.	-15,000	-15,000	0	
	2	B. M.					153,600
Data e Postimit	Tipi i Dokumentit	VAT Registration No	Përshkrim	Vlera Fillestare	Vlera		

Data e Postimit	Tipi i Dokumentit	VAT Registration No	Përshkrim	Vlera Fillestare	Vlera	Vlera e Mbetur	Vlera qe mungon
3/28/2022	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrichiimi, Gjellbërimi	15,000	15,000		
3/28/2022	Fatura		Taksë Ndërtese	5,840	5,840		
6/24/2022	Kamatëvonesa		Kamatëvonesa	813	813		
6/24/2022	Pagesa		I. B.	-20,840	-20,840		
1/1/2023	Fatura		Taksë Ndërtese	7,787	7,787		
1/1/2023	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrichiimi, Gjellbërimi	20,000	20,000		
1/1/2023	Fatura		Tarifë Shfrytëzimi i Hapësirave Publike	64,800	64,800		
	3	A. C.					64,000
Data e Postimit	Tipi i Dokumentit	VAT Registration No	Përshkrim	Vlera Fillestare	Vlera	Vlera	
42370	Fatura		D. 2016	2,500	2,500	2,500	
42736	Fatura		Taksë Ndërtese	21,300	21,300	21,300	
42736	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrichiimi, Gjellbërimi	10,000	10,000	10,000	
42736	Fatura		Tarifë Shfrytëzimi i Hapësirave Publike	36,000	36,000	36,000	
42887	Kamatëvonesa		Gjobe 0.06 % ne dite	789	789	789	
42887	Pagesa		C.	-31,300	-31,300	-31,300	
42887	Pagesa		C.	-2,500	-2,500	-2,500	
43101	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrichiimi, Gjellbërimi	10,000	10,000	10,000	
43101	Fatura		Taksë Ndërtese	5,325	5,325	5,325	
43131	Kamatëvonesa		Gjobe 0.06 % ne dite	670	670	670	
43131	Pagesa		C. B.	-36,789	-36,789	-36,789	
43191	Fatura		Taksë Ndërtese	9,872	9,872	9,872	
43466	Fatura		Taksë Ndërtese	13,163	13,163	13,163	
43466	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrichiimi, Gjellbërimi	10,000	10,000	10,000	
43593	Kamatëvonesa		Gjobe 0.06 % ne dite	5,768	5,768	5,768	
43593	Pagesa		C.	-25,867	-25,867	-25,867	
43825	Kamatëvonesa		Gjobe 0.06 % ne dite	3,224	3,224	3,224	
43825	Pagesa		C.	-28,932	-28,932	-28,932	
43831	Fatura		Tarifë Pastrim, Ndrichiim, Gjellbërim	12,000	12,000	12,000	
43831	Fatura		Taksë Ndërtese	13,163	13,163	13,163	
44116	Fatura		Tarifë Shfrytëzimi i Hapësirave Publike	24,000	24,000	24,000	
44160	Kamatëvonesa		Gjobe 0.06 % ne dite	1,515	1,515	1,515	
44160	Pagesa		C.	-3,224	-3,224	-3,224	
44197	Fatura		Taksë Ndërtese	13,163	13,163	13,163	
44197	Fatura		Tarifë Pastrim, Ndrichiim, Gjellbërim	12,000	12,000	12,000	
44197	Fatura		Tarifë Shfrytëzimi i Hapësirave Publike	72,000	72,000	72,000	
44411	Kamatëvonesa		Gjobe 0.06 % ne dite	8,989	8,989	8,989	
44411	Pagesa		A.	-50,678	-50,678	-50,678	
44562	Fatura		Taksë Ndërtese	13,163	13,163	13,163	
44562	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrichiimi, Gjellbërimi	20,000	20,000	20,000	
44677	Kamatëvonesa		Dok. Rreg.Fin. i Pag. Shtese 25174	13,462	13,462	13,462	
44677	Pagesa		C.	-139,316	-139,316	-139,316	
44700	Pagesa		C.	-13,462	-13,462	-13,462	
44927	Fatura		Taksë Ndërtese	13,163	13,163	13,163	
44927	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrichiimi, Gjellbërimi	25,000	25,000	25,000	
	4	K. L.					72,000

Data e Postimit	Tipi i Dokumentit	VAT Registration No	Përshkrim	Vlera Fillestare	Vlera	Vlera e Mbetur	Vlera qe mungon
1/1/2016	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrëçimi, Gjellbërimi	2,500	2,500		
1/1/2016	Fatura		Taksë Ndërtese	3,000	3,000		
3/23/2022	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrëçimi, Gjellbërimi	8,333	8,333		
3/23/2022	Fatura		Taksë Ndërtese	9,888	9,888		
4/28/2022	Kamatëvonesa		Dok. Rreg. Fin. i Pag. Shtese 25449	87	87		
4/28/2022	Pagesa		C.	-23,721	-23,721		
1/1/2023	Fatura		Taksë Ndërtese	11,866	11,866		
1/1/2023	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrëçimi, Gjellbërimi	10,000	10,000		
4/20/2023	Pagesa		C.	-21,953	-21,953		
6/1/2023	Fatura		Tarifë Shfrytëzimi i Hapësirave Publike	12,000	12,000		
	6	S. M.					18,000
Data e Postimit	Tipi i Dokumentit	VAT Registration No	Përshkrim	Vlera Fillestare	Vlera	Vlera e Mbetur	
10/11/2021	Fatura		Tarifë Pastrim, Ndrëçim, Gjellbërim	3,000	3,000	3,000	
1/1/2022	Fatura		Taksë Ndërtese	9,455	9,455	9,455	
1/1/2022	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrëçimi, Gjellbërimi	20,000	20,000	20,000	
12/31/2022	Kamatëvonesa		Gjobe 0.06 % ne dite	657	657	657	
1/1/2023	Fatura		Taksë Ndërtese	9,455	9,455	9,455	
1/1/2023	Fatura		Tarifë Pastrimi, Ndrëçimi, Gjellbërimi	20,000	20,000	20,000	
	7	E. B.					90,000
							572,800

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshti me shkresë nr. 11597, datë 27.10.2023 (prot KLSH nr. 1026/29, datë 3.11.2023) “Mbi Projektraportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Lidhur me gjetjen e mësipërme, punonjësja R. P. ka kundërshtuar si me poshtë: Ju bëj me dije se sektori i pranimit kryen vlerësimin tatimor në bazë të dokumenteve justifikues dhe rregjistrat gjeografik. Në zbatim të pikës d të Nenit 108, Kapitulli 3, Vendim Nr.11 datë 29.03.2012 “ Për miratimin e rregullores së Bashkisë Vlorë” i takon për të na i dorëzuar sektori i kontrollit në terren.

Sipas akt –kontrollit me nr. serial 000461, datë 22.02.22 bashkëlidhur subjekti fizik “ A. R.” nuk ushtron aktivitet.

Subjekti “O.” ShPK, pas shqyrtimit të dokumentacionit pronësor matja e sipërfaqes së hapësirës publike është bere gabim nga inspektorët e kontrollit në terren, pasi nuk është hapësirë publike por truell në pronësi të vet subjektit . Subjekti ushtron aktivitet në truallin e ti.

Subjekti “I. S. B.” është vlerësuar në fillim të vitit ushtrimor për taksë tabele dhe ka bere zëvendësim të tabelës në datën 26.10.2022. Asnjë nga subjekte nuk është lënë qëllimisht pa u ngarkuar me detyrime tatimore. Por këto subjekte do të faturohen nga specialisti i cili ka marrë në dorëzim Rajonin 2 sipas rregullores se brendshme të Bashkisë Vlorë dhe urdhra të punës do të kryhet dhe rivlerësimi tatimor pa shmangur kamatëvonesat me vlerën 0.06% të shumës së

faturuar, e cila gjenerohen automatikisht pas shlyerjes së detyrimeve, si rrjedhojë pa shmangur arkëtimet kundrejt thesarit të Bashkisë Vlorë.

Qëndrim i grupit të KLSH

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

Observacioni i paraqitur pranohet pjesërisht për rastet kur ishin të argumentuara me dokumentacion mbështetës. Ndërsa rastet e tjera nuk merren në konsideratë, pasi argumentimet e dhëna nuk përbëjnë fakte të reja.

- Menaxhimi i debitorëve nga DAV Bashkia Vlorë.

Titulli gjetjes: Masat e marra nga DAV Bashkia Vlorë, mbi menaxhimin e debitorëve periudha objekt auditimit (2021/2022), dhe problematikat e shumta mbi kartelat e paraqitura në sistemin TAIS, të verifikuara nga raporti statistikor i gjeneruar nga sistemi për periudhën 01/01/2021 – 31.12.2022.

Situata: Referuar strukturës së DAV Bashkia Vlorë, konstatohet se menaxhimi i borxhit bëhet nga Sektori i Menaxhimit të borxhit i përbërë nga 2 inspektor, konkretisht: **F. Ll.** (nga viti 1999 e vijim) dhe **A. Sh.** (emëruar me 3.6.2022 e vijon).

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se gjendja e debitorëve në fund të periudhës 31.12.2022 paraqitet në vlerën 768,711 mijë lekë kjo për 52767 subjekte, sipas të dhënave të pasqyrës si vijon:

Pasqyra 1

EMËRTIMI	2021		2022	
	Vlera	Nr/Subjekt	Vlera	Nr. Subjekt
Biznesi i madh	129,466,325	780	127,292,477	930
Biznesi i vogël	232,750,168	4213	257,759,154	5119
Individë	17,701,682	149	13,901,374	141
Abonent familjarë	272,235,054	26357	369,758,437	46577
Debitorë ne total	652,153,229	31,499	768,711,442	52,767

Referuar të dhënave të pasqyrës, konstatohet se niveli i borxhit nga një periudhë në tjetër vjen në rritje si në numër subjektesh po ashtu dhe në vlera, kështu nga viti 2021 në vitin 2022 ky nivel është rritur për vlerën **22,835,138 lekë**, si dhe numër i subjekteve **1056** subjekte.

Nga DAV Bashkia Vlorë në planifikimit e të ardhurave bëhej dhe planifikimi i debitorëve ku për cdo vit planifikohej në vlerën 65,000 mijë lekë. Ky planifikim varjon në nivelet 16-17% të totalit të debitorëve, kjo me argumentin se referuar statistikave të viteve kaq është pritshmëria e vjeljes së debitorëve në periudha ushtrimore.

Po kështu dhe niveli i arkëtimeve paraqitet me ulje në vlerën 11,616 mijë lekë. Ku për vitin 2021 është arkëtuar vlera 94,826 mijë lekë të debisë së vitit 2020 për vlerën 376,873 mijë lekë ose 25% dhe për vitin 2022 është arkëtuar vlera 83,210 mijë lekë të vlerës së detyrimeve të vitit 2021 ose 20.8%.

Ndërsa në total duke marrë në konsideratë dhe debitorët familjarë, kjo diferencë është akoma më e madhes për shumën 116,585 mijë lekë për 21268 subjekte/abonentët familjarë, për vitet 2021/2022.

Konstatohet se totali i debisë për bashkinë Vlorë është 59.1% e planit të taksave e tarifave vendore dhe 33.4% e planit të buxhetit. Pra këto të dhëna tregojnë se vlera e detyrimeve debitorë është në nivelin shumë të lartë, ku peshën kryesore e zënë debitorët familjar në shumën 369,758 mijë lekë ose 48% e totalit të detyrimeve.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se mosha e borxhit për subjektet e biznesit të madh, biznesit të vogël dhe pronarë të bizneseve, paraqitet si më poshtë:

Moshë e Borxhit	2022	
	Vlera	Nr. Subjekte
Totali		
1 deri 3 vite	84,663,994	3297
Nga 3 deri 5 vite	96,440,053	1030
Mbi 5 vjet	222,551,380	1999
Debitor pa shpresë arkëtimi	123,506,372	1285

Referuar të dhënave të pasqyrës, vlerën më të lartë të borxhit e zënë debitorët e moshës mbi 5 vite për vlerën **222,551** mijë lekë ose 55.7% e ndjekur nga **borxh i keq (pa shpresë arkëtimi)** për 1285 subjekte me vlerë 123,506 mijë lekë ose 30% e totalit të debitorëve për taksat/tarifave vendore.

- **Historiku i lëvizjes së debitorëve.**

Sipas të dhënave të paraqitura nga sektori i borxhit dhe përpunimi i tyre, konstatohet se krahasuar me vitet e mëparshme gjendja në fund të çdo viti e vlerës së debisë, paraqitet si më poshtë:

Debia sipas viteve	Nr. i subjekteve	Vlera	% rritjes se vlerës se debisë	Rritja e vlerës se debisë ne lek
Debia deri 31.12.2017	2870	243,548,445.00		
Debia deri 31.12.2018	4458	287,771,902.00	18.16%	44,223,457.00
Debia deri 31.12.2019	4783	324,901,227.00	12.90%	37,129,325.00
Debia deri 31.12.2020	5502	376,837,174.00	15.99%	51,935,947.00
Debia deri 31.12.2021	6190	398,953,005.00	5.50%	22,657,991.00
Debia deri 31.12.2022	6326	403,655,427.00	1.18%	4,702,422.00

Gjithashtu, nga të dhënat e disponueshme, konstatohet se për periudhën objekt auditimi, ka dhe subjekte të cilat janë me status pasiv ose të çregjistruar nga QKB, por që nuk kanë bërë të mundur likuidimin e detyrimeve për taksat e tarifave vendore. Kështu për vitin 2021 janë 3541 subjekte me vlerë **264,443** mijë lekë ose 70.2% totali të detyrimeve nga taksat/tarifave vendore dhe për vitin 2022 janë 3127 subjekte me vlerë **238,347** mijë lekë ose 59.7% e totalit të detyrimeve nga taksat/tarifave vendore.

Në këto kushte DAV Bashkia Vlorë duhet të ketë një bashkëpunim me të madh me Administratën e QKB dhe mos lejoje fenomene të tilla, si dhe për subjektet të cilat janë me status pasiv/mbyllur, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni

181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve⁸, me pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45⁹ – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” (me ndryshime).

- **Masat e marra nga DAV Bashkia Vlorë për arkëtimin e debitorëve.**

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga DAV Bashkia Vlorë për vitet 2021/2022 dhe kundërshtive të subjektit, rezulton se nga kjo administratë (Sektori i borxhit), janë ndërmarrë këto hapa për vjeljen e debitorëve, konkretisht:

Për vitin 2021 kemi patur objekt pune **5142 debitore** me shume **376,837,175 lekë**, nga këto subjekte:

Për 4323 debitore = 1230 debitore për vitin 2021 + 3093 debitore për periudhën 2011-2020 me shumë totale **307,045,135 lekë** janë kryer procedurat e borxhit, ndërsa **për 819 debitorë** me shumë **6,385,824 lekë** nuk janë bërë procedurat e borxhit, pasi janë debitore me vlere nën 1,000 lekë (*procedure që nuk justifikon shpenzimet kancelarie, duke patur parasysh se për një subjekt duhen dërguar me poste rreth 16 praktika shkresore*).

Pra numri i masave të marrë nga sektori borxhit është në masën **84 %** të nr. total të debitorëve .

Për vitin 2022 kemi patur objekt pune **6190 debitore** me shume 398,953,004 lekë, nga këto subjekte:

Për 5272 debitore = 1587 debitore për vitin 2022 + 3685 debitore për periudhën 2011-2021 me shumë **392,479,247 lekë**, janë kryer procedurat e borxhit, ndërsa **për 918 debitorë me shumë 6.473757 lekë**, nuk janë bërë procedurat e borxhit, pasi janë debitore me vlere nën 1000 lekë (*procedure që nuk justifikon shpenzimet kancelarie, duke patur parasysh se për një subjekt duhen dërguar me poste rreth 16 praktika shkresore*).

Pra numri i masave të marre nga sektori ynë është në masën **85.2 %** të nr. total të debitorëve

⁸Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithëse mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

⁹**Pika 3.** Qendra Kombëtare e Biznesit ose gjykata, menjëherë me marrjen e kërkesës për çregjistrim prej tatimpaguesit, njofton organin tatimor kompetent për regjistrimin e hapjes së procedurave të likuidimit ose për kërkesën për çregjistrim të personit fizik apo për aplikimin për çregjistrim të personit juridik edhe kur kemi të bëjmë me aplikimin për çregjistrim pa kryerjen e likuidimit.

Pika 4. Organi tatimor kompetent, brenda 10 ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës për çregjistrim, sipas pikës 3, të këtij neni, është i detyruar të verifikojë situatën tatimore të subjekteve dhe njofton njëkohësisht QKB-në ose gjykatën dhe subjektin. Kur organi tatimor, sipas analizës së riskut, gjykon se është e nevojshme të ushtrojë kontroll në mjedisin ku ushtron veprimtarinë subjekti, atëherë ky afat nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë pune, përfshirë kryerjen e kontrollit. **Pika 5.** Qendra Kombëtare e Biznesit ose gjykata nuk mund të kryejë çregjistrimin, në qoftë se brenda afatit 30-ditor, të përmendur në pikën 4, të këtij neni, administrata tatimore e kundërshton me shkrim çregjistrimin. Kundërshtimi i çregjistrimit të tatimpaguesit nga administrata tatimore tregon shumën e detyrimeve tatimore të papaguara të tatimpaguesit dhe, në rastin e personit juridik, faktin se ai nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit deri në momentin e likuidimit, ose nuk ka dorëzuar deklaratat tatimore.

Pika 6. Nëse organi tatimor nuk i përgjigjet QKB-së ose gjykatës brenda afatit, QKB-ja ose gjykata çregjistron automatikisht subjektin dhe njofton në të njëjtën ditë organin tatimor dhe tatimpaguesin. Në rastin kur subjektet e regjistruara pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ose gjykatës rezultojnë me detyrime tatimore, ato çregjistrohen automatikisht pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet tatimore, përfshirë detyrimet që lindin në rastin kur çregjistrimi kryhet me likuidim. Në momentin kur subjekti paguan detyrimet tatimore, organi tatimor menjëherë njofton QKB -në ose gjykatën dhe subjektin, që subjekti nuk ka detyrime tatimore të papaguara.

Duke vlerësuar riskun e praktikave të menaxhimit të borxhit u përzgjedhën disa raste për auditimin e procedurave që janë kryer, *rezultoi se:*

- Për Institucionet shtetërore, të identifikuar si debitorë është ndjekur vetëm procedura e nxjerrjes së Njoftimit për Pagesë të Detyrimeve Tatimore dhe nuk është vazhduar me asnjë procedurë tjetër.

- Nuk gjen zbatim ndryshimi ligjor i nenit 89¹⁰ i ligjit të procedurave tatimore.

- Nuk janë ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, **pasi** janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar **kallëzim penal** bazuar në nenin 181 “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar.

Kriteri: Këto veprime janë në kundërshtim me: **Ligjin** nr. 9920 datë 19.05.2018 “Për procedurat tatimore në RSH:; i ndryshuar, respektivisht nenet: - *Neni 89-Njoftimi dhe kërkesa për pagim të detyrimeve;* - *Neni 90-Urdhër bllokimet ;* - *Neni 92- Masa për sigurimin e detyrimit tatimor, nuk janë bërë për të gjithë subjektet debitorë;* - *Neni 93- Sekuestro dhe konfiskim i pasurisë ;* - *Neni 94- Urdhër sekuestrimi, nuk gjen zbatim në asnjë moment, duke parë që një pjesë e subjekteve janë debitorë nga njëra periudhë në tjetër;* - *Neni 181-Mos pagimi i taksave dhe tatimeve, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime.* Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe VKB nr. 88, datë 24.12.2022.

Ndikimi/Efekti: Mos zbatimi i dispozitave ligjore në arkëtimin e debitorëve të të gjitha llojeve (fizik/juridik/abonentë familjarë etj), të cilat zënë rreth **59.1%** të planit vjetor të taksave/tarifave dhe **33.4%** të buxhetit të bashkisë, bëjnë që bashkia të mund të mos realizojë projektet e investimeve dhe shërbimeve të ndryshme që bashkia planifikon në fillim të çdo vitit buxhetor, ku mungesa e mos realizimit të të ardhurave e bën të pamundur atë dhe njëkohësisht bëhet shkak për rritjen e faturave të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore (kreditorë). Kështu deri në fund të vitit 2022, si rezultat i punës së pamjaftueshëm të DAV Bashkia Vlorë dhe strukturave të tjera të ngarkuara sipas rregullores së brendshme të bashkisë, **për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: z. D. L. me detyrë ish-Kryetar i Bashkisë Vlorë**, për mos organizim me personel të mjaftueshëm të sektorit të borxhit dhe pas kërkesave të DAV Bashkia Vlorë; **z. F. Ll.** (nga viti 1999 e vijim); **znj. A. Sh.** (emëruar me 03/06/20022 e vijon).

Shkaku: Punë e pamjaftueshme nga strukturat përgjegjëse në mirë menaxhimit e tij në zbatim të kuadrit ligjorë dhe numër i ulët i inspektorëve të ngarkuar për menaxhimin e borxhit. Mungesa e bashkëpunimit të strukturave përgjegjëse Bashkia Vlorë me agjentët tatimorë në planifikimin, arkëtimin dhe derdhjen në buxhetin e bashkisë të detyrimeve fiskale.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Vlorë në bashkëpunim me sektorët e tjerë të Bashkisë Vlorë, si Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, Drejtoria e Planifikimit Zhvillim Territorit, Drejtorinë Juridike, Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë Financës

¹⁰ ; “ Në funksion të mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit, administrata tatimore mund të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume **jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar**, por jo më shumë se detyrimi tatimor, për të cilin ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, për llogari të detyrimeve tatimore të pashlyera të tatimpaguesit”

Buxhetit dhe Kontabilitetit, të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve debitorë në vlerën **768,711,442 lekë** kjo për **52767** subjekte/abonent familjare, për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit të keq që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshti me shkresë nr. 11597, datë 27.10.2023 (prot KLSH nr. 1026/29, datë 3.11.2023) “Mbi Projektraportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Ne lidhje me ne si inspektorë borxhin, nuk ka nje shkresë drejtuar drejtorisë juridike ne lidhje me: a. Procedurën e sekuestros sipas nenit 93,94 të Ligjit 9920 date.19.05.2008 : “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Siç e kemi theksuar dhe tek observacioni ndaj Akt Konstatimit nr. 3 mbajtur datë.14.07.2023 nga audituesit e KLSH-së, që të kryhet kjo procedure duhet të krijohet komisioni i vlerësimit dhe i shitjes së pasurisë më ankand, krijimi i të cilit bazuar mbi ligjin Nr.9874, date 14.02.2008 “Për ankandin publik” , neni 3 pika 2, a) është jashtë kompetencave tona si inspektor te sektorit te borxhit tatimor.

Per procedurat e konfiskimit përpos personelit tone te kufizuar ne borxh, duhet te bëhen pjese te komisionit dhe eksperte te vlerësimit te pasurisë (vlerësimi inxhinierik dhe kontabël) dhe baze logjistike. Përmeshja e këtyre dy kushteve te përmendura me sipër, qe mundësojnë realizimin e procedurave te sekuestro-konfiskimit në zbatim të neni 93, 94 të ligjit tatimor, nuk janë kompetencë e personelit të borxhit. Si mund te çojmë nje liste debitorësh ne drejtorinë juridike për procedurën e Sekuestro Konfiskim kur mungojnë strukturat per vijimin e procedurave deri ne konfiskim te pasurisë te tatimpaguesit debitore, praktikë që jo vetëm administrata vendore e Bashkisë Vlorë por, asnjë administrate vendore të Bashkive të mëdha nuk e kane kryer ndonjëherë gjatë këtyre 30 viteve! Ky fakt tregon mese miri se kjo procedure sekuestro-konfiskimi mundësohet vetëm përmes shprehjes së vullnetit e te vendimmarrjes së strukturave drejtuese të Bashkisë.

Ndaj për këto arsye të përmendura më lart ne nuk mund të bëhemi përgjegjës për mos kryerjen e kësaj praktike ligjore! b. Kallëzimin penal sipas neni 181 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë miratuar me ligjin nr.7895,datë 27.01.1995 i ndryshuar. Siç e kemi theksuar dhe tek observacioni ndaj Akt Konstatimit nr.3 mbajtur datë.14.07.2023 Në neni 181 te Kodit Penal thuhet: “Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithë mundësinë e pagimit të tyre nga persona ndaj të cilëve janë marë më parë masa administrative për këtë qëllim dënohen me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet”. Pra siç shihet, objekt i nenit 181 bën fjalë vetëm për atë tatimpagues për të cilin:

E para është konfirmuar fakti që ky tatimpagues i ka plotësisht mundësitë për t`i paguar detyrimet e prapambetura. Ne, si sektor i borxhit tatimor vendor nuk posedojmë ndonjë rrugë tjetër administrative që ligji na ngarkon, që ne të sigurojmë informacion shtesë e të konfirmojmë, që këta debitorë e kanë plotësisht mundësinë për ti paguar detyrimet e prapambetura, siç e kërkon neni 181 i Kodit Penal ,pasi drejtoria e te ardhurve vendore nuk ka attribute te nje organi hetimor.

E dyta ndjekja penale ndaj tij të behet vetëm pasi jane marre te gjitha masat administrative, që nënkupton edhe kryerjen e plote te procedurës se mbledhjes me force te detyrimeve te papaguara nga sektori i borxhit, sipas Kreu XI :” Mbledhja me force e detyrimeve te papaguara” neni. 89. 90, 91, 93, 94.” Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 ”Per Procedurat Tatimore ne Rep. Shqipërisë”. Për këto arsye të përmendura më sipër : pamundësinë për të vërtetuar në se e ka apo jo mundësinë për të paguar detyrimet debitori si dhe pa kryer të gjithë procedurat tatimore të mbledhjes me

forcë të detyrimeve të prapambetura ne nuk mund të çojmë një listë debitorësh drejtorisë juridikë për ndjekje penale Ndaj për këto arsye të përmendura më lart s' mund të bëhemi përgjegjës në si inspektor borxhi, për mos kryerjen e kësaj praktike ligjore! Problemet e ngritura nga ana juaj në këtë kontroll, sigurisht janë një ndihmese për ne, pasi do të na ndihmojnë në përmirësimin e mëtejshëm të punës tonë si sektor i borxhit tatimor dhe ju falënderojmë për sugjerimet tuaja.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa kundërshtoni argumentet nuk merren në konsideratë, pasi në referencë të **Ligjit** nr. 9920 datë 19.05.2018 “Për procedurat tatimore në RSH., i ndryshuar, Kreu XI- Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara, është detyrë e sektorit të mbledhjes së detyrimeve zbatimi i këtij kreu, pavarësisht faktit se ka struktura të ngritura për ecurinë e mëtejshme të procesin. Nga ana juaj duhet të ishin zbatuar kjo dispozitë për të gjithë debitorët të cilat janë të shumë në numër dhe vlera të konsiderueshëm dhe që ushtrojnë aktivitetet.

- **“Mbi auditimin e të ardhurave “shqyrtimin e ankesave të subjekteve për detyrimet fiskale periudha 01.01.2021 – 31.12.2022”.**

Në zbatim të vendimit të Kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. 108, datë 18/10/2018 (*prot 7814/1*), është miratuar Rregullorja e Organizmit dhe Funksionimit në strukturën vendore të Komisionit të Apelitit Tatimorë në bashkinë Vlorë.

Në zbatim të kësaj rregulloreje, Kryetari i Bashkisë me urdhër nr. 258, datë 20/11/2018 (*prot 10066 Bashkia Vlorë*) ka ngritur komisionin me këtë përbërje: **Sh. R. / kryetar, O. B., T. Z., E. P., J. Gj.**

Me urdhër nr. 240, datë 10/11/2020 (*prot 10323 Bashkia Vlorë*) është bërë zëvendësimi i disa prej anëtarëve, ku **znj. A. Sh.** zëvendëson **z. O. B.** dhe **znj. A. P.** zëvendëson **z. J. Gj.**

Gjithashtu me urdhër nr. 267, datë 20/10/2021 (*prot 14153 Bashkia Vlorë*) është bërë zëvendësim anëtarësh, ku **znj. A. V.** zëvendëson **z. Sh. R.** dhe **znj. O. M.** zëvendëson **znj. Xh. K.**

Nga sa sipër për periudhën objekti auditimi anëtarë të komisionit të apelitit janë: **znj. A. V. / Kryetar, znj. O. M., znj. A. Sh., z. T. Z., z. E. P., znj. A. P., znj. O. M.**

Sipas dokumentacionit të paraqitur, rezulton se për periudhën objekti auditimi kanë paraqitur ankesë për detyrimet fiskale, gjithsej **5 subjekte**, si më poshtë vijon:

1- Me shkresën ankesë nr. s'ka, datë 08/04/2022 paraqitur ankesë nga subjekti “**B. A. I.**” sha, ku kundërshton vlerësimin tatimorë nr. 2450, datë 07/03/2022 në shumën **787,500 lekë**, të vitit 2021 për taksë reklame me emërtimin “*Reklama në Klubin Shumësportesh Flamurtari*”.

2- Me shkresën ankesë e datë 15/11/2021 (*prot Bashkia Vlorë nr. 15145, datë 15/11/2021*), ka paraqitur ankesë subjekti “**N. B.**” me aktivitet “*bar restorant hotel*”, për anulimin pjesërisht të aktit administrativ nr. 14897, datë 09/11/2021 për sipërfaqen e jashtme e përlogaritur **prej 50 m²**, për shkak se kjo sipërfaqe nuk është në pronësi të Bashkisë Vlorë.

3- Me shkresën nr. s'ka, datë 21/07/2022 (*prot 8550, datë 28/07/2022 Bashkia Vlorë*), shoqëria “**T. K. VI**”, ka paraqitur ankesë për anulimin e shkresës nr. 2450 prot, datë 07/03/2022, ku është shpallur debitorë për shumën **170,018 lekë**.

4- Me shkresën nr. s'ka, datë 16.9.2022 (*prot 10659, datë 22/09/2022 Bashkia Vlorë*), shoqëria “**A. K.**” ShPK ka paraqitur ankesë mbi detyrimin prej **332,978 lekë** të paraqitur nga DAV Bashkia Vlorë me shkresën nr. 9838 prot, datë 01/09/2022 “*Njoftim vlerësim tatimor*” për taksën e ndërtesës.

5- Me shkresën datë 12/09/2022 (prot nr. 10228, Bashkia Vlorë), nga subjekti fizik “**L. T.**” është paraqitur ankesë mbi faturën për arkëtim të lëshuar nga DAV Bashkia Vlorë, për vlerën 4,167,243 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se për tre ankesa, respektivisht ankesat e subjekteve “**B. A. I.**” sha, “**N. B.**” dhe “**T. K. VI**”, KAT ka vepruar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të ligjit të procedurave tatimore dhe rregullores së KAT dhe rregullores së brendshme Bashkia Vlorë. Në lidhje me subjektin “**A. KEK**” ShPK, veprimi KAT nuk është sipas akteve ligjore, pasi ai i është kaluar për shqyrtim inspektores së dosjes znj. R. P., e cila është inspektorja që ka kryer vlerësimin për të cilën subjekti është ankuar, veprime në kundërshtim me VKB n nr. 108, datë 18/10/2018 “Rregullorja e funksionimit të KAT”, ku të drejtën e shqyrtimit e ka ky komision (pika 2,2 e rregullores), **për të cilën ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KAT.**

Titulli gjetjes: *Mangësitë e konstatuara në ankesën e subjektit “L. T.” PF, për vlerësimin tatimorë në vlerën 4,167,243 lekë.*

Situata: Me shkresën datë 12/09/2022 (prot nr. 10228, Bashkia Vlorë), nga subjekti “**L. T.**” PF është paraqitur ankesë mbi faturën për arkëtim të lëshuar nga DAV Bashkia Vlorë në vlerën 4,167,243 lekë, ku përmbledhurazi thuhet se:

“Nga ana ime si subjekt gjatë gjithë periudhës që kam kryer aktivitet kam likujduar detyrimet sipas njoftim vlerësimeve të dërguara nga DAV Bashkia Vlorë (2016; 2017; 2018; 2019; 2020; 2021 dhe 2022). Cila është dokumentacioni dhe baza ligjorë që ju jeni referuar për këtë detyrim tatimor të rivlerësuar. Referuar dispozitave të ligjit për urbanistikën dhe dokumentacionit që disponoj, trualli për të cilën jam vlerësuar nuk është hapësirë publike. Cili është dokumentacioni si dhe kopje e aktkonstatim mbi verifikimin e kryer nga inspektorët, ku ju jeni bazuar në përllogaritje dhe keni tarifuar detyrimet. Është kërkuar se cila ka qenë indicja që inspektorja e dosjes ka bërë rivlerësim, kjo bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 “Për procedurat tatimor në RSH” i ndryshuar”.

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e auditimit dhe sistemin TAIS, rezulton se: Sipas të dhënave të QKB subjekti është regjistruar në vitin 2015 (datë 22/07/2015) dhe aktivitet “*Bar-restorant, pizeri, import eksport*” (PF). Sipas historikut të QKB subjekti punon në sezone (tre deri katër muaj).

Nga DAV Bashkia Vlorë (inspektorja e dosjes znj. R. P.), subjektit i është bërë vlerësim nga zyra për të cilën ka dalë faturë arkëtimi me datë 25.8.2022 në shumën **4,167,243 lekë** për zërin “*Tarifa shfrytëzim hapësirë publike*”, per sipërfaqe publike prej **442.55 m², për 5 vitet.**

Ky njoftim vlerësimi i cili i është përcjellë subjektit mban vetëm nënshkrimin e inspektorit të dosjes (R. P.), **por jo të Përgj/Sektorit të Vlerësimit, z. E. P. dhe Drejtorit të DAV Bashkia Vlorë, znj. A. Sh.**

Me urdhër pune datë 6.9.2022 të Drejtorit të DAV Bashkia Vlorë, **znj. A. Sh.** në zbatim të kërkesës së Përgjegjësit të Vlerësimit, **z. E. P.**, është ngritur grupi i punës i përbërë nga specialistët: **z. E. P., përgjegjës** dhe anëtarët **z. I. M., anëtarë inspektor terreni** dhe **z. G. A., inspektor i taksës së pasurisë** dhe topografin e DPPMA, **z. K. A.**

Nga të dhënat, konstatohet se njoftim vlerësimi tatimor është prodhuar më herët se sa është kryer akt kontrollin nga inspektorët e terrenit (kontrolli është bërë në datën 6.9.2022, ndërsa njoftim vlerësimi mban datën 25.8.2022).

Sipas të dhënave të aktkontrollit, në përfundim është konkluduar se sipërfaqja totale është 1008 m², ku objekt banimi 255 m², objekt shërbimi 50 m², hapësirë shërbimi me tavolinë 120 m² dhe 583 m² është hapësirë ku përfshihen: lulishte, rrugë hyrëse dhe pjesë e pashfrytëzuar nga pronari. Sipas pretendimeve të subjektit kjo sipërfaqe është tokë private. Ju la detyrë subjektit mbi paraqitjen e dokumentacionit vërtetues të pronësisë mbi tokën.

Me shkresën datë 16.9.2022, grupi i punës informon Drejtorinë e DAV Bashkia Vlorë, **znj. A. Sh.** dhe specialistet e pranimit, **znj. R. P.**, mbi rezultat e aktkontrollit nr. 1860, datë 6.9.2022, **ku janë të specifikuar matjet faktike në vend.** Gjithashtu, ju la detyrë subjektit për plotësimin e dosjes me dokumentacion e munguar mbi pronësinë.

Me shkresën datë 20.9.2022 të Drejtorit të DAV Bashkia Vlorë, **znj. A. Sh.**, i është drejtuar Përgjegjësit të Vlerësimit, **z. E. P.** dhe specialistit të dosjes (vlerësim), **znj. R. P.**, që në zbatim të shkresës së grupit të punës datë 16.9.2022 të hartohet shkresa drejtuar ASHK Vlorë mbi konfirmimin e dokumentacionit mbi pronësinë e pasurisë. Në varësi të dokumentacionit të bëhet vlerësimi i mëtejshëm i procedurës. Gjithashtu ti kërkohet planvendosjen bashkisë mbi këtë hapësirë.

Me shkresën nr. 10508 prot, datë 20.9.2022 Bashkia Vlorë nëpërmjet **Kryetarit z. D. L.**, i është drejtuar ASHK Vlorë mbi pronësinë e pasurisë që pretendohet nga subjektit që është në pronë të tij. Në këtë shkresë nuk janë të evidentuara numrat e pasurive që subjekti pretendon, por vetëm adresa ku ndodhet.

Në përgjigje të shkresës së bashkisë nr. 10508 prot, datë 20.9.2022, ASHK informon se pasuria me nr. 42/10, vol 63, faq 39 në zk 8602 është PPV (**pronar pavërtetuar**).

Me shkresën nr. 10228 prot; datë 12.09.2022 subjekti “L. T.”, i është drejtuar Strukturës Vendore të Apelimit Tatimor për faturën për arkëtim lëshuar nga DTTV.

Kjo shkresë nga drejtori DAV Bashkia Vlorë i është kaluar për vlerësim të ankesës dhe të përgatisë dosjen për Strukturën Vendore të Apelimit Tatimor. Ankesa i ka kaluar edhe përgjegjësit z. E. P., ne vijimësi të urdhrit të punës së kërkuar prej tij.

Shkresa është refuzuar nga specialistja duke e kthyer për shqyrtim tek Komisioni Apelimit Tatimor, pa dhënë asnjë argumentimin ligjor se si ka arritur në vlerësim të subjektit me ato detyrime, kur deri në atë datë ka qenë po e njëjta punonjëse që ka kryer vlerësimin e subjektit për vitet e mëparshme (*sipas pretendimit të subjektit në ankesën e bërë prej tij*).

Në lidhje me këtë vlerësim është vënë në dijeni edhe Drejtoria Juridike mbi procedurën e ndjekur nga DAV dhe ankesën e subjektit me shkresën nr. 10228 prot; datë 12.09.2022.

Me shkresën nr. 11129 prot; datë 4.10.2022 subjekti “L. T.” i është drejtuar sërish specialistit me ankesën për faturën për arkëtim, e cila ka përpiluar shkresën mbi ankesën për faturën për arkëtim në muajin nëntor 2022, ku ka argumentuar vlerësimin tatimor. Kjo shkresë nuk është miratuar nga përgjegjësi i sektorit.

Në datën 04.10.2022, **z. E. P.** me detyrë P/Sektorit Vlerësimi i ka kërkuar specialistes **znj. R. P.** informacion mbi:

- *Procedurën e ndjekur për detyrimin tatimor të këtyre subjekteve*
- *Bazën ligjore mbi të cilën je mbështetur për vlerësimin tatimor, për subjektin “L. T.”, shkresë e cila nuk ka përgjigje.*

Nisur nga mos përgjigjja e kësaj shkrese, në datën 9.12.2022 nga ana e Përgjegjësit Sektorit të Vlerësimit është bërë një relacion mbi vlerësimin e subjektit “L. T.”, i cili i ka kaluar Drejtorit të DAV Bashkia Vlorë, ku sqarohet se:

“Vlerësimi tatimor në sistemin TAIS është bërë në datën 25.08.2022 dhe akt kontrolli I terrenit mban datën 6.9.2022. Nisur nga rregullorja e funksionimit të bashkisë, neni 106- detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit të vlerësimit tatimor

për biznesin, pika (b), thekson se: bën përditësime të detajuara të të dhënave për ushtrimin e aktivitetit, llojit, sipërfaqes, periudhat, detyrime shtesë si gjoba, në subjektet e ndryshme tatimpaguese, duke marrë informacionin zyrtarë nga subjekti, institucionet e ngarkuara me ligj, inspektorët e kontrollit në terren si dhe nga sektorë të tjerë të tjerë brenda drejtorisë”.

Vlerësimi i bërë në sistemin TAIS është për zërin hapësirë publike 442.55 m², kurse në akt kontrollin e datës 6.9.2022 ka rezultuar 50 m² objekt shërbimi për aktivitet dhe **120 m² hapësirë** e shërbimit për tavolina dhe karrige.

Sipas përcaktimeve të VKB nr. 79, datë 2.12.2021, Kreu II- pika 1 tarifa për zënien e hapësirës publike për qëllime biznesi citohet:

Subjektet ku evidentohen që përdorin hapësirë publike dhe nuk kanë lidhur akt marrëveshje, vlerësimi i hapësirës publike do të bëhet në bazë të akt kontrolleve të mbajtura nga inspektorët e terrenit të DAV. Afati i përdorimit të hapësirës publike pe qëllime biznesi do të jetë i përcaktuar në kontratën e lidhur apo akt kontrolleve të inspektorëve të terrenit.

Me shkresën nr. 150 prot; datë 09.01.2023, Drejtori DAV Bashkia Vlorë i është drejtuar Kryetarit të Komisionit Vendor të Apelimit Tatimor, duke kërkuar mbështetje dhe koordinim të strukturave brenda Bashkisë Vlorë për çuarjen në një zgjidhje ligjore të vlerësimit me detyrime për subjektet. **Shkresë për të cilën nuk ka asnjë procedurë të ndjekur nga KVAT.**

Ankesa e subjektit “L. T.”, i ka kaluar me emali KAT për të cilën ka patur dy herë njoftim dhe komisioni nuk është mbledhur, kjo sipas dokumentacionit të administruar në dosje **ku nuk ka asnjë procesverbal mbi mbledhje të organizuara për këtë ankesë.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit deri në këtë datë, vihet re se vlerësimi i subjektit në sistemin TAIS është bërë në datën 25.8.2022, ora 09:58:⁴³ AM (sipas faturës për arkëtim konceptuar nga znj. R. P.), **ndërsa akt kontrolli në ambjentet e subjektit është mbajtur në datën 06/06/2022,** (sipas akt kontrollit nr 001860, datë 6.9.2022).

Me shkresë të datës 5.12.2022 Përgjegjësi i Sektorit Vlerësimit **z. E. P.** i ka kthyer përgjigje Drejtorit DAV Bashkia Vlorë, për shkresën e datës 5.10.2022, ku sqaron se specialistit i është kërkuar disa herë të rishikojë këtë vlerësim, ku edhe në shkresën e datës 25.11.2022 mbetet i pandryshuar. Sipas përgjegjësit i cili deklaron se ka arritur në përfundimin se vlerësimi është bërë jo në bazë të procedurave ligjore dhe mos zgjidhjen e situatës së krijuar për vlerësimin e këtij subjekti mes tij dhe përgjegjës e kalon dokumentacionin ligjor tek Drejtorit DAV Bashkia Vlorë, ku bashkëlidhur shkresës ka shkresë të drejtuar specialistes, **për të cilën nuk ka përgjigje.**

Kriteri: Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKB n nr. 108, datë 18/10/2018 “Rregullorja e funksionit të KAT”, ku të drejtën e shqyrtimit e ka ky komision (pika 2,2 e rregullores), si dhe Ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 “Për procedurat tatimore në RSH, i ndryshuar, nenet 68 dhe 71.

Ndikimi/Efekti: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në shqyrtimin e ankesave të subjekteve fizik/juridik si dhe Rivlersimi i situatave pa dokumentacionin e nevojshëm ligjorë, janë veprime që rëndojnë situatën financiare të subjekteve.

Shkaku: Përgjegjësi e inspektorëve personave përgjegjës në zbatimin e kuadrit ligjorë, respektivisht: **znj. A. V.**, me detyrë Zv/Kryetare dhe Kryetare e KAT, për mos shqyrtim të ankesës duke ia deleguar atë DAV Bashkia Vlorë, në kundërshtim me VKB n nr. 108, datë 18/10/2018 “Rregullorja e funksionit të KAT”, ku të drejtën e shqyrtimit e ka ky komision (pika 2,2 e rregullores); **znj. R. P.**, me detyrë specialiste e vlerësimit për rivlerësimin e detyrimit për subjektin “L. T.”, pa dokumentacion argumentues dhe justifikues mbi arsyet që kanë çuar inspektorin e

dosjes në rivlerësim, pasi në dosja nuk ka asnjë indicje për të vënë në lëvizje dispozitat e neneve 68 dhe 71, të Ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 “Për procedurat tatimore në RSH, i ndryshuar.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Komisioni i Apelimit Tatimorë (KAT) të marrë në analizë të plotë shqyrtimin e ankesës së subjektit “L. T. ”, për vlerësimin e situatës mbi njoftim vlerësimin e nxjerrë për vlerën **4,147,243 lekë**.

Gjithashtu në cdo rast Komisioni i Apelimit Tatimorë duhet të marrë në shqyrtim ankesat e subjekteve fizik/juridik në zbatim të kuadrit ligjorë dhe të mos delegojnë ato në instuticionit që i kanë prodhuar këto akte.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë, të ngrëjë një grup pune me specialist të fushës nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Drejtoria DPKZHT dhe Komisioni i Apelimit Tatimorë për verifikimin dhe saktësimin e njoftim detyrimit datë 25.8.2022 të prodhuar nga Sektori i Vlerësimit Tatimor në ngarkim të subjektit “T. Z. (A. H.)” PF për vlerën **2,152,137 lekë**.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshti me shkresë nr. 11597, datë 27.10.2023 (prot KLSH nr. 1026/29, datë 3.11.2023) “Mbi Projektraportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Sipas znj. R. P., në referencë të nenit 105 pika (m) e rregullores së brendshme të bashkisë është detyrë e përgjegjësit të sektorit mbajtja e korrespondencës për QKB, drejtoritë pranë bashkisë dhe me instuticionit e tjera.

Sqarojë se për të dy subjektet “L. T.” dhe “T. Z. (A. H.)”, nga ana ime si inspektore dosje nuk është shkaktuar dëm ekonomik në buxhet dhe as nuk preken interesat e subjekteve.

Në lidhje me subjektin “L. T.” PF, sqarojë se gjatë periudhës së Auditimit unë kam qenë me leje zakonshme prapambetur dhe më pas me leje lindje nga data 20.2.2023 dhe dosja nuk është dhënë nga ana ime. Nga kjo periudhë subjektet e rajonit nr. 2 janë menaxhuar nga specialistja B. Ll.

Nga dokumentacioni plan rilevimi i dorëzuar nga vet subjekti sipërfaqja e ndërtesës është 78.3 m² (bashkëlidhur shkresa nr.4). Gjithashtu me shkresën e dorëzuar nga subjekti L. T. me nr.796/1 prot, Tiranë datë. 25.05.2016 “Ministria e Kulturës ka shpallur objektin “ banesa e Q. T.” në qytetin e Vlorës në mbrojtje paraprahe. Gjatë kësaj periudhe ndalohet çdo lloj ndërhyrje në gjendjen fizike të objektit (bashkëlidhur shkresa nr.5).

Me shkresën nr.10228, datë 12/09/2022 subjekti “L. T.”, i është drejtuar Strukturës Vendore të apelimit Tatimor, për faturën për arkëtim lëshuar nga DTTV.... Kjo shkresë nga ana e drejtorit i ka kaluar për Vlerësim të ankesës dhe të përgatitjes së dosjes për strukturën vendore të apelimit tatimor... Kjo shkresë është refuzuar nga specialistja duke e kthyer për shqyrtim tek Komisioni i Apelimit Tatimor, pa dhënë asnjë argumentimin ligjor se si ka arritur në Vlerësimin e subjektit për vitet e mëparshme.

Në datën 16.09.2022, më është deleguar shkresa ku më është kërkuar të bëj vlerësimin e ankesës se subjektit. Pasi lexoj shkresën më momentin e tërheqjes në regjistrin e brendshëm të shkresave thuhej shprehimisht; “Drejtuar: Strukturës Vendore të Apelimit Tatimor, Bashkia Vlore.” .

Kam lënë shënimin duke i kërkuar Drejtorit që shkresa duhet të delegohet në shqyrtim në komision (KAT) dhe specialisti i pranimit i cili nuk është pjesë në këtë komisioni.

Pas shënimit që unë bej në regjistrin e brendshëm të shkresave, Drejtori Znj. A. Sh. delegon dhe rishkruan mbi kartelën shoqëruese për të cilën drejtori pretendon që e kam refuzuar dhe le njoftim

për sekretaren e komisionit të apelimit tatimor Znj. O. M. për njoftim të KAT, duke bashkëlidhur dhe shkresën të cilën e keni me poshtë (bashkëlidhur shkresa nr.8). Po në datën 16.09.2022 është tërhequr shkresa pranë znj. O. M. e cila mban regjistrin e Shkresave në DAV. Në asnjë moment nuk jam shmangur nga detyrat e vendosura nga Drejtori znj. A. Sh., por kam vazhduar të përgatisë dosjen e cila do i kalonte për shqyrtim KAT, të cilën ja kam dorëzuar Drejtorit të institucionit pasi është mbyllur gjithë procedura e mbledhjes së dokumentacionit. Rikujtesë shkresa me nr.10228, datë 12.09.2022 bashkë me praktiken për KAT (fotokopje dhe vlerësimi i subjektit) i është dorëzuar Përgjegjësit të pranimit z. E. P. dhe më pas Drejtorit znj. A. Sh. në datën 04.10.2022.

Kur kam kërkuar kopjen e praktikës drejtori Znj. A. Sh. më ka bere me dije që shkresat janë nisur në protokoll. Me sa duket fshehja e këtyre veprimeve ka qenë e qëllimshme nga ana e drejtorit Znj. A. Sh. në mos zbatim të nenit 69 të ligjit të procedurave tatimore (i ndryshuar), ku thuhet se: “Administrata tatimore”, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e llogaritjes së vlerësimit prej saj, i dërgon tatimpaguesit njoftimin e vlerësimit tatimor dhe kërkesën për pagesën e detyrimit tatimor.

Në datën 04.10.2022 nga përgjegjësi i sektorit z. E. P. ka kërkuar specialistes informacioni mbi... shkresë e cila nuk ka përgjigje. Përgjegjësit të pranimit z. E. P. i është dorëzuar shkresa e kërkuar që në momentin që i është dhënë shkresa me nr.10228 prot, datë 12.09.2022.

Sipas konstatimit tuaj “specialisti i ka përpiluar shkresën mbi ankesën, ku ka argumentuar vlerësimin tatimor”.

Në akt-kontrollin e datës 06.09.2022 ka rezultuar 50 m² objekt shërbimi për aktivitet dhe 120 m² hapësirë e shërbimit për tavolina dhe karrige. Sipas përcaktimeve të VKB-së nr 79, datë 02.12.2021, kreu II-pika 1 tarifa për zënien e hapësirës publike për qëllime biznesi....”

Ju bej me dije së në regjistrin gjeografik të vitit 2022 sipërfaqja e matur nga specialistët e terrenit është 200 m² truall (matur në muajin Janar), ndërsa në ndër muajt më të nxehtë sipërfaqja me tavolina dhe karrige është vetëm 120 m² sipas aktkontrollit. VKM Neni 4 Regjimi i hapësirave publike ekzistuese PIKA 2 Kjo hapësirë nuk rrethohet, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në lejen e ndërtimit., ndryshe shkruhet në aktin e kontrollit të datës 06.09.2022 nr. Serial 001860 (bashkëlidhur shkresa nr.11) “Me shkresë të datës 5.12.2022 përgjegjësi i sektorit vlerësimit z. E. P. i ka kthyer përgjigje Drejtorit të DAV...” Nuk kam pasur informacion që subjektit në datë 05.12.2022 nuk i kanë vajtur shkresa me nr.11129 prot, datë 04.10.2022. Çdo veprim nga ana e Drejtorit znj.A. Sh. ka qenë i qëllimshëm pasi vazhdimisht më është bere presion psikologjik për ti hequr detyrimet (Credit Notë) vlerësimit tatimor të një subjekti , pa u bazuar në asnjë nga ligjet në fuqi .

Për sa i përket konkluzioneve

a. Nuk jam pjesë e komisionit të apelimit tatimor

b. Sipas dokumenteve te paraqitur nëpërmjet kundërshtive ka dokumente argumentuese dhe justifikuese, që tregon se jam venë në lëvizje depozitat e neneve 68 dhe 71, te ligjit nr.9920, datë 19/05/2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH, i ndryshuar.

c. Asnjë shkresë nuk është refuzuar, dhe vlerësimi i subjektit është bere në zbatim të neneve 68 dhe 71, të ligjit nr.9920, datë19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore në RSH, i ndryshuar.”

d. Gjatë gjithë akt-konstatimit kontrolli citon pretendimet e përgjegjësit të pranimit z. E. P. dhe drejtorit Znj. A. Sh. pa shqyrtuar shkresat faktike. Për sa më sipër nuk kam shkaktuar asnjë dëm ekonomin ndaj shtetit dhe asnjë dëmtim të subjektit i cili nuk rezulton pronar i asnjë prej pronave në të cilën ai ushtron aktivitet.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se: Observacioni i paraqitur nuk pranohet, pasi nga **znj. R. P.** është bërë një pasqyrim i shkresave bashkëpunues si brenda dhe jashtë institucionit si dhe përgjegjësinë, duke mos dhënë asnjë argument se ku është mbështetur në rivlerësimin e bërë dhe pse nuk ka marrë për bazë të dhënat e aktkontrollit datë 6.6.2022. Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

Pretendim i subjektit:

Nga **znj. A. V.** në lidhje me problematikat e KAT, përmbledhurazi sqaron se:

Ashtu siç kemi parashtruar edhe në observacionet e bëra nga ana ime si Kryetare e KAT, theksojmë se: Bazuar në Rregulloren për Organizimin dhe Funkcionimin në strukturën vendore të KAT në Bashkinë Vlorë si dhe në zbatim të udhërit nr.267, datë 20.10.2021 është janë marrë në shqyrtim 5 subjekte të cilët kanë paraqitur ankesë për detyrimet fiskale të ngarkuara nga DAV Bashkia Vlorë. Nëse i referohemi të gjitha rasteve unë si Kryetare e KAT bazuar edhe në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e strukturës vendore të Apelimit tatimor në Bashkinë Vlorë si dhe procedurave përkatëse të apelit”, pasi jam njoftuar nga Sekretaria e Komisionit e cila ka marrë në dorëzim edhe ankimet e subjekteve është njoftuar edhe komisioni për ditën orën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes. (Procesverbalet e nisjes se procesit dhe të gjitha mbledhjeve të bëra ndodhen në dosje) Vlen të theksojmë se në të gjitha rastet për nisjen e procedurës së vlerësimit të dosjes nga KAT, ka procesverbal i cili është hartuar dhe firmosur rregullisht nga të gjithë anëtarët. E gjithë dosja është e administruar në DAV, në brendësi të së cilës është i gjithë dokumentacioni tekniko-ligjor. Nëse i referohemi regjistrit që ju përmendni në Raportin e Auditimit kjo gjë nuk është e përcaktuar në Rregulloren e Komisionit të Apelimit Tatimor. Por e gjithë dosja administrohet nga DAV. Gjithashtu, në të gjitha rastet edhe pse unë si Kryetare e Komisionit kam konstatuar se dosjet kanë qenë jo të plota duke i kërkuar në çdo rast dhe në mënyrë të përsëritur DAV të plotësoj dosjen dhe pastaj ta drejtoj drejt KAT. Vetëm pasi kjo Drejtori të kish plotësuar dosjen nga ana formale e saj, pra ajo të ishte e rregullt në formë dhe në përmbajtje pastaj ky Komision do të mbledhë dhe të vendoste në pranimin ose jo të kërkesës. Në rast se këto raste do të shqyrtoheshin me atë pak dokumentacion që DAV kishte vendosur në dispozicion do të sillte një vendimmarrje të gabuar të Komisionit. Në të dyja rastet që ju si Audit keni konstatuar, KAT është mbledhur dhe ka njoftuar të gjithë anëtarët e komisionit dhe është lënë si detyrë nga ana e komisionit që në mbledhjen e radhës DAV të dilte me një akt përfundimtar. Nëse i referohemi objektit të apelimit administrativ në nivel vendor shprehet se: Është objekt apelimi administrativ pranë Komisionit Vendor të Apelimit Administrativ të Takave dhe Tarifave Vendore çdo akt administrativ apo mosveprim për nxjerrjen e një akti administrativ nga DAV në lidhje me një taksë ose tarifë vendore. Cili është akti administrativ i cili duhet të gjykohet nga ana e Komisionit? Qëndrimi i DAV është kontradiktor, pasi në njërin anë shprehet se subjektit i është kryer vlerësimi tatimor dhe nga ana tjetër shprehet se Komisioni duhet të shprehet për mosveprim të kësaj drejtorie. Ashtu siç është edhe objekti i kësaj Rregullore. Nëse akti do pretendohet se ishte i saktë ai duhet ti ishte njoftuar subjektit, në mënyrë të tillë që ai ta kundërshtonte atë duke e paguar edhe në masën 70% ashtu siç Rregullorja e Komisionit të Apelimit Tatimor parashikon dhe më pas t'i drejtohej këtij Komisioni. Nëse i referohemi mosveprimin, në rastin konkret vet DAV shpjegon dhe sqaron faktin që subjekti është ngarkuar me këtë detyrim duke ligjëruar kështu faturën e subjekteve. Gjithashtu nëse i referohemi Rregullores së Komisionit të Apelimit Tatimor në Nenin 5 pika e shprehet se: “KAT shqyrton dhe merr vendime të pavarura për ankimet e paraqitura nga taksapaguesi. Ai i bazon vendimet e saj në provat dhe argumentet e paraqitura

nga taksapaguesi dhe administrata tatimore vendore. KAT mund të kërkojë informacion shtesë, (psh dokumente të tjera nga taksa paguesi dhe tarifave vendore dhe palëve të treta si dhe mund të bëjë verifikime që ndihmojnë në shqyrtimin dhe zgjidhjen e drejtë të çështjes). Pra, në të dyja rastet objekt i auditimit unë si Kryetare e Komisionit kam kërkuar dokumentacion shtesë ashtu siç rregullorja e parashikon. Ka qenë pikërisht DAV e cila ka pezulluar punën e Komisionit, duke e zvarritur kështu mbledhjen e këtij Komisioni. Në këto kushte, kërkojmë nga Audituesit Shtetëror të Autorizuar të KLSH-së të rishikojnë edhe njëherë Raport Auditimin nr.1026/1, datë 25.11.2022, duke i marrë parasysh dhe vlerësuar argumentet e parashtruara në këtë observacion. Bashkëlidhur po ju dërgojmë dhe dokumentacionin shoqërores, ku mbështeten observacionet që po i paraqes grupit auditues.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Për sa kundërshtoni, nga ana juaj nuk është sqaruar pse nuk janë marrë në shqyrtim ankesa por i është kaluar për shqyrtim DAV Bashkia Vlorë, pasi në zbatim të rregullores së brendshme është detyra juaj shqyrtimi i rasteve të ankesave dhe kthimit të përgjigjes subjektit nëse plotëson kushtet e ankesë ose ka apo nuk ka të drejtë në ankesën e bërë. Gjithashtu dokumentacioni bashkëshoqërues është i vitit 2023, pra pas periudhës objekt auditimi.

Qëndron fakti se nga ana juaj mund të kërkohej dokumentacion shtesë për të qenë më të qartë për kërkesën e subjektit.

Titulli gjetjes: Mbi detyrimet e subjektit “T. Z. (A. H.)” FP.

Situata: Nga të dhënat e kërkuara në DSV Bashkia Vlorë mbi detyrimet e paarkëtuara për taksat e tarifave vendore, rezulton se sipas shkresës së **DAV Bashkia Vlorë nr. 5132 prot, datë 28/04/2023**, ndër të tjera thuhet se:

*Në listën e detyrimeve të vitit 2022 që disponon DAV Bashkia Vlorë sipas sistemit TAIS, rezulton se subjekteve “T. Z. (A. H.)” FP dhe subjekti “L. T.”, kanë dalë si debitorë si rezultat i vlerësimeve tatimore të bërë nga zyra, respektivisht për subjektin “T. Z. (A. H.)” FP për vlerën **2,152,137 lekë** dhe për subjektin “L. T.” për vlerën **4,147,243 lekë**.*

Në lidhje me subjektin “**T. Z. (A. H.)**” FP, konstatohet se është shpallur debitorë për vlerën **2,152,137 lekë**, sipas rivlerësimit të kryer nga sektori i vlerësimit datë 25.8.2022, për tarifë të hapësirës publike për vitet 2020, 2021 dhe 2022 në vlerën **2,152,137 lekë**.

Referuar dosjes së subjektit “**T. Z. (A. H.)**” FP, me shkresën nr. 2823 prot, datë 08/03/2023 ka bërë ankesë pranë Strukturës Vendore të Apelimit Tatimor në Bashkinë Vlorë.

Subjekti me veprimtari në fushën e hotelierisë ka paguar taksat dhe tarifave vendore konkretisht, tarifë pastrimi, taksë ndërtese, taksë hoteli, taksë trualli, taksë table për periudhën 2020, 2021 dhe 2022, për të cilat i ka paguar sipas afateve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Bashkisë.

Njoftim vlerësimi është punuar nga specialist i vlerësimit tatimor **znj. R. P., vlerësim i cili mban miratimin vetëm të specialistit** dhe nuk i është përcjellë subjektit për të marrë dijeni mbi këtë detyrim, pasi nuk është firmosur nga përgjegjësi, ku per te njëjtën sipërfaqe prej **292,69 m²**, e cila në këto periudha është vlerësuar edhe për zërin truall. Gjithashtu ky vlerësim është kryer pa marre parasysh akt kontrollin e inspektoreve të terrenit, **kontroll i cili është bërë me datë 25.8.2023**.

Rezultati i kontrollit (akt kontrollit nr 001840 serie, datë 25.8.2022), ka qenë verifikimi i hapësirës publike për parkim që subjekti shfrytëzon, nga ku evidentohet se për këtë sipërfaqe

subjekti nga ana e tij i ka bërë kërkesë Bashkisë Vlorë (*adresuar në Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike me shkresën nr. 3903 prot; datë 13/02/2022*), për t'ia kaluar për shfrytëzim.

Në përfundim inspektorët e terrenit i kanë përcjellë inspektorit të vlerësimit aktin e datë 25.8.2022, **por ndërkohë vlerësimi ka qenë i kryer në sistemin e taksave.**

Mbas shkresës nr. 11033 prot; datë 03/11/2022, subjekti pretendon se nuk ka marre faturën për muajin gusht.

Nga ana e Drejtorit AV Bashkia Vlorë i është kërkuar specialistit të dosjes arsyet e mos vlerësimit të shkresës nr. 9821 prot; datë 01/09/2022 mbi regjistrin e fjetjes në hotel për muajin gusht.

Me shkresë të datës 04/10/2022 "*Relacion mbi vlerësimin e subjektit "H. A."* adresuar Drejtorit DAV Bashkia Vlorë dhe për dijeni Përgjegjësit të Sektorit, nga ana e specialistes së dosjes i është bërë me dije me anë të një relacioni për vlerësimin e subjektit.

Në këtë relacion theksohet se sipas dy akt kontrolleve nr. 0001115, datë 22/10/2022 dhe nr. 0000425, datë 24/02/2021 rezultati i kontrollit ka qenë se subjekti nuk ka filluar aktivitet dhe është në punime e sipër, dhe me akt kontrollin nr. 001840, datë 25.8.2022 të inspektorëve është pretenduar nga specialist i dosjes se nuk është bërë matja reale e sipërfaqes së shfrytëzuar nga subjekti.

Mbas këtij relacioni me shkresë të datës 05/10/2022 Drejtori DAV Bashkia Vlorë i është drejtuar Përgjegjësit të Sektorit dhe për dijeni specialistit të dosjes (inspektori vlerësimit), mbi vlerësimet dhe konstatimet e tij në lidhje me këtë relacion. Përgjegjësi i Sektorit me shkresën të datës 07/10/2022 i është drejtuar specialistes së vlerësimit tatimor dhe për dijeni drejtorit të drejtorisë, lidhur me pretendimet e saj, ku konkretisht ka cituar se:

Në njoftim vlerësimin e bërë nga ana juaj, janë llogaritur taksat dhe tarifat vendore për tre periudha ushtrimore (viti 2020, 2021 dhe 2022) duke përfshirë zërin e hapësirës publike për cdo vit. Për llogaritjen e kësaj tarife nuk është marrë parasysh dokumentacioni si : akt kontrolli i inspektorëve të terrenit (pasi edhe vetë specialistja deklaroi në relacion që në vitin 2020 dhe 2021 subjekti nuk ka ushtruar aktivitet). Subjekti me shkresën nr. 3903 prot; datë 13.04.2022 ka paraqitur kërkesë për tu pajisur me vend parkimi në shërbim të aktivitetit hotel, ku subjektit nuk i është miratuar kërkesa dhe të lidhet kontratë për vend parkimet, tarifë e cila nuk i takon për vlerësim Drejtorisë së të Ardhurave Vendore. Nga përgjegjësi i sektorit është kërkuar verbalisht punonjëses në varësi që të marrë parasysh dokumentacionin ligjor për të bërë vlerësim të drejtë të detyrimeve me taksa dhe tarifa të këtij subjekti, gjë të cilën punonjësjë nuk e ka marrë parasysh. Referenca ligjore ku është bazuar specialistja nuk i përket institucionit të bashkisë por Drejtorisë Rajonale të Tatimeve. I është kërkuar specialistes të veprojë mbi dokumentacionin që vërteton pronësinë e truallit ose verifikimit në terren për hapësirën që përdor subjekti. Gjithashtu nga përgjegjësi është kërkuar që specialistja e vlerësimit të rishikojë vlerësimin tatimor dhe në rast të mos ndryshimi të këtij detyrimi njoftimet do ti kalojnë drejtorit të drejtorisë.

Me shkresë të datës 07/10/2022 specialisti pretendon se ka kryer vlerësimin tatimor bazuar në urdhrin e punës së miratuar nga Drejtori DAV Bashkia Vlorë. Ndërkohë nga shqyrtimi i dosjes konstatohet se vlerësimi është bërë para dorëzimit të dokumentacionit nga grupi i punës, i cili kishte për objekt vetëm verifikimin e hapësirës publike për vendparkime, kjo sipas kërkesës së terrenit, ku nga Kryetari i Bashkisë ju është kërkuar të bëhet ky verifikim.

Më tej procedura e vlerësimit do të shqyrtohej bazuar në vendim të Këshillit të Bashkisë, ku detyrimet për këtë zë të hapësirës publike do të ngarkohej strukturës përgjegjëse që në këtë rast është DIIP.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit (*aktkontrollit datë 25.8.2022 dhe njoftim vlerësimit datë 25.8.2022*), konstatohet se nuk kanë lidhje, pasi sipas terrenit është konstatuar se sipërfaqja është për parkim dhe hapësirë publike për të cilën subjekti ka kërkuar në Drejtorinë e Infrastrukturës

dhe Investimeve Publike për lidhje kontrate, ndërsa nga specialist i vlerësimit është vlerësuar më zërin hapësirë publike, **e njëjta sipërfaqe që ka qenë më parë e vlerësuar për zërin truall.**

Me shkresë të datës 5.12.2022 Përgjegjësi i Sektorit **z. E. P.** i ka kthyer përgjigje Drejtorit DAV Bashkia Vlorë për shkresën e datës 05/10/2022, ku sqaron se specialistes i është kërkuar disa herë të rishikojë këtë vlerësim, ku edhe në shkresën e datës 25/11/2022 mbetet i pandryshuar.

Nisur nga shkresa e Përgjegjësit Sektorit dhe relacionit të specialistit të dosjes, Drejtori DAV Bashkia Vlorë me shkresën nr. 13820 prot; datë 06.12.2022 “*Kërkesë për bashkëpunim dhe dhënie mendimi, për të çuar në një zgjidhje ligjore për vlerësimin tatimor të subjektit “A. H.”*”, është drejtuar Drejtorisë Juridike, Drejtorisë së Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit si dhe Njësisë së Auditimit të Brendshëm, ku për këtë shkresë është shprehur vetëm njësia e auditit të brendshëm me shkresën nr. 13820.1 prot; datë 15.12.2022.

Me shkresën nr. 150 prot; datë 09.01.2023 Drejtori DAV Bashkia Vlorë i është drejtuar Kryetarit të Komisionit Vendor të Apelimit Tatimor, duke kërkuar mbështetje dhe koordinim të strukturave brenda Bashkisë Vlorë për çuarjen në një zgjidhje ligjore të vlerësimit me detyrime për subjektet. Shkresë për të cilën nuk ka asnjë procedurë të ndjekur nga K VAT.

Me shkresën nr. 1082 prot; datë 27.01.2023 Drejtorja Juridike i është përgjigjur shkresës nr. 13820 prot; datë 05.12.2022 së Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, e cila nuk ka dhënë një relacion ligjor për vijim të kësaj procedure.

Drejtorja e të Ardhurave Vendore me shkresën nr. 150/1 prot; datë 03.03.2023 I është drejtuar sërish kryetares së KAT mbi vijimin e procedurës së vlerësimit tatimor të subjektit “**T. Z. (A. H.)**”. Mbas shkresës nr. 2823 prot; datë 8.3.2023 së subjektit “**T. Z. (A. H.)**” deleguar DAV, kjo drejtori me shkresën nr. 2823/1 prot; datë 10.03.2023 i është drejtuar K VAT si struktura më e lartë në Bashkinë Vlorë për vlerësimin e situatës së krijuar deri në marrjen e një vendimi përfundimtar për detyrimet tatimore të subjektit. Shkresë për të cilën nuk ka asnjë procedurë të ndjekur nga kryetarja e komisionit vendor të apelimit tatimor.

Kriteri: Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me e Ligjin nr. 9920, datë 19/05/2008 “Për procedurat tatimore në RSH, i ndryshuar, nenet 68 dhe 71.

Ndikimi/Efekti: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në shqyrtimin e ankesave të subjekteve fizik/juridik si dhe Rivlersimi i situatave pa dokumentacionin e nevojshëm ligjorë, janë veprime që rëndojnë situatën financiare të subjekteve.

Shkaku: Përgjegjësi e inspektorëve personave përgjegjës në zbatimin e kuadrit ligjorë, respektivisht: **Znj. R. P.**, me detyrë specialiste e vlerësimit për dosjen e subjektit “**T. Z. (A. H.)**”, pa dokumentacion argumentues mbi arsyet që kanë çuar inspektoren e dosjes në rivlerësim, pasi në dosja nuk ka asnjë indicje për të vënë në lëvizje dispozitat e neneve 68 dhe 71 të Ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 “Për procedurat tatimore në RSH, i ndryshuar.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë, të ngrëjë një grup pune me specialist të fushës nga Drejtorja e të Ardhurave Vendore, Drejtorja DPKZHT dhe Komisioni i Apelimit Tatimorë për verifikimin dhe saktësimin e njoftim detyrimit datë 25.8.2022 të prodhuar nga Sektori i Vlerësimit Tatimor në ngarkim të subjektit “**T. Z. (A. H.)**” PF për vlerën **2,152,137 lekë.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshti me shkresë nr. 11597, datë 27.10.2023 (prot KLSH nr. 1026/29, datë 3.11.2023) “Mbi Projektraportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

“Nga subjekti “T. Z. (A. H.)” PF me shkresën nr.2823 prot, date 08.03.2023 është bere ankese pranë strukturës vendore te Apelimit Tatimor ne Bashkinë Vlore per mos veprim te Drejtorisë se te Ardhurave vendore.”

Përgjatë vitit ushtrimor 2021-2022 referuar kontrollit dhe deri në datën 03.02.2023 që unë kam qenë në punë, nuk kam pasur asnjë njoftim apo shkresë përcjellëse që subjekti ka bërë Ankimim dhe ka qenë në shqyrtim të komisionit vendor të apelimit tatimor, por vetëm shkresa për vlerësimin e Taksës së fjetjes në hotel. Gjithashtu deklaroj me përgjegjësi të plotë se nuk di se si ka vazhduar historiku i subjektit T. Z. për vitin 2023. Detyrimi im ligjor ne zbatimet ligjeve dhe VKB-ve në fuqi mbaron me vlerësimin tatimor, nuk është përgjegjësia imë qe subjektit nuk i janë dërgua shkresat zyrtare nga ana e Përgjegjësit apo Drejtorit të institucionit, pasi është detyrë e tyre funksionale, kjo në bazë të rregullores së brendshme të Bashkisë Vlorë.

Ky vlerësim nisur nga dokumentacioni i administruar ne dosje, është kryer pa marre parasysh akt kontrollin e inspektoreve te terrenit, kontroll i cili është bere ne date 25.08.2023. Mbi këtë kontroll është miratuar urdhër pune ne datën 25.08.2022 me kërkesë te inspektoreve te terrenit (te datës 25.08.2023 per verifikimin e hapësirës qe ky subjekt përdor per parkim automjetesh). Rezultati I kontrollit, sipas akt kontrollit nr.001840 serie, date 25.08.2022, ka qene per hapësirën publike per parkim qe subjekti shfrytëzon, sipas kërkesës se bere nga subjekti per vend parkime ne bashkinë Vlore adresuar ne Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike me shkresën nr.3903 prot, date 13.02.2022.

Akt kontrolli me shkresë përcjellëse te inspektoreve te terrenit i është përcjellë specialistes se vlerësimit tatimor, por ndërkohë vlerësimi ka qene I kryer ne sistemin e taksave. Për cdo akt-kontrolli është i bashkëlidhur fotografimi i subjektit në momentin e kontrollit në subjekt, e cila bie ndesh me akt- kontrollin e mbajtur nga specialistët e terrenit, ne të cilën evidentohet qartazi hapësira publike e shfrytëzuar nga ky subjekt për qëllim të biznesit të tij.

Pretendimi i mësipërm bie poshtë për aq kohë sa ka qenë vetë drejtori Znj. A. Sh. e cila ka nxjerr urdhër punë për verifikimin e hapësirës publike të shfrytëzuar për parkim, nëse nuk faturohet kjo hapësirë cili është qëllimi i këtij kontrolli?

Sipas shkresës nr11033 ptot, date 03.11.2022 subjekti pretendon se nuk ka marre faturën per muajin gusht. Nga ana e drejtorit AV Bashkia Vlore i është kërkuar specialistit te dosjes arsyet e mos vlerësimit te shkresës nr. 9821 prot, date 01.09.2022 mbi regjistrin e fjetjes ne hotel per muajin gusht. Me shkresë te datës 04.10.2022 “Relacion mbi vlerësimin e subjektit “H. A.” adresuar drejtorit DAV bashkia Vlore dhe per dijeni përgjegjësit te sektorit, është bere me dije me ane te nje relacioni per vlerësimin e subjektit. Ne këtë relacion theksohet se sipas dy akt kontrolleve nr 0001115, date 22.10.2022 dhe nr. 0000425, date 24.02.2021 rezultati i kontrollit ka qene se subjekti nuk ka filluar aktivitet dhe është ne punime e sipër, dhe me akt kontrollin nr. 001840 prot, date 25.08.2022 te inspektoreve është pretenduar nga specialist t dosjes se nuk është bere matja reale e sipërfaqes se shfrytëzuar nga subjekti.” Në datën 04.10.2022, shkresa mban datën 03.10.2022 dhe jo 03.11.2023 shkresë drejtuar i është drejtorit znj. A. Sh. përgjigje për pretendimin e subjekti gjithashtu është kërkuar dhe kopje e njoftim vlerësimit të datës 26.08.2022- “Arsyen e mos Vlerësimit të shkresës me nr. 9821 prot, datë 01.09.2022, të cilën e kam tërhequr në datën 06.09.2022 , ju bëj me dije qe po në atë datë është bërë vlerësimi tatimor për Taksën e

ffjetjes në hotel. Ju rikujtoj dhe njëherë që nga ana juaj nuk kam marrë kopjen e njoftim vlerësimit të datës 26.08.2022 , ose arsyen pse ky Njoftim Vlerësimi nuk po firmoset ?!” për të cilin kam marr përgjigje verbalisht që shkresat janë nisur për protokoll. Gjë që përgënjeshtrohet në shkresat në vazhdim nga vet subjekti.

Nga ana ime është bërë vlerësimi tatimor për cdo nga shkresat e përmendura me sipër, kjo vërtetohet nga fatura për arkëtim bashkëlidhur. Nëse subjekti nuk ka marr vlerësim cili ka qenë qëllimi i mos dërgimit së shkresës zyrtare nga drejtori znj. A. Sh.?? Nëse vlerësimi ka nevojë për rishikim cilat kanë qenë shkaqet që në 6 muaj (periudhe te cilën kam qenë unë në punë) dhe deri me datë 14.07.2023 drejtori nuk ka marr në rishqyrtim çështjen? Mos vall duke mbajtur më parë detyrën e drejtorit të menaxhimit të asetëve znj. A. Sh., është më e ndërgjegjshme se mua që këto subjekte shfrytëzoj Hapësirë publike ku janë kryer dhe miratuar investime publike?? Nuk pata kohën e duhur për shpjegimet, sepse, e theksoj, kam marrë dijëni ne date 18 korrik, kam nxjerre arkivën dhe përmbloodha përgjigjen, qe e konsideroj jo te plote, sepse kisha shume per te thënë dhe shkruar.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

Observacioni i paraqitur nuk pranohet, pasi nga znj. R. P. është bërë një pasqyrim i shkresave bashkëpunues si brenda dhe jashtë institucionit si dhe përgjegjësinë, duke mos dhënë asnjë argument se ku është mbështetur në rivlerësimin e bërë. Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

Pika 3 e programit. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

- Nxjerrja e pasqyrave financiare për vitin 2022.

Për vitin 2022, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 05, datë 21/02/2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit me shkresën nr. 3714 prot; datë 27.03.2023, të përbëra si vijon:

Format nr. 1 – Pasqyra e pozicionit financiar.

Format nr. 2 – Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).

Format nr. 3 – Pasqyra e flukseve monetare (Cash-Flow).

Format nr. 4 – Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

Format nr. 5 – Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.

Format nr. 6 – Investimet dhe burimet e financimit.

Format nr. 7/a – Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).

Format nr. 7/b – Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).

Format nr. 8 – Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga Kryetari i Bashkisë (Nëpunësi Autorizues), Drejtori i Financës **z. D. Z.** (Nëpunësi zbatues) si dhe hartuesi i llogarive **z. H. H.**

- Mbajtja e kontabilitetit viti 2022.

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, ditari i arkës, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj.

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitet dhe pasivitet, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2022, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si vijon:

Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet =	5,805,963,351 lekë
Aktivet	6,790,226,845 lekë
Pasivet	984,263,496 lekë
Aktivet neto	5,805,963,351 lekë

Aktivet afatshkurtra

Aktivet afatshkurtra më datë 01.11.2022 paraqiten në vlerën **1,896,481,140 lekë** dhe përbëhen nga:
Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 918,053,472 lekë,
Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 61,731,702 lekë,
Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 916,695,966 lekë,

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
56	Mjete monetare ne bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	916,146,472	529,266,818	386,879,654
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	1,907,000	2,249,000	(342,000)
54	Akredeitiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provigjone zhvlerësimi	0	0	0
Totali		918,053,472	531,515,818	386,537,654

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 916,146,472 lekë, sipas aktrakordimet me Degën e Thesarit datë 01.11.2022, përbëhet nga : gjendja e Llogaria 85 “Rezultati i vitit ushtrimor” në pasqyrën 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, në vlerën 850,485,944 lekë, gjendja e llogarisë 466 “Mjete në ruajtje” në vlerën 65,660,528 lekë, Llogaria 532 “Vlera të tjera” në vlerën 1,907,000 lekë që përfaqëson vlerën e pullave të taksës gjendje ne magazinë, gjendje në arkë me 01.11.2022, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica ne fillim te vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “Teprica e Likujditeteve ne fund te vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOW) sipas metodës direkte”, të paraqitur më poshtë:

Numër Rreshti	Numër Rubrike	Përmbajtja	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhëse
(a)	(b)	(c)	(1)	(2)
1	I	VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT	1,051,501,459	732,577,738
2	1	Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime korentë (+)	1,894,856,261	1,554,782,408
3	2	Arkëtime e te hyra (Cash), gjate vitit ushtrimor	1,232,121,452	1,004,181,453
4		Te Hyra nga Tatimet e Doganat tatimore e Doganore(+)	1,177,586,405	984,203,767
5		Te hyra nga Kontributet e Sig. shoq. e shëndet(+)	0	0
6		Te hyra nga ardhurat jotatimore (+)		
7		Te hyra, Sponsorizime nga te trete,(+)		
8		Te hyra, nga kredi e huamarrje afatshkurtër(+)		
9		Te hyra nga Mjetet ne ruajtje(+)	6,655,426	18,699,686
10		Te tjera, arketuar(+)	47,879,621	1,278,000

Numër Rreshti	Numër Rubrike	Përmbajtja	Periodha Raportuese	Periodha Paraardhëse
11	3	Pagesa per Detyrime e Shpenzime korentë	-2,075,476,254	-1,826,386,123
12		Per detyrime e Shpenzime nga vitet e kaluara(-)	-59,132,120	-46,819,566
13		Per detyrime e Shpenzime te viti ushtrimor(-)	-2,012,217,690	-1,770,547,310
14		Pagesat per mjetet ne ruajtje(-)	-3,295,837	-8,573,838
15		Interesi I paguar(-)	-188,607	-445,409
16		Tatime te paguara(-)	-342,000	
17		Te tjera te paguara (-)	-300,000	
18	II	VEPRIMTARITE E INVESTIMEVE	-203,958,540	107,568,492
19		Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime Kapitale (+)		584,226,587
20		Te hyra nga Kredi dhe e huamarje afatgjata(+)		
21		Te hyra nga shitja e Aktiveve Afatgjata (+)		
22		Te hyra nga interesat e huadhënies dhe nenhuadhenies(+)		
23		Pagesa per detyrime e Investime nga vitet e kaluara(-)		
24		Per detyrime e Investime te viti ushtrimor(-)	-197,435,564	-465,299,357
25		Huadhënie e Nenhuadhenie(-)	-6,522,976	-11,358,738
26		Pjesmarrije ne kapitalin e vet(-)		
27		Divident te paguar(-)		
28	III	TRANSFERTA E TE TJERA	-461,005,265	-548,851,782
29		Derdhje e Transferime te te Ardhurave ne Buxhet(-)	-4,665,663	-5,558,909
30		Transferime ne buxhet te Fondeve te pa përdorura(-)	-9,603,800	-125,193,131
31		Lëvizje e brendshme e transferata te tjera(+/-)	-446,735,802	-418,099,742
32	IV	Rritja /Renia neto e Mjeteve monetare	386,537,654	291,294,448
33	V	Teprica ne fillim te vitit ushtrimor	531,515,818	240,221,370
34	VI	Teprica e Likujditeteve ne fund te vitit ushtrimor	918,053,472	531,515,818

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
31	Materiale	17,963,764	12,161,137	5,802,627
32	Inventar i imët	43,767,938	41,745,331	2,022,607
33	Prodhime, punime e shërbime ne proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmëri	0	0	0
37	Gjendje te pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Shuma te parashikuara për zhvlerësim te inventarit(-)	0	0	0
	Totali	61,731,702	53,906,468	7,825,234

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Vlorë në 01.11.2022 paraqitet në vlerën 61,731,702 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 17,963,764 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 43,767,938 lekë. Diferencat me vitin e mëparshëm përfaqësojnë lëvizjen e inventarit në shumën 7,825,234 lekë, e cila rakordon me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 7,825,234 lekë.

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 17,963,764 lekë, vlerë e cila është e barabartë me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen dhe Aktrakordimin e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjësin material dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.11.2022	12,161,137
Hyrje me pagesë gjatë vitit	68,346,029
Dalje nga magazina gjatë	62,543,402
Gjendja në 01.11.2022	17,963,764

Llogaria 32 “Inventarë i imët”, ka vlerën 43,767,938 lekë vlerë e cila është e barabartë me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen dhe Aktrakordimin e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjësin material dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.11.2022	41,745,331
Hyrje gjatë vitit 2022	6,516,988
Dalje gjatë vitit 2022	4,494,381
Gjendja në 01.11.2022	43,767,938

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”. Për të gjitha shtesat dhe pakësimet për shkak të marrëdhënieve midis institucioneve është përdorur llogaria 45 “Marrëdhënie midis institucioneve apo njësisive ekonomike”.

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
	Llogari të arkëtueshme	916,695,968	724,067,405	192,628,563
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	0	0	0
431	Tatime e taksa	0	0	0
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog. Pushtetit Lokal	0	0	0
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti	0	0	0
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0
437,438	Organizma te tjerë shoqërore	135,335	135,335	0
44	Institucione te tjera publike	0	0	0
465	Efekte per t'u arkëtuar nga shitja letra me vlere vendosjes	0	0	0
468	Debitorë te ndryshëm	751,810,068	664,799,950	87,010,118
4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	164,750,563	59,132,120	105,618,443
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0
49	Shuma te parashikuara per zhvlerësim(-)	0	0	0
	Të tjera aktive afatshkurtra	0	115,078,465	115,078,465
409	Furnitore(Debitorë),parapagime pagesa pjesore	0	0	0
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	0
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	0
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	0
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	115,078,465	0

Llogaritë 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 751,810,068 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.11.2022	664,799,950
Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	87,010,118

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0
Gjendja në 01.11.2022	751,810,068

Vlera e debitorëve në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 ka pësuar një rritje prej 87,010,118 lekë në të cilën ka ndikuar rritja e gjobave të IMT në vlerën 82,205,000 lekë, shtesë tatime në vlerën 4,702,422 lekë dhe tjera 102,696 lekë.

Analiza e gjendjes së llog. “Debitorë të ndryshëm” sipas listës që disponon Sektori i Financës, ku për shkak të volumit nuk janë bashkëlidhur po në CD.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 164,750,563 lekë e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 164,750,563 lekë.

- Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe kërkime”, në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2022 në shumën prej 41,396,526 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 58,784,151 lekë, diferenca është vlerë e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 115,857,512 lekë. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar sipas Aneksi 3.1, bashkëlidhur aktit.

Titulli gjetjes: Sistemi i llog. 202 “Studime kërkime”.

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 202 “Studime kërkime” sipas Formatit nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, paraqiten në të njëjtën vlerë si në mbyllje dhe në çelje të vitit ushtrimorë 2022 për vlerën 115,857,512 lekë.

Konstatohet se për **52** projekt-studime për investime të kryera gjatë viteve, nuk është bërë i mundur shpërndarja e investimeve sipas llojit të aktiveve materiale, ku për projektet e vënë në zbatim pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme, për vlerat duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së projekteve si vlerë e shtuar e çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Gjithashtu vlera prej **9,812,760 lekë**, e emërtuar “Të tjera”, nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson.

Kriteri: Në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” “Aneksi 1. “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 2, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata”, Pika 3.3 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci), nënpika 62. Nënpika “Aktivet afatgjata jo materiale”, dhe me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75.

Ndikimi/Efekti: Me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Jo Materiale.

Shkaku: Përgjegjësi e personave përgjegjës në hartimin e pasqyrave financiare 2022.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Vlorë të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite nga ish-Njësitë Vendore, që i janë bashkuar nga reforma territoriale për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare për vlerën **9,812,760 lekë** e emërtuar **“Të tjera”** dhe të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Për projektet e vëna në zbatim të llogarisë 202 “Studime projekte”, të bëhet sistemimet përkatëse duke debituar llogaritë e aktiveve dhe kredituar llogarinë 2022.

- **Aktivitet e afatgjata materiale (AAM)**

Llog 210 “Toka, troje Terrene” paraqitet me vlerë neto dhe vlerë bruto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 111,833,518 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në të njëjtën vlerë prej 111,833,518 lekë. Këto gjendje paraqiten të analizuar sipas vlerës bruto në tabelën e mëposhtme, sipas Aneksit 3.2 bashkëlidhur aktit.

Llog 211 “Pyje, Plantacione”, paraqitet me vlerë neto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 272 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 272 lekë.

Llog 212 “Ndërtesa konstruksione”, paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 1,079,068,164 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 1,450,591,607 lekë dhe në vitin 2021 në vlerën 1,419,596,938 lekë. Pra kemi rritje në vlerën 30,994,669 lekë, që përbëhet shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM si:

Llog analitike 212 “Ndërtesa konstruksione”.

EMERTIMI	Shtesa
Rikonstruksion I banesave Egjiptiane v.2017	6,828,810
Rikonstruksion I Shkollave te Qytetit	2,737,950
Shpronësim D. Hoxha oborri Shk.Ali Demi	6,796,650
Shpronësim Merita Kapllanaj Uji Ftohte	7,819,806
Rikonstruksion I Kopshte ,Çerdheve te Qytetit	72,084
Rikostr Tuateve Shkolla J. M.	3,273,900
Ndertesha Shkolla Babice e Madhe	3,465,469
Shuma	30,994,669

Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe ndryshimet nga viti 2021 në vitin 2022 paraqiten në Aneksin nr. 3.3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Titulli gjetjes: Kontabilizimi gabim në llog 212 “Ndërtesa konstruksione” për 21 artikuj me vlerë 139,985,242 lekë.

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 212 “Ndërtesa Konstruksione” sipas Formatit nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, paraqiten në mbyllje të vitit 2021

në vlerën 1,419,596,938 lekë. Ndërsa në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 1,450,591,607 lekë.

Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione” konstatohet se, kjo llogari është e analizuar sipas vlerës së investimeve të kryer, duke mos ia shtuar vlerën e rikonstruksionit vlerës së ndërtesës dhe emetuar si artikuj kontabël më vete më vete vlerat e rikonstruksionit.

Gjithashtu në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 21 artikuj aktive materiale në vlerën 139,985,242 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit të llogarive 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 83,080,542 lekë, llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 56,904,700 lekë, konkretisht:

EMERTIMI	Llog. qe i përket	Vlera
Varrezat e Otrantos	210	7,696,806
Lulishte para Bashkise	210	1,180,884
Lulishte Pallati i Kulturës	210	2,478,370
Trotuari Plazhi " Aulona"	210	2,901,840
Rrjeti ujësjellësit Rruga Nr.1 ndert.dhjetor.2002	213	100,000
Fusha e futbollit Oriku	210	4,038,000
Rikonstruksion rrugës Zigur Lelo	213	80,511,438
Shpronësim Merita Kapllanaj Uji Ftohte	210	7,819,806
Mbjellje Peme	210	630,000
Veshje me beton kanale	213	96,000
Ruge varrezash per fshatrat	213	2,792,715
Rrethim varreza Sherishte	210	1,701,450
Rrethim varreza Narte-Bestrove	210	2,982,600
Depo uji Zvernec	213	2,373,104
Rreth rrotullim Oriku	210	348,000
Varreza Tragjas+Dukat fshat	210	7,503,721
Varrezat Dukat i ri	210	1,425,414
Fregu Oriku	210	6,309,744
F e sport e mesme Oriku	210	2,282,809
Sh bar sintetik f e mes Oriku	210	2,235,000
Rik fusha sport dukat i ri	210	2,577,541
Shuma		139,985,242

Kriteri: Në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” i ndryshuar me Udhëzimin nr.5 datë 21/02/2022, Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), “Klasifikimi kontabël”, me Nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75.

Ndikimi/Efekti: Me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare

Shkaku: Përgjegjësi e personave përgjegjës në hartimin e pasqyrave financiare 2022

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Vlorë, të marrë masa për saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 212 “Ndërtesa konstruksione”, duke shtuar vlerën e shpenzimeve për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite të paanalizuara dhe për **21** artikuj kontabël në vlerën 139,985,242 lekë, si dhe të bëjë sistemimet duke pakësuar inventarin e kësaj llogarie dhe shtuar inventarin e llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 83,080,542 lekë, llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 56,904,700 lekë.

Llog 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 2,992,800,424 lekë.

Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 4,273,830,858 lekë dhe në vitin 2021 në vlerën 4,014,937,668 lekë. Pra kemi rritje në vlerën 259,009,926 lekë, që përbëhet shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM si:

Shtesat me pagesë Llog 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”

EMERTIMI	Shtesa	Pakësime
Bulevardi Vlore Skele	7,123,431	
Riasfaltime ne Qytet 2017	92,746,296	
Rik. Bllokut Pelivan L. Sh.07	171,948	
Studimi Arkeologjik I Landfillit	887,760	
Mbikëqyrje e Pajisje te Ndriçimit rrugor	136,086	
Struktura pilota pas godinës Bashkise	4,185,387	
Rruga Isa Boletini Shpronësim E. I.	2,071,570	
Shpronësim Sherishte Landfili F. Z.	193,175	
Shpronësim A. Xh.	714,162	
Shpronësim K. H.,M. T.	119,114	
Shpronësim A.M.,M. T.	59,557	
Rruga Llakatund- Beshisht	57,671,711	
Rruga e Kaninës	210,573	
Riasfaltim Rruga Xhyherine-Babice	16,412,611	
Rruga Panaja-Oshtime	15,725,196	
Rruga Narte-Sherisht	5,304,960	
Rikualifikim Urban Njësia Adm.Qender	16,800	
Rezervuar beton vaji	0	62,336
Pompe zhytëse	0	54,400
Rruga Novosele	8,465,580	
Seg.rrugore Novosele	108,673	
Rruga poro	3,329,760	
Rruga Cerkovine -Trevllazer	42,964,598	
Rruga Skrofotine -Trevllazer	390,978	
Shuma	259,009,926	116,736

Në mbyllje të bilancit për vitin 2022, llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, është pakësuar për vlerën 116,736 lekë, si rezultat i nxjerrës jashtë përdorimit.

Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe ndryshimet nga viti 2021 në vitin 2022 paraqiten në *Aneksin nr. 3.4 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Titulli gjetjes: Sistemi i gabim i 31 artikujve në llogarinë 213 “Rrugë rreje vepra ujore” me vlerë 76,464,190 lekë.

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” sipas Formatit nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,014,937,669 lekë. Ndërsa në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 4,237,830,859 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, konstatohet se kjo llogari është e analizuar sipas vlerës së investimeve të kryer, pra ndërtesave nuk i është shtuar vlera e rikonstruksionit, por janë trajtuar si artikuj kontabël më vete.

Gjithashtu në këtë llogari janë kontabilizuar gabim **31** artikuj aktive materiale në vlerën 76,464,190 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 202 “Studime e kërkime” në vlerën 887,760 lekë, llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 42,144,484 lekë, llog. 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 22,735,016 lekë, llog. 214 “Instalime teknike makineri e paisje” në vlerën 10,696,930 lekë.

Gjithashtu vlera prej **37,387,815** lekë e emërtuar “**Të tjera**”, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson, konkretisht:

EMERTIMI	Llogarisë që i përket	Vlera
Studimi Arkeologjik I Landfillit	202	887,760
Plazhi I Ri	210	13,161,534
Lulishte Blloku i Coles	210	2,323,500
Lulishte Blloku lagja "Isa Boletini"	210	777,480
Lulishte Blloku te lagjes "Rilindja"	210	1,518,000
Lulishte Rruga "J.De Rada"	210	344,400
Shpronësim Sherishte Landfili F. Z.	210	193,175
Shpronësim A. Xh.	210	714,162
Shpronësim K. H.,M. T.	210	119,114
Shpronësim A.M.,M. T.	210	59,557
Sistemim plazhi	210	7,380,575
Rabilitim plazhi publik	210	11,738,557
Rehabilitim fusha e sportit Orikum	210	3,814,430
Lapidare	212	4,620,648
Prishje e Ish Frigoriferit	212	17,993,605
Shkolla Dukat iri	212	120,763
Sistemi i K:U:B. Kume viti 2010	214	5,681,280
Sistemi Informatik i kartave	214	395,000
Paisje sigurimi Bashkise	214	734,570
Elektropompe centrifugale rikonstruksion	214	687,000
Valvul thithje	214	15,000
Saracineska	214	15,000
Pompe zhytëse	214	220,000
Elektromotor rikonstruksion	214	75,000
Transformator	214	170,000
Pompe zhytëse	214	300,000
Pompe 75 Kë rikosrtikson	214	187,680
Eketrpompa 35 Kë me H164	214	537,600
Panele elektrike rikonstruksion	214	120,000
Saracineska	214	100,000
Pompa uji	214	1,458,800
Shuma		76,464,190

Kriteri: Në kundërshtim , në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e

qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” i ndryshuar me Udhëzimin nr.5 datë 21/02/2022, Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), “Klasifikimi kontabël”, me Nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75.

Ndikimi/Efekti: Trajtimi i tyre si aktive më vete ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit.

Shkaku: Përgjegjësi e personave përgjegjës në hartimin e pasqyrave financiare 2022.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Vlorë, të marrë masa për:

- Saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, duke shtuar vlerën e shpenzime për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre.
- Të kryejë zbrëthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite të paanalizuar dhe për **31** artikuj kontabël në vlerën 76,464,192 lekë, si dhe të bëjë sistemimet duke pakësuar inventarin e kësaj llogarie dhe shtuar inventarin e llog. 202 “Studime e kërkime” në vlerën 887,760 lekë, llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 42,144,484 lekë, llog. “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 22,735,016 lekë dhe llog. 214 “Instalime teknike makineri e paisje” në vlerën 10,696,930 lekë.
- Të kryejë zbrëthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite nga ish-Njësitë Vendore, që i janë bashkuar nga reforma territoriale për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare për vlerën **37,387,815 lekë** e emërtuar “**Të tjera**” dhe të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Titulli gjetjes: Mbi transferimin e aseteve në Ujësjellësin Sha

Situata: Nga analizimi i llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, rezulton se **33** objekte inventari të ujësjellës dhe KUZ me vlerë 561,707,469 lekë, të cilat aktualisht janë në inventarin e Bashkisë Vlorë, duhet të transferohen pranë shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Vlorë sha, pasi janë asete të këtyre të fundit, *konkretisht:*

EMERTIMI	Shtesa	gjendje 01.11.2022
Linja Ujësjellësit të rruga Nr.3 Osman Haxhiu		2,047,140
Ujësjellësi Fshati Risili		51,595,160
Linja uji lagje Risili		49,942
Ujësjellësi Drithas		12,068,070
Rikost Ujesllsa të ndryshëm fshatrat		47,255
Ujësjellësi Fshati Grabian, Mekat, Drithas		102,842,941
Kanalizime ujërash të ndryshme		3,124,000
Kanalizime ujërash të bardha		5,774,226
KUZ Shushice -Llakatund		37,949,681
Rikuns I Kuz Lakatund		812,766
Ujësjellësi Sherishte		5,576,841
Ujësjellësi Kanine		17,636,445
Ujësjellësi Shamogjin-Panaja		43,847,085
Ujësjellësi Hoshtime		11,559,440
Ujësjellësi Narte		13,132,140

EMERTIMI	Shtesa	gjendje 01.11.2022
Ujësjetllësi Xhyerine		4,794,783
Ujësjetllësi Alikoke		4,436,500
Ujësjetllësi Xhyerine -Babice		52,476,932
Ujësjetllësi Babice e vogël		1,225,956
Kanali i Ujërave te zeza Babice e Madhe		5,441,313
Kanali i Ujërave te zeza Babice e Vogël		1,037,879
Rikonstrukcion depo uji zvernec		122,025
Rikonstrukcion rrjeti brendshëm Panaja		24,790
Rikonstrukcion rrjeti K.U.Z. Babice e Vogël		54,625
Ujësjetllësi Orikum		25,841,118
K.u.z Orikum		18,069,615
Kanalizime Orikum		4,875,804
Ujësjetllësi Dukat		600,000
K.u.b		5,169,307
Ujësjetllësi qyrokali rezervuar		4,490,993
Riko ujësjetllësi Maruk		955,260
Kuz Radhimë		2,618,600
Rikonstrukcion I Qendrës Fshatit Dukat		3,560,866
ujësjetllësi shamogjin panaja		53,750,672
ujëra te bardha fshati fitore		4,041,299
ujësjetllësi Novosele		49,285,948
ujësjetllësi mifol		1,996,311
ujësjetllësi poro		494,375
ujësjetllësi cerkovine		488,565
ujësjetllësi bishan		460,298
ujësjetllësi delisuf		4,514,458
ujësjetllësi skrofotin		334,800
ujësjetllësi shamogin bestrove		2,481,245
Shuma		561,707,469

Kriteri: Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 05, datë 21/02/2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

Ndikimi/Efekti: Me ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

Shkaku: Përgjegjësi e personave përgjegjës në hartimin e pasqyrave financiare 2022

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Vlorë, të marra masa për transferimin e **33** objekte inventari të ujësjetllës me vlerë 561,707,469 lekë në sha UK Vlora, pasi nuk i përkasin inventarit të Bashkisë Vlorë.

Llog 214 “Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 204,997,027 lekë.

Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 263,274,841 lekë dhe në vitin 2021 në vlerën 245,709,065 lekë.

Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe ndryshimet nga viti 2021 në vitin 2022 paraqiten në Aneksin nr. 3.5 bashkëlidhur këtij Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 215 “Mjete transporti”. Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë më datë 31.12.2021 në shumën 48,055,352 lekë, (në vlerë neto).

Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 104,438,190 lekë dhe në vitin 2021 në vlerën 104,438,190 lekë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe ndryshimet nga viti 2020 në vitin 2021 paraqiten në Aneksin nr. 3.6 bashkëlidhur këtij Akt-konstatimi.

Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”. Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative të Bashkisë. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 5,576,556 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 10,720,695 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 7344,369,865 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën kontabël 37,926,303 lekë.

Gjendja e aktiveve afatgjata në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2021 paraqiten në Formatin nr.7/A “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF si më poshtë:

Nr. Refn Llog	E M E R T I M I	Gjendje ne Fillim vit te vitit	Shtesa gjate vitit ushtrimor, Kosto Historike				Pakësime gjate vitit , Kosto Historike			Gjendja mbyllje te ushtrimit
			Blerje e krijuar me pagese	Shtesa pa pagese Jashtë sistemit	Lëvizje brenda aktiveve	Gjithë sejt	Nx.jasht përdor.	Pakësime të tjera	Gjithë ej	
b	c	1	2	3	6				11	
20	I. AAGJ/JO MATERIALE	115,857,512	0	0	0	0	0	0	115,857,512	
201	Prime te emisio e rimbursim te huave					0			0	
202	Studime dhe kërkime	115,857,512				0			115,857,512	
203	Koncesion, patenta ,licenca e ngjashme					0			0	
21- 28	II. TAAGJ/ MATERIALE	5,940,885,516	293,897,395	20,183,894	0	0	314,081,289	0	13,071,216	6,241,895,589
210	Toka,troje,Terene	111,833,518				0			111,833,518	
211	Pyje, Kullota Plantacione	272				0			272	
212	Ndërtime e Konstruksione	1,419,596,938	30,994,669			30,994,669			1,450,591,607	
213	Rrugë,rrjete,vepra ujore	4,014,937,668	259,009,926			259,009,926		116,736	4,273,830,858	
214	Instalime tek,makiner,paisje,vegla pune	245,709,065	3,892,800	20,183,894		24,076,694		6,510,918	263,274,841	
215	Mjete transporti	104,438,190				0			104,438,190	
216	Rezerva shtetore	0				0			0	
217	Kafshe pune e prodhimi	0				0			0	
218	Inventar ekonomik	44,369,865				0		6,443,562	37,926,303	
24	Aktive te Qend.te trupëzua te dëmtuara	0				0			0	
28	Caktime					0			0	
	T O T A L I (I + II)	6,056,743,028	293,897,395	20,183,894	0	0	314,081,289	0	13,071,216	6,357,753,101

Titulli gjetjes: *Pasaktësitë e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”*

Situata: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) për vitin buxhetor 2022 paraqitet në vlerën 6,099,533,096 lekë, me të gjitha shtesat/pakësimet për çdo lloj grup aktivi.

Inventari kontabël i aktiveve materiale gjendje në llogaritë 210 “*Toka, Troje, Terrene*” është në vlerën 111,833,518 lekë; llogaria 211 “*Pyje, Plantacione*” në vlerën 272 lekë, llogaria 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” në vlerën 1,450,591,607 lekë, llogaria 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në vlerën 4,273,830,858 lekë; llogaria 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në vlerën 263,274,841 lekë.

Në këto llogari **nuk është i qartë përcaktimet e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për artikull**, duke mos përcaktuar vlerën e plotë të çdo aktivi, e cila duhet të përfshijë vlerën fillestare dhe shtesat gjatë viteve të secilit aktiv.

Në këto inventarë kontabël janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv.

Gjithashtu për këto aktive mungojnë kartelat kontabël apo regjistri historik me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Kriteri: Ne kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30 dhe me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21/02/2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar pika 2.1 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit të llogarive 21 “Aktive afatgjata materiale.

Ndikimi/Efekti: Veprime të cilat nuk japin garanci mbi saktësinë e pasqyrave financiare 2022.

Shkaku: Përgjegjësi e personave përgjegjës në hartimin e pasqyrave financiare 2022.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Vlorë të marr masa për:

- Analizimin e llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” është në vlerën 111,833,518 lekë; llog. 211 “*Pyje, Plantacione*” në vlerën 272 lekë, llog. 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” në vlerën 1,450,591,607 lekë, llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në vlerën 4,273,830,858 lekë; llog. 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në vlerën 263,274,841 lekë, në përcaktimin e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për artikull, të vlerës së plotë të çdo aktivi, nga vlera fillestare dhe shtesat gjatë viteve.

- Të hapen kartelat kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Klasa 3 “Aktive Afatgjata Financiare” rezultojnë në fund të vitit 2021 dhe 2022 me gjendje në vlerën 2,000,0000 lekë. Në këtë klasë përfshihet gjendja e llogarisë 26 “*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*” e cila përfaqëson përmirje kapitali tek tregu fruta perime.

- Investimet

Llogaria kontabël 231 “Për Aktivet Afatgjata Materiale”. Kjo llogari përfaqëson investime në proces për kontrata të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor e cila për vitin 2022 paraqitet në vlerën 405,017,866 lekë, konkretisht:

Llogaria 231 VITI 2022		Mbetja	105	115
Nr	Emërtimi			
1	Ujësllësi tragjasit % per F.Zhvilimit	18,396,000.0	18,396,000	
2	Ujësllësi Trans ballkanike	107,547,840.0	107,547,840	
3	Supervizimi Ujësllësi Tranballkanike	790,040.0	790,040	
4	Ujësllësi Uji Ftohte-Marina	65,602,622.0	65,602,622	
5	Mbikëqyrje Uji ftohte-Marina	1,118,518.0	1,118,518	
6	Rekonstrukioni Rrugës drithas	1,854,360.0		1,854,360
7	Projekti invalor, kosha pastrimi	193,208.0		193,208
8	Projekti alarms, paisje per zjarrriksen	282,957.0		282,957
9	Rikonstrukioni ujësllësi të fshatrave	148,550,729.0		148,550,729
10	Projekti B. M. P.	1,930,684.0		1,930,684
11	T. Vlora pagese e kontrib te Bashkise per projektin T. Vlora	8,600,000.0		8,600,000
12	S. ShPK projekti C.-C. rikonstrukioni i kopsht 5	8,962,333.0		8,962,333
13	L. projekti vazhdimi I punimeve rruga e biçikletave	15,449,453.0		15,449,453
14	Qendra per bashkëpunim projekti S. pagese konsulence	542,819.0		542,819
15	S. paisje elektrike	4,820,331.0		4,820,331
16	C. Al. rikonstrukioni I shkollës Muco Delo	15,727,492.0		15,727,492
17	A. kontrate shërbimi projekt S.	1,582,224.0		1,582,224
18	P. K. RIKONSTRUKSIONI I SHK M.DELO	2,690,284.0		2,690,284
19	N. kolaudimi I ujësllësit transballkanike	375,972.0		375,972
	TOTALI I + II	405,017,866.0	193,455,020	211,562,846

- Inventarizimi i aktiveve për vitin 2022 Bashkia Vlorë

Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Bashkia Vlorë nuk disponon një regjistër aktivesh i cili hartohet në vartësi të llojit të aktiveve afatgjata apo afatshkurtra si dhe grupit përkatës brenda llojit. Gjithashtu ky regjistër duhet të përmbajë kërkesat minimale konkretisht, datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datë e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

Për vitin 2022, Kryetari i Bashkisë Vlorë ka nxjerrë Urdhrin nr. 85, datë 22.4.2022 (prot nr. 4327), për krijimin e komisionit të inventarizimit të aktiveve të vetë institucionit dhe Njësive Administrative.

Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i inventarizimit nuk është hartuar raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit t'i dorëzohej nëpunësit autorizues të institucionit, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 85, germa "c".

Nga të dhënat, konstatohet se për inventarët e NJA Shushicë dhe arsimit ku janë evidentuar materiale në vlerën 42,509 lekë dhe magazina në vlerën 74,700 lekë, nuk janë ngritur komisioni për asgjësimin e materialeve, veprime në kundërshtim me pikën 100, të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, **duke ngarkuar me përgjegjësi z. D. L. në cilësinë e nëpunësit autorizues.**

Me Urdhrin nr. 85, datë 22.4.2022 (*prot nr. 4327*), të Kryetarit të Bashkisë është krijuar komisioni për vlerësimin e aktiveve për vitin 2022. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve të propozuara nga komisioni i inventarizimit, në total nga komisioni i sipërpërmendur janë mbajtur 8 procesverbale më datën 6.6.2023; 8.6.2023; 12.6.2023; 8.6.2023; 29.6.2023; 30.5.2023; 5.6.2023; 31.5.2023.

Duke u bazuar në procesverbalet e hartuara nga komisioni për vlerësimin e aktiveve është vlerësuar që të nxirren aktive jashtë përdorimit të Bashkisë Vlorë dhe Njësi Administrative në total në vlerën 1,549,141 lekë.

Në listën e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit ka materiale të cilat konsiderohen të dëmshme konkretisht, ngrohës me korrent, ngrohës elektrik, gërshërë mishi, tava inoksi, termometër, etj, për të cilat hedhja apo asgjësimi i tyre, duhet të kryhet me një procedurë të mirëfilltë për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre me qëllim parandalimin dhe pakësimin e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të destinuara për asgjësim si dhe të përmirësimit të performancës mjedisore.

Nga Kryetari i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues nuk janë përcaktuar rregulla për mënyrën e transportit, asgjësimit të tyre dhe nuk disponohet asnjë korrespondencë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për lejimin e asgjësimit dhe groposjen e pajisjeve të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe impaktin që kanë në komunitet.

Në të gjitha procesverbalet citohet se, "Gjatë verifikimit të këtyre materialeve u konstatua se këto materiale nuk janë në gjendje për t'u përdorur dhe nuk përshtaten për përdorim. Materialet që dolën jashtë përdorimit u ndryshua forma dhe një pjesë e tyre u gropos dhe pjesa tjetër u dogj".

Referuar të dhënave të paraqitura në procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve konstatohet se, nuk vërtetohet me dokumentacion justifikues (procesverbal, fotografi) transporti si dhe vendi në të cilën është kryer asgjësimi i aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, Ligji nr. 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, VKM nr. 957, datë 19.12.2012, "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike", Kreu I, pikat 1-2, dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 122.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi komisionin për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit i ngritur me Urdhrin nr. 163, datë 22.5.2023 (*prot nr. 6017*), të Kryetarit të Bashkisë Vlorë.

Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Vlorë në fund të vitit 2022, paraqitet në vlerën (1,871,025,262) lekë. Krahasuar me vitin 2021 llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” paraqitet me shtesë prej (262,749,889) lekë, shtesë e cila ka ardhur si rezultat:

Pasqyra statistikore nr. 7.b “Aktivet afatgjata me vlerë neto”

Nr. Reference Llogarie	Teprica Neto	Shtesat gjate vitit		Pakësimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
b	3	4	5	6	7	8	9	10
20	58,784,151	0	17,387,625	0	0	115,857,512	74,460,986	41,396,526
201	0.0					0.0	0.0	0.0
202	58,784,151.0		17,387,625.0			115,857,512.0	74,460,986.0	41,396,526.0
203	0.0					0.0	0.0	0.0
21- 28	4,389,683,504.0	314,081,289.0	258,433,480.0	13,071,216.0	13,071,216.0	6,241,895,589.0	1,796,564,276.0	4,445,331,313.0
210	111,833,518.0					111,833,518.0	0.0	111,833,518.0
211	272.0					272.0	0.0	272.0
212	1,103,235,205.0	30,994,669.0	55,161,710.0			1,450,591,607.0	371,523,443.0	1,079,068,164.0
213	2,877,674,208.0	259,009,926.0	143,883,710.0	116,736.0	116,736.0	4,273,830,858.0	1,281,030,434.0	2,992,800,424.0
214	226,150,416.0	24,076,694.0	45,230,083.0	6,510,918.0	6,510,918.0	263,274,841.0	58,277,814.0	204,997,027.0
215	60,069,190.0		12,013,838.0			104,438,190.0	56,382,838.0	48,055,352.0
216	0.0					0.0	0.0	0.0
217	0.0					0.0	0.0	0.0
218	10,720,695.0		2,144,139.0	6,443,562.0	6,443,562.0	37,926,303.0	29,349,747.0	8,576,556.0
24	0.0		0.0			0.0	0.0	0.0
28	0.0		0.0			0.0	0.0	0.0
Totali	4,448,467,655.0	314,081,289.0	275,821,105.0	13,071,216.0	13,071,216.0	6,357,753,101.0	1,871,025,262.0	4,486,727,839.0

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36.

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të llogaritura nga Bashkia Vlorë, janë si më poshtë:

- Ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- Inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- Për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25 %
- Për mjetet e transportit 20 %

- PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Vlorë më 31.12.2021, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2021, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2021, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2022	Viti 2021	Diferenca/ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	1,240,618	0	1,240,618
42	Detyrime ndaj personelit	39,680,906	35,338,128	4,342,778
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	2,994,348	2,609,911	384,437
435	Sigurime shoqërore	12,011,499	10,774,341	1,237,158
436	Sigurime shëndetësore	1,649,902	1,479,551	170,351
44	Institucione të tjera publike (kredia)	2,503,000	3,620,000	-1,117,000

Llogaritë		Viti 2022	Viti 2021	Diferenca/ndryshimi
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	65,660,528	62,600,940	3,059,588
467	Kreditorë të ndryshëm	104,766,077	115,078,465	-10,312,388
475	Të ardhura për tu regjistruar vitet pasardhëse	751,259,403	663,564,285	87,695,118
	Gjendja më fund të periudhës	981,766,281	895,065,621	

Llogaritë e klasës 4 të aktivitet të bilancit “Llogari të arkëtueshme” janë për vlerën **916,695,966** lekë ndërsa llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë “llogari të pagueshme” ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Vlorë më 31.12.2021, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2021, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2021, janë pasqyruar për vlerën **916,105,753** (981,766,281-65,660,528) lekë.

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit 2022 është në vlerën 1,240,618 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Vlorë më 31.12.2021. Lëvizja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në tabelën si me poshtë:

Llog. 401-408 “Furnitorë e llogari te lidhura me to”	
Çelje e vitit 2022	0
Shtesa (K)	65,864,656
Pakësime (D)	64,624,038
Gjendja në 01.11.2022 (K)	1,240,618

Kjo llogari është e pa analizuar, nuk ka fatura për të vërtetuar detyrimet që ka Bashkia ndaj furnitorëve dhe kjo vlerë i përket detyrimeve të vitit 2004.

Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Vlorë, paraqitet në vlerën 39,680,906 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, lëvizjet gjatë vitit 2022, paraqiten në pasqyrën sa më poshtë:

Llog. 42 "Detyrime ndaj personelit"	
Çelje e vitit 2022	35,338,128
Shtesa (K)	557,109,828
Pakësime (D)	552,767,050
Gjendja në 01.11.2022(K)	39,680,906

Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 2,994,348 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor, lëvizjet gjatë vitit 2022, paraqiten në pasqyrën sa më poshtë:

Llog. 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
Çelje e vitit 2022	2,609,911
Shtesa (K)	33,647,922
Pakësime (D)	33,263,485
Gjendja në 01.11.2022 (K)	2,994,348

Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2022 që paguhen në muajin janar 2023 dhe janë përkatësisht në vlerat 12,011,499 lekë dhe 1,649,902 lekë, lëvizjet gjatë vitit 2022, paraqiten në pasqyrën sa më poshtë:

Llog. 435 "Sigurime shoqërore"	
Celje e vitit 2022	10,774,341
Shtesa	138,110,734
Pakësime	136,873,576
Gjendja në 01.11.2022	12,011,499
Llog. 436 "Sigurime shëndetësore"	
Celje e vitit 2022	1,479,551
Shtesa	18,257,689
Pakësime	18,087,338
Gjendja në 01.11.2022	1,649,902

Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 62,600,940 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 65,660,528 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit Vlorë në mënyrë analitike, e cila paraqitet në Aneks nr. 3.7, të bashkëlidhur aktit.

Titulli gjetjes: *Mos marrja e masave për zhbllokimin e garancive të punimeve për vlerën 62,600,940 lekë.*

Situata: Nga auditimi rezulton se llogaria 466 “Kreditore për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare paraqitet në vlerën kontabël 65,660,528 lekë e rakorduar kjo dhe me Degën e Thesarit. Sipas analizës së kësaj llogarie, kjo llogari për vitin 2022 është shtuar për **22** objekte për vlerën 6,655,526 lekë, dhe është pakësuar në **16** objekte për vlerën 3,595,838 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë të ngurtësuar fonde për vlerën 62,600,940 lekë të cilat i përkasin ngurtësimeve të garancinë te punimeve për periudhën 2021 e para, të cilave u ka kaluar afati i garancisë. Bashkia Vlorë nga ana e sajë nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për c’bllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre për interes publik.

Kriteri: Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21/02/2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Ndikimi/Efekti: Mos marrja e angazhimeve për çngurtësimi e fondeve të garancive të punimeve, veprime në mos angazhim të fondeve të prokuruar.

Shkaku: Përgjegjësi e personave përgjegjës në ndjekjen e kontratave.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit (Sektori i Menaxhimit të Kontratave), Drejtorinë Juridike Bashkia Vlorë, të marrin masa duke ndjekur të gjitha hapat e nevojshme që për punimet e përfunduara dhe marrë në dorëzim konformë përcaktimeve në kontratës, të bëjnë njoftimet e subjekteve për marrjen e garancive të punimeve.

Në rast mos plotësimi të kushteve ose refuzimit nga subjektet në zbatim të dispozitave ligjore të bashkëpunohet me Degën e Thesarit Vlorë për kalimin e këtyre fondeve në favor të autoritetit kontraktor si e ardhur për mospërmbushje të kushteve të kontratës.

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqiten faturat e pa likuiduara shërbime të cilat për vitin 2022 paraqiten në shumën 104,766,077 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2022 paraqitet si më poshtë:

Llog. 467 "Kreditorë të ndryshëm"	
Çelje e vitit 2022	115,078,465
Shtesa	2,562,999
Pakësime	12,875,387
Gjendja në 01.11.2022	104,766,077

Në mënyrë analitike sipas objekteve dhe vitit që i përket paraqitet në pasqyrën, si më poshtë:

Nr	Nr UR	Date	Subjekti	467
2020				
1		qershor 2020	Furnizuesi shërbimit universal	32,394,556
2		tetor 2020	E. A.	17,223
3		tetor 2017	A. sha	92,400
4		korrik 2018	A. S.	5,500
5		qershor 2018	A. 3D	41,870
6		2013-2014	A. P.	1,234,240
7		korrik 2017	B. D.	25,920
8		tetor 2018	C. ShPK	14,040
9		tetor 2018	E. O.	28,800
10		nëntor 2017	E. I.	3,000
11		nëntor 2017	E.	10,000
12		shtator 2017	E.	52,580
13		qershor 2015	G. H.	12,000
14		shtator 2018	K.	139,000
15		gusht 2018	M. R.	2,500
16		dhjetor 2017	N. V.	11,000
17		mars 2017	N.	94,080
18		gusht 2018	P. D.	9,900
19		tetor 2018	P. Sh.	1,145
20		mars 2017	S. E.	58,080
21		korrik 2016	Sh. K.	45,000
22		korrik 2018	Sh. R.	20,700
23		tetor 2017	Sh.e B.	1,560
24		tetor 2017	S.	34,680
25		korrik 2017	S. V.	1,400
26		2017	T. I.	0
27		shtator 2018	T.	5,700
28		mars 2017	T. 6+1 V.	20,000
29		korrik 2017	U.	3,247
30		2017	V. B.	9,500
31		gusht 2017	Xh.	19,200
32		mars 2020	E. M. ShPK	230,400
33		dhjetor 2020	Shpërblim lindje	2,680,000

Nr	Nr UR	Date	Subjekti	467
34			B. kredia	
35		janar 2019-2020	A. ShPK	13,680
36		Fat.244.dt.11.12.2020	U. P. T.	397,134
36		Fat.244.dt.11.12.2021	U. P. T.	325,041
36			2022	0
36		fat.17.dt 27.09.2021	Rikonstruksion i Ujësjetllësit Transballkanike	59,392,230
36		fat.908.dt 26.07.2022	Rikonstruksion i Ujësjetllësit Ujë i Ftohtë	1,040,575
36		fat.906.dt 29.07.2022	Rikonstruksion i Ujësjetllësit Novosele	1,022,370
36		fat.79.dt 28.12.2022	Riparimi i Shkollës Teli Ndini	651,600
36		fat.26.dt 12.10.2022	Ndërtimi i Sallës së Këshillit	3,517,418
36		fat.56.dt 16.12.2022	Rikonstruksioni i banesave Egjiptiane	405,684
36		fat.62.dt 27.10.2021	Supervizimi i ujësjetllësit Novosele	581,116
36		fat.96.dt 29.12.2022	Botim Libri	100,008
			Totali	104,766,077

Llogaria 475 “Të ardhura për tu regjistruar vitet pasardhëse”, paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 663,564,285 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 751,259,403 lekë, vlera të cilat nuk rakordon me gjendjet e llogarisë kundërparti 468 “*Debitorë të ndryshëm*” në aktiv të bilancit, për vlerën **550,665 lekë**.

Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2022 paraqitet si më poshtë:

Llog. 475 “Të ardhura për tu regjistruar vitet	
Çelje e vitit 2022	663,564,285
Shtesa	
Pakësime	
Gjendja në 01.11.2022	751,259,403

Pasivet afatgjata, paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 8,930,189 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,407,213 lekë, e cila ka të bëjë me pagesën e kredisë.

Pasqyra e Performancës financiare (F2)

Të ardhurat dhe shpenzimet, e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të Bashkisë Vlorë më datë 01.11.2022 janë të kuadruar me Degën e Thesarit Vlorë, konkretisht:

Rakordimi të ardhurave

Emërtimi	Vlera sipas Pasqyrës së Performancës	Dokumentimi	Vlera	Diferenca
-Të ardhurat e krijuara gjatë vitit	1,225,466,026	Aktrakordimin me Degën e Thesarit	1,225,466,026	
-Granti nga buxheti	1.768.008.796	Sipas çeljes së buxhetit nga MFE	1.768.008.796	
-Financim i pritshëm nga buxheti	164.750.563	Sipas llogarisë 7206	164.750.563	
-Fonde buxhetore të trashëguara	265.001.611	aktrakordim Degën e Thesarit		
-Të ardhura të trashëguara (rez)	201,664,267	Nga rezultati i vitit të mëparshëm llog.85	466.665.878	
-Llog 73 Ndryshim i gjendjes me(+)		Sipas llog 63 me (+)		
Totali të ardhura	3,624,891,263	Totali të ardhura	3,624,891,263	

Rakordimi i Shpenzimeve

Emërtimi	Sipas Situacionit	Detyrimet e vitit 2021	Detyrime të vitit 2022	Sipas Pasqyrës së Performancës
600	549,093,134	37,948,039	42,675,254	553,820,340
601	91,268,861	12,253,892	13,661,401	92,676,370
602	666,794,294		106,006,695	666,794,294
604	11,390,312			11,390,312
603	4,364,690			4,364,690
606	748,526,384			748,526,984
651	188,607			188,607
231	197,435,564			197,435,564
166	6,522,979	8,930,189	2,407,213	
63				
Totali	2,275,584,822	59,132,120	164,750,563	2,381,203,265

Pasqyra e flukseve monetare (F3)

Pasqyra e Flukseve Monetare, paraqet rrjedhën e likuiditeteve dhe gjendjen më datë 01.11.2022.

Nr Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhëse
(b)	(c)	(1)	(2)
I	Veprimtaritë e shfrytëzimit	708.431.914	732577.738
II	Veprimtaritë e investimeve	139.111.005	107.568.492
III	Transferta e te tjera	-461.005.265	-548.851.782
VI	Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor	918.053.472	531.515.818

Nga kontrolltet e kryera rezultoi se teprica e llogarisë së likuiditeteve më datë 01.11.2022, e paraqitur në këtë pasqyrë rezulton në shumën 918,053,472 lekë dhe kuadron me tepricën e likuiditeteve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" e cila paraqitet në shumën 918,053,472 lekë.

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F 4)

Numër llogarie	Emërtimi	Fonde bazë dhe grante kapitale	Rezultatet e mbartura	Rezultatet e ushtrimit	Gjithsej aktive neto/fonde neto
101	Aktivet neto	4.504.374.124	314,081,289		4,818,455,413
	Ndryshimet në aktivet neto	968,145,575	-1,048,772,539		
105	Nga burime të brendshme Grante të brendshme kapitale	269,884,751	-134,541,276	58,111,545	193,455,020
	Transferta të brendshme (grante në natyre)				
1013	Nga konsumi i AAGJ (Amortizimi)		-275,821,105		-275,821,105
1015	Dalje jashtë përdorimi				
109	Rivlerësime				
1016	Nga Transferta e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)		7,825,233		7,825,233
1016, (+,-)	Nga transferta e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)		-20,183,894	20,183,894	
115	Nga Fondet e veta te investimeve	231,594,946	-159,386,119	139,324,019	211,562,846
12	Rezultati i mbartur	466,665,875	-466,665,878		
85	Nga rezultati i vitit ushtrimor			850,485,944	850,485,944
Totali		5,472,519,699	- 734,691,250	1,068,105,402	5,805,86,351

- **Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës.**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- **Veprimet nëpërmjet magazinës.**

-Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

-Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga nen/Kryetari.

- Janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre ekziston viti i krijimit si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to, por nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30, të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

- **Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore në kryerjen e pagesave për pagat e punonjësve, shtesat mbi to , shpërblimeve.**

Nga Bashkia Vlorë është mbajtur dhe përditësuar libri dhe ditari i pagave. Ato hartoheshin sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave deri tek paga neto.

Përmbledhëset janë të kuadruar me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkuara nga punonjësi i financës dhe titullari.

Për të gjithë periudhën e kontrolluar, janë përlogaritur, ndaluar dhe xhiruar detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat. Janë respektuar strukturat organike të miratuara përsa i përket numrit të punonjësve si dhe janë respektuar dispozitat ligjore për kohëzgjatjen e punës.

Per vitin 2022 totali i te ardhurave ne vlere është 3,624,891,263 lekë dhe totali shpenzimeve është 2,774,405,319 lekë . Diferenca e tyre ne vlerën 850,485,944 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit” .

Gjithashtu gjendja e llogarisë **63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”** është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2022 është në vlerën - 7,825,234 lekë.

Pika 4 e programit. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlerë të lartë, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022.

2.4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

2.4.4. Auditim mbi hartimin e zbatimit e projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomike fitues.

-Në mënyrë të përmbledhur realizimi i prokurimeve për periudhën e auditimit, 01.07.2021-31.12.2021 dhe 2022 si më poshtë.

Në total u audituan **12** procedura prokurimi me vlerën limit të kontratës **111,330,000** lekë pa TVSH me kontrata të lidhura në vlerën **94,051,306.62** lekë me TVSH, ose **84.47 %** e vlerës limit të kontratës.

Sipas viteve të auditimit:

1. Për periudhëm **01.07.2021 – 31.12.2021** janë audituar **5** procedura prokurimi me vlerën limit të kontratës **20,908,771** lekë pa tvsh dhe janë lidhur kontrata në vlerën **18,481,255** lekë pa tvsh ose **88.38 %** e fondit limit të kontratës.

2. Për vitin **2022** janë audituar **7** procedura prokurimi me vlerën limit të kontratës **90,421,229** lekë pa tvsh dhe janë lidhur kontrata në vlerën **75,570,052** lekë pa tvsh ose **83.57 %** e fondit limit të kontratës.

Sipas llojit të procedurës:

1. Për periudhëm **01.07.2021 – 31.12.2021** janë audituar **5** procedura prokurimi “E hapur e thjeshtuar” me vlerën limit të kontratës **20,908,771** lekë pa tvsh dhe vlera e negociuar dhe e kontraktuar është **18,481,255** lekë pa tvsh ose **88.37 %**, nga ku:

- **3 (tre)** procedura “Për punë publike” me vlerën limit të kontratës **16,033,509** lekë pa tvsh dhe vlera e negociuar dhe e kontraktuar është **13,672,181.75** lekë pa tvsh ose **85.27 %**.

- **1 (Një)** procedura “Për Shërmim” me vlerën limit të kontratës **3,215,262** lekë pa tvsh dhe vlera e negociuar dhe e kontraktuar është **3,189,073** lekë pa tvsh ose **99.18 %**.

- **1 (një)** procedura “Për Mallra” me vlerën limit të kontratës **1,660,000** lekë pa tvsh dhe vlera e negociuar dhe e kontraktuar është **1,620,000** lekë pa tvsh ose **97.59** %.

2. Për periudhëm **2022** janë audituar **7** procedura prokurimi “E hapur e thjeshtuar” me vlerën limit të kontratës **20,908,771** lekë pa tvsh dhe vlera e negociuar dhe e kontraktuar është **18,481,255** lekë pa tvsh ose **88.37** %, nga ku

- **3 (tre)** procedura “Për punë publike” me vlerën limit të kontratës **47,537,284** lekë pa tvsh dhe vlera e negociuar dhe e kontraktuar është **33,518,467** lekë pa tvsh ose **98.17** %.

- **4 (Katër)** procedura “Për Mallra” me vlerën limit të kontratës **51,385,346** lekë pa tvsh dhe vlera e negociuar dhe e kontraktuar është **50,446,703** lekë pa tvsh ose **97.59** %.

Në zbatim të pikës së programit të auditimit, u shqyrtua procedura elektronike e prokurimit dhe dokumentacioni në dosjet e prokurimit ku u konstatua:

1. Tenderat me objekt: “*Blerje Kompjutera Desktop, Workstation, Printer AIO, Laptop Praktik*” dhe “*Pëmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara*”.

Në vijim pasqyrojmë situatat dhe Rekomandimet përkatëse si më poshtë:

Titulli i Gjetjes: Në zbatim të programit të auditimit u audituan procedurat e prokurimit publik ku u konstatua se nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, nuk janë respektuar rregullat e procedurave të prokurimit publik në vlerësimin e drejtë të operatorëve teknike, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar dhe, LPP, i ndryshuar.

Situata 1: Nga auditimi i prokurimit me objekt: “Blerje Kompjutera Desktop, Workstation, Printer AIO, Laptop Praktik” me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

Tenderi me objekt: “ Blerje Kompjutera Desktop, Workstation, Printer AIO, Laptop Praktik ”, Nr. Ref. 96505-05-26-2021.		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 133, datë 25.05.2021 (Nr. prot. 8356, datë 25.05.2021)	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit/NjP 1. P. Th., Jurist 2. P. M., Specialist IT 3. J. Ç., inxhinier	4. KVO-ja: Urdhër nr. 134, datë 25.05.2021 (Nr. prot. 835, datë 25.05.2021) 1. T. Z., Kryetar 2. M. M., Anëtar 3. V. Z., Ekonomist
2. Lloji i Procedurës: “E hapur e thjeshtuar”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 1,660,000 lekë.	6. Oferta fituese: OE “PC. S” ShPK me ofertë të 1,620,000 lekë pa tvsh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 40,000 lekë pa tvsh, ose 2.40 %
8. Data e hapjes së tenderit: Datë 07.06.2021 ora 10:00	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Vlorë.	10. Operatorët Ekonomike: Pjesëmarrës në tender 1 OE: -Kualifikuar 1 OE - Skualifikuar -- OE
11. Ankimime; Po	12. Përgjigje Ankesës nga AK: Po	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: Po

u konstatuan problematika si vijon:

KVO nga verifikimi i dokumentacionit nga ofertuesit në rrugë elektronike, konstatoi se ka paraqitur ofertën operatori “PC. S” ShPK me vlerë 1,620,000 lekë.

KVO, mbas shqyrtimit të dokumenteve të kritereve të përgjithshme dhe ato teknike, referuar proces-verbalit, datë 14.06.2021 (Sqarojë se ky proces-verbal nuk administrohet në dosjen e

prokurimit, por të dhënat u morën nga Raporti përmbledhës) për vlerësimin e ofertave të OE pjesmarrë, për prokurimin “Blerje Kompjuterë Desktop, Workstation, Printer AIO, Laptop Praktik” vendosi të skualifikojë OE “PC. S” ShPK.

Kryetari i Bashkisë Vlorë, me nr. 9709 prot; datë 22.06.2021, ka miratuar Raportin përmbledhës për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje Kompjuterë Desktop, Workstation, Printer AIO, Laptop Praktik” me OE të kualifikuar OE “PC. S” ShPK, me vlerë oferte 1,620,000 lekë pa TVSH. Raporti përmbledhës është nënshkruar nga anëtarët e KVO-së.

-AK, me nr. 9280 prot, datë 11.06.2021, i dërgon APP-së formularin e njoftimit të fituesit për publikim në Buletinin e njoftimeve publike.

- Formulari i njoftimit të fituesit (AK) është publikuar nga APP, në Buletinin nr. 95, datë 21.06.2021.

- Formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar (nga AK) është publikuar nga APP, në Buletinin nr. 111, datë 19.07.2021.

- Për realizimin e investimit me objekt “Blerje Kompjuterë Desktop, Workstation, Printer AIO, Laptop Praktik”, është lidhur kontrata për punë publike me nr. 10581 prot; **13.07.2021** mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë, përfaqësuar nga Kryetari, z. D. L. dhe sipërmarrësit të punimeve OE “PC. S” ShPK me administrator Z. V. M. me vlerë **1,944,000** lekë me TVSH. Afati i realizimit të kontratës është 1 (një) muaj.

Vlerësimi nga grupi i auditimit:

Së pari: Nga shqyrtimi në SPE dhe në dojen e prokurimit të dokumentacionit të paraqitur nga OE “PC. S” ShPK, rezulton se ky OE është shpallur fitues në kushtet e mosplotësimit të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK.

Në bazë të VKM –së Nr. 285, datë 19.05.2021, neni 24, pika 2, përcaktohet se: “Në procedurat e prokurimit nën kufijtë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”. Bazuar në këtë dispozitë në DST në seksionin 4.6 përcaktohet se:

-Pika 4.6 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip	<input checked="" type="checkbox"/>	Anglisht	<input type="checkbox"/>
Tjetër	_____		

-Tek “**Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit**” të DST, theksohet se: “*Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në **gjuhën shqipe**.*”.

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e prokurimit si dhe në sistemin elektronik SPE, konstatohet se katalogët për mallrat (Kompjuter Desktop 1 Monitor; Kompjuter Workstation; Printer All In One; Fotokopje Color MFP) janë në gjuhën Angleze dhe shoqërohen me një përkthim të noterizuar në **gjuhën shqipe**.

Sa më sipër, APP e ka parashikuar këtë situatë në hartimin dhe miratimin e DT, duke përcaktuar shprehimisht rubrikën se në cilën gjuhë do të hartohen katalogët. Në zbatim të kësaj rubrike, AK në hartimin e DST, e ka dhënë informacionin e nevojshëm për OE se gjuha që do të hartohen katalogët është “Shqip”.

Fakti që ky dokumentacion nuk është paraqitur prej operatorit ekonomik “PC. S” ShPK jo në formën e kërkuar, sjell si pasojë mosplotësimin e njëkohshëm të përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

*Në lidhje me mangësitë në plotësimin e kriterëve nga OE pjesëmarrës në garë dhe shpallur fitues, nga KVO-ja nuk rezulton të mos jetë kërkuar **asnjë sqarim nga ofertuesi apo NJP** për të motivuar apo argumentuar vendimin e tyre.*

Si përfundim, kualifikimi i OE "PC. S" ShPK është i padrejtë dhe nuk qëndron dhe në gjykimin e grupit të auditimit, kjo procedurë prokurimi duhej të ishte anuluar.

-Sa më sipër KVO ka vlerësuar dhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 75 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar dhe, nenit 64 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik".

Së dyti: Në Bashkinë Vlorë në zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt: "Blerje materiale elektrike për ndriçimin publik dhe institucioneve" me Nr. REF-04452-09-02-2022 me Urdhër Prokurimi Nr. 36, datë 03.03.2022, me Fond Limit 10,347,020 lekë pa TVSH, me fitues OE "L. B." ShPK në vlerën 10,140,080 lekë pa TVSH, rezulton që KVO-ja (ku z. V. Z., ka qenë anëtar i KVO-së në dyja procedurat e prokurimit) si dhe AK Bashkia Vlorë, të ketë kryer një trajtim jo të barabartë dhe diskriminues për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedure prokurimi, përse i përket kriterit "Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit" të DST, theksohet se: "*Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.*" Argumentuar si vijon:

- Në procedurën e prokurimit me objekt: "Blerje kompjutera desktop, Workstation, Printer AIO, Laptop Praktik" me Nr. REF-96505-05-26-2021 me Urdhër Prokurimi Nr. 133, datë 25.05.2021, me Fond Limit 1,660,000 lekë pa TVSH, me fitues OE "PC. S" ShPK në vlerën 1,620,000 lekë pa TVSH, rezulton që KVO-ja, për katalogët për mallrat (Kompjuter Desktop 1 Monitor; Kompjuter Workstation; Printer All In One; Fotokopje Color MFP) ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE "PC. S" ShPK edhe pse katalogët për mallrat objekt të kontratës, janë në **gjuhën Angleze** dhe nuk janë shoqëruar me një përkthim të noterizuar në **gjuhën shqipe**.

Në rastin konkret, veprimet e KVO-së dhe, të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, përveçse nuk sigurojnë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik duke ndikuar negativisht në mirëpërdorimin e fondeve publike, kanë shkaktuar paligjshmëri në përdorimin dhe kontraktimin e fondeve në procedurën me objekt: "Blerje kompjutera desktop, Workstation, Printer AIO, Laptop Praktik".

Si konkluzion, për sa më sipër, në lidhje me vlerësimin e ofertës me objekt: "Blerje Kompjutera Desktop, Workstation, Printer AIO, Laptop Praktik" nga KVO-ja dhe, Kryetari i Bashkisë Vlorë rezulton se, nga njëra anë **nuk ka vlerësuar drejt** si fitues OE "PC. S" ShPK në tender.

Veprimet e KVO-së bien në kundërshtim me neni 75, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar dhe, neni 92, pika 3 të LPP "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Përgjegjësia për titullarit të autoritetit kontraktor z. D. L., rrjedh nga neni 73 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik", si dhe neni 21 i ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", pika 1, pika 2 dhe 5, ku respektivisht thuhet:

-Pika 5 e nenit 73 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku citoj se: "*Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij, duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin*".

-Ligji Nr. 162/2020:

Pika 1: "Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e

parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj....

Pika 5: Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij.

Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike”.

Lidhur mbi gjetjet dhe rekomandimet është observuar mbi projekt-raportin e auditimit nga **Z. T. Z.**, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1026/29 prot; datë 03.11.2023, me anë të shkresës me nr. 11597 prot; datë 27.10.2023, në procedurën e prokurimit “Blerje Kompjuter Desktop, Workstation, Printer AIO, Laptop Praktik” është trajtuar si vijon:

1.1 Pretendimi i subjektit:

-Në arritjen e kësaj kësaj vendimarrjeje ...e kam bazuar te OE i cili ka qenë operator i vetëm në dhënien e fertës dhe kam gjykuar se duke u bazuar në nenin 80, pika 5 “Nëse anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave kanë mendime të ndryshme ose në se komisioni vendos me votim, kjo gjë duhet të dokumentohet”, sipas kësaj pike proces verbali mbahet kur anëtarët e KVO nuk kanë të njëjtin mendim. Në këtë procedurë të gjithë anëtarët kanë qenë në të njëjtin mendim vendimi, ka qenë unanim dhe nuk ka lindur nevoja e mbajtjes së procesverbalit.

- Për sa i përket komentit që bëni krahasim me objektin: "Blerje materiale elektrike për ndriçimin publik dhe të institucioneve" nuk mund të krahasohen dy procedura prokurimi të ndryshme për të arritur në konkluzionin që ju keni arritur, pasi janë dy procedura të ndryshme dhe në rrethana të ndryshme nga njëra- tjetra. Janë dy procedura prokurimi me operatorë ekonomik të ndryshëm, ku te objekti "Blerje Kompjuter Desktop, Workstation, Printer AIO, Laptop Praktik" ka marre pjesë vetëm një operator ekonomik dhe është ruajtur kriteri i ligjit nr.162 dt. 23.12.2020 i nenit 18 pika 1: "Mbrojtja e integritetit të procedurës dhe masat e përgjithshme për parandalimin e korrupsionit. 1- Prokurimi publik duhet të zhvillohet në mënyrë transparente me paanshmëri dhe pa asnjë trajtim preferencial...", ndërsa në objektin "Blerje materiale elektrike për ndriçimin publik dhe institucioneve" ka patur oferta nga më shumë se një operator, ku unë nuk kam qenë anëtar i K.V.O-së dhe nuk mund të shprehem qartësisht për rrethanat në të cilat është bërë ky vlerësim. Por ajo që më ka bindur në pavarësinë e vendimarrjes sime është edhe gjykimi që i kam bërë ligjit nr.162 dt.23.12.2020, nenit 92 pika 4, ku thekson "Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nese ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit". Ndër të tjera ky paragraf thotë: “informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”. Fatmirësisht informacionet mbi katalogët në anglisht janë përkthyer lehtësisht nga ana e K.V.O për të parë parametrat teknikë të çdo pajisjeje të dhëna nga ofertuesi dhe të kërkuar në DT. Pra janë gjykuar si devijime të vogla të cilat nuk janë thelbësore që të ishim në kushtet e pabarazisë se operatorëve, favorizimeve apo dem ekonomik.

1.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin tuaj, shprehemi se:

- Pranojmë argumentin se: proces verbali mbahet kur anëtarët e KVO nuk kanë të njëjtin mendim, por nga ana tjetër nga KVO, por edhe pse manualet nuk janë paraqitur në gjuhën Shqipe në zbatim të kriterit të vendosur nga AK, është konsideruar si devijim i vogël dhe nuk është mbajtur proces

verbal. Gjithsesi ushtrimi i këtij **diskrecioni** ligjor, nga ana e KVO-së duhej të ishte dokumentuar nëpërmjet një proces verbal, në përputhje me pikën 4 të nenit 80 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 e cila, ndër të tjera citon se: “Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbal...”.

Pranojmë faktin se ky devijim nuk ka ndryshuar thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Përsa më sipër, do të reflektohet në Raportin përfundimtar të auditimit, dhe në gjykimin e grupit të auditimit pasi kemi të bëjmë me një rast sporadik dhe jo të përsëritur, ky pretendim merret pjesërisht në konsideratë.

Situata 2: Nga auditimi i prokurimit me objekt “Pëmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara” me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës.

Tenderi me objekt: “Pëmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”, Nr. Ref. 04452-09-02-2021.		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 211, datë 02.09.2021 (Nr. prot. 12282/4, datë 02.09.2021)	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit/NjP 1. P. Th., Jurist 2. D. Ç., Inxhinierë 3. V. Z., Ekonomist	4. KVO-ja: Urdhër nr. 212, datë 02.09.2021 (Nr. prot. 12283, datë 02.09.2021) 1. Z. S., Kryetar 2. T. Z., Anëtar 3. J. Ç., Anëtar
2. Lloji i Procedurës: “E hapur e thjeshtuar” kuadër		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 4,701,180 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE “N. 1934” & “G.” ShPK me ofertë 3,454,244 lekë pa tvsh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1,246,936 lekë pa tvsh, ose 26.52 %
8. Data e hapjes së tenderit: Datë 13.09.2021 ora 10:00 Njoftimi në APP: Buletini nr. 132, datë 07.09.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit dhe i Bashkisë Vlorë.	10. Operoret Ekonomike: Pjesëmarrës në tender 5OE/BOE: -Kualifikuar 3 OE (1 BOE + 2 OE - Skualifikuar 2 OE
11. Ankimime; Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK: -----.	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: -----

u konstatua problematika si vijon:

Në dosje nuk ndodhet proces-verbali për hapjen e ofertave për procedurës elektronike të prokurimit, por referuar (Formularit të njoftimit të fituesit si dhe, Raportit përmbledhës) rezulton se anë marrë pjesë 5 (pesë) OE/BOE, konkretisht:

- **B.O.E “N. 1934” & “G.” ShPK me ofertë 3,454,244 lekë (Kulifikuar).**

- OE “B-93 II” ShPK me ofertë 3,678,712 lekë.

- OE “A.” ShPK me ofertë 3,851,451 lekë.

- OE “A.-2A. C.” ShPK me ofertë 3,851,772,25 lekë.

- OE “K.” ShPK me ofertë 3,919,723 lekë.

KVO, mbas shqyrtimit të dokumenteve të kriterëve të përgjithshme dhe ato teknike, referuar proces-verbalit, datë 13.09.2021(Sqarojë se ky proces-verbal nuk administrohet në dosjen e prokurimit, por të dhënat u morën nga Raporti përmbledhës) për vlerësimin e ofertave të OE

pjesmarrë, për prokurimin “Përmirësim i banesave ekzistues për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuar” vendosi të skualifikojë/kualifikojë, me argumentet, si vijon:

Nr	Operatori Ekonomik	NIPTI	Oferta e ofertës referuese, lekë pa TVSH	Kualifikuar/skualifikuar
1	BOE “N. 1934” & “G.”	-	3,454,244	Kualifikuar
<p><u>Vlerësimi sipas KVO:</u> BOE “N. 1934” & “G.”, me ofertën me vlerë totale prej 3,454,244 (tre milionë e katërqind e pesëdhjetë e katër mijë e dyqind e dyzetë e katër) lekë pa tvsh është identifikuar si Oferta e suksesshme., duke plotësuar kriteret e kualifikimit sipas DST.</p> <p><u>Vlerësimi sipas Grupit të auditimit:</u> Nga auditimi i dokumentacionit në SPE dhe në doje, rezulton se:</p> <p>1. Inxhinieri H. R., nuk ka paraqitur CV përkatëse.</p> <p>3. Inxhinier Mjedisi O. N. i ngarkuar të punojë në profesionin Inxhinier Mjedisi, pozicioni Drejtues Teknik sipas kontratës individualeme nr. Rep. 871 dhenr. Kol. 313, datë 06.04.2021, nuk ka paraqitur CV përkatëse.</p> <p>4. Inxhinieri M. S. i ngarkuar të punojë në profesionin Inxhinier Mekanik, pozicioni Drejtues Teknik sipas kontratës individualeme nr. Rep. 874 dhenr. Kol. 316, datë 06.04.2021, referuar zërave të punimeve të Preventivit, konstatohet se puna e tij nuk ka lidhje me natyrën dhe llojin e kontratës, veprim ky jo në përputhje me kriterin 2.3.4 dhe 2.3.4 të kapacitetit teknik.</p> <p>5. Inxhinieri Th. B. i ngarkuar të punojë në profesionin Inxhinier Elektrik, pozicioni Drejtues Teknik sipas kontratës individualeme nr. Rep. 875 dhenr. Kol. 317, datë 06.04.2021, referuar zërave të punimeve të Preventivit, konstatohet se puna e tij nuk ka lidhje me natyrën dhe llojin e kontratës, veprim ky jo në përputhje me kriterin 2.3.4 dhe 2.3.4 të kapacitetit teknik.</p> <p>6. Inxhinieri G. D. i ngarkuar të punojë në profesionin Inxhinier Gjeodet, pozicioni Drejtues Teknik sipas kontratës individuale me nr. Rep. 876 dhenr. Kol. 318, datë 06.04.2021, referuar zërave të punimeve të Preventivit, konstatohet se puna e tij nuk ka lidhje me natyrën dhe llojin e kontratës, veprim ky jo në përputhje me kriterin 2.3.4 dhe 2.3.4 të kapacitetit teknik.</p> <p>7. Shoqëria “N. 1934” ka emëruar si Drejtues Teknik të punimeve në objekt ing. Ndërtimi K. K. i cili është njëkohësisht Drejtues Teknik i shoqërisë, ndërkohë që referuar Licencës së shoqërisë “N. 1934” me nr. NZ. 1417/16, konstatohet që nuk është Drejtues Teknik dhe i përfshirë në këtë licencë.</p> <p>8. OE “G.” ka paraqitur “Listëpagesa të kontributeve të sigurimeve shoqërore” për muajt Janar, shkurt, mars, prill të vitit 2021 dhe nuk ka paraqitur listëpagesat për periudhën Maj - Korrik 2021, veprim ky në kundërshtim me kriterin 2.3.3 të Kapacitetit Teknik.</p>				
2	OE “B.-93 II” ShPK	-	3,678,712	Skualifikuar
<p><u>Vlerësimi sipas KVO:</u> Është skualifikuar, sepse në formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST, nuk përcaktohen se disponon 3 hidroizolues dhe 3 muratorë.</p> <p><u>Vlerësimi sipas Grupit të auditimit:</u> Nga auditimi i dokumentacionit në SPE dhe në doje, rezulton se është vlerësuar drejt nga KVO për skualifikimin e OE “B.-93 II” ShPK, sepse nuk plotëson kriterin teknik 2.3.5 ku nga 3 specialist ndërtimi murator, ka sjell dokumente për 2(dy) dhe asnjë nuk ka sjellë asnjë dokument për 3 (tre) specialist ndërtimi hidroizolues.</p>				
3	OE “A.” ShPK	-	3,851,451	Skualifikuar
<p><u>Vlerësimi sipas KVO:</u> Është skualifikuar, sepse Deklarata për përcaktimin e inxhinierit të zbatimit të punimeve (Inxhinier ndërtimi) në objekt, nuk e ka përcaktuar emrin e objektit që i referohet dhe për më tepër përcakton që është për qytetin e Burrelit.</p> <p><u>Vlerësimi sipas Grupit të auditimit:</u> Nga auditimi i dokumentacionit në SPE dhe në doje, rezulton se: Deklarata për përcaktimin e inxhinierit të zbatimit të punimeve (Inxhinier ndërtimi) në objekt, nuk e ka përcaktuar emrin e objektit që i referohet dhe për më tepër përcakton që është për qytetin e Burrelit.</p>				
4	OE “A.-2A. C.” ShPK	-	3,851,772.25	Kualifikuar
<p><u>Vlerësimi sipas KVO:</u> OE “A.-2A. C.” ShPK, me ofertën me vlerë totale prej 3,851,772.25 lekë pa tvsh është kualifikuar duke plotësuar kriteret e kualifikimit sipas DST.</p>				
5	OE “K.” ShPK	-	3,919,723	Kualifikuar
<p><u>Vlerësimi sipas KVO:</u></p>				

OE "K." ShPK, me ofertaën me vlerë totale prej 3,919,723 lekë pa tvsh është kualifikuar duke plotësuar kriteret e kualifikimit sipas DST
--

- Për realizimin e investimit me objekt "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara", është lidhur kontrata për punë publike me nr. 13376 prot; 30.09.2021.2021 mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë, përfaqësuar nga Kryetari z. D. L. dhe sipërmarrësit të punimeve BOE "N. 1934" & "G.", përfaqësuar nga OE "N. 1934" ShPK" me administrator z. M. S. dhe znj. J. B. (sipas prokurës së përgjithshme me datë "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara" 11.09.2021 me nr. Licence NZ.1417/16 dhe vlerë 4,145,092.8 lekë me TVSH. Afati i realizimit të kontratës është 1 (një) muaj.

Vlerësimi nga grupi i auditimit:

-Nga shqyrtimi në SPE dhe në dojen e prokurimit të dokumentacionit të paraqitur nga BOE "N. 1934" & "G.", rezulton se BOE është shpallur fitues në kushtet e mosplotësimit të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK, veprim ky në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike. Sa më sipër KVO ka vlerësuar dhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 75 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar dhe, nenit 64 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së, dhe Kryetarin e Bashkisë Vlorë.

- Nga KVO skualifikimi i OE "B-93 II" ShPK është i drejtë, sepse nuk plotëson kriterin teknik 2.3.5 ku nga 3 specialist ndërtimi murator, ka sjell dokumente për 2(dy) specialist dhe nuk ka sjellë asnjë dokument për 3 (tre) specialist ndërtimi hidroizolues.

- Nga KVO skualifikimi i OE "A." ShPK është i drejtë sepse nuk plotëson kriterin teknik 2.3.4, ku rezulton se Deklarata për përcaktimin e inxhinierit të zbatimit të punimeve (Inxhinier ndërtimi) në objekt, nuk e ka përcaktuar emrin e objektit që i referohet dhe për më tepër përcakton që është për qytetin e Burrelit.

Përgjegjësia për titullarit të autoritetit kontraktor z. D. L., rrjedh nga neni 73 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik", si dhe neni 21 i ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", pika 1, pika 2 dhe 5, ku respektivisht thuhet:

-Pika 5 e nenit 73 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku citoj se: "Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij, duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

-Ligji Nr. 162/2020:

Pika 1: "Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj....

Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pika 2. Autoriteti ose enti kontraktor administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit.

Pika 5: Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij.

Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike”.

Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar; ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Vlerësim jo i drejtë në kualifikimin e OE nga KVO dhe Titullari i AK, duke mos respektuar kërkesat e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar; ligjitNr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Shkaku: Kryerja e procedurave të prokurimit pa u respektuar rregullat e procedurave të prokurimit publik, në procesin e vlerësimit të OE, duke mos respektuar kërkesat e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar; ligjitNr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Bashkia Vlorë, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publike.

Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:

(*Situata 1, për prokurimin me objekt “Blerje Kompjutera Desktop, Workstation, Printer AIO, Laptop Praktik”*):

1. **z. D. L.**, në cilësinë e Titullarit të Bashkisë Vlorë
2. **z. T. Z.; z. M. M.; z. V. Z.**, në cilësinë e anëtarëve të KVO-së

(*Situata 2, për prokurimin me objekt “Pëmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”*):

1. **z. D. L.**, në cilësinë e Titullarit të Bashkisë Vlorë
2. **z. Z. S.; z. T. Z.; z. J. Ç.**, në cilësinë e anëtarëve të KVO-së

Lidhur mbi gjetjet dhe rekomandimet është observuar mbi projekt-raportin e auditimit nga z. T. Z., me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1026/29 prot; datë 03.11.2023, me anë të shkresës me nr. 11597 prot; datë 27.10.2023, në procedurën e prokurimit “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara” është trajtuar si vijon:

1.1 Pretendimi i subjektit:

Komentet e mia duke filluar nga drejtuesi teknike i cili nuk është në licencën e subjektit "N. 1934", K.V.O-ja ka gjykuar jo mbi kontratën që ka me inxhinierin K. K., por është bazuar me drejtuesin teknik që ka në licensë me kategorinë përkatëse të punimeve që do kryente Bashkia.

Për inxhinierët të cilët nuk është paragitur CV-ja, nga K.V.O-ja është gjykuar duke u bazuar në ligjin nr.162. datë 23.12.2020, neni 87 pika 1: "**Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme**". Dhe pika 4: "Kriteret për shpalljen e kontratës fituesenuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit. "Duke u nisur nga sa më sipër ne si anetarë të K.V.O-së nuk dyshuam te ky operator, **pasi CV-it**

e inxhinierëve përkatës sipas gjykimit tonë nuk përbëjnë kusht skualifikimi duke ju referuar ligjin nr.162. dt.23.12.2020 neni 92, pika 4 i cili thekson:"Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet etenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit", ku ky informacion saktësohet te licenca që ka subjekti për këta drejtues. Subjekti ka të gjitha pikat e licensës të cilat nevojiten për këtë objekt të prokuruar. Gjithashtu gjykimi i K.V.O-së është bazuar edhe në nenin 87, pika I, e këtij ligji, ku operatori ekonomik ka dhënë ofertën më të ulët me vlerë **1,246,936** lekë pa TVSH nga fondi limit dhe 397,528 lekë nga subjekti i klasifikuar i dyti. Për këto komente dhe për këto sqarime ligjore i kërkoj grupit të auditimit ta rivlerësoj dhe një herë gjetjen e bërë për këto dy objekte, duke u nisur nga argumentat dhe shpjegimet e mësipërme.

1.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin tuaj, shprehemi se:

- Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme, por gjithmonë duke plotësuar kriteret e vendosura në DT, fakti që OE B.O.E “N. 1934” & “G.” ShPK. Fakti që ky OE është shpallur fitues duke mos plotësuar të gjitha kriteret nga KVO rezulton të jetë bërë vlerësim i gabuar dhe jo në përputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimit.

- Në përmban devijime të vogla gjykimin e grupit të auditimit, CV-të e inxhinierëve dhe nuk përbën devijim të vogël. Edhe nëse do të ishte kështu (Sipas KVO-së) ushtrimi i këtij **diskrecioni** ligjor, nga ana e KVO-së duhej të ishte dokumentuar nëpërmjet një proces verbal, në përputhje me pikën 4 të nenit 80 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 e cila, ndër të tjera citon se: “Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbal...”.

-Sqarojmë se OE i dyti nuk ka vlerën **397,528** lekë siç jeni shprehur. Në këtë tender kanë marrë pjesë 5 (pesë) OE dhe vlerësimi nga KVO është, si vijon:

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta e ofertës referuese, lekë pa TVSH	
1	B.O.E “N. 1934” & “G.” ShPK	3,454,244	kualifikuar
2	OE “B-93 II” ShPK	3,678,712	skualifikuar
3	OE “A.” ShPK	3,851,451	skualifikuar
4	OE “A.-2A. C.” ShPK	3,851,772.25	kualifikuar
5	OE “K.” ShPK	3,919,723	kualifikuar

Nga paraqitja në tabelë duket qartë se OE i dyti në renditje është OE “A.-2A. C.” ShPK në vlerën 3,851,772.25 lekë pa TVSH, gjithashtu sqarojmë se operatori ekonomik i kualifikuar dhe i shpallur fitues ka dhënë ofertën me vlerë 3,454,122 lekë pa TVSH dhe ofertën ekonomike me vlerë **1,246,936** lekë pa TVSH. Përsa më sipër, ky pretendim **nuk merret** në konsideratë.

2. Tenderat me objekte: “Blerje Komputera Desktop, Workstation, Printer AIO, Laptop Praktik”, “Ndërhyrje riparimi në çerdhe, kopshte dhe shkolla të Bashkisë Vlorë”, “Pëmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”, “Strukturë me pilota për

përforcim skarpiti pas Godinë së Bashkisë Vlorë” dhe, “Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë”.

Në vijim pasqyrojmë situatat dhe Rekomandimet përkatëse si më poshtë:

Titulli i Gjetjes: *Në zbatim të programit të auditimit u audituan procedurat e prokurimit publik ku u konstatua se nuk janë respektuar rregullat e procedurave të prokurimit publik në hartimin e kriterave teknike në DST, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar dhe, LPP, i ndryshuar.*

Situata 1: Nga auditimi i prokurimit me objekt “**Blerje Kompjuterë Desktop, Workstation, Printer AIO, Laptop Praktik**” me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

Prokurimi me objekt: “ Blerje Kompjuterë Desktop, Workstation, Printer AIO, Laptop Praktik ”, Nr. Ref. 96505-05-26-2021.		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 133, datë 25.05.2021 (Nr. prot. 8356, datë 25.05.2021)	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit/NjP 1. P. Th., Jurist 2. P. M. Specialist IT 3. J. Ç., inxhinier	4. KVO-ja: Urdhër nr. 134, datë 25.05.2021 (Nr. prot. 835, datë 25.05.2021) 1. T. Z., Kryetar 1. M. M., Anëtar 2. V. Z., Ekonomist
2. Lloji i Procedurës: “E hapur e thjeshtuar”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 1,660,000 lekë.	6. Oferta fituese: OE “PC. S” ShPK me ofertë 1,620,000 lekë pa tvsh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 40,000 lekë pa tvsh, ose 2.40 %
8. Data e hapjes së tenderit: Datë 07.06.2021 ora 10:00	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Vlorë.	10. Operatoret Ekonomike: Pjesëmarrës në tender 1 OE: -Kualifikuar 1 OE - Skualifikuar -- OE
11. Ankimime; Po	12. Përgjigje Ankesës nga AK: Po	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: Po

u konstatua problematika si vijon:

NjP nëpërmjet procesverbalin me nr. 8356/2 prot; darë 25.05.2021, ka përcaktuar Kriteret e pranimit/kualifikimit. Njoftimi në APP është bërë në Buletinin nr. 83, datë 31.05.2021.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua si vijon:

AK lidhur me kriterin **2.3 “Për kapacitetin teknik”** pika 2, ka kërkuar që OE duhet të jetë i certifikuar sipas:

- ISO 9001 - 2015 ose ekuivalente të vlefshëm në fushën e menaxhimit të cilësisë, objekti i së cilës të kete lidhje me objektin e prokurimit.
- **ISO 27001: 2013** ose ekuivalente të vlefshëm në fushën e menaxhimit të sigurisë së informacionit.

Gjykimi i grupit të auditimit:

Në gjykimin e grupit të auditimit, kërkesa për paraqitjen e certifikatës “ISO 27001:2013 ose ekuivalent mbi “Menaxhim i sigurisë së Informacionit”, lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim” nuk lidhet ngushtë me objektin e prokurimit, me qëllimin e tij e aq më tepër me, sigurimin e cilësisë së mallrave. Ky kriter nuk përmbush qëllimet e përcaktuara Ligjin e Prokurimit Publik (LPP), ku parashikohet që Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

Nga përshkrimi që ka certifikata e ISO 27001:2013, theksohet se: “Vlefshmëria e certifikatës në fjalë është rrjedhim i ekzekutimit të rregullt të auditeve të kontrollit që kanë për qëllim të verifikojnë qëndrueshmërinë e kushteve të aplikuara nga sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit”.

Dokumentet e tenderit të hartuara (Kriteret e kualifikimit dhe të vlerësimit) të hartuara nga **Njësia e Prokurimit** dhe të miratuara Kryetari i Bashkisë Vlorë **z. D. L.**, nuk është argumentuar, veprim ky, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 78, pika 2 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “...Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen teknikisht dhe ligjërish dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...”.

Mendojmë se kjo certifikatë nuk është e nevojshme, pasi nuk lidhet ngushtë me objektin e prokurimit.

-Dokumentet e tenderit (Kriteret e kualifikimit dhe të vlerësimit) të hartuara nga Njësia e Prokurimit dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë Bashkisë Vlorë, në 1 (një) rastë NjP nuk ka të argumentuar vendosjen e kriterit për kualifikim, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **neni 78, pika 2** “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “... Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen teknikisht dhe ligjërish dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...”. **Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit dhe Kryetari i Bashkisë Vlorë.**

Situata 2: Nga auditimi i prokurimit me objekt “**Ndërhyrje riparimi në çerdhe, kopshte dhe shkolla të Bashkisë Vlorë**” me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës.

Prokurimi me objekt: “ Ndërhyrje riparimi në çerdhe, kopshte dhe shkolla të Bashkisë Vlorë ”, Nr. Ref. 08064-10-13-2021.		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 253, datë 12.10.2021 (Nr. prot. 13832, datë 12.10.2021)	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit/NjP 1. P. Th., Jurist 2. D. Ç., Inxhinier 3. J. Ç., inxhinier	4. KVO-ja: Urdhër nr. 254, datë 12.10.2021 (Nr. prot. 13833, datë 12.10.2021) 1. Z. S., Kryetar 2. T. Z., Anëtar 3. V. Z., Ekonomist
2. Lloji i Procedurës: “E hapur e thjeshtuar” kuadër		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 3,332,329 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE “L.” & “J.” ShPK me ofertë 2,281,625 lekë pa tvsh. Kontratë nr. 15117/3 dt. 22.11.2021 lekë me vlerë 2,737,950 lekë me TVSH;	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1,050,704 lekë pa tvsh, ose 31.50 %
8. Data e hapjes së tenderit: Datë 25.10.2021 ora 10:00 Njoftimi në APP: Buletini nr. 132, datë 07.09.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Vlorë.	10. Operoret Ekonomike: Pjesëmarrës në tender 5 OE/BOE: -Kualifikuar 4 OE (1 BOE + 3 OE - Skualifikuar 1 OE
11. Ankimime; Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK: -----.	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: -----

u konstatuan problematikat si vijon:

Mbi vendosjaene kriterëve.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të vërtetojë/disponojë që ka të punësuar mesatarisht 20 përsone, përfshirë stafin teknik (drejtues) për periudhën Korrik - Shtator 2021. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Në rast se shpallet fitues, për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën Maj - Korrik 2021.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Maj - Korrik 2021, sipas formatit E-Sig 025/a.

Në gjykimin e grupit të auditimit:

Përsa i përket numrit 20 të punonjësve, nga NjP, është bërë argumentimi si vijon:

Në dosjen e tenderit nuk ka dokument, që të vërtetojë konkretisht argumentimin teknik për numrin 20 të punonjësve. Në lidhje me këtë kriter, konstatohet se NjP ka kërkuar një numër të pa-argumentuar teknikisht punonjësish duke mos u bazuar në asnjë analizë konkrete e cila do të mund të përcaktojë numrin minimal të punonjësve të domosdoshëm, për realizimin e punimeve objekt kontrate, pretenduar sipas: pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Në rastin konkret, NjP i ngritur për hartimin e kriterëve, duke kërkuar një numër të pabazuar dhe të pa-argumentuar punonjësish, vendosja e këtij kriteri eventualisht sjell kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, me një numër më të ulët punonjësish se ai i vendosur në këtë kriter. Ky kriter me ndjeshmëri në konkurrencën e OE garues, është i pa-argumentuar nga grupi i punës, çka bie në kundërshtim me LPP.

Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 2, të nenit 78 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku theksohet: “...Në çdo rast hartimi i tyre (kriteret + dokumentet e tenderit) duhet të argumentohen teknikisht dhe ligjrisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur.... ”. Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit.

2.3.7 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, (pronësi ose me qera) që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca 8).

Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës dhe transportues deri 3.5 ton	copë 2 (dy)	Në pronësi ose me qera
Elektroorgano	copë 1 (një)	Në pronësi ose me qera
Vinç kullë	copë 1 (një)	Në pronësi ose me qera
Skele inventari	100 m ²	Në pronësi ose me qera
Pompë suvatimi	copë 1 (një)	Në pronësi ose me qera

-Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), policen e sigurimit, *çertifikaten e kontrollit teknik*, taksat vjetore të mjetit, si dhe lejen e transportit nga bashkia për vetë ose të treta.

-Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore të blerjes.

-Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës së makinerive.

Në gjykimin e grupit të auditimit:

Nuk janë argumentuar mjetet, paisjet bazuar në VKM nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" dhe VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre". Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit.

-Në lidhje me konstatimin se në preventivin e punimeve, konkretisht për zërat nr. 2.501 është përdorur termi "F.V WC allafranga **importi**", nr. 2.504 "WC allafranga **importi**" është hatuar bazuar VKM Nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2019, gjykojmë se dyhet të ishte realizuar me analizë çmimi bazuar në VKM nr. 514, datë 15.8.2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit" për shmangur problematikën mbi përcaktimin e "**Markës**" apo "**Origjinës**" së mallit. Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 36, pika 4, të LPP ku parashikohet se: "Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet i ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë **markë** tregtare, patentë, tipi ose **origjinë** apo prodhim specifik...". **Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit.**

Si konkluzion mund të themi:

Dokumentet e tenderit (Kriteret e kualifikimit dhe të vlerësimit) të hartuara nga Njësia e Prokurimit dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë, në 2 (dy) raste NjP nuk ka të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", **neni 78, pika 2** "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "...Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të **argumentohen teknikisht dhe ligjërisht** dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre..." si dhe specifikim teknike për zërat nr. 2.501 është përdorur termi "F.V WC allafranga importi", nr. 2.504 "WC allafranga importi" është hatuar bazuar VKM Nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve. **Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit dhe Kryetari i Bashkisë z. D. L.**

Lidhur me gjetjet dhe rekomandimet sa më sipër trajtuar, nuk ka pasur observacione.

Situata 3: Nga prokurimi me objekt "**Pëmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara**" me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

Prokurimi me objekt: “Pëmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”, Nr. Ref. 04452-09-02-2021.		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 211, datë 02.09.2021 (Nr. prot. 12282/4, datë 02.09.2021)	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit/NjP 1. P. Th., Jurist 2. D. Ç., Inxhinierë 3. V. Z., Ekonomist	4. KVO-ja: Urdhër nr. 212, datë 02.09.2021 (Nr. prot. 12283, datë 02.09.2021) 1. Z. S., Kryetar 2. T. Z., Anëtar 3. J. Ç., Anëtar
2. Lloji i Procedurës: “E hapur e thjeshtuar” kuadër		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 4,701,180 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE “N. 1934” & “G.” ShPK me ofertë 3,454,244 lekë pa tvsh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1,246,936 lekë pa tvsh, ose 26.52 %
8. Data e hapjes së tenderit: Datë 13.09.2021 ora 10:00 Njoftimi në APP: Buletini nr. 132, datë 07.09.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit dhe i Bashkisë Vlorë.	10. Operatoret Ekonomike: Pjesëmarrës në tender 5OE/BOE: -Kualifikuar 3 OE (1 BOE + 2 OE) - Skualifikuar 2 OE
11. Ankimime; Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK: -----.	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: -----

u konstatuan problematikat si vijon:

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

NjP nëpërmjet procesverbalin me nr. 12282/1 prot; darë 02.09.2021, ka përcaktuar Kriteret e pranimit/kualifikimit.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se:

Mbi përcaktimin e kriterëve teknike nga NjP.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga MIE, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme: (NP – 3 A Rikonstruksion dhe Mirëmbajtje Godinash Civile e Industriale, Veshje Fasada; NS – 1 A (Punime për Prishjen e Ndërtimeve).

Në gjykimin e grupit të auditimit: Vendorsja e kriterit 2.3.2 për licencën profesionale të kategorisë (N.S –1 Punime për prishjen e ndërtimeve) është kriter i tepërt dhe i pa nevojshëm, sepse nga auditimi i preventivit, nuk janë parashikuar punime çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve. Në rastin konkret në preventiv janë parashikuar 618 m² prishje shtresash të tarracës ekzistuese, nuk ka lidhje me “prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave”. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM Nr.42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar; me nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”; nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të vërtetojë/disponojë që ka të punësuar mesatarisht 30 persona, përfshirë stafin teknik (drejtues)

për periudhën Maj - Korrik 2021. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Në rast se shpallet fitues, për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën Maj - Korrik 2021.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Maj - Korrik 2021, sipas formatit E-Sig 025/a.

Në gjykimin e grupit të auditimit:

Përsa i përket numrit 30 të punonjësve, nga NjP, është bërë argumentimi si vijon:

Numri është vendosur, bazuar në sasi të e çdo zëri punimesh në preventiv dhe në natyrën e objektit të kësaj kontrate, pasi nga zbërthimi i zërave të preventivit dhe afati i parashikuar i punimeve janë gjithsej 742 ditë pune, për të cilat nevojiten 34 punonjës, por është vendosur një numër më i vogël prej 30 punonjësish.

Në dosjen e tenderit nuk ka dokument, që të vërtetojë konkretisht argumentimin teknik për numrin 30 të punonjësve. Në lidhje me këtë kriter, konstatohet se NjP ka kërkuar një numër të pa-argumentuar teknikisht punonjësish duke mos u bazuar në asnjë analizë konkrete e cila do të mund të përcaktojë numrin minimal të punonjësve të domosdoshëm, për realizimin e punimeve objekt kontrate, pretenduar sipas: pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Në rastin konkret, NjP i ngritur për hartimin e kriterëve, duke kërkuar një numër të pabazuar dhe të pa-argumentuar punonjësish, vendosja e këtij kriteri eventualisht sjell kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, me një numër më të ulët punonjësish se ai i vendosur në këtë kriter. Ky kriter me ndjeshmëri në konkurrencën e OE garues, është i pa-argumentuar nga grupi i punës, çka bie në kundërshtim me LPP.

*Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 2, të nenit 78 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku theksohet: “...Në çdo rast hartimi i tyre (kriteret + dokumentet e tenderit) duhet të argumentohen teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur.... ”. Për veprimet dhe mosveprimet **ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit.***

2.3.8 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, (pronësi ose me qera) që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca 8)

Automjet ATP me kapacitet mbajtës dhe transportues deri në 3,5 ton	copë 1 (një)	Në pronësi ose me qera
Vinç kullë	cope 1(një)	Në pronësi ose me qera
Skelë inventari	500 m ²	Në pronësi ose me qera
Elektroorgano	cope 1 (nje)	Në pronësi ose me qera

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), policen e sigurimit, *çertifikaten e kontrollit teknik*, taksat vjetore të mjetit, si dhe lejen e transportit nga bashkia për vetë ose të tjerë.

Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jepen aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Në gjykimin e grupit të auditimit:

*Nuk janë argumentuar mjetet, paisjet bazuar në VKM nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" dhe VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre". Për veprimet dhe mosveprimet **ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit.***

Dokumentet e tenderit (Kriteret e kualifikimit dhe të vlerësimit) të hartuara nga Njësia e Prokurimit dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë, në 3 (tre) raste mbi hartimin e kriterëve nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim, veprim ky në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **neni 78, pika 2** "hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" ku citohet se: "...Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen teknikisht dhe ligjërishit dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...".

Situata 4: Nga prokurimi me objekt "Strukturë me pilota për përforsim skarpati pas Godinës së Bashkisë" me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

Prokurimi me objekt: "Strukturë me pilota për përforsim skarpati pas Godinës së Bashkisë", Nr. Ref. 27192-04-29-2022.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 4752, datë 29.04.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 4753, datë 29.04.2022
2. Lloji i Procedurës: "E hapur e thjeshtuar"	1. P. Th., (Personi përgjegjës) 2. J. Ç., Dr. i Urbanistikës 3. D. Ç.	1. Z. S., kryetar 2. D. Z., anëtar 3. V. Z., anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSh) 8,501,401 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE "I." ShPK me ofertë 8,395,118 lekë pa tvsh, Afati 2 muaj	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 106,283 lekë ose 1.2 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 16.05.2022 ora 10.00 Shtyhet me datë 23.05.2022 ora 10:00	9. Burimi Financimit Buxhet i Bashkisë Vlorë i vitit 2022	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE në shumën 26,666,843 lekë b) Skualifikuar 1 OE c) Kualifikuar 1 OE

u konstatua problematikat si vijon:

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit me nr. 4752/1prot; datë 29.04.2022. Me shkresën nr. 5408 prot; datë 16.05.2022 është kryer ndryshimi i DT, për efekt të kryerjes të disa saktësimeve të konstatuara nga grupi i monitorimit të APP dhe dërguar në datë 06.05.2022 dhe për pasojë afati i hapjes së ofertave është caktuar në datën 23.05.2022 ora 10:00.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura nga AK Bashkia Vlorë, u konstatua se:

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të vërtetojë/disponojë që ka të punësuar mesatarisht **20** persona, përfshirë stafin teknik (drejtues) për periudhën Mars 2022...

Në gjykimin e grupit të auditimit:

Në dosjen e tenderit nuk ka dokument, që të vërtetojë konkretisht argumentimin teknik për numrin minimal prej 20 punonjësve si dhe mënyrën e llogaritjes. Në lidhje me këtë kriter, konstatohet se NjP ka kërkuar një numër të pa-argumentuar teknikisht punonjësish duke mos u bazuar në asnjë analizë konkrete e cila do të mund të përcaktojë numrin minimal të punonjësve të domosdoshëm, për realizimin e punimeve objekt kontrate, pretenduar sipas: pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Në rastin konkret, NjP i ngritur për hartimin e kriterëve, duke kërkuar një numër të pabazuar dhe të pa-argumentuar punonjësish, vendosja e këtij kriteri eventualisht sjell kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, me një numër më të ulët punonjësish se ai i vendosur në këtë kriter. Ky kriter me ndjeshmëri në konkurrencën e OE garues, është i pa-argumentuar nga NjP, çka bie në kundërshtim me LPP.

Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 2, të nenit 78 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku theksohet: “...Në çdo rast hartimi i tyre (kriteret + dokumentet e tenderit) duhet të argumentohen teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur.... ”. Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion OE, (pronësi ose me qera) që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes dhe transportues mbi 3,5 ton deri ne 18 ton	copë 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
Eskavatore me goma	copë 1 (nje)	Në pronesi ose me qera
Sonde për shpime	copë 1 (nje)	Në pronesi ose me qera
Kallepë inventari	300 m ²	Në pronesi ose me qera
Skele inventari	100 m ²	Në pronesi ose me qera
Rul me vibrim	copë 1 (nje)	Në pronesi ose me qera

Në gjykimin e grupit të auditimit:

Nuk janë argumentuar mjetet, paisjet bazuar në VKM nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” dhe VKM nr. 629, date 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike te çmimeve te punimeve te ndërtimit dhe te analizave teknike te tyre" të ndryshuar.

Sa më sipër, ngarkon me përgjegjësi Njësia e Prokurimit.

Dokumentet e tenderit (Kriteret e kualifikimit dhe të vlerësimit) të hartuara nga Njësia e Prokurimit dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, në 2 (dy) raste NjP nuk ka të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **neni 78, pika 2** “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “...Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen teknikisht dhe ligjërish dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...”. **Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit dhe Kryetari i Bashkisë z. D. L.**

Situata 5: Nga prokurimi me objekt “**Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë**” me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

Prokurimi me objekt: “ Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë ”, Nr. Ref. 35936-07-08-2022.		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 190, datë 04.07.2022 (Nr. prot. 7624, datë 04.07.2022)	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit/NjP 1. P. Th., Jurist 2. J. Ç., Inxhinierë 3. D. Ç., Specialiste e Infrastrukturës	4. KVO-ja: Urdhër nr. 191, datë 04.07.2022 (Nr. prot. 11114, datë 04.10.2022) 1. Z. S., Kryetar 2. D. Z., Anëtar 3. V. Z., Anëtar
2. Lloji i Procedurës: “E hapur Pune”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 30,830,000 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE “Sh. 07” ShPK me ofertë 18,000,000 lekë pa tvsh. Kontratë nr. 1857 dt. 14.02.2023 me vlerë 21,600,000 lekë me TVSH dhe afat 2 (dy) muaj.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 12,830,000 lekë pa tvsh, ose 41.61 %
8. Data e hapjes së tenderit: Datë 11.08.2022 ora 10:00	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Vlorë.	10. Operoret Ekonomike: Pjesëmarrës në tender 6 OE: -Kualifikuar 6OE - Skualifikuar - OE
11. Ankimime; Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK: -----.	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: -----

u konstatuan problematikat si vijon:

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

NjP nëpërmjet procesverbalin me nr. 7624/1 prot; darë 04.07.2022, ka përcaktuar Kriteret e pranim/kualifikimit.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura nga AK Bashkia Vlorë, u konstatua se:

<p>Nga zbatimi i kriterëve të kualifikimit u konstatua se:</p> <p>2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë një numër mesatar prej jo më pak se 15 punonjës të siguruar për periudhën Maj-Qershor (duke përfshirë edhe stafin teknik të sipërcituar). Për ta vërtetuar këtë duhet të paraqesë:</p> <p>-Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën qershor-gusht 2022.</p> <p>-Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislati në fuqi për periudhën qershor-gusht 2022, sipas formatit E-Sig 025/a.</p> <p><u>Në gjykimin e grupit të auditimit:</u></p>

Në dosjen e tenderit nuk ka dokument, që të vërtetojë konkretisht argumentimin teknik për numrin minimal prej 15 punonjësve si dhe mënyrën e llogaritjes. Në lidhje me këtë kriter, konstatohet se NjP ka kërkuar një numër të pa-argumentuar teknikisht punonjësish duke mos u bazuar në asnjë analizë konkrete e cila do të mund të përcaktojë numrin minimal të punonjësve të domosdoshëm, për realizimin e punimeve objekt kontrate, pretenduar sipas: pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Në rastin konkret, NjP i ngritur për hartimin e kriterëve, duke kërkuar një numër të pabazuar dhe të pa-argumentuar punonjësish, vendosja e këtij kriteri eventualisht sjell kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, me një numër më të ulët punonjësish se ai i vendosur në këtë kriter. Ky kriter me ndjeshmëri në konkurrencën e OE garues, është i pa-argumentuar nga NjP, çka bie në kundërshtim me LPP.

Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 2, të nenit 78 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku theksohet: “...Në çdo rast hartimi i tyre (kriteret + dokumentet e tenderit) duhet të argumentohen teknikisht dhe ligjrisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur... ”. Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit.

2.3.10 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion OE, (pronësi ose me qera) që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes dhe transportues deri ne 18 ton	copë 4 (katër)	Në pronesi ose me qera
Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes dhe transportues mbi 18 ton	copë 2 (dy)	Në pronesi ose me qera
Grejder	copë 1 (një)	Në pronesi ose me qera
Rrul me vibrim	copë 1 (një)	Në pronesi ose me qera
Rrul me kompresor	copë 1 (një)	Në pronesi ose me qera
Autobitumatrice	copë 1 (një)	Në pronesi ose me qera
Asfaltoshtruese	copë 1 (një)	Në pronesi ose me qera
Eskavator me goma	copë 1 (një)	Në pronesi ose me qera
Vibrator thellësie	copë 2 (dy)	Në pronesi ose me qera
Betoniere	copë 2 (dy)	Në pronesi ose me qera
Elektrosaldarriçe	copë 1 (një)	Në pronesi ose me qera
Gazogjen	copë 1 (një)	Në pronesi ose me qera
Pajisje topografike GPS	copë 1 (një)	Në pronesi ose me qera
Fabrikë asfaltbetoni	copë 1 (një)	Në pronesi ose me qera
Autobot uji	copë 1 (një)	Në pronesi ose me qera

Në gjykimin e grupit të auditimit:

Nuk janë argumentuar mjetet, paisjet bazuar në VKM nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” dhe VKM nr. 629, date 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike te çmimeve te punimeve te ndërtimit dhe te analizave teknike te tyre" të ndryshuar.

P.SH: Kërkesa në kriterin 2.3.10 nga Njësia e Prokurimit për 2(betonjere) është kërkesë e tepër, sepse referuar preventivit të punimeve për zërin “3.244/1 Struktura të holla monolite betoni C20/25 Kunetat” në seksionin II. Punime në trupin e rrugës dhe në seksionin III. Punime të ndryshme, konstatohet ka volum të vogël betoni, prandaj në gjykimin e audituesit, nga AK

kërkesa duhej të ishte për 1(një) betoniere dhe jo për 2(dy) betoniere. Gjithashtu kërkesa nga AK për “Elektrosaldatriçe dhe Gazogjen” është e tepërt, sepse po ti referohemi zërit 2.182 në seksionin III. Punime të ndryshme janë pasqyruar si nën zë pune si vijon dhe është detyrë e Operatorit ekonomik zbatimi i këtij zëri.

Zëri 2.182 (VKM nr. 629)	F V konstruksione metalike te thjeshta
	Sp + p
	Sigurime shoqerore 16.7%
	Transport
	Elektrosaldatriçe
	Gazogjen
	Autovinç
	Vinç ekskavator
	Elektrotrapano
	Konstruksiom i gatshem
	Elektroda
	Karbit
	Oksigjen
	Slele inventari

Sa më sipër, ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit.

Dokumentet e tenderit (Kriteret e kualifikimit dhe të vlerësimit) të hartuara nga Njësia e Prokurimit dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, në 2 (dy) raste NjP nuk ka të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 78, pika 2 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “...Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen **teknikisht dhe ligjërish** dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...”. **Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit dhe Kryetari i Bashkisë z. D. L.**

Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar; Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Hartimi i Dokumenteve Standarde të tenderit, kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kriteret teknike nga DST duke mos respektuar kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimet dhe **Rekomandimet** e APP kufizojnë pjesëmarrjen e ofertuesve në procedurat e prokurimeve dhe konkurrencën e lirë.

Shkaku: Kryerja e procedurave të prokurimit pa u respektuar rregullat e procedurave të prokurimit publik, hartimit të DST, të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, kriterëve teknike duke mos respektuar kërkesat e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar; ligjitNr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë, Njësia e Prokurimit, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e kriterëve në përputhje me procedurën e zhvilluar, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikën e zhvillimit të procedurave me një OE, me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet.

Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:

-(**Situata 1**, për prokurimin me objekt “*Blerje Kompjutera Desktop, Workstation, Printer AIO, Laptop Praktik*”):

1. **z. D. L.**, në cilësinë e Titullarit të Bashkisë Vlorë.
2. **z. P. M. dhe z. J. Ç.**, në cilësinë e anëtarëve të NjP, në cilësinë e anëtarëve të NjP.

-(**Situata 2**, për prokurimin me objekt “*Ndërhyrje riparimi në çerdhe, kopshte dhe shkolla të Bashkisë Vlorë*”):

1. **z. D. L.**, në cilësinë e Titullarit të Bashkisë Vlorë.
2. **znj. D. Ç.; z. V. Z.**, në cilësinë e anëtarëve të NjP.

-(**Situata 3**, për prokurimin me objekt “*Pëmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara*”):

1. **z. D. L.**, në cilësinë e Titullarit të Bashkisë Vlorë.
2. **znj. D. Ç.; z. V. Z.**, në cilësinë e anëtarëve të NjP.

-(**Situata 4**, për prokurimin me objekt “*Strukturë me pilota për përforsim skarpati pas Godinë së Bashkisë Vlorë*”):

1. **z. D. L.**, në cilësinë e Titullarit të Bashkisë Vlorë.
2. **znj. D. Ç.; z. J. Ç.**, në cilësinë e anëtarëve të NjP.

-(**Situata 5**, për prokurimin me objekt “*Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë*”):

1. **z. D. L.**, në cilësinë e Titullarit të Bashkisë Vlorë.
2. **znj. D. Ç.; z. J. Ç.**, në cilësinë e anëtarëve të NjP.

Lidhur mbi gjetjet dhe rekomantimet e trajtuara sa më sipër, nuk janë paraqitur observacione.

3. Tenderat me objekte: “*Ndërhyrje riparimi në çerdhe, kopshte dhe shkolla të Bashkisë Vlorë*”, “*Shërbimi i mirëmbajtjes të varrezave publike dhe të dëshmorëve të Bashkisë Vlorë*”, “*Pëmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara*”, “*Strukturë me pilota për përforsim skarpati pas Godinë së Bashkisë Vlorë*”, “*Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë*”, “*Furnizim vendosje pajisje për ndriçimin rrugor*”, “*Rikonstruksion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë*”.

Në vijim pasqyrojmë situatat dhe Rekomandimet përkatëse si më poshtë:

Titulli i Gjetjes: *Hartimi i Projekteve të Zbatimit nga AK dhe DPKZHT, pa licencë përkatëse profesionale, në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar.*

Situata 1: Nga auditimi i prokurimit me objekt “*Ndërhyrje riparimi në çerdhe, kopshte dhe shkolla të Bashkisë Vlorë*”, me të dhëna të përgjithshme sipas tabelës,

Prokurimime objekt: “ <i>Ndërhyrje riparimi në çerdhe, kopshte dhe shkolla të Bashkisë Vlorë</i> ”, Nr. Ref. 08064-10-13-2021.		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 253, datë 12.10.2021 (Nr. prot. 13832, datë 12.10.2021)	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit/NjP 1. P. Th., Jurist 2. D. Ç., Inxhinier 3. J. Ç., Inxhinier	4. KVO-ja: Urdhër nr. 254, datë 12.10.2021 (Nr. prot. 13833, datë 12.10.2021) 1. Z. S., Kryetar 2. T. Z., Anëtar 3. V. Z., Ekonomist
2. Lloji i Procedurës: “E hapur e thjeshtuar” kuadër		

5. Fondi Limit (pa TVSh) 3,332,329 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE "L." & "J." ShPK me ofertë 2,281,625 lekë pa tvsh. Kontratë nr. 15117/3 dt. 22.11.2021 me vlerë 2,737,950 lekë me TVSH;	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1,050,704 lekë pa tvsh, ose 31.50 %
8. Data e hapjes së tenderit: Datë 25.10.2021 ora 10:00 Njoftimi në APP: Buletini nr. 132, datë 07.09.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Vlorë.	10. Operoret Ekonomike: Pjesëmarrës në tender 5 OE/BOE: -Kualifikuar 4 OE (1 BOE + 3 OE - Skualifikuar 1 OE
11. Ankimime; Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK: -----.	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: -----

u konstatua problematika si vijon:

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike; projektit të zbatimit:

-Projekti i zbatimit, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar në vitin 2021 nga ing. D. Ç., specialiste në Drejtorinë e Përgjithshme Publike, Strehimit dhe Transportit, Bashkia Vlorë.

- Specifikimet teknike dhe llogaritja e FL për tenderin me objekt: "Ndërhyrje riparimi në çerdhe, kopshte dhe shkolla të Bashkisë Vlorë" janë hartuar nga ing. D. Ç. dhe ing. hidro. D. M., të cilët nuk disponojnë licensat profesionale në zbatim.

Nga kontrolli i bërë në dokumentet e administruara në dosje dhe verifikimi në zyrat e Bashkisë, rezulton se grupi i punës për hartimin e projekt të zbatimit, nuk është i pajisur me licencën e projektimit. Ky veprim, është në kundërshtim me neni 5 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, sipas të cilit "*Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse. Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II, të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit*". Përsa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Autoriteti Kontraktor.

Situata 2: Nga auditimi i prokurimit me objekt "Shërbimi i mirëmbajtjes të varrezave publike dhe të dëshmorëve të Bashkisë Vlorë", me të dhëna të përgjithshme sipas tabelës:

Prokurimime objekt: " Shërbimi i mirëmbajtjes të varrezave publike dhe të dëshmorëve të Bashkisë Vlorë ", Nr. Ref. 01135-07-16-2021.		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 181, datë 16.07.2021 (Nr. prot. 10752, datë 16.07.2021)	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit/NjP 1.P. Th., Jurist 2. E. Xh., Mbikëqyrëse e shërbimit 3. J. Ç., Inxhinier	4. KVO-ja: Urdhër nr. 182, datë 16.07.2021 (Nr. prot. 10753, datë 16.07.2021) 1. Z. S., Kryetar 2. T. Z., Anëtar 3. V. Z., Anëtar
2. Lloji i Procedurës: "E hapur shërbime"		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 8,000,000 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE "K & N" ShPK me ofertë 7,936,312.75 lekë pa tvsh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 63,687.25 lekë pa tvsh, ose 0.79 %
8. Data e hapjes së tenderit: Datë 06.08.2021 ora 10:00	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Vlorë. Afati 12 muaj	10. Operoret Ekonomike: Pjesëmarrës në tender 2 OE: -Kualifikuar 1 OE - Skualifikuar - OE
11. Ankimime; Po	12. Përgjigje Ankesës nga AK: PO	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: PO

u konstatua problematika si vijon:

Mbi hartimin e projektit të zbatimit dhe përcaktimi i specifikimeve teknike.

-Relacioni teknik si dhe Specifikimet Teknike janë hartuar nga znj. E. Xh..

Mbi përlllogaritjen e fondit limit.

Fondi Limit në vlerën 8,000,000 lekë është llogaritur nga, znj. E. Xh., sipas proces verbalit me nr. 10752/2 prot; datë 16.07.2021. Llogaritja e analizës së kostos, si dhe të zërave të shërbimeve janë hartuar bazuar në preventivin e vitit 2018, 2019, 2020. Nga auditimi mbi llogaritjen e FL, rezulton se është kryer në përputhje me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” të ndryshuar.

Nga kontrolli i bërë në dokumentet e administruara në dosje dhe verifikimi në zyrat e Bashkisë, rezulton se grupi i punës për hartimin e projekt të zbatimit, nuk është i pajisur me licencën e projektimit. Ky veprim, është në kundërshtim me neni 5 të Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, sipas të cilit “Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse. Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II, të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit”. Përsa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Titullarin e Autoriteti Kontraktor.

Situata 3: Nga auditimi i prokurimit me objekt “Pëmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”, me të dhëna të përgjithshme sipas tabelës,

Prokurimime objekt: “Pëmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”, Nr. Ref. 04452-09-02-2021.		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 211, datë 02.09.2021 (Nr. prot. 12282/4, datë 02.09.2021)	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit/NjP 1. P. Th., Jurist 2. D. Ç., Inxhinierë 3. V. Z., Ekonomist	4. KVO-ja: Urdhër nr. 212, datë 02.09.2021 (Nr. prot. 12283, datë 02.09.2021) 1. Z. S., Kryetar 2. T. Z., Anëtar 3. J. Ç., Anëtar
2. Lloji i Procedurës: “E hapur e thjeshtuar” kuadër		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 4,701,180 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) B.O.E “N. 1934” & “G.” ShPK me ofertë 3,454,244 pa tvsh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1,246,936 lekë pa tvsh, ose 26.52 %
8. Data e hapjes së tenderit: Datë 13.09.2021 ora 10:00 Njoftimi në APP: Buletini nr. 132, datë 07.09.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit dhe i Bashkisë Vlorë.	10. Operatorët Ekonomike: Pjesëmarrës në tender 5OE/BOE: -Kualifikuar 3 OE (1 BOE + 2 OE - Skualifikuar 2 OE
11. Ankimime; Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK: -----.	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: -----

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike; projektit të zbatimit:

-Projekti i zbatimit, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar në vitin 2021 nga Ing. D. Ç., specialiste në Drejtorinë e Përgjithshme Publike, Strehimit dhe Transportit, Bashkia Vlorë.

- Specifikimet teknike dhe llogaritja e FL për tenderin me objekt: “Pëmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara” janë hartuar nga ing. D. Ç. dhe ing. hidro. D. M., të cilët nuk disponojnë licensat profesionale në zbatim.

Nga kontrolli i bërë në dokumentet e administruara në dosje dhe verifikimi në zyrat e Bashkisë, rezulton se grupi i punës për hartimin e projekt të zbatimit, nuk është i pajisur me licencën e projektimit. Ky veprim, është në kundërshtim me neni 5 të Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, sipas të cilit “*Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse. Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II, të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit*”. Përsa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Titullarit i Autoriteti Kontraktor.

Situata 4: Nga auditimi i prokurimit me objekt “Strukturë me pilota për përforsim skarpati pas Godinë së Bashkisë Vlorë”, me të dhëna të përgjithshme sipas tabelës,

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Strukturë me pilota për përforsim skarpati pas Godinës së Bashkisë”, Nr. Ref. 27192-04-29-2022.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 4752, datë 29.04.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 4753, datë 29.04.2022
2. Lloji i Procedurës: “E hapur e thjeshtuar”	1. P. Th. (Personi përgjegjës) 2. J. Ç., Dr. i Urbanistikës 3. D. Ç. Inxhinierë	1. Z. S., Kryetar 2. D. Z., anëtar 3. V. Z., anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSh) 8,501,401 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE “I.” ShPK me ofertë 8,395,118 lekë pa tvsh, Afati 2 muaj	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 106,283 lekë ose 1.2 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 16.05.2022 ora 10.00 Shtyhet me datë 23.05.2022 ora 10:00	9. Burimi Financimit Buxhet i Bashkisë Vlorë i vitit 2022	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE në shumën 26,666,843lekë b) S’kualifikuar 1 OE c) Kualifikuar 1 OE

Mbi përcaktimin e PZ, specifikimeve teknike, etj:

- Projekti i zbatimit, relacioni teknik dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar në Vitin 2021 nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Vlorë me përbërje: ing. D. H., dr. J. Ç. dhe, është miratuar nga Titullari i Bashkisë Vlorë.

Nga kontrolli i bërë në dokumentet e administruara në dosje dhe verifikimi në zyrat e Bashkisë, rezulton se grupi i punës për hartimin e projekt të zbatimit, nuk është i pajisur me licencën e projektimit. Ky veprim, është në kundërshtim me neni 5 të Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, sipas të cilit “*Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse. Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II, të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit*”. Përsa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Autoriteti Kontraktor.

Situata 5: Nga auditimi i prokurimit me objekt “**Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë**”, me të dhëna të përgjithshme sipas tabelës,

Prokurimime objekt: “Rikonstrukcion i rrugës së fshatit Kërkovë” , Nr. Ref. 35936-07-08-2022.		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 190, datë 04.07.2022 (Nr. prot. 7624, datë 04.07.2022)	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit/NjP 1. P. Th., Jurist 2. J. Ç., Inxhiniere 3. D. Ç., specialist i Infrastrukturës	4. KVO-ja: Urdhër nr. 191, datë 04.07.2022 (Nr. prot. 11114, datë 04.10.2022) 1. Z. S., Kryetar 2. D. Z., Anëtar 3. V. Z., Anëtar
2. Lloji i Procedurës: “E hapur Pune”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 30,830,000 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE “Sh. 07” ShPK me ofertë 18,000,000 lekë pa tvsh. Kontratë nr. 1857 dt. 14.02.2023 me vlerë 21,600,000 lekë me TVSH dhe afat 2 (dy) muaj.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 12,830,000 lekë pa tvsh, ose 41.61 %
8. Data e hapjes së tenderit: Datë 11.08.2022 ora 10:00	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Vlorë.	10. Operatoret Ekonomike: Pjesëmarrës në tender 6 OE: -Kualifikuar 6OE -Skualifikuar - OE
11. Ankimime; Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK: -----.	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: -----

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike; projektit të zbatimit:

-Projekti i zbatimit, Specifikimet teknike, Preventivi i punimeve, Grafiku i punimeve, është hartuar në vitin 2022 nga ing. E. B., top. A. G., ing. J. Ç., Drejtor DPKZHT, në Bashkinë Vlorë. Projekti i zbatimit është miratuar nga Kryetari i Bashkisë.

Nga kontrolli i bërë në dokumentet e administruara në dosje dhe verifikimi në zyrat e Bashkisë, rezulton se grupi i punës (DPKZHT) për hartimin e projekt të zbatimit, nuk është i pajisur me licencën e projektimit. Ky veprim, është në kundërshtim me neni 5 të Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, sipas të cilit *“Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse. Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II, të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit”*. Përsa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Bashkisë Vlorë.

Situata 6: Nga auditimi i prokurimit me objekt “Furnizim vendosje pajisje për ndriçimin rrugor”, me të dhëna të përgjithshme sipas tabelës,

Prokurimime objekt: “Furnizim vendosje pajisje për ndriçimin rrugor” , Nr. Ref. 27271-05-04-2022.		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 86, datë 26.04.2022 (Nr. prot. 4395, datë 26.04.2022)	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit/NjP 1. P. Th., Jurist 2. Z. S., DIIP 3. A. L., Pergj. Sek të Ndriçimit	4. KVO-ja: Urdhër nr. 96, datë 29.04.2022 (Nr. prot. 4754, datë 29.04.2022) 1. D. Z., Kryetar 2. V. Z., Anëtar 3. J. Ç., Anëtar
2. Lloji i Procedurës: “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me prokurim elektronik		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 8,205,883 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE “S.” ShPK me ofertë 7,123,349 lekë pa tvsh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1,082,534 lekë pa tvsh, ose 13.19 %
8. Data e hapjes së tenderit:	9. Burimi Financimit	10. Operatoret Ekonomike:

Datë 16.05.2022 ora 10:00	Buxheti i Bashkisë Vlorë.	Pjesëmarrës në tender 5 OE -Kualifikuar 3 OE -Skualifikuar 2 OE
11. Ankimime; Jo	12. Përgjigje Ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: Jo

u konstatua problematika si vijon:

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike, Fondit Limit, PZ, etj;

Për llogaritjen e FL është mbajtur proces verbal me nr. 3801 prot; datë 11.04.2022.

Hartimi i preventivit për procedurën e prokurimit me objekt: “Furnizim vendosje pajisje për ndriçimin rrugor” është kryer si vijon:

-Punime për vendosjen e shtyllave të ndriçimit në rrugën “Misto Mele”, “Pilo B.” dhe “Fiqerete Musta” hartuar nga A. L. dhe Drejtori Z. S. në vlerën **971,811** lekë pa TVSH.

-Investim ndriçimi rruga “At Kriso Negovani” hartuar nga ing. elektrik A. L. dhe Drejtori Z. S. në vlerën **4,433,703** lekë pa TVSH.

-Blerje materiale elektrike për Ndriçim Publik hartuar nga ing. elektrik A. L. dhe Drejtori Z. S. në vlerën **735,000** lekë pa TVSH.

Specifikimet teknike hartuar nga ing. elektrik A. L. për tenderin me objekt: “Furnizim vendosje pajisje për ndriçimin rrugor” janë, në përputhje me nenin 2 dhe 15 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Çmimet janë sipas VKM-së Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar.

Nga kontrolli i bërë në dokumentet e administruara në dosje dhe verifikimi në zyrat e Bashkisë, rezulton se grupi i punës (DPKZHT) për hartimin e projekt të zbatimit, nuk është i pajisur me licencën e projektimit. Ky veprim, është në kundërshtim me neni 5 të Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, sipas të cilit “Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse. Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II, të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit”. Përsa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Bashkisë Vlorë.

Situata 7: Nga auditimi i zbatimit të kontratës për punë publike me objekt “**Rikonstruksion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë**”, me të dhëna të përgjithshme sipas tabelës,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë”.		
14. Lidhja e kontratës Nr. 8409 prot; 26.05.2021 OE “B.-X” ShPK	15. Vlera e kontratës VI e prev ofertues 13,418,547.6 lekë me TVSh.	16. Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 5,546,064 lekë me TVSH Sit. 2 (përfundimtar) në vlerën 7,478,859 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera 13,418,547.6 lekë me TVSH.	18. Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 25.06.2021 Përfundimi punimeve: 26.07.2021	19. Zgjatja e kontratës S’ka
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “A. MK” ShPK	Licenca MK.2892/6	Kontratë me nr. 8411 prot; datë 26.05.2021
21. Kolaudatori i punimeve OE “K. CO” ShPK	Licenca Nr: MK.3596	Kontratë nr. 14660 prot; datë 02.11.2021
22. Akt Kolaudimi Datë: 10.12.2021	23. Akt i marrjes në dorëzim:	

	Me datë 10.12.2021. Nga Kryetari i Bashkisë Vlorë nuk është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit. Veprim ky në kundërshtim me nenin 38 (Mbarimi dhe marrja përsipër e ndërtimeve) të kontratës së sipërmarrjes me nr. 8409 prot, datë 26.05.2021.
--	--

u konstatua problematika si vijon:

Projekti i zbatimit, etj.

-Projekti i zbatimit është punuar nga ing. M. K. dhe pranuar nga ing. J. Ç. në cilësinë e drejtorit të DPKZHT, Bashkia Vlorë. në vitin 2020 nga shoqëria nga Bashkia Vlorë.

Nga kontrolli i bërë në dokumentet e administruara në dosje dhe verifikimi në zyrat e Bashkisë, rezulton se grupi i punës (DPKZHT) për hartimin e projekt të zbatimit, nuk është i pajisur me licencën e projektimit. Ky veprim, është në kundërshtim me neni 5 të Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, sipas të cilit “Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse. Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II, të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit”. Përsa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Bashkisë Vlorë.

(Sa më sipër është trajtuar më gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 21, datë 14.07.2023 mbi Auditimin e procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë”).

Kriteri: Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Hartimi i Projekteve të Zbatimit, duke mos respektuar kërkesat e neni 5 të Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar.

Shkaku: Neglizhencë nga AK dhe DPKZHT për hartimim e Projekteve të Zbatimit duke mos respektuar kërkesat e Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë dhe, DPKZHT, për çdo rast të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, të caktojë grupe pune projektuese me specialistë të fushës (DPKZHT) të pajisur me licencë profesionale, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me lejen e ndërtimit, me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tyre si dhe jetëgjatësinë e investimit.

Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi **z. D. L.**, në cilësinë e Titullarit të Bashkisë Vlorë, për:

-(**Situata 1**, për prokurimin me objekt “Ndërhyrje riparimi në çerdhe, kopshte dhe shkolla të Bashkisë Vlorë”):

-(**Situata 2**, për prokurimin me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes të varrezave publike dhe të dëshmorëve të Bashkisë Vlorë”):

-(**Situata 3**, për prokurimin me objekt “Pëmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”):

-(**Situata 4**, për prokurimin me objekt “Strukturë me pilota për përforcim skarpati pas Godinë së Bashkisë Vlorë”):

-(**Situata 5**, për prokurimin me objekt “Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë”):

-(**Situata 6**, për prokurimin me objekt “Furnizim vendosje pajisje për ndriçimin rrugor”):

-(**Situata 7**, për prokurimin me objekt “*Rikonstrukcion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë*”):

4. Nga auditimi i prokurimit me objekt “*Shërbimi i mirëmbajtjes të varrezave publike dhe të dëshmorëve të Bashkisë Vlorë*” me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës.

Prokurimi me objekt: “ <i>Shërbimi i mirëmbajtjes të varrezave publike dhe të dëshmorëve të Bashkisë Vlorë</i> ”, Nr. Ref. 01135-07-16-2021.		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 181, datë 16.07.2021 (Nr. prot. 10752, datë 16.07.2021)	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit/NjP 1.P. Th., Jurist 2. E. Xh., Mbikëqyrëse e shërbimit 3. J. Ç., Inxhinier	4. KVO-ja: Urdhër nr. 182, datë 16.07.2021 (Nr. prot. 10753, datë 16.07.2021) 1. Z. S., Kryetar 2. T. Z., Anëtar 3. V. Z., Anëtar
2. Lloji i Procedurës: “E hapur shërbime”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 8,000,000 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE “K & N” ShPK me ofertë 7,936,312.75 lekë pa tvsh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 63,687.25 lekë pa tvsh, ose 0.79 %
8. Data e hapjes së tenderit: Datë 06.08.2021 ora 10:00	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Vlorë. Afati 12 muaj	10. Operoret Ekonomike: Pjesëmarrës në tender 2 OE: -Kualifikuar 1 OE - Skualifikuar - OE
11. Ankimime; Po	12. Përgjigje Ankesës nga AK: PO	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: PO

U konstatua problematika si vijon:

Titulli i Gjetjes: Mos realizim i Lejes Infrastrukturore të projektit të zbatimit me objekt: “*Shërbimi i mirëmbajtjes të varrezave publike dhe të dëshmorëve të Bashkisë Vlorë*”.

Situata:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit dhe i dosjes teknike të zbatimit të punimeve të kontratës me objekt: “*Shërbimi i mirëmbajtjes të varrezave publike dhe të dëshmorëve të Bashkisë Vlorë*” u konstatua se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Vlorë, nuk ka miratuar Leje Ndërtimi Ndërtimore/Infrastrukturore për projektin e zbatimit. Ky veprim është në kundërshtim me Nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe neneve 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar. Sa më sipër ngarkon me përgjegjësi Titullarin e AK Bashkisë Vlorë.

Kriteri: Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekt: Realizimi i projektit të zbatimit pa Leje Ndërtimi Infrastrukturore, në mos respektim të kërkesave të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

Shkaku: Neglizhencë e Bashkisë Vlorë dhe DPKZHT

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë dhe DPZHKT të marrë masa që të pajisin me Leje Ndërtimi për çdo projekt zbatimi sipas legjislacionit në fuqi, për të siguruar hartimin e

projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre..

Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi **z. D. L.**, në cilësinë e Titullarit të Bashkisë Vlorë, për prokurimin me objekt *“Shërbimi i mirëmbajtjes të varrezave publike dhe të dëshmorëve të Bashkisë Vlorë”*):

5. Nga auditimi i prokurimit për objektet: *“Pëmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”*, *“Strukturë me pilota për përforcim skarpati pas Godinë së Bashkisë Vlorë”*, *“Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë”*, *“Furnizim vendosje pajisje për ndriçimin rrugor”*, *“Rikonstruksion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë”*, *“Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + Sistem ngrohje”* u konstatua problematika si vijon:

Titulli i Gjetjes: Mos realizim i Oponencës Teknike për projektet e zbatimit të investimeve.

Situata: Në **6 (gjashtë)** raste nga Bashkia Vlorë nuk është kryer oponenca teknike për projektin e zbatimit të investimeve.

Në vijim po pasqyrojmë situatat dhe Rekomandimet përkatëse si më poshtë:

Situata 1:

Nga auditimi i prokurimit me objekt *“Pëmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”*, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

Prokurimi me objekt: “Pëmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara” , Nr. Ref. 04452-09-02-2021.		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 211, datë 02.09.2021 (Nr. prot. 12282/4, datë 02.09.2021)	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit/NjP 1. P. Th., Jurist 2. D. Ç., Inxhinierë 3. V. Z., Ekonomist	4. KVO-ja: Urdhër nr. 212, datë 02.09.2021 (Nr. prot. 12283, datë 02.09.2021) 1. Z. S., Kryetar 2. T. Z., Anëtar 3. J. Ç., Anëtar
2. Lloji i Procedurës: “E hapur e thjeshtuar” kuadër		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 4,701,180 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE “N. 1934” & “G.” ShPK me ofertë 3,454,244 lekë pa tvsh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1,246,936 lekë pa tvsh, ose 26.52 %
8. Data e hapjes së tenderit: Datë 13.09.2021 ora 10:00 Njoftimi në APP: Buletini nr. 132, datë 07.09.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit dhe i Bashkisë Vlorë.	10. Operatoret Ekonomike: Pjesëmarrës në tender 5OE/BOE: - Kualifikuar 3 OE (1 BOE + 2 OE) - Skualifikuar 2 OE
11. Ankimime; Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK: -----.	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: -----

u konstatua problematika si vijon:

-Projekti i zbatimit, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar në vitin 2021 nga ing. D. Ç., specialiste në Drejtorinë e Përgjithshme Publike, Strehimit dhe Transportit, Bashkia Vlorë.

Për projektin e zbatimit të objektit: *“Pëmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”* nuk është kryer oponencë teknike nga Bashkia Vlorë. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve

të Ndërtimi”, i ndryshuar, neni 6, pika 1, germa “a”, ku theksohet: “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha:

a) ndërtimet publike;

b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë;

c) objektet me akses publik”. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Vlorë. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Vlorë.

Situata 2:

Nga auditimi i prokurimit me objekt “Strukturë me pilota për përforcim skarpati pas Godinë së Bashkisë Vlorë”, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Strukturë me pilota për përforcim skarpati pas Godinës së Bashkisë”, Nr. Ref. 27192-04-29-2022.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 4752, datë 29.04.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 4753, datë 29.04.2022
2. Lloji i Procedurës: “E hapur e thjeshtuar”	1. P. Th. (Personi përgjegjës) 2. J. Ç., Drejtori i Urbanistikës 3. D. Ç., inxhinieri	1. Z. S., Kryetar 2. D. Z., anëtar 3. V. Z., anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSh) 8,501,401 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE “I.” ShPK me ofertë 8,395,118 lekë pa tvsh, Afati 2 muaj	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 106,283 lekë ose 1.2 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 16.05.2022 ora 10.00 Shtyhet me datë 23.05.2022 ora 10:00	9. Burimi Financimit Buxhet i Bashkisë Vlorë i vitit 2022	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE në shumën 26,666,843lekë b) S’kualifikuar 1 OE c) Kualifikuar 1 OE

Për projektin e zbatimit të objektit: “Strukturë me pilota për përforcim skarpati pas Godinë së Bashkisë Vlorë” nuk është kryer oponencë teknike nga Bashkia Vlorë. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, neni 6, pika 1, germa “a”, ku theksohet: “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha:

a) ndërtimet publike;

b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë;

c) objektet me akses publik”. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Vlorë. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Vlorë.

Situata 3:

Nga auditimi i prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë”, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

Prokurimime objekt: “Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë”, Nr. Ref. 35936-07-08-2022.		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 190, datë 04.07.2022 (Nr. prot. 7624, datë 04.07.2022)	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit/NjP	4. KVO-ja: Urdhër nr. 191, datë 04.07.2022 (Nr. prot. 11114, datë 04.10.2022)
2. Lloji i Procedurës: “E hapur Pune”	1. P. Th., Jurist 2. J. Ç., Inxhinieri 3. D. Ç., Special e Infrastrukturës	1. Z. S., Kryetar 2. D. Z., Anëtar 3. V. Z., Anëtar

5. Fondi Limit (pa TVSh) 30,830,000 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE “Sh. 07” ShPK me ofertë 18,000,000 lekë pa tvsh. Kontratë nr. 1857 dt. 14.02.2023 me vlerë 21,600,000 lekë me TVSH dhe afat 2 (dy) muaj.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 12,830,000 lekë pa tvsh, ose 41.61 %
8. Data e hapjes së tenderit: Datë 11.08.2022 ora 10:00	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Vlorë.	10. Operoret Ekonomike: Pjesëmarrës në tender 6 OE: - Kualifikuar 6OE - Skualifikuar - OE
11. Ankimime; Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK: -----.	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: -----

Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike; projektit të zbatimit:

-Projekti i zbatimit, Specifikimet teknike, Preventivi i punimeve, Grafiku i punimeve, është hartuar në vitin 2022 nga ing. E. B., top. A. G., ing. J. Ç., Drejtor i DPKZHT, në Bashkinë Vlorë. Projekti i zbatimit është miratuar nga Kryetari i Bashkisë.

Për projektin e zbatimit të objektit: “Specifikimet teknike, grafiku i punimeve” **nuk është kryer opionencë teknike** nga Bashkia Vlorë. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, neni 6, germa (a) për ndërtimet publike, ku theksohet: “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha:

a) ndërtimet publike;

b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë;

c) objektet me akses publik”. Sa më sipër ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Vlorë.

Situata 4:

Nga auditimi i prokurimit me objekt “*Furnizim vendosje pajisje për ndriçimin rrugor*”, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

Prokurimi me objekt: “ Furnizim vendosje pajisje për ndriçimin rrugor ”, Nr. Ref. 27271-05-04-2022.		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 86, datë 26.04.2022 (Nr. prot. 4395, datë 26.04.2022)	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit/NjP 1.P. Th., Jurist 2. Z. S., DIIP 3. A. L., Pergj. Sek të Ndriçimit	4. KVO-ja: Urdhër nr. 96, datë 29.04.2022 (Nr. prot. 4754, datë 29.04.2022) 1.D. Z., Kryetar 2.V. Z., Anëtar 3.J. Ç., Anëtar
2. Lloji i Procedurës: “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me prokurim elektronik		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 8,205,883 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE “S.” ShPK me ofertë 7,123,349 lekë pa tvsh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1,082,534 lekë pa tvsh, ose 13.19 %
8. Data e hapjes së tenderit: Datë 16.05.2022 ora 10:00	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Vlorë.	10. Operoret Ekonomike: Pjesëmarrës në tender 5 OE -Kualifikuar 3 OE - Skualifikuar 2 OE
11. Ankimime; Jo	12. Përgjigje Ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: Jo

-Projekti i zbatimit është punuar në vitin 2022 nga ing. A. L. dhe pranuar nga z. Z. S.

-Për projektin e zbatimit të objektit: “Furnizim vendosje pajisje për ndriçimin rrugor”, Vlorë” nuk është kryer oponente teknike nga Bashkia Vlorë. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 6, pika 1, ku theksohet: “Oponenta teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha:

a) ndërtimet publike;

b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë;

c) objektet me akses publik”,

Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Vlorë dhe mbikëqyrësi i punimeve.

Situata 5:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “**Rikonstruksion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë**”, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë”.		
14.Lidhja e kontratës Nr. 8409 prot; 26.05.2021 OE “B.-X” ShPK	15.Vlera e kontratës Vl e prev ofertues 13,418,547.6 lekë me TVSh.	16.Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 5,546,064 lekë me TVSH Sit. 2 (përfundimtar) në vlerën 7,478,859 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera 13,418,547.6 lekë me TVSH.	18.Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 25.06.2021 Përfundimi punimeve: 26.07.2021	19. Zgjatja e kontratës S’ka
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “A. MK” ShPK	Licenca MK.2892/6	Kontratë me nr. 8411 prot; datë 26.05.2021
21. Kolaudatori i punimeve OE “K. CO” ShPK	Licenca Nr: MK.3596	Kontratë nr. 14660 prot; datë 02.11.2021
22.Akt Kolaudimi Datë: 10.12.2021	23.Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 10.12.2021. Nga Kryetari i Bashkisë Vlorë nuk është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit. Veprim ky në kundërshtim me nenin 38 (Mbarimi dhe marrja përsipër e ndërtimeve) të kontratës së sipërmarrjes me nr. 8409 prot, datë 26.05.2021.	

- Për projektin e zbatimit të objektit: “Rikonstruksion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë, Faza II”, Vlorë” nuk është kryer oponente teknike nga Bashkia Vlorë. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 6, pika 1, ku theksohet: “Oponenta teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha:

a) ndërtimet publike;

b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë;

c) objektet me akses publik”. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Vlorë.

Situata 6:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “**Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + Sistem ngrohje**”, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + Sistem ngrohje” Vlorë.		
14.Lidhja e kontratës Nr. 1808 prot; datë 01.03.2019 OE “C.” ShPK	15.Vlera e kontratës Vl e prev ofertues 44,489,454 lekë me TVSh.	16.Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 4,026,526 lekë me TVSH

17- Situacioni Përfundimtar -Vlera ---- lekë me TVSH.	18.Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 02.03.2020 Përfundimi punimeve: ----	19. Zgjatja e kontratës -----
20. Mbikëqyrësi i punimeve - OE "H. & SK. 11" ShPK -OE "R. 95" ShPK	Licenca MK. 2018/23 Licenca MK. 1506/10	Kontratë me nr. 2110 prot; datë 31.03.2019 Kontratë me nr. 8341 prot; datë 25.07.2022
21. Kolaudatori i punimeve ---	Licenca Nr: MK.----	Kontratë nr. ----- prot; datë ----
22.Akt Kolaudimi Datë: -	23.Akt i marrjes në dorëzim: Me datë ---	

-Për projektin e zbatimit të objektit: “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + Sistem ngrohje” nuk është kryer oponencë teknike nga Bashkia Vlorë. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 6, pika 1, ku theksohet: “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha:

a) ndërtimet publike;

b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë;

c) **objektet me akses publik**”. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Vlorë. **Kriteri:** Ligji Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, germa (a) ndërtimet publike.

Ndikimi/Efekti: Realizimi i projektit të zbatimit në mungesë të oponencës teknike, në mosrespektim nenit 6, germa (a) të Ligji Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

Shkaku: Neglizhencë e Bashkisë Vlorë .

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marrë masa për pajisjen me Oponencë Teknike për të gjitha ndërtimet publike, si dhe për objektet me akses publik, sipas legjislacionit në fuqi.

Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi **z. D. L.**, në cilësinë e Titullarit të Bashkisë Vlorë, për mos kryerjen e oponencës teknike për objektet:

-Situata 1 për prokurimin me objekt “Pëmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”, **-Situata 2** për prokurimin me objekt “Strukturë me pilota për përforcim skarpatis pas Godinës së Bashkisë Vlorë”, **-Situata 3** për prokurimin me objekt “Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë”, **-Situata 4** për prokurimin me objekt “Furnizim vendosje pajisje për ndriçimin rrugor”, **-Situata 5** për zbatimin e kontratës me objekt “Rikonstruksion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë”, **-Situata 6** për zbatimin e kontratës me objekt “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + Sistem ngrohje”.

6. Prokurimi me objekt: “Rikualifikim i bllokut të banesave kufizuar nga bulevardi “Çamëria”, rruga “Pelivan L.”, rruga “Kujtim Beqiri”, ”, me të dhëna të përgjithshme sipas tabelës.

Prokurimi me objekt: “Rikualifikim i bllokut të banesave kufizuar nga bulevardi “Çamëria”, rruga “Pelivan L.”, rruga “Kujtim Beqiri”, Nr. Ref. 44446-10-05-2022.		
1. Urdhër Prokurimi:	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit/NjP	4. KVO-ja:

Nr. 256, datë 04.10.2022 (Nr. prot. 11113, datë 04.10.2022)	1. P. Th., Jurist 2. J. Ç., Inxhinierë 3. D. Ç., Specialiste e Infrastrukturës	Urdhër nr. 257, datë 04.10.2022 (Nr. prot. 11114, datë 04.10.2022) 1. Z. S., Kryetar 2. D. Z., Anëtar 3. V. Z., Anëtar
2. Lloji i Procedurës: “E hapur e thjeshtuar”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 4,442,884 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE “A.” ShPK me ofertë 3,632,240 pa tvsh. Kontratë nr. 1758 dt. 13.02.2023 me vlerë 4,358,688 lekë me TVSH;	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 810,644 lekë pa tvsh, ose 18.24 %
8. Data e hapjes së tenderit: Procedura e I e anuluar: Datë 17.08.2022 ora 10:00 Procedura e II: Datë 19.10.2022 ora 10:00	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Vlorë.	10. Operoret Ekonomike: Pjesëmarrës në tender 2 (1 OE/1 BOE): - Kualifikuar 1 OE - Skualifikuar 1 BOE
11. Ankimime; Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK: -----.	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: -----

Burimi i të dhënave: Bashkia Vlorë

Bazuar në shkresën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallë së parë Vlorë me Nr. 4870 Prot./A.M., datë 08.05.2023 drejtuar Bashkisë Vlorë protokolluar me Nr. 5462 Prot; datë 09.05.2023, ku kërkohen të dhëna me interes me hetimin.

Për interesa të hetimeve paraprake të kallëzimit penal nr. 660, datë 03.05.2023, kërkohet nga ana Juaj informacionin për sa më poshtë:

-Të dhëna kopje të njësuar të dokumentacionit në lidhje me projektin dhe lejen infrastrukturore të prokurimit publik “Rikualifikim i bllokut të banesave kufizuar nga Bulevardi “Çamëria”, rruga “Pelivan L.”, rruga “Kujtim Beqiri” dhe rruga “Piro Sava”, procedurën e tenderimit dhe procedurën e shpronësimit të pronarëve që preken nga ky projekt publik.

-Grupi i auditimit, duke vlerësuar rëndësinë dhe qëllimin e procedurës së prokurimit me objekt “Rikualifikim i bllokut të banesave kufizuar nga Bulevardi “Çamëria”, rruga “Pelivan L.”, rruga “Kujtim Beqiri” dhe rruga “Piro Sava”, bën me dije se nuk mund të kryej auditim mbi vendimmarrjen dhe dokumentacionin e administruar në dosjen së procedurës së prokurimit, pasi çështja është duke u gjykuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallë së parë Vlorë.

Në këto kushte, referuar ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, neni 36, paragrafi 3-të i cili përcakton shprehimisht se: “Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile e cila është duke u gjykuar nga gjykata”, grupi i auditimit nuk mund të dalë me një konkluzion.

Konkluzion i përgjithshëm mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet publike:

1. Nga auditimi i 12 (dymbëdhjetë) procedura prokurimi me vlerën limit të kontratës 111,330,000 lekë pa TVSH me kontrata të lidhura në vlerën 94,051,306.62 lekë me TVSH, ose 84.47 % e vlerës limit të kontratës, u konstatuan problematikat si vijon:

- Në 2(dy) prokurime u konstatua parregullsi në vlerësimin e kualifikimit të operatorëve ekonomik nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), duke shpallur fitues OE që nuk plotësonin të gjitha kriteret e përcaktuara në DST, respektivisht për prokurimet me objekt:

- “Pëmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara” me fitues BOE “N. 1934” & “G.” ShPK me ofertë në vlerën 3,454,244 lekë.

- “Blerje Kompjutera Desktop, Workstation, Printer AIO, Laptop Praktik” me fitues OE “PC. S” ShPK me ofertë në vlerën 1,620,000 lekë.

- Në **5(pesë)** prokurime u konstatua se në **11** (njëmbëdhjetë) raste Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë dhe Njësia e Prokurimit, kanë kryer procedura prokurimi pa argumentuar kriteret për kualifikim (kapacitetet teknike) dhe pa respektuar rregullat e procedurave të prokurimit publik, hartimit të DST, të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit dhe, kriterëve teknike, respektivisht për prokurimet me objekt:

- “Blerje Kompjutera Desktop, Workstation, Printer AIO, Laptop Praktik”

- “Ndërhyrje riparimi në çerdhe, kopshte dhe shkolla të Bashkisë Vlorë”

- “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”

- “Strukturë me pilota për përforsim skarpati pas Godinës së Bashkisë”

- “Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë”.

- Në **7(shatatë)** prokurime u konstatu s,e Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë dhe DPKZHT, kanë Hartuar Projekte Zbatimi për investime publike pa licencë profesionale, respektivisht për prokurimet me objekt:

- “Ndërhyrje riparimi në çerdhe, kopshte dhe shkolla të Bashkisë Vlorë”

- “Shërbimi i mirëmbajtjes të varrezave publike dhe të dëshmorëve të Bashkisë Vlorë”

- “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”

- “Strukturë me pilota për përforsim skarpati pas Godinës së Bashkisë”

- “Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë”

- “Furnizim vendosje pajisje për ndriçimin rrugor”

- “Rikonstruksion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë”

-Në **1(një)** rast për zbatimin e kontratës me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes të varrezave publike dhe të dëshmorëve të Bashkisë Vlorë” fituar nga OE “K & N” ShPK, nga AK Bashkia Vlorë nuk ka miratuar Leje Ndërtimi për projektin e zbatimit.

-Në **6(gjashhtë)** të prokurimeve dhe zbatimit të kontratave u konstatua se, nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë nuk është kryer Oponenca Teknike, respektivisht për prokurimet me objekt:

- “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”

- “Strukturë me pilota për përforsim skarpati pas Godinë së Bashkisë Vlorë”

- “Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë”

- “Furnizim vendosje pajisje për ndriçimin rrugor”

- “Rikonstruksion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë”

- “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + Sistem ngrohje”

2.4.1 Auditim mbi prokurimet me blerje të vogla.

- Në mënyrë të përmbledhur auditimi i prokurimeve për periudhën e auditimit, 01.07.2021-31.12.2021 dhe 2022 si më poshtë.

Në total u audituan **205** procedura prokurimi me vlerën limit të kontratës **92,070,126** lekë pa TVSH me kontrata të lidhura në vlerën **75,896,476** lekë me TVSH, ose **82.43 %** e vlerës limit të kontratës.

Sipas viteve të auditimit:

1. Për periudhëm **01.07.2021 – 31.12.2021** janë audituar **79** procedura prokurimi me vlerën limit të kontratës **44,701,660** lekë pa tvsh dhe janë lidhur kontrata në vlerën **37,996,411** lekë pa tvsh ose **85 %** e fondit limit të kontratës.

2. Për vitin **2022** janë audituar **126** procedura prokurimi me vlerën limit të kontratës **47,368,466** lekë pa tvsh dhe janë lidhur kontrata në vlerën **37,900,065** lekë pa tvsh ose **80.01 %** e fondit limit të kontratës.

Procedurat e prokurimit me blerje me vlera të vogla, të audituara me të dhënat specifike sipas UMF nr. 57, datë 12.06.2014, “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, paraqiten në Aneksin nr. 2.4 sipas tabelës nr.2.4.1.

- Në asnjë rast të përdorimit të formës së prokurimit “Blerje me vlerë të vogël”, fondi limit nuk ka qenë mbi 1,000,000 lekë pa TVSH, pra mbi kufirin monetar të përcaktuar me vendimin e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu II, pika 2 si dhe udhëzimin e APP nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” të ndryshuar.

- Për të gjitha rastet e blerjeve si për shërbimet dhe mallrat është kryer procesi i marrjes në dorëzim të mallit dhe shërbimit nga komisioni i ngritur për çdo rast nga Titullari i AK.

-Nga auditimi i pagesave për blerje me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël rezultoi se procedurat në përgjithësi ishin të plotësuara dhe dokumentacioni bashkëlidhur përbën gjurmën e auditimit të këtyre procedurave në të gjitha fazat dhe hapat e kryera për realizimin e këtyre procedurave deri në momentin e kontabilizimit të tyre në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Udhëzimi i APP nr. 2, datë 24.04.2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”, pika 2 dhe me UMF nr.57 datë 12.06.2014 “Për Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

1. Mbi auditimin e zbatimit të procedurave “Blerje me vlerë të vogël” dhe “Blerje nën vlerën 100,000 lekë” për coptimin e fondit të kontratave.

Në vijim paraqesim problematikat e konstatuara për 17 prokurime (periudha 01.07.2021-31.12.2022) “Blerje me vlerë të vogël dhe me “Blerje nën vlerën 100,000 lekë”, si më poshtë:

Titulli i Gjetjes: *Autoriteti Kontraktor ka kryer procedura prokurimi duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit, në mosrespektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe, LPP, i ndryshuar.*

Situata: Nga dokumentacioni dhe të dhënat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit, si dhe nga verifikimi i procedurave me zgjedhje në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkellje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” dhe VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet:

Të dhëna mbi Regjistrin e Realizimeve të Prokurimit Publik:

Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.07.2021 deri 31.12.2021		
<i>Lloji i procedurës së prokurimit të përdorur nga AK</i>	<i>Procedura gjithësej të realizuara nga data 01.07.2021 deri 31.12.2021</i>	<i>Totali i fondit limit (në lekë pa tvsh) për procedurat përkatëse.</i>
“blerje me vlerë të vogël”	31 procedura	23,377,724
“blerje nën vlerën 100 000 lekë”	43 procedura	3,610,256
“e hapur e thjeshtuar”	5 procedura	17,713,680
TOTALI	79 procedura	44,701,660

Nga verifikimi, rast pas rasi, i procedurave të sipërcituara, rezulton se në disa raste nga Autoriteti Kontraktor është kryer ndarja e procedurave të prokurimit duke copëzuar fondin dhe, duke sjellë si pasojë shmangien nga fusha e zbatimit të ligjit, duke shmangur procedurat standarde të

prokurimit për shkak të ndryshimit artificial të kufirit monetar, pa arsye objektive të cilat do të justifikonin veprimin konkret, konkretisht:

Rasti 1:

Të dhëna mbi Realizimin e Procedurave të Prokurimit:

Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.07.2021 deri 31.12.2021		
<i>Objekti i procedurës së prokurimit.</i>	<i>Lloji i procedurës sipas SPE.</i>	<i>Fondi limit (në lekë pa tvsh) për procedurën përkatëse.</i>
1-Blerje materiale për bredhin e vitit të ri.	“blerje me vlerë të vogël”	1,000,000
2-Blereje materiale për dekorimin e ambjenteve të Bashkisë	“blerje nën vlerën 100 000 lekë”	60,000
3-Materiale dekori për festat e fundvitit	“blerje me vlerë të vogël”	991,500
TOTALI	3 procedura	2,051,500

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktor ka kryer procedura prokurimi duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit. Konkretisht, duke u nisur nga ngjajshmëria apo funksionaliteti i tyre, objektet duhet të prokuroheshin bashkë nëpërmjet procedurës “E hapur e thjeshtuar”.

Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup - mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure”.

Rasti 2:

Të dhëna mbi Realizimin e Procedurave të Prokurimit:

Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.07.2021 deri 31.12.2021		
<i>Objekti i procedurës së prokurimit.</i>	<i>Lloji i procedurës sipas SPE.</i>	<i>Fondi limit (në lekë pa tvsh) për procedurën përkatëse.</i>
1-Blerje fishekzjarre për festimet e fundvitit.	“blerje me vlerë të vogël”	899,000
2-F.V. fishekzjarre për festen e 28 Nëntorit.	“blerje me vlerë të vogël”	301,000
TOTALI	2 procedura	1,200,000

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktor ka kryer procedura prokurimi duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit. Konkretisht, duke u nisur nga ngjajshmëria apo funksionaliteti i tyre, objektet duhet të prokuroheshin bashkë nëpërmjet procedurës “e hapur e thjeshtuar”.

Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup - mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure”.

Rasti 3:

Të dhëna mbi Realizimin e Procedurave të Prokurimit:

Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.07.2021 deri 31.12.2021		
<i>Objekti i procedurës së prokurimit.</i>	<i>Lloji i procedurës sipas SPE.</i>	<i>Fondi limit (në lekë pa tvsh) për procedurën përkatëse.</i>
1-Shërbim, foni, ndriçim, skenë, led ëall... koncerti gala për paqen...	“blerje me vlerë të vogël”	715,000

2- Shërbim, foni, ndriçim, skenë, led ëall... festën e Kaninës...	“blerje me vlerë të vogël”	716,400
TOTALI	2 procedura	1,431,400

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktor ka kryer procedura prokurimi duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit.

Vlen të theksohet se për të njëjtin objekt prokurimi, AK Bashkia Vlorë përgjatë vitit buxhetor 2021, ka kryer gjithësej 6 (gjashtë) procedura prokurimi të llojit “blerje me vlerë të vogël”, të ndara nga njëra-tjetra për një vlerë totale të fondit limit prej **4,599,400 lekë**.

Në lidhje me dy procedurat e sipërcituara prokurimi duhet të kryhej në një procedure të vetme nisur edhe nga fakti i afërsisë kohore të nevojës për shërbimin e kërkuar. Konkretisht, duke u nisur nga ngjajshmëria apo funksionaliteti i tyre, objektet duhet të prokurroheshin bashkë nëpërmjet procedurës “E hapur e thjeshtuar”.

Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup - mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure”.

Rasti 4:

Të dhëna mbi Realizimin e Procedurave të Prokurimit:

Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.07.2021 deri 31.12.2021		
<i>Objekti i procedurës së prokurimit.</i>	<i>Lloji i procedurës sipas SPE.</i>	<i>Fondi limit (në lekë pa tvsh) për procedurën përkatëse.</i>
1-Blerje material elektrike për shkollën Z. Lelo	“blerje nën vlerën 100 000 lekë”	100,000
2-Blerje llamba elektrike për arsimin	“blerje me vlerë të vogël”	600,000
3-Blerje material për ndriçimin e rr. Kosova dhe Gj. Kastrioti	“blerje me vlerë të vogël”	847,000
TOTALI	3 procedura	1,547,000

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktor ka kryer procedura prokurimi duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit.

Vlen të theksohet se AK Bashkia Vlorë përgjatë vitit buxhetor 2021, ka kryer edhe dy procedura të tjera me objekt të ngjashëm, konkretisht: 1- “Blerje shtylla ndriçimi” me procedure “të hapur” dhe fond limit 16,666,667 lekë si dhe 2- “Blerje material elektrike për ndriçimi publik” me procedure “të hapur” dhe fond limit 11,645,300 lekë.

Në lidhje me tre procedurat e sipërcituara prokurimi duhet të kryhej në një procedure të vetme nisur edhe nga fakti i afërsisë kohore të nevojës për shërbimin e kërkuar. Konkretisht, duke u nisur nga ngjajshmëria apo funksionaliteti i tyre, objektet duhet të prokurroheshin bashkë nëpërmjet procedurës “e hapur e thjeshtuar”.

Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup - mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure”.

Rasti 5:

Të dhëna mbi Realizimin e Procedurave të Prokurimit:

Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.07.2021 deri 31.12.2021		
<i>Objekti i procedurës së prokurimit.</i>	<i>Lloji i procedurës sipas SPE.</i>	<i>Fondi limit (në lekë pa tvsh) për procedurën përkatëse.</i>
1-Siguracioni i mjeteve të ndriçimit	“blerje me vlerë të vogël”	700,000

2-Siguracioni i mjeteve zjarrfikse	“blerje me vlerë të vogël”	600,000
TOTALI	2 procedura	1,300,000

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktor ka kryer procedura prokurimi duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit.

Vlen të theksohet se AK Bashkia Vlorë përgjatë vitit buxhetor 2021, ka kryer edhe dy procedura të tjera me objekt të ngjashëm, konkretisht: 1- “*Siguracioni i jetës së punonjësve zjarrfikës*” me procedurë “*blerje me vlerë të vogël*” dhe fond limit 1,000,000 lekë si dhe 2- “*Siguracioni i mjeteve të Policisë Bashkiake*” me procedurë “*blerje me vlerë të vogël*” dhe fond limit 800,000 lekë.

Në lidhje me dy procedurat e sipërcituara prokurimi duhet të kryhej në një procedure të vetme nisur edhe nga fakti i afërsisë kohore të nevojës për shërbimin e kërkuar. Konkretisht, duke u nisur nga ngjajshmëria apo funksionaliteti i tyre, objektet duhet të prokuroroheshin bashkë nëpërmjet procedurës “*e hapur e thjeshtuar*”.

Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup - mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurorohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure”.

Rasti 6:

Të dhëna mbi Realizimin e Procedurave të Prokurimit:

<i>Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.07.2021 deri 31.12.2021</i>		
<i>Objekti i procedurës së prokurimit.</i>	<i>Lloji i procedurës sipas SPE.</i>	<i>Fondi limit (në lekë pa tvsh) për procedurën përkatëse.</i>
1-Riparime hidraulike në shkollën Risili...	“blerje nën vlerën 100 000 lekë”	100,000
2-Riparime hidraulike në shkollën Z. Murro...	“blerje nën vlerën 100 000 lekë”	74,200
3-Riparime hidraulike në konviktin e shkollës ind.	“blerje nën vlerën 100 000 lekë”	67,466
4-Riparime hidraulike kopshti 2, 5...	“blerje nën vlerën 100 000 lekë”	100,000
5-Riparime hidraulike në shkollën M.C...	“blerje nën vlerën 100 000 lekë”	89,000
TOTALI	5 procedura	430,666

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktor ka kryer procedura prokurimi duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit.

Në lidhje me 5 (pesë) procedurat e sipërcituara, prokurimi duhet të kryhej në një procedurë të vetme nisur nga ngjajshmëria dhe funksionaliteti i tyre, konkretisht objektet duhet të prokuroroheshin bashkë nëpërmjet procedurës “*blerje me vlerë të vogël*”.

Nga dispozitat e sipërcituara rezulton se, është e vërtetë që Autoritetet Kontraktore kanë mundësinë që për mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përlllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 100,000 (njëqind mijë) lekë, të mos zbatojnë procedurat standarde të prokurimit, por këto objekte të ngjashme në tërësinë apo totalin e vlerës së tyre brenda një viti nuk duhet ta kalojnë vlerën e njëqind mijë lekë.

Si konkluzion, në rrethanat e sipërcituara, veprimet dhe mosveprimet e AK-së, konkretisht, copëzimi i fondeve (ndarja e vlerës së kontratës) dhe për pasojë devijimi nga aplikimi i LPP-së për shkak të mosaplikimit të rregullt të llojit të procedurës, në kundërshtim me mënyrën e parashikuar, ka ndikuar negativisht në mirëpërdorimin e fondeve publike.

Për sa më sipër:

a) kur copëzimi i fondeve (ndarja e vlerës së kontratës) sjell për pasojë aplikimin e metodës (llojit) të “blerjes nën vlerën 100 000 lekë”, në rastin kur nisur nga rrethanat duhej të aplikohesh procedura e “blerjes me vlerë të vogël”, mosaplikimi i rregullt i llojit të procedurës në këtë rast përbën një risk të shtuar për cënimin e transparencës dhe konkurrencës në procedurat e prokurimit publik.

b) kur copëzimi i fondeve (ndarja e vlerës së kontratës) sjell për pasojë aplikimin e metodës (llojit) të “blerjes me vlerë të vogël”, në rastin kur nisur nga rrethanat duhej të aplikohesh procedura “e hapur e thjeshtuar”, mosaplikimi i rregullt i llojit të procedurës në këtë rast, referuar rregullave të ekonomisë së tregut të lirë (rritja e sasisë ndikon në uljen e çmimit), përbën një risk eventual për prokurimin e objektit me një vlerë më të lartë.

Për sa më sipër, janë veprime të cilat **ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e AK, komisionin e prokurimit me vlera të vogëla si dhe personi përgjegjës për prokurimin publik**. Përgjegjësia në rastin konkret diktohet nga: Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 21, pika 5 sipas të cilës: “Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij. Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.”; VKM nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 74, pika 1 sipas të cilës: “Titullari i autoritetit/entit kontraktor, në fillim të vitit, cakton me urdhër të veçantë personin/personat përgjegjës për prokurimin...Personi/at përgjegjës për prokurimin duhet të administrojë/jnë në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit.”.

Në përfundim për sa konstatuar më sipër, veprimet e AK-së bien në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Neni 2 i Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” ku përcaktohet se: “Qëllimi i këtij ligji është... a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Neni 21, pika 1 e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirë planifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

Neni 11 pika 5 e VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 ku përcaktohet se: “Asnjë kontratë publike nuk mund të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPP-ja”.

Neni 12 pika 3 e VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 ku përcaktohet se: “Përzgjedhja e metodës që përdoret për përllogaritjen e vlerës së prokurimit nuk bëhet me qëllim për ta përjashtuar atë nga fusha e zbatimit të LPP-së dhe këtyre rregullave, apo për të copëzuar kontratën me qëllim shmangien e procedurave sipas kufijve monetarë”.

Neni 56 pika 2 e VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 ku përcaktohet se: “...Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup - mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat

zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure”.

Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar; ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit.

Shkaku: Neglizhencë nga AK dhe strukturat e ngarkuara mbi përcaktimin e fondit limit dhe llojin e procedurave.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë, komisioni i prokurimit me vlera të vogëla si dhe personi përgjegjës për prokurimin publik, në asnjë rast, nuk duhet të pjesëtojë (ndajë) vlerën e kontratës me qëllim për të shmangur procedurat standarde të prokurimit publik. Gjithashtu AK, gjatë përlllogaritjes së vlerës limit të kontratës, duhet të ketë si qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohen me përgjegjësi personat si vijon:

1. **z. D. L.**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Vlorë;
2. **z. H. H.**, në cilësinë e Kryetarit të KVO me Blerje të Vogla;
3. **znj. E. B.**, në cilësinë e anëtarit të KVO me Blerje të Vogla;
4. **znj. M. M.**, në cilësinë e anëtarit të KVO me Blerje të Vogla;
5. **z. D. Z.**, në cilësinë e Drejtorit të FKB.

Lidhur mbi gjetjet dhe rekomandimet është observuar mbi projekt-raportin e auditimit nga **z. D. Z., z. H. H., znj. E. B. dhe znj. M. M.**, në rrugë elektronike, mbi **Akt Konstatimin nr.7 për auditimin e ushtruar në Bashkinë Vlorë, mbi zbatimin e procedurës së prokurimit “Me Blerjet te Vogla”** si vijon:

1.1 Pretendimi i subjektit:

Për rastin 1: Në lidhje me argumentin tuaj ju sqarojme sa më poshtë;

1. Blerje materiale për bredhin e Vitit të Ri. në shumën 1.000.000 ishin material specifike ndërtimi hekur bazament hekuri dhe të tjera të cilat nuk mund të parashikoheshin në fillim të vitit dhe nevoja doli gjatë dekorimit për festat e fundvitit.

2. Blereje materiale për dekorimin e ambjenteve të Bashkisë në Shumen 60.000 është rastë emergjent, lindi nevoja për zbukurimin e pemës së Vitit të Ri brenda godines së Bashkisë. 3. Materiale dekori për festat e fundvitit, kjo është e planifikuar për zbukurimet në rrugë dhe sheshe dhe janë dekore dhe aksesori. Njesia e prokurimitit e ka menduar se është në përputhje me legjislacionin.

Për rastin 2:

Në lidhje me argumentin tuaj ju sqarojme sa më poshtë;

1-Blerje fishekzjarre për festimet e fundvitit me vlere 899.000 leke e përcaktuar në calendarin e aktiviteve kulturore dhe procedurat e prokurimit janë vendosur në bazë të Aktivitetit për arsye se lidhet me llojin e aktivitet këngëtari i ftuar skenografia etje. Në këto kushte komisioni e ka ndertuar regjistrin në bazë të llojit të aktiviteti dhe prokurimet janë bërë në bazë të aktivitetit.

2-Blerje fishekzjarre për festimet e 28-Nentorit me vlere 301.000. leke e percaktuar ne calendar e aktiviteve kulturore dhe procedurat e prokurimit jane vendosur ne Baze te Aktivitetit per

arsye se lidhet me llojin e aktivitet kengetari i ftuar skenografia etje .Ne keto kushte komisioni e ka ndertuar regjistrin në bazë të llojit të aktiviteti dhe prokurimet janë berë në bazë të aktivitetit...

Për rastin 3:

Ju sqarojmë se si në rastin e dytë se projektet kulturore janë prokuruar si projekt me vete vlerat e të cilit nuk e kan kapërcyer kufirin monetar me argumentin se çdo procedure është varur nga lloji i aktivitetit si dhe skena korografia ndricimi kengetaret e ftuar. Komisini është nisur nga vlera e projektit kulturor për të përcaktuar formën e prokurimit, pra nuk ka berë coptim të fondit.

Për rastin 4:

Ju sqarojme se blerja prej 100.000 lekesh ka qenë rast emergjent .

Blerja e dytë llamba ndricimi për shkollat komisioni e ka përcaktuar shpenzimin në bazë programi si njesi shpenzuese dhe i perket Arsimit.

Blerja e trete material për Ndricimin Rrugor “Rruga Kosova” janë program me vete dhe kërkesa ka ardhur si raste i vecantë.

Komisioni nuk ka pas mundësi t’i gruponte në një procedurë se kan ardhur në kohë të ndryshme si kerkesa.

Për rastin 5:

Në lidhje me dy procedurat e mësipërme të siguracioneve kemi të bëjmë me dy programe të ndryshme. 1. Ndricimi Rrugor dhe 2. Shërbimi Zjarrfikës. Fondet e shërbimit zjarrfikës kanë ardhë me vonesë nga fondi i kontigjences. Duke u nisur nga sa shprehem më sipër komisioni nuk është se ka shmangur procedure ne prokurim ose coptimin e fondit .

Për sa i përket rastit të 5 procedurave te mesiperm ju sqarojme se të 5 procedurat janë raste emergjente dhe nuk mund të parashikoheshin nga komisioni.

1.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin tuaj, shprehemi se:

Në gjykimin e grupit të auditimit, nga komisioni janë kryer procedura prokurimi duke copëtuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit. Të gjitha rastet e trajtuara në procedura me blerje të vogël, rezultojnë se nga AK janë raste të ndodhura dhe të ngjashme në tre vitet e fundit, kështu që parashikimi duhej të ishte bërë pa i ndarë në kontrata të ndryshme duke shmanguir kofirin monetar. Sa më sipër, argumentet e paraqitura nuk provojnë të kundërtën e mendimit të grupit të auditimit dhe observacioni nuk merret në konsideratë.

2. Mbi auditimin e hartimit të regjistrit të parashikimeve për procedurat “Blerje me vlerë të vogël” dhe “Blerje nën vlerën 100 000 lekë”.

Në vijim paraqesim problematikat e konstatuara mbi hartimin e regjistrit të planifikimit, si më poshtë:

Titulli i Gjetjes: Krijimi i zërave të rinj të Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimit, në mospërputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar dhe, LPP, i ndryshuar.

Situata:Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje planifikimin e mirë të përdorimit të fondeve publike dhe planifikimin e realizimin në kohë të procedurave të prokurimit publik, u konstatuan

disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” dhe V.K.M-së nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht si vijon: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë, gjatë hartimit të regjistrit vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik, ka vepruar në kundërshtim me mënyrën e parashikuar në V.K.M-në nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe udhëzimet e APP-së.

Pjesa më e madhe e zërave të objekteve të prokurimit, pavarësisht llojit apo vlerës për secilën procedurë, janë krijuar në regjistrin e parashikimeve “Sistemin e Prokurimit Publik (SPE)” në **shkelje të afateve** të përcaktuara në dispozitat e sipërcituara.

AK në varësi të nevojave, gjatë periudhës shtator – dhjetor të çdo viti, përgatit regjistrin për vitin ushtrimor në vijim, bazuar në ligjin që miraton parashikimet buxhetore afatmesme. Në çdo rast, afati maksimal i hartimit të regjistrit është jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin ushtrimor pasardhës.

Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton se, AK Bashkia Vlorë, për periudhën objekt auditimi nga 01.07.2021 deri 31.12.2021 (periudhë për të cilën presupozohet që duhet të kishte përfunduar hartimi i regjistrit), ka shtuar në regjistrin e parashikimeve 91 zëra të rinj (duke përfshirë edhe blerjet me vlerë nën 100,000 lekë), konkretisht si vijon:

Tabela e zërave të rinj, të krijuar për periudhën objekt auditimi nga 01.07.2021 deri 31.12.2021			
Muaji	Zëra të rinj për procedurën “blerje me vlerë të vogël”	Zëra të rinj për “blerje nën vlerën 100,000 lekë”	Zëra të rinj për procedurën “e hapur e thjeshtuar”
Korrik	5	1	-
Gusht	3	2	1
Shtator	10	8	1
Tetor	10	17	4
Nëntor	6	6	-
Dhjetor	3	14	-
TOTALI	37	48	6

Regjistri i parashikimeve duhet të synojë planifikimin e mirë të përdorimit të fondeve publike dhe planifikimin e realizimit në kohë të procedurave të prokurimit publik.

Zërat e paqyruara në tabelën e mësipërme vlerësohen si zëra apo planifikime të krijuara në kundërshtim me dispozitat e LPP-së. Ligji i prokurimit publik, në nenin 21 të tij, përcakton se, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Referuar dispozitave ligjore të cilat rregullojnë procesin e prokurimit publik, Autoritetet Kontraktore, gjatë vitit buxhetor, lejohet të bëjnë ndryshime (shtime/pakësime) në regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik, por këto ndryshime janë raste përjashtimore, që do të thotë se, mund të bëhen vetëm në raste kur këto ndryshime vijnë për arsye që nuk kanë qenë të mundura të parashikohen në kohën e hartimit të regjistrit.

Pjesa më e madhe e zërave (objekteve të prokurimit) të evidentuara në tabelën e mësipërme nuk mund të konsiderohen si ndryshime të regjistrit për pamundësi parashikimi, kjo pasi shumica e tyre janë objekte prokurimi për nevoja të cilat rezultojnë të përsëritura në të paktën 3-4 vitet e fundit nga Bashkia Vlorë, çka i bën ato lehtësisht të parashikueshme.

Për sa më sipër, janë veprime të cilat **ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e AK si dhe personin përgjegjës për prokurimin publik.** Përgjegjësia në rastin konkret diktohet nga: Ligjit nr. 162,

datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 21, pika 5 sipas të cilës: “Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij. Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.”; V.K.M nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 74, pika 1 sipas të cilës: “Titullari i autoritetit/entit kontraktor, në fillim të vitit, cakton me urdhër të veçantë personin/personat përgjegjës për prokurimin...Personi/at përgjegjës për prokurimin duhet të administrojë/jnë në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit.”.

Në përfundim për sa konstatuar më sipër, veprimet e AK-së bien në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe V.K.M nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Neni 2 i Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” ku përcaktohet se: “Qëllimi i këtij ligji është... a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Neni 21, pika 1 e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

Neni 3 pika 1 e V.K.M-së nr. 258, datë 19.05.2021 ku përcaktohet se: “Në bazë të nevojave për punë, mallra ose shërbime, autoriteti/enti kontraktor është përgjegjës për hartimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik, në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së”.

Neni 3 pika 3 e V.K.M-së nr. 258, datë 19.05.2021 ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të nevojave, gjatë periudhës shtator – dhjetor të çdo viti, përgatit regjistrin për vitin ushtrimor në vijim, bazuar në ligjin që miraton parashikimet buxhetore afatmesme. Në çdo rast, afati maksimal i hartimit të regjistrit është jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin ushtrimor pasardhës”.

Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar; ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekt: Shtimi i zërave të rinj në Regjistrin e Parashikimit të Prokurimeve, ku shumica e zërave janë objekte prokurimi për nevoja të cilat rezultojnë të përsëritura nga Bashkia Vlorë.

Shkaku: Neglizhencë nga AK dhe strukturat e ngarkuara mbi përcaktimin e sasive dhe nevojave dhe shkelja e afateve.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë, si dhe strukturat përgjegjëse për Planifikimin e Regjistrit të Prokurimit me blerje të vogël, gjatë periudhës shtator – dhjetor të çdo viti, në bazë të nevojave për punë, mallra ose shërbime, të hartojë regjistrin vjetor të parashikimeve

për procedurat e prokurimit publik, në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së, duke përjashtuar këtu rastet për nevoja urgjente apo në pamundësi parashikimi të Autoritetit Kontraktor.

Për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohen me përgjegjësi personat si vijon:

1. z. D. L., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Vlorë.

2. z. D. Z., në cilësinë e Drejtorit të FKB.

2.4.6. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues.

- Në mënyrë të përmbledhur nga ana e audituesve të KLSH-së, për periudhën e auditimit 01.07.2021 - 31.12.2022 u audituan 8 (tetë) kontrata për punë publike/shërbime/mallra në vlerën 794,921,380 lekë pa TVSH ose 953,905,656 lekë me TVSH, respektivisht sipas viteve, si vijon:

1. Për vitin **2019** u auditua **1 (një)** kontratë për punë publike në vlerën 37,074,545 lekë pa TVSH ose 44,489,454lekë me TVSH (*Auditimi për k’ të kontratë u krye sepse zbatimi i kontraës ishte në proces pune në periudhën e auditimit, edhe pse është jashtë periudhës së Auditimit të Përputhshmërisë*).

2. Për vitin **2020** u audituan **2 (dy)** kontra për punë publike/shërbime në vlerën 720,802,545 lekë pa TVSH ose 864,963,054 lekë me TVSH, përkatësisht:

- Auditimi i realizimit të kontratës së shërbimit me objekt: “*Shërbimi i pastrimit në qytetin Vlorë*” me sipërmarrës shoqërinë “D.” ShPK me vlerë 698,022,984 lekë me TVSH, nuk u krye, sepse është duke u gjykuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë).

- Auditimi i realizimit të kontratës për punë publike me objektet: “*Ndërtim i ujësjetës në rrugën Transballkanike Vlorë*” me sipërmarrës shoqërinë “Sh. 07” ShPK me vlerë 166,940,070 lekë me TVSH, u krye, sepse zbatimi i kontraës ishte në proces, edhe pse është jashtë periudhës së Auditimit të Përputhshmërisë.

3. Për vitin **2021** u audituan **2 (dy)** kontratë për punë publike/mallra në vlerën 12,802,123 lekë pa TVSH ose 15,362,547.60 lekë me TVSH, përkatësisht:

-kontrata për punë publike me objekt: “*Rikonstruksion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë*” me sipërmarrës OE “B.-X” ShPK dhe vlerë 13,418,547.6 lekë me TVSH.

-kontrata për mallra me objekt: “*Blerje Kompjutera Desktop, Workstation, Printer AIO, Laptop Praktik*” me kontraktor shoqërinë “PC. S” ShPK me vlerë 1,944,000 lekë me TVSH.

4. Për vitin **2022** janë audituar **3 (tre)** kontrata nga ku: 2 kontrata për punë publike dhe 1 kontratë për mallra në vlerën 24,242,167.5 lekë pa TVSH ose 29,090,601 lekë me TVSH.

Në vijim pasqyrojmë problematikat dhe Rekomandimet përkatëse.

1. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: “**Furnizim vendosje pajisje për ndriçimin rrugor**”, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Furnizim vendosje pajisje për ndriçimin rrugor”.		
14.Lidhja e kontratës Nr. 8893 prot; 05.08.2022 OE “S.” ShPK	15.Vlera e kontratës Vl e prev ofertues 8,548,019 lekë me TVSh.	16.Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 2,717,481 lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 2,102,850 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera 3,727,688 lekë me TVSH.	18.Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 17.10.2022	19. Zgjatja e kontratës Amendim kontrate deri me dt. 28.12.2022

	Përfundimi punimeve: 27.12.2022	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "A. MK" ShPK	Licenca MK.1506/10 dhe MK.6835/7	Kontratë me nr. 7620 prot; datë 04.07.2022
21. Kolaudatori i punimeve OE "K. CO" ShPK	Licenca Nr: MK.3596	Kontratë nr. 4687 prot; datë 19.04.2023
22. Akt Kolaudimi Datë: 24.04.2023	23. Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 24.04.2023	

u konstatua problematika si vijon:

Titulli i Gjetjes: Punime ndërtimi të pa kryera në volumet e situacionuara për kontratën me objekt: "Furnizim vendosje pajisje për ndriçimin rrugor".

Situata: Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë dëm ekonomik ndaj Buxhetit të Bashkisë Vlorë, në vlerën **932,797.84 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Kriteri: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", Kreu II, Pika 3; Kontrata e sipërmarrjes së punimeve, nr. 8893 prot; 05.08.2022; Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve, nr. 7620 prot; datë 04.07.2022.

Ndikimi/Efekti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Vlorë.

Shkaku: Mosrealizim zëra punë ndërtimi në volumet e situacionuara.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **932,798 lekë** pa TVSh nga "S." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 8893 prot; 05.08.2022, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. znj. R. N., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

2. z. I. A., në cilësinë e kolaudatorit të punimeve.

Lidhur mbi gjetjen edhe rekomandimin, trajtuar sa më sipër, nuk janë paraqitur observacione.

2. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për kontratat me objekt: "Rikonstrukcion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë", me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstrukcion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë".		
14. Lidhja e kontratës Nr. 8409 prot; 26.05.2021 OE "B.-X" ShPK	15. Vlera e kontratës Vl e prev ofertues 13,418,547.6 lekë me TVSh.	16. Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 5,546,064 lekë me TVSH Sit. 2 (përfundimtar) në vlerën 7,478,859 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera 13,418,547.6 lekë me TVSH.	18. Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 25.06.2021 Përfundimi punimeve: 26.07.2021	19. Zgjatja e kontratës S'ka
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "A. MK" ShPK	Licenca MK.2892/6	Kontratë me nr. 8411 prot; datë 26.05.2021
21. Kolaudatori i punimeve	Licenca Nr: MK.3596	Kontratë nr. 14660 prot; datë 02.11.2021

OE "K. CO" ShPK	
22.Akt Kolaudimi Datë: 10.12.2021	23.Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 10.12.2021. Nga Kryetari i Bashkisë Vlorë nuk është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit. Veprim ky në kundërshtim me nenin 38 (Mbarimi dhe marrja përsipër e ndërtimeve) të kontratës së sipërmarrjes me nr. 8409 prot, datë 26.05.2021.

u konstatuan problematikat si vijon:

Titulli i Gjetjes: Punime ndërtimi të pa kryera në volumet e situacionuara për kontratën me objekt: "Rikonstruksion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë".

Situata:

Situata 1: Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt për zërat e punimeve: "Shtresë stabilizanti t=10cm", "Shtresë binderi me granil gur kave, 4 cm, me makineri", "Shtresë asfaltobeton me granil gur kave, 4 cm, me makineri", rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të Bashkisë Vlorë, në vlerën **500,000 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Situata 2: Për kryerjen e shërbimit të kolaudimit të punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 14660 prot; datë 02.11.2021 ndërmjet Bashkisë Vlorë, përfaqësuar nga Titullari z. D. L. dhe, OE "K. CO" ShPK përfaqësuar nga Drejtuesi Ligjor, z. I. A., me nr. lic. MK. 3596. Ngritja e g rupit të kolaudimit është bërë rreth **5 (pesë)** muajt me vonesë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, neni 12 ku citohet "Emërimi i kolaudatorit apo grupit të kolaudimit... brenda 30 ditëve nga përfundimit i punimeve të ndërtimit" dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e institucionit.

Situata 3: Për investimin me objekt: "Rikonstruksion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë" nga Kryetari i Bashkisë Vlorë nuk është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit. Veprim ky në kundërshtim me nenin 38 (Mbarimi dhe marrja përsipër e ndërtimeve) të kontratës së sipërmarrjes me nr. 8409 prot, datë 26.05.2021.

Kriteri:

Situata 1, 2 dhe 3: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"; Kontrata e sipërmarrjes së punimeve, nr. 8409 prot; 26.05.2021; Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve, nr. 8411 prot; datë 26.05.2021.

Ndikimi/Efekti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Vlorë, kolaudimi i vonuar i investimit si dhe nuk është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit.

Shkaku: Mosrealizim zëra punë ndërtimi në volumet e situacionuara.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi 1: Titullari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **500,000 lekë** pa TVSh nga "B. X" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 8409 prot; 26.05.2021, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Rekomandimi 2: Titullari i Bashkisë Vlorë për zbatimin e kontratave për punë publike, të bëjë emërimin e kolaudatorit apo grupit të kolaudimit, brenda 30 ditëve nga përfundimit i punimeve të

ndërtimit për të hapur rrugën e periudhës së garancisë së defekteve të punimeve.

Rekomandimi 3: Titullari i Bashkisë Vlorë mbas përfundimit të zbatimit të kontratave për punë publike, të marrë masa për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të objektit sipas kushteve të kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. **z. D. L.**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Vlorë (Situata 1, 2 dhe 3).
2. **z. E. M.**, në cilësinë e Mbikëqyrësit të punimeve (Situata 1).
3. **z. I. A.**, në cilësinë e Kolaudatorit të punimeve (Situata 1 dhe 2).

3. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për kontratat me objekt: “**Ndërtim i ujësjellësit në rrugën Transballkanike Vlorë**”, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ndërtim i ujësjellësit në rrugën Transballkanike Vlorë”.		
14. Lidhja e kontratës Nr. 9412 prot; datë 21.10.2020 OE “Sh. 07” ShPK	15. Vlera e kontratës VI e prev ofertues 166,940,070 lekë me TVSh.	16. Likuiduar: Sit. Pjes 1 në vlerën 37,904,208 lekë me TVSH Sit. Pjes 2 në vlerën 54,643,632 lekë me TVSH Sit. (përfundimtar) në vlerën 74,392,230 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera 166,940,070 lekë me TVSH.	18. Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 11.12.2020 Përfundimi punimeve: 10.07.2021	19. Zgjatja e kontratës S’ka
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “I. D. A.” ShPK	Licenca MK.1886/96	Kontratë me nr. 9057/1 prot; datë 11.12.2020
21. Kolaudatori i punimeve OE “N. S.” ShPK	Licenca Nr: MK1846/7	Kontratë nr. 8437 prot; datë 26.07.2022
22. Akt Kolaudimi Datë: 29.07.2022	23. Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 01.08.2022. Nga Kryetari i Bashkisë Vlorë nuk është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit. Vepim ky në kundërshtim me nenin 38 (Mbarimi dhe marrja përsipër e ndërtimeve) të kontratës së sipërmarrjes me nr. 9412 prot; datë 21.10.2020.	

u konstatuan problematikat si vijon:

Titulli i Gjetjes: Punime ndërtimi të pa kryera në volumet e situacionuara për kontratën me objekt: “Ndërtim i ujësjellësit në rrugën Transballkanike Vlorë”.

Situata:

Situata 1: Nga auditimi i situacioneve pjesore progresive dhe situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt për zërin e punës “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³”, rezultoi se zëri “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³” është pasqyruar në librezën e masave jo saktësisht në volumnin 543 m³ dhe në vlerën **190,050 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Situata 2: Për kryerjen e shërbimit të kolaudimit të punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 8437 prot; datë 26.07.2022 e lidhur ndërmjet Bashkisë Vlorë, përfaqësuar nga Titullari z. D. L. dhe, OE “N. S.” ShPK përfaqësuar nga Drejtuesi Ligjor z. E. N., me nr. lic. MK. 1846/7.

Ngritja e grupit të kolaudimit është bërë rreth **1(një)** vit me vonesë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 12 ku citohet “Emërimi i kolaudatorit apo grupit të kolaudimit... brenda 30 ditëve nga përfundimi i punimeve të ndërtimit” dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e institucionit.

Situata 3: Për objektin: “Ndërtim i ujësjellësit në rrugën Transballkanike Vlorë” nga Kryetari i Bashkisë Vlorë nuk është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit. Veprim ky në

kundërshtim me **nenin 38** (Mbarimi dhe marrja përsipër e ndërtimeve) të kontratës së sipërmarrjes me nr. 9412 prot, datë 21.10.2020.

Kriteri:

Situata 1, 2 dhe 3: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”; Kontrata e sipërmarrjes së punimeve, nr. 9412 prot; datë 21.10.2020; Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve, nr. 9057/1 prot; datë 11.12.2020.

Ndikimi/Efekti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Vlorë, kolaudimi i vonuar i investimit si dhe nuk është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit.

Shkaku: Mosrealizim zëra punë ndërtimi në volumet e situacionuara.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi 1: Titullari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **190,050 lekë** pa TVSh nga “Sh. 07” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 9412 prot; datë 21.10.2020, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Rekomandimi 2: Titullari i Bashkisë Vlorë për zbatimin e kontratave për punë publike, të bëjë emërimin e kolaudatorit apo grupit të kolaudimit, brenda 30 ditëve nga përfundimit i punimeve të ndërtimit për të hapur rrugën e periudhës së garancisë së defekteve të punimeve.

Rekomandimi 3: Titullari i Bashkisë Vlorë mbas përfundimit të zbatimit të kontratave për punë publike, të marrë masa për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të objektit sipas kushteve të kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. **z. D. L.**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Vlorë (Situata 2 dhe 3);
2. **z. A. H.**, në cilësinë e Mbikëqyrësit të punimeve (Situata 1).

4. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për kontratat me objekt: “**Strukturë me pilota për përforcim skarpati pas godinës së Bashkia Vlorë**”, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Strukturë me pilota për përforcim skarpati pas godinës së Bashkia Vlorë”, Vlorë		
14. Lidhja e kontratës Nr. 7619 prot; da 04.07.2022 OE “I.” ShPK	15. Vlera e kontratës VI e prev ofertues 10,074,142 lekë me TVSh.	16. Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 4,026,526 lekë me TVSH Sit. 2 (përfundimtar) në vlerën 6,047,616 lekë me TVSH
17. Situacioni Përfundimtar -Vlera 10,074,142 lekë me TVSH.	18. Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 17.10.2022 Përfundimi punimeve: 26.12.2022	19. Zgjatja e kontratës Amendim Kontrate me nr. prot. 7619/2, datë 26.12.2022, ku afati i përfundimit të punimeve shtyhet deri me datë 26.12.2022.
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “R. 95” ShPK & “MCE” ShPK	Licenca MK.1506/10	Kontratë me nr. 2913 prot; datë 04.07.2022
21. Kolaudatori i punimeve PF. Ing. V. Ç.	Licenca Nr: MK.2166/2	Kontratë nr. 12618 prot; datë 09.03.2023
22. Akt Kolaudimi Datë: 15.03.2023	23. Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 15.03.2023. Nga Kryetari i Bashkisë Vlorë nuk është nxjerrë urdhër i brendshëm për ngritjen e grupit për marrjen në dorëzim të objektit.	

u konstatuan problematikat si vijon:

Titulli i Gjetjes: Punime ndërtimi të pa kryera në volumet e situacionuara për kontratën me objekt: “Strukturë me pilota për përforcim skarpati pas godinës së Bashkia Vlorë”.

Përshkrimi i situatave:

Situata 1:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt për zërat e punimeve “**Betonim Pilotash C/25/30**”, “**Mure b/a t=21-30 cm, h=4m C/25/30**”, “**Veshje pilotash me membranë beton**”, si kryerje punimesh jashtë afatit të kontratës, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Vlorë, në vlerën **220,945.44 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Mbi zbatimin e afatit të përfundimit të punimeve sipas kontratës.

-Punimet e ndërtimit kanë filluar me datë **17.10.2022** sipas njoftimit të fillimit të punimeve nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve dhe, sipas Kushteve të veçanta të kontratës (Shtojca 17) neni 5 (Data e fillimit të punimeve) duhet të përfundonin me datë **16.12.2022**. Bazuar në dokumentet mbi përfundimin e punimeve hartuar nga sipërmarrësi i punimeve shoqëria “I.” ShPK dhe Mbikëqyrësi i punimeve JV “R. 95” ShPK & “M.” ShPK për faqësuar nga znj. R. N., kanë përfunduar me datë **26.12.2022** brenda afatit të kontratës të amenduar me nr. prot. 7619/2, datë 26.12.2022.

-Mbikëqyrësi i punimeve shoqëria “R. 95” ShPK me shkresën me nr. 04 prot; datë 14.12.2022 (Pa u protokolluar në Bashkinë Vlorë) i drejtohet z. D. L. dhe për dijeni Shoqërisë zbatuese “I.” ShPK, me kërkesë për zgjatje afati për përfundim për shirat e vazhdueshëm në objektin “Strukturë me pilota për sistemim Skarpati mbrapa Godinës së Bashkisë Vlorë”.

-Kryetari i Bashkisë Vlorë me shkresën me nr. 7619/1 prot; datë **19.12.2022** i drejtohet Mbikëqyrësit të punimeve shoqërisë “R. 95” ShPK përfaqësuar nga Ing. R. N. dhe për dijeni shoqërisë zbatuese “I.” ShPK përfaqësuar nga Administratori z. F. Ç., mbi miratimin e zgjatjes së afatit për shkak të shirave të vazhdueshëm në objektin “Strukturë me pilota për sistemim Skarpati mbrapa Godinës së Bashkisë Vlorë”. Konstatohet se miratimi nga Kryetari i Bashkisë Vlorë është bërë jashtë afatit kontraktual, pra 4 (katër) ditë me vonesë, pas afatit të përfundimit të punimeve, në kundërshtim me kushtet e kontratës së sipërmarrjes. Në vijim është bërë Amendim me nr. 7619/2 prot; datë 19.12.2022, pra 4 (katër) ditë me vonesë, pas afatit të përfundimit të punimeve, veprim ky në kundërshtim me paragrafin 27.3 të nenit 5 të kontratës bazë me Nr. 7619 prot; da 04.07.2022 dhe paragrafit 27.5. Kryetari ka vlerësuar situatën dhe kë bërë amendimin, në kohën pas përfundimit afatit fillestar të përcaktuar në Kontratë.

Për kryerje punime ndërtimi jashtë afatit të kontratës, Kryetarit të Bashkisë Vlorë, i lind e drejta që të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim të afatit të shërbimit, sipas klauzolave të nenit 20 “*Dëmet e likuiduara*” të kontratës, shkronja (a), ku theksohet: “*Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës*”.

Llogaritja e penalitetit:

-Vlera e penalitetit nga llogaritja deri në momentin e përfundimit të punimeve, në datën **26.12.2022** për shoqërinë “I.” ShPK, i kontraktuar për zbatimin e kontratës me objekt: “Strukturë me pilota për sistemim Skarpati mbrapa Godinës së Bashkisë Vlorë”, rezulton **161,186 lekë me TVSH =**

10,074,142 lekë (Vlera e kontratës) x 4 ditë vonesë x 4/1000, që duhet t'i paguajë Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë. Kjo vlerë përbën dëm ekonomik për buxhetin e Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë.

Situata 2:

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit për objektin “Strukturë me pilota për përforsim skarpati pas godinës së Bashkia Vlorë” Kryetari i Bashkisë Vlorë, me urdhër nr. 69 (nr. 2913 prot; datë 09.03.2023) ka ngarkuar si kolaudator i punimeve znj. V. Ç., me nr. lic. MK. 2166/2. Kolaudimi është bërë me datë 15.03.2023, rreth 2 (dy) muaj me vonesë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 12 ku citohet “Emërimi i kolaudatorit apo grupit të kolaudimit... bëhet brenda 30 ditëve nga përfundimit i punimeve të ndërtimit”. Proces verbali mbi kolaudimin është nënshkruar nga: ing. V. Ç. Kontraktori i punimeve “I.” ShPK përfaqësuar nga Administratori z. F. Ç.; nga Mbikëqyrësi i punimeve BOE “R. 95” ShPK & “M.” ShPK përfaqësuar nga ing. R. N. dhe nga Kolaudatori i punimeve. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi Titullarin e institucionit.

Referuar Licencës së kolaudatorit znj. V. Ç. me nr. 2166/2 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” konstatohet se në licencë nuk disponon pikën “NP – 5 A Punime nëntokësore” aq më tepër që në preventiv janë parashikuar punime Pilotash (Betonim, shpim, armim, etj). Pika NP-5 A, nga Bashkia Vlorë është vendosur si kriter në Dokumentet e Tenderit, konkretisht, në pikën 2.3 Kapacitetet teknike dhe profesionale, nën-pika 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga MIE, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

NP – 1 A Punime gjurmimi në tokë

NP – 2 A Ndërtime civile e industriale

NP – 5 A Punime nëntokësore

Sa më sipër trajtuar, emërimi i znj. V. Ç. si kolaudatore duke mos plotësuar “Aftësinë teknike dhe profesionale” për punimet nëntokësore, është në kundërshtim me DST, pika 2.3.2; me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9, pika 1/1, 1/6, neni 64/a, me ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 12, dhe ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Vlorë z. D. L.

Situata 3:

Për objektin: “Strukturë me pilota për sistemim Skarpati mbrapa Godinës së Bashkisë Vlorë” nga Kryetari i Bashkisë Vlorë nuk është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit, vepim ky në kundërshtim me nenin 38 (Mbarimi dhe marrja përsipër e ndërtimeve) të kontratës së sipërmarrjes me nr. 7619 prot, datë 04.07.2022.

Kriteri:

Situata 1, 2 dhe 3: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”; Kontrata e sipërmarrjes së punimeve me nr. 7619 prot, datë 04.07.2022; Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve me nr. 7621 prot; datë 04.07.2022.

Ndikimi/Efekti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Vlorë, kolaudimi i vonuar i investimit si dhe nuk është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit.

Shkaku: Mos realizim zëra punë ndërtimi në volumet e situacionuara.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi 1: Titullari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike në

bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **220,945 lekë** pa TVSh nga “I.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7619 prot, datë 04.07.2022, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Rekomandimi 2: Titullari i Bashkisë Vlorë për zbatimin e kontratave për punë publike, të bëjë emërimin e kolaudatorit apo grupit të kolaudimit, brenda 30 ditëve nga përfundimit i punimeve të ndërtimit për të hapur rrugën e periudhës së garancisë së defekteve të punimeve.

Rekomandimi 3: Titullari i Bashkisë Vlorë mbas përfundimit të zbatimit të kontratave për punë publike, të marrë masa për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të objektit sipas kushteve të kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. **z. D. L.**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Vlorë (Situata 1, 2 dhe 3);
2. **znj. R. N.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve (Situata 1);
3. **znj. V. Ç.**, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve (Situata 2).

Lidhur mbi gjetjen dhe rekomandimin për sa më sipër trajtuar, nuk janë paraqitur observacione.

5. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për kontratat me objekt: “**Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + Sistem ngrohje**”, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + Sistem ngrohje” Vlorë.		
14. Lidhja e kontratës Nr. 1808 prot; datë 01.03.2019 OE “C.” ShPK	15. Vlera e kontratës VI e prev ofertues 44,489,454 lekë me TVSh.	16. Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 4,026,526 lekë me TVSH (pa likuiduar)
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera ---- lekë me TVSH.	18. Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 02.03.2020 Përfundimi punimeve: ----	19. Zgjatja e kontratës -----
20. Mbikëqyrësi i punimeve - OE “H. & SK. 11” ShPK -OE “R. 95” ShPK	Licenca MK. 2018/23 Licenca MK. 1506/10	Kontratë me nr. 2110 prot; datë 31.03.2019 Kontratë me nr. 8341 prot; datë 25.07.2022
21. Kolaudatori i punimeve ---	Licenca Nr: MK.----	Kontratë nr. ----- prot; datë ----
22. Akt Kolaudimi Datë: -	23. Akt i marrjes në dorëzim: Me datë ---	

u konstatuan problematikat si vijon:

Titulli i gjetjes: Penalitet për punime të pa kryera në afatet e kontratës për objektin: “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + Sistem ngrohje”.

Përshkrimi i situatave:

Nga auditimi i dokumentacionit tekniko – ligjor në dosjen teknike të zbatimit, rezultoi si vijon:

1. Në gjykimin e grupit të auditimit, nuk u konstatua asnjë pengesë nga AK për disponimin e kantierit dhe asnjë kërkesë e ligjshme e kontraktorit për të justifikuar mos zbatimin e afatit të përfundimit të punimeve sipas kontratës së sipërmarrjes.

Duke qenë se ndërmjet kontraktori shoqërisë “C.” ShPK dhe Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë nuk është miratuar asnjë shtyrje e afatit të kontratës, pra nuk është kryer asnjë Amendim i Kontratës bazë me nr. 1808 prot; datë 01.03.2019 për objektin “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + sistem ngrohje”, sipas pikës 33.2 të nenit 33 “Vonesa në zbatim dhe zgjatja e afatit”, Autoritetit Kontraktor i lind e drejta që të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim sipas klauzolave të nenit 34 “Dëmet e likujdueshme për vonesën në mbarimin e punimeve” të kontratës, pika 34.1, shkronja (c), ku theksohet: “Për kontratat me periudhë zbatimi mbi 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës korresponduake të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës”.

-Duke pasur parasysh se punimet e ndërtimit duhet të ishin përfunduar në datën 01.06.2019 dhe kanë kaluar **1,505 ditë** nga data kur duhet të kishte përfunduar ndërtimi i investimit [214 ditë për vitin 2019; 366 ditë për vitin 2020; 365 ditë për vitin 2021; 365 ditë për vitin 2022 dhe 195 ditë për vitin 2023] nga palët e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes me nr. 1808 prot; datë 01.03.2019, nuk janë përmbushur kushtet e kësaj kontrate.

-Në Bashkinë Vlorë janë paraqitur faturat elektronike si vijon:

- Faturë elektronike datë 21.09.2022, në vlerën 3,826,171 lekë me TVSH, bashkëlidhur me situacionin pjesor nr. 1 me vlerë 3,826,171 lekë me TVSH, të firmosur nga, Zbatuesi i punimeve shoqëria “C.” ShPK me përfaqësues ligjor znj. D. L. dhe drejtues teknik z. H. L., dhe të pa firmosur nga Mbikëqyrësi i punimeve “H. & SK. 11” ShPK me administrator z. F. B. dhe nga Investitori Bashkia Vlorë përfaqësuar nga z. D. L.
- Faturë elektronike datë 16.01.2023, si detyrim i prapambetur në vlerën **3,517,418** lekë (sipas urdhër – regjistrimi detyrim i prapambetur Nr. 5, datë 30.12.2022), bashkëlidhur me situacionin pjesor nr. 1 me vlerë **3,517,418 lekë**, të firmosur nga zbatuesi i punimeve shoqëria “C.” ShPK me përfaqësues ligjor z. D. L. dhe drejtues teknik z. H. L. dhe, nga Mbikëqyrësi i punimeve shoqëria “R. 95” ShPK me administrator znj. R. N. dhe nga Investitori Bashkia Vlorë përfaqësuar nga z. D. L.

Llogaritja e penalitetit:

-Çmimi total i kontratës është 44,489,454 lekë me TVSH,

-Punime ndërtimi të realizuar sipas situacionit nr. 1, në vlerën 3,517,418 lekë me TVSH,

-Vlera e penalitetit nga llogaritja deri në momentin e dorëzimit të këtij akt-konstatimi, në datën 14.07.2023 për shoqërinë “C.” ShPK, i kontraktuar për zbatimin e investimit me objekt: “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + sistem ngrohje”, rezulton **15,415,728 lekë me TVSH** = [(44,489,454 (vlera e kontratës) – 3,517,418) x 25% x 1505 ditë vonesë x 1/1000, që duhet t’i paguajë Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë. **Kjo vlerë përbën dëm ekonomik për buxhetin e Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë.**

2. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit vërehet se nga palët: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. D. L., Mbikëqyrësi i punimeve shoqëria “H. & SK. 11” ShPK me Administrator z. F. B. (për periudhën përkatëse), sipërmarrësi i punimeve shoqëria “C.” ShPK me Administrator znj. D. L., nuk janë mbajtur dokumentet tekniko – ligjore për objektin “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + sistem ngrohje”, si më poshtë vijon:

- Akt i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, i firmosur nga Sipërmarrësi i punimeve, nga Mbikëqyrësi i punimeve dhe Investitori/Zhvilluesi Bashkia Vlorë.

- Proces verbal mbi fillimin e punimeve, i firmosur nga Sipërmarrësi i punimeve, nga Mbikëqyrësi i punimeve dhe Investitori Bashkia Vlorë.

- Njoftim për fillimin e punimeve, i firmosur nga Sipërmarrësi i punimeve.
- Njoftim për fillimin e punimeve, i firmosur nga Sipërmarrësi i punimeve, Mbikëqyrësi i punimeve, dhe Investitori/zhvilluesi Bashkia Vlorë.
- Proces verbal mbi akt piketimin në objekt dhe lirim të sheshit të ndërtimit, i firmosur nga Sipërmarrësi i punimeve, nga Mbikëqyrësi i punimeve, Projektuesi dhe Investitori Bashkia Vlorë.
- Realizimi i punimeve për Situacionin nr. 1, i firmosur nga Drejtuesi Teknik, Sipërmarrësi i punimeve, Mbikëqyrësi i punimeve dhe Investitori/zhvilluesi Bashkia Vlorë.

Sa më sipër, është në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të KM për “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar me VKM Nr. 610, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”. Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi: **Sipërmarrësi i punimeve, Mbikëqyrësi i punimeve “H. & SK. 11” ShPK dhe Investitori/zhvilluesi Bashkia Vlorë.**

3. Në gjykimin e grupit të auditimit, palët: Sipërmarrësi i punimeve shoqëria “C.” ShPK përfaqësuar nga znj. D. L., Investitori/zhvilluesi Bashkia Vlorë përfaqësuar nga z. D. L., nënshkruesit e kontratës me objekt “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + Sistem ngrohje” me nr. 1808 prot; datë 01.03.2019, **kanë dështuar në realizimin e kontratës me objekt:** “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + sistem ngrohje”.

Palët, duhej të kishin zbatuar:

- Pikën **46.2** të Nenin **46** (Zgjidhja e mosmarrëveshjeve) të kontratës me nr. 1808 prot; datë 01.03.2019, ku thuhet: “Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë”.

- Pikën **22** të kontratës për mbikëqyrje punimesh “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + Sistem ngrohje” me nr. 2110 prot; datë 21.03.2019, të lidhur ndërmjet Bashkisë Vlorë, përfaqësuar nga Kryetari z. D. L. dhe shoqërisë “H. & SK. 11” ShPK e përfaqësuar nga ing. F. B., ku thuhet: “Për çdo mos marrëveshje palët duhet t’i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve”.

Sa më sipër, për veprimet dhe mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi: **Sipërmarrësi i punimeve, Mbikëqyrësi i punimeve “H. & SK. 11” ShPK dhe Investitori/zhvilluesi Bashkia Vlorë.**

Kriteri:

Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”; Kontrata e sipërmarrjes së punimeve me nr. 1808 prot; datë 01.03.2019; Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve me nr. 2110 prot; datë 31.03.2019 dhe, nr. 8341 prot; datë 25.07.2022 .

Ndikimi/Efekti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Vlorë, kolaudimi i vonuar i investimit si dhe nuk është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit.

Shkaku: Mos realizim i kontratës së sipërmarrjes

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi 1: Bashkia Vlorë të kërkojë, ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimin, arkëtimin e shumë **15,415,728 lekë TVSH** nga shoqëria

sipërmarrëse “C.” ShPK, si penalitet për punime të pakryera, parashikuar në afatet e kontratës nr. 1808 prot; datë 01.03.2019, me objekt “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + Sistem ngrohje”.

Rekomandimi 2: Titullari i Bashkisë Vlorë, të marrë masa që të ngrëjë një grup pune me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve shoqërinë “R.95” ShPK, që të vlerësojnë e të analizojnë arsyet dhe shkaqet e mosmarrëveshjeve ose konfliktit mes palëve mbi dështimin e realizimit të kontratës për punë publike me objekt: “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + sistem ngrohje”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë dhe shoqërisë sipërmarrëse “C.” ShPK me nr. 1808 prot; datë 01.03.2019. Në rast të kundërt, Bashkia Vlorë bazuar në Pikën 46.2 të Nenit 46 (Zgjidhja e mosmarrëveshjeve) të kontratës me nr. 1808 prot; datë 01.03.2019, duhet t’i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, në kushtet ku kjo kontratë ka dështuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. z. D. L., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Vlorë.

2. z. F. B., në cilësinë e Mbikëqyrësit të punimeve.

Lidhur mbi problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit, trajtuar sa më sipër, nuk janë paraqitur observacione.

6. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për kontratat me objekt: “*Shërbimi i pastrimit në qytetin Vlorë*”, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

Dosja e zbatimit përmab këto të dhëna të përgjithshme, të paraqitura në tabelën, si vijon:

13. Zbatimi i Kontratës së shërbimit me objekt: “ <i>Shërbimi i pastrimit në qytetin Vlorë</i> ”, Bashkia Vlorë		
14. Lidhja e kontratës Nr. 5227/1 Prot datë 03.07.2020	15. Vlera e kontratës 698,022,984 lekë me Tvsh OE fitues “D.” ShPK	16. Likuiduar: Sit. korrik me vlerë 15,095,816 lekë me TVSH Sit. gusht me vlerë 16,464,440 lekë me TVSH Sit. shtator me vlerë 15,608,848 lekë me TVSH Sit. korrik me vlerë 15,095,816 lekë me TVSH
17- Situacioni për 18 muaj -Vlera -----	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 3 vjet Fillimi i shërbimit: 03.07.2020 Perfundimi shërbimit më datë 03.07.2023	19. Zgjatja e kontratës S’ka
20. Mbikëqyrësi i shërbimit - V. Ç. - Administratorët e Rajoneve Administrative të Bashkisë Vlorë (1,2,3,4,5)		

Grupi i auditimit, duke vlerësuar rëndësinë dhe qëllimin e kontratës së shërbimit me nr. 5227/1 prot; datë 03.07.2020 “Shërbimi i pastrimit në qytetin Vlorë”, bën me dije se nuk mund të kryej një hetim administrativ mbi vendimmarrjen dhe dokumentacionin e administruar në dosjen teknike të zbatimit, pasi çështja është duke u gjykuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë. Në këto kushte, referuar ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, neni 36, paragrafi 3-të i cili përcakton shprehimisht se: “*Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile e cila është duke u gjykuar nga gjykata*”, grupi i auditimit nuk mund të dalë me një konkluzion.

Konkluzion i përgjithshëm mbi zbatimin e kontratave për punë publike:

1. Nga auditimi i 8 (tetë) kontratave për punë publike/shërbime/mallra në vlerën 794,921,380 lekë pa TVSH ose 953,905,656 lekë me TVSH, në 5 (pesë) raste rezultuan zëra pune të pakryera në volumet e situacionuara si dhe penalitete në mos respektim të afateve kohore në vlerën 19,830,420 lekë pa TVSH, respektivisht:

- **Vlera 932,798 lekë pa TVSh**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të pakryera në volumet e situacionuara në kontratën me Nr. 8893 prot; 05.08.2022 me objekt “Furnizim vendosje pajisje për ndriçimin rrugor” me sipërmarrës shoqërinë “S.” ShPK.

- **Vlera 500,000 lekë pa TVSh**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të pakryera në volumet e situacionuara në kontratën me Nr. 8409 prot; 26.05.2021 me objekt “Rikonstruksion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë” me sipërmarrës shoqërinë “B. - X” ShPK.

- **Vlera 190,050 lekë pa TVSh**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të pakryera në volumet e situacionuara në kontratën me Nr. 9412 prot; datë 21.10.2020 me objekt “Ndërtim i ujësjellësit në rrugën Transballkanike Vlorë” me sipërmarrës shoqërinë “Sh. 07” ShPK.

- **Vlera 220,945 lekë pa TVSh**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të pakryera në volumet e situacionuara në kontratën me Nr. 7619 prot; da 04.07.2022 me objekt “Strukturë me pilota për përforcim skarpiti pas godinës së Bashkia Vlorë” me sipërmarrës shoqërinë “I.” ShPK.

- **Vlera 15,415,728 lekë pa TVSh**, përfaqëson dëm ekonomik për penalitet për mos zbatim të afateve kohore në kontratën me Nr. 1808 prot; datë 01.03.2019 me objekt “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + Sistem ngrohje” me sipërmarrës shoqërinë “C.” ShPK

2. Në 3(tre) raste kolaudimi i objekteve nuk është bërë në përputhje me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 12, përkatësisht:

- Kolaudimi i objektit “Rikonstruksion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë” është bërë **5(pesë)** muaj me vonesë.

- Kolaudimi i objektit “Ndërtim i ujësjellësit në rrugën Transballkanike Vlorë” është bërë **1(një)** vit me vonesë.

- Kolaudimi i objektit “Strukturë me pilota për përforcim skarpiti pas godinës së Bashkia Vlorë” është bërë **1(një)** vit me vonesë.

3. Në 3(tre) raste nga AK nuk është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të objekteve në mospërputhje me kushtet e kontrës së sipërmarrjes, respektivisht për objektet:

- “Rikonstruksion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë.

- “Ndërtim i ujësjellësit në rrugën Transballkanike Vlorë”.

- “Strukturë me pilota për përforcim skarpiti pas godinës së Bashkia Vlorë”.

Pika 5 e programit. Mbi zbatimin e procedurave të lejeve të ndërtimit dhe zhvillimit.

Nga auditimi mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit, rezultoi:

Bashkia Vlorë ka të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit, me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) nr. 1, datë 16.10.2017 (e rishikuar me Vendim nr. 4, datë 17.05.2019 dhe Vendim nr. 3, datë 03.12.2020).

Referuar të dhënave në sistemin elektronik *e-lejet* për Bashkinë Vlorë, rezulton se për afatin e auditimit **01.07.2021 deri në 31.12.2022**, ka pasur **1283 aplikime në sistem për lloje të ndryshme lejesh** si: leje zhvillimi, leje ndërtimi, deklarata për kryerje punimesh, leje për ndryshim funksioni, leje për shtesa në objekte ekzistuese, rikonstruksione dhe çertifikata përdorimi, etj., përkatësisht 128 aplikime për leje zhvillimi, 139 për leje ndërtimi, 110 çertifikata

përdorimi, 41 shtyrje afati leje ndërtimi, 660 deklarata paraprake për kryerje punimesh, 53 ndryshime funksioni, 37 rikonstruksione dhe 20 leje infrastrukture, të evidentuara në tabelat përmbledhëse si më poshtë:

Tabela mbi aplikimet e kryera në sistemin e-lejet për periudhën 01.07.2021 – 31.12.2021

Lloji i lejes	Total	Miratuar	Refuzuar
Leje zhvillimi	36	13	23
Leje ndërtimi mbi 250m ²	-	5	-
Leje ndërtimi deri 250m ²	-	7	-
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	199	107	92
Rikonstruksion	4	0	4
Çertifikatë përdorimi	32	12	20
Shtesë në objekt ekzistues deri në 250 m ²	-	5	-
Ndryshim projekti gjatë zbatimit	8	3	5
Ndryshim funksioni	12	4	8
Njoftim fillim punimesh	14	5	9
Shtyrje afati leje ndërtimi	9	5	4
Leje infrastrukture	9	5	4

Burimi: DPKZHT, Bashkia Vlorë

Përpunoi: Grupi i auditimit

Tabela mbi aplikimet e kryera në sistemin e-lejet për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022

Lloji i lejes	Total	Miratuar	Refuzuar
Leje zhvillimi	92	16	76
Leje ndërtimi mbi 250m ²	12	6	6
Leje ndërtimi deri 250m ²	19	7	12
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	461	180	281
Rikonstruksion	33	15	18
Çertifikatë përdorimi	78	36	42
Shtesë në objekt ekzistues deri në 250 m ²	50	27	23
Ndryshim projekti gjatë zbatimit	22	8	14
Ndryshim funksioni	41	15	26
Njoftim fillim punimesh	22	1	21
Shtyrje afati leje ndërtimi	32	15	17
Leje infrastrukture	11	8	3

Burimi: DPKZHT Bashkia Vlorë

Përpunoi: Grupi i auditimit

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga DPKTZH e Bashkisë Vlorë, leje për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m² janë miratuar **11 leje**, leje ndërtimi për ndërtim të ri deri në 250 m² janë miratuar **14 leje**, leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe me të madhe se 250 m² është miratuar **1 leje**, leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m² janë miratuar **32 leje**, ndërsa çertifikata përdorimi janë miratuar **48 të tilla**, të pasqyruara në tabelën e mësipërme.

-Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për t'u audituar rastet e mëposhtme të lejeve të ndërtimit për ndërtime me sipërfaqe deri ose më të madhe se 250 m², si dhe çertifikatat e përdorimit:

Nr.	Objekti	Zhvilluesi	Data e lëshimit të lejes	Preventivi
1	Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimesh me 10 kate dhe një kat parkim nën tokë në BP N.; M.; H.; S. në L."10 Korriku" Vlorë	"A"	14/07/2021	169.309.528,44
2	Leje ndërtimi për strukturë në funksion të bujqësisë për grumbullim dhe ruajtjen e përpunimin e produkteve bujqësore, Vlorë	O. A.	11/08/2021	138.827.697
3	Leje ndërtimi për hotel 1, 2 dhe 3 kate me 1 kat nëntokë	D. Z.	19/10/2021	51.572.375

4	Leje ndërtimi për stallë për mbarështimin e deleve për qumësht	“S. F. G.”	17/12/2021	39.376.359
5	Leje ndërtimi për kompleks shtëpish të dyta me 3 kate, hotel me 5 kate dhe 3 kate nëntokë, në lagjen “Uji i Ftohtë”, Vlorë	H.-P.	31/12/2021	329.343.742,2
6	Leje ndërtimi për rikonstruksion për Qendrën e Kontrollit Teknik në DRSHTRR	DPSHTRR	01/10/2021	-
7	Leje ndërtimi për objekt 8 kat + papafingo, me 1 kat nëntokë, në rr. Ibrahim Avdullai, Vlorë	A. K. ShPK dhe F. H.	26/07/2021	238.269.233
8	Leje ndërtimi për objekte banimi me 6-7 kate dhe 1 kat nën tokë, Orikum, Vlorë.	“M.” ShPK.	09.11.2022	585.884.385
9	Leje ndërtimi për objekt banimi dhe shërbimi me 3 dhe 10 kate mbi tokë dhe papafingo, me 1 kat nën tokë, me adresë në rr. “Gjergj Kastrioti”, Vlorë.	“F. I.” ShPK.	04.10.2022	208.317.722
10	Leje ndërtimi për objekt me funksion agroturizmi 2 kat + 1 kat nënçati dhe 1 kat nëntokë, me adresë në Kaninë, Vlorë.	A. T.	22.02.2022	57.169.713,53
11	Leje ndërtimi për kompleks me funksion hoteleri dhe shtëpi të dyta, me 5 kate dhe 1 kat nën tokë, me adresë në Radhimë, Vlorë.	“I. & AG C.”	16.03.2022	286.919.239
12	Leje ndërtimi për objekt banimi dhe shërbimesh me hoteleri dhe pishina 6-8 kate, me 2 kate nën tokë, me adresë në rr. “Llambro Rexho”, Vlorë.	“T.M.Z.B” ShPK	04.02.2022	413.361.461
13	Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 2-4 kate, me 1 kat nën tokë + parkim + shërbim, me adresë në rr. “Dush Strati”, Vlorë.	A. Sh.	02.09.2022	32.111.472
14	Leje ndërtimi për objekt për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, përfshirë dhe ato për tharjen e trajtimit paraprak të produkteve bujqësore, me adresë në Dukat Fushë, Vlorë	J. H.	20.04.2022	11.489.447
15	Çertifikatë përdorimi për rikonstruksion dhe shtesë kati, objekt banimi 1-2-3-5 kate ,me 1 kat bodrum në lagjen “Isa Boletini”, Vlorë	Dh. Z., Th. V.	30/09/2021	-
16	Çertifikatë përdorimi për kapanon për prodhimin e transformatorëve në Hoshtim, Vlorë	A.-B.	30/09/2021	-
17	Çertifikatë përdorimi për pike karburanti 1 kat, me 1 kat shërbimi nëntokë, në rrugën “Pelivan L.”	B.-O. SHA	18/10/2021	-
18	Çertifikatë përdorimi për strukturë me funksion turistik 4 kate	S.	12/10/2021	-
19	Çertifikatë përdorimi për godinë hoteleri 3 kate me një kat nëntokë, me adresë në Radhimë, Vlorë.	“D.”	09.03.2022	-
20	Çertifikatë përdorimi për banesë 8 kate dhe papafingo, me 1 kat dyqane dhe 1 kat parkim nëntokë, me adresë në lagjen “Hajro Cakerri”, Vlorë.	B.	31.03.2022	-
21	Çertifikatë përdorimi për objekt banimi dhe shërbimi 4-8-9 kate me 1 kat parkim nëntokë, në lagjen “Uji I Ftohtë”, Vlorë.	A. K.	13.04.2022	-
22	Çertifikatë përdorimi për objekt banimi dhe shërbimi në funksion të turizmit, seksioni B, në Radhimë, Vlorë.	D. G.	05.10.2022	-
23	Çertifikatë përdorimi për strukturë ku zhvillohet veprimtari e agroturizmit blegtoral, në Dukat Fushë, Vlorë.	B. M.	24.08.2022	-
24	Çertifikatë përdorimi për ndërtim kompleks për mbarështim lopësh, në Bunavi, Vlorë.	M. C. S.	07.11.2022	-

Nga auditimi i zbatimit të procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, vërehen parregullsitë si më poshtë:

Titulli gjetjes 1: Mosrespektimi i kondicioneve urbane.

Situata: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në dhjetë raste nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë distancat urbane nga

trupi i rrugës së propozuar, distancat urbane midis ndërtimeve, distancat urbane ndërtesë – kufi prone, lartësia maksimale e lejuar e matur me metra dhe numër katesh, përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapsira publike, aksesit për në pronë, lartësia minimale e lejuar për katin përdhe, mangësi në projektin arkitektonik, intensiteti i ndërtimit. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi për objektin "Godinë banimi dhe shërbimesh me 10 kate dhe një kat parkim nën tokë në BP N.; M.; H.; S. në L."10 Korriku" Vlorë" me zhvillues "A" ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- *Objekti i miratuar nuk zbaton distancat urbane nga trupi i rrugës së propozuar;*
- *Objekti i miratuar nuk zbaton distancat urbane midis ndërtimeve;*
- *Objekti i miratuar nuk zbaton lartësinë maksimale të lejuar;*
- *Objekti i miratuar nuk zbaton përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapsira publike.*

2. Leje ndërtimi për objektin "Strukturë në funksion të bujqësisë për grumbullim dhe ruajtjen e përpunimin e produkteve bujqësore, Vlorë " me subjekt zhvillues znj. O. A., me problematika si më poshtë vijon:

- *Aksesi për në pronë është i paqartë, pasi kryhet mbi një pronë tjetër, për të cilën nuk është dhënë informacion dhe nuk është marrë asnjë dakordësi.*

3. Leje ndërtimi për objektin "Hotel 1, 2 dhe 3 kate me 1 kat nëntokë, Vlorë" me subjekt zhvillues z. D. Z., me problematika si më poshtë vijon:

- *Objekti nuk respekton lartësinë minimale të lejuar për katin përdhe;*
- *Objekti nuk respekton përcaktimet ligjore në lidhje me shfrytëzimin e hapsirave publike dhe hapsirave për rrugë.*

4. Leje ndërtimi për objektin "Stallë për mbarështimin e deleve për qumësht" me subjekt zhvillues "S. F. G.", me problematika si më poshtë vijon:

- *Objekti i miratuar nuk zbaton vëllimin maksimal të lejuar për objektet ndihmëse funksionale;*
- *Objekti nuk respekton lartësinë maksimale të lejuar.*

5. Leje ndërtimi për objektin "Kompleks shtëpish të dyta me 3 kate, hotel me 5 kate dhe 3 kate nën tokë, në lagjen Uji i Ftohtë, Vlorë" me subjekt zhvillues "H.-P.", me problematika si më poshtë vijon:

- *Objekti nuk respekton distancat urbane ndërtesë – kufi prone;*
- *Objekti nuk respekton distancat urbane ndërtesë – ndërtesë;*
- *Objekti nuk respekton lartësinë minimale të lejuar për katin përdhe;*
- *Objekti nuk respekton lartësinë maksimale të lejuar, e matur me metra;*
- *Objekti nuk respekton lartësinë maksimale të lejuar, e matur me numër katesh.*

6. Leje ndërtimi për objektin "Objekte banimi me 6-7 kate dhe 1 kat nën tokë, Orikum, Vlorë" me zhvillues "M." ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- *Objekti i miratuar nuk zbaton distancat urbane nga kufiri i pronës.*

7. Leje ndërtimi për "Objekt me funksion agroturizmi 2 kat + 1 kat nënçati dhe 1 kat nëntokë", me adresë Kaninë, Vlorë, me subjekt zhvillues z. A. T., me problematika si më poshtë vijon:

- *Kjo leje ka shkelur kërkesat për plotësimin e infrastrukturës së nevojshme, pasi aksesit për në pronë bëhet duke kaluar nga një pronë tjetër, për të cilën nuk është dhënë informacion dhe nuk është marrë asnjë dakordësi;*
- *Objekti i miratuar nuk respekton Instensitetin e Ndërtimit;*
- *Objekti nuk respekton lartësinë minimale të lejuar për katin përdhe;*

- *Objekti nuk respekton distancat urbane ndërtesë – kufi prone.*

8. Leje ndërtimi për “Kompleks me funksion hoteleri dhe shtëpi të dyta, me 5 kate dhe 1 kat nën tokë”, me adresë Radhimë, Vlorë, me subjekt zhvillues “I. & AG C.”, me problematika si më poshtë vijon:

- *Aksesi për në pronë është i paqartë, pasi kryhet mbi një pronë tjetër, për të cilën nuk është dhënë informacion dhe nuk është marrë asnjë dakordësi.*

- *Objekti nuk respekton lartësinë minimale të lejuar për katin përdhe.*

9. Leje ndërtimi për “Objekt banimi dhe shërbimesh me hoteleri dhe pishina 6-8 kate, me 2 kate nën tokë”, me adresë rr. "Llambro Rexho", Vlorë, me subjekt zhvillues “T.M.Z.B” ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- *Objekti nuk respekton lartësinë minimale të lejuar për katin përdhe;*

- *Objekti nuk respekton distancat urbane ndërtesë – kufi prone;*

- *Objekti nuk respekton distancat urbane ndërtesë – ndërtesë;*

- *Objekti i miratuar nuk zbaton distancat urbane nga trupi i rrugës së propozuar;*

- *Objekti nuk respekton lartësinë maksimale të lejuar, e matur me metra.*

10. Leje ndërtimi për “Godinë banimi dhe shërbimi 2-4 kate, me 1 kat nën tokë + parkim + shërbim”, me adresë rr. "Dush Strati", Vlorë, me subjekt zhvillues znj. A. Sh., me problematika si më poshtë vijon:

- *Objekti nuk respekton distancat urbane ndërtesë – kufi prone;*

- *Objekti nuk respekton distancat urbane ndërtesë – ndërtesë*

Kriteri: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 14; Neni 34, pika 2; Neni 35; Neni 36, pika 3, nënpika b); Neni 37, pika 1, nënpika a) dhe c), pika 3, nënpika c); Ligji 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 38; Neni 45; Rregullorja e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë, e ndryshuar, Neni 42; Neni 46, pika 10; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 283 “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, datë 01.04.2015, paragrafi II.b, pika 1, nënpika a); pika 3, nënpika b).

Ndikimi/Efekti: Mosrespektimi i parametrave urban ndikon në zhvillimin e kontrolluar urban, duke cënuar parametra të përcaktuar në legjislacion dhe rregullore, si dhe duke ndikuar negativisht në stantartet ndërtimore, kushtet e sigurisë, higjenës, ato mjedisore dhe urbanistike.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Vlorë

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë të marrë masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në legjislacionin dhe rregulloret mbi të cilat ky institucion funksionon, të kërkohen të kryhen të gjitha ndryshimet e nevojshme mbi projektet ndërtimore deri në përputhjen e plotë sipas ligjit, në të kundërt, të mos miratohet asnjë leje ndërtimi që nuk i plotëson të gjitha kondicionet urbane të parashikuara.

Për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohen me përgjegjësi: **z. J. Ç.** / drejtor i DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1-5, 7-10); **z. Z. S.** / drejtor i DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 6, 8); **z. R. H.** / specialist pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1-3); **znj. S. A.** / specialiste pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1, 2); **z. K. M.** / specialist pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 3); **z. D. H.** / specialist pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 4); **znj. E. N.** /

specialiste pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet 4, 5, 7, 8, 9); z. M. K. / specialist pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet 5, 7, 8, 9); z. D. L. / kryetar i Bashkisë Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1-10).

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1026/26 prot; datë 26.07.2023, është observuar mbi aktet e konstatimeve të dorëzuara në zyrën e protokollit të Bashkisë Vlorë nga z. Z. S., me detyrë ish-drejtor i DPKZHT dhe funksionarët e DPKZHT me anë të shkresës nr. 8688/1 prot; datë 21.07.2023. Në vazhdim, është observuar mbi projekt-raportin e auditimit nga funksionarët dhe ish-funksionarët e Bashkisë Vlorë, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1026/29 prot; datë 03.11.2023, me anë të shkresës me nr. 11597 prot; datë 27.10.2023. Për të gjitha ato raste kur observacioni është i njëjtë apo nuk ka dokumentacion ose argumentim të shtuar, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshin dhe nuk do të përfshihen në dokumentin e raportit të auditimit.

1.1 Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me mosrespektimin e kondicioneve urbane, është observuar nga z. R. H., ish-funksionar i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT), Bashkia Vlorë, duke argumentuar se në periudhën kohore 23.02.2021 deri më 15.11.2021, z. H. ka qenë i komanduar në rolin e “kontrolluesit” në sistemin e-lejet. Roli i kontrolluesit është të rishikojë aplikimet që dërgon “nëpunësi” dhe më pas i dërgon tek “drejtuesi” për konfirmim.

1.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin tuaj, shprehemi se, qëllimi i kontrollit të dokumentacionit në disa shkallë është shmangia e gabimeve njerëzore, si dhe eliminimi i risqeve të tjera, në funksion të zbatimit të ligjit dhe dispozitave rregullatore. Roli i “kontrolluesit”, siç është përmendur edhe në argumentimin tuaj, është rishikimi i dokumentacionit, me qëllim dërgimin e praktikës së saktë dhe të plotë tek “drejtuesi”. Miratimi i këtyre praktikave, është në kundërshtim me bazën ligjore të cituar në fragmentin e gjetjeve, si rrjedhim, shprehemi se nuk janë respektuar kriteret ligjore nga personat përgjegjës për shqyrtimin e aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Titulli gjetjes 2: Mosrespektimi i kontributit që sektori privat duhet të ofrojë përkundrejt fondit publik të banesave sociale.

Situata: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në pesë raste nuk janë respektuar përcaktimet ligjore në lidhje me kontributin që sektori privat duhet të ofrojë përkundrejt fondit publik të banesave sociale, me mungesën e kontratës midis palëve për evidentimin e sipërfaqes së përfituar, si dhe me kontributin e përfituar nga subjektet të cilat kanë përdorur të drejtën e ndërtimit me intensitet me kusht. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi për objektin “Godinë banimi dhe shërbimesh me 10 kate dhe një kat parkim nën tokë në BP N.; M.; H.; S. në L."10 Korriku" Vlorë” me zhvillues “A” ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- *Bashkia Vlorë dhe DPKZHT nuk kanë hartuar kontratën me zhvilluesin për përcaktimin e kushteve, për përfitimin e hapsirave në favor të fondit publik të banesave sociale.*

2. Leje ndërtimi për objektin “Kompleks shtëpish të dyta me 3 kate, hotel me 5 kate dhe 3 kate nën tokë, në lagjen Uji iFtohte, Vlorë” me subjekt zhvillues “H.-P.”, me problematika si më poshtë vijon:

- Bashkia Vlorë dhe DPKZHT nuk kanë hartuar kontratën me zhvilluesin për përcaktimin e kushteve, për përfitim të hapsirave në favor të fondit publik të banesave sociale.

3. Leje ndërtimi për objektin "Objekte banimi me 6-7 kate dhe 1 kat nën tokë, Orikum, Vlorë" me zhvillues "M." ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- Bashkia Vlorë dhe DPKZHT nuk kanë hartuar kontratën me zhvilluesin për përcaktimin e kushteve, për përfitim të hapsirave në favor të fondit publik të banesave sociale.

4. Leje ndërtimi për objektin "Objekt banimi dhe shërbimi me 3 dhe 10 kate mbi tokë dhe papafingo, me 1 kat nën tokë" me adresë rr. "Gjergj Kastrioti", Vlorë, me subjekt zhvillues "F. I." ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- Zhvilluesi është objekt i Intensitetit të Ndërtimit me Kusht (nga shfrytëzimi i kësaj të drejte, Bashkia Vlorë do të duhej të përfitonte një sipërfaqe prej 299.86 m² (me vlerë shitjeje 299.86 m² * 61.800 lekë/m² = 18.531.348 lekë). Palët kanë rënë dakort që ky përfitim të merret si investim publik, më konkretisht, si investim për rehabilitimin e rrugës "Xher Rashimi". Sipas marrëveshjes midis Bashkisë Vlorë dhe subjektit zhvillues "F. I." ShPK, datë 04.04.2022, nr. 2145/1 prot., DPKZHT ka përpiluar projektin për rehabilitimin e rrugës, duke e preventivuar atë me vlerë totale prej 8.633.559 lekë. Rezulton se vlera e shitjes së sipërfaqes së përfitur nga Bashkia Vlorë është më e madhe se vlera e preventivuar për rrugën "Xher Rashimi", më konkretisht, diferenca është 9.897.789 lekë, vlerë e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Vlorë.

- Bashkia Vlorë dhe DPKZHT nuk kanë hartuar kontratën me zhvilluesin për përcaktimin e kushteve, për përfitim të hapsirave në favor të fondit publik të banesave sociale.

5. Leje ndërtimi për "Objekt banimi dhe shërbimesh me hoteleri dhe pishina 6-8 kate, me 2 kate nën tokë", me adresë rr. "Llambro Rexho", Vlorë, me subjekt zhvillues "T.M.Z.B" ShPK., me problematika si më poshtë vijon:

- Bashkia Vlorë dhe DPKZHT nuk kanë hartuar kontratën me zhvilluesin për përcaktimin e kushteve, për përfitim të hapsirave në favor të fondit publik të banesave sociale.

Kriteri: Ligji 22/2018 "Për strehim social", datë 03.05.2018, Neni 19, pika 1.

Ndikimi/Efekti: Mangësitë në dokumentacionin e kontributit që sektori privat duhet të ofrojë përkundërt fondit publik të banesave sociale, cenojnë detyrimin e përfitimit të tij, si dhe ndikojnë buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe Fondit Publik të Banesave Sociale.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Vlorë

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë të marrë masa për përfitim të kontributit që sektori privat duhet të ofrojë përkundërt fondit publik të banesave sociale sipas parashikimeve ligjore, hartimin e kontratave midis palëve përpara miratimit të lejes së ndërtimit, si dhe të marrë masat që ky përfitim të jetë i barabartë me vlerën e shitjes, për ato raste kur kontributi nuk përfitohet si sipërfaqe e banueshme, por si investim publik.

Për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohen me përgjegjësi: **z. J. Ç.** / drejtor i DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1, 2, 4, 5); **z. Z. S.** / drejtor i DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 3); **z. R. H.** / specialist pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1); **znj. S. A.** / specialiste pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1); **z. M. K.** / specialist pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 2, 5); **znj. E. N.** / specialiste pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet 2, 5); **z. D. L.** / kryetar i Bashkisë Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1-5).

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1026/26 prot; datë 26.07.2023, është observuar mbi aktet e konstatimeve të dorëzuara në zyrën e protokollit të Bashkisë Vlorë nga z. Z. S., me detyrë ish-drejtor i DPKZHT dhe funksionarët e DPKZHT me anë të shkresës nr. 8688/1 prot; datë 21.07.2023. Në vazhdim, është observuar mbi projekt-raportin e auditimit nga funksionarët dhe ish-funksionarët e Bashkisë Vlorë, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1026/29 prot; datë 03.11.2023, me anë të shkresës me nr. 11597 prot; datë 27.10.2023. Për të gjitha ato raste kur observacioni është i njëjtë apo nuk ka dokumentacion ose argumentim të shtuar, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshin dhe nuk do të përfshihen në dokumentin e raportit të auditimit.

1.1 Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me mosrespektimin e kondicioneve urbane, është observuar nga z. R. H., ish-funksionar i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT), Bashkia Vlorë, duke argumentuar se në periudhën kohore 23.02.2021 deri më 15.11.2021, z. H. ka qenë i komanduar në rolin e "kontrolluesit" në sistemin e-lejet. Roli i kontrolluesit është të rishikojë aplikimet që dërgon "nëpunësi" dhe më pas i dërgon tek "drejtuesi" për konfirmim.

1.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin tuaj, shprehemi se, qëllimi i kontrollit të dokumentacionit në disa shkallë është shmangia e gabimeve njerëzore, si dhe eliminimi i risqeve të tjera, në funksion të zbatimit të ligjit dhe dispozitave rregullatore. Roli i "kontrolluesit", siç është përmendur edhe në argumentimin tuaj, është rishikimi i dokumentacionit, me qëllim dërgimin e praktikës së saktë dhe të plotë tek "drejtuesi". Miratimi i këtyre praktikave, është në kundërshtim me bazën ligjore të cituar në fragmentin e gjetjeve, si rrjedhim, shprehemi se nuk janë respektuar kriteret ligjore nga personat përgjegjës për shqyrtimin e aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Titulli gjetjes 3: Mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqëruar të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj për pajisjen me leje ndërtimi.

Situata: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 12 raste të audituara, projekti ndërtimor nuk është i plotë, si dhe mungon dokumentacioni shoqëruar, më konkretisht:

1. Leje ndërtimi për objektin "Strukturë në funksion të bujqesisë për grumbullim dhe ruajtjen e përpunimin e produkteve bujqësore, Vlorë " me subjekt zhvillues znj. O. A., me problematika si më poshtë vijon:

- Rilevimi nuk paraqet të dhëna mbi rrugët, gjerësinë e tyre, madhësinë e pronës e paraqitur me dimensione, koordinatat e kufirit të pasurisë, të dhëna në raport me kanalën kullues dhe lumin që kalon në pjesën Veri – Perëndimore të pronës.

2. Leje ndërtimi për objektin "Stallë për mbarështimin e deleve për qumësht" me subjekt zhvillues "S. F. G.", me problematika si më poshtë vijon:

- Projekti arkitektonik nuk është i plotësuar me të gjitha detajet e domosdoshme, vihet re se mungojnë prerje, detaje dhe dimensionim të objekteve ndihmëse funksionale.

- Projekti arkitektonik nuk është i njëjtë përgjatë gjithë dokumentacionit të ngarkuar elektronikisht.

3. Leje ndërtimi për objektin "Hotel 1, 2 dhe 3 kate me 1 kat nëntokë, Vlorë" me subjekt zhvillues z. D. Z., me problematika si më poshtë vijon:

- *Projekti arkitektonik është jo – i plotë, mungon fasada lindore.*

4. Leje ndërtimi për rikonstrukcion për objektin "Rikonstrukcion për Qendrën e Kontrollit Teknik në DRSHTRR, Vlorë" me subjekt zhvillues DPSHTRR, me problematika si më poshtë vijon:

- *Miratim i lejes së ndërtimit në kushtet e mosplotësimin të kërkesave të vendosura nga vet Bashkia Vlorë, siç janë fatura dhe aktet që provojnë pagimin e taksës së Vlerësimit të Projektit të MKZ-së dhe licenca profesionale e ekspertit zjarrfikës.*

5. Leje ndërtimi për objektin "Godinë banimi dhe shërbimi 8 kate + papafingo me 1 kat nëntokë, në rrugën 'Ibrahim Avdullai', Bashkia Vlorë" me subjekt zhvillues A. K. ShPK dhe z. F. H., me problematika si më poshtë vijon:

- *Mungon deklarata e projektuesit të licencuar për studimin sizmik;*

- *Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për projektin arkitektonik dhe për relacionin e studimit sizmik.*

- *Mungon relacioni teknik për projektin konstruktiv;*

- *Mungon raporti i eficiencës energjetike;*

- *Mungon dokumentacioni që vërteton statusin aktiv të subjekteve.*

6. Leje ndërtimi për objektin "Objekte banimi me 6-7 kate dhe 1 kat nën tokë, Orikum, Vlorë" me zhvillues "M." ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- *Rilevimi nuk paraqet të dhëna mbi rrugët, gjerësinë e tyre, madhësinë e pronës e paraqitur me dimensione, koordinatat e kufirit të pasurisë, asnjë informacion në lidhje me objektet kufitare, distancat dhe lartësinë e matur me numër katesh;*

- *Subjekti zhvillues nuk ka ngarkuar licencat e ndërtimit dhe vërtetimet që nuk ka detyrime të papaguara;*

- *Mungon projekti ndërtimor në formatin DWG.*

7. Leje ndërtimi për objektin "Objekt banimi dhe shërbimi me 3 dhe 10 kate mbi tokë dhe papafingo, me 1 kat nën tokë" me adresë rr. "Gjergj Kastrioti", Vlorë, me subjekt zhvillues "F. I." ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- *Mungon projekti ndërtimor në formatin DWG;*

- *Bashkia Vlorë dhe DPKZHT nuk kanë respektuar pikat e marrëveshjes me subjektin zhvillues, përfitues i zhvillimit të objektit me Intensitet me Kusht.*

8. Leje ndërtimi për "Objekt me funksion agroturizmi 2 kat + 1 kat nënçati dhe 1 kat nëntokë", me adresë Kaninë, Vlorë, me subjekt zhvillues z. A. T., me problematika si më poshtë vijon:

- *Subjekti ndërtues nuk ka ngarkuar licencat e ndërtimit dhe vërtetimet që nuk ka detyrime të papaguara;*

- *Mungon polica e sigurimit e ekspertit privat zjarrfikës;*

- *Mungon Çertifikatës e Regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit për projektin e instalimeve ngrohje – ftohje dhe raportin gjeologo – inxhinierik.*

9. Leje ndërtimi për "Kompleks me funksion hoteleri dhe shtëpi të dyta, me 5 kate dhe 1 kat nën tokë", me adresë Radhimë, Vlorë, me subjekt zhvillues "I. & AG C.", me problematika si më poshtë vijon:

- *Mungon projekti ndërtimor në formatin DWG;*

- *Mungon studimi sizmik dhe gjeologjik;*

- *Mungon dokumenti për delegim kompetencash, midis Bashkisë Vlorë dhe KKT;*

- *Mungon oponenca teknike.*

10. Leje ndërtimi për “Objekt banimi dhe shërbimesh me hoteleri dhe pishina 6-8 kate, me 2 kate nën tokë”, me adresë rr. " Llambro Rexho", Vlorë, me subjekt zhvillues “T.M.Z.B” ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- Kartelat e pasurisë së paluajtshme nuk janë ngarkuar të azhornuara gjatë 3 muajve të fundit;
- Miratim i lejes së ndërtimit në kushtet e mosplotësisë të kërkesave të vet Bashkisë Vlorë.

11. Leje ndërtimi për “Godinë banimi dhe shërbimi 2-4 kate, me 1 kat nën tokë + parkim + shërbim”, me adresë rr. " Dush Strati", Vlorë, me subjekt zhvillues znj. A. Sh., me problematika si më poshtë vijon:

- Mungon projekti ndërtimor në formatin DWG;
- Mungon aksesi për në parkimin nëntokësor.

12. Leje ndërtimi për “Objekt për grumbullimin, rruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, perfshire dhe ato për tharjen e trajtimin paraprak të produkteve bujqësore ", me adresë në Dukat Fushë, Vlorë, me subjekt zhvillues z. J. H., me problematika si më poshtë vijon:

- Preventivi i punimeve është i paplotë, mungojnë çmimet për pjesën më të madhe të zërave;
- Mungon studimi sizmik dhe gjeologjik;
- Mungon Çertifikatë e Regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit për Hartuesit e projekteve konkretisht: Projekti arkitektonik, projekti konstruktiv, projekti elektrik, projekti hidraulik dhe MNZ, plan rilevimi;

- Mungon licenca profesionale dhe deklarata e përgjegjësisë profesionale si dhe, polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hatuesin e projektit të instalimeve të ngrohje – ftohjes.

Kriteri: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 10, Neni 15, Neni 41; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 457 “Për disa ndryshime në...”, datë 29.6.2022; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1162, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun...”, Shtojca 1”.

Ndikimi/Efekt: Mangësitë në projektin ndërtimor, si dhe në dokumentacionin shoqërues të tij, ndikojnë në cilësinë dhe garatimin e ndërtimeve sipas standarteve, kushteve higjeno-sanitare dhe të sigurisë, nga subjekte të cilat duhet të plotësojnë kriteret e ushtrimit të profesionit, sipas legjislacionit në fuqi.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Vlorë

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë të marrë të gjitha masat e duhura, që në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, të kërkohet prej saj i gjithë dokumentacioni i nevojshëm dhe të detyrueshëm, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi, si dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi me mangësi të tilla. DPKZHT dhe Bashkia Vlorë të marrin masa për të kontrolluar të gjithë dokumentacionin e dorëzuar mbi saktësinë dhe plotësinë e tij.

Për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohen me përgjegjësi: **z. J. Ç.** / drejtor i DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1 – 5; 7 - 12); **z. Z. S.** / drejtor i DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 6, 9); **z. R. H.** / specialist pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1,3,4); **znj. S. A.** / specialiste pranë DPKZHT Vlorë (Për lejen e ndërtimit 1); **znj. E. N.** / specialiste pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet 2, 8, 9, 10, 12); **z. D. H.** / specialist pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 2, 12); **z. K. M.** / specialist pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet 3, 4); **z. M. K.** / specialist pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet 8, 9, 10); **z. D. L.** / kryetar i Bashkisë Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1-12).

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1026/26 prot; datë 26.07.2023, është observuar mbi aktet e konstatimeve të dorëzuara në zyrën e protokollit të Bashkisë Vlorë nga z. Z. S., me detyrë ish-drejtor i DPKZHT dhe funksionarët e DPKZHT me anë të shkresës nr. 8688/1 prot; datë 21.07.2023. Grupi i auditimit është përgjigjur dhe ka argumentuar qëndrimin e tij në dokumentin e projekt-raportit të auditimit. Në vazhdim, është observuar mbi projekt-raportin e auditimit nga funksionarët dhe ish-funksionarët e Bashkisë Vlorë, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1026/29 prot; datë 03.11.2023, me anë të shkresës me nr. 11597 prot; datë 27.10.2023. Për të gjitha ato raste kur observacioni është i njëjtë apo nuk ka dokumentacion ose argumentim të shtuar, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshin dhe nuk do të përfshihen në dokumentin e raportit të auditimit.

1.1 Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me mosrespektimin e kondicioneve urbane, është observuar nga z. R. H., ish-funksionar i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT), Bashkia Vlorë, duke argumentuar se në periudhën kohore 23.02.2021 deri më 15.11.2021, z. H. ka qenë i komanduar në rolin e "kontrolluesit" në sistemin e-lejet. Roli i kontrolluesit është të rishikojë aplikimet që dërgon "nëpunësi" dhe më pas i dërgon tek "drejtuesi" për konfirmim. Gjithashtu, sqarojnë se, nga ana teknike, një dokument i prodhuar nga topografi i licensuar ka shkallën matese të hartimit, dhe çdo distancë mund të matet nga specialisti duke përllogaritur shkallën e hartimit edhe nëse ajo nuk është e shenuar.

1.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin tuaj, shprehemi se, qëllimi i kontrollit të dokumentacionit në disa shkallë është shmangia e gabimeve njerëzore, si dhe eliminimi i risqeve të tjera, në funksion të zbatimit të ligjit dhe dispozitave rregullatore. Roli i "kontrolluesit", siç është përmendur edhe në argumentimin tuaj, është rishikimi i dokumentacionit, me qëllim dërgimin e praktikës së saktë dhe të plotë tek "drejtuesi". Miratimi i këtyre praktikave, është në kundërshtim me bazën ligjore të cituar në fragmentin e gjetjeve, si rrjedhim, shprehemi se nuk janë respektuar kriteret ligjore nga personat përgjegjës për shqyrtimin e aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi. Gjithashtu, fakti se, një dokument i prodhuar nga topografi i licensuar ka shkallën matese të hartimit, nuk jep garanci të plotë se këto matje janë kryer nga ana e specialistit. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Titulli gjetjes 4: Në 2 (dy) raste, një pjesë e dokumentacionit të nevojshëm dhe të detyrueshëm për aplikim për pajisje me leje ndërtimi, nuk ka kaluar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.

Situata: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në dy raste, një pjesë e dokumentacionit të nevojshëm dhe të detyrueshëm për aplikim për pajisje me leje ndërtimi, nuk ka kaluar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, por është marrë dorazi, më konkretisht:

1. Leje ndërtimi për objektin "Hotel 1, 2 dhe 3 kate me 1 kat nëntokë, Vlorë" me subjekt zhvillues z. D. Z., me problematika si më poshtë vijon:

- Aplikanti nuk ka ngarkuar dokumentat që vërtetojnë jashtëligjshmërinë e objektit kufitar me objektin në zhvillim, për të justifikuar mosrespektimin e distancave urbane ndërmjet tyre.

2. Leje ndërtimi për rikonstruksion për objektin "Rikonstruksion për Qendrën e Kontrollit Teknik në DPSHTRR, Vlorë" me subjekt zhvillues DPSHTRR, me problematika si më poshtë vijon:

- Dorëzimi i dokumentit të preventivit dorazi, dhe jo nëpërmjet sistemit të lejeve.

Kriteri: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 45/1, pika 3.

Ndikimi/Efekti: Marrja në konsideratë e dokumentave të procedurave të aplikimit për pajisje me leje ndërtimi, nga një burim që nuk është sistemi elektronik i lejeve, ndikon në vërtetësinë e këtij dokumentacioni, ndikon në trajtimin e barabartë të të gjithë aplikanteve, si dhe në transparencën që proces duhet të reflektojë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Vlorë

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë të marrë masa për të mos marrë në konsideratë asnjë dokumentacion që nuk kalon nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve. Dokumentet që nuk kalojnë nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve duhet të konsiderohen të pavlefshme dhe të mos merren parasysh.

Për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohen me përgjegjësi: **z. J. Ç.** / drejtor i DPKZHT Vlorë; **z. R. H.** / specialist pranë DPKZHT Vlorë; **z. K. M.** / specialist pranë DPKZHT Vlorë; **z. D. L.** / kryetar i Bashkisë Vlorë.

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1026/26 prot; datë 26.07.2023, është observuar mbi aktet e konstatimeve të dorëzuara në zyrën e protokollit të Bashkisë Vlorë nga z. Z. S., me detyrë ish-drejtor i DPKZHT dhe funksionarët e DPKZHT me anë të shkresës nr. 8688/1 prot; datë 21.07.2023. Grupi i auditimit është përgjigjur dhe ka argumentuar qëndrimin e tij në dokumentin e projekt-raportit të auditimit. Në vazhdim, është observuar mbi projekt-raportin e auditimit nga funksionarët dhe ish-funksionarët e Bashkisë Vlorë, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1026/29 prot; datë 03.11.2023, me anë të shkresës me nr. 11597 prot; datë 27.10.2023. Për të gjitha ato raste kur observacioni është i njëjtë apo nuk ka dokumentacion ose argumentim të shtuar, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshin dhe nuk do të përfshihen në dokumentin e raportit të auditimit.

1.1 Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me mosrespektimin e kondicioneve urbane, është observuar nga z. R. H., ish-funksionar i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT), Bashkia Vlorë, duke argumentuar se në periudhën kohore 23.02.2021 deri më 15.11.2021, z. H. ka qenë i komanduar në rolin e “kontrolluesit” në sistemin e-lejet. Roli i kontrolluesit është të rishikojë aplikimet që dërgon “nëpunësi” dhe më pas i dërgon tek “drejtuesi” për konfirmim.

1.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin tuaj, shprehem se, qëllimi i kontrollit të dokumentacionit në disa shkallë është shmangia e gabimeve njerëzore, si dhe eliminimi i risqeve të tjera, në funksion të zbatimit të ligjit dhe dispozitave rregullatore. Roli i “kontrolluesit”, siç është përmendur edhe në argumentimin tuaj, është rishikimi i dokumentacionit, me qëllim dërgimin e praktikës së saktë dhe të plotë tek “drejtuesi”. Miratimi i këtyre praktikave, është në kundërshtim me bazën ligjore të cituar në fragmentin e gjetjeve, si rrjedhim, shprehem se nuk janë respektuar kriteret ligjore nga personat përgjegjës për shqyrtimin e aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Titulli gjetjes 5: DPKZHT dhe Bashkia Vlorë nuk ka kërkuar mendimin e autoriteteve të tjera publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, nuk janë respektuar

vendimet që rregullojnë veprimtarinë ndërtimore pranë zonave të mbrojtura dhe zonave me përparësi zhvillimin e turizmit.

Situata: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 6 raste, DPKZHT dhe Bashkia Vlorë nuk ka kërkuar mendimin e autoriteteve të tjera publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, nuk janë respektuar vendimet që rregullojnë veprimtarinë ndërtimore pranë zonave të mbrojtura dhe zonave me përparësi zhvillimin e turizmit, më konkretisht:

1. Leje ndërtimi për objektin "Godinë banimi dhe shërbimi 8 kate + papafingo me 1 kat nëntokë, në rrugën 'Ibrahim Avdullai', Bashkia Vlorë" me subjekt zhvillues A. K. ShPK dhe z. F. H., me problematika si më poshtë vijon:

- *Leja e ndërtimit në fjalë, është miratuar me vendim të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, edhe pse në këto kushte, ky fakt nuk shuan detyrimin e kërkesës së mendimit ndaj autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje me lejet e ndërtimit.*

2. Leje ndërtimi për objektin "Objekte banimi me 6-7 kate dhe 1 kat nën tokë, Orikum, Vlorë" me zhvillues "M." ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- *Nuk i është kërkuar mendim Agjencisë Kombëtare për Zonat e Mbrojtura (AKZM), Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM), si dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST).*

3. Leje ndërtimi për objektin "Objekt banimi dhe shërbimi me 3 dhe 10 kate mbi tokë dhe papafingo, me 1 kat nën tokë" me adresë rr. "Gjergj Kastrioti", Vlorë, me subjekt zhvillues "F. I." ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- *DPKZHT Vlorë nuk i ka kërkuar mendim AKZM-së dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, duke mos respektuar përcaktimet e Vendimit 41 të KKT-së, datë 03.12.2020.*

4. Leje ndërtimi për "Kompleks me funksion hoteleri dhe shtëpi të dyta, me 5 kate dhe 1 kat nën tokë", me adresë Radhimë, Vlorë, me subjekt zhvillues "I. & AG C.", me problematika si më poshtë vijon:

- *DPKZHT Vlorë nuk i ka kërkuar mendim AKZM-së dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, duke mos respektuar përcaktimet e Vendimit 41 të KKT-së, datë 03.12.2020.*

5. Leje ndërtimi për "Objekt banimi dhe shërbimesh me hoteleri dhe pishina 6-8 kate, me 2 kate nën tokë", me adresë rr. "Llambro Rexho", Vlorë, me subjekt zhvillues "T.M.Z.B" ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- *Nuk i është kërkuar mendim OST dhe AKZM.*

6. Leje ndërtimi për "Objekt për grumbullimin, rruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, perfshire dhe ato për tharjen e trajtimin paraprak të produkteve bujqësore ", me adresë në Dukat Fushë, Vlorë, me subjekt zhvillues z. J. H..

- *Nuk i është kërkuar mendim Ujësjellës Kanalizime Vlorë (UKV), si dhe Agjencisë për Eficencën e Energjisë (AEE).*

Kriteri: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 10/1 "Shqyrtimi i kërkesave për leje zhvillimi", pika 6.

Ndikimi/Efekti: Mosmarrja e mendimit nga të gjithë autoritetet të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, ndikon në zhvillimin e pakontrolluar dhe të paplanifikuar të territorit, çënon kompetencat e që ligji ju njeh këtyre autoriteteve, si dhe çënon infrastrukturën dhe projektet e këtyre autoriteteve.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Vlorë

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë të marrë të gjitha masat e duhura, që në çdo rast që aplikohet për t'u pajisur me leje ndërtimi, të kërkohet mendimi i autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, sipas rastit. Gjithashtu, DPKZHT Vlorë, si autoriteti i planifikimit në një zonë me përparësi zhvillimin e turizmit, duhet të respektojë të gjitha përcaktimet e kuadrit ligjor në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit në këto zona.

Për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohen me përgjegjësi: **z. J. Ç.** / drejtor i DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1, 3, 4, 5, 6); **z. Z. S.** / drejtor i DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 2, 5); **z. M. K.** / specialist pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 4, 5); **z. D. H.** / specialist pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 6); **znj. E. N.** / specialiste pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet 4 - 6); **z. D. L.** / kryetar i Bashkisë Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1 - 6).

Titulli gjetjes 6: Përlllogaritje e gabuar dhe me mungesë dokumentacioni e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Situata: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 3 raste të audituara, përlllogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është e saktë, si dhe një njërin prej këtyre rasteve, ka mangësi në dokumentacion, më konkretisht:

1. Leje ndërtimi për objektin "Godinë banimi dhe shërbimi 8 kate + papafingo me 1 kat nëntokë, në rrugën 'Ibrahim Avdullai', Bashkia Vlorë" me subjekt zhvillues A. K. ShPK dhe z. F. H., me problematika si më poshtë vijon:

- Taksa e ndikimit në infrastrukturë përlllogaritet me dy mënyra, mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet, dhe merret në konsideratë mënyra me vlerën më të madhe. Për këtë objekt është paraqitur preventivi me vlerë 238.269.233 lekë. Më poshtë po kryejmë përlllogaritjen me të dyja mënyrat:

Mbi çmimin referencë: $4\% * [(61.800 \text{ lekë} * 7K * 6546.49 \text{ m}^2) + (0.7 * 61.800 \text{ lekë} * 835.19 \text{ m}^2) + (1.5 * 61.800 \text{ lekë} * 835.18 \text{ m}^2)] = 20.725.020,6 \text{ lekë}$

Mbi preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet: $4\% * 238.269.233 \text{ lekë} = 9.530.769,32 \text{ lekë}$.

Metoda që do të merret në konsideratë është ajo mbi çmimin referencë, pra vlera e saktë e taksës së ndikimit në infrastrukturë do të ishte 20.725.020,6 lekë. Vlera e llogaritur nga Bashkia Vlorë me mungesë prej 12.670.220,9 lekë përbën arkëtim të munguar për institucionin e Bashkisë Vlorë.

2. Leje ndërtimi për "Kompleks me funksion hoteleri dhe shtëpi të dyta, me 5 kate dhe 1 kat nën tokë", me adresë Radhimë, Vlorë, me subjekt zhvillues "I. & AG C.", me problematika si më poshtë vijon:

- Mungon dokumentacioni justifikues i pagesës së plotë të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, pasi është ngarkuar në sistem mandat-pagesa për 6,170.69 lekë, nga 11,216,170.69 lekë, e cila është vlera totale e përlllogaritur nga Bashkia Vlorë.

- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është përlllogaritur e saktë. Vlera e TNI-së për këtë objekt, sipas Bashkisë Vlorë, është 11.216.170,69 lekë. Vlera e skatë e TNI-së, rillogaritur nga grupi i auditimit është 11,662,928.9 lekë. Vlen të theksohet se, siç është përmendur edhe më sipër, nuk është vërtetuar se subjekti zhvillues e ka paguar të plotë vlerën e TNI-së (sipas përlllogaritjes së Bashkisë Vlorë), pasi në sistem është ngarkuar mandat-pagesa vetëm për një pjesë të saj (për 6,170.69 lekë). Nëse Bashkia Vlorë vendos në dispozicion të grupit të auditimit mandat-pagesën për pjesën e mbetur prej 11.210.000 lekë, atëherë do të konsiderohet e ardhur e munguar vlera

prej 446.758,21 lekë. Nëse Bashkia Vlorë nuk e vendos në dispozicion këtë mandat – pagesë, vlera që do të konsiderohet e ardhur e munguar do të jetë 11,662,928.9 lekë - 6,170.69 lekë = 11.656.758,21 lekë.

3. Leje ndërtimi për “Objekt banimi dhe shërbimesh me hoteleri dhe pishina 6-8 kate, me 2 kate nën tokë”, me adresë rr. " Llambro Rexho", Vlorë, me subjekt zhvillues “T.M.Z.B” ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është përlllogaritur e saktë. Vlera e TNI-së për këtë objekt, sipas Bashkisë Vlorë, është 16.500.515,5 lekë. Nga tabela e përlllogaritjes së TNI-së nga ana e Bashkisë Vlorë, marrim informacionin se kjo taksë është përlllogaritur me dy mënyra, për hapsirat e banimit dhe për hapsirat e dedikuara për shërbime turistike (hotel). Nga këqyrja e kryer mbi projektin arkitektonik, rezulton se ky objekt nuk respekton parashikimet ligjore në lidhje me objektet që klasifikohen si hoteleri, pasi nuk plotëson kriteret e VKM-së nr. 730, datë 20.10.2016, i ndryshuar. Vlen të theksohet se të gjitha planimetritë e apartamente ose dhomave (nëse do t'i quajmë të tilla), nuk ndryshojnë në asnjë rast, nga ato të dedikuara për hotel tek ato të dedikuara për banim. Nga përlllogaritja e kryer, duke i konsideruar të gjitha hapsirat të dedikuara për banim, si rezulton nga projekti arkitektonik, vlera e saktë e TNI-së do të ishte 31.956.532,6 lekë. Diferenca prej 15.456.017,1 lekë përbën të ardhur të munguar institucionin e Bashkisë Vlorë.*

Kriteri: Ligji 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 46; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 730, datë 20.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifatat...”, i ndryshuar. Për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohen me përgjegjësi: **z. J. Ç.** / drejtor i DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1, 2, 3); **z. Z. S.** / drejtor i DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 2); **z. R. H.** / specialist pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 2); **znj. N. R.** / specialiste pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 3); **z. D. L.** / kryetar i Bashkisë Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1, 2, 3).

Ndikimi/Efekti: Mungesa e dokumentacionit justifikues për vërtetimin e pagesës së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë ndikon në marrjen e sigurisë së plotë mbi arkëtkimin ose jo të kësaj takse. Përlllogaritja e gabuar e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë ndikon negativisht në buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Vlorë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: DPKZHT Bashkia Vlorë të marrë masa të mos miratojë asnjë leje ndërtimi deri në marrjen e sigurisë së plotë mbi pagesën e saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë. Bashkia Vlorë të përlllogarisë të saktë taksë e ndikimit në infrastrukturë, me qëllim maksimizimin e të ardhurave të saj, duke respektuar kuadrin ligjor në fuqi. Për çdo rast, kur aplikohet për leje ndërtimi dhe objekti në zhvillim ka funksion miks, të kërkohet ndarja e preventivit të punimeve në dy ose më shumë nën-ndarje, sipas këtyre funksioneve, me qëllim përlllogaritjen e saktë të kësaj takse.

Për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohen me përgjegjësi: **z. J. Ç.** / drejtor i DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1, 2, 3); **z. Z. S.** / drejtor i DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 2); **z. R. H.** / specialist pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 2); **znj. N. R.** / specialiste pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 3); **z. D. L.** / kryetar i Bashkisë Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1, 2, 3).

Titulli gjetjes 7: Bashkia Vlorë dhe DPKZHT nuk kanë respektuar përcaktimet ligjore në lidhje me përmbajtjen e dokumentit të lejes së zhvillimit.

Situata: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 2 raste të audituara, nuk janë respektuar përcaktimet ligjore në lidhje me përmbajtjen e dokumentit të lejes së zhvillimit, më konkretisht:

1. Leje ndërtimi për objektin "Objekt banimi dhe shërbimi me 3 dhe 10 kate mbi tokë dhe papafingo, me 1 kat nën tokë" me adresë rr. "Gjergj Kastrioti", Vlorë, me subjekt zhvillues "F. I." ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- Në dokumentin e lejes së zhvillimit mungojnë të dhënat, si: përdorimin e tokës dhe strukturat e lejueshme; intensitetin e ndërtimit; koeficientin e shfrytëzimit të tokës për ndërtim; lartësinë maksimale në metra; distancat; gjelbërimin publik; parkimin; fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese (genplani i azhornuar); hartën e infrastrukturës inxhinierike në zonë. Asnjë nga të dhënat e sipërcituara nuk u gjet në dokumentin e lejes së zhvillimit për këtë objekt.

2. Leje ndërtimi për "Objekt me funksion agroturizmi 2 kat + 1 kat nënçati dhe 1 kat nëntokë", me adresë Kaninë, Vlorë, me subjekt zhvillues z. A. T., me problematika si më poshtë vijon:

- Në dokumentin e lejes së zhvillimit mungojnë të dhënat, si: përdorimin e tokës dhe strukturat e lejueshme; intensitetin e ndërtimit; koeficientin e shfrytëzimit të tokës për ndërtim; lartësinë maksimale në metra; distancat; gjelbërimin publik; parkimin; fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese (genplani i azhornuar); hartën e infrastrukturës inxhinierike në zonë. Asnjë nga të dhënat e sipërcituara nuk u gjet në dokumentin e lejes së zhvillimit për këtë objekt.

Kriteri: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 9, pika 1.

Ndikimi/Efekti: Mangësitë në dokumentin e lejes së zhvillimit nuk respektojnë kuadrin rregullator në fuqi, si dhe nuk japin siguri të plotë mbi parametrat urban dhe të dhëna të tjera që objekti në zhvillim duhet të respektojë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Vlorë

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Vlorë dhe DPKZHT të marrë masa për të përfshirë, në çdo rast, në dokumentin e lejes së zhvillimit të gjithë informacionin dhe parametrat urban të lejuar dhe të miratuar, sipas kuadrit rregullator në fuqi.

Për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohen me përgjegjësi: **z. J. Ç.** / drejtor i DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1, 2); **z. D. L.** / kryetar i Bashkisë Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1, 2).

Titulli gjetjes 8: Bashkia Vlorë dhe DPKZHT kanë miratuar një leje ndërtimi për një objekt i cili ka filluar ndërtimin përpara pajisjes me leje ndërtimi.

Situata: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 1 rast, zhvilluesi e ka filluar ndërtimin e objektit përpara pajisjes me leje ndërtimi, më konkretisht:

1. Leje ndërtimi për objektin "Objekt banimi dhe shërbimi me 3 dhe 10 kate mbi tokë dhe papafingo, me 1 kat nën tokë" me adresë rr. "Gjergj Kastrioti", Vlorë, me subjekt zhvillues "F. I." ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- Leja e ndërtimit për objektin në fjalë është miratuar në datën 04.10.2022. Nga këqyrja e fotografimit satelitor të periudhës Gusht, 2021, vihet re se objekti ka qënë në fazë ndërtimi. Pra, subjekti zhvillues e ka filluar ndërtimin e objektit pa marrë miratimin e autoriteti përgjegjës, në këtë rast Bashkia Vlorë, kjo në shkelje të Nenit 39 të Ligjit 107/2014, i ndryshuar. Vlen të theksohet se zhvilluesi ka aplikuar për miratimin e njoftimit të fillimit të punimeve në datën 04.04.2023 dhe

është miratuar në datën 13.04.2023. Nga kontrolli në terren, konstatohet se objekti është në ndërtim, në katin e 5 teknik, në fazën e karabinasë.

Kriteri: Ligji 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, i ndryshuar, Neni 39.

Ndikimi/Efekti: Lejimi i zhvillimit të objekteve në mungesë të lejeve të posaçme, si dhe miratimi i lejeve të ndërtimit në ato raste kur ndërtimi ka filluar përpara marrjes së miratimit për të ndërtuar cënon qëllimin e vet lejes së ndërtimit, që është marrja e sigurisë së domosdoshme mbi sigurinë, qëndrueshmërinë, respektimin e parametrave urban dhe të të drejtës mbi pronës, si dhe të kushteve higjieno – sanitare, sipas legjislacionit në fuqi.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Vlorë

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, në bashkëpunim me Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, të marrin masa për të ushtruar aktivitetin e kontrollit të territorit në mënyrë periodike dhe sipas planeve të punës nga kryeinspektori i IMTV. Bashkia Vlorë dhe DPKZHT të marrin masa për të rritur bashkëpunimin me strukturën e IMTV dhe të kryejnë kontrole mbi parcelën mbi të cilën aplikohet për të zhvilluar ndërtime. Bashkia Vlorë të mos miratojë asnjë leje ndërtimi kur konstatohet se ndërtimi ka filluar përpara miratimit të lejes së posaçme, si dhe të marrë masa ndëshkuese ndaj subjekteve për të cilat konstatohet kjo shkelje, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohen me përgjegjësi: **z. J. Ç.** / drejtor i DPKZHT Vlorë; **z. D. L.** / kryetar i Bashkisë Vlorë.

Titulli gjetjes 9: Mosrespektimi i kriterëve dhe përcaktimeve të njësisë strukturore ku zhvillohet objekti, në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Vlorë.

Situata: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 2 raste të audituara, nuk janë respektuar kriteret dhe përcaktimet e njësisë strukturore në të cilat zhvillohet objekti, sipas përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Vlorë, më konkretisht:

1. Leje ndërtimi për objektin “Stallë për mbarështimin e deleve për qumësht” me subjekt zhvillues “S. F. G.”, me problematika si më poshtë vijon:

- Ndërtimi i objekteve ndihmëse funksionale nuk është i lejuar në parcelën e marrë në shqyrtim.

2. Leje ndërtimi për “Objekt me funksion agroturizmi 2 kat + 1 kat nënçati dhe 1 kat nëntokë”, me adresë Kaninë, Vlorë, me subjekt zhvillues z. A. T., me problematika si më poshtë vijon:

- Parcela në të cilën propozohet të ndërtohet objekti, nuk plotëson kriteret për t’u klasifikuar si Zonë Bujqësore me mundësi agroturizmi.

Kriteri: Rregullore e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë, Neni 33, pika 12.

Ndikimi/Efekti: Lejimi i zhvillimit të objekteve ndihmëse funksionale është në kundërshtim me planifikimin e territorit sipas Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë, si dhe cënon zhvillimin e kontrolluar të tij.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Vlorë

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, si autoriteti përgjegjës për zhvillimin e kontrolluar të territorit në juridiksionin e tij, të marrë masa për të mos shqyrtuar asnjë aplikim për leje ndërtimi që nuk plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Vlorë, sipas pasaportës së njësisë strukturore.

Për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohen me përgjegjësi: **z. J. Ç.** / drejtor i DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1, 2); **z. M. K.** / specialist pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 2); **znj. E. N.** / specialiste pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet 1, 2); **z. D. H.** / specialist pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1); **z. D. L.** / kryetar i Bashkisë Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1, 2).

Titulli gjetjes 10: Shqyrtimi i aplikimeve me afate të tejzgjatura, më shumë se afatet e parashikuara në ligj.

Situata: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 5 raste të audituara, nuk janë respektuar afatet kohore të parashikuara në ligj për shqyrtimin e aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi ose certifikata përdorimi, më konkretisht:

1. Leje ndërtimi për "Objekt me funksion agroturizmi 2 kat + 1 kat nënçati dhe 1 kat nëntokë", me adresë Kaninë, Vlorë, me subjekt zhvillues z. A. T., me problematika si më poshtë vijon:

- Shqyrtuar për 80 ditë pune.

2. Leje ndërtimi për "Objekt banimi dhe shërbimesh me hoteleri dhe pishina 6-8 kate, me 2 kate nën tokë", me adresë rr. " Llambro Rexho", Vlorë, me subjekt zhvillues "T.M.Z.B" ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- Shqyrtuar për 99 ditë pune.

3. Çertifikatë përdorimi për "Rikonstruksion dhe shtesë kati, objekt banimi 1-2-3-5 kate, Lgj. Isa Boletini, Vlorë ", me subjekt zhvillues z. Dh. Z., z. Th. V., me problematika si më poshtë vijon:

- Shqyrtuar për 109 ditë pune.

4. Çertifikatë përdorimi për "Kapanon për prodhimin e transformatorëve në Hoshtim, Bashkia Vlorë", me subjekt zhvillues z. A. L. dhe subjekt ndërtues A.-B., me problematika si më poshtë vijon:

- Shqyrtuar për 107 ditë pune.

5. Çertifikatë përdorimi për "Pikë karburanti 1 kat, me 1 kat shërbim, në rr. Pelivan L., Vlorë ", me subjekt zhvillues B.-O. SHA, me problematika si më poshtë vijon:

- Shqyrtuar për 88 ditë pune.

Kriteri: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 20 dhe Neni 21; Ligjit 107/2014 "Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Neni 44, pika 2.

Ndikimi/Efekti: Shqyrtimi i aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi ose certifikatë përdorimi me afate të tejzgjatura, më shumë se parashikimi ligjor, cënon të drejtën e qytetarit në cilësinë e zhvilluesit për të marrë shërbimin e kërkuar brenda afateve të caktuara.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Vlorë

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, të marrë masa për të shqyrtuar të gjitha aplikimet që vijnë nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve brenda afateve të parashikuara në ligj, si dhe të merren të gjitha masat administrative ndaj personave përgjegjës për vonesat e konstatuara në shqyrtimin e aplikimeve.

Për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohen me përgjegjësi: **z. J. Ç.** / drejtor i DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1, 2); **z. M. K.** / specialist pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1, 2); **znj. E. N.** / specialiste pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet 1, 2); **z. D. L.** / kryetar i Bashkisë Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1, 2).

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1026/26 prot; datë 26.07.2023, është observuar mbi aktet e konstatimeve të dorëzuara në zyrën e protokollit të Bashkisë Vlorë nga z. Z. S., me detyrë ish-drejtor i DPKZHT dhe funksionarët e DPKZHT me anë të shkresës nr. 8688/1 prot; datë 21.07.2023. Grupi i auditimit është përgjigjur dhe ka argumentuar qëndrimin e tij në dokumentin e projekt-raportit të auditimit. Në vazhdim, është observuar mbi projekt-raportin e auditimit nga funksionarët dhe ish-funksionarët e Bashkisë Vlorë, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1026/29 prot; datë 03.11.2023, me anë të shkresës me nr. 11597 prot; datë 27.10.2023. Për të gjitha ato raste kur observacioni është i njëjtë apo nuk ka dokumentacion ose argumentim të shtuar, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshin dhe nuk do të përfshihen në dokumentin e raportit të auditimit.

1.1 Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me mosrespektimin e kondicioneve urbane, është observuar nga z. R. H., ish-funksionar i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT), Bashkia Vlorë, duke argumentuar se në periudhën kohore 23.02.2021 deri më 15.11.2021, z. H. ka qenë i komanduar në rolin e “kontrolluesit” në sistemin e-leje. Roli i kontrolluesit është të rishikojë aplikimet që dërgon “nëpunësi” dhe më pas i dërgon tek “drejtuesi” për konfirmim.

1.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin tuaj, shprehemi se, qëllimi i kontrollit të dokumentacionit në disa shkallë është shmangia e gabimeve njerëzore, si dhe eliminimi i risqeve të tjera, në funksion të zbatimit të ligjit dhe dispozitave rregullatore. Roli i “kontrolluesit”, siç është përmendur edhe në argumentimin tuaj, është rishikimi i dokumentacionit, me qëllim dërgimin e praktikës së saktë dhe të plotë tek “drejtuesi”. Miratimi i këtyre praktikave, është në kundërshtim me bazën ligjore të cituar në fragmentin e gjetjeve, si rrjedhim, shprehemi se nuk janë respektuar kriteret ligjore nga personat përgjegjës për shqyrtimin e aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Titulli gjetjes 11: Mungesa në dokumentacionin e detyrueshëm për pajisje me certifikatë përdorimi ose ky dokumentacion është i pasaktë ose jo i plotë.

Situata: Nga auditimi i procedurave të miratimit të certifikatave të përdorimit u konstatua se në 10 raste të audituara, ka mungesa në dokumentacionin e detyrueshëm për pajisje me certifikatë përdorimi ose ky dokumentacion është i pasaktë ose jo i plotë, më konkretisht:

1. Certifikatë përdorimi për “Rikonstruksion dhe shtesë kati, objekt banimi 1-2-3-5 kate, Lgj. Isa Boletini, Vlorë”, me subjekt zhvillues z. Dh. Z., z. Th. V., me problematika si më poshtë vijon:

- Mungon kontrata e nënshkruar, ndërmjet zhvilluesit dhe mbikëqyrësit të punimeve;

- Mungon projekti “as built” (i zbatuar) në sistemin e-leje.

2. Certifikatë përdorimi për “Kapanon për prodhimin e transformatorëve në Hoshtim, Bashkia Vlorë”, me subjekt zhvillues z. A. L. dhe subjekt ndërtues A.-B., me problematika si më poshtë vijon:

- Mungon projekti “as built” (i zbatuar) në sistemin e-leje.

3. Certifikatë përdorimi për “Pikë karburanti 1 kat, me 1 kat shërbim, në rr. Pelivan L., Vlorë”, me subjekt zhvillues B.-O. SHA, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk është ngarkuar projekti “as built” (i zbatuar) në sistemin e-leje.

- Nuk janë ngarkuar aktet përkatëse (procesverbal, akt miratimi, akt kolaudimi, akt teknik etj.), të lëshuara nga shoqëria "Ujësjiellës-Kanalizime" sh.a., Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, dhe ato për menaxhimin e mbetjeve urbane.

- Fotografitë e objektit janë ngarkuar vetëm në 3 drejtime, mungon fasada perëndimore.

4. Çertifikatë përdorimi për "Struktura me funksion turistik 4 kate, Vlorë", me subjekt zhvillues S., me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk është ngarkuar projekti "as built" (i zbatuar) në sistemin e-leje.

5. Çertifikatë përdorimi për "Godinë hoteleri 3 kate me një kat nëntokë", me adresë në Radhimë, Vlorë, me subjekt zhvillues "D." ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- Mungon çertifikata përfundimtare e Eficiencës së Energjisë.

- Mungon projekti "as built" (i zbatuar) në sistemin e-leje.

6. Çertifikatë përdorimi për "Banesë 8 kate dhe papafingo, me 1 kat dyqane dhe 1 kat parkim nëntokë", me adresë në lagjen "Hajro Cakerri", Vlorë, me subjekt zhvillues B. ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- Mungon çertifikata përfundimtare e Eficiencës së Energjisë.

- Akti i kontrollit të përfundimit të fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re nuk ka datë.

- Të gjithë aktet e kontrollit të mbajtura nuk janë të firmosur nga mbikëqyrësi i punimeve.

- Mungon vërtetimi nga OSHEE që subjekti zhvillues nuk ka detyrime të papaguara ndaj këtij operatori.

- Mungon projekti "as built" (i zbatuar) në sistemin e-leje.

- Projekti arkitektonik nuk është i plotë.

- Fotot e objektit të ndërtuar nuk pasqyrojnë objektin në të gjithë drejtimet.

7. Çertifikatë përdorimi për "Objekt banimi dhe shërbimi 4-8-9 kate me 1 kat parkim nëntokë" në lagjen "Uji I Ftohtë", Vlorë, me subjekt zhvillues A. K. ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- Aktet e kontrollit të fazave të ndërtimit nuk janë firmosur në momentin e përpilimit nga koludatori i licencuar.

- Subjekti zhvillues nuk ka ngarkuar të plotë dokumentacionin që vërteton se nuk ka detyrime të papaguara.

- Mungon projekti "as built" (i zbatuar) në sistemin e-leje.

8. Çertifikatë përdorimi për "Objekt banimi dhe shërbimi në funksion të turizmit, seksioni B", në Radhimë, Vlorë, me subjekt zhvillues D. G. ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- Mungojnë aktet përkatëse nga SHA Ujësjiellës – Kanalizime, si dhe për menaxhimin e mbetjeve urbane.

- Mungon projekti "as built" (i zbatuar) në sistemin e-leje.

9. Çertifikatë përdorimi për "Objekt banimi dhe shërbimi në funksion të turizmit, seksioni B", në Dukat Fushë, Vlorë, me subjekt zhvillues z. B. M., me problematika si më poshtë vijon:

- Mungon vërtetimi nga OSHEE që subjekti ndërtues nuk ka detyrime të papaguara ndaj këtij operatori.

- Mungojnë aktet përkatëse nga SH.A Ujësjiellës – Kanalizime.

- Mungon projekti "as built" (i zbatuar) në sistemin e-leje.

- Mungon dokumenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, polica dhe deklarata e përgjegjësisë profesionale për mbikëqyrësin e punimeve.

10. Çertifikatë përdorimi për "Ndërtim kompleks për mbarështim lopësh", në Bunavi, Vlorë, me subjekt zhvillues M. C. S. ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- Mungojnë aktet përkatëse nga SH.A Ujësjellës – Kanalizime dhe ato për menaxhimin e mbetjeve urbane.

- Mungojnë vërtetimet nga OSHEE, SH.A.U.K, Drejtoritë Rajonale dhe Vendore të Tatim Taksave, që tregojnë se subjekti zhvillues dhe ndërtues nuk kanë detyrime të papaguara ndaj këtyre enteve.

- Mungon projekti “as built” (i zbatuar) në sistemin e-leje.

Kriteri: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 27/1, pika 1; Neni 27/2, pika 1, nënpika ë), g), j), l); Ligji 124/2015, “Për efikasitetin e energjisë” Neni 16, pika 5, nënpika b).

Ndikimi/Efekti: Mangësitë në dokumentacionin e nevojshëm dhe të detyrueshëm në procedurat e aplikimit për pajisje me certifikatë përdorimi, si dhe dokumentacioni jo i plotë dhe jo i saktë ndikojnë në marrjen e sigurisë së plotë mbi ndërtimin e objektit sipas lejes së miratuar, në përputhje me kriteret ligjore, si dhe mbi vërtetësinë dhe saktësinë e dokumentacionit të hartuar nga profesionistët.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Vlorë

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, të marrë masa që të mos miratojnë asnjë certifikatë përdorimi, për ato raste kur dokumentacioni i kërkuar në ligj dhe rregullore nuk është i plotë, i saktë ose me mangësi. Bashkia Vlorë të marrë masa për të kërkuar në çdo rast vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe vërtetimet se subjektet ndërtuese nuk kanë detyrime të papaguara ndaj autoriteteve rajonale dhe qendrore. Bashkia Vlorë të kërkojë projektin as-bulit, në çdo rast që evidentohen shmangie nga projekti i miratuar, për të bërë të mundur përlloraritjen e volumit të shmangies nga projekti i miratuar.

Për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohen me përgjegjësi: **z. J. Ç.** / drejtor i DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1 - 9); **z. Z. S.** / drejtor i DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 10); **z. R. H.** / specialist pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1 - 4); **znj. N. R.** / specialiste pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1-7); **z. M. K.** / specialist pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1, 2); **znj. E. N.** / specialiste pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet 5- 7); **z. D. L.** / kryetar i Bashkisë Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1-10).

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1026/26 prot; datë 26.07.2023, është observuar mbi aktet e konstatimeve të dorëzuara në zyrën e protokollit të Bashkisë Vlorë nga z. Z. S., me detyrë ish-drejtor i DPKZHT dhe funksionarët e DPKZHT me anë të shkresës nr. 8688/1 prot; datë 21.07.2023. Grupi i auditimit është përgjigjur dhe ka argumentuar qëndrimin e tij në dokumentin e projekt-raportit të auditimit. Në vazhdim, është observuar mbi projekt-raportin e auditimit nga funksionarët dhe ish-funksionarët e Bashkisë Vlorë, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1026/29 prot; datë 03.11.2023, me anë të shkresës me nr. 11597 prot; datë 27.10.2023.

1.1 Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me mungesën e kontratës midis subjektit zhvillues dhe mbikëqyrësit të punimeve, është observuar nga z. R. H., ish-funksionar i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT), Bashkia Vlorë, duke argumentuar se, pas verifikimit të sistemit e-leje, në sistem figuron kontrata ndërmjet subjektit ndërtues E.-V. me supervizoren N. J. Subjekti E.-V., e pajisur me licencë për ndërtim ka bërë kontratë me zhvilluesin z. Dh. Z. dhe z. Th. V. Gjithashtu

në sistemin e-leje është aplikuar edhe projekti i zbatimit arkitektonik i firmosur nga projektuesi i licensuar. Gjithashtu, z. H. shprehet se ka qenë i komanduar në rolin e “kontrolluesit” në sistemin e-lejet. Roli i kontrolluesit është të rishikojë aplikimet që dërgon “nëpunësi” dhe më pas i dërgon tek “drejtuesi” për konfirmim.

1.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin tuaj, shprehem se, qëllimi i kontrollit të dokumentacionit në disa shkallë është shmangia e gabimeve njerëzore, si dhe eliminimi i risqeve të tjera, në funksion të zbatimit të ligjit dhe dispozitave rregullatore. Roli i “kontrolluesit”, siç është përmendur edhe në argumentimin tuaj, është rishikimi i dokumentacionit, me qëllim dërgimin e praktikës së saktë dhe të plotë tek “drejtuesi”. Miratimi i këtyre praktikave, është në kundërshtim me bazën ligjore të cituar në fragmentin e gjetjeve, si rrjedhim, shprehem se nuk janë respektuar kriteret ligjore nga personat përgjegjës për shqyrtimin e aplikimeve për pajisje me leje ndërtime. Gjithashtu, nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit përsëri, në sistemin e-lejet, rezulton se kontrata midis subjektit zhvillues dhe mbikëqyrësit të punimeve nuk është pjesë e procedurës së aplikimit. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

2.1 Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me mungesat e konstatuara të projekti “as built” në sistemin e-lejet, aktet përkatëse të lëshuara nga shoqëria “Ujesjelles-Kanalizime” sh.a, Operatori i shpërndarjes së Energjisë Elektrike, dhe ato të menaxhimit të mbetjeve urbane, fotografitë e objektit në të gjitha drejtimet, si dhe për mungesën e fasadës perendimore, shprehen se, në sistemin e-lejet është aplikuar edhe projekti i zbatimit arkitektonik i firmosur nga projektuesi i licensuar, në dosjen e aplikimit në sistemin e-lejet janë aktet përkatëse nga ndërmarrja e “Ujesjellës-Kanalizime” sh.a dhe Operatori i shpërndarjes së Energjisë Elektrike. Përsa i përket vërtetimit për mbetjet urbane, objektit pikë karburanti 1 kat, nuk është objekt banimi shumë familjar që prodhon mbetje urbane dhe për të cilat duhet që të kërkojë një vërtetim për pozicionimin e konteniereve ku depozitohen mbetjet. Përsa i përket mungesës së fasadës perendimore, duke qenë se objekti i shërbimit ka formë trekëndore, është parë e arsyeshme që fotot e apliuara janë të mjaftueshme.

1.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin tuaj, shprehem se, projekti “as built” kërkohet specifikisht në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 27/2, pika 1, nënpika g). Duke qenë se në objektin e zbatuar janë konstatuar ndryshime nga projekti i miratuar, prania e projektit “as built” merr rëndësi të veçantë për identifikimin e raportit të shmangies. Dokumentet e ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, të lëshuara nga ana e “Ujesjellës-Kanalizime” sh.a dhe Operatori i shpërndarjes së Energjisë Elektrike, janë vërtetime për detyrime të papaguara, dhe jo një nga dokumentat e kërkuar në rregullore. Në lidhje me argumentimin tuaj për mungesën e vërtetimit për mbetjet urbane, shprehem se në rregullore nuk ka raste përshtimore për këtë pikë. Në lidhje me argumentimin tuaj për mungesën e fotove në të gjitha drejtimet, shprehem se fotot nuk japin informacion për të gjitha fasadat, edhe pse objekti ka konfigurim trekëndor. Për sa më sipër, pretendimi juaj nuk merret në konsideratë.

Titulli gjetjes 12: Ndryshime midis projektit të miratuar dhe objektit të ndërtuar.

Situata: Nga auditimi i procedurave të miratimit të certifikatave të përdorimit u konstatua se në 7 (shtatë) raste të audituara, ka ndryshime midis projektit të miratuar dhe objektit të ndërtuar, më konkretisht:

1. Çertifikatë përdorimi për “Rikonstruksion dhe shtesë kati, objekt banimi 1-2-3-5 kate, Lgj. Isa Boletini, Vlorë”, me subjekt zhvillues z. Dh. Z., z. Th. V., me problematika si më poshtë vijon:
 - *Ka ndryshim tek dritarja sipër hyrjes së parkimit nëntokësor, duke shkelur përcaktimet e projektit të miratuar, në kundërshtim kjo me Ligjin Nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, IMT dhe DPKZHT Bashkia Vlorë kanë anashkaluar përgjegjësitë e veta, duke mos konstatuar devijimin nga leja e miratuar e ndërtimit.*
2. Çertifikatë përdorimi për “Kapanon për prodhimin e transformatorëve në Hoshtim, Bashkia Vlorë”, me subjekt zhvillues z. A. L. dhe subjekt ndërtues A.-B., me problematika si më poshtë vijon:
 - *Konstatohet se çarjet në fasada, si dyer dhe dritare nuk janë realizuar sipas projektit të miratuar, duke shkelur përcaktimet e Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”.*
3. Çertifikatë përdorimi për “Pikë karburanti 1 kat, me 1 kat shërbim, në rr. Pelivan L., Vlorë”, me subjekt zhvillues B.-O. SHA, me problematika si më poshtë vijon:
 - *Konstatohet se konstruksioni në fasadën veriore tek i cili, sipas projektit, mbështetet konsoli mbulues nuk është realizuar sipas projektit të miratuar, duke shkelur përcaktimet e Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”.*
4. Çertifikatë përdorimi për “Struktura me funksion turistik 4 kate, Vlorë”, me subjekt zhvillues S., me problematika si më poshtë vijon:
 - *Konstatohet se ka ndryshime në papafingo në raport me projektin e miratuar, duke shkelur përcaktimet e Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”.*
5. Çertifikatë përdorimi për “Godinë hoteleri 3 kate me një kat nëntokë”, me adresë në Radhimë, Vlorë, me subjekt zhvillues “D.” ShPK, me problematika si më poshtë vijon:
 - *Mbulesat e ballkoneve në katin e fundit, në fasadën perëndimore, nuk janë realizuar sipas projektit për të tre objektet, pasi në projektin e miratuar këto volume arkitektonike shërbejnë si mbulesë për ballkonet e katit të mëposhtëm, ndërsa në objektin e zbatuar këto janë ballkone të shfrytëzueshme.*
 - *Çarjet në fasadat anësore nuk janë realizuar sipas projektit, pasi përmasat e këtyre çarjeve nuk janë të njëjta me ato të zbatuara.*
 - *Kafazi i shkallëve në fasadat lindore, në projekt është i veshur me brisolei, ndërsa në objektin e zbatuar është i veshur me fasadë xhami struktural.*
 - *Soleta e kafazit të shkallëve nuk është realizuar sipas projektit.*
 - *Shkallët dhe veranda që të çojnë te kafazi i shkalleve nuk është realizuar sipas projektit.*

Të gjitha veprimet e mësipërme janë në shkelje të Ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” dhe Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.
6. Çertifikatë përdorimi për “Objekt banimi dhe shërbimi në funksion të turizmit, seksioni B”, në Dukat Fushë, Vlorë, me subjekt zhvillues z. B. M., me problematika si më poshtë vijon:
 - *çarjet në fasadën veriore të katit të parë nuk janë realizuar sipas projektit;*
 - *çatia nuk është realizuar sipas projektit;*
 - *fotot në fasadën lindore dhe perëndimore nuk pasqyrojnë të gjithë fasadën, për këtë arsye nuk mund të shprehemi nëse objekti është realizuar sipas projektit.*
 - *nga dokumentacioni fotografik vihet re një dalje volumetrike në çatinë e objektit, e cila nuk është e pasqyruar në projektin e miratuar.*

7. Certifikatë përdorimi për “Ndërtim kompleks për mbarështim lopësh”, në Bunavi, Vlorë, me subjekt zhvillues M. C. S. ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- Nga verifikimi në terren, si dhe e provuar me dokumentacion fotografik, rezulton se objekti nuk ka përfunduar punimet. Në këto kushte, shprehemi se DPKZHT dhe Bashkia Vlorë kanë miratuar një certifikatë përdorimi për një objekt të papërfunduar.

Kriteri: Ligji 107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 42, pika 1; Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar, Neni 1.

Ndikimi/Efekti: Shmangiet e konstatuar midis objektit të zhvilluar dhe projektit të miratuar ndikojnë në zhvillimin e kontrolluar të territorit, cenojnë parametrat urban, kushtet e sigurisë dhe ato higjieno – sanitare.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Vlorë

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, në bashkëpunim me Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, të marrin masa për të mos lejuar asnjë objekt në zhvillim të devijojë nga projekti i miratuar, në kushtet e mungesës së lejeve të posaçme. Bashkia Vlorë të mos miratojnë asnjë certifikatë përdorimi kur konstatohet se ky objekt ka shmangie nga projekti i miratuar, pa proceduar paraprakisht me ndjekjen e hapave ligjor, deri në ndryshimin e objektit sipas projektit të miratuar, si dhe ndëshkimin e personave përgjegjës.

Për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohen me përgjegjësi: **z. J. Ç.** / drejtor i DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1 - 6); **z. Z. S.** / drejtor i DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 7); **z. R. H.** / specialist pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1 - 4); **znj. N. R.** / specialiste pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1-5); **znj. E. N.** / specialiste pranë DPKZHT Vlorë (Për lejet e ndërtimit 5); **z. D. L.** / kryetar i Bashkisë Vlorë (Për lejet e ndërtimit 1-7).

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1026/26 prot; datë 26.07.2023, është observuar mbi aktet e konstatimeve të dorëzuara në zyrën e protokollit të Bashkisë Vlorë nga z. Z. S., me detyrë ish-drejtor i DPKZHT dhe funksionarët e DPKZHT me anë të shkresës nr. 8688/1 prot; datë 21.07.2023. Grupi i auditimit është përgjigjur dhe ka argumentuar qëndrimin e tij në dokumentin e projekt-raportit të auditimit. Në vazhdim, është observuar mbi projekt-raportin e auditimit nga funksionarët dhe ish-funksionarët e Bashkisë Vlorë, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1026/29 prot; datë 03.11.2023, me anë të shkresës me nr. 11597 prot; datë 27.10.2023.

1.1 Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me shmangiet e konstatuara nga projekti i miratuar, shprehen se, përsa i përket praktikës në fjalë, dosja është shqyrtuar në bazë të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, Neni 27/1, pika 1. Gjithashtu, përsa i përket disa ndryshimeve në fasadën e objektit, ju sqarohet se: Në VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, kreu III, Neni 27, pika 1, theksohet se: “në përfundimin e punimeve të objektit të ri, nuk konsiderohet shkelje por marzh gabimi, në rast se nuk e tejkalon masën 1% të sipërfaqes ndërtimore të përgjithshme të lejes së ndërtimit, me kusht që ndërtimi të jetë në përputhje me kushtet urbane. Në këtë rast objekti nuk i ka shkelur kushtet urbane. Pra, siç shihet, në bazë të legjislacionit në fuqi, dhe në mungesë të ndonjë raport inspektimi nga IMT për shkelje të punimeve gjatë ndërtimit, si dhe kur në dosje janë depozituar aktet e kontrollit nga subjekti i licensuar, objekti nuk i ka shkelur kushtet urbane dhe shkeljet në fasadë konsiderohen marzh

gabimi, në rast se nuk e tejkalon masën 1% të sipërfaqes ndërtimore të përgjithshme të lejes së ndërtimit, nga ana ime duke parë shqyrtimin që “nëpunesi” i ka bërë aplikimit, është parë e arsyeshme dërgimi për konfirmim tek “Drejtuesi”.

1.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin tuaj, shprehemi se, në mungesë të projektit “as built”, nuk mund të verifikohet nëse shmangia nga projekti i miratuar është në masën 1% ose jo. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Konkluzion i përgjithshëm:

1. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në dhjetë raste nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë distancat urbane nga trupi i rrugës së propozuar, distancat urbane midis ndërtimeve, distancat urbane ndërtesë – kufi prone, lartësia maksimale e lejuar e matur me metra dhe numër katesh, përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapsira publike, aksesit për në pronë, lartësia minimale e lejuar për katin përdhe, mangësi në projektin arkitektonik, intensiteti i ndërtimit.

2. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në pesë raste nuk është lidhur kontrata midis palëve, zhvilluesit dhe Bashkisë Vlorë, për përfitim të hapësirës në favor të fondit të banesave sociale, përpara miratimit të lejes së ndërtimit. Në njërin prej këtyre rasteve, zhvilluesi është objekt i Intensitetit të Ndërtimit me Kusht (nga shfrytëzimi i kësaj të drejte, Bashkia Vlorë do të duhej të përfitonte një sipërfaqe prej 299.86 m² me vlerë shitjeje 299.86 m² * 61.800 lekë/m² = 18.531.348 lekë. Palët kanë rënë dakort që ky përfitim të merret si investim publik. Sipas marrëveshjes midis Bashkisë Vlorë dhe subjektit zhvillues “F. I.” ShPK, DPKZHT ka përpiluar projektin për rehabilitimin e rrugës, duke e preventivuar atë me vlerë totale prej 8.633.559 lekë. Rezulton se vlera e shitjes së sipërfaqes së përfitur nga Bashkia Vlorë është më e madhe se vlera e preventivuar për rrugën “Xher Rashimi”, me diferencë prej 9.897.789 lekë, vlerë e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Vlorë.

3. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 12 raste të audituara, projekti ndërtimor nuk është i plotë, si dhe mungon dokumentacioni shoqëruar, siç janë mangësi në rilevimin topografik, mangësi në projektet ndërtimore dhe relacionet teknike të tyre, oponenca teknike, licencat profesionale të hartuesve të projekteve, deklaratat e përgjegjësive profesionale, polica e sigurimit të përgjegjësive profesionale, mangësi në dokumentacioni që vërteton statusin aktiv të subjekteve, projekti ndërtimor në formatin DWG.

4. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në dy raste, një pjesë e dokumentacionit të nevojshëm dhe të detyrueshëm për aplikim për pajisje me leje ndërtimi, nuk ka kaluar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, por është marrë dorazi.

5. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 6 raste, DPKZHT dhe Bashkia Vlorë nuk kanë kërkuar mendimin e autoriteteve të tjera publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, nuk janë respektuar vendimet që rregullojnë veprimtarinë ndërtimore pranë zonave të mbrojtura dhe zonave me përparësi zhvillimin e turizmit. Në 2(dy) raste nuk janë respektuar përcaktimet e Vendimit nr. 41 të KKT-së, datë 03.12.2020, i cili në pikën 3 të tij përcakton se, nëse nuk kërkohet mendim, ndër të tjera,

edhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, këto leje do të konsiderohen **nul dhe të pavlefshme**. Rastet, të cilat nuk kanë respektuar përcaktimet e këtij vendimi janë:

- Leje ndërtimi për objektin "Objekt banimi dhe shërbimi me 3 dhe 10 kate mbi tokë dhe papafingo, me 1 kat nën tokë" me adresë rr. "Gjergj Kastrioti", Vlorë, me subjekt zhvillues "F. I." ShPK;

- Leje ndërtimi për "Kompleks me funksion hoteleri dhe shtëpi të dyta, me 5 kate dhe 1 kat nën tokë", me adresë Radhimë, Vlorë, me subjekt zhvillues "I. & AG C."

6. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 3 raste të audituara, përlllogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është kryer e saktë, si dhe një njërin prej këtyre rasteve, ka mangësi në dokumentacion.

Për leje ndërtimi për objektin "Godinë banimi dhe shërbimi 8 kate + papafingo me 1 kat nëntokë, në rrugën 'Ibrahim Avdullai', Bashkia Vlorë" me subjekt zhvillues A. K. ShPK dhe z. F. H., taksa e ndikimit në infrastrukturë është përlllogaritur me vlerë të munguar prej 12.670.220,9 lekë.

Për leje ndërtimi për "Kompleks me funksion hoteleri dhe shtëpi të dyta, me 5 kate dhe 1 kat nën tokë", me adresë Radhimë, Vlorë, me subjekt zhvillues "I. & AG C.", taksa e ndikimit në infrastrukturë është përlllogaritur me vlerë të munguar prej 446.758,21 lekë, gjithashtu në këtë rast nuk është ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve mandat-pagesa e TNI-së, sipas përlllogaritjes së Bashkisë Vlorë, me vlerë prej 11.210.000 lekë. Nëse mandat-pagesa për këtë vlerë nuk do t'i vendoset në dispozicion grupit të auditimit, edhe vlera prej 11.210.000 lekë, do të konsiderohet e ardhur e munguar.

Për leje ndërtimi për "Objekt banimi dhe shërbimesh me hoteleri dhe pishina 6-8 kate, me 2 kate nën tokë", me adresë rr. "Llambro Rexho", Vlorë, me subjekt zhvillues "T.M.Z.B" ShPK, taksa e ndikimit në infrastrukturë është përlllogaritur për një objekt me funksion miks banim, shërbim dhe hoteleri, me vlerë 16.500.515,5 lekë, kur në këtë objekt nuk evidentohet pjesa takuese me funksion hoteleri, përlllogaritje e cila jep një vlerë më të vogël të TNI-së. Nëse do të bëhet përlllogaritja për këtë objekt, duke e konsideruar të gjithin me funksion banim dhe shërbime, vlera e saktë e TNI-së do të ishte 31.956.532,6 lekë. Diferenca prej 15.456.017,1 lekë përbën të ardhur të munguar institucionin e Bashkisë Vlorë, nëse zhvilluesi nuk siguron hapësirat e dedikuara për hoteleri në objektin në zhvillim.

7. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 2 raste të audituara, nuk janë respektuar përcaktimet ligjore në lidhje me përmbajtjen e dokumentit të lejes së zhvillimit, më konkretisht, në dokumentin e lejes së zhvillimit për këto objekte, mungojnë të dhënat, si përdorimi i tokës dhe strukturat e lejueshme; intensiteti i ndërtimit; koeficienti i shfrytëzimit të tokës për ndërtim; lartësia maksimale në metra; distancat; gjelbërimin publik; parkimi; fragmenti i hartës në gjendjen ekzistuese (genplani i azhornuar); harta e infrastrukturës inxhinierike në zonë.

8. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 1 rast, zhvilluesi e ka filluar ndërtimin e objektit përpara pajisjes me leje ndërtimi, më konkretisht:

-Leje ndërtimi për objektin "Objekt banimi dhe shërbimi me 3 dhe 10 kate mbi tokë dhe papafingo, me 1 kat nën tokë" me adresë rr. "Gjergj Kastrioti", Vlorë, me subjekt zhvillues "F. I." ShPK. Leja e ndërtimit për objektin në fjalë është miratuar në datën 04.10.2022. Nga këqyrja e fotografimit satelitor të periudhës Gusht, 2021, vihet re se objekti ka qënë në fazë ndërtimi. Pra, subjekti zhvillues e ka filluar ndërtimin e objektit pa marrë miratimin e autoriteti përgjegjës, në këtë rast Bashkia Vlorë.

9. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 2 raste të audituara, nuk janë respektuar kriteret dhe përcaktimet e njëjësive strukturore në të cilat zhvillohet objekti, sipas përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Vlorë, më konkretisht,

për rastin “Stallë për mbarështimin e deleve për qumësht” me subjekt zhvillues “S. F. G.”, ndërtimi i objekteve ndihmëse funksionale nuk është i lejuar në parcelën e marrë në shqyrtim, ndërsa për “Objekt me funksion agroturizmi 2 kat + 1 kat nënçati dhe 1 kat nëntokë”, me adresë Kaninë, Vlorë, me subjekt zhvillues z. A. T., parcela në të cilën propozohet të ndërtohet objekti, nuk plotëson kriteret për t’u klasifikuar si Zonë Bujqësore me mundësi agrourtizmi.

10. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit u konstatua se në 5 raste të audituara, nuk janë respektuar afatet kohore të parashikuara në ligj për shqyrtimin e aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi ose përdorimi.

11. Nga auditimi i procedurave të miratimit të certifikatave të përdorimit u konstatua se në 10 raste të audituara, ka mungesa në dokumentacionin e detyrueshëm për pajisje me certifikatë përdorimi ose ky dokumentacion është i pasaktë ose jo i plotë, më konkretisht mungojnë kontrata e nënshkruar, ndërmjet zhvilluesit dhe mbikëqyrësit të punimeve, projekti “as built” (i zbatuar), aktet përkatëse (procesverbal, akt miratimi, akt kolaudimi, akt teknik etj.), të lëshuara nga shoqëria “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a., Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, dhe ato për menaxhimin e mbetjeve urbane, problematika me fotot e objektit të përfunduar në të katërta drejtime, certifikata përfundimtare e eficiencës së energjisë, projekti arkitektonik nuk është i plotë, etj.

12. Nga auditimi i procedurave të miratimit të certifikatave të përdorimit u konstatua se në 7 raste të audituara, ka ndryshime midis projektit të miratuar dhe objektit të ndërtuar, më konkretisht, evidentohet se në një rast ka ndryshim tek dritarja sipër hyrjes së parkimit nëntokësor, duke shkelur përcaktimet e projektit të miratuar, në kundërshtim kjo me Ligjin Nr. 9780, datë 16.07.2007. Në një rast tjetër konstatohet se çarjet në fasada, si dyer dhe dritare nuk janë realizuar sipas projektit të miratuar; në një rast tjetër konstatohet se konstruksioni në fasadën veriore tek i cili, sipas projektit, mbështetet konsoli mbulues nuk është realizuar sipas projektit të miratuar; në një rast tjetër soleta e kafazit të shkallëve nuk është realizuar sipas projektit; shkallët dhe veranda që të çojnë te kafazi i shkalleve nuk është realizuar sipas projektit.

Pika 6 e programit: Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor.

Në zbatim të pikës 2.6. të Programit të Auditimit me nr. 1026/1 prot; datë 15.11.2022, i ndryshuar, me objekt: “Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV), prej datës 01.07.2021 deri më 31.12.2022, u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion, ku u konstatua:

Titulli i gjetjes 1: Mangësi në strukturën organizative të IMTV-së.

Situata: Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Vlorë, struktura organizative e IMTV-së është në përputhje me Ligjin nr. 9780 datë 16/07/2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, Neni 11, gjithsesi, referuar informacionit të dërguar nga IMTV, konstatohet se nuk ka asnjë punonjës me profil arsimimi teknik, profile të cilat janë të specializuara në njohjen e materialeve, strukturave, projekteve, si dhe evidentimit të gjendjes faktike të strukturave në raport me strukturat e miratuara me anë të vendimeve të organeve kompetent, gjë e cila do të rriste dhe përmirësonte rendimentin e IMTV, duke mbrojtur kështu territorin nga ndërhyrjet abuzive. Struktura e IMTV-së pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 1

Punonjësit e IMTV Bashkia Vlorë për vitin 2021

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Lloji i Diplomimit	Data e fillimit	Data e largimit
1	Z. S.	K/Inspektor	Drejtësi		24.06.2021
2	F. H.	K/Inspektor	Ing. mjedisi	25.06.2021	
3	M. I.	Inspektor	Drejtësi		
4	E. Sh.	Inspektor	Drejtësi		
5	I. Z.	Inspektor	Ekonomik		
6	R. M.	Inspektor	Ing. hidroteknike		
7	E. B.	Jursite/Inspektore	Drejtësi	01.01.2021 (juriste)	27.03.2021 (ne vazhdim inspektore)
8	U. H.	Juriste	Drejtësi		
9	K. H.	Inspektor	Drejtësi		
10	E. F.	Inspektor	Drejtësi		
11	B. C.	Inspektor	Drejtësi		
12	N. Ll.	Inspektor	Drejtësi		
13	O. P.	Inspektor	Drejtësi		
14	A. Rr.	Inspektor	Drejtësi		
15	D. K.	Inspektor	Drejtësi		
16	A. Sh.	Inspektor	Drejtësi		
17	A. S.	Inspektor	Drejtësi		31.05.2021
18	R. F.	Inspektor	Drejtësi	11.05.2020	

Burimi: IMTV Vlorë

Përpunoi: Grupi i auditimit

Tabela 2

Punonjësit e IMTV Bashkia Vlorë për vitin 2022

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Lloji i Diplomimit	Data e fillimit	Data e largimit
1	F. H.	K/Inspektor	Inxhinieri mjedisi	25.06.2021	22.09.2022
2	M. I.	Inspektor	Drejtësi		
3	E. Sh.	Inspektor	Drejtësi		
4	I. Z.	Inspektor / K/inspektor	Ekonomik	23.09.2022	
5	R. M.	Inspektor	Ing. hidroteknike		
6	E. B.	Inspektore	Drejtësi		
7	U. H.	Juriste	Drejtësi	27.03.2021	
8	K. H.	Inspektor	Drejtësi		
9	E. F.	Inspektor	Drejtësi		
10	B. C.	Inspektor	Drejtësi		
11	N. Ll.	Inspektor	Drejtësi		
12	O. P.	Inspektor	Drejtësi		
13	A. Rr.	Inspektor	Drejtësi		
14	D. K.	Inspektor	Drejtësi		
15	A. Sh.	Inspektor	Drejtësi		
16	F. C.	Inspektor	Drejtësi		
17	A. M.	Inspektor	Drejtësi		

Burimi: IMTV Vlorë

Përpunoi: Grupi i auditimit

Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Kriteri: Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e formimit profesional të nevojshëm për pozicionin e punës, ndikon në zbatimin e detyrës si inspektor në Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e Bashkisë Vlorë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të strukturës së IMTV, Kryetari i Bashkisë Vlorë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për të shtuar në këtë strukturë punonjës me profil arsimimi teknik dhe të profilizuar në degët që lidhen me njohjen e materialeve, strukturave, projekteve, si dhe evidentimit të gjendjes faktike të strukturave. Më konkretisht, inspektorët duhet të jenë me formim arsimor të inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- **z. D. L.**, me detyrë ish-Kryetari i Bashkisë Vlorë.

Titulli i gjetjes 2: Niveli i arkëtimit të masava administrative shumë i ulët dhe mungesa e përlllogaritjes së kamat-vonesës.

Situata: Në lidhje me nivelin e arkëtimit të masava administrative shprehemi se është i ulët, më konkretisht, në vitin 2021, janë vendosur në total 104 gjoba me vlerë 40,520,000 lekë nga të cilat janë paguar në mënyrë vullnetare 15 gjoba (14.3% të numrit total të gjobave) me vlerë 1,350,000 lekë (3.3% të vlerës totale të gjobave), për 86 vendime gjobash është bërë kërkesë nga ana e IMT-së për titull ekzekutiv pranë Gjykatës Administrative, nga të cilat 36 vendime kanë marrë titull ekzekutiv dhe 50 të tjera nuk kanë marrë akoma titull ekzekutiv. Në vitin 2022, janë vendosur në total 151 gjoba me vlerë 91,630,000 lekë, nga të cilat janë paguar në mënyrë vullnetare 20 gjoba (13.2% të numrit total të gjobave) me vlerë 1,850,000 lekë (2.02% të vlerës totale të gjobave), për 121 vendime gjobash është bërë kërkesë nga ana e IMTV-së për titull ekzekutiv pranë Gjykatës Administrative, nga të cilat 63 vendime kanë marrë titull ekzekutiv dhe 58 të tjera nuk kanë marrë akoma titull ekzekutiv.

Në asnjë nga rastet e mësipërme nuk është e dokumentuar vjelja e gjobës nëpërmjet pagës, si një nga mënyrat kur gjobat nuk paguhen vullnetarisht, referuar Ligjit nr. 10279, date 20.05.2010, Kreu V, neni 31, pika 5. Vlen të theksohet se IMTV dhe DFB Vlorë nuk kanë informacion mbi arkëtimin ose jo të masave që janë arkëtuar / do të arkëtohen nga Shërbimi Përmbarimor. IMTV i ka kërkuar Shërbimit Përmbarimor informacion dhe bashkëpunim në lidhje me arkëtimin e gjobave, por nuk ka vendosur në dispozicion kthim përgjigjeje nga ana e Shërbimit Përmbarimor, duke supozuar se nuk e ka marrë një të tillë. Nga analizimi i të dhënave të marra nga IMT dhe DFB, vërejmë parregullsi në 1 rast:

- Për PV e konstatimit të kundërvajtjes 000581, dt. 06.12.2021, subjekti D.A, vlera e masës së gjobës sipas dokumentacionit nga IMT është **500.000 leke**, ndërsa nga ana e DFB nuk është kontabilizuar.

Gjithashtu, nga auditimi i blloqeve të dënimit me gjobë dhe ballafaqimit të tyre me informacionin e vendosur në dispozicion nga DFB, rezulton se nuk është aplikuar kamat-vonesa 2%, e parashikuar në ligj, për personat ose subjektet të cilat nuk i kanë paguar këto gjoba brenda afateve ligjore.

Kriteri: Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar, Neni 5; Ligji nr.10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Neni 9/Neni 22; Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, Kreu V, Neni 30, pika 3.

Ndikimi/Efekti: Mangësitë në ndërmarrjet e hapave që ligji parashikon për vjeljen e gjobave të pa-arkëtuara, së bashku me kamat-vonesën, ndikojnë negativisht në buxhetin e Bashkisë Vlorë, gjithashtu zvogëlohet efekti ndëshkues ndaj shkelësve të ligjit.

Shkaku: Mos zbatim i legjislacionit nga IMTV për ndjekjen e hapave ligjorë për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave dhe aplikimin e kamat-vonesës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga Bashkia Vlorë, Drejtoria e të Ardhurave, Drejtoria Juridike dhe IMTV të merren masa për kryerjen e të gjitha procedurave që ligji parashikon, për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha masave administrative të vendosura nga IMTV. Gjithashtu, të merren masat për përlogaritjen e kamat-vonesës dhe vjeljen e saj në çdo rast që gjobat nuk paguhen brenda afateve të përcaktuara, të merren masa për vendosjen në dijeni dhe rritjen e bashkëpunimit me Shërbimin Përmbarimor, si dhe Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, Bashkia Vlorë.

Titulli i gjetjes 3: Bashkëveprim ndërinstitucional i ulët midis autoriteve vendore të kontrolli dhe mbrojtjes së territorit, si dhe mungesa në kontrollin mbi objektet me leje të miratuara.

Situata: Grupi i auditimit i kërkoi IMTV-së dokumentacionin lidhur me bashkëpunimin e IMTV-se dhe DPKZHT-se, planet një mujore dhe tre mujore të miratuara nga k/inspektori, si dhe kërkesat drejtuar DPKZHT për pajisjen me projektet e miratuara për ndërtimet objekt – kontrolli, të pajisura me leje zhvillimore / ndërtimi. Nga ana e IMTV u dorëzuan 4 kërkesat drejtuar DPKZHT për informacion, si dhe korrispondenca midis 2 strukturave në lidhje me proces-verbalin e konstatimit të kundërvajtjes me numër serie 000526, datë 19.11.2021. Nga sa vërehet më sipër, referuar Ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Neni 51, pika 3, si dhe, referuar Ligjit Nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, Neni 12, pika 10, rezulton se IMTV nuk ka kryer detyrat e saj, përcaktuar në legjislacionin dhe rregulloret e sipër-përmendura. Mungesa e bashkëpunimit midis strukturave, si dhe mungesa e planeve mujore dhe 3 mujore të miratuara nga k/inspektori, ul efektivitetin e kryerjes së detyrave, duke krijuar rrezik për mungesë inspektimi në të gjitha subjektet që shkelin ligjin. Gjithashtu, gjatë ushtrimit të detyrave funksionale IMTV duhet të kryejë kontrolle mbi zbatimin e punimeve në objektet me leje ndërtimi, referuar kjo VKM-së nr. 894, datë 04.11.2015, pika 2, për të kontrolluar nëse objekti po ndërtohet në përputhje me kërkesat e lejes së zhvillimit/të ndërtimit e të projektit teknik. Për përiudhën nën auditim nga IMTV nuk u paraqitën akte kontrolli të miratuara nga Kryeinspektori për kontrollet e ushtruara në objektet e pajisura me leje ndërtimi, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipër cituara dhe detyrat e Kryeinspektorit dhe inspektorëve të përcaktuara në Rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e administratës së Bashkisë Vlorë, neni 180, germa b, neni 180, germa i.

Situata 2: Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 894, datë 04.11.2015, “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektoriati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, pika 1, nën-pika b.ii), kryeinspektori duhet të hartojë planet mujore të punës dhe t’ua përcjellë këto plane inspektorëve. Ky informacion nuk është vendosur në dispozicion.

Situata 3: Në lidhje me të dhënat statistikore që IMTV duhet t’i japi IKMT-së çdo tre muaj, konstatohet se IMTV Bashkia Vlorë nuk e ka përgatitur dhe raportuar këtë informacion. Në zbatim të përcaktimeve të Ligjit nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, IMTV Vlorë ka për detyrë të raportojë në IKMT në mënyrë periodike mbi aktivitetin e tij, përkatësisht mbi gjobat e vendosura sipas llojit të

shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, mbi vendimet për pezullimin e punimeve, mbi vendimet për prishjen e ndërtimeve të kundër-ligjshëm etj. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezultoi se Kryeinspektori nuk ka përgatitur informacion periodik çdo tre muaj për masat e marra dhe nuk ka raportuar në IKMT në kundërshtim me përcaktimet ligjore sipërcituar.

Kriteri: Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, Neni 5, pika f); Neni 12, pika 10; Ligji 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 50, pika 2; Neni 51, pika 3; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 894, datë 04.11.2015, “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektoriati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, pika 1, nënpika b.ii); pika 2; Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e administratës së Bashkisë Vlorë, Neni 180, gërma b); Neni 180, gërma i).

Ndikimi/Efekti: Mungesa e bashkëpunimit midis autoriteteve lokale të mbrojtjes së territorit rrit rrezikun e zhvillimit të ndërhyrjeve jo-të ligjshme dhe abuzive. Mungesa e kontrollit dhe e akteve të kontrollit, sipas planeve mujore të inspektimit, të hartuara nga kryeinspektori, mbi objektet në ndërtim, të miratuar me leje ndërtimi, ul efektivitetin e punës kontrolluese të IMTV, si dhe rrit mundësitë e shantazhit nga projekti i miratuar. Mungesa e raportimit pranë IKMT në mënyrë periodike çdo tre muaj çënon bashkërendimin ndërinstitucional, nuk respekton detyrimin e raportimit të institucioneve të linjës, si dhe efektivitetin e kontrollit të territorit nga këto struktura.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime:

- Nga Bashkia Vlorë, DPKZHT dhe IMTV të merren masa për rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, të informojnë njëra-tjetrën mbi aktivitetin e tyre, si dhe të kërkojnë asistencë në rastet kur vlerësohet e nevojshme. Gjithashtu, IMTV në bashkëpunim me DPKZHT duhet të kryejnë kontrole periodike mbi objektet në zhvillim, të pajisur me leje ndërtimi, për të verifikuar ecurinë sipas projektit të miratuar. Gjithashtu, kryeinspektori i IMTV të marrë masa për të hartuar në mënyrë periodike plane mujore të punës për inspektorët, sipas zonave të kontrollit.

- IMTV Bashkia Vlorë të marrë masa për të përgatitur informacion periodik tre muaj ndaj Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) mbi aktivitetin e saj, procedurat e mbajtura gjatë kësaj kohe, vendimet e marra, si dhe informacion mbi rastet e trashëguara, për të cilat IKMT duhet të jetë në dijeni, sipas parashikimeve ligjore.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen më përgjegjësi:

- **z. F. H.**, me detyrë ish-Kryeinspektor i IMTV, Bashkia Vlorë;

- **z. I. Z.**, me detyrë ish-Kryeinspektor Bashkia Vlorë.

Lidhur me gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1026/10 prot; datë 24.07.2023, është observuar nga punonjësit e IMTV Bashkia Vlorë, me shkresën nr. 8690/1 prot; datë 20.07.2023. Grupi i auditimit është përgjigjur dhe ka argumentuar qëndrimin e tij në dokumentin e projekt-raportit të auditimit. Në vazhdim, është observuar mbi projekt-raportin e auditimit nga funksionarët dhe ish-funksionarët e Bashkisë Vlorë, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1026/29 prot; datë 03.11.2023, me anë të shkresës me nr. 11597 prot; datë 27.10.2023.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me mangësitë e konstatuar të planeve mujore të hartuara nga kryeinspektori për inspektorët, shprehen se, duke patur parasysh ndërtimin e strukturës së IMT, Bashkia Vlorë, ku inspektorët kanë të qartë me Urdhër të Brendshëm të Kryetarit ë Bashkisë ndarjen territoriale në grupe pune dhe rrjedhimisht detyrat funksionale të kontrollit të territorit sipas këtyre territoreve kanë qënë të qarta.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin tuaj, shprehem se, hartimi i planeve mujore të punës nga kryeinspektori për inspektorët është procedurë e parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara dhe në detyrat funksionale të parashikuara në rregulloren e Bashkisë Vlorë. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Titulli i gjetjes 4: Mangësi në dosjet individuale që IMTV duhet të mbajë për çdo procedurë.

Situata: Nga auditimi i procedurave të mbajtura nga IMTV, konstatohet se informacioni nuk është mbajtur në dosje individuale për çdo rast. Gjithashtu, dokumentimi fotografik, informacioni i cili është kërkuar, nuk është vendosur në dispozicion, informacioni i cili duhet të ishte pjesë e relacioneve përkatëse.

Kriteri: Rregullorja e Bashkisë Vlorë, Neni 182, pika b.3.

Ndikimi/Efekti: Mosmbajtja e dosjeve individuale për secilën procedurë, si dhe informacioni dhe dokumentacioni që duhet të përmbajë, cënon rendimentin e punës kontrolluese të inspektoriatit, si dhe dokumentimin e secilës procedurë, sipas parashikimeve ligjore.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e Bashkisë Vlorë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga IMTV, Bashkia Vlorë, të merren masa për të mbajtur informacionin në dosje individuale për secilin rast të konstatuar, të bëjnë pjesë të dosjes dokumentimin fotografik të konstatimit, si dhe atë të prishjes së objektit të kundërligjshëm, për ato raste kur procedura shoqërohet me vendim prishjeje.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen më përgjegjësi:

- **z. F. H.**, me detyrë ish-Kryeinspektor i IMTV, Bashkia Vlorë;
- **z. I. Z.**, me detyrë ish-Kryeinspektor Bashkia Vlorë.

Titulli i gjetjes 5: IMTV nuk ka kërkuar në asnjë rast heqjen e licencës profesionale për subjektet dhe mbikëqyrësit e punimeve, që kanë shkelur projektin e miratuar.

Situata: Referuar Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 52, IMTV ka detyrimin e kërkimit të menjëhershëm për heqjen e licencës së subjektit ndërtues, projektuesit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, për të gjitha ato raste kur këto subjekte devijojnë nga projekti i miratuar. Edhe pse IMTV ka kryer konstatime të tilla, në asnjë rast nuk është kërkuar heqja e licencës për subjektin.

Kriteri: Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 52, pika 5.

Ndikimi/Efekti: Moskryerja e kërkesave për heqje të licencës profesionale për subjektet dhe mbikëqyrësit e punimeve, që kanë shkelur projektin e miratuar, ndikon në ndëshkimin jo-proporcional të kundërvajtësve, ul efektivitetin e punës kontrolluese dhe mbrojtëse të IMTV, si dhe zbut efektin ndëshkues, në shkelje të përcaktimeve ligjore.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e Bashkisë Vlorë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Vlorë të marrë masa për të kërkuar në çdo rast që konstatohet shmangie nga projekti i miratuar, përveç ndëshkimit me masë administrative, heqjen e licencës profesionale për personat përgjegjës, sipas parashikimeve ligjore, me qëllim forcimin e masave për kontrollin e territorit dhe mbrojtjen e tij nga ndërhyrjet abuzive.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen më përgjegjësi:

- **z. F. H.**, me detyrë ish-Kryeinspektor i IMTV, Bashkia Vlorë;
- **z. I. Z.**, me detyrë ish-Kryeinspektor Bashkia Vlorë.

Titulli i gjetjes 6: Parregullsi në procedurat dhe vendimet e marra.

Situata: Në 5 (pesë) raste konstatohen parregullsi në vendosjen e masës administrative në raport me shkeljen e konstatuar:

- Për akt-konstatimin me nr. serie 000435, datë 10.01.2022, me shkelje “*Ndërtimi i objektit me mure blloku i pambuluar 1.2ml x 1.5ml x 1.8ml, pa leje të miratuar*”, ndërhyrje e cila ka të nevojshme lejen e ndërtimit, është marrë masa administrative sipas Ligjit 107/2014, Neni 52, pika 1, nënpika d), dhe jo sipas nënpikës e).

- Për akt-konstatimin me nr. serie 000495, datë 17.01.2022, me shkelje “*Ngritja e 29 kollonave betoni me lartësi 1.9ml*”, ndërhyrje e cila ka të nevojshme lejen e ndërtimit, është marrë masa administrative sipas Ligjit 107/2014, Neni 52, pika 1, nënpika d), dhe jo sipas nënpikës e).

- Për akt-konstatimin me nr. serie 000533, datë 18.01.2022, me shkelje “*2 mure me blloqe 1.2 x 1.5 ml dhe 30ml x 0.4ml*”, ndërhyrje e cila ka të nevojshme lejen e ndërtimit, është marrë masa administrative sipas Ligjit 107/2014, Neni 52, pika 1, nënpika d), dhe jo sipas nënpikës e).

- Për akt-konstatimin me nr. serie 000496, datë 31.01.2022, me shkelje “*Prishja dhe rindërtimi i mureve te fasades se jashtme*”, ndërhyrje e cila ka të nevojshme lejen e ndërtimit, është marrë masa administrative sipas Ligjit 107/2014, Neni 52, pika 1, nënpika d), dhe jo sipas nënpikës e).

- Për akt-konstatimin me nr. serie 000717, datë 27.12.2022, me shkelje “*Rikonstruksion total i objektit , prishje e strukturës ekzistuese mur mbajtës ndërtimi i kollonave dhe trareve B/A*”, ndërhyrje e cila ka të nevojshme lejen e ndërtimit, është marrë masa administrative sipas Ligjit 107/2014, “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, Neni 52, pika 1, nënpika d), dhe jo sipas nënpikës e).

Kriteri: Ligjit 107/2014, “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, Neni 52, pika 1, nënpika e), d). Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen më përgjegjësi: **z. F. H.**, me detyrë Kryeinspektor i IMTV, Bashkia Vlorë; **z. I. Z.**, me detyrë Kryeinspektor Bashkia Vlorë.

Ndikimi/Efekti: Parregullsitë në vendosjen e masave administrative sipas përcaktimeve ligjore ndikojnë në ndëshkimin e kundërvajtësve në mënyrë jo të drejtë më shkeljen e konstatuar.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e Bashkisë Vlorë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Vlorë të marrë masa që për përcaktimin e shkeljes dhe ndëshkimin e kundërvajtësit sipas dispozitave ligjore, duke i bashkangjitur përcaktimet ligjore sipas rregulloreve të miratuara. Konstatimet e kundërvajtjeve nga ana e inspektoratit ndërtimor duhet të jenë në përputhje me ligjin, dhe si rrjedhojë, edhe masat administrative të vendosura duhet të jenë konform shkeljes së konstatuar dhe parashikimit ligjor për to.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen më përgjegjësi:

- **z. F. H.**, me detyrë ish-Kryeinspektor i IMTV, Bashkia Vlorë;
- **z. I. Z.**, me detyrë ish-Kryeinspektor Bashkia Vlorë.

Lidhur me gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1026/10 prot; datë 24.07.2023, është observuar nga punonjësit e IMTV Bashkia Vlorë, me shkresën nr. 8690/1 prot; datë 20.07.2023. Grupi i auditimit është përgjegjës dhe ka argumentuar qëndrimin e tij në dokumentin e projekt-raportit të auditimit. Në vazhdim, është observuar mbi projekt-raportin e auditimit nga funksionarët dhe ish-funksionarët e Bashkisë Vlorë, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1026/29 prot; datë 03.11.2023, me anë të shkresës me nr. 11597 prot; datë 27.10.2023.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me problematikat e konstatuar, shprehen se akt-konstatimet të cituara janë marrë masat administrative sipas rasteve në mbështetje të Ligjit 107/2014, Neni 52, pika 1, nënpika d, ku objekti është konsideruar kundërvajtje që kërkon pajisjen me deklaratë paraprake punimesh në mbështetje të Nenit 41 të Ligjit 107/2014, të VKM-së nr. 408 të Rregullores së Urbanistikës dhe Nenit 7, pika 3, nënpika xiv) dhe vlera e gjobës 50 000 lekë është përlllogaritur sipas Nenit 52, pika 1, nënpika d). Në rastet kur është konstatuar kundërvajtja “ndërtim, riparim, restaurim, apo prishje të objektit egzistues me përjashtim të parashikuara në nenin 41 të Ligjit”, vlera e gjobës është përlllogaritur sipas vlerës së punimeve të konstatuara, shoqëruar me vendimin e prishjes së objektit dhe kallzimin penal të kundërvajtësit, në mbështetje kjo të Nenit 52, pika 1 nënpika e).

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin tuaj, shprehemi se, “Ndërtimi i objektit me mure blloku i pambuluar 1.2ml x 1.5ml x 1.8ml, pa leje të miratuar”; “Ngritja e 29 kollonave betoni me lartesi 1.9ml”; “2 mure me blloqe 1.2 x 1.5 ml dhe 30ml x 0.4ml”; “Prishja dhe rindërtimi i mureve të fasades së jashtme”; “Rikonstruksion total i objektit, prishje e strukturës ekzistuese mur mbajtës ndërtimi i kollonave dhe trareve B/A”, janë punime të cilat zhvillohen vetëm pas marrjes së lejes së ndërtimit, sipas përcaktimeve të Nenit 11 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Titulli i gjetjes 7: Mosrespektimi i detyrave funksionale duke lejuar ndërtimin e një objekti pa leje ndërtimi të miratuar.

Situata: Referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, rezulton se IMTV dhe DPKZHT, si dy strukturat përgjegjëse për zhvillimin e kontrolluar të territorit dhe mbrojtjen e tij, nuk kanë kryer detyrat e tyre funksionale duke lejuar fillimin e ndërtimit të një objekti banimi dhjetë kate përpara miratimit të lejes së ndërtimit, më konkretisht për objektin me leje ndërtimi të miratuar me vendim nr. 687, nr. 3293/1 prot; datë 04.10.2022 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për "Objekt banimi dhe shërbimi me 3 dhe 10 kate mbi tokë dhe papafingo, me 1 kat nën tokë" me adresë rr. "Gjergj Kastrioti", Vlorë, me subjekt zhvillues "F. I." ShPK. Nga auditimi u konstatua se ky objekt është pajisur me leje ndërtimi pasi ka filluar ndërtimin, më konkretisht, leja e ndërtimit për objektin në fjalë është miratuar në datën 04.10.2022. Nga këqyrja e fotografimit satelitor të periudhës Gusht 2021, si dhe nga verifikimi në terren, vihet re se objekti ka qenë në fazë ndërtimi. Pra, subjekti zhvillues e ka filluar ndërtimin e objektit pa marrë miratimin e autoriteti përgjegjës, në këtë rast Bashkia Vlorë, kjo në shkelje të Nenit 39 të Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe

Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar. Zhvilluesi ka aplikuar për miratimin e njoftimit të fillimit të punimeve në datën 04.04.2023 dhe është miratuar në datën 13.04.2023. Nga kontrolli në terren, konstatohet se objekti është në ndërtim, në katin e 5 teknik, në fazën e karabinasë.

Kriteri: Ligji 107/2014 “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”, i ndryshuar, Neni 39.

Ndikimi/Efekti: Ndërtimi i objekteve pa leje ndërtimi të miratuar nga autoritetet kompetente cënon në mënyrë flagrante zhvillimin e kontrolluar të territorit, mbrojtjen e tij, standartet e sigurisë, ato higjeno-sanitare dhe të mjedisit.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e Bashkisë Vlorë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Vlorë të marrë masa për të mos lejuar asnjë ndërtim të zhvillohet në kushtet e mungesës së lejes së ndërtimit të miratuar nga Autoriteti Kontraktor. IMTV duhet të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin nën juridiksionin e Bashkisë Vlorë në mënyrë periodike, sipas zonave të inspektimit të inspektorëve dhe planeve mujore të punës, të hartuara nga kryeinspektori, me qëllim parandalimin e zhvillimit të objekteve të kundërligjshëm, të papajisur me leje ndërtimi të miratuar.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen më përgjegjësi:

- **z. D. L.**, me detyrë ish-Kryetari i Bashkisë Vlorë;
- **z. F. H.**, me detyrë ish-Kryeinspektor i IMTV, Bashkia Vlorë;
- **z. I. Z.**, me detyrë ish-Kryeinspektor i IMTV, Bashkia Vlorë.

Lidhur me gjetjet e mësipërme, është observuar mbi projekt-raportin e auditimit nga funksionarët dhe ish-funksionarët e Bashkisë Vlorë, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1026/29 prot; datë 03.11.2023, me anë të shkresës me nr. 11597 prot; datë 27.10.2023.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me problematikat e konstatuar, shprehen se IMT Bashkia Vlorë, gjatë inspektimeve të kryera në objektin “Objekt banimi dhe shërbimi me 3 dhe 10 kate mbi tokë dhe papafingo me 1 kat nëntokë”, me adresë në rrugën “Gjergj Kastrioti”, i kryer nga subjekti “F. I.” ShPK, ka rezultuar me leje ndërtimi të miratuar me vendim nr. 687, datë 04.10.2022, dhe në zbatim të plotë të projektit të miratuar në këtë leje ndërtimi.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin tuaj, shprehemi se nuk justifikon dhe nuk argumenton fillimin e ndërtimit përpara miratimit të lejes së ndërtimit. Objekti rezulton të ketë filluar ndërtimin në periudhën Gusht 2021. Gjatë kësaj periudhe, Gusht 2021 – Tetor 2022, IMT nuk ka ushtruar detyrat e saj funksionale për identifikimin e ndërtimit të jashtëligjshëm. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Konkluzion i përgjithshëm mbi aktivitetin e inspektoriatit ndërtimor:

1. Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga DBNJ të Bashkisë Vlorë, struktura organizative e IMTV-së është në përputhje me Ligjin nr.9780 datë 16/07/2007, Neni 11, gjithsesi, referuar informacionit të dërguar nga IMTV, konstatohet se nuk ka asnjë punonjës me profil arsimimi teknik, profile të cilat janë të specializuara në njohjen e materialeve, strukturave, projekteve, si dhe evidentimit të gjendjes faktike të strukturave në raport me strukturat e miratuara me anë të vendimeve të organeve kompetent.

2. Në lidhje me nivelin e arkëtimit të masava administrative shprehemi se është i ulët, më konkretisht, në vitin 2021, janë vendosur në total 104 gjoba me vlerë 40,520,000 lekë nga të cilat

janë paguar në mënyrë vullnetare 15 gjoba (14.3% të numrit total të gjobave) me vlerë 1,350,000 lekë (3.3% të vlerës totale të gjobave). Në vitin 2022, janë vendosur në total 151 gjoba me vlerë 91,630,000 lekë, nga të cilat janë paguar në mënyrë vullnetare 20 gjoba (13.2% të numrit total të gjobave) me vlerë 1,850,000 lekë (2.02% të vlerës totale të gjobave). Nga auditimi rezulton se nuk është aplikuar kamat-vonesa 2%, e parashikuar në ligj, për personat ose subjektet të cilat nuk i kanë paguar këto gjoba brenda afateve ligjore.

3. Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me bashkëpunimin e IMTV-se dhe DPKZHT-se, planet një mujore dhe tre mujore të miratuara nga k/inspektori, si dhe kërkesat drejtuar DPKZHT për pajisjen me projektet e miratuara për ndërtimet objekt – kontrolli, të pajisura me leje zhvillimore / ndërtimi, rezulton se bashkëpunimi është në nivele të ulta, nuk janë përpiluar në mënyrë periodike planet mujore të punës për inspektoret, nga ana e kryeinspektorit, sipas zonave të kontrollit.

4. Nga auditimi i procedurave të mbajtura nga IMTV, konstatohet se informacioni nuk është mbajtur në dosje individuale për çdo rast. Gjithashtu, dokumentimi fotografik, informacioni i cili është kërkuar, nuk është vendosur në dispozicion, informacioni i cili duhet të ishte pjesë e relacioneve përkatëse.

5. IMTV nuk ka kërkuar në asnjë rast heqjen e licencës profesionale për subjektet dhe mbikëqyrësit e punimeve, që kanë shkelur projektin e miratuar. IMTV ka detyrimin e kërkimit të menjëhershëm për heqjen e licencës së subjektit ndërtues, projektuesit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, për të gjitha ato raste kur këto subjekte devijojnë nga projekti i miratuar.

6. Në lidhje me të dhënat statistikore që IMTV duhet t'i japi IKMT-së çdo tre muaj, konstatohet se IMTV Bashkia Vlorë nuk e ka përgatitur dhe raportuar këtë informacion. IMTV Vlorë ka për detyrë të raportojë në IKMT në mënyrë periodike mbi aktivitetin e tij, përkatësisht mbi gjobat e vendosura sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, mbi vendimet për pezullimin e punimeve, mbi vendimet për prishjen e ndërtimeve të kundër-ligjshëm etj.

7. Në **5 (pesë)** raste konstatohen parregullsi në vendosjen e masës administrative në raport me shkeljen e konstatuar, më konkretisht, në 1 rast shkelja e konstatuar është kategorizuar sipas Ligjit 107/2014, Neni 52, pika 1, nënpika e), kur në fakt duhet të kategorizohej sipas nënpikës d), duke e ngarkuar kundërvajtësin me një masë administrative më të madhe sesa parashikimi sipas nënpikës d), si dhe duke e kallëzuar penalisht; në 4 raste të tjera shkelja e konstatuar është kategorizuar sipas Ligjit 107/2014, Neni 52, pika 1, nënpika d), kur në fakt duhet të kategorizohej sipas nënpikës e), duke krijuar kështu rrethana lehtësuese për kundërvajtësin dhe duke marrë një masë administrative më të vogël se parashikimet ligjore.

8. Referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, rezulton se IMTV dhe DPKZHT, si dy strukturat përgjegjëse për zhvillimin e kontrolluar të territorit dhe mbrojtjen e tij, nuk kanë kryer detyrat e tyre funksionale duke lejuar ndërtimin e një objekti banimi dhe shërbimi me 3 dhe 10 kate mbi tokë dhe papafingo, me 1 kat nën tokë, pa leje ndërtimi të miratuar nga organet kompetente. Vlen të theksohet se ky objekt është pajisur me leje ndërtimi pasi ka filluar ndërtimin, më konkretisht, leja e ndërtimit për objektin në fjalë është miratuar në datën 04.10.2022. Nga këqyrja e fotografimit satelitor të periudhës Gusht 2021, si dhe nga verifikimi në terren, vihet re se objekti ka qënë në fazë ndërtimi.

Pika 7 e programit. Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i fundit.

Titulli gjetjes: Statusit të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 731/37 datë 2.6.2022

Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve dërguar me shkresën nr. 731/37 datë 2.6.2022, rezulton se:

Nga Bashkia Vlorë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 6562/1prot, datë 22.6.2022, brenda afatit ligjorë të **20 ditëve**.

Në lidhje me zbatimin e afatit **6 mujour**, në kushtet kur auditimi aktual korrespondon në periudhën që do të raportohet në KLSH, nuk është e nevojshme të bëhet raportimi pasi nga grupi i auditimit është pjesë e programit të auditimit.

Nga Bashkia Vlorë është hartuar “Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve”, me nr. 6562/2 prot datë 22.06.2022, duke përcaktuar edhe strukturat përgjegjëse sipas llojit të rekomandimit.

Nga Bashkia Vlorë nuk është raportuar në Këshillin Bashkiak, mbi rezultatet e auditimit të kryera nga KLSH dhe marrjen e masa për zbatimin e tyre, në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pika 5 e nenit 50-Auditimi i jashtëm.

Në mënyrë të përmbledhur situata e zbatimit të rekomandimeve paraqitet si vijon:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 46 masa organizative, të pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë zbatuar **18** masa, në proces auditimi janë **14** masa dhe **nuk janë zbatuar 14 masa**.

b. Për masa shpërblim dëmi janë rekomanduar 17 masa me vlerë 27,662,270 lekë, të pranuar nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar **3** masa me vlerë 701,728 lekë, në proces zbatimi **7** masë me vlerë 19,863,398 lekë dhe **nuk janë zbatuar 17 masa me vlerë 7,097,144 lekë**.

c. Për masa mungesë të ardhurash janë rekomanduar 21 masë me vlerë 968,844 mijë lekë dhe 700 000 EU, të pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë zbatuar **2** masa pa vlerë, janë në proces zbatimi **4** masa me vlerë 315,897 mijë lekë, nga e cila likuajduar vlera 484,000 lekë, **duke mbetur për likuajdim vlera 315,413 mijë lekë. Nuk janë zbatuar 15 masa me vlerë 652,946 mijë lekë**.

d. Për masa disiplinore, janë rekomanduar gjithsej **33 masa** të pranuar plotësisht dhe zbatuara nga subjekti.

e. Për masa administrative janë rekomanduar 15 masa të pranuar dhe zbatuara nga subjekti.

Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e Bashkisë Vlorë

Masat	Rekomanduar	Shprehur ne numër			Shprehur ne vlera në 000/lekë			
		Rek të zbatuara	Në Proces zbatimi	Rek të Pa Zbatuara	Vlera. Rekoman	Vlera. Zbatuar	Vlera. Proces	Vlera. Pa zbatuar
Masa Organizative	46	15	14	14				
Masa Për Shpërblim Dëmi	17	3	7	7	27,662	702	19,863	7,097
Masa mungesë të ardhurash	21	1	9	11	574,630	484	455,546	118,599
Ne euro					700,000			700,000
Masa Disiplinore	33	33						
Masa Administrative	12	12						
Kompetence e IMTV	3			3				
Totali leke	132	64	30	35	602,292	1,186	475,409	125,696
<i>Euro</i>					700,000			700,000

Kriteri: Ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa (j). ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Ndikimi/Efekti: Mos ndjekje të procedurave në arkëtimin e të ardhurave të munguara në vlerën **5,408 mijë lekë**.

Shkaku: Neglizhencë dhe papërgjegjshmëri e personave përgjegjës të ngarkuar me urdhrin nr. 6562/2 prot datë 22.06.2022 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë dhe mos marrja e masave të vetë kryetarit për verifikimin e urdhrave të nxjerra prej tij, respektivisht: **z. D. L., me detyrë ish-Kryetar i Bashkisë Vlorë; z. D. Z., në cilësinë e Drejtorit Financa/Buxhet; znj. S. H., në cilësinë e Drejtorit të Aseteve dhe Juridike; z. A. Rr., në cilësinë e Kryeinspektorit; z. Z. S., në cilësinë e Drejtorit të DPKZHT; z. E. L., në cilësinë e Drejtorit të Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë; z. M. M., në cilësinë e Drejtorit të Policisë Bashkiake.**

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces si më poshtë:

A. Masa organizative:

9.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë, të marrë masat e nevojshme që, të ngrëjë një grup pune i cili të identifikojë institucionet ku janë nxjerrë jashtë përdorimit materialet me profil metalik (Administrata Bashkia Vlorë, Gjendje Civile, Qendra Ekonomike, Çerdhe, Kopshte, Njësi Administrative, etj), si dhe komisionet përkatëse, për vitet 2019-2020.

9.2. Rekomandimi: Në vijim nga grupi i punës të përllorarit vlera e shitjes me ankand (peshë¹¹) vlera e tregut për 1 kg) të materialeve të mësipërme me profil metalik, që janë nxjerrë jashtë përdorimit në vitet 2019 dhe 2020.

9.3. Rekomandimi: Në përfundim të procesit të identifikimit dhe vlerësimit, Titullari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin në mënyrë përpjesëtimore, të vlerës së shitjes me ankand të materialeve me profil metalik.

10.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “Ujësjellës Kanalizime Vlorë” SHA me vlerë kontabël 632,287,414 lekë dhe të pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “F. F. C. SHA” me vlerë 3,500,000 lekë, në debi të llogarisë nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

12.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, si dy struktura përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme, por edhe kontrollin e zbatimit të objekteve të ndërtuara me leje apo në shkelje të saj, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga ligji nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, dhe ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, si dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit

¹¹ Specifikimet teknike të materialit, përmasa dhe pesha.

të territorit” të ndryshuar, të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për ndëshkimin e subjektit zhvillues **A. S.**, mbikëqyrësi **D. Gj.** i pajisur me licencë nr. MK2629, Subjekti ndërtues “**T. C.**” ShPK, dhe kolaudatori **N. J.** dhe trajtimin e ndërtimit të kundërligjshëm sipas referimit ligjor të sipërcituar, deri në kthimin e ligjshmërisë në fazën fillestare.

13.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, si dy struktura përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme, por edhe kontrollin e zbatimit të objekteve të ndërtuara me leje apo në shkelje të saj, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga ligji nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, dhe ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, si dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar, të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për ndëshkimin e subjektit zhvillues “**A. P.**” ShPK, dhe mbikëqyrësin “**I. RS**” ShPK dhe trajtimin e ndërtimit të kundërligjshëm sipas referimit ligjor të sipërcituar, deri në kthimin e ligjshmërisë në fazën fillestare.

14.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marrë masa për trajnimin e stafit i cili angazhohet me realizimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe rishikimin e dokumentacionit të projekt preventivave të cilat përgatiten nga konsulentët e përzgjedhur, për të përshtatur dokumentacionin sipas kërkesave ligjore.

15.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve që angazhohen me zbatimin e procedurave të prokurimit

17.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marrë masa për analizimin e arsyeve të mos realizimit të shërbimit të pastrimit sipas kërkesave në kontratën përkatëse, duke i kërkuar kontraktorit realizimin e tyre, aplikimin e penaliteteve për rastet e mos realizimit të kontratës dhe përlloraritjen e dëmeve të shkaktuara si pasojë e mos realizimit të kontratës.

21.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit në çdo rast përpara nxjerrjes së Çertifikatave të përdorimit dhe çdo dokumenti tjetër apo akti administrative të verifikohen rast pas rasti dokumentacioni i ngarkuar në sistemin E-Leje nëse janë në përputhje me kërkesat e legjislacionin në fuqi. Të hartohen procesverbalet përkatëse dhe të informohen subjektet e interesuara.

Në çdo rast në momentin e paraqitjes së kërkesës për pajisjen me çertifikatë përdorimi nga ana e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit të verifikohet situacionit përfundimtar me preventivin fillestar dhe të mbahen diferencat nëse dalin.

22.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, si dy struktura përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme, por edhe kontrollin e zbatimit të objekteve të ndërtuara me leje apo në shkelje të saj, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga ligji nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, dhe ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, si dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar, të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për vendosjen e penaliteteve ligjore ndaj subjektit zhvillues **T. Z.**, mbikëqyrësin, subjektin ndërtues dhe trajtimin e ndërtimit të kundërligjshëm sipas referimit ligjor të sipërcituar, deri në kthimin e ligjshmërisë në fazën fillestare.

23.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, të marrin masat për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme duke ushtruar kontroll në zbatimin e projekteve të objekteve të ndërtuara duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për vendosjen e penalteteve ndaj subjektit zhvillues, mbikëqyrësit dhe subjektin ndërtues.

23.2. Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për subjektin zhvillues “T.M.Z.B” ShPK, dhe mbikëqyrësin “A. M.” dhe trajtimin e ndërtimit të kundërligjshëm deri në kthimin e ligjshmërisë në fazën fillestare në referim të ligjit nr. 107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, dhe ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, si dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar.

23.3. Rekomandimi: Referuar shkeljeve, parregullsive dhe zhvillimit të ndërtimit në mungesë të dokumentacionit tekniko-ligjor, Bashkia Vlorë, të paraqesë kopje të plotë të gjithë dosjes të subjektit (“I.” ShPK dhe “T.M.Z.B” ShPK) dhe akteve të mbajtura nga strukturat përgjegjëse, të cilat do jenë objekt shqyrtimi dhe verifikimi pas vënies në dispozicion të tyre nga KLSH.

25.1. Rekomandim: Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë, të marrë masa për eliminimin e praktikave të llogaritjes së fondit limit vetëm nëpërmjet një metode (*testimit të tregut*) dhe me dokumentacion jo të saktë ligjorë, si dhe të eliminohen rastet e zhvillimit të procedurave të prokurimit të mallrave dhe shërbimeve të të njëjtit lloj.

33.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë dhe Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore të marrë masa për vlerësimin dhe regjistrimin si Aset të sistemit TAIS dhe kodin në burim të tij.

44.1.Rekomandimi: Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve të bashkëpunojë me Drejtorinë e Taksave Vendore duke kryer verifikimet për çdo subjekt që aplikon për tu pajisur me leje për shfrytëzimin e hapësirave të plazhit dhe pasi të jetë marrë konfirmimi me shkrim të vazhdojë procedurat për kryerjen e pagesës dhe lidhjen e kontratës.

45.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë të marrë masa dhe të analizojnë në Bashki dhe Këshillin Bashkiak, mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën 1005/74, datë 20.12.2018 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Vlorë”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës. Të hartohet plan pune i veçantë e të marren të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre.

Menjëherë

C. Masa për shpërblim dëmi

3.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marrë masa për zbritjen nga garancisë e punimeve të vlerës **370,000 lekë** përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “A.” ShPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara.

3.2.Rekomandimi: Bashkia Vlorë, në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, përpara përfundimit të garancisë së punimeve, të analizojnë dhe të nxjerrin rezultatin e plotë të volumeve të shtresave asfaltike të realizuara, duke zbritur vlerat përkatëse nga garancia e punimeve, në rast të konstatimit të diferencave në sasi.

4.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për verifikimin e sasisë dhe cilësisë së punimeve për realizimin e konstruksioneve metalike. Në

rast të mos përputhshmërisë me përcaktimet kontraktore, të merren masa për zbritjen nga garancia e punimeve të vlerës **381,981 lekë**, përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “A.” ShPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara.

5.1.Rekomandimi: Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë, me grup pune të analizojë situatën mbi gjendjen e karburantit të bërë hyrje-dalje dhe gjendje në magazinë dhe në përfundim të procesit të inventarizimit për diferencën e konstatuar të kërkohet shpërblimi i dëmit në shumën **804,530 lekë**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët në ngarkim të personave përgjegjës, konkretisht:

- vlera **211,887 lekë**, në ngarkim të punonjësës **znj. A. B.** me funksion magazinierë.
- vlera **592,643 lekë**, në ngarkim të punonjësit **ing. E. H.** me funksion Përgjegjës i Sektorit Teknik.

7.1.Rekomandimi: Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Përgjegjësën e Sektorit të Financës në NSHP, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **538,196 lekë** në ngarkim të shoqërisë “C.”, për mos zbatim në afat të punimeve sipas kontratës nr. 146, datë 11.06.2018.

9.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë, nëpërmjet Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit të marrë masa për kryerjen e kontabilizimit të detyrimeve në llogaritë debitore dhe nëpërmjet Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve e Drejtorisë Juridike të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës **prej 3,145,400 lekë**, nga subjektet e individ privatë.

13.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **125,844 lekë**, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti “A., P. dhe V. V.”.

14.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **1,565,508 lekë**, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti “H.-P.” ShPK.

Menjëherë

D. Masa për eliminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet.

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Taksave Vendore, të analizojë situatën e krijuar si pasojë e detyrimeve të krijuara nga UK SHA, Vlorë (në rolin e Agjentit tatimor), për Taksën e ndërtesës dhe tarifë pastrimi - gjelbërim-ndriçimi nga abonentët familjarë dhe të nënshkruajnë një akt- marrëveshje me këtë shoqëri, me qëllim marrjen e përgjegjësive ligjore nga palët dhe shmangien e veprimeve abuzive në mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

2.2.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Rajoneve dhe të Njësive Administrative, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat

e tarifrat vendore si edhe të hartohet regjistri i familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim rritjen e të ardhurave.

2.3.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë, të marrin masa duke bashkëpunuar me UK-Vlorë si dhe të ndjekin të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **148,587,530 lekë**.

- Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë të bashkëpunojë me UK sha, për evidentimin e vlerës së patarifuar prej **196,996,337 lekë** dhe nëse ka shmangie në lidhje me ndjekjen dhe mos arkëtim të detyrimeve për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit të aplikohet masë administrative ndaj agjentit tatimor .

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, të kërkojë arkëtimin detyrim të llogaritur si penalitet në vlerën **1,517,789 lekë** për pagesë me vonesë subjektit “D.” ShPK.

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të kërkojë arkëtimin e detyrim të llogaritur si mos mbajtje e saktë e taksës në vlerën **79,145,441 lekë** subjektit “B.” ShPK.

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të kërkojë arkëtimin e detyrim të llogaritur si mos mbajtje e saktë e taksës në vlerën **36,538,289 lekë** subjektit “B.” ShPK.

9.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë, të marrë masat për të bërë të mundur arkëtimin e shumës prej **700,000 Euro** nga T. P. në zbatim të vendimit të arbitrazhit. Të merret informacion nga pala e autorizuar S. B. McK. për ecurinë e deritanishme të procedurave të ndjekura për arkëtimin e këtij detyrimi.

10.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë, nëpërmjet Drejtorisë së Investimeve Publike, Strehimit dhe Transportit, të marrë masa që të pajisë 17 subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, duke arkëtuar shumën prej **17,000,000 lekë** si edhe të arkëtojë duke aplikuar tarifrat e plota për 19 subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për diferencën debitore prej **15,200,000 lekë**. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të tyre.

11.2.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e kësaj takse nga të gjithë individët me status “debitorë” në shumën **3,385,382 lekë**, bazuar në legjislacionin tatimor.

12.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë të ndjekin procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimit prej **347,040 lekë**, tarifë qiraje e pa paguar nga subjekti qiramarrës “I. A.”.

12.2.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë të analizojnë situatën e krijuar dhe të marrin masa për vënien në zbatim të VKB nr.101, datë 03.10.2019 “Për miratimin e dhënies së pasurisë së paluajtshme (Thertore) me qira në Njësinë administrative Novoselë”, miratuar me afat 5 vjet dhe vlerë qiraje 44,740 lekë/muaj, me qëllim shfrytëzimin e këtij ambienti dhe rritjen e të

ardhurave të Bashkisë, pasi vetëm për periudhën 2 vjeçare është shkaktuar një e ardhur e munguar në shumën **1,073,760 lekë**.

13.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë, Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, në bashkëpunim me MZHETT-s referuar VKB nr. 60, datë 27.10. 2016 të rishikojë dhe të amendojë kontratën e datës 04.06.2002 dhe aneks-kontratën e datës 03.07.2013, duke bërë ndryshimet përkatëse në objektin e kontratës dhe në përcaktimin e pagesës sipas sipërfaqes së re të konstatuar nga matjet faktike të kryera në terren prej 14,932 m² janë sipërfaqe trualli funksional dhe 28 m² sipërfaqe ndërtese, e konstatuar nga matjet faktike të kryera në terren në dakortësi me qiramarrësin, si dhe të aplikohen ndryshimet e tarifës së qirasë/m² truall funksional nga ndryshimi i legjislacionit, duke përcaktuar edhe periudhën e fillimit të detyrimit.

13.2.Rekomandimi: Strukturat drejtuese, të analizojnë situatën e krijuar dhe të nxjerrin përgjegjësitë administrative ndaj personave përgjegjës që kanë shkaktuar efekt negativ financiar në shumën **10,198,440 lekë**, për mos përcaktimin e pagesës sipas sipërfaqes së re të konstatuar nga matjet faktike të kryera në terren si edhe mos aplikimin e tarifave të reja të qirasë/m² duke favorizuar subjektin **“I. I” ShPK**.

14.1.Rekomandimi: Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Financë Kontabilitetit, të marrë masa për kryerjen e rakordimeve në lidhje me subjektet të cilat nuk kanë kryer pagesat për shfrytëzimin e hapësirave të plazheve dhe kanë shfrytëzuar këto hapësira për vitet 2018-2021, duke kryer arkëtimin e vlerës prej **14,903,440 lekë**.

15. Gjetje nga auditimi: Sipas procedurës së prokurimit “Rikonstruksion i rrugës Panaja-Hoshtime”, kanë marrë pjesë 4 ofertues, nga të cilët janë skualifikuar 3 ofertuesit si më poshtë:Nga ana e KVO duhet të merrej në konsideratë se transporti në rrugën standarde, megjithëse distanca është pak mbi 30 kilometër, të konsiderohej si devijim i vogël. OE “Sh. 07” ShPK, ka paraqitur ofertë anomalish të ulët dhe nga ana e KVO duhet të kërkoheshin sqarime për zërat e preventivit, nëse argumentohej apo jo mundësia e realizimit të kontratës. Sa më sipër, duke marrë në konsideratë faktin se nga rruga standarde për të cilën është parashikuar realizimi i transportit, ka një distancë pak më të madhe se 30 kilometër, e cila mund të konsiderohej devijim i vogël, faktin se oferta është anomalish e ulët, për të cilën nuk janë kërkuar sqarime, si dhe faktin se nga OE përkatës nuk ka patur ankesë, **vlera 2,956,640 lekë**, e cila del nga diferenca e ofertës së OE fitues “A.” ShPK me ofertën e paraqitur nga OE “Sh.” ShPK, konsiderohet efekt negativ financiar. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE fitues “A.” ShPK, rezulton se dokumentacioni për mekanizmin ekskavator me zinxhirë, i përket një mekanizmi me goma. Veprim në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik.

15.1 Rekomandim: Bashkia Vlorë të shqyrtojë vlerësimin e ofertave për këtë procedurë, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për mangësitë e përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit, nga KVO.

16.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë nëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Njësinë Prokurimit të saktësojë listat e bizneseve të ndërtimit që kanë qenë zbatuese të lejeve të ndërtimit dhe të projekteve të investimeve të prokuruar për vitet 2018-2019-2020-2021, që kanë seli jashtë territorit të Bashkisë Vlorë dhe Njësi Administrative dhe që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, të nxjerrin njoftim detyrimin për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës së kësaj tarife prej **2,890,000 lekë** si edhe marrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve debitore në vlerën **2,280,000 lekë**.

17.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë nëpërmjet strukturave të NJA-ve, Drejtoria e Pronave Publike

dhe Menaxhimit të Aseteve dhe Drejtoria Juridike të marrë masa për monitorimin dhe rishikimin e kontratave për subjektet private që janë debitore, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për anulimin e kontratave që nuk janë aktive si dhe ndjekjen e arkëtimit e detyrimeve debitore.

18.3.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë dhe Sektori Pyjeve dhe Kullotave të marrë masa për ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimit e vlerës debitore **prej 210,000 lekë, nga subjekti “N.” ShPK.**

F.2. Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit për mos zbatimin e kontratave në afat, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar me Ligjin nr. 120/2020, datë 07.10.2020 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Vlorë t’i kërkojë **Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor**, Bashkia Vlorë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të bëjë propozimin për fillimin e procedurës disiplinore me gjobë, për:

1. znj. I. S. përfaqësues i shoqërisë “I.-18” ShPK, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për mos ndjekjen e kushteve të kontratës nr. 263, datë 25.7.2019 të lidhur midis institucionit NSHP Bashkia Vlorë ka lidhur me shoqërinë “L.” ShPK, për përfundimin në afat të punimeve, veprime me efekt negativ me dëm në vlerën **207,030 lekë.**

2. znj. R. N. përfaqësues i shoqërisë “R.-18” ShPK, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për mos ndjekjen e kushteve të kontratës nr. 400/1, datë 15.11.2019 të lidhur midis institucionit NSHP Bashkia Vlorë ka lidhur me shoqërinë “S.” ShPK, për përfundimin në afat të punimeve, veprime me efekt negativ me dëm në vlerën **827,777 lekë.**

3. Shoqëria “D.” ShPK, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin “Rikonstruksion i rrugës Panaja-Hoshtimë”, për certifikim të punime me vlerë 370,000 lekë, të cilat nuk janë realizuar.

Menjëherë

Pika 8 e programit. Mbi administrimin e asetëve dhe regjistrimin e tyre në ASHK dhe kontabilitet.

- **Hartimi i regjistrit kontabël të asetëve që ka në administrim Bashkia Vlorë.**

Nga auditimi i kryer dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se; në Bashkinë Vlorë për pronat të cilat janë pajisur me certifikatë pronësie nuk kanë të hartuar regjistrin kontabël të asetëve që ka në administrim Bashkia Vlorë, veprime që bien në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kreu III regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes se tyre, regjistri i aktiveve të njësisive të sektorit publik ku citohet;

26. Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.

27. Nëpunësi Autorizues i njësisë, brenda strukturës së institucionit, cakton nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit.

28. Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë.

30. Formati i regjistrimit të aktiveve hartohet në varësi të llojit të tyre, afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në varësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

31. Njësia publike e qeverisjes së përgjithshme duhet të mbajë një regjistër të veçantë për secilën nga pronat e dhëna me qira, shoqëritë tregtare në të cilat shteti zotëron aksione dhe kontratat e koncesionit dhe enfiteozës.

1. Nga auditimi, dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se; me ndarjen e re territoriale Bashkisë Vlorë i janë shtuar 4 njësi Administrative.

Inventari i pronave, në zbatim të ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe në mbështetje të Pikave 9, 10, 11 dhe 22 të VKM nr.500, datë 14.8.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, nuk janë ngritur grupet e punës, kjo e përcaktuar në misionin dhe detyrat e saj për administrimin e aseteve, si dhe struktura e ngarkuar për ndjekjen e tyre. Nga auditimi sipas dokumentacionit që na u vu në dispozicion dhe deklaratime verbale të punonjësve; drejtori i menaxhimit të aseteve, drejtori i fondit pyjor dhe kullotave, ish/drejtori i AMTP tokave bujqësore, u konstatua se:

Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Vlorë dhe Njësi Administrative që përmbledh kjo bashki nuk janë inventarizuar si dhe nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale. Dokumentacioni dhe të dhënat përkatëse në lidhje me asetet e Bashkisë janë vënë në dispozicion me shkresa zyrtare nëpërmjet VKM-ve përkatëse, si më poshtë:

Në Bashkinë Vlorë është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim Bashkia Vlorë, të miratuar me VKM nr.639 datë 29.9.2007, lista me 81 (tetëdhjetë e një) fletë, fillon me numrin 1 (një) dhe përfundon me numrin 825 (tetëqind e njëzet e pesë).

Njësia Novoselë është miratuar lista e inventarit paraprak e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim me VKM nr.500 datë 14.8.2001, lista me 114 (njëqind e katërbëdhjetë) fletë, fillon me numrin 1 (një) dhe mbaron me numrin 765 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë).

Njësia Qendër Vlorë, është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim, miratuar me VKM nr.453 datë 22.05.2013, ‘të ish-Komunës Qendër Vlorë’ lista me 171 (njëqind e shtatëdhjetë e një) fletë, fillon me numrin 1 (një) dhe përfundon me numrin 1279 (një mijë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë).

Njësia Qendër Vlorë, miratimi i listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, shtojca e miratuar me VKM nr.754 datë 28.5.2008, miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të Njësisë së Qeverisjes Vendore, ish-Komuna Qendër Vlorë” lista me 1 (një) fletë, fillon me numrin 1 (një) dhe përfundon me numrin 23 (njëzet e tre).

Njësia Shushicë është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim, lista e inventarit paraprak miratuar me VKM nr.478 datë 25.07.2012, lista me 224 (dyqind e njëzet e katër) fletë, fillon me numrin 1 (një) dhe mbaron me numrin 1822 (njëmijë e tetëqind e njëzet e dy).

Njësia Orikum është miratuar lista paraprake e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim, lista e inventarit paraprak miratuar me VKM nr.937 datë 26.12.2012, ka në listën e inventarit 208 pasuri.

-Nga Bashkia Vlorë nuk janë ngritur grupe pune në bashkëpunim me DVASHK Vlorë në lidhje me regjistrimin e pronave sipas listave të inventarëve paraprakë të Bashkisë dhe Nj/Administrative.

Gjithashtu, lidhur me listat e pronave të paluajtshme në këto njësi, nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik, me qëllim dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentet e pronësisë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” datë 05.03.2020, Neni 37 “*Përditësimi nga institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore 1. Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. 2. Procedura e përditësimit mbështetet në: a) verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së; b) verifikimin e gjendjes juridike të pronës. Institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore i kërkon ASHK-së informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligj. 3. Në përfundim të këtyre verifikimeve, institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore i paraqet për shqyrtim ASHK-së listën e pronave shtetërore të përditësuar, pjesë e detyrueshme e së cilës është dokumentacioni hartografik”.*

Titulli gjetjes: Transferimi dhe Inventarizimi i aseteve në Bashkinë Vlorë

Situata: - Në zbatim të ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe në mbështetje të Pikave 9, 10, 11 dhe 22 të VKM nr.500, datë 14.8.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, rezultoise;nuk janë ngritur grupet e punës, për marrjen në dorzim të aseteve të transferuara në pronësi të Bashkisë Vlorë dhe Njësiave Administrative që përmbledh kjo bashki nuk janë ngritur grupet e punës për inventarizimin si dhe nuk janë marrë në dorëzim pronat,kjo e përcaktuar në misionin dhe detyrat e saj për administrimin e aseteve, si dhe struktura e ngarkuar për ndjekjen e tyre. *drejtori i menaxhimit të aseteve, drejtori i fondit pyjor dhe kullotave, ish/drejtori i AMTP tokave bujqësore.*

Kriteri: Sipas VKM-së, nr.500 datë 14.8.2001“Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”,nr.8744, datë 22.02.2001“Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore.

Ndikimi/Efekti: Bashkia Vlorë nuk ka kryer evidentimi dhe inventarizim e pronave, sipas VKM-ve, përkatëse, si rezultat nuk ka një pasqyre të qartë për pronat që ka në adnmininstrim.

Shkaku: Mos ngritja e grupeve të punës nga titullari i institucionit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë, të marrë masa dhe të ngrëjë grupet e punës me specialist të fushës për të evidentuar dhe për të kryer inventarizimin e aseteve sipas llojit të asetit dhe të marrë në dorëzim me procesverbal përkatës për çdo aset.

- **Identifikimi i asetëve të cilat janë zaptuar dhe masat e marra nga bashkia për kthimin e tyre në administrim të saj.**

Në lidhje me trojet, ndërtesat dhe sheshet publike, nuk ka raste të zaptimit të pronës, si në rastet kur janë të pajisur me dokument pronësie ashtu dhe në rastet të cilat janë në administrim të Bashkisë Vlorë.

Për sa i përket Drejtorisë së Pyjeve/Kullotave, sipas informacionit të vënë në dispozicion rezultoi se në bashkinë Vlorë nuk ka pyje dhe kullota të zaptuara nga palë të treta.

- **Vlerësimi i punës së ZAMT-ve për tokat bujqësore, azhurnimet e kryera mbi zbatimin e ligjshmërisë për veprimet e kryera në marrëdhëniet e ndryshimeve të pronësisë dhe regjistrimi në ASHK.**

Nga auditimi i kryer në lidhje me ZAMT, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se; Drejtoria e Tokave, është krijuar në vitin 2016, referuar parashikimeve të bëra në VKM nr. 994 datë 9.12.2015, e përbërë nga specialistë, të cilët menaxhonin secili nga 1 njësi administrative, pra 4 njësitë administrative të Bashkisë Vlorë dhe 1 drejtor. Kjo drejtori ka funksionuar mbi verifikimet e dokumenteve të sjella nga qytetarët për pajisje me AMTP. Pasi fermerët që ishin të pajisur me AMTP paraqiteshin pranë çdo njësie administrative, fillonte procedura për certifikimin e tokave bujqësore sipas AMTP-ve të cilat pasqyronin sipërfaqet e tokave të mara sipas *Ligjit 7501 dt. 19.07.1991 "Për tokën" i ndryshuar*, nëse kishte pasuri të cilat ishin të pasqyruara në AMTP, paraqiste kopje të certifikatës së pronësisë dhe kopje të AMTP-së. Më pas bëhej verifikimi në terren nga specialistët, prej tyre përgatitej dokumentacioni që i bashkëlidhej AMTP-së, plan rievimi, plan vendosje, certifikata familjare për kooperativat dhe NB-të, vërtetim të pagesës së taksës së tokës, relacion pas verifikimit në terren, vërtetim banimi, AMTP. Fermeri në zbatim të kërkesave të paraqitura sipas VKM nr. 994, date 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi" i ndryshuar, referuar edhe kërkesave të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, përgatiste dokumentacionin para noterit, Deklaratë Noteriale bashkëlidhur plan rievimet e pasurive dhe plan vendosjet. Ky dokumentacion i përgatitur nga specialistët e çdo njësie përcillej nga njësi administrative në bashki, në zbatim të parashikimeve të bëra në VKM Nr. 994, datë 9.12.2015,

"Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi", i ndryshuar, përcillej në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë.

Nga verifikimi me zgjedhje, dosjet e përgatitura ishin në përputhje me VKM-të e sipërcituara. Me daljen e Ligjit Nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", i cili i jepte kompetenca të plota ASHK-ve.

- **Mbi administrimin e asetëve të Bashkisë Vlorë.**

Sipas ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, bashkitë kanë qenë të detyruara të paraqisnin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që kërkonin t'u transferoheshin. Për bashkinë Vlorë, lista e pronave është miratuar me VKM nr.574, datë 28.05.2009 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë dhe VKM-së nr.639, datë 29.09.2007 "Për miratimin e listës së pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim

të Bashkisë Vlorë, ndërsa VKM paraprake njësia administrative Novoselë dhe njësia administrative Orikum.

Për njësitë administrative Novoselë dhe Orikum nuk kanë dalë VKM-të përfundimtare, por janë vetëm VKM paraprake.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga strukturat e Bashkisë Vlorë rezulton se; në strukturën aktuale organizative të Bashkisë Vlorë është krijuar drejtoria e Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve, e cila ka në vartësi dhe sektorin, Toka bujqësore të pandara, por rezulton se ka mungesë të stafit, në këtë drejtori.

Për njësitë administrative kanë dalë VKM përkatëse të miratuara nga ministrinë e linjës, bashkëlidhur ndodhen listat e inventarëve me nr. fiq dhe nr. rendorë, ndërsa në dy njësi administrative janë VKM paraprake. Rezulton se në total nr. i pasurive që i janë transferuar Bashkisë Vlorë, është rreth 4,415 pasuri, nga të cilat janë të certifikuar 44 pasuri, janë dërguar për certifikim 12 pasuri mbeten pa certifikuar 4,371 pasuri pra e përkthyer në 10% e pronave e certifikuar.

Nga auditimi rezultoi se nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e asetëve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.), dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Kjo strukturë duhet të realizonte **marrjen në dorëzim të asetëve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV**, vënien në evidencë të ndërtesave me sipërfaqe dhe tokës bujqësore produktive dhe jo produktive të përcaktuara në listat e inventarëve, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira. Si pasojë e mos inventarizimit të gjithë pronave, për të gjitha asetet nuk është hapur regjistër kontabël, në kundërshtim me kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Aktualisht nga strukturat e Bashkisë administrohen lista të plota apo të pjesshme të pronave që ka bashkia sikurse janë:

- Lista e pronave të paluajtshme të njërive administrative dhe bashkisë, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Vlorë”. Pronat që transferohen janë të klasifikuara në 11 kategori sikurse janë: Në përdorim - Prona të lira dhe hapësira të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji; Në pronësi – Infrastrukturë, rrugë vendore, lulishte, sheshe dhe shërbime publike, shërbime funerale, prona në fushën e mbrojtjes civile, prona për funksione të shërbimit social, prona social-kulturore dhe sportive, prona për zhvillimin ekonomik, për shëndetin publik, për realizimin e programeve arsimore, prona në fushën e bujqësisë tokë bujqësore dhe jo bujqësore.

Bashkia Vlorë nuk ka një regjistër në nivel bashkiak për të gjitha asetet që ajo zotëron, në pronësi.

- Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik,
- Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore,
- Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik,
- Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive,
- Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)
- Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile,
- Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike),
- Varreza publike.

Titulli gjetjes: Mbi menaxhimin dhe administrimin e asetëve

Situata: Sipas VKM-së, nr.574, datë 28.05.2009, ‘Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike’, ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 ‘Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore’, që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, lista e pronave është miratuar për tu transferuar pranë bashkisë por nga ana e Titullarit, nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e asetëve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.), dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar.

Kriteri: Ligji nr.8744, datë 22.2.2001 ‘Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore’.

Ndikimi/Efekti: Bashkia Vlorë nuk ka një regjistër në nivel bashkiak, për të gjitha asetet që ajo zotëron, në pronësi.

Shkaku: Mos ngritja e grupeve të punës nga titullari i institucionit.

Rëndësia : I lartë

Rekomandimi: Titullari i institucionit në bashkinë Vlorë, të marrë masa dhe të ngrejë grupet e punës për të kryer inventarizimin e asetëve sipas llojit të asetit dhe të marrë në dorëzim me procesverbal përkatës për çdo aset.

Përmbledhëse e pronave sipas listës së inventarit si dhe VKM-ve, përkatëse të njërive administrative dhe Bashkisë Vlorë

Numri i pronave të Bashkisë Vlorë dhe i njërive administrative pranë kësaj bashkie

Tabela nr.1

Nr.	Bashkia/ Njësitë	Nr. Pronave në Inventar	Nr. i Praktikave të Certifikuara	Prona të pa Regjistruara
1	Bashkia Vlorë	720	10	710
2	Njësia Novoselë	765		765
3	Njësia Qendër	900		900
4	Njësia Shushicë	1822		1822
5	Njësia Oriku	208	34	174
	Totali	4,415	44	4,371

Siç shihet dhe nga tabela është regjistruar një nr. i pa konsiderueshëm i pronave pranë bashkisë, ndërsa për pasuritë e tjera nuk ka asnjë informacion nëse janë në proces certifikimi nga DVASHK Vlorë.

Për praktikën e përmendur më sipër të cilat janë përcjellë për regjistrim nga Bashkia Vlorë në Drejtorinë Vendore të Kadastrës Vlorë, pretendohet se problematikat e mos regjistrimit janë të natyrave të ndryshme. Pjesa më e madhe e këtyre praktikave janë të pa trajtuara nga ana e DVASHK Vlorë, sipërfaqe të konsiderueshme të pronës janë të pa azhurnuara, ka diferencë dokument–fakt (sipërfaqja e inventarit e miratuar me terrenin), ka mbivendosje të pronave, mungesë të ardhurash.

-Rezultoni se Bashkia Vlorë nuk ka kryer veprimet sipas VKM nr.433, datë 08.06.2016, VKM nr.600, datë 13.10.2021, Ligjit nr.10296 /Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, për ngritjen e grupeve përkatëse të punës për marrjen në dorëzim dhe regjistrimin e pronave për një numër të madh të tyre sipas tabelës së mësipërme, çka bën të paqartë nr. e pronave sipas listave të

inventarëve pronë të bashkisë, për verifikim në terren nëse këto prona janë të lira, të zaptuara, ose të tjetërsuara nga palë të treta. Nuk janë kryer verifikime në terren të pasurive që bashkia ka në inventar, si dhe në kundërshtim me rregulloren e brendshme kreu IV, neni 50, Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë pika 14, «Nxjerr urdhër dhe vendime në zbatim të detyrave që rrjedhin nga aktet e këshillit si dhe nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi».

- Nuk janë dhënë vlerat e trullit dhe të ndërtesave të regjistruara në ZRPP, nuk është kryer inventarizimi i trojeve me komision, veprim në mospërputhje me VKM nr.510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu II pika 1,2,3,4, si dhe Kreu (VI) “Transferimi pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika (1); (2),

Nga certifikimi i këtyre pronave nuk janë ngritur komisione për marrjen në dorëzim të pronave, si dhe vlerësimin e tyre, nuk janë hartuar regjistra të aktiveve në kundërshtim të udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, ” Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu III. Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre, Regjistri i aktiveve të njërive të sektorit publik pika 26, çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar, pika 27, Nëpunësi Autorizues i njësisë, si dhe pika 30. Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre, afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Veprime që bëjnë përgjegjës Titullarin e Njësisë, si dhe drejtorët përkatës. Sipas rregullores së brendshme Kreu IV, neni 66, pika a,b,e,f. drejtorit të menaxhimit të pronave si dhe neni 67, pika b,c,d,f,g, të specialistit të kontabilitetit.

-Auditim mbi procedurat e ndjekura nga Bashkia për regjistrimin e asetëve në ASHK. Evidentimi i numrit total të asetëve që ka Bashkia, sipas llojit të asetit, numri i regjistruar dhe numri i pa regjistruar në ASHK.

Tabela përmbledhëse mbi menaxhimin dhe administrimin e asetëve sipas llojit të pasurisë.

NR	Lloji i pronës	Numri i pronave në inventar	Prona të regjistruara	Prona në proces regjistrimi	Prona të paregjistruara
1	Kulturë	10			10
2	Arsim	57	1		56
3	Shërbim Publik	5	4		1
4	Kabina Plazhi, truall rërë	11			11
5	Kulturë Sport	7			7
6	Shëndetësi	3			3
7	Tokë bujqësore, joproduktive	5			5
8	Infrastrukturë, truall	223			223
9	Institucione shtetërore	44	9		35
10	Vendstrehime	314			314
11	Zhvillim Ekonomik	4			4
12	Pyll, kullote	46			46
13	Varrezat e Dëshmorëve	1			1
14	Pemtore, ullishte	3			3
	Total	733	14		719

Siç shihet nga tabela e mësipërme sipas VKM-ve përkatëse sipas zërave, për 4 njësitë administrative rezulton se, një numër i lartë i pasurive sipas VKM nuk janë regjistruar pranë Bashkisë Vlorë, por mbeten vetëm në përdorim të tyre .

Veprime që bien në kundërshtim me VKM për inventarizimin e pronave si dhe ligjin 20/2020 Kreu IV, neni 37, pika 1, 2, germa a, b.

-Me procesverbalin nr.105/6, datë 16.03.2022, mbajtur nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike me objekt mbi fillimin e inventarizimit fizik të të gjithë pasurive që janë në administrim të ndërmarrjes së Shërbimit Publik Rrugë, në zbatim të Urdhrit nr.88 datë 29.12.2021, Inventarizim

për rrugët mbi bazën e kartelave të marra nga dega e financës me komision të përberë nga: **Ing. D. H.; Ing. A. L.; Ing. F. Rr.**

Rezultoi se nga 48 rrugë të cilat ishin në listat e inventarit vetëm 7 rrugë gjendeshin dhe ishin në ristrukturim, për 41 rrugë nuk ka informacion dhe të dhëna nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike. Po me të njëjtin urdhër dhe me të njëjtin komision është mbajtur procesverbali me datë 28.02.2022, mbi fillimin e inventarizimit për **trotuaret**, ku pas verifikimit rezultoi se nga 4 trotuaret e paraqitura në inventarë një citohet se është në ristrukturim, ndërsa 3 trotuare nuk gjenden.

Konkluzion: Nuk është vepruar sipas VKM-së nr. 600, datë 13.10.2021, pika 1) dhe pika 6) e VKM -së, “Për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimin e pronësisë nëpërmjet enteve pronare të rrugëve”, pasi nga Kryetari i Bashkisë nuk është hartuar dhe ngritur asnjë grup pune për fillimin e procesit të marrjes në pronësi të rrjetit rrugor.

-Drejtoria e Regjistrimit të Pronave nuk ka përcjellë pranë Drejtorisë së Financës Kontabilitetit dhe Buxhetit dokumentacionin përkatës edhe për arsye se, një pjesë e objekteve janë të trashëguara dhe të mbartura nga njësitë që u shkrinë (*ish/komunat*) në periudhat raportuese para vitit 2015 të pa shoqëruar me kartela objekti, nuk evidentohet viti i ndërtimit. Në këto kushte, për mospërputhjet në administrim, për çdo objekt të “Ndërtesave e Konstruksioneve” nga njësia publike vendore Bashkia Vlorë, kërkohet menjëherë të bëhet hedhja në kontabilitet e objekteve dhe sipërfaqeve të regjistruara nga Drejtoria e Regjistrimit të Pronave, saktësimi i objekteve, dokumentimi me kartelë objekti, inventarizim fizik i objektit, si dhe rivlerësim me normat për secilin objekt, veprim në mospërputhje me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika (1); (2).

Sipas të dhënave nga Bashkia Vlorë dhe të dhënat nga Njësitë Administrative sipas VKM-ve paraprake përkatësisht sipas tabelës.

- Nga ku rezultoi se në bazë të: VKM nr.500, datë 14.8.2001, VKM nr.453, datë 22.05.2013, VKM nr.754, datë 28.5.2008, VKM nr.478, datë 25.07.2012, në asnjë rast nga Bashkia Vlorë si dhe katër Njësitë Administrative, pronat të cilat janë në listat e inventarëve nuk janë të regjistruara në ASHK-Vlorë.

Tabela me të dhënat të Bashkisë Vlorë, sipas njësive Administrative, sipas zërave të aseteve.

Nr.	Komuna	Vendimet paraprake	Lumë Km Kënetë Ha	Truall, ndërtesë M ²	Kullotë, dru zjarri, pyll prodhues, Lulishte Ha	Rrugë Km	Kanal kullues, ujitës, stacion pompimi rezervuar M ²
1	Vlorë	Nr.639 datë 29.09.2007		568,217	938	7	
2	Qendër	Nr.453 datë 22.05.2013	3,100 ha	1,366,537	300	11	292,910
3	Novoselë	Nr.500 datë 14.08.2001				10	
4	Orikum	Nr.937 datë 26.12.2012	39,1 km	34,373	2,706	9	97,395
5	Shushicë	Nr.3 datë 23.01.2013		277,110	3,210	12,7	1,481,100

Katër Njësitë Administrative, për të përpiluar në këtë mënyrë një pasqyrë të qartë të pasurive të paluajtshme të bashkisë, me qëllim inventarizimin, vlerësimin, administrimin, regjistrimin, dhe dokumentimin në pasqyrat financiare, vjetore të Bashkisë Vlorë.

-Nuk është dërguar informacion me shkrim, për zyrën e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokave në Këshillin e Qarkut Vlorë në lidhje, me dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, të çdo viti si dhe në kundërshtim të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”;

pika 66 dhe UMF nr. 30 datë, 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pika 30,35/a; si dhe VKM-së, nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”.

Nga auditimi rezulton se; Bashkia Vlorë nuk ka inventarizuar apo përditësuar pronat e paluajtshme në asnjë nga Njësitë e saj Administrative, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, neni 17, pika a) neni 18, si dhe në mbështetje të pikave 9,10,11 dhe 22 të VKM nr.500, datë 14.8.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe VKM-në nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/ bashkive”, lidhur me listat e inventarit të pronave të paluajtshme të Njësive Administrative dhe në Bashkinë Vlorë, nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik me qëllim dërgimin e tyre në zyrat e DVASHK-së për pajisjen me dokumentet e pronësisë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” datë 05.03.2020, neni 37, “Për këto veprime mbajnë përgjegjësi kryetari i bashkisë z. D. L. dhe Drejtoria e Menaxhimit të Aseteve dhe strukturat përkatëse për inventarizimin e pronave sipas llojit të pasurisë, si dhe Agronomët e njësive Administrative.

- **Administrimi dhe inventarizimi Pyje/kullota**

Lista e pyjeve dhe kullotave të transferuara me VKM-në nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, ndryshuar me VKM nr. 684, datë 02.09.2020, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike” ku numri i pronave pyje dhe kullota dhe fletë inventari është 244, me sipërfaqe totale **10.430 Ha**. Nga auditimi rezulton se Bashkia Vlorë që nga transferimi i këtyre sipërfaqeve me VKM-në nr. 433, datë 8.6.2016, nuk ka iniciuar asnjë procedurë për verifikimin në terren dhe regjistrimin e kësaj sipërfaqe dhe më pas kalimin në fazën tjetër atë të pajisjes me certifikatën e pronësisë për sipërfaqet pyjore, kullosore dhe shkëmbore që administrojnë. Nga auditimi rezultoi se janë certifikuar pranë ish/zyrës se hipotekës

Sipërfaqe e certifikuar 45,76 ha.

Këto Sipërfaqe janë pjesë të ngastrës 19 zona kadastrale 8604 të pyllit të Sodës (fidanishtja) të zënë me ndërtime e cila sipas planit vendor të Bashkisë Vlorë ka kaluar si zonë informale. Këto ndërtime janë në proces legalizimi.

Këto Certifikime janë bërë në vitet 2009-2013-2015, në këtë periudhë bashkitë kishin në administrim nga 40 deri në 60 % të fondit Pyjor-Kullosor.

Në vitin 2016, me krijimin e 61 bashkive sipas VKM nr.433, datë 8.6.2016, gjithë pasuria pyjore kullosore që administrohej nga ish DSHP-të (drejtoritë e pyjeve) dhe ish Komunat, kanë kaluar në pronësi publike të bashkive.

Sipërfaqe e Certifikuar 45.76 ha gjithsej, produkti përfundimtar për regjistrimin e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Vlorë është përgatitur nga konsorciumi i kompanive të

kontraktuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe është dorëzuar pranë Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë, për miratimin përfundimtar dhe certifikimin e produktit.

Në bashkinë Vlorë struktura përgjegjëse e pyjeve, nuk është e përditësuar me ndryshimet e reja të legjislacionit në fushën e pyjeve dhe konkretisht me VKM-në nr.171, datë 18.03.2022, “Ngritjen e bazës së të dhënave për Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor dhe regjistrin e fondit kullor si dhe manualin e përdorimit të programit ALFIS.

Nga auditimi rezulton se Bashkia Vlorë që nga transferimi i këtyre sipërfaqeve me VKM-në nr.433, datë 8.6.2016, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 22, shtojca me nr.33, në kundërshtim me pikën 64, pika 65, Ministri i Mjedisit dhe kryetarët e bashkisë përcaktojnë personat përgjegjës si anëtarë komisioni të përbashkët brenda 20 ditëve pune nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për transferimin e pronave nga Ministria e Mjedisit pranë Bashkisë Vlorë, si dhe pika 66 të ligjit, kryetarët e bashkive regjistrojnë sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullor të transferuar nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe nuk ka iniciuar procedura për verifikimin në terren dhe regjistrimin e kësaj sipërfaqe dhe më pas kalimin në fazën tjetër atë të pajisjes me certifikatën e pronësisë për sipërfaqet pyjore, kullorë dhe shkëmbore etj.. që administron.

-Gjithashtu nuk është vepruar sipas përcaktimeve të Ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, datë 05.03.2020, neni 37, “Përditësimi nga institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore 1. Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. 2. Procedura e përditësimit mbështetet në: a) verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së; b) verifikimin e gjendjes juridike të pronës. Institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore i kërkon ASHK-së informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligj. 3. Në përfundim të këtyre verifikimeve, institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore i paraqet për shqyrtim ASHK-së listën e pronave shtetërore të përditësuar, pjesë e detyrueshme e së cilës është dokumentacioni hartografik”.

-Bashkia Vlorë nuk ka hartuar planet e mbarështimit të kullotave në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për Fondin Kullor”, i ndryshuar me Ligjin nr. 49/2016, neni 26, “Bashkitë janë pronarë të kullotave që gjenden brenda territorit administrativ të tyre dhe kanë për detyrë të a) ruajnë, administrojnë dhe i përdorin kullotat dhe livadhet, në përputhje me kërkesat e këtij ligji e të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij; b) hartojnë, me shpenzimet e veta, planet e mbarështimit të kullotës apo livadhit, të cilat miratohen nga ministri përgjegjës për kullotat dhe livadhet”.

- nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e aseteve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.) dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Kjo strukturë duhet të realizonte **marrjen në dorëzim të aseteve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV**, vënien në evidencë të ndërtesave me sipërfaqe dhe tokës bujqësore produktive dhe jo produktive të përcaktuara në listat e inventarëve , duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira.

-Fondi Pyjor -

Në fondin Pyjor në Bashkinë Vlorë dhe Njësitë administrative, nuk administrohen kontrata, Ndërsa ne fondin kulloror janë miratuar 40 kontrata sezonale me afat 3-6 mujor, me objekt “kullota” dhe kositje bari, kontratat janë hartuar në përputhje me Ligjin nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullororë” i ndryshuar për blegtorinë:
Nga auditimi me zgjedhje të 23 dosjeve rezultoi se, dosjet nuk kishin parregullsi .

-Fondi Pyjor /kulloror

Në fondin Pyjor në Bashkinë Vlorë dhe Njësitë administrative, nga informacioni që kemi marrë në fondin kulloror janë miratuar 40 kontrata për vitin 2021 të gjitha sezonale me afat 6 mujor, me objekt “Kullota” dhe kositje bari, si dhe 37 kontrata sezonale për vitin 2022, nga auditimi rezultoi se kontratat sezonale janë në përputhje me Ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullororë” i ndryshuar për blegtorinë .

1.Sektori pyje-kullota Vlorë

Burimi: Njësitë administrative / Bashkia Vlorë

Tabela nr.1 Plani dhe realizimi i të ardhurave nga kullotat e dhëna me qira për vitin 2022,

Emërtimi	Kapaciteti i kullotave në/krerë gjithsej	Kullota gjithsej/ha	Planifikimi i të ardhurave	Sip. e dhënë me kontratë	Sip. me faturë	Krerë te kontraktuar	Të ardhurat Nga kullota
Kullota Verore	7909	2886,3	790.900	327		767	80.200
Dhen	4339		433.900			762	76.200
Dhi	3570		357.000				
Të Trasha	0		0			5	4.000
Kullota Dimërore	10982	4262.5	1.128200	1511		4500	456.300
Dhen	6684		668.400			3242	324.200
Dhi	4238		423.800			1249	124.900
Të Trasha	60		36.000			9	7.200
Totali	18891	7148.8	1.919.100	1838		5267	536500
Dhen	11203		1.102.300			4004	400.400
Dhi	7808		780.800			1249	124.900
Të Trasha	60		36.000			14	11.200

Burimi: Sektori Pyje –Kullota

Titulli gjetjes: Transferimi i në pronësi të bashkisë të fondit pyjor/kulloror

Situata: Drejtoria e Menaxhimit të Aseteve si dhe Drejtoria Pyje /Kullota rezultojnë se nuk kanë ngritur grupe pune /apo persona përgjegjës nga kryetari i bashkisë, sipas VKM Nr.433, dt. 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 22, shtojca me nr.33, në kundërshtim me piken 64, pika 65, Ministri i Mjedisit dhe kryetarët e bashkive përcaktojnë personat përgjegjës si anëtarë komisioni të përbashkët brenda 20 ditëve pune nga hyrja në fuqi e këtij vendimi ,për transferimin e pronave nga Ministria e Mjedisit pranë Bashkisë Vlorë, si dhe pika 66 e ligjit kryetarët e bashkive regjistrojnë sipërfaqet e fondit pyjor dhe kulloror të transferuar nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Kriteri: VKM nr. 433 dt.08.06.2016 të sipërpërmendur.

Ndikimi/Efekti: Mos evidentimi i fondit pyje/kullota, ka sjelle mos hartim dhe miratim të planeve të mbarështimi për menaxhimin e tyre me qëllim dhënien në përdorim, sipas parashikimeve të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”.

Shkaku: Mos ngritja e grupeve të punës nga titullari i institucionit, si dhe Drejtoria e Menaxhimit të Aseteve ka sjellë mos evidentim dhe inventarizim.

Rëndësia : E lartë

Rekomandimi: Titullari i institucionit në bashkinë Vlorë, të marrë masa dhe të ngrejë grupet e punës për të kryer inventarizimin pyje/ kullota.

Nga auditimi me zgjedhje i kontratave sezonale, nuk rezultuan parregullsi.

- **Tokat e lira bujqësore.**

Referuar të dhënave që administrojnë Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave (DZHBAPK), Bashkia Vlorë dhe njësitë administrative kanë gjithsej 17053.19 ha tokë bujqësore, nga të cilat 15524.19 ha është marrë nga banorët dhe 1837.5 ha është tokë e pa ndarë në pronësi të Bashkisë.

- Gjithashtu sipas të dhënave të Njesisë të Menaxhimit të Tokës në Drejtorinë e Pronave Publike & Menaxhimi Aseteve, rezulton se numri i familjeve të trajtuara me tokë është 11,070 fermerë me një sipërfaqe të përgjithshme prej 15,764 ha, të cilat të ndara sipas kategorisë së tokës dhe Njësive Administrative paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Numri i familjeve të trajtuara me tokë,

Tabela nr. 1: Sipërfaqja e tokës bujqësore në Bashkinë Vlorë

Nr.	Njësia Administrative	Tokë gjithsej	Tokë e marrë me AMTP (ha)	Sipërfaqe e pandarë në pronësi të Bashkisë (ha)
1	Nja Shushice	2845.071	2445.071	400
2	Nja Orikum	2412.88	2831.88	100.5
3	Nja Novoselë	6.524	5.785	528
4	Nja Qendër	5271.235	4,462.235	809
Shuma		17053.19	15524.19	1837.5

Burimi: Bashkia Vlorë

Theksojmë se kontrata për fonde pyjore , toka të pandara si dhe për objekte shtetërore nuk janë nënshkruar që nga viti 2013 e në vazhdim.

- **Tokat Bujqësore**

4.- Ligjshmëria e kontratave të qirave për tokat bujqësore. Nga auditimi, referuar të dhënave të audituara, Bashkia Vlorë ka dhënë me qira 354.54 ha tokë bujqësore të pa ndarë. Njësia Administrative Novoselë 211 ha, Njësia Administrative Qendër 55.9 ha dhe Njësia Administrative Shushicë 87.64 ha. Bashkia Vlorë nuk ka tokë në pronësi për dhënie me qira, ndërsa Njësia Administrative Orikum ka 100.5 ha tokë të pandarë por nuk ka lidhur kontrata për dhënie me qira.

Njësia Administrative Shushicë ka lidhur gjithsej:

1. 151 kontrata qiraje me afat për 99 vjet. Nga të cilat 113 qiramarrës paguajnë rregullisht detyrimet për qiranë, ndërsa 38 qiramarrës nuk kanë paguar detyrimin referuar kushteve të kontratave. Për 6 kontrata nga këto 38 është kërkuar zgjidhje e kontratës por nuk është bërë deri në fund të vitit 2022.

2. Për 26 kontrata me afat 10 vjeçar për të cilët qiramarrësit kanë paguar detyrimet në zbatim të kushteve të kontratave.

3. Janë 12 kontrata me afat 5-6 vjet të cilat kanë përfunduar në vitin 2020 dhe nuk janë kontraktuar më. Por sipas kërkesave të sjella sipas rasteve rezultoi se; janë lidhur **gjithsej 266** kontrata për

dhënie me qira të tokës bujqësore për mbjellje me ullinj apo arrorë. Qiramarrësit kanë lidhur kontrata, me afat 99 vjet. Në total sipërfaqja e dhënë me qira është 317.61 ha.

-*Me urdhrin nr.208 datë 27.09.2019*, Kryetari Bashkisë ka ngritur grupin e punës “Për verifikimin e pagesës së qirasë nga subjektet që kanë lidhur kontrata qiraje me bashkinë Vlorë dhe Ish/Komuna sot NJ/Administrative të Bashkisë Vlorë si dhe verifikimin e tokës bujqësore sipas destinacionit të përcaktuar në kontratë”.

Komisioni i përbërë nga ;

- **Sh. R.**, Nënkyetar i Bashkisë,

- **O. B.**, Drejtor i Taksave dhe Tarifave, Nënkyetar

- **D. Z.**, Drejtor i Drejtorisë Juridike, Anëtar

- **S. H.**, Përgjegjëse e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve , Anëtar

- **Th. Q.**, Agronom, Anëtar

- Specialistët e taksave dhe tarifave vendore sipas njësive administrative, Anëtar,

Pika 1. Bashkëpunimi me njësitë administrative të evidentojë të gjitha subjektet fizike dhe juridike të cilat kanë kontrata qiraje për tokat bujqësore , pagesën e qirasë si dhe detyrimet e pashlyera.

Pika 2. Grupi i punës të verifikojë për çdo kontratë qiraje destinacionin e përdorimit të parashkruar si dhe përdorimin faktik të tokës.

Pika 3. Verifikimet e kryera të pikës 1,2 të shoqërohen edhe me sipërfaqet përkatëse të tokës bujqësore dhënë në përdorim për çdo kontratë.

Pika 4. Në përfundim të procedurës grupi i punës të bëjë një raport përmbledhës me rekomandimet përkatëse për zgjidhjen e problemeve të konstatuara.

Pika 5. Afati i kryerjes së detyrave të realizohet brenda 30 ditëve nga dalja e urdhrit.

Komisioni nuk ka zbatuar urdhrin e kryetarit .

Procedura e ndjekur për lidhjen e kontratave

1.Nga të dhënat, Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve si dhe Njësitë Administrative Vlorë, administrojnë 266 kontrata të dhënies me qira të tokave të pandara, të lidhura që para reformës territoriale nga Ish-Komunat Qendër, Shushicë dhe Novoselë, si më poshtë.

Njësia Administrative Shushicë ka lidhur gjithsej:

1. Janë 151 kontrata qiraje me afat për 99 vjet. Nga të cilat 113 qiramarrës paguajnë rregullisht detyrimet për qiranë, ndërsa 38 qiramarrës nuk kanë paguar detyrimin referuar kushteve të kontratave. Për 6 kontrata nga këto 38 është kërkuar zgjidhje e kontratës por nuk është bërë deri në fund të vitit 2022.

2. Janë 26 kontrata me afat 10 vjeçar, për të cilat qiramarrësit kanë paguar detyrimet në zbatim të kushteve të kontratave.

3. Janë 12 kontrata me afat 5-6 vjet, të cilat kanë përfunduar në vitin 2020 dhe nuk janë rilidhur më.

2.Njësia administrative Qendër ka hartuar dhe nënshkruar 68 kontrata me afat 30 dhe 99 vjeçare me objekt përdorimi, shfrytëzim ullishte .

3. Njësia administrative Novoselë ka hartuar dhe nënshkruar 47 kontrata me afat 30 dhe 99 vjeçare me objekt përdorimi, shfrytëzim ullishte. Me një sipërfaqe prej 317.61 ha;

Tabela më poshtë na tregon numrin e kontratave të nënshkruara nga ish/komunat tani në administrim të nj/administrative.

Nr.	Emërtimi	Kontrata me afat 30-99 vjeçare	Sipërfaqja e tokës së ndarë	Sipërfaqja e tokës së dhënë me qira	Nr. i familjeve të trajtuara me tokë sipas ligjit 7501
1	Bashkia Vlorë	-		-	
2	Nj. Adm. Shushice	151	2375	84.460	1960
3	Nj. Adm. Qendër	68	5290	40.05	2886
4	Nj. Adm. Orikum	0	2412.88	-	1896
5	Nj. Adm. Novoselë	47	4950	193.1	3228
	Shuma	266	15027.88	317.61	9,970

Kontrata të lidhura nga ish/Kryetarët e komunave

1. Nga ish-Komuna Qendër, për periudhën 2008 - 2013 në referim të VKM nr.3, datë 16.05.2007, “Për tokat bujqësore të pandara” janë lidhur gjithsej 68 kontrata nga te cilat, 57 kontrata për qiradhënie **të tokave bujqësore të pandara** me afat 99 vjet, 10 kontrata me afat 30 vjeçar dhe 1 kontratë me afat 50 vite.

Nga verifikimi i dokumentacionit në **aspektin procedural**, rezulton se së pari, në dosjen përkatëse të kontratës së qirasë nuk ka inventar, mungon dokumentacioni i detyrueshëm të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit, rezulton se; kontrata nuk është në përputhje me VKM nr.3, datë 16.05.2007, “Për tokat bujqësore të pandara”, pasi:

- Mungon procesverbali i dorëzimit të kësaj prone nga ish/komuna Qendër.
- Mungon Plani i biznesit i detajuar etj..
- Mungojnë grupet e monitorimit të kontratave.
- Mungon grupi i punës për dorëzimin e pasurisë qiramarrësit, si rezultat nuk ka të dhëna për vlerën, pasi nuk ka dokumentacion kontabël mbi vlerën e administruar.

Nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve si dhe NJA nuk është realizuar në asnjë rast monitorimi i kontratave, pra nëse individë apo subjekte private qiramarrës kanë realizuar investimin sipas objektit të kontratës apo janë në kushtet e moszbatimit të saj. Për rastet e subjekteve debitorë, nuk ka prishje të kontratës për mos përmbushje të kushteve të saj nga subjekti përfitues/qiramarrës. Nuk është bërë mbikëqyrja e përdorimit të tokës bujqësore të marrë me qira mbi bazën e kartelës personale për çdo kontratë.

-Për periudhën 2008 - 2013 në referim të VKM nr.3, datë 16.05.2007, “Për tokat bujqësore të pandara”, janë lidhur 57 kontrata për qiradhënie **të tokave bujqësore të pandara**, me afat 99 vjet, 10 kontrata me afat 30 vjeçar dhe 1 kontratë me afat 50 vite. Nga verifikimi i pagesave deri më 30.12.2022 për kontratat e lidhura rezulton se, nuk janë shlyer detyrimet kontraktore dhe penaltitetet **mbështetur** në pikën 2 të kontratës së qirasë, në vlerën prej **902,270 lekë gjithsej**.

-Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 2 të kontratës dhe me kërkesat e ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, VKM nr. 531, datë 21.08.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, VKM nr.3, datë 16.05.2007, Udhëzimit të KM nr.1, datë 18.07.2012, “Për tokat bujqësore të pandara”, udhëzimit **nr.3, datë 16.5.2007**, “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, kushtet e kontratës sipas, **pika 4 e kontratës tip, monitorimi i subjektit**.

Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se, **Kontratat nuk janë regjistruar sipas udhëzimit nr.3 datë 16.5.2007, për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara si dhe në vendimin nr.549, datë 26.8.1996 të Këshillit të Ministrave, për regjistrim në zyrën vendore të pasurive të paluajtshme (ZVRPP), si dhe ligjit 33/12 neni 51** Regjistrimi i kontratës së qirasë pika 1, 2 .

- Theksojmë se; në asnjë rast në kushtet e kontratës nuk është cituar rishikimi i kushteve të kontratës pas një periudhe të caktuar. Si rrjedhojë e këtyre mos përcaktimeve kontratat nuk janë rishikuar, por kanë vazhduar aktivitetin e tyre sipas ligjeve, VKM-ve dhe udhëzimeve të shfuqizuara .

Konkretisht;

- VKM –së nr.373, datë 20.6.2018, për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe - kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të Shtetit, detyrimet sipas Kreut IV me nenin 2,3,4,5. pika 9.gërma a) b) c) ç) dh) f) si dhe pika 24.

- VKM -së nr.54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira të tokave shtetërore”.

- Udhëzimi nr. 6756/2015 për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, pika 21), njësitë monitoruese të kontratave të qirasë, pika 22)

Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara për monitorimin e detyrimeve kontraktuale të mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi: **znj. S. H.**, me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve; **znj. M. K.**, me detyrë Administratore e Njesisë Administrative Qendër, Vlorë.

2. Njësia administrative Shushicë, për periudhën Janar-Dhjetor 2013 e në vazhdim, në referim të VKM nr.3, datë 16.05.2007, “Për tokat bujqësore të pandara” janë lidhur gjithsej 161 kontrata (sipas aneksin bashkëlidhur Raport Auditimit) për qiradhënie nga këto, 154 kontrata me afat 99 vjeçar nga fondi i tokave bujqësore të pandara dhe 7 kontrata nga fondi kullor me sipërfaqe prej 45,721 ha. Nga verifikimi i pagesave deri më 30.12.2022 për kontratat e lidhura rezulton se nuk janë shlyer detyrimet kontraktuale dhe penalitetet **mbështetur** në pikën 2 të kontratës së qirasë, në vlerën prej **6,998,951 lekë gjithsej**.

- Siç shihet dhe nga tabela e mësipërme në 9 raste të dhënies me qira, nuk janë shfrytëzuar sipërfaqet.

Nuk janë ngritur grupe për verifikimin në terren nëse kryhet aktivitet nga qiramarrësi. Në rast shkelje, nga drejtoria e menaxhimit të asetëve duhet të hiqet drejta e përdorimit të sipërfaqes së tokës sipas kushteve të përcaktuara në kontratë. Për këto veprime mban përgjegjësi S. H. , me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve Drejtoresha e Asetëve dhe agronomi Alim Arshiaj i njesisë administrative, pasi nuk ka kryer verifikimin në terren të sipërfaqeve të dhëna me qira.

- *Nga ana e drejtorit të asetëve nuk është vënë në dijeni përmes informacionit apo (Memo), bordi i këshillit bashkiak për kontrata me afat 30-99 vite, për rishikimin e kushteve të kontratës sipas legjislacionit në fuqi.*

Lista e personave që kanë kontrata qiraje 10 vjeçare, Njësia Administrative Shushicë.

	Nj/Ad Shushicë		Afati					Detyrimi
Nr	Emër Mbiemër	Fshati	Vjet	SIP ha	Kultura	Parcela	F.Kontratës	Vjetor
1	F. A.	Drithas	10	1.35	Bime arash	110	10.02.2012	16200
2	G. A.	Drithas	10	0.7		134	20.09.2012	2800
3	A. A.	Drithas	10	3	Bime arash	282	20.02.2013	6000
4	H. T.	Llakatund	10	1	Per kullotje	361/1	17.10.2012	2000
5	A. B.	Llakatund	10	0.11	Bime arash	170,171	05.07.2012	1320
6	A. M.	Llakatund	10	0.511	Per kullotje	361	20.09.2012	3600

7	P. P.	Mekat	10	0.45	Bime arash	134/1	11.10.2012	5400
8	Q. P.	Mekat	10	1.2	Nuk ekz.ne lib kad	456/4	21.05.2012	1920
9	V. L. K.	Mekat	10	1	Bime arash	256/1	20.02.2013	2000
10	V. L. K.	Mekat	10	0.5	Bime arash	134	20.02.2013	6000
11	A. Q.	Mekat	10	22.4	Per kullotje	133,59,129	04.05.2012	16800
	K. K.	Mekat	10	47.38	Kullot	2639	04.05.2012	
12	Rr. M.	Mekat	10	0.15	Bime arash	134	24.10.2012	1000
13	I. K.	Mekat	10	0.15	Bime arash	134	21.03.2012	2250
14	P. D.	Mekat	10	0.56	Ullinj	10	07.12.2010	8400
15	M. Sh.	Beshisht	10	0.3	Pyll	40,48,50	11.10.2012	1600
16	B. C.	Beshisht	10	1	Pyll	40,41,42	11.10.2012	4000
17	N. M.	Beshisht	10	0.1	Pyll	40,48,50	11.10.2012	800
18	G. C.	Beshisht	10	1	Pyll	40,41,42	11.10.2012	4000
19	K. C.	Beshisht	10	0.1	Kullote	72	11.10.2012	400
20	K. C.	Beshisht	10	0.3	Pyll	40,48,49	11.10.2012	1600
21	P. Sh.	Beshisht	10	0.4	Kulote	110,105	18.10.2012	1600
22	T. P.	Tirane	10	28	Kullote	916/3,9/1,120,53	10.10.2012	80000
23	A. H.	Tirane	10	17.85	Kullote	53/2,54	10.12.2010	71200
24	A. H.	Tirane	10	21.61	Kullote	1/1,1/3,916/1	18.06.2012	259332
25	M. Sh.	Tirane	10	19.48	Kullote	48,53	10.12.2010	56000
26	M. Sh.	Tirane	10	20.52	Pyll	58	10.12.2010	56000
	SHUMA			141				612222

Burimi NJ/Ad/Shushicë

1.Nga auditimi i dosjeve të 26 kontratave me afat 10 vjeçar, rezultoi se; nuk ka inventarë të dosjeve, dokumentacioni është i cunguar dhe jo i plotë, gjithashtu rezultoi se; 12 kontrata janë hartuar në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, Neni 51, Regjistrimi i kontratës së qirasë pika 1. Çdo kontratë qiraje e bërë me akt noterial, për një pasuri të paluajtshme, me zgjatje kohore më shumë se 9 vjet, duhet të regjistrohet në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë së paluajtshme të qiradhënësit. Kontrata e qirasë, e bërë me akt noterial, për një pasuri të paluajtshme, me një zgjatje kohore mbi një vit, mund të regjistrohet në regjistrin e pasurisë së paluajtshme.Për këto kontrata nuk është marrë asnjë masë për ndërprerjen e tyre, nga drejtoria e menaxhimit të aseteve, pranë Bashkisë Vlorë.

2. Kur një kontratë qiraje është për një pjesë të një pasurie të paluajtshme, atëherë kartela ekzistuese e pasurisë së paluajtshme mbyllet dhe hapen kartela të reja për pjesën/pjesët që është/janë dhënë me qira dhe për pjesën/pjesët e pasurisë së paluajtshme që mbetet/mbeten, si dhe bëhen shënimet përkatëse në hartën kadastrale, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 33, të këtij ligji.

-12 kontrata janë të nënshkruara nga ish/kryetari i komunës z. **L. P.** në kundërshtim me kodin civil neni 826, “Kontrata e qirasë të pasurisë së paluajtshme, që shërben për kultivimin bujqësor për një kohë mbi nëntë vjet, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet në regjistrin publik”.

-Gjithashtu, në kontratën tip dispozita të veçanta, nuk është zbatuar pika 4, kontrolllet periodike. Nga drejtoria e menaxhimit të aseteve, nuk është marrë asnjë masë për gjithë periudhën për verifikimin në terren, si dhe nuk janë ngritur grupe pune për verifikim të sipërfaqeve pas përfundimit të kontratave.

Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në zbatimin dhe monitorimin e detyrimeve kontraktuale të mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: **znj. S. H., me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve; z. B. A., me detyrë Administrator i Njësisë Administrative Shushicë.**

3.Nga ish-Komuna Novoselë për periudhën 2008-2013 në referim të VKM nr.3, datë 16.05.2007, “Për tokat bujqësore të pandara” janë lidhur 48 kontrata për qiradhënie, me afat 99 vjeçar.

Për periudhën 2008-2013 në referim të VKM nr. 3, datë 16.05.2007, “Për tokat bujqësore të pandara” janë lidhur 48 kontrata për qiradhënie, me afat 99 vjeçar. Nga verifikimi i pagesave deri më 30.12.2022 për kontratat e lidhura rezulton se, nga 48 kontrata në 2 raste subjektet nuk ekzistojnë rezultuar nga verifikimi, ndërsa në 44 raste qiradhënësit janë debitorë, të cilët nuk kanë shlyer detyrimet kontraktore dhe penalitetet, **mbështetur** në pikën 2 të kontratës së qirasë në vlerën prej **49,621,292 lekë gjithsej.**

TABELA NR.1 TË TOKAVE ME QIRA NJESIA ADM.NOVOSELË,

N r	Qiramarrësi	Fshati	Nr.Kontrate	DATA KONTRATË S	E Afati/Vje t	Kultura	Të mbjella PO//JO	Sip.Ha
1	R. V.	Aliban	Kol.2970,Rep.5313	03.11.2008	99	Frutikulture	Jo	9.3
2	L. R.	Aliban	K.780,Rep.1455	04.05.2010	99	Ullishte	Verifikim	3
3	I. P. & M. Q.	Aliban	Kol.951,Rep.1292	28.03.2011	99	Ullishte	Jo	3
4	P. Dh.	Aliban	Kol.2303,Rep.4069	01.09.2008	99	Frutikulture	Jo	10
5	E. M.	Skrofotin	Kol.682,Rep.1292	20.03.2008	99	Frutikulture	Verifikim	1
6	V. M.	Skrofotin	Kol.3342,Rep.6044	10.12.2008	99	Ullishte	Verifikim	0.4
7	A. V.	Skrofotin	Kol.2848,Rep.4173	13.10.2009	99	Frutikulture	Jo	10
8	Gj. L. & J. K.	Skrofotin	Kol.4122,Rep.5929	21.01.2010	99	Frutikulture	Jo	10
9	Gj. L. & P. V.	Skrofotin	Kol.1109,Rep.1940	04.06.2010	99	Frutikulture	Jo	1.5
10	P. P.	Skrofotin	Kol.1105,Rep.2218	29.10.2010	99	Ullishte	Verifikim	0.22
11	L. M.	Trevllazer	Kol.324,Rep.616	05.03.2010	99	Ullishte	Po	2.24
12	Xh. L.	Trevllazer	Kol.626,Rep.1169	21.03.2011	99	Ullishte	Po	2.2
13	G. M.	Trevllazer	Kol.1038,Rep.1789	03.04.2009	99	Ullishte	Po	2
14	S. M.	Trevllazer	Kol.1067,Rep.1824	04.04.2009	99	Ullishte	Po	2
15	D. M.	Trevllazer	Kol.4018,Rep.5731	08.01.2010	99	Ullishte	Verifikim	0.5
16	I. M.	Trevllazer	Kol.526,Rep.831	06.02.2009	99	Ullishte	Po	1
17	Dh. D.	Mifol	Kol.879,Rep.1855	26.04.2011	99	Ullishte	Po	0.12
18	J. H.	Poro	Kol.2326,Rep.4113	03.09.2008	99	Frutikulture	Po	0.38
19	Y. Xh.	Poro / Akërrni	Kol.2382 , Rep.4190	03.09.2008	99	Kopshti Botanik	Jo	10
20	A. B.	Bishan	Kol.4112,Rep.5898	20.01.2010	99	Fidanishte	Jo	0.17
21	V. J.	Bishan	Kol.3022,Rep.5396	06.11.2008	99	Fidanishte	Jo	10
22	I. Xh.	Novosele		0.942719907	99	Ullishte	Verifikim	0.385
23	Gj. L. & O. Gj.	Skrofotin	Kol.1110,Rep.1941	04.06.2010	99	Frutikulture	Jo	1.8
24	T. M. & A. V.	Skrofotin	Kol.291,Rep.559	04.02.2008	99	Frutikulture	Jo	10
25	A. V.	Skrofotin	Kol.1402,Rep.4086	05.10.2007	99	Frutikulture	Jo	10
26	P. M.	Skrofotin	Kol.341,Rep.658	11.02.2008	99	Frutikulture	Po	1

27	R. L.	Bishan	Kol.1382,Rep2600	03.06.2008	99	Frutikulture	Po	10
28	M. M.	Trevllazer	Kol.658,Rep.1230	24.03.2011	99	Ullishte	Po	0.96
29	A. B.	Mifol	Kol.446,Rep.904	04.03.2011	99	Vreshtari	Verifikim	0.19
30	R. C.	Akerni	Kol.908,Rep.1916	29.04.2011	99	Ullishte	Jo	0.38
31	N. Ll.	Novoselë	Kol.757,Rep1467	07.04.2011	99	Ullishte	jo	0.8
32	S. M.	Skrofotin	Kol.1387,Rep2615	04.06.2008	99	Fidanishte	Po	0.17
33	R. N.	Poro	Kol.973,Rep2045	10.05.2011	99	Ullishte	Verifikim	0.63
34	L. R.	Aliban	Kol.947,Rep.2007	06.05.2011	99	Ullishte	Jo	4
35	N. B.	Skrofotin	Kol.181,Rep.370	23.01.2008	99	Ullishte	Jo	4.6
36	Dh. G.	Skrofotin	Kol.367,Rep.598	29.01.2009	99	Ullishte	Verifikim	4.5
37	N. D.	Aliban	Kol.627,Rep.1063	28.04.2011	99	Ullishte	Jo	3
38	Gj. V.	Trevllazer					Verifikim	2
39	L. L.	Trevllazer	Kol.891,Rep1521	19.03.2009	99	Ullishte	Verifikim	2.86
40	A. D:	Aliban	Vendim Nr 582/1 Prot	10.11.2008	99	Frutikulture	Verifikim	10
41	A. D.	Bishan	Vendim Nr435/1Prot	20.08.2008	99	Frutikulture	Verifikim	8.7
42	Gj. L. & E. G.	Skrofotin	Kol.444,Rep882	19.03.2010	99	Frutikulture	Verifikim	0.75
43	Gj. L.	Skrofotin	Kol.0025,Rep0055	07.01.2008	99	Ullishte	Jo	10
44	Gj. L. & Ll. H.	Skrofotin	Kol.530,Rep1036	29.03.2010	99	Frutikulture	Jo	1
45	M. L.	Trevllazer	Kol.2846,Rep.4769	12.10.2009	99	Ullishte	Po	2
46	B. A.	Delisuf	Vendim Nr 96 Prot	09.02.2009	99	Frutikulture	Jo	10
47	Gj. L. & S. P.	Skrofotin	Vendim Nr 332 Prot	06.11.2007	99	Frutikulture	Jo	4.95
48	A. V.	Delisuf	Kol.2969,Rep.5312	27.10.2008	99	Frutikulture	jo	10
	Totali							193.1

Burimi njësia Novoselë

Për të gjitha rastet e kontratave ku subjektet qiramarrës janë debitorë nga Bashkia Vlorë nuk është bërë asnjë veprim për verifikimin dhe rishikimin e kontratave, si dhe ndryshimin e kushteve apo anulimin e tyre, rimarrjen e parcelave që ato shfrytëzojnë. Nuk është kryer asnjë procedurë ligjore për zgjidhjen e këtyre kontratave.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi: **z. K. Sh.**, Administrator i Njesisë Novoselë dhe **znj. S. H.**, me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve; **z. A. H.**, Agronom pranë njësisë.

4. Njësia administrative Orikum nuk ka kontrata qiraje sepse nuk ka toka të pandara dhe ato toka që janë i janë kaluar në administrim nga Agjencia e Trajtimit të Pronave.

-Për të gjitha rastet e kontratave ku subjektet qiramarrës janë debitorë, apo nëse janë në përputhje me kushtet e kontratës, nga Bashkia Vlorë nuk është bërë asnjë veprim për verifikimin, rishikimin dhe ndryshimin e kushteve të kontratave apo anulimin e tyre, rimarrjen e parcelave që ato shfrytëzojnë, si edhe nuk është kryer asnjë procedurë ligjore për zgjidhjen e këtyre kontratave. Gjithashtu për kontratat e nënshkruara nga Ish/Komunat, në asnjë rast nuk janë kryer monitorime, veprime që bien në kundërshtim me udhëzimet përkatëse si dhe me nenin 826 të kodit civil, nenin 827, "Qiradhënësi me anë të inventarit i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme si tokën bujqësore, kullotat, si dhe neni 829, "Qiradhënësi ka të drejtë që në çdo kohë të ushtrojë

kontroll mbi pasurinë e dhënë me qira për të përcaktuar nëse qiramarrësi respekton marrëveshjen sipas detyrimeve të vëna në kontratë, sipas natyrës dhe rregullave agroteknike;
Gjithashtu nuk është vepruar sipas rregullores së brendshme viti 2018 neni 34,35, Misioni i Njësive Administrative, “Mbikëqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin”.

Nga auditimi me zgjedhje për hartimin dhe nënshkrimin e kontratave si dhe dokumentacioni shoqëruar rezultuan, parregullsi dhe shkelje të ligjit dhe udhëzimeve si më poshtë .

1. Rezultojnë që kontratat e qirasë nuk janë të regjistruara pranë ish/ZRPP-ve, veprime që bien në kundërshtim me ligjin nr. 33 /2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neni 51, veprime në kundërshtim me ligjet dhe udhëzimet e sipërcituara. Gjithashtu nuk është vepruar sipas rregullores së brendshme viti /2018, neni 34,35, Misioni i Njësive Administrative, “Mbikëqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin”,

2. Në të gjitha rastet për kontratat e hartuara nga njësitet administrative, në kontrata tip, të nënshkruara nga Ish/Kryetarët e komunave nuk është respektuar neni 3) të drejtat dhe detyrimet e palëve, pika a) planimetria e tokës së dhënë me qira, pika c) të ushtrijve kontrolle periodike mbi gjendjen e fondit të tokës bujqësore, gjithashtu rezultojnë veprime jo në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 827, neni 829, VKM Nr.54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Udhëzimi nr. 6756/2015 për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, pika 21), pika 22)

- vendimit nr. 373, datë 20.6.2018, Kreu IV, “Procedurat që ndiqen për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” germa dh) e) ë) Pika 4.1 germa a) dh) .

Konkluzion; Në 266 kontrata të nënshkruara me afat 30-99 vjeçar, nuk janë marrë masa nga ana e drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve për rishikimin e kushteve të kontratave si dhe ndryshimet ligjore që janë ndër vite, nuk janë rishikuar sipas VKM Nr.54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” si dhe **udhëzimit nr.6756/2015**, mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Titulli gjetjes: Dhënie me qira e 266 kontratave të tokave bujqësore të pandara, me një afat 30-99 vjeçar.

Situata: Nga Bashkia Vlorë nuk është bërë asnjë veprim për verifikimin, rishikimin dhe ndryshimin e kushteve të kontratave apo anulimin e tyre, rimarrjen e parcelave që ato shfrytëzojnë, si edhe nuk është kryer asnjë procedurë ligjore për zgjidhjen e këtyre kontratave. Nuk është bërë mbikëqyrja e përdorimit të tokës bujqësore të marrë me qira mbi bazën e kartelës personale për çdo kontratë.

Gjithashtu nuk është vepruar në asnjë rast sipas rregullores së brendshme të viti /2018 neni 34,35 Misioni i Njësive Administrative “Mbikëqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e Bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të Bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin”.

Kriteri: Neni 826 te kodit civil, me neni 827”Qiradhënësi me anë inventari i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme si tokën bujqësore, kullotat.

Ndikimi/Efekti: Ushtrimi i veprimtarisë nga qiramarrësit për tokat bujqësore pa dokumentacioni e detyrueshëm, Sipas VKM përkatëse.

Shkaku: Mos ngritja e grupeve të punës nga titullari i institucionit, si dhe mos marrja e masave nga Drejtoresha e Menaxhimit të Aseteve dhe Pronës Publike, për mbikëqyrjen e kontratave dhe rinovimin e tyre në rastet kur ka shkelje.

Rëndësia : I lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve dhe Pronës Publike, të marrin masa për ngritjen e grupeve të punës për rishikimin e kontratave.

Gjithashtu pas lidhjes së kontratës së qirasë ose të enfiteozës, të behët dorëzimi te qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi me procesverbal të objektit të përshkruar në kontratë, sipas genplanit përkatës. Në procesverbal të përshkruhen qartë gjendja fizike e pronës, vlera kontabël e objektit që jepet me qira ose enfiteozë, germa d) Për çdo kontratë të lidhur.

Titulli gjetjes: Kontrata e nënshkruar nga ish/Kryetarët e komunave.

Situata: Në asnjë rast në kushtet e kontratave të nënshkruar nga ish/Kryetarët e komunave nuk janë cituar në kontrata rishikimi i kushteve të kontratës pas një periudhe të caktuar.

Si rrjedhojë e këtyre mos përcaktimeve në kontratë , kanë vazhduar aktivitetin e tyre sipas ligjeve, VKM-ve dhe udhëzimeve të shfuqizuara nuk janë respektuar neni 3) të drejtat dhe detyrimet e palëve, pika a) planimetria e tokës së dhënë me qira, pika c) Të ushtrojë kontrole periodike mbi gjendjen e fondit të tokës bujqësore, si dhe veprime në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 827 “*Qiradhënësi me anë inventari i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme si tokën bujqësore, kullotat, e drejta e kundërshtimit të përmbajtjes së inventarit dhe prezumimi i saktësisë së tij rregullohet sipas dispozitave të këtij kreu*” si dhe neni 829 “*Qiradhënësi ka të drejtë që në çdo kohë të ushtrojë kontroll mbi pasurinë e dhënë me qira për të përcaktuar nëse qiramarrësi respekton marrëveshjen sipas detyrimeve të vëna në kontratë, sipas natyrës dhe rregullave agroteknike*”.

Kriteri: Neni 829 i kodit civil, me neni 827 “Qiradhënësi me anë inventari i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme si tokën bujqësore, kullotat”, si dhe neni 829.

Ndikimi/Efekti: Nuk është bërë rinovimi i kontratave sipas ndryshimeve ligjore.

Shkaku: Mos ngritja e grupeve të punës nga titullari i institucionit, si dhe mos marrja e masave nga Drejtoresha e Menaxhimit të Aseteve dhe Pronës Publike për mbikëqyrjen e kontratave dhe rinovimin e tyre sipas ndryshimeve ligjore.

Rëndësia : E lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve dhe Pronës Publike dhe Drejtorinë Juridike nëpërmjet strukturave të Njësive Administrative, të marrë masa për rishikimin e kushteve të kontratave për subjektet private me afat 30 dhe 99 vjeçare, nëse plotësojnë kushtet kontratave dhe të rishikohen për ndryshimin e tarifave sipas legjislacionit në fuqi.

Titulli gjetjes: Kontratat me qira për tokat bujqësore të pandara, pranë Bashkisë Vlorë janë të pa regjistruara.

Situata: Nga auditimi rezultoi se në asnjë rast kontratat me qira për tokat bujqësore të pandara nuk janë regjistruar, sipas udhëzimit nr.3 datë 16.5.2007 për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara kundrejt tarifës së përcaktuar në vendimin nr.549, datë 26.8.1996 të Këshillit të Ministrave, në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP), **Ligjit 33/2012, neni 51** Regjistrimi i kontratës së qirasë pika 1, 2 si dhe neni 57, pika 1,2,3 e ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën” Regjistrimi i kontratës së qirasë dhe enfiteozës.

Kriteri: Udhëzimit nr.3 datë 16.5.2007 për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara sipas **nenit 51** Regjistrimi i kontratës së qirasë pika 1, 2 si dhe neni 57, pika 1,2,3 e Ligjit 33/2012.

Ndikimi/Efekti: Nuk është kryer regjistrimi i kontratave në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë së paluajtshme të qiradhënësit, me akt noterial.

Shkaku: Mos ngritja e grupeve të punës nga titullari i institucionit, si dhe mos marrja e masave nga Drejtoresha e Menaxhimit të Aseteve për mbikëqyrjen e kontratave dhe rinovimin e tyre në rastet kur ka shkelje.

Rëndësia : E lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve dhe Pronës Publike të marrin masa që çdo kontratë qeraje për një pasuri të paluajtshme, me zgjatje kohore më shumë se 9 vjet, duhet të regjistrohet në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë së paluajtshme të qiradhënësit. Kontrata e qirasë, e bërë me akt noterial, për një pasuri të paluajtshme, me një zgjatje kohore mbi një vit, mund të regjistrohet në regjistrin e pasurisë së paluajtshme.

-Monitorimet

Nga Administratorët e 4 njësive administrative Vlorë, nuk janë lëshuar në asnjë rast urdhra për ngritjen e grupeve të punës për monitorimin e kontratave. Veprime që bien në kundërshtim me pikën e kontratave si dhe VKM nr.54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. VI. Monitorimi i kontratave,

1. Monitorimi i kontratave të qirasë dhe të enfiteozës drejtohet nga organi që ka lidhur kontratën e qirasë ose të enfiteozës. Monitorimi bëhet nga njësitë monitoruese që janë institucionet shtetërore, shoqëritë tregtare dhe ish-ndërmarrjet shtetërore, që kanë në administrim objektet e dhëna me qira ose enfiteozë, si dhe nga degët e shoqërive publike pranë prefekturave.

2. Njësia monitoruese e kontratave të qirasë ose të enfiteozës kryen këto detyra: a) Pas lidhjes së kontratës së qirasë ose të enfiteozës, bën dorëzimin të qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi me procesverbal të objektit të përshkruar në kontratë, sipas genplanit përkatës. Në procesverbal përshkruhen qartë gjendja fizike e pronës, vlera kontabël e objektit që jepet me qira ose enfiteozë, d) Për çdo kontratë të lidhur, në fund të 6-mujorit të parë, brenda datës 15 korrik, dhe në fund të vitit, brenda datës 20 janar, njësia monitoruese dërgon në degën e shoqërive publike, pranë prefekturës përkatëse, një raport të hollësishëm për ecurinë e tyre, të konfirmuar për arkëtimet dhe nga degët e thesarit të rrethit përkatës.

Nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve si dhe NJA Qendër, Novoselë dhe Shushicë, nuk është realizuar në asnjë rast monitorimi i kontratave. Veprime që bien në kundërshtim me kushtet e kontratës tip të miratuar nga ish/komunat, “Dispozitat e veçanta“ pika 4 e kontratës, të ushtrojë kontrollë periodike mbi fondin e gjetjes së tokës, zbatimin e dispozitave të ligjit për

mbrojtjen e tokës dhe në fund të çdo kontrolli ti dorëzojë procesverbal me detyrat konkrete të bazuar në ligj, nëse subjektet përfituese të tyre kanë realizuar investimin sipas objektit të kontratës apo janë në kushtet e moszbatimit të saj. Gjithashtu kontratat nuk janë regjistruar sipas udhëzimit nr.3, datë 16.5.2007, për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara, kundrejt tarifës së përcaktuar në vendimin nr.549, datë 26.8.1996, të Këshillit të Ministrave, në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP). Neni 57, pika 1,2,3, e ligjit Nr. 111/2018, “Për kadastrën” Regjistrimi i kontratës së qirasë dhe enfiteozës.

Nga auditimi i kontratave për rastet e subjekteve debitorë, nuk ka ndërprerje të kontratës për mos përmbushje të kushteve të saj nga subjekti përfitues/qiramarrës. Nga auditimi i zbatimit të kontratave rezulton se për një pjesë të kontratave nuk janë respektuar kushtet e kontratës, në lidhje me pagesën e tarifës së qirasë, si dhe nuk është bërë mbikëqyrja e përdorimit të tokës bujqësore të marrë me qira mbi bazën e kartelës personale për çdo kontratë.

Titulli gjetjes: Monitorimi i kontratave.

Situata: Nga auditimi i kryer rezulton se për të gjitha kontratat e nëshkuara nga ish/kryetarët e komunave tashmë (Njesi administrative), në asnjë rast nuk janë ngritur grupe të punës për monitorimin e kontratave, veprime që bien në kundërshtim më pikën e kontratave si dhe Vendimin nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, VI. Monitorimi i kontratave të qirasë dhe të enfiteozës drejtohet nga organi që ka lidhur kontratën e qirasë ose të enfiteozës.

Kriteri: VKM nr.54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Ndikimi/Efekti: Nga mos kryerja e monitorimit të kontratave, nuk del qartë situata në terren e përdorimit të tokave bujqësore nga qiramarrësit edhe nëse ka raste të tjetërsimit tokave .

Shkaku: Titullari i institucionit, nuk ka ngritur urdhra për monitorimin e kontratave sipas NJA. Gjithashtu dhe Drejtoresha e Menaxhimit të Aseteve nuk ka informuar Kryetarin me memo, mbi situatën e monitorimit të kontratave ndër vite.

Rëndësia : E lartë

Rekomandimi: Bashkia Vlorë nëpërmjet strukturave të NJA-ve, Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe Drejtoria Juridike të marrin masa për hartimin e grupeve të punës për monitorimin e kontratave.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi: **z. D. L., me detyrë ish- Kryetar i Bashkisë dhe znj. S. H., me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Menaxhimit të Aseteve dhe strukturat përkatëse për inventarizimin e pronave sipas llojit të pasurisë, si Agronomët dhe inspektorët e taksave sipas njësive Administrative.**

- **Procedurat e ndjekura nga Bashkia për shitjen e asetëve**

Për periudhën objekt auditimi rezultoi se Bashkia Vlorë nuk kishte shitje të asetëve.

Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara më lartë ngarkohet me përgjegjësi: **z. D. L., në funksionin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë; znj. S. H., me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve; znj. M. K., me detyrë Administratore e Njësia Qendër; z. K. Sh., me detyrë Administrator i NJA Novoselë; z. B. A., me detyrë Administrator i NJA Shushicë; z. M. L., Inspektor i taksave, z. J. J., Inspektor i taksave; z. A. A., Agronom; z. A. H., Agronom; z.**

Sh.R., Nënkyetar i Bashkisë; **z. O. B.**, Drejtor i Taksave dhe Tarifave, Nënkyetar; **z. D. Z.**, Drejtor i Drejtorisë Juridike; **z. Th. Q.**, Agronom.

Njësia Administrative Shushicë

Për sa është trajtuar në këtë Projekt Raport të Auditimit, nga subjekti i audituar, përkatësisht **Bashkia Vlorë, njësia administrative Shushicë** me administrator z. Birçe Aliraj me shkresën e administruar në KLSH me nr.8668/1, prot.1026/9, datë 24.07.2023, është dërguar observacion ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

*Lidhur me Akt Konstatimin nr.6 të mbajtur nga KLSH, Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, nga ana e subjektit **njësia administrative Shushicë** pretendohet që, nuk ka kompetenca për ngritjen e grupeve të punës për verifikimin në terren të sipërfaqeve të dhëna me qera. Në **VKM nr.54, datë 05.02.2014**, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, **kreu VI, pika 1,2**, përcaktohet qartë që qiradhënësi duhet të monitorojë në mënyrë periodike sipërfaqen që është dhënë me qira.*

Për sa i përket shkresave të dërguara në observacion për korrespondencën me drejtorinë e pronave publike dhe menaxhimit të asetëve me Nr.310/1 prot; datë 13.10.2022, Nr.310/3 prot; datë 07.11.2022, do të merren pjesërisht në konsideratë.

Nga ana e subjektit nuk është vënë në dispozicion i plotë informacioni që u kërkua nga grupi i auditimit të KLSH.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me sa më sipër observacioni i paraqitur merret pjesërisht në konsideratë.

Njësia Administrative Novoselë ,

Për sa është trajtuar në këtë Projekt Raport të Auditimit, nga subjekti i audituar, përkatësisht **Bashkia Vlorë, njësia administrative Novoselë** me administrator z. K. Sh. me shkresën e administruar në KLSH me nr. 8668/1 prot; dhe nr. 1026/9 prot; datë 24.07.2023, është dërguar observacion ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

*-Lidhur me Akt Konstatimin nr.6 të mbajtur nga KLSH, Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, nga ana e subjektit **njësia administrative Novoselë** pretendohet që, nuk ka kompetenca për ngritjen e grupeve të punës për verifikimin në terren të sipërfaqeve të dhëna me qera. Në **VKM nr.54, datë 05.02.2014**, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, **kreu VI, pika 1,2**, përcaktohet qartë që qiradhënësi duhet të monitorojë në mënyrë periodike sipërfaqen që është dhënë me qira.*

*- Nga njësia administrative Novoselë na është paraqitur shkresa me nr. prot. 36/1, datë 17.01.2020 lidhur me korrespondencën që kanë pasur me drejtorinë juridike dhe me drejtorinë e pronave publike dhe menaxhimit të asetëve në bashkinë Vlorë, për sa i përket informacionit mbi shlyerjen e detyrimeve nga qiramarrësit e tokave bujqësore dhe gjendjen faktike të tyre. Për mbledhjen e detyrimeve financiare të qirave të tokave bujqësore dhe monitorimin e kontratave, është përgjegjësi e përbashkët e **njesisë Novoselë** si dhe e **Drejtorisë Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetëve Bashkia Vlorë**, në bazë të **VKM nr.460, datë 22.05.2013**, “Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në*

pronësi të shtetit”, kreu III, pika 5 si dhe VKM nr.54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, kreu VI, pika 1,2.

Për sa i përket shkresave të dërguara në observacion për korrespondencën me drejtorinë e pronave publike dhe menaxhimit të aseteve me Nr.527/1 prot; datë 20.09.2022, Nr.36/1 prot; datë 17.01.2020 do të merren pjesërisht në konsideratë.

Nga ana e subjektit nuk është vënë në dispozicion i plotë informacioni që u kërkua nga grupi i auditimit të KLSH.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me sa më sipër observacioni i paraqitur merret pjesërisht në konsideratë.

Pika 9 e programit. TË NDRYSHME (shqyrtim i ankesave)

Titulli gjetjes: Mbi shqyrtimin e ankesave të znj. T. H. dhe znj. V. H.

Situata: Në KLSH është paraqitur ankesa e bëra nga znj. T. H., protokolluar në KLSH me nr. 416 prot., datë 08.05.2023, vijuar nga ankesa e znj. V. H. (e bija e T. H.), protokolluar në KLSH me nr. 554 prot., datë 14.06.2023, vijuar nga ankesa e nga znj. T. H., protokolluar në KLSH me nr. 417/1 prot., datë 29.06.2023, në lidhje me dyshimet e ankimesve mbi ligjshmërinë e vendim-marrjes për ndërtimin e një rruge, që cenonte palltin në të cilin ankimeset jetonin. Gjithashtu, znj-t. H., shprehin ankesat e tyre mbi ligjshmërinë e një objekti të ndërtuar dhe një aplikimi për pajisje me leje ndërtimi, objekte të cilat kanë cenuar pallatin në të cilin ato jetojnë, gjithashtu rrezikojnë ta cenojnë në vazhdim.

Në mënyrë të përmbledhur, me anë të shkresës me nr. 416 prot., datë 08.05.2023, si dhe si dhe shkresës me nr. 554 prot., datë 14.06.2023, drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, znj T. H. dhe znj. V. H., i kanë paraqitur ankesën e tyre dhe kanë specifikuar se janë banuese dhe pronare e apartamentit Nd. 7, Pall. 887, H.2 Ap. 8, në rrugën Çamëria, lgj. Skelë, Vlorë. Ky apartamenti rrezikon të shembet, pasi, në vitin 2010, Bashkia Vlorë ka dhënë dy leje ndërtimi për pallate 12 katëshe me 1 kat nëntokë, firmave Ç. dhe “H.” ShPK / Group, të cilat do të shfrytëzonin truallin e pallatit 887. Ndërtimi i objektit nga Ç. ShPK është realizuar dhe ka përfunduar në vitin 2014. Ky subjekt ka prishur ¼ e pallatit nr. 887, në mënyrë abuzive, pa një leje të posaçme, pa respektuar standartet e sigurisë. Për këtë shkelje, IMT ka marrë vetëm një masë vendim dënimi me gjobë, nr. 6, datë 18.06.2014, nr. serie 000206, me vlerë 300.000 lekë. Në vitin 2021, Bashkia Vlorë ka miratuar një leje infrastrukture për rrugë (rrugë e cila cenon pallatin 887), si dhe është miratuar procedura e shpronësimit me VKM nr. 200. Lejet e ndërtimit të përmendura më sipër janë dhënë më përpara se të miratohej projekti i rrugës. Znj. H. ka kërkuar mbrojtjen e pronës së saj, duke cituar se nuk pranon shpronësim.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga znj. T. dhe V. H., si dhe nga Bashkia Vlorë, konstatohet se:

- Znj. T. H. është pronare e vetme e apartamentit Nd. 7, Pall. 887, H. 2 Ap. 8, në rrugën Çamëria, lgj. Skelë, Vlorë.

- Në vitin 2010, Bashkia Vlorë ka dhënë dy leje ndërtimi për pallate 12 katëshe me 1 kat nëntokë, firmave Ç. ShPK. dhe “H.” ShPK / Group. Projekti i miratuar për subjektin Ç. ShPK është

zhvilluar (sot Ç. C.), ndërsa projekti i subjektit “H.” ShPK / Group, nuk ka miratuar të gjithë formularët e nevojshëm për miratimin e lejes, për këtë arsye nuk është zhvilluar akoma, gjithsesi gjykata ka vendosur miratimin e kësaj leje ndërtimi.

- Për zhvillimin e Ç. C., është prishur nga ana e këtij të fundit, ¼ e pallatit nr. 887, në mënyrë abuzive, pa një leje të posaçme, pa respektuar standartet e sigurisë. Për këtë shkelje, IMT ka marrë vetëm një masë vendim dënimi me gjobë, nr. 6, datë 18.06.2014, nr. serie 000206, me vlerë 300.000 lekë.

- Subjekti “H.” ShPK, në datë 10.05.2019, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë, duke paditur Bashkinë Vlorë, si dhe drejtoritë e varësisë, për mos-miratimin e aplikimit për lejen e ndërtimit në fjalë.

- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Vlorë, ka pranuar kërkesën e paditësit dhe ka nxjerrë vendimin nr. 642, datë 21.05.2019, ku ka vendosur detyrimin e palës së paditur për nxjerrjen e akteve administrative, formularët ligjore, etj., pra miratimin e lejes së ndërtimit.

- Palët i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, e cila ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë.

- Bashkia Vlorë dhe DPKZHT kanë miratuar lejen e infrastrukturës nr. 524, datë 12.07.2022, me objekt: “Rikualifikimi i bllokut të banesave kufizuar nga bulevardi Çamëria, rr. Pelivan L., rr. Piro Sava”, projekt i cili prek pjesërisht edhe pallatin nr. 887.

- Në datën 01.06.2023, IMT Vlorë, së bashku me IKMT kanë ndërhyrë duke shembur objektin në fjalë, në kuadër të projektit të miratuar në lejen e infrastrukturës.

Mbi auditimin e ankesës së znj. T. H. dhe V. H.:

Referuar korrespondencës së mësipërme, si dhe të gjithë informacionit dhe dokumentacionit të marrë nga Bashkia Vlorë, shprehemi se situata në lidhje me ankesën e paraqitur nga znj-t. H., është si më poshtë vijon:

Znj. T. H. është pronare e vetme e apartamentit Nd. 7, Pall. 887, H.2 Ap. 8, në rrugën Çamëria, lgj. Skelë, Vlorë, i blerë prej më shumë se 30 vjetësh. Në vitin 2010, Bashkia Vlorë ka dhënë dy leje ndërtimi për pallate 12 katëshe me 1 kat nëntokë, firmave Ç. ShPK dhe “H.” ShPK / Group. Projekti i miratuar për subjektin Ç. ShPK është zhvilluar (sot Ç. Centre), ndërsa projekti i subjektit “H.” ShPK / Group, nuk ka miratuar të gjithë formularët e nevojshëm për miratimin e lejes, për këtë arsye nuk është zhvilluar akoma, gjithsesi gjykata ka vendosur miratimin e kësaj leje ndërtimi. Për zhvillimin e Ç. C., është prishur nga ana e këtij të fundit, ¼ e pallatit nr. 887, në mënyrë abuzive, pa një leje të posaçme, pa respektuar standartet e sigurisë. Për këtë shkelje, IMT ka marrë vetëm një masë vendim dënimi me gjobë, nr. 6, datë 18.06.2014, nr. serie 000206, me vlerë 300.000 lekë.

Subjekti “H.” ShPK, në datë 10.05.2019, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë, duke paditur Bashkinë Vlorë, si dhe drejtoritë e varësisë, për mos-miratimin e aplikimit për lejen e ndërtimit në fjalë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Vlorë, ka pranuar kërkesën e paditësit dhe ka nxjerrë vendimin nr. 642, datë 21.05.2019, ku ka vendosur detyrimin e palës së paditur, pra Bashkia Vlorë, për nxjerrjen e akteve administrative, formularët ligjore, etj., pra miratimin e lejes së ndërtimit.

Palët i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, e cila ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë. Bashkia Vlorë dhe DPKZHT kanë miratuar lejen e infrastrukturës nr. 524, datë 12.07.2022, me objekt: “Rikualifikimi i bllokut të banesave

kufizuar nga bulevardi Çamëria, rr. Pelivan L., rr. Piro Sava”, projekt i cili prek pjesërisht edhe pallatin nr. 887.

Në datën 01.06.2023, IMT Vlorë, së bashku me IKMT kanë ndërhyrë duke shembur objektin në fjalë, në kuadër të projektit të miratuar në lejen e infrastrukturës.

Vlen të theksohet fakti se znj. H. nuk e ka pranuar dhe nuk e ka tërhequr vlerën e shpronësimit prej 4,777,869.76 lekë, referuar VKM-së së shpronësimit nr. 200, datë 07.04.2023, për shpronësimin e pronarëve të prekur nga “Rikualifikimi i bllokut të banesave kufizuar nga bulevardi Çamëria, rr. Pelivan L., rr. Piro Sava”.

Referuar fakteve të mësipërme, si dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit të vendosur në dispozicion, grupi i auditimit shprehet se:

- Kalimi i fazave të shqyrtimit të aplikimit për miratimin e lejeve të ndërtimit (të gjitha fazat përveç miratimit të formularit nr. 4 – zbardhja) për 2 objektet (në favor të subjekteve Ç. ShPK dhe “H.” ShPK), është në kundërshtim me Ligjin nr. 8405, “Për urbanistikën”, ligj i cili ka qenë në fuqi në momentin e shqyrtimit të këtyre objekteve, pasi asnjëri prej objekteve nuk respekton, ndër të tjera, edhe distancat nga pallati nr. 887, respektivisht Ç. C. ka prishur në kushtet e jashtëligjshmërisë, pa asnjë leje të miratuar, $\frac{1}{4}$ e këtij pallati për t’u ndërtuar, ndërsa objekti që pretendohet të zhvillohet nga “H.” ShPK nuk respekton distancat minimale nga pallati nr. 887, duke e propozuar ndërtimin ngjitur me këtë objekt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me **Ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998, “Për urbanistikën”,** i ndryshuar, si dhe **VKM-në nr. 722, datë 19.11.1998, “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”,** Neni 120.

- Nga këqyrja e dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga Bashkia Vlorë, më konkretisht projekti dhe planvendosja e objektit të propozuar (“H.” ShPK), vihet re se pallati nr. 887, nuk është marrë në konsideratë, sikur të mos ekzistonte. Gjithashtu në planvendosje (projekt i hartuar në vitin 2010) është paraqitur një rrugë e njëjtë ose e ngjashme me rrugën e miratuar me lejen e infrastrukturës nr. 524, datë 12.07.2022, me objekt: “Rikualifikimi i bllokut të banesave kufizuar nga bulevardi Çamëria, rr. Pelivan L., rr. Piro Sava”. Nga ana e Bashkisë Vlorë nuk është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion ose akt-marrëveshje, që vërteton pëlqimin e banorëve të pallatit nr. 887, për prishjen e tij, si dhe kompensimin e secilit prej tyre në objektin e ri, ose objekte të tjera, në pronësi të zhvilluesit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me **VKM-në nr. 722, datë 19.11.1998, “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”,** Neni 52.

- Bashkia Vlorë ka Planin e Përgjithshëm Vendor, të miratuar me vendim nr. 1, datë 16.10.2017, i ndryshuar. Ky plan parashikon edhe mënyrën e zhvillimit të shërbimeve dhe infrastrukturës së propozuar, më konkretisht “Rrjeti rrugor dhe vendparkimeve publike të propozuara”, sipas hartës 19-c. Rruga e propozuar, e miratuar me lejen e infrastrukturës, rikualifikimi i bllokut në shqyrtim, nuk bën pjesë në hartën 19-c, pra nuk është pjesë në projekteve të propozuara infrastrukturore sipas PPV-së. Nuk është e qartë se ku është mbështetur Bashkia Vlorë për vendimmarrjen e rikualifikimit të këtij blloku. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë, Paragrafi 3 “Plani i shërbimeve dhe infrastrukturave publike”, si dhe Harta 19-c e PPV-së.

- Bashkia Vlorë ka vepruar me 2 standarte pasi, në vitin 2018 është ndërtuar një rrugë e cila kalon përmes pronës e cila pretendohet të zhvillohet. Bashkia Vlorë, në këtë rast nuk e ka kryer procesin e shpronësimit, si ka vepruar në rastin e prishjes së pallatit nr. 887. Një veprim i tillë do ndante pronën në 2 pjesë, si rezultat përlllogaritja e koeficienteve urban do të reduktohej. Veprimet e

mësipërme janë në kundërshtim me **Ligji 8561, datë 22.12.1999**, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, Neni 5.

- Pasuria nr. 27/57, ZK 8602, është përdorur si truall ku mbështetet objekti, si për objektin që pretendohet të zhvillohet, po ashtu edhe për një kompleks prej 3 objektësh të ndërtuar nga “H.” ShPK, miratuar nga KRRT me vendim nr. 4/47, datë 14.12.2007. Gjendur përpara këtij fakti, shprehemi se përdorimi i të njëjtës parcelë, si truall ku mbështeten 2 objekte të ndryshme, të miratuar me leje të ndryshme, ndikon në uljen fiktive të koeficientit të shfrytëzimit të territorit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me **VKM-në nr. 722, datë 19.11.1998**, “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”, Neni 127 dhe **Ligjin nr.107/2014 datë 31.07.2014**, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 39.

- Bashkia Vlorë, DPKZHT dhe Zyra juridike nuk kanë ndërmarrë të gjithë hapat dhe masat për mbrojtjen e tyre, si dhe mbrojtjen e territorit nën juridiksionin e tyre, përpara gjykatës administrative dhe asaj të apelit, pasi:

- Nuk kanë evidentuar faktin se objekti i propozuar shkel çdo kondicion urban në lidhje me distancat me pallatin nr. 887, objekt i cili ka qenë i ndërtuara përpara se subjekti “H.” ShPK të aplikonte për herë të parë për pajisje me leje ndërtimi.

- Nuk kanë evidentuar faktin se pallati nr. 887 është dëmtuar fillimisht nga ndërtimi i Ç. C., duke i reduktuar $\frac{1}{4}$ e objektit, pa asnjë projekt ose dokumentacion.

- Nuk kanë evidentuar faktin se subjekti “H.” ShPK nuk ka pasur marrëveshje me të gjithë pronarët e pallatit nr. 887, (znj. T. H. pretendon se nuk ka firmos kurrë ndonjë marrëveshje me subjektin në fjalë), duke qenë se ky pallat nuk është marrë në konsideratë gjatë projektimit dhe procedurës së aplikimit për leje ndërtimi.

- Nuk kanë evidentuar faktin se objekti i propozuar zhvillohet mbi një rrugë ekzistuese, duke krijuar një tunel për të lejuar kalimin e makinave, kjo në kundërshtim me legjislacionin e zhvillimit të territorit, atë të shfuqizuar dhe atë në fuqi. Edhe pse trualli ku pretendohet të zhvillohet objekti është në pronësi të zhvilluesit, Bashkia Vlorë duhet të kishte ndjekur procedurën e shpronësimit përkundrejt “H.” ShPK, si ka vepruar në rastin e pallatit nr. 887. Edhe në këtë rast është vepruar me 2 standarte.

- Bashkia Vlorë dhe zyra juridike nuk e kanë ankimuar rastin në rekurs, pranë Gjykatës Kushtetuese, siç ligji e parashikon.

- Në dokumentin e projektit të lejes së infrastrukturës “Rikualifikimi i bllokut të banesave...”, vihet re si mbi objektin që pretendohet të zhvillohet, shkruhet: “Objekt me leje të miratuar”, informacioni i cili nuk është i vërtetë, pasi ky objekt nuk ka aplikuar akoma për t’u pajisur me leje ndërtimi. Projekti i rikualifikimit është hartuar nga ing. D. H. dhe ing. J. Ç., si dhe është miratuar nga kryetari i Bashkisë Vlorë, z. D. L. Informacioni jo i saktë në dokumenta zyrtare është në kundërshtim me **Ligjin nr. 8503, datë 30.06.1999**, “Për të drejtën e informimit për dokumente zyrtare”, Neni 6 dhe Neni 9.

Si përfundim, në lidhje me ankesën e znj. T. dhe V. H., mbi veprimtarinë e dyshuar anti-ligjore të Bashkisë Vlorë dhe funksionarëve të saj, për favorizimin e subjektit zhvillues H. G. ShPK, si dhe në lidhje me vendimmarrjen për ndërtimin e projektit të infrastrukturës (rrugë), i cili ka pasur si pasojë prishjen e pallatit ku pala ankuese jetonte, shprehemi se vendimmarrja për ndërtimin e rrugës është e pabazuar në Planin e Përgjithshëm të miratuar për Bashkinë Vlorë, në ndonjë Plan të Detajuar Vendor, në studime pjesore të miratuara, ose në ndonjë dokument tjetër zyrtar. Gjithashtu, e dhëna “Objekt me leje të miratuar”, në dokumentin e projektit të lejes së

infrastrukturës “Rikualifikimi i bllokut të banesave...”, nuk është i vërtetë, pasi ky objekt nuk ka aplikuar akoma për t’u pajisur me leje ndërtimi.

Kriteri: Ligji nr. 8405, datë 17.09.1998, “Për urbanistikën”, i ndryshuar.

VKM nr. 722, datë 19.11.1998, “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”, Neni 52; Neni 120; Neni 127. Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë, Paragrafi 3 “Plani i shërbimeve dhe infrastrukturave publike”; Harta 19-c e PPV-së. Ligji 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, Neni 5. Ligji nr.107/2014 datë 31.07.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 17, pika 1, nën-pika e); Neni 39. Ligji nr. 8503, datë 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumente zyrtare”, Neni 6 dhe Neni 9; duke ngarkuar me përgjegjësi:

- **z. D. L.**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Vlorë, për vendim-marrjen jo konform Planit të Përgjithshëm Vendor, mbi miratimin e lejes së infrastrukturës nr. 524, datë 12.07.2022, me objekt: “Rikualifikimi i bllokut të banesave kufizuar nga bulevardi Çamëria, rr. Pelivan L., rr. Piro Sava”; për vendim-marrjen me dy standarte mbi procedurat e shpronësimit mbi pasuritë; si dhe për mangësitë në mbrojtjen përpara gjykatës administrative dhe asaj të apelit.

- **z. J. Ç.**, në cilësinë e drejtorit të DPKZHT, për hartimin e projektit të “Rikualifikimi i bllokut të banesave...” dhe miratimit të lejes së infrastrukturës, me informacion jo të saktë në përmbajtjen e tij.

- **z. D. H.**, në cilësinë e specialistit inxhinier pranë DPKZHT, për hartimin e projektit të “Rikualifikimi i bllokut të banesave...”, me informacion jo të saktë në përmbajtjen e tij.

Ndikimi/Efekti: Nga sa trajtuar me sipër, miratimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtim me kondicionet urbane, vendim-marrja jo-konform përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor, vendim-marrja me dy standarte, mos-evidentimi i tjetërsimit të parcelës, që si pasojë ka sjell uljen fiktive të Koeficientit të Shfrytëzimit të Territorit, mangësitë në ndërmarrjen e të gjithë hapave dhe masave për mbrojtjen e tyre, si dhe mbrojtjen e territorit nën juridiksion e tyre, përpara gjykatës administrative dhe asaj të apelit, si dhe miratimi i dokumentave zyrtar me informacion jo të saktë, është në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator, mbi të cilën ky institucion funksionon. Këto vendimmarrje ndikojnë negativisht në zhvillimin e kontrolluar të territorit.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës

Rëndësia : E lartë

Rekomandimi:

1- Bashkia Vlorë, për çdo rast të ngjashëm, kur miratimi i lejeve të ndërtimit kërkohet të kryhet me vendim të gjykatës administrative, të marrë masa për të evidentuar gjatë mbrojtjes së saj në gjykatë të gjitha ndryshimet e parametrave urban dhe të gjendjes ekzistuese, në funksion të miratimit të këtyre leje ndërtimi, sipas kondicioneve të reja urbane, në zbatim të kuadrit rregullator në fuqi.

2- Bashkia Vlorë dhe DPKZHT të marrin gjitha masat për të zbatuar me përpikmëri Planin e Përgjithshëm Vendor të saj, si dhe specifikisht, të gjitha direktivat mbi zhvillimin e shërbimeve dhe infrastrukturës së propozuar. Bashkia Vlorë duhet të vendosi fillimisht në zbatim të gjitha projektet referuar këtij plani, edhe nëse shikohet e nevojshme, të kërkojë pranë KKT-së, si autoriteti përgjegjës për hartimin e PPV-ve, ndryshimet e argumentuara të këtij plani.

3- Bashkia Vlorë të marrë masa për t’i trajtuar të gjitha rastet me të njëjtin standart, specifikisht në lidhje me nisjen e procedurave të shpronësimit, për të gjitha ato pasuri të cilat preken ose janë prekur nga projekte infrastrukturorë për interes publik. Bashkia Vlorë të marrë masa për evidentimin e këtyre rasteve dhe nisjen e menjëhershme të procedurave të shpronësimit.

4- Bashkia Vlorë dhe DPKZHT të verifikojnë situatën në lidhje me pasurinë nr. 27/57, ZK 8602, e cila shërben si truall ku mbështet objekti që pretendohet të zhvillohet, objekt për të cilin Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Vlorë, ka pranuar kërkesën e paditësit dhe ka nxjerrë vendimin nr. 642, datë 21.05.2019, ku ka vendosur detyrimin e palës së paditur, pra Bashkia Vlorë, për nxjerrjen e akteve administrative, formularët ligjore, etj., pra miratimin e lejes së ndërtimit. Nëse nga verifikimi rezulton se pasuria me nr. 27/57, ZK 8602 është përdorur si truall ku mbështet objekti për më shumë se një rast, pra edhe për një kompleks prej 3 objektësh të ndërtuar nga “H. G.” ShPK, miratuar nga KRRT me vendim nr. 4/47, datë 14.12.2007, Bashkia Vlorë të marrë masa për t’u evidentuar këtë fakt, deri në vendosjen në dijeni të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë. Gjithashtu, Bashkia Vlorë të marrë masa për evidentimin e tjetërsimit të pasurisë mbi të cilën pretendohet të zhvillohet një ndërtim i ri, qoftë kjo shitje, blerje, ndarje ose bashkim pasurie, me qëllim shmangien e përdorimit disa herë të të njëjtës ngastër, si truall ku mbështet objekti në zhvillim, duke zvogëluar në mënyrë fiktive koeficientin e shfrytëzimit të territorit dhe intensitetit, por duke i rritur realisht këto parametra për njësinë strukturore ku parcela ndodhet.

5. Bashkia Vlorë të marrë masa për të mos përfshirë në asnjë rast në dokumentat zyrtare të nxjerrë prej saj, informacion jo të saktë, kjo konform dispozitave ligjore në lidhje me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit. Informacioni dhe të dhënat në dokumentat zyrtar duhet të jenë të saktë, të plotë, të përshtatshme dhe të shpejtë.

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1026/26 prot; datë 26.07.2023, është observuar nga z. D. H., ish-specialist inxhinier pranë DPKZHT dhe J. Ç., ish-drejtor i DPKZHT, me anë të shkresës nr. 8688/1 prot;, datë 21.07.2023, si më poshtë vijon:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara për ankesën e znj. T. H., dërguar në KLSH me anë të shkresës me nr. 416 prot;, datë 08.05.2023, vijuar nga ankesa e znj. V. H. (e bija e T. H.), protokolluar në KLSH me nr. 554 prot; datë 14.06.2023, vijuar nga ankesa e nga znj. T. H., protokolluar në KLSH me nr. 417/1 prot;, datë 29.06.2023, shprehen se:

1.1 Pretendimi i subjektit:

“Në lidhje me pretendimin se në planvendosjen e sheshit të ndërtimit të propozuar nga H. ShPK nuk është paraqitur objekti 2 katësh me nr. 887, ju sqarojmë se në planvendosjen e sheshit të ndërtimit ky objekt është paraqitur dhe ka numrat e pasurisë 27/28, dhe 27/90 ND.”

1.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin tuaj, shprehem se, në planvendosjen e sheshit të ndërtimit të propozuar nga H. ShPK, mbi pallatin me nr. 887 kalon një rrugë, e cila në kohën kur është aplikuar me këtë planvendosje, nuk ka qenë as rrugë ekzistuese, as rrugë e propozuar. Është e paqartë se cila nga të dyja duhet të merret në konsideratë. Të dyja këto konvencione, pallati nr. 887 dhe rruga e vizatuar mbi të, nuk mund të merren në konsideratë njëkohësisht. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

2.1 Pretendimi i subjektit:

“Bashkia Vlorë, në lidhje vendim-marrjen e rikualifikimit të këtij blloku banimi dhe konkretisht në realizimin e kësaj rruge lidhëse, është bazuar në projekt-idenë e financiar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, hartuar nga studio projektimi Sy.A për projektin: DESIGN SERVICES FOR URBAN REQUALIFICATION IN VLORA MUNICIPALITY.”

2.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin tuaj, shprehemi se, si citohet edhe nga ju, realizimi i kësaj rruge është bërë mbi një projekt-ide, dhe jo mbi një plan të miratuar nga organet kompetente. Bashkia Vlorë ka Plan të përgjithshëm Vendor që prej datës 16.10.2017, ku përcaktohet edhe zhvillimit i infrastrukturës rrugore. Rikualifikimi i këtij blloku banimi dhe konkretisht realizimi i rrugës lidhëse nuk bëjnë pjesë në PPV, Bashkia Vlorë. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

3.1 Pretendimi i subjektit:

“Në lidhje me pretendimin se përshkrimi “Objekt me Leje Ndërtimi të Miratuar” në projektin e lejes së infrastukturës nuk është i vërtetë ju sqarojmë se:

Terminologjia “Shesh ndërtimi i miratuar” ose “Leje ndërtimi i miratuar” i referohet procedurës së miratimit nga ana e ish-organit kolegjal K.RR.T. Termat e mësipërm nuk nënkuptojnë aspak se vendmet e mësipërme janë firmosur nga personat të cilët kanë patur detyrë funksionale nënshkrimin e dokumentave të sipër cituar. Në rastin se dokumentat e mësipërme do të ishin të nënshkruara nga personat të cilët kanë patur detyrë funksionale nënshkrimin e dokumentave atëherë do të përdorej terminologjia “Zbardhje e sheshit të ndërtimit të miratuar” ose “Zbardhje e lejes së ndërtimit të miratuar”. Pra nuk duhet krijuar konfuzion midis dy termave: Miratim i lejes së ndërtimit të miratuar nga organi kolegjal i K.RR.T-së, dhe Zbardhje e vendimit të K.RR.T-së nga Kryetari i Bashkisë. Ky fakt citohet dhe në shumë faqe të Vendimit të Gjykatës Administrative nga i cili po vendos në dispozicion një fragment.

3.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin tuaj, shprehemi se projekti i hartuar nga DPKZHT, Bashkia Vlorë, për rikualifikimin e bllokut të banimit në fjalë, daton në vitin 2021, dhe nuk ka të bëjë me periudhën kur është aplikuar nga subjekti zhvillues H. ShPK. Gjithsesi, në çdo rast, planvendosja e vendosur në dispozicion nga ana juaj, nuk ka firmat dhe/ose vulat e nevojshme për t’u konsideruar si “Objekt me Leje Ndërtimi të Miratuar”. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Titulli gjetjes: Mbi shqyrtimin e ankesës së z. J. M..

Situata: Në KLSH është paraqitur ankesa e bërë nga z. J. M., në lidhje me dyshimin e ankimesit, mbi veprimtarinë antiligjore mbi sipërfaqen e tokës që disponojnë (ankimesi bashkë me trashgimtarët e z. J. M.), me sipërfaqe 4264 m², në Vlorë, rr. “Ibrahim Avdullai”, lgj. “Pavarësia”, nr. pasurie 31/203, vol. 98, fq. 154, ZK 8602. Trashgimtarët e J. M. kanë rënë dakort me subjektin zhvillues “A. C.” ShPK, për zhvillimin e një objekti të miratuar me leje ndërtimi me vendimet nr. 2/269, datë 28.09.2011 dhe 2/270, datë 28.09.2011 me titull “*Godinë banimi dhe shërbimi 8 kate + papafingo me 1 kat nëntokë*”. Ky zhvillues nuk ka filluar ndërtimin deri në vitin 2013, kur kryetari i bashkisë së asaj kohe, z. Sh. Gj, mori vendimin për revokimin e lejes së ndërtimit, me anë të vendimit nr. 35, datë 10.10.2013. Në vitin 2019, shoqëria “A. C.” ShPK, padit Bashkinë Vlorë, me objekt të kërkesë-padisë: “*Kundërshtim i refuzimit të palës së paditur për zbardhjen dhe dorëzimin e dokumentave të sheshit dhe lejes së ndërtimit...*”. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Vlorë, në datën 23.12.2019, ka marrë vendimin nr. 1398, ku urdhëron Bashkinë Vlorë për pajisjen e paditësit me dokumentat, formularë ligjor për sheshin dhe lejen e ndërtimit. Me daljen e këtij vendimi, Bashkia Vlorë ka pajisur me leje ndërtimi shoqërinë “A. K.” ShPK dhe z. F. H., me vendim për miratim nr. 13, nr. 11060 prot; datë 26.07.2021 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë. Nga verifikimi në sistemin e-lejet, deri në momentin e

përpilimit të akt-verifikimit, datë 14.07.2023, subjekti zhvillues nuk ka aplikuar akoma për pajisje me dokumentin e Njoftimit të Fillimit të Punimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga z. J. M., si dhe nga Bashkia Vlorë, konstatohet se:

- Trashgimtarët e J. M. kanë rënë dakort me subjektin zhvillues “A. C.” ShPK, për zhvillimin e një objekti të miratuar me leje ndërtimi me vendimet nr. 2/269, datë 28.09.2011 dhe 2/270, datë 28.09.2011 me titull “*Godinë banimi dhe shërbimi 8 kate + papafingo me 1 kat nëntokë, në rrugën ‘Ibrahim Avdullai’, Bashkia Vlorë*”.

- “A. C.” ShPK nuk ka filluar ndërtimin deri në vitin 2013, periudhë kur kryetari i bashkisë së asaj kohe, z. Sh. Gj, mori vendimin për revokimin e lejes së ndërtimit, me anë të vendimit nr. 35, datë 10.10.2013.

- Në vitin 2019, shoqëria “A. C.” ShPK, padit Bashkinë Vlorë, me objekt të kërkesë-padisë: “*Kundërshtim i refuzimit të palës së paditur për zbardhjen dhe dorëzimin e dokumentave të sheshit dhe lejes së ndërtimit...*”. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Vlorë, në datën 23.12.2019, ka marrë vendimin nr. 1398, ku urdhëron Bashkinë Vlorë për pajisjen e paditësit me dokumentat, formularë ligjor për sheshin dhe lejen e ndërtimit, pra miratimin e lejes së ndërtimit.

- Me daljen e këtij vendimi, Bashkia Vlorë ka pajisur me leje ndërtimi shoqërinë A. K. ShPK dhe z. F. H., me vendim për miratim nr. 13, nr. 11060 prot., datë 26.07.2021 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë.

- Nga verifikimi në sistemin *e-lejet*, deri në momentin e përpilimit të këtij akt-verifikimi, subjekti zhvillues nuk ka aplikuar akoma për pajisje me dokumentin e Njoftimit të Fillimit të Punimeve.

Referuar fakteve të mësipërme, si dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit të vendosur në dispozicion, grupi i auditimit shprehet se:

1. Referuar pretendimeve të z. J. M., se subjektet zhvillues “A. C.” ShPK, si dhe “A. K.” ShPK dhe F. H., ku ai shprehet se këto subjekte nuk kanë statusin aktiv për ushtrimin e aktivitetit, i është kërkuar Bashkisë Vlorë dokumenti i certifikatës së regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), si dhe ekstrakti historik për këto subjekte. Ky dokumentacion nuk është vendosur në dispozicion. Referuar dokumentacionit dorëzuar nga ana e ankimesit, z. J. M., shprehemi se, referuar ekstraktit të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “A. K.” ShPK, konstatohet se statusi i këtij subjekti ka qenë “*i pezulluar*”. Referuar këtyre të dhënave, shprehemi se Bashkia Vlorë ka miratuar një leje ndërtimi ndaj një subjekti i cili nuk ka dorëzuar vërtetimet e ushtrimit të aktivitetit ose nuk e ka të drejtën e ushtrimit të aktivitetit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, Neni 15, pika 1, nënpika ë).

2. Bashkia Vlorë ka miratuar një leje ndërtimi për një subjekt tjetër, në kundërshtim me vendimin nr. 1398, datë 23.12.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë. Nga ballafaqimi i dokumentacionit të vendimit të gjykatës me dokumentacionin e miratimit të lejes së ndërtimit, konstatohet se pala paditëse ka qenë “A. C.” ShPK, gjithashtu gjykata është shprehur në vendimin e saj në favor të kësaj shoqërie, ndërsa Bashkia Vlorë e ka miratuar këtë leje ndërtimi në favor të shoqërisë “A. K.” ShPK dhe z. F. H. Grupi i auditimit i kërkoi Bashkisë Vlorë, dokumentin e lejes për ndryshim të subjektit zhvillues, sipas parashikimeve ligjore. Ky dokument nuk u vendos në dispozicion. Si përfundim, shprehemi se Bashkia Vlorë nuk ka zbatuar vendimin e gjykatës, duke

miratuar lejen e ndërtimit në favor të dy subjekteve të tjera, dhe jo atij subjekti për të cilin është shprehur gjykata, gjithashtu nuk është dhënë asnjë shpjegim për këtë vendimmarrje.

3. Edhe pse në këto kushte, grupi i auditimit i kërkoi Bashkisë Vlorë dokumentin e njoftimit të fillimit të punimeve për objektin me leje ndërtimi të miratuar me vendim për miratim nr. 13, nr. 11060 prot., datë 26.07.2021 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë. Ky dokument nuk u vendos në dispozicion, edhe pse, nga verifikimi në terren, këta zhvillues e kanë filluar ndërtimin. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014, “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”, i ndryshuar, Neni 52, pika 1, nënpika dh).

4. Referuar dokumentit të lejes së ndërtimit me vendim për miratim nr. 13, nr. 11060 prot; datë 26.07.2021 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, ku citohet: “35. Afati i fillimit të punimeve është një vit nga data e miratimit të lejes së ndërtimit”, shprehemi se, edhe pse afati një vjeçar ka kaluar, DPKZHT dhe IMTV nuk kanë marrë asnjë masë sipas parashikimeve ligjore për këto subjekte, kjo në kundërshtim me Ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014, “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”, i ndryshuar, Neni 40, pika 1.

Si përfundim, në lidhje me ankesën e z. J. M., si dhe trashgimtarëve të z. J. M., në lidhje me veprimtarinë të konsideruar antiligjore nga ana e ankimesve, mbi sipërfaqen e tokës që disponojnë me sipërfaqe 4264 m², në Vlorë, rr. “Ibrahim Avdullai”, lgj. “Pavarësia”, nr. pasurie 31/203, vol. 98, fq. 154, ZK 8602, grupi i auditimit shprehet se:

- Vendimmarrja e Bashkisë Vlorë për të miratuar lejen e ndërtimit me vendim për miratim nr. 13, nr. 11060 prot; datë 26.07.2021, në favor të subjekteve “A. K.” ShPK dhe z. F. H. është në kundërshtim me vendimin nr. 1398, datë 23.12.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë, pasi gjykata është shprehur në favor të subjektit “A. C.” ShPK, dhe jo në favor të dy subjekteve të sipërcituara.

- Vendimmarrja e Bashkisë Vlorë për të miratuar lejen e ndërtimit me vendim për miratim nr. 13, nr. 11060 prot; datë 26.07.2021, në kushtet e mungesës së dokumentacionit që vërteton të drejtën e subjekteve “A. K.” ShPK dhe z. F. H. për ushtrimin e aktivitetit në fushën e ndërtimitarisë, është në kundërshtim me Ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014, “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”, i ndryshuar, Neni 52, pika 1, nënpika dh).

- Referuar dokumentit të lejes së ndërtimit me vendim për miratim nr. 13, nr. 11060 prot; datë 26.07.2021 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, ku citohet: “35. Afati i fillimit të punimeve është një vit nga data e miratimit të lejes së ndërtimit”, shprehemi se kjo leje duhet të konsiderohet **nul dhe epavlefshme**, pasi subjektet zhvilluese “A. K.” ShPK dhe z. F. H. nuk kanë aplikuar dhe nuk janë pajisur me dokumentin e Njoftimit të Fillimit të Punimeve brenda afatit një vjeçar të parashikuar në lejen e ndërtimit.

Kriteri: VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, Neni 15, pika 1, nënpika ë); Vendimi nr. 1398, datë 23.12.2019, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë; Ligji nr.107/2014 datë 31.07.2014, “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”, i ndryshuar, Neni 40, pika 1; Neni 52, pika 1, nënpika dh); duke ngarkuar me përgjegjësi:

- **z. D. L.**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Vlorë, dhe **z. J. Ç.**, me detyrë drejtor i DPKZHT, për miratimin e një leje ndërtimi në kushtet e mungesës së dokumentacionit të detyrueshëm, sipas kuadrit rregullator në fuqi, për miratimin e lejes së ndërtimit në favor të një subjekti që nuk gëzon të drejtën e ushtrimit të aktivitetit; për vendim-marrje në kundërshtim me vendimin e gjykatës, duke miratuar lejen e ndërtimit për një bashkim subjektësh, të cilët nuk kanë lidhje të vërtetuar me subjektin për të cilin është shprehur gjykata, si dhe për mos-marrjen e masave ndaj subjektit

ndërtues për shkelje të afatit të fillimit të punimeve.

- **z. F. H.** dhe **z. I. Z.**, me detyrë kryeinspektor të IMTV, për periudhën 26.07.2021-31.12.2022, për mos-ushttrimin e aktivitetit inspektues mbi këtë subjekt, si rrjedhojë nuk është konstatuar fillimi i punimeve në mungesë të miratimit të njoftimit të fillimit të punimeve, në kushtet e jashtëligjshmërisë.

Ndikimi/Efekti: Nga sa trajtuar me sipër, miratimi i lejes së ndërtimit në mungesë të dokumentacionit të domosdoshëm, ndaj një subjekti që nuk gëzon të drejtën e ushtrimit të aktivitetit, në kundërshtim me vendimin e gjykatës, si dhe në shkelje të afateve të punimeve, është në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator, mbi të cilën këto institucione funksionojnë. Këto vendim-marrje ndikojnë negativisht në zhvillimin e kontrolluar të territorit.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrin ligjorë nga personat përgjegjës

Rëndësia : E lartë

Rekomandimi: 1- Bashkia Vlorë dhe Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të marrin masa për të verifikuar statusin e ushtrimit të aktivitetit për subjektet “A. K.” ShPK dhe z. F. H. në periudhën kur këto subjekte kanë aplikuar për pajisje me lejen e ndërtimit të miratuar me vendim nr. 13, nr. 11060 prot; datë 26.07.2021 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë. Nëse vërtetohet se këto subjekte nuk kanë pasur të drejtën e ushtrimit të aktivitetit në periudhën e aplikimit, Bashkia Vlorë, DPKZHT dhe Drejtoria Juridike të marrin masat dhe të ndjekin procedurat për shpalljen e kësaj leje ndërtimi **nul dhe të pavlefshme**. Bashkia Vlorë dhe DPKZHT nuk duhet të miratojnë asnjë leje ndërtimi kur subjekti zhvillues nuk arrin të vertetojë të drejtën e ushtrimit të aktivitetit.

2- Bashkia Vlorë dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor të marrë masa për të bërë të gjitha verifikimet e nevojshme nëse ky subjekt e ka filluar ndërtimin në mungesë të miratimit të njoftimit të fillimit të punimeve ose jo, dhe sipas rastit, të marrë masat administrative, sipas përcaktimeve ligjore.

3- Bashkia Vlorë dhe Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të verifikojnë situatën në lidhje me tejkalimin e afatit një vjeçar nga miratimi i lejes së ndërtimit, për fillimin e punimeve, siç parashikohet në dokumentin e lejes së ndërtimit. Në rast se ky afat është tejkaluar, Bashkia Vlorë të procedojë me marrjen e masava sipas parashikimeve ligjore, deri në shpalljen nul dhe të pavlefshme të lejes së ndërtimit me vendim për miratim nr. 13, nr. 11060 prot; datë 26.07.2021 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë.

Lidhur me gjetjet e mësipërme, është observuar mbi projekt-raportin e auditimit nga funksionarët dhe ish-funksionarët e Bashkisë Vlorë, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1026/29 prot; datë 03.11.2023, me anë të shkresës me nr. 11597 prot; datë 27.10.2023.

1.1 Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me problematikat e konstatuar, shprehen se subjekti “A. K.” ShPK me administrator z. F. A., ka kërkuar shkresërisht lirim të sheshit të ndërtimit të miratuar nga Bashkia Vlorë, duke na vendosur në dispozicion edhe lejen e ndërtimit, sheshin e ndërtimit dhe njoftimin e fillimit të punimeve, ku subjekti ka bërë aplikimin në sistemin e-lejet (kopja bashkëlidhur) në datë 16.06.2022. Gjithsesi ky subjekt nuk ka kryer punime në kantier, të cilat do të ishin objekt i kontrollit të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Vlorë.

1.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin tuaj, shprehem se, dokumenti që ju keni bashkëlidhur, nuk është vendimi për miratimin e njoftimit të fillimit të punimeve, por është njoftimi për vijimin me shqyrtim në themel të kërkesës për leje. Nga auditimi i ushtruar në sistemin elektronik të lejeve,

statusi për aplikimin AN160620220020, rezulton të jetë “i refuzuar”. Në lidhje me argumentimin tuaj se ky subjekt nuk ka kryer punime në kantier, të cilat do të ishin objekt i kontrollit të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Vlorë, shprehemi se leja e ndërtimit për objektin në fjalë, është shoqëruar me prishjen e objektit ekzistues, objekti i cili, nga kontrolli në terren, rezulton të jetë prishur. Prishja e objektit ekzistues në mungesë të vendimit të miratimit të njoftimit të fillimit të punimeve, është në kundërshtim me Ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 51, pika 2. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Titulli gjetjes: Mbi shqyrtimin e ankesës së ing. L. B..

Situata: Në KLSH është paraqitur ankesa e ing. L. B., në lidhje me dyshimin e ankimuesit, në rolin e hartuesit të projektit arkitektonik dhe konstruktiv për shoqërinë “I. – 2004” ShPK, në lidhje me aplikimin për pajisje me leje ndërtimi, të miratuar me vendim të KRRT, nr. 5/95, datë 17.08.2010, për “*Godinë banimi dhe shërbimesh me 5 kate, me 1 kat parkim nëntokë, në lagjen ‘Uji i Ftohtë’, Vlorë*”, me afat kohor deri në 31.01.2014.

Në mënyrë të përmbledhur, ing. z. L. B., përfaqësues i studios “L.S.B”, i ka paraqitur ankesën e saj dhe ka specifikuar se “L.S.B” ka hartuar në vitin 2010 projektin për shoqërinë “I. – 2004” ShPK, ka dorëzuar pranë organeve kompetente dosjen për aplikim për leje ndërtimi (leje e cila është miratuar), si dhe pranon se projektuesi i anës konstruktive është ai vet, ing. L. B.. Për rreth 10 vjet, puna për realizimin e këtyre objekteve ngeli në fazën e gërmimit të tabanit. Në vitin 2021, leja e ndërtimit është shtyrë për dhjetë vjet me të njëjtin material ligjor dhe teknik, por për llogari të një subjekti tjetër zhvillues, “T.M.Z.B” ShPK. Nga konstatimi i bërë në terren nga ana e studios “L.S.B”, rezulton se projekti i zbatuar nuk është i njëjti me projektin e hartuar nga studio e projektimit. Z. B. shprehet gjithashtu se nga ana e subjektit zhvillues nuk i është bërë asnjë lajmërim në lidhje me ndryshimet thelbësore që janë bërë në projekt, gjithashtu hedh dyshime mbi mënyrën e shqyrtimit të kërkesës për shtyrje afati, kur kanë kaluar rreth 10 vjet nga miratimi i lejes fillestare të ndërtimit. Z. B. shprehet se për projektin e ndryshuar që po ndërtohet, nuk ka asnjë projekt të hartuar nga ana e studios “L.S.B”, nuk ka asnjë lloj kontrate për kryerjen e projektit të zbatimit të anës konstruktive, se nuk i kanë vendosur në dispozicion subjektit zhvillues “T.M.Z.B” ShPK asnjë licencë, sigël apo vulë në fletët e projektit, përveç dokumentave të depozituara në Bashkinë Vlorë 10 vjet më parë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga z. L. B., përfaqësues i studios “L.S.B”, si dhe nga Bashkia Vlorë, konstatohet se:

- Z. L. B., përfaqësues i studios “L.S.B”, ka hartuar në vitin 2010 projektin ndërtimor për shoqërinë “I. – 2004” ShPK, ka dorëzuar pranë organeve kompetente dosjen për aplikim për leje ndërtimi (leje e cila është miratuar), si dhe pranon se projektuesi i anës konstruktive është ai vet, ing. L. B.
- Për rreth 10 vjet, puna për realizimin e këtyre objekteve ngeli në fazën e gërmimit të tabanit.
- Në vitin 2019 subjekti “I.-2004” ShPK, pajiset me leje ndërtimi për shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve, kërkesë për të cilën është marrë vendimi nr. 753, datë 17.08.2019, për shtyrjen e afatit të përfundimit të ndërtimit deri në datë 10.12.2022.
- Nga konstatimi i bërë në terren nga ana e studios “L.S.B”, rezulton se projekti i zbatuar nuk është i njëjti me projektin e hartuar nga studio e projektimit. Z. B. shprehet gjithashtu shprehet se nga ana e subjektit zhvillues nuk i është bërë asnjë lajmërim në lidhje me ndryshimet thelbësore që janë bërë në projekt, gjithashtu hedh dyshime mbi mënyrën e shqyrtimit të kërkesës për shtyrje

afati, kur kanë kaluar rreth 10 vjet nga miratimi i lejes fillestare të ndërtimit.

- Z. B. shprehet se për projektin e ndryshuar që po ndërtohet, nuk ka asnjë projekt të hartuar nga ana e studios “L.S.B”, nuk ka asnjë lloj kontrate për kryerjen e projektit të zbatimit të anës konstruktive, se nuk i kanë vendosur në dispozicion subjektit zhvillues “T.M.Z.B” SHPK asnjë licencë, sigël apo vulë në fletët e projektit, përveç dokumentave të depozituara në Bashkinë Vlorë 10 vjet më parë.

- Në 19.02.2020 është miratuar leja për ndryshimin e subjektit zhvillues nga “I.-2004” ShPK, në favor të “T.M.Z.B” ShPK, miratuar me vendim nr. 95, datë 19.02.2020.

- Është miratuar leja e ndërtimit për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, me vendim nr. 564, datë 05.10.2020.

- Është miratuar leja e ndërtimit për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, me vendim nr. 340, datë 06.05.2021.

- Është miratuar leja e ndërtimit për shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve, me vendim nr. 4, nr. 874 prot;, datë 23.01.2023.

Mbi auditimin e ankesës së z. L. B.:

Referuar korrespondencës së mësipërme, si dhe të gjithë informacionit dhe dokumentacionit të marrë nga sistemi e-leje dhe nga Bashkia Vlorë, shprehemi se situata në lidhje me ankesën e paraqitur nga z. L. B., është si më poshtë vijon:

- KRRT ka marrë vendimin për miratimin e lejes së ndërtimit me nr. 5/95, datë 17.08.2010, në favor të subjektit zhvillues “I.-2004” ShPK, me objekt “*Godinë banimi dhe shërbimesh me 5 kate, me 1 kat parkim nëntokë, në lagjen ‘Uji i Ftohtë’, Vlorë*”, me afat kohor deri në 31.01.2014.

- Subjekti “I.-2004” ShPK nuk i ka filluar punimet deri në muajin Shkurt, 2019. Ky subjekt ka aplikuar nëpërmjet sistemit e-leje për shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve, kërkesë për të cilën është marrë vendimi nr. 753, datë 17.08.2019, për shtyrjen e afatit të përfundimit të ndërtimit deri në datë 10.12.2022.

- Bashkia Vlorë dhe DPKZHT kanë marrë vendimin për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me nr. 753, datë 10.12.2019, deri në datën 10.12.2022, kjo konform përcaktimeve ligjore të pikës 3, Neni 40 i Ligjit nr. 107/2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar.

- Subjekti “I.-2004” ShPK ka aplikuar nëpërmjet sistemit e-lejet për ndryshimin e subjektit zhvillues, në favor të subjektit “T.M.Z.B” ShPK, kërkesë e cila është miratuar me vendim nr. 95, datë 19.02.2020.

- Bashkia Vlorë dhe DPKZHT kanë marrë vendimin për ndryshimin e subjektit zhvillues me nr. 95, datë 19.02.2020, në favor të subjektit “T.M.Z.B” ShPK, kjo konform përcaktimeve ligjore të pikës 3, Neni 13 i VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar.

- Në vijim, subjekti “T.M.Z.B” ShPK ka aplikuar në datën 19.06.2020 për leje ndërtimi për ndryshim të projektit gjatë ndërtimit, me nr. aplikimi AN190620200041, me pretendimin se për shkak të rreshkitjes së dherave, ishte dobësuar bazamenti.

- Bashkia Vlorë dhe DPKZHT kanë marrë vendimin për miratimin e lejes së ndërtimit për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, me vendim nr. 564, datë 05.10.2020, kjo në kundërshtim me përcaktimet ligjore të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*”, si dhe Ligjit Nr. 107/2014 “*Për*

planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, pasi:

- Argumentimi që aplikanti dhe zhvilluesi kanë parashtruar për miratimin e kërkesës për ndryshim të projektit gjatë ndërtimit nuk mund të klasifikohet në asnjërën prej pikave dhe nënpikave të Nenit 17 “Ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit”, të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar. Studimi sizmik dhe gjeologjik janë pjesë e listës së dokumentave që dorëzohen në procedurën e aplikimit për leje ndërtimi për të dhënë siguri mbi qëndrueshmërinë e bazamentit të parcelës së ndërtueshme. Për këtë arsye, argumenti i zhvilluesit nuk duhet të merrej parasysh gjatë shqyrtimit të procedurës. Gjithashtu, në argumentimin e mësipërm, zhvilluesi shprehet se është dobësuar cilësia e bazamentit, ndërkohë që, faktikisht, është shtuar 1 kat parkim nëntokë. Ankorimi i strukturës që do të ndërtohet, në bazament që siguron qëndrueshmërinë e objektit, realizohet me teknika të veçanta. Shtimi i 1 kati nëntokë nuk mund të argumentohet si masë për arritjen e bazamentit të qëndrueshëm.

- Nga këqyrja e fotografimit satelitor historik, më konkretisht ai i Qershor, 2020, i cili përkon me kohën e aplikimit (19.06.2020), rezulton se objekti ka qënë në ndërtim kur është bërë kërkesa për leje ndërtimi për ndryshim të projektit gjatë ndërtimit. Lejet për ndryshim të projektit gjatë ndërtimit, janë në vetvete leje ndërtimi, dhe si të tilla, duhet të miratohen në momentin e konstatimit të problematikës, më konkretisht, për rastin e marrë në shqyrtim, para ndërtimit të kateve nëntokë, edhe jo pasi objekti ka filluar ndërtimin. Si përfundim, shprehem se DPKZHT dhe IMTV Vlorë, nuk kanë kryer detyrat e tyre funksionale konform ligjit, si dy struktura përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme, por edhe kontrollin e zbatimit të objekteve të ndërtuara me leje apo në shkelje të saj, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga Ligji nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, dhe Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, si dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar. Gjithashtu, subjekti zhvillues “T.M.Z.B” ShPK dhe mbikëqyrësi i punimeve, kanë shkelur ligjin duke ndërtuar një objekt pa lejen e ndërtimit përkatëse.

- Gjatë kësaj periudhe IMTV Vlorë ka ushtruar aktivitetin e saj në objektin e sipërcituar dhe ka konstatuar shkelje dhe ka marrë vendimet e listuara më poshtë:

- Proces-verbali për konstatimin e kundërvajtjes, nr. 000452 serie, datë 28.06.2021.

- Vendim për pezullim punimesh, nr. 000022 serie, datë 01.07.2021.

- Vendim për dënim me gjobë, nr. 000154 serie, datë 07.07.2021.

- Vendim për prishje objekti, nr. 000348 serie, datë 13.08.2021.

Proces-verbali dhe vendimet e mësipërme janë marrë për shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit me vendim nr. 564, datë 05.10.2020, më konkretisht për ndërtimin e kateve parkim, të cilat sipas lejes fillestare kanë qënë nëntokë, dhe sipas konstatimit, janë ndërtuar mbi tokë, duke mos respektuar kështu kuotat e gërmimit.

- Bashkia Vlorë dhe DPKZHT kanë marrë vendimin për miratimin e lejes së ndërtimit për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, me vendim nr. 340, datë 06.05.2021, ndryshim i cili ka të bëjë me shtimin e sipërfaqes së ndërtuar në katin e fundit të objektit, në funksion të hapsirave teknike, sipas Nenit 17 “Ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit”, pika 1, nënpika e) të Ligjit nr.107/2014 datë 31.07.2014, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “ndryshime që rezultojnë në ndryshimin e sipërfaqes ndërtimore të objektit, mbi tokë dhe nën tokë, brenda kufijve dhe kushteve urbane të zhvillimit, me kusht që ndryshimi i sipërfaqes ndërtimore mbi tokë të mos tejkalojë masën 2% të sipërfaqes ndërtimore mbi tokë të miratuar në lejen e ndërtimit.”

- Gjatë kësaj periudhe IMTV Vlorë ka ushtruar aktivitetin e saj në objektin e sipërcituar dhe ka konstatuar shkelje dhe ka marrë vendimet e listuara më poshtë:

- *Proces-verbali për konstatimin e kundërvajtjes, nr. 000526 serie, datë 19.11.2021.*

- *Vendim për pezullim punimesh, nr. 000029 serie, datë 19.11.2021.*

- *Vendim për dënim me gjobë, nr. 000330 serie, datë 26.11.2021.*

Proces-verbali dhe vendimet e mësipërme janë marrë për shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit me vendim nr. 340, datë 06.05.2021, më konkretisht për mosrespektim të kuotave të gërmimit dhe për mungesë të dokumentacionit tekniko – ligjor në kantier.

- Vlen të theksohet se me miratimin e kësaj leje ndërtimi, Bashkia Vlorë dhe DPKZHT kanë shkelur përcaktimet ligjore dhe kanë dalë jashtë kompetencave të tyre, duke miratuar një leje ndërtimi për një objekt që ka filluar punimet dhe nuk i ka mbaruar ato brenda afatit 10 vjeçar që ligji parashikon, kjo në kundërshtim me Nenin 40 “*Afati i lejes së ndërtimit*”, pika 6 të Ligjit nr.107/2014 datë 31.07.2014, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Për punimet e filluara prej më shumë se dhjetë vjetësh dhe ende të papërfunduara, sipas projektit të miratuar, autoriteti përgjegjës për miratimin e lejes së ndërtimit përcakton mënyrën e ndërtimit të detyruar ose vendos prishjen apo konfiskimin e ndërtimit*”.

- Gjatë kësaj periudhe IMTV Vlorë ka ushtruar aktivitetin e saj në objektin e sipërcituar dhe ka konstatuar shkelje dhe ka marrë vendimet e listuara më poshtë:

- *Vendim për pezullim punimesh, nr. 000037, datë 27.04.2022.*

- *Proces-verbali për konstatimin e kundërvajtjes, nr. 000573 serie, datë 27.06.2022.*

- *Vendim për dënim me gjobë, nr. 000342 serie, datë 06.05.2022.*

- *Vendim për prishje objekti, nr. 000430 serie, datë 06.05.2022.*

Proces-verbali dhe vendimet e mësipërme janë marrë për shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit me vendim nr. 340, datë 06.05.2021, më konkretisht për vazhdimin e punimeve pa miratuar ndryshimet në projekt me projektin e miratuar me lejen nr. 340, datë 06.05.2021.

- Gjatë kësaj periudhe IMTV Vlorë i është drejtuar Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) me anë të shkresës me nr. 6387 prot; me kërkesë mbi verifikimin e procedurës së ndjekur nga ana e IMT Vlorë në lidhje me objektin nën shqyrtim. IKMT i është përgjigjur me anë të shkresës me nr. 2724/2 prot; datë 04.08.2022, me lëndë “*Kthim përgjigje*”, duke u shprehur se “*...vlerësohet se procedura sipas kundërvajtjes së përshkruar nga ana juaj dhe vendimmarrja nuk i korrespondon situatës faktike në vend...*”.

- Kryetari i Bashkisë Vlorë ka marrë vendimin nr. 4, nr. 874 prot; datë 23.01.2023, për miratimin e shtyrjes së afatit të lejes së ndërtimit për objektin e sipërcituar, gjithashtu Bashkia Vlorë dhe DPKZHT kanë marrë vendimin nr. 158, datë 17.02.2023, për miratimin e shtyrjes së afatit të lejes së ndërtimit deri në datën 17.11.2026, kjo në kundërshtim me përcaktimet ligjore të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, si dhe Ligjit Nr. 107/2014, “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*” i ndryshuar, pasi:

- Bashkia Vlorë dhe DPKZHT, me miratimin e kësaj leje ndërtimi, kanë shkelur përcaktimet ligjore dhe kanë dalë jashtë kompetencave të tyre, duke miratuar një leje ndërtimi për një objekt që ka filluar punimet dhe nuk i ka mbaruar ato brenda afatit 10 vjeçar që ligji parashikon, kjo në kundërshtim me Nenin 40 “*Afati i lejes së ndërtimit*”, pika 6 të Ligjit nr.107/2014 datë 31.07.2014, “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Për punimet e filluara prej më shumë se dhjetë vjetësh dhe ende të papërfunduara, sipas*

projektit të miratuar, autoriteti përgjegjës për miratimin e lejes së ndërtimit përcakton mënyrën e ndërtimit të detyruar ose vendos prishjen apo konfiskimin e ndërtimit”.

- Bashkia Vlorë dhe DPKZHT, me miratimin e kësaj leje ndërtimi, kanë shkelur përcaktimet ligjore dhe kanë dalë jashtë kompetencave të tyre, duke miratuar një leje për shtyrje afati të përfundimit të punimeve në kundërshtim me përcaktimet e nënpikës 2, Neni 40 “Afati i lejes së ndërtimit”, pika 6 të Ligjit nr.107/2014 datë 31.07.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Afati i përfundimit të punimeve përcaktohet në bazë të kalendarit të punimeve të miratuar nga autoriteti i planifikimit.”, pasi aplikanti ka ngarkuar në sistemin e-leje grafikun e ri të punimeve me një afat 36 mujor, ndërsa leja e miratuar është për një afat 45 mujor. Vlen të theksohet fakti se afati i lejes së ndërtimit të miratuar nga K.RR.T-ja ka qenë 39 mujor, pra shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve e datës 17.02.2023 është më e gjatë se vet afati i fillësatar i lejes së ndërtimit, edhe pse nga fotot e gjendjes ekzistuese dallohet qartë se seksioni B është në fazën finale të përfundimit të punimeve, ndërsa seksioni A është në fazën e ndërtimit (3 katet e para kanë përfunduar fazën e karabinasë).

Si përfundim, në lidhje me ankesën e z. L. B., për dyshimin mbi realizimin e projektit arkitektonik dhe konstruktiv të objektit me leje ndërtimi të miratuar me vendim të KRRT Bashkia Vlorë, nr. 5/95, datë 17.08.2010, si dhe për të gjitha lejet për ndryshim projekti gjatë ndërtimit, shprehemi se subjekti zhvillues nuk ka detyrimin e ruajtjes së marrdhënieve me shoqëritë që kanë hartuar projektet ndërtimore fillestare përgjatë gjithë etapave të ndryshimeve të projektit. Subjekti zhvillues, në këtë rast, për ndryshimin e projektit gjatë zbatimit, ka bashkëpunuar me shoqëri të tjera që ushtrojnë aktivitetin në fushën e ndërtimit, veprime këto të konsideruara të rregullta sipas kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.

Kriteri: VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 17 “Ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit”;

Ligji nr.107/2014 datë 31.07.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 17, pika 1, nënpika e); Neni 40, pika 6;

Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, Neni 1 dhe Neni 5; duke ngarkuar me përgjegjësi:

- **z. D. L.**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Vlorë, dhe **z. Z. S.**, me detyrë drejtor i DPKZHT, për miratimin e lejes së ndërtimit për shtyrje të afatit të punimeve, miratuar me vendimin nr. 4, nr. 874 prot; datë 23.01.2023, për një objekt i cili i ka nisur punimet dhe nuk i ka përfunduar ato brenda afatit dhjetë vjeçar, si dhe për një afat të përfundimit të punimeve më të gjatë se afati fillestar i lejes së ndërtimit të miratuar nga KRRT, kjo në kundërshtim me Nenin 40 të Ligjit nr.107/2014 datë 31.07.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, pika 6 dhe nënpika 2 e saj.

- **z. Z. S.**, me detyrë kryeinspektor i IMTV për periudhën deri në 24.06.2021, pasi nuk ka kryer detyrat funksionale për identifikimin e shmangieve nga projekti i miratuar në kohën kur këto devijime janë kryer, por i kanë evidentuar ato në një periudhë më të vonshme, pasi nga fotografimi satelitor i periudhës Qershor, 2020, i cili përkon me kohën e aplikimit (19.06.2020), rezulton se objekti ka qënë në ndërtim kur është bërë kërkesa për leje ndërtimi për ndryshim të projektit gjatë ndërtimit, ndërsa IMT i ka marrë masat administrative ndaj subjektit zhvillues në datën 28.06.2021, duke i bërë ato të pavlefshme, sepse në këtë periudhë subjekti zhvillues ishte pajisur me leje ndërtimi për ndryshimin e objektit.

Ndikimi/Efekti: Nga sa trajtuar me sipër, miratimi i lejes së ndërtimit për shtyrje të afatit të punimeve për një objekt i cili i ka filluar dhe nuk i ka përfunduar punimet brenda afatit dhjetë vjeçar të parashikuar në ligj, si dhe miratimi i grafikut të ri të punimeve për një periudhë më të gjatë sesa afati i lejes fillestare të ndërtimit, edhe pse objekti ka qenë në një fazë të avancuar të ndërtimit, është në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator, mbi të cilën këto institucione funksionojnë. Këto vendimmarrje ndikojnë negativisht në zhvillimin e kontrolluar të territorit.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës

Rëndësia : E lartë

Rekomandimi:

1- Bashkia Vlorë dhe DPKZHT, në bashkëpunim me IMTV, të marrin të gjitha masat për të kontrolluar gjendjen faktike të objektit në ndërtim, si dhe të analizojnë me kujdes dhe konform kudit rregullator argumentimin e të gjithë atyre subjekteve që aplikojnë për ndryshim të projektit gjatë zbatimit. Bashkia Vlorë dhe DPKZHT nuk duhet të japin asnjë leje ndërtimi për ndryshim të projektit gjatë zbatimit, pa kontrolluar paraprakisht gjendjen ekzistuese, si dhe të vërtetojnë që ky subjekt nuk i ka reflektuar ndryshimet e kërkuara, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

2- Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor të marrë masa për të ushtruar aktivitetin e tij mbi të gjithë territorin e Bashkisë Vlorë, sipas planeve mujor të punës të miratuara nga kryeinspektori dhe sipas ndarjes së zonave të kontrollit për secilin inspektor. Kryeinspektori dhe inspektorët duhet të ushtrorjnë aktivitetin e tyre kontrollues me efektivitet të lartë dhe të evidentojnë shmangiet e objekteve të pajisur me leje ndërtimi gjatë procesit të ndërtimit, dhe jo pasi këto subjekte janë pajisur me leje për ndryshim projekti. IMTV dhe DPKZHT të rrisin bashkëpunimin midis tyre për të evidentuar në kohë të gjitha rastet e devijimit nga projekti i miratuar.

3- Bashkia Vlorë dhe DPKZHT të marrin të gjitha masat për të evidentuar të gjithë ata subjekte zhvillues dhe ato objekte të pajisura me leje ndërtimi, të cilët e kanë filluar dhe nuk e kanë mbaruar procesin e ndërtimit brenda afatit dhjetë vjeçar, të parashikuar në ligj. Bashkia Vlorë nuk duhet të miratojë asnjë kërkesë nga këto subjekte, siç janë leje për ndryshim projekti ose leje për shtyrje të afatit të ndërtimit. Bashkia Vlorë të vazhdojë procedurat e parashikuara për të gjitha ato raste kur evidentohet tejkalimi i afatit dhjetë vjeçar për ndërtimin e objektit, sipas kuadrit ligjor.

4- Bashkia Vlorë dhe DPKZHT të marrin masa që, për çdo rast që aplikohet për shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve, të respektojnë grafikun e punimeve, të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, nga ana e subjektit zhvillues. Në asnjë rast, afati i përfundimit të punimeve, nuk duhet të jetë më i gjatë se afati i paraqitur nga subjekti zhvillues në grafikun e punimeve. Grafiku dhe preventivi i punimeve duhet të ballafaqohen në çdo rast me gjendjen ekzistuese të objektit në zhvillim, nga DPKZHT në bashkëpunim me IMTV.

Titulli gjetjes: Mbi shqyrtimin e ankesës së disa mësuesve parashkollor.

Situata:

Në KLSH është paraqitur ankesa e disa mësuesve me arsim parashkollorë në lidhje me ndryshimin e nivelit të pagës së grupit nga 14,000 lekë në 11,000 lekë, konkretisht kanë paraqitur ankesë:

Nr	ANKIMUSI	ANKESA		prot KLSH	
		Nr.	Datë	Nr.	Datë
1	D. B.		16.5.2023	462	18.5.2023
2	A. R.		31.5.2023		
3	K. M.		30.5.2023		
4	R. N.		29.5.2023		

Nr	ANKIMUSI	ANKESA		prot KLSH	
		Nr.	Datë	Nr.	Datë
5	A. R.		30.5.2023	515	2.6.2023
6	L. A.		8.6.2023	547	13.6.2023

Në mënyrë të përmbledhur ankesa e 6 mësuesve parashkollorë është se atyre ju është ndryshuar niveli i pagës së grupit nga 14,000 lekë në 11,000 lekë, pavarësisht faktit se të gjithë zotërojnë diplomë të tipit DND dhe deri në muaj në shkurt 2023 janë paguar me pagë grupi 14,000 lekë. Pas kësaj periudhë ato janë njoftuar nga Qendra Ekonomike Bashkia Vlorë se referuar diplomës dhe librezës së punës, paga e grupit është 11,000 lekë, kjo në zbatim të VKM nr. 175, datë 8.3.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimor në arsimin parauniversitar”. Nga auditimi i dokumentacionit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore Bashkia Vlorë në lidhje me këto ankesa, rezulton se:

Nga Bashkia Vlorë me shkresën nr. 1024/2prot, datë 25.01.2023 kërkon nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve (Drejtoria Juridike), interpretim të VKM nr. 175, datë 8.3.2017 “Për trajtimin me paga dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar” për pikën 3/a, ku thuhet se: “Punonjësit mësimorë/edukatore që fillojnë punë për herë të parë si punonjës mësimorë/edukator në lidhjen nr. 2të vendimit”, i ndryshuar me VKM nr. 351, datë 19.4.2017 dhe VKM nr. 265, datë 16.5.2018.

Në këtë interpretim është kërkuar:

- Me cilin grup page do të paguhet një edukatore me diplomë Bachelor dega parashkollor 2006-2009, e cila ka qenë punësuar dhe siguruar në instuticionit arsimore publike deri më 01.3.2017, ka shkëputur marrëdhëniet e punës dhe tashmë po punësohet në një instuticioni arsimorë publik pas hyrje në fuqi të VKM nr. 175, datë 8.3.2017 “Për trajtimin me paga dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar.
- Me cilin grup page do të trajtohet një edukatore me diplomë Bachelor dega parashkollor 2006-2009 e cila ka qenë e punësuar dhe siguruar në instuticionit arsimore publike deri më datë 01.3.2017, ka shkëputur marrëdhëniet e punës tashmë po punësohet në një instuticioni arsimor publik dhe krahas diplomës Bachelor ka dhe master profesional.
- Me cilin grup page do të paguhet një edukatore me diplomë Bachelor dega parashkollor 2006-2009 e cila ka qenë e punësuar dhe siguruar në instuticioni arsimore publike deri me datë 01.3.2017, ka shkëputur marrëdhëniet e punës tashme po punësohet në një instuticioni arsimor publike dhe krahas diplomës Bachelor ka kryer master shkencor.
- Me cilin grup të pagës do të paguhet një edukatore me diplomë Bachelor dega parashkollor 2006-2009 e cila ka qenë e punësuar dhe siguruar në instuticioni arsimore publike p.sh Berat deri me datë 3.10.2022 dhe po me datë 3.10.2022 transferohet me portal dhe punësohet një instuticioni arsimor publik Vlorë dhe ka kryer master profesionale në pedagogji me profil menaxhim arsimit.
- Mësues ndihmës me diplomë Bachelor me master profesionale paga grupi 11,000 lekë apo 14,000 lekë.

Ministria e Arsimit dhe Sporteve nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, me shkresën nr. 616/1prot, datë 8.2.2023 informon bashkinë Vlorë në lidhje me kërkesën nr. 1024prot, datë 25.01.2023 “Kërkesë për interpretim”, duke shpjeguar se:

- Në lidhje me pagën sipas diplomës, sqarohet se VKM nr. 251, datë 19.4.2017, i ndryshuar, është përcaktuar se: “Punonjësit aktual të cilët zotërojnë diplomë cikli të parë të studimeve Bachelor, ose të barvlefshëm me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe deri para datës 01.3.2017 kanë përfituar pagë grupi 14,000 lekë, do të vazhdojnë ta përfitojnë të njëjtën masë page grupi deri

në momentin e ndryshimit të nivelit të diplomës, apo ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me institucioni arsimor përkatës. Punonjësit që fillojnë punë rishtazi (për herë të parë), si punonjës mësimorë/edukator në arsimin parauniversitar pas datës 01.3.2017, do të trajtohen me pagë sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 2 të VKM nr. 175, datë 8.3.2017 “Për trajtimin me paga dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar.

- Në përgjigje të pikës (a) dhe (d), sqarohet se në zbatim të VKM nr. 351, datë 19.4.2017 është përcaktuar se: “Punonjësit aktual mësimorë/edukator të cilët zotërojnë diplomë të ciklit të parë Bachelor, ose të barasvlershëm me të, sipas legjislacionit dhe deri para datës 01.3.2017 kanë përfituar pagën e grupit në masën 14,000 lekë, do të vijojnë të përfitojnë një njëjtën masë page grupi deri në momentin e ndryshimit të nivelit të diplomës, apo ndërprerjes së marrëdhënieve të punës në institucioni arsimor.

- Në përgjigje të pikës (b.c), sqarohet se në zbatim të nenit 57, të Ligjit nr. 69/2012 i ndryshuar, përcaktohet se: “Mësues për arsimin parashkollor duhet të ketë fituar diplomë e ciklit të parë Bachelor, që formon mësues të arsimit parashkollor”. Pra në këtë program mësimor nuk kërkohet kualifikim i nivelit të dytë master, pra punonjësit mësimor në arsim parashkollor që fitojnë diploma të nivelit të dytë në “Master profesional” apo “Master shkencor”, nuk përfitojnë shtesë page në këto programe arsimore nuk kërkohet diplomë e nivelit të dytë “Master shkencor” apo “Master profesional”. Punonjësit mësimorë/edukator që fillojnë punë për herë të parë si punonjës mësimorë/edukator në arsimin parauniversitar pa datës 01.3.2017, do të trajtohen me pagë grupi sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 2 të këtij vendimi.

Sipas të dhënave në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore Bashkia Vlorë, nga auditimi i dosjeve të personave që kanë bërë ankesë në KLSH në lidhje me nivelin e pagë, rezulton se:

Znj. H. M., është emëruar si edukatorë kopshti me urdhër nr. 2, me datë 23.5.2018 e vazhdim.

Znj. D. B., është emëruar si edukatore kopshti me urdhër nr. 2 me datë 28.01.2019 e vazhdim.

Znj. S. H., emëruar si edukatore kopshti me urdhër nr. 2, me datë 9.6.2017 e vazhdim.

Znj. E. Xh., emëruar si edukatore kopshti me urdhër nr. 3 me datë 3.10.2017 e vazhdim.

Znj. T. K., emëruar si edukatore kopshti me urdhër nr. 5 me datë 2.2.2018 e vazhdim;

Znj. E. I., emëruar si edukatore kopshti 7 me datë 19.9.2022 e vazhdim.

Znj. M. H., emëruar si edukatore kopshti “Musa Cakëri” me datë 20.9.2017 e vazhdim.

Znj. J. H., emëruar si edukatore “4 –Heronjtë” me datë 7.10.2019 e vazhdim.

Znj. M. L., emëruar si edukatore në “Radhimë”, me datë 7.5.2021.

Znj. S. K., emëruar si edukatore në “Babicë” me datë 27.9.2017 e vazhdim.

Znj. K. M., emëruar si edukatore “Kafil Mala Bishan”, me datë 01.12.2017 e vazhdim.

Znj. A. R., emëruar si edukatore kopshti me urdhër nr. 9, me datë 8.11.2001 e vazhdim.

Kriteri: VKM nr. 175, datë 8.3.2017 “Për trajtimin me paga dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar” për pikën 3/a, ku thuhet se: “Punonjësit mësimorë/edukatore që fillojnë punë për herë të parë si punonjës mësimorë/edukator në lidhjen nr. 2 të vendimit”, i ndryshuar me VKM nr. 351, datë 19.4.2017 dhe VKM nr. 265, datë 16.5.2018, duke ngarkuar me **përgjegjësi znj. L. B. me detyrë Drejtoresh e Burimeve Njerëzore.**

Ndikimi/Efekti: Drejtoria e Burimeve Njerëzore Bashkia Vlorë, në zbatim të VKM nr. 175, datë 8.3.2017 “Për trajtimin me paga dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar, si dhe shkresave të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (të trajtuara më sipër), duhet të kishte evidentuar punonjësit e emëruar rishtazi mbi pozicionet e punës në periudhën e mëparshme nëse ishin brenda ose jashtë sistemit arsimor parauniversitar dhe jo vetëm,

kjo për një vlerësim të saktë të pagës së grupit nëse i takon 14,000 lekë apo 11,000 lekë në referencë të dispozitave të VKM nr. 175, i ndryshuar. Gjithashtu në dosjen e paraqitur nga ana znj. B. por dhe në shpjegimet e bëra, nuk del i qartë cili ka qenë shkaku i fillimit të zbatimit të këtij vendimi me afërsisht 6 vite vonesë nga data e daljes dhe hyrjes në fuqi të kësaj VKM-je.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: - Drejtoria e Burimeve Njerëzore Bashkia Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe në korrespondencë me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, të analizojë me kujdes të gjitha dosjet e punonjësve të emëruar në sistemin parauniversitar për nivelin e diplomës, datën e emërimit në pozicionin punonjësit mësimorë/edukator që nga koha e daljes në punë dhe deri në momentin e punësimit në bashkinë Vlorë.

Në rast të konstatimit të parregullsive për ndryshimet që mund të ketë pësuar paga e grupit nga 14,000 lekë në 11,000 lekë, të bëhen rilogaritje për cdo punonjës që është në kushtet e VKM nr. 175, datë 8.3.2017 “Për trajtimin me paga dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar, duke kompesuar diferencat.

Rekomandimi:- Drejtoria e Burimeve Njerëzore Bashkia Vlorë, në rast mos ndryshimi të kushteve sipas interpretimit të saj për pagesën 11,000 lekë dhe jo 14,000 lekë, t’i kërkohet interpretim pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve që për këto punonjës të cilat janë paguar për një periudhë 6 vjeçare me 14,000 lekë, pavarësisht datës së emërimit, si duhet vepruar në lidhje me pagën e grupi.

Titulli i gjetjes: Mbi shqyrtimin e ankesë nga FSHF

Situata: Në KLSH është paraqitur ankesa nga FSHF, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 531/2 prot; datë 07.06.2023 dhe nr. 531/14 prot; datë 07.06.2023.

-FSHF, në shkresën me nr. 531/2 prot; datë 07.06.2023, drejtuar z. D. L. në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Vlorë dhe, për dijeni Kontrollit të Lartë të Shtetit (këtu e në vijim: “KLSH”, ndër të tjera, ka kërkuar që: *“Në kuadër të zhvillimeve dhe ndryshimeve ligjore në veprimtarinë sportive, me datë 29.07.2020, kanë hyrë në fuqi ndryshimet në Ligjin nr. 79/2017 “Për sportin”. Ndër qëllimet e këtij ligji është edhe përcaktimi i kompetencave të autoriteteve qendrorë dhe vendorë në fushën sportive. Sipas nenit 22 të ligjit nr. 105/2020, datë 29.07.2020 të gjitha institucionet publike qendrore dhe vendore, të cilat kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare sportive, **brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji i nxjerrin ato në shitje** në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Pas kalimit të këtij afati, institucionet publike qendrore dhe vendore **nuk mund të zotërojnë aksione të shoqërive tregtare sportive...**”.* Aktualisht, edhe pse ka kaluar më shumë se një vit nga data e hyrjes në fuqi të ndryshimeve në ligjin nr. 79/2017 “Për sportin”, miratuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.07.2020, në të dhënat e regjistrit tregtar të shoqërisë “F. F. C.” Sh.A rezulton se Bashkia Vlorë është zotëruese e 100 % të aksioneve të saj.

-FSHF, në shkresën me nr. 531/14 prot; datë datë 07.06.2023, drejtuar z. D. L. në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Vlorë dhe, për dijeni Kontrollit të Lartë të Shtetit (këtu e në vijim: “KLSH”, ndër të tjera, ka kërkuar që: *“Në kuadër të zhvillimeve dhe ndryshimeve ligjore në veprimtarinë sportive, me datë 29.07.2020, kanë hyrë në fuqi ndryshimet në Ligjin nr. 79/2017 “Për sportin”. Ndër qëllimet e këtij ligji është edhe përcaktimi i kompetencave të autoriteteve qendrorë dhe vendorë në fushën sportive. Sipas nenit 22 të ligjit nr. 105/2020, datë 29.07.2020 të gjitha institucionet publike qendrore dhe vendore, të cilat kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare*

sportive, **brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji i nxjerrin ato në shitje në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Pas kalimit të këtij afati, institucionet publike qendrore dhe vendore nuk mund të zotërojnë aksione të shoqërive tregtare sportive...**”.

Aktualisht, edhe pse ka kaluar më shumë se një vit nga data e hyrjes në fuqi të ndryshimeve në ligjin nr. 79/2017 “Për sportin”, miratuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.07.2020, në të dhënat e regjistrit tregtar të shoqërisë “K.F. O.” Sh.A rezulton se Bashkia Vlorë është zotëuese e 100 % të aksioneve të saj.

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Bashkia Vlorë, grupi i auditimit arrin në Përfundimet si vijon:

Pas kryerjes së verifikimeve të dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga grupi i auditimit në Zyrën e Protokollit në Bashkinë Vlorë, në Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit, rezulton se:

1. Bashkia Vlorë, nuk ka ndërmarrë asnjë masë për zbatimin e kërkesave të parashtruara nga FSHF, sipas shkresave protokolluar në Bashkinë Vlorë me nr. 6736 prot; datë 07.06.2023 si dhe protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr. 531/2 prot; datë 07.06.2023 dhe nr. 531/14 prot; datë 07.06.2023.

2. Bashkia Vlorë, nuk ka vepruar në zbatim të nenit 22 të ligjit nr. 105/2020, datë 29.07.2020, ku të gjitha institucionet publike qendrore dhe vendore, të cilat kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare sportive, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji i nxjerrin ato në shitje në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Pas kalimit të këtij afati, institucionet publike qendrore dhe vendore nuk mund të zotërojnë aksione të shoqërive tregtare sportive.

Pra, edhe pse kanë kaluar shumë kohë nga data e hyrjes në fuqi të ndryshimeve në ligjin nr. 79/2017 “Për sportin”, miratuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.07.2020, në të dhënat e regjistrit tregtar të shoqërisë “F. F. C.” Sh.A dhe të shoqërisë “K.F. O.” Sh.A rezulton se Bashkia Vlorë është zotëuese e 100 % të aksioneve të saj.

3. Bashkia Vlorë nuk disponon asnjë dokumentacion tekniko ligjor për shoqërinë “K.F. O.” Sh.A.

4. Nga Bashkia Vlorë prej vitit 2015 e në vijim nuk është kryer asnjë pagesë për shoqërinë aksionere “F. F. C.” Sh.A, pasi prej datës 01.06.2015 e në vijim ka kaluar në përgjegjësinë e menaxhimit të operatorit privat “F. F. C.” Sh.A dhe “TRK G.” e “A.” të përfaqësuar nga z. S. I., miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Vlorë Nr. 39, datë 31.07.2014 “Për disa ndryshime në administrimin e shoqërisë “F. F. C.” Sh.A.

5. Bashkia Vlorë ka financuar për shoqërinë “F. F. C.” Sh.A fonde në varësi të mundësive deri në hyrjen në fuqi të ligjit të ri për sportin, nr. 105/2020, datë 29.07.2020. Për vitin 2021 nga Bashkia Vlorë janë planifikuar fonde në shumën 13 milion lekë. Mbas kësaj, për shkak të kërkesës për ndryshimin e statusit juridik të shoqërive, nuk janë planifikuar fonde për vitet respektive 2022-2023.

Kriteri: Ligji nr. 79/2017 “Për sportin” i miratuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.07.2020, duke ngarkuar me përgjegjësi, ish-Kryetarin e Bashkisë Vlorë, **z. D. Z.**, në cilësinë e DFBK në Bashkinë Vlorë dhe **znj. S. H.**, në cilësinë e Drejtorisë Juridike.

Ndikimi/Efekti: Nga sa trajtuar me sipër, nga ana e Bashkisë Vlorë, zbatim të Ligjit nr. 79/2017 “Për sportin” i miratuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.07.2020 si dhe shkresave të FSHF të trajtuara më sipër, duhet të ishte marrë masa për zbatimin e kërkesave të parashtruara nga FSHF, në zbatim të nenit 22 të ligjit nr. 105/2020, datë 29.07.2020, ku të gjitha institucionet

publike qendrore dhe vendore, të cilat kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare sportive, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji i nxjerrin ato në shitje në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, pasi pas kalimit të këtij afati, institucionet publike qendrore dhe vendore nuk mund të zotërojnë aksione të shoqërive tregtare sportive. Gjithashtu në dokumentet dhe materialet e paraqitur nga ana e Bashkisë Vlorë, nuk del e qartë, cili ka qenë shkaku i moszbatimit të këtij propozimi me shumë vonesë nga data e daljes dhe hyrjes në fuqi të ligjit për sportin.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit ligjorë për sportin nga Bashkia Vlorë si dhe personat përgjegjës të ngarkuar.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtoria Juridike Bashkia Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë DFBK dhe në korrespondencë me Federatën Shqiptare të Futbollit, të analizojë kërkesat e parashtruara nga FSHF, ku të gjitha institucionet publike qendrore dhe vendore, të cilat kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare sportive, t'i nxjerrin në shitje në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, sepse institucionet publike qendrore dhe vendore nuk mund të zotërojnë aksione të shoqërive tregtare sportive.

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

“Mjedisi i kontrollit”:

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Nga auditimi rezulton se GMS nuk ka kryer detyrat si: - Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

-Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme. Jo në çdo rast nga punonjësve e larguar është dorëzuar me procesverbal. Në institucion nuk ka rregulla të shkruara

për veprimet e punonjësve përpara largimit dhe detyrat e strukturave përkatëse të financës dhe burimeve njerëzore në raste të tilla.

“Menaxhimi i Riskut”

-Mungon Urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të Bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë riskut për veprimtarinë e Bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. Këto mosveprime janë në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar ku citohet se: “Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut”.

“Aktivitetet e Kontrollit”

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Vlorë, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorët më poshtë rendisimi disa nga mangësit e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkon komponenti Aktivitetet e Kontrollit në drejtim të funksionimit përgjegjshmërinë menaxheriale.

- Bashkia Vlorë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar programe në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programe të ciklet përfshihen në aktivitet e kontrollit. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (*back-up*) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka programe pune të licensuara. për rikuperimin e të dhënave në raste dëmtimi. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemeve. Nuk ka ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT, pasi një punonjës kontrollon të gjitha fazat e funksionimit të instalimin e softuerit, programimin e testimin etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të IT të miratuar nga Kryetari si dhe kjo fushë nuk është audituar nga audit i brendshëm.

“Informimi dhe komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj.- Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e Bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. Nga Bashkia Vlorë kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, por mungon dokumenti i konsultimit publik.

“Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë Vlorë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 36-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Vlorë, me atributet e Kryetarit të GMS e të Nëpunësit Autorizues si dhe Koordinatorit të Riskut, të marrë masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët e programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

1.2. Rekomandimi: Në mënyrë që të parandalohen rastet e mos dorëzimit të detyrës nga punonjësi kur ai ndërpret marrëdhëniet e punës, nga titullari të vendosen rregulla të brendshme të shkruara për këtë qëllim: të hartohet urdhër i veçantë apo të shtohet në rregulloren e brendshme dhe për këtë të njihen të gjithë punonjësit. Në këto rregulla të përcaktohet detyrimi që ka punonjësi për dorëzimin e aktiveve që ka në inventar dhe të gjithë punës së kryer, dosjeve shkresore, dokumentacionit elektronik, e gjithçka të krijuar nga punonjësi gjatë qëndrimit të tij në detyrë, e cila duhet të konsiderohet “pronë e institucionit”. Gjithashtu të përcaktohen edhe detyrimet e strukturave përkatëse të institucionit për këtë qëllim: sektori i shërbimeve, burimeve njerëzore, financës, etj. Nga ana e strukturave të Bashkisë Vlorë të merren masa për përditësimin ose ndryshimin e rregullores së brendshme.

Menjëherë dh ne vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

-Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk janë marrë masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart.

-Në Programin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, nuk ka të përcaktuar Indikatorët e matjes së performancës, gjë që ka kushtëzuar hartimin e raporteve specifike të vlerësimit të performancës dhe si rrjedhim adresimin e rekomandimeve për përmirësim, duke munguar raportimi tek Titullari për këtë procedurë. Rezulton se nuk është kryer procedura sigurimi i cilësisë.-Nuk ka gjurmë, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar (e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim. Gjithashtu ne disa dosje të auditimit mungon Memo e planifikimit, pra Projekt Drafti i programit të auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit. Mungon dokumenti i miratimit të kodit të etikës për audituesit e brendshëm në sektorin publik. Në auditimin e pasqyrave financiare nuk jepet vlerësim mbi vërtetësinë / saktësinë e gjendjes aktuale të paraqitjes së pasqyrave financiare dhe përcaktimin e riskut, materialiteti dhënie e opinionit të sigurisë së arsyeshme mbi pasqyrat financiare. AB në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe ka dhënë vlerësime për sistemin e kontrollit të brendshëm vetëm në auditimet në institucionet e varësisë dhe jo për Drejtoritë e Aparatit të Bashkisë, duke u shprehur në të njëjtin format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha

subjektet e audituara, si më poshtë: “a.-Kontrolli brendshëm. në këtë ndërmarrje funksionon mirë. Ekziston një ndërthurje e punëve ndërmjet hallkave dhe sektorëve për një funksionim normal të ndërmarrjes. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm u realizua duke analizuar komponentë e tij si:1. Ambienti i kontrollit të brendshëm; 2. Vlerësimi i riskut; 3. Aktiviteti i kontrollit operacional; 4. Sistemi i informacionit dhe komunikimit; 5. Monitorimin.-Përgjithësisht mbikëqyrja funksionon sipas hierarkisë së strukturës, ndarjes së detyrave, përgjegjësive që kanë të bëjnë me vendimmarrjen, kontrollin, vendosjen dhe zbatimin e linjave të raportimit, të niveleve specialist. Përgjegjës sektori, Drejtor ndërmarrje.-funksionon ndarja e detyrave në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për dy ose më shumë funksione.-sistemi i dy nënshkrimeve është i vendosur për çdo veprim që ka të bëjë me kryerjen e pagesave ose ndonjë veprimi tjetër që kërkon nënshkrimin e nëpunësit autorizues dhe atij zbatues.

-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm”. Përsa i përket Auditimeve të planifikuara për vitin 2021 dhe për vitin 2022, rezulton se nuk janë planifikuar auditime të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, siç janë prokurimet publike, Taksat dhe tarifat vendore apo Drejtoria e Financës Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, pasi planet vjetore nuk janë hartuar bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, veprime në kundërshtim me nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 ”Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” nenin 12 dhe neni 14 pika iv, Manuali i AB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të AB në sektorin publik “Kapitullin VII pika 2.4.1, 2.4.2, pikën 7.1.1, kapitulli IV pikat 4.1.7 - 4.1.12 kapitulli IV pika 4.1.1, pika 4.1.12; kapitulli VI, pika 6.1; Kapitulli VII, pika 7.1.1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1.2 faqe 48-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Vlorë, të marrë masa për realizimin e të gjitha proceseve në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. Në raportet e auditimit të kryhen teste substanciale dhe analitike, në mënyrë që në fushat me risk të lartë auditimet të jenë të thelluara, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit nëpërmjet formulimit të qartë të gjetjeve. Veprimtaria e AB të funksionojë si veprimtari, që mbështet menaxhimin e kësaj njësie vendore për arritjen objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën. Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të merren masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse ti jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave.

Menjëherë dhe vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të hartimit të PBA-së dhe dokumentimit të hapave të ndjekura rezulton se:

-Nuk është paraqitur në Këshillin Bashkiak Projekt dokumenti i parë i PBA-së, i cili duhet të paraqitet në KB dhe të miratohet nga ky i fundit brenda datës 30 qershor 2020;;
Nga auditimi i formatit të PBA-së së miratuar me Vendim nr. 95, datë 28.12.2020 dhe Vendim nr. 55 datë 30.09.2021 rezulton se në hartimin e tij nuk janë plotësuar të gjitha formatet e përcaktuara

në Udhëzimin e MFE nr. 10, datë 28.02.2020 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023”. Dhe udhëzim nr.7. datë 26.02.2021 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024” Përkatësisht janë plotësuar vetëm formatet F 1-2-12-13-14 dhe Formatit C3 ndërkohë nuk janë plotësuar të gjitha Formatet e tjera të grupit F, nuk janë plotësuar formatet B1 dhe B2 “Numri i punonjësve” si dhe Formatit C 6 “Lista emërore e projekteve të investimeve”.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, nenet 36,37,38,39 si dhe përcaktimet e Udhëzimit nr. 10, datë 28.02.2020 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023”, pikat 4,5,7,10,12,13,24,Dhe udhëzim nr.7. datë 26.02.2021 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 54-77, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike të marrin masa për dokumentimin e të gjitha fazave të PBA-së, të bëhen raportimet sipas afateve të përcaktuara, si dhe të plotësohen formatet sikurse parashikohet në udhëzim.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i tabelave të realizimit të tregueseve të buxhetit u konstatua se niveli i realizimeve për vitin 2021 është në masën 66 % dhe për vitin 2022 është në masën 65 % . Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Vlorë në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Gjithashtu, Bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) gjë e cila ndodh, por që nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës. Shpjegimet nga Drejtoria ekonomike për këtë diferencë midis planifikimit dhe realizimit jepen me mungesën e realizimit të të ardhurave. Nga ana tjetër konstatohet se nuk ka korrigjim të planit vjetor të buxhetit, në varësi të pritshmërisë dhe realizimit faktik gjatë vitit buxhetor, në mënyrë që të ngushtohet diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve. Bazuar në nenin 47 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, i ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ku thuhet: “ Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore bën një analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, edhe propozimet përkatëse për ndryshimin e vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, që ka miratuar buxhetin e vitit. Procedura e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve të vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore është e njëjtë me atë të vendimit për miratimin e buxhetit vjetor”, gjykojmë se duke parë trendin e realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, buxhetet e planifikuar mund të ishin korrigjuar, duke ju përshtatur realizimit faktik si të viteve të mëparshme, ashtu edhe të periudhës së vitit buxhetor. Në këtë mënyrë realizimi faktik i shpenzimeve do të ishte si vlerë më afër planifikimit. Gjithashtu në nenin 5 i ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, përcaktohet se në hartimin e buxhetit vjetor duhet bazuar në të ardhurat dhe shpenzimet faktike të viteve të mëparshëm.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe nenin 47 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për

menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, nenet 50 - 51 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; nenet 79 -80 -81, të udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime, si dhe pika 1 e nenit 4 dhe neni 76 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 54-77, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1 Rekomandimi: Drejtorja e Financës dhe Buxhetit Bashkia Vlorë, të marrë masa që:

- Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.
- Planifikimi i procedurave për investime/ shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave dhe jo të planifikimit, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (faturave të palikujduara), në fund të periudhës, duke planifikuar ato shërbim dhe investime më të domosdoshme për nevojat e Bashkisë Vlorë.
- Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga drejtorja e financës në lidhje me planin të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura rezulton se detyrimi i mbetur në dhjetor 2020 është në shumën 246,000 mijë lekë dhe shuma e parashikuar për shlyerje përgjatë tre viteve është sipas planit për vitin 2021 në shumën 212,745 mijë lekë për vitin 2022 në shumën 120,000 mijë lekë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtorja e Financës dhe e Buxheti vërehet se gjatë vitit 2021 janë shlyer 750,329 mijë lekë nga 212,745 mijë lekë të parashikuara. Duke iu referuar planit të shlyerjes së stokut të detyrimeve të prapambetura për vitin 2022, nuk është përcaktuar detyrimi i mbetur Detyrimi në fillim të vitit i mbartur nga viti 2021, dhe nuk është parashikuar shlyerja e detyrimit që duhet të shlyej gjatë vitit 2022.

Për sa më sipër rezulton se marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”,

Auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin afatit 60-ditor të paraqitjes në Degën e Thesarit Vlorë të urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 01/01/2021–31/12/2021 janë faturat e pa likuiduara janë 37 fatura 1 faturë për investime për subjektin A. ShPK faturë nr. 28 datë 27.07.2021 për vlerën 6,347,911 lekë dhe 36 fatura për shpenzime operative në vlerën 103,820,677 lekë. Pasqyruar në Aneksin nr. 11. Për vitin 2022 u konstatua se për periudhën 01/01/2022– 31/12/2022 janë 7 fatura të pa likuiduar nga të cilat për investime në vlerën 7,218,763

lekë dhe Faturat e pa likuiduara për shpenzime operative në vlerën 681,124 lekë pasqyruar në *Aneksin nr. 12*.

Gjithashtu nga Bashkia Vlorë (Drejtoria e Financë/Buxhet), ka edhe fatura të cilat nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë, duke kryer pagesa pjesore të tyre, e cila ka si shkak mungesën e fondeve nga realizimi i të ardhurave vendore. Për periudhën 01/01/2021 – 31/12/2022, paraqiten gjithsej 13 fatura me vlerë 165,694,990 lekë, nga e cila: për vitin 2021 paraqiten 9 fatura me vlerë 148,964,705 lekë, për vitin 2022 paraqiten 5 fatura me vlerë 16,730,285 lekë. sipas *Aneksit nr. 6 dhe Aneksit nr. 10*.

Sa i përket likuidimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, konstatohet se nuk respektohet rradha e likuidimit të tyre, pra fatura e parë likujdohet më parë.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 54-77, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

5.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtoria e Financë/ Buxhet Bashkia Vlorë, të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 60 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Gjithashtu të merren masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitet e mëparshme.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Referuar tabelave 1 dhe 2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të *Auditimit*, konstatohet se për disa taksa dhe tarifa, realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa taksa dhe tarifa të tjera realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve, e cila kryesisht vjen për shkak të mos identifikimit të faktorëve të cilët ndikojnë në planifikimin jo të saktë, gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Vlorë, që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme, në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të bëhet mbi baza sa më reale, për të mos shkaktuar deficit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve, etj, në dëm të interesave të publikut. Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit konstaton që metodologjia e përdorur nga DAV-ja për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmërinë lidhur me të ardhurat e veta të Bashkisë. Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër për periudhën nën auditim konkretisht për vitin 2021 realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Vlorë, paraqitet në masën 69 %, nga 1,410,692 mijë lekë të parashikuara janë realizuar 977,764 mijë lekë (minus 432,928 mijë lekë). Për vitin 2022 paraqitet në masën 87.2% nga 1,399,948 mijë lekë janë realizuar 1,220,873 mijë lekë (minus 179,075 mijë lekë). Në qoftë se analizojmë të dhënat e tabelës më sipër vërehet se të ardhurat që kanë një tejkalim të

realizimit në nivele të larta janë të ardhurat nga taksat e ndara që nuk vilen nga DAV. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoritë e tjera që merren me menaxhimin dhe ndjekjen e të ardhurave, të marrin masa për një planifikim sa më të saktë të të ardhurave vendore në raport me mundësitë reale të Bashkisë Vlorë, duke mos krijuar diferenca të theksuara në zëra të veçantë si në mos realizime dhe në realizime, si dhe të shmang mbi planifikimin e tyre për të shmangur në maksimum zhvillimin e procedurave pa fonde.

Drejtoritë duhet të rakordojnë me njëra tjetrën me qëllim rritjen e nivelit të arkëtimit por edhe për një planifikim sa më real të të ardhurave.

6.2 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë të riorganizojë strukturën e Drejtorisë së të Ardhurave, në mënyrë të atillë që cdo burim të ardhurash të jetë i strukturuar në këtë drejtori, pasi janë disa drejtori që arkëtojnë të ardhura duke krijuar kështu mundësinë e rrjedhjes së të ardhurave për tu arkëtuar dhe planifikuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga filtrimi i tabelave të databasës vlera e kolonës identifikuese nuk është parashikuar të jetë me format të unifikuar.

- Useri i SA i databasës së sistemit TAIS nuk ka një password autentifikimi.
- Nuk ka raporte të problemeve/ incidenteve dhe aksesit të paautorizuar.
- Nuk ka procedura formale për ruajtjen e dokumenteve, politikat e vazhdimësisë së punës dhe rimëkëmbjes për proceset kritike.
- Në sistemin e administrimit të taksave TAIS të Bashkisë Vlorë back-up i DB kryhet manualisht, çdo 1 muaj.

- Sistemin e administrimit të taksave TAIS të Bashkisë Vlorë nuk ka plan të miratuar emergjence dhe politika të vazhdimësisë së punës dhe rimëkëmbjes për kritike, backup-i i bazës së të dhënave kryhet në të njëjtin ambient me bazën e të dhënave primare (*ambienti i serverëve*).

Veprime në kundërshtim me Ligji 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”; Neni 27, Ligji Nr. 9887, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe strukturën e teknologjisë së informacionit Bashkia Vlorë, të marrin masa për:

- Analizimin e hollësishëm të të gjithë përdoruesve aktivë të sistemit TAIS që ka në përdorim Bashkia Vlorë me të drejta në sistem sipas pozicioneve të punës.
- Hartimin dhe miratimin e një politike të mirë dokumentuar për analizimin periodik të gjurmëve të auditimit të veprimeve të kryera në sistemet IT me qëllim evidentimin dhe parandalimin e problematikave të mundshme në lidhje me mirëfunksionimin dhe mirëpërdorimin e sistemeve IT.
- Për vendosjen e një fjalëkalimi për userin Administrator të databasës së sistemit TAIS.
- Ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat.

Menjëherë dhe vijimësi

8. Titulli i Gjetjes: Nga auditimi i Konfigurimeve të Sistemit TAIS u konstatua se specialistët janë të limituar në kryerjen e veprimeve si:

Shfaqjen e Pagesave sipas viteve përkatëse në momentin që ka kaluar viti fiskal.

Shfaqjen e Postimeve të bëra jashtë fatit ligjor, raportet aktuale nuk nxjerr informacionin e kërkuar.

Shfaqjen e Debitëve në vitet e kaluara pasi hidhen pagesa të vazhdueshme për zërin debi. Në kundërshtim me Standardet ndërkombëtare të TI dhe praktikën më të mira. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Strukturën e Teknologjisë së Informacionit të listojnë mangësitë e sistemit për nxjerrjen e raporteve të nevojshme dhe më pas të komunikojnë me kontraktuesin e mirëmbajtës së sistemit për përmirësimin e funksionaliteteve të sistemit.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ambientit fizik të dhomës së serverit të Sistemit TAIS u konstatua se nuk është në përputhje me praktikën më të mira si dhe standardet e përcaktuara në Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit) përkatësisht:

d. Pika 4.3. Parandalimi i zjarrit.

Dhoma duhet të jetë e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit

Dhoma duhet të jetë rezistente ndaj zjarrit nëse kabllo dhe sistemet e ftohjes kombinohen në të njëjtën hapësirë sipër tavanit ose nën dysheme

e. Pika 4.5. Sistemi Elektrik. Instalimi elektrik i dhomës së serverëve nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm.

f. Pika 4.6. Sistemi i Alarmit. Mungon sistemi i alarmit. Duhet të jenë të tillë që të sinjalizojnë problemet me rrymën elektrike, me ambientin fizik, sensor për rrjedhjen e ujit, sensor për parandalimin e dëmtimeve fizike të strukturës së dhomës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatimeve dhe Tarifave Vendore, Bashkia Vlorë dhe Strukturën e Teknologjisë së Informacionit, të marrë masa për ndërtimin e ambienteve të dhomave të serverave në përputhje me praktikën më të mira si dhe standardet e përcaktuara në bazë të VKM nr. 248, datë 27.04.2007 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” dhe Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit të taksave dhe tarifave vendore (TAIS) në Bashkinë Vlorë rezultoi se për periudhën e auditimit nga data 01.01.2021 deri 31.12.2022 janë kryer veprime stornimi (Credit Note) nga specialistët e pranimit/vlerësimit në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifave vendore të subjekteve fizik/juridik të regjistruara në këtë sistem.

Këto veprime stornimi u kryqëzuan me procesverbalet e mbajtura për çdo veprim stornimi, nga të cilat rezultoi se nga **361** stornime në sistemin TAIS nuk janë mbajtur procesverbale për **10 stornime**.

Në sistemin TAIS specialistët e pranimit ngarkojnë në formatin PDF Procesverbalet e mbajtura pas stornimit në sistem, nga auditimi u konstatua se ngarkimi i tyre në sistem ishte fakultative jo e detyrueshme për të gjitha Kredit Notet.

Veprime në kundërshtim me Urdhri i Brendshëm Nr.78 datë 08.04.2021 për ngritjen e Komisionit për miratimin e Stornimeve në Sistemin TAIS. Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni nr. 4/26; Ligji nr. 10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”, neni nr. 3; Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 35 “Dokumente të kontabilitetit”, pika nr. 36. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Vlorë (strukturat përgjegjëse), të marrë masa që ngarkimi i procesverbaleve për stornimet në sistem duhet të jetë e standardizuar për të gjithë procesverbalet dhe të mos lejimin në kryerjen e asnjë stornimi pa dokumentacionin e nevojshëm ligjorë.

10.2 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore Bashkia Vlorë, të marrin masa për:

- Rastet kur për ndryshimin e vlerës financiare (stornim), mungon dokumentacioni shkresor, të nxirren përgjegjësitë dhe të analizohet vlera financiare dhe dëmi i shkaktuar.
- Trajnimin e punonjësve të DTTV-së, me qëllim për të arritur përdorim korrekt, eficient dhe profesional të sistemit TAIS.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i të dhënave në raportet e gjeneruara nga sistemi TAIS u konstatua se ekzistonin raste të veprimeve të kryera për ngarkesat me taksa dhe tarifave vendore jashtë periudhave ushtrimore dhe me vonesë, në disa raste edhe mbi dy vjet, ndërkohë që këto ngarkesa dhe njoftim vlerësimit/faturimet sipas VKB-ve të miratimit të paketave fiskale, duhet të kryheshin deri në muajin prill të vitit ushtrimor. Për rrjedhojë kjo ka çuar në aplikimin kamatëvonesave për detyrimet e papaguara (ngarkuara me vonesë), përgjegjësi direkte e specialistëve të DAV-së, pa sistemi i merr automatikisht kamatat.

Veprimet e mësipërme nga DAV-së sjellin vështirësi për alokimin e taksave dhe aplikim të kamatëvonesave të panevojshme, duke krijuar një borxh të keq për bashkinë Vlorë dhe çuar drejt të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë.

Gjithashtu nga auditimi i dosjeve fizike (2021-2022), u konstatuan raste të cilat subjektet edhe pse rezultoni aktive ishin të pa ngarkuara për periudhat ushtrimore objekt auditimi.

Veprime në kundërshtim me Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni nr. 4 “Zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nr. 68 “Vlerësimi tatimor”, neni nr. 69 “Njoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën e detyrimit tatimor”, neni nr. 114 “Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit”, “Rregullore e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë”, neni 104 “Drejtori i Drejtorisë së Regjistrimit, vlerësimit tatimor, mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore”, neni 105 “Sektori i pranimit dhe kontabilitetit tatimor”, neni 106 “Detyrat dhe përgjegjësitë e Specialistit të vlerësimit të detyrimit tatimor për biznesin. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, të ngrëjë një grup pune për të përlogaritur efektin e dëmit të shkaktuar cdo biznesi, detyrimi i të cilit është vlerësuar jashtë afateve të përcaktuara nga vendimet e Këshillit të Bashkisë, si dhe të merren masat administrative për cdo specialist që ka kryer vlerësime jashtë afateve ligjore.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Në zbatim të vendimit të Kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. 108, datë 18/10/2018 (*prot 7814/1*), është miratuar Rregullorja e Organizmit dhe Funksionimit në strukturën vendore të Komisionit të Apelimit Tatimorë në bashkinë Vlorë.

Në zbatim të kësaj rregulloreje, Kryetari i Bashkisë me urdhër nr. 258, datë 20/11/2018 (*prot 10066 Bashkia Vlorë*) ka ngritur Komisionin e Apelimit tatimorë.

Sipas dokumentacionit të paraqitur, rezulton se për periudhën objekti auditimi kanë paraqitur ankesë për detyrimet fiskale, gjithsej **5 subjekte**.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se për tre ankesa, respektivisht ankesat e subjekteve “**B. A. I.” sha**, “**N. B.**” dhe “**T. K. VI**”, KAT ka vepruar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të Ligjit të procedurave tatimore dhe rregullores së KAT dhe rregullores së brendshme Bashkia Vlorë.

Në lidhje me subjektin “**A. K.**” ShPK, veprimi KAT nuk është sipas akteve ligjore, pasi ai i është kaluar për shqyrtim inspektorese së dosjes znj. R. P., e cila është inspektorja që ka kryer vlerësimin për të cilën subjekti është ankuar, veprime në kundërshtim me VKB n nr. 108, datë 18/10/2018 “Rregullorja e funksionimit të KAT”, ku të drejtën e shqyrtimit e ka ky komision (pika 2,2 e rregullores), **për të cilën ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KAT.**

- **Me shkresën datë 12/09/2022** (*prot nr. 10228, Bashkia Vlorë*), nga subjekti fizik “**L. T.**” është paraqitur ankesë mbi faturën për arkëtim të lëshuar nga DAV Bashkia Vlorë.

Nga ana e Komisionit të Apelimit Tatimorë Bashkia Vlorë, nuk është marrë në shqyrtim ankesa, duke ia deleguar atë DAV Bashkia Vlorë, në kundërshtim me VKB n nr. 108, datë 18/10/2018 “Rregullorja e funksionimit të KAT”, ku të drejtën e shqyrtimit e ka ky komision (pika 2,2 e rregullores).

Nuk gjejmë dokumente argumentues dhe justifikues mbi arsyet që kanë çuar inspektoren e dosjes në rivlerësim, pasi në dosja nuk ka asnjë indicje për të vënë në lëvizje dispozitat e neneve 68 dhe 71, të Ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 “Për procedurat tatimore në RSH, i ndryshuar.

Referuar dokumentacionit në dosje (*njoftim vlerësimi, aktkontrolli, shkresave refuzues, etj*), vlerësimi i subjektit është bërë në kundërshtim me 68 dhe 71, të Ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 “Për procedurat tatimore në RSH, I ndryshuar, nenin 106-*Detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit të vlerësimit të detyrimit tatimorë*, të rregullores së Bashkisë Vlorë, si dhe shkresës së Drejtorit të DAV Bashkia Vlorë dhe urdhrit të punës datë 6.9.2022, pasi referuar aktkontrollit të inspektorëve tatimorë sipërfaqja e konstatuar në terren si hapësirë shfrytëzueshme nuk është 442.55 m² por është 120 m² dhe se njoftim vlerësimi është bërë para datës kur është mbajtur aktkontrolli, bërë me datë 25.8.2022, ndërsa aktkontrolli datë 6.9.2022.

- **Nga të dhënat e kërkuara në DAV Bashkia Vlorë** mbi detyrimet e paarkëtuara për taksat e tarifave vendore, rezulton se sipas shkresës së DAV Bashkia Vlorë nr. 5132 prot, datë 28/04/2023, ndër te tjera thuhet se:

*Në listën e detyrimeve të vitit 2022 që disponon DAV Bashkia Vlorë sipas sistemit TAIS, rezulton se subjekteve “T. Z. (A. H.)” FP dhe subjekti “L. T.”, kanë dalë si debitorë si rezultat i vlerësimeve tatimore të bërë nga zyra, respektivisht për subjektin “T. Z. (A. H.)” FP për vlerën **2,152,137 lekë** dhe për subjektin “L. T.” për vlerën **4,147,243 lekë**.*

Në lidhje me subjektin “**T. Z. (A. H.)” FP**, konstatohet se është shpallur debitorë për vlerën **2,152,137 lekë**, sipas rivlerësimit të kryer nga sektori i vlerësimit datë 25.8.2022, për tarifë të hapësirës publike për vitet 2020, 2021 dhe 2022.

Me shkresën nr. 2823prot, datë 8.3.2023 subjekti “**T. Z. (A. H.)” FP**, ka bërë ankesë pranë Strukturës Vendore të Apelimit Tatimor në Bashkinë Vlorë.

Njoftim vlerësimi është punuar nga specialist i vlerësimit **znj. R. P.**, vlerësim i cili mban miratimin vetëm të specialistit dhe nuk i është përcjellë subjektit për të marrë dijeni mbi këtë detyrim, pasi nuk është firmosur nga përgjegjësi, ku për të njëjtën sipërfaqe prej **292,69 m²**, e cila në këto periudha është vlerësuar edhe për zërin truall. Gjithashtu ky vlerësim është kryer pa marrë parasysh akt kontrollin e inspektoreve të terrenit, bërë më datë 25.8.2023.

Në përfundim inspektorët e terrenit i kanë përcjellë inspektorit të vlerësimit aktin e datë 25.08.2022, por ndërkohë vlerësimi ka qenë i kryer në sistemin e taksave.

Mbas shkresës nr. 11033 prot., datë 03/11/2022, subjekti pretendon se nuk ka marrë faturën për muajin gusht.

Me shkresë të datës 04/10/2022 “*Relacion mbi vlerësimin e subjektit “H. A.”*” adresuar Drejtorit DAV Bashkia Vlorë dhe për dijeni Përgjegjësit të Sektorit, nga ana e specialistes së dosjes i është bërë me dije me anë të një relacioni për vlerësimin e subjektit.

Në këtë relacion theksohet se sipas dy akt kontrolleve nr. 0001115, datë 22/10/2022 dhe nr. 0000425, datë 24/02/2021, rezultati i kontrollit ka qenë se subjekti nuk ka filluar aktivitetet dhe është në punime e sipër dhe, me akt kontrollin nr. 001840, datë 25.08.2022 të inspektorëve është pretenduar nga specialist i dosjes se nuk është bërë matja reale e sipërfaqes së shfrytëzuar nga subjekti.

Mbas këtij relacioni me shkresë të datës 05/10/2022 Drejtori DAV Bashkia Vlorë i është drejtuar Përgjegjësit të Sektorit dhe për dijeni specialistit të dosjes (inspektori vlerësimit), mbi vlerësimet dhe konstatimet e tij në lidhje me këtë relacion. Përgjegjësi i Sektorit me shkresën të datës 07/10/2022 i është drejtuar specialistes së vlerësimit tatimor dhe për dijeni drejtorit të drejtorisë, lidhur me pretendimet e saj.

Me shkresë të datës 07/10/2022 specialisti pretendon se ka kryer vlerësimin tatimor bazuar në urdhrin e punës së miratuar nga Drejtori DAV Bashkia Vlorë. Ndërkohë nga shqyrtimi i dosjes konstatohet se vlerësimi është bërë para dorëzimit të dokumentacionit nga grupi i punës, i cili kishte për objekt vetëm verifikimin e hapësirës publike për vendparkime, kjo sipas kërkesës së terrenit, ku nga Kryetari i Bashkisë ju është kërkuar të bëhet ky verifikim.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit (*aktkontrollit datë 25.08.2022 dhe njoftim vlerësimit datë 25.08.2022*), nuk kanë lidhje, pasi sipas terrenit është konstatuar se sipërfaqja është për parkim dhe hapësirë publike për të cilën subjekti ka kërkuar në Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike për lidhje kontrate, ndërsa nga specialist i vlerësimit është vlerësuar më zërin hapësirë publike, e njëjta sipërfaqe që ka qenë më parë e vlerësuar për zërin truall.

Me shkresë të datës 05.12.2022 Përgjegjësi i Sektorit **z. E. P.** i ka kthyer përgjigje Drejtorit DAV Bashkia Vlorë për shkresën e datës 05/10/2022, ku sqaron se specialistes i është kërkuar disa herë të rishikojë këtë vlerësim, ku edhe në shkresën e datës 25/11/2022 mbetet i pandryshuar.

Nisur nga shkresa e Përgjegjësit Sektorit dhe relacionit të specialistit të dosjes, Drejtori DAV Bashkia Vlorë me shkresën nr. 13820 prot., datë 06.12.2022 “*Kërkesë për bashkëpunim dhe dhënie mendimi, për të çuar në një zgjidhje ligjore për vlerësimin tatimor të subjektit “A. H.”*”, është drejtuar Drejtorisë Juridike, Drejtorisë së Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit si dhe Njesisë së Auditimit të Brendshëm, ku për këtë shkresë është shprehur vetëm njësia e auditit të brendshëm me shkresën nr. 13820.1 prot., datë 15.12.2022.

Me shkresën nr. 150 prot., datë 09.01.2023 Drejtori DAV Bashkia Vlorë i është drejtuar Kryetarit të Komisionit Vendor të Apelimit Tatimor, duke kërkuar mbështetje dhe koordinim të strukturave brenda Bashkisë Vlorë për çuarjen në një zgjidhje ligjore të vlerësimit me detyrime për subjektet. Shkresë për të cilën nuk ka asnjë procedurë të ndjekur nga KVAT.

Me shkresën nr. 1082 prot., datë 27.01.2023 Drejtoria Juridike i është përgjigjur shkresës nr. 13820 prot., datë 05.12.2022 së Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, e cila nuk ka dhënë një relacion ligjor për vijim të kësaj procedure.

Drejtoria e të Ardhurave Vendore me shkresën nr. 150/1 prot., datë 03.03.2023 i është drejtuar sërish kryetares së KAT mbi vijimin e procedurës së vlerësimit tatimor të subjektit “T. Z. (A. H.)”. Mbas shkresës nr. 2823 prot., datë 8.3.2023 së subjektit “T. Z. (A. H.)” deleguar DAV, kjo drejtori me shkresën nr. 2823/1 prot., datë 10.03.2023 i është drejtuar KAT si struktura më e lartë në Bashkinë Vlorë për vlerësimin e situatës së krijuar deri në marrjen e një vendimi përfundimtar për detyrimet tatimore të subjektit. Shkresë për të cilën nuk ka asnjë procedurë të ndjekur nga kryetarja e komisionit vendor të apelimit tatimor.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKB n nr. 108, datë 18/10/2018 “Rregullorja e funksionit të KAT”, ku të drejtën e shqyrtimit e ka ky komision (pika 2,2 e rregullores). Nuk gjejmë dokumente argumentues dhe justifikues mbi arsyet që kanë çuar inspektoren e dosjes në rivlerësim, pasi në dosja nuk ka asnjë indicje për të vënë në lëvizje dispozitat e neneve 68 dhe 71 të Ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 “Për procedurat tatimore në RSH, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandim: Komisioni i Apelimit Tatimorë (KAT) të marrë në analizë të plotë shqyrtimin e ankesës së subjektit “L. T. ”, për vlerësimin e situatës mbi njoftim vlerësimin e nxjerrë për vlerën **4,147,243 lekë**.

Gjithashtu në cdo rast Komisioni i Apelimit Tatimorë duhet të marrë në shqyrtim ankesat e subjekteve fizik/juridik në zbatim të kuadrit ligjorë dhe të mos delegojnë ato në instuticionit që i kanë prodhuar këto akte.

12.2 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë, të ngrëjë një grup pune me specialist të fushës nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Drejtoria PZHT dhe Komisioni i Apelimit Tatimorë për verifikimin dhe saktësimin e njoftim detyrimit datë 25.8.2022 të prodhuar nga Sektori i Vlerësimit Tatimor në ngarkim të subjektit “T. Z. (A. H.)” **PF** për vlerën **2,152,137 lekë**.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2020 me VKB nr. 88, datë 24.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë ” dhe për vitin 2021 me VKB nr. 79, datë 02.12.2021 “Për disa ndryshime në VKB-në nr. 88, datë 24.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë ”, janë miratuar tarifat, struktura dhe procedura për ndjekjen e tarifës së hapësirës publike për qëllime biznesi plazh, si vijon:

a- Për zënien e hapësirave publike në plazhin e Nartës dhe Plazhin e vjetër me tarifë 400 lekë/m²/sezon.

b- Për zënien e hapësirave publike në për të gjithë plazhet e tjerë përveç pikës 1 me tarifë 500 lekë/m²/sezon.

Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Vlorë **nuk** është ngritur komisioni i menaxhimit të Stacioneve të Plazhit, në kundërshtim me Kapitullin II, pika a/2.

Referuar të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe Drejtoria e Financë Buxhet Bashkia Vlorë, rezulton se:

a- **Përgjatë sezonit turistik të vitit 2021** ushtrojnë aktivitet “shfrytëzim të hapësirave për stacione plazhi”, me afat 1, 2 dhe 5 vjeçare, **por pa lidhur kontratë me bashkinë Vlorë**, gjithsej:

- 55 subjekte me afat 1-vjeçar..
- 90 subjekte me afat 2 dhe 5-vjeçar.

Shuma totale e mbledhur përgjatë sezonit turistik nga subjektet është prej **32,339,160 lekë për një sipërfaqe prej 83388 m².**

b- Përgjatë sezonit turistik të vitit 2022 ushtrojnë aktivitet “shfrytëzim të hapësirave për stacione plazhi”, me afat 1, 2 dhe 5 vjeçare, **por pa lidhur kontratë me bashkinë Vlorë**

- 98 subjekte me afat 1-vjeçar.
- 89 subjekte me afat 2-5-vjeçar.

Shuma totale e mbledhur përgjatë sezonit turistik nga subjektet e plazheve është arkëtuar një vlerë prej **38,906,336 lekë për sipërfaqen gjithsej prej 101647 m².**

Nga të dhënat e mësipërme evidentohet fakti se nga viti 2021 në vitin 2022 kemi një rritje të vlerës së arkëtimeve për vlerën 6,567,176 lekë (38,906,336 – 32,339,160), e cila vjen pasi kemi rritje të sipërfaqes së dhënë me qira nga viti 2021 në vitin 2022 për sipërfaqen prej 18,259 m² (101647 – 83388).

Nga kryqëzimi i të dhënave të miratuara nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB) dhe sipërfaqeve faktike të faturuara të shoqëruar me lista nga Drejtoria e Aseteve, rezulton se ka mospërputhje për sipërfaqen 57265 m², ku sipas AKB sipërfaqja është 44382 m², ndërsa sipas Bashkisë sipërfaqja e dhënë për qira është 101647 m², pra nga bashkia janë dhënë sipërfaqe plazhi më shumë se ato të miratuara nga AKB.

Për asnjë nga vitet objekt auditimi (2021-2022), nga ana e ish- Kryetarit të Bashkisë Vlorë z. D. L. nuk janë nënshkruar kontratat e miratuara nga AKB, kjo me pretendimin se stacionet e plazhit për të cilat janë lidhur kontratat kanë konflikte midis individëve dhe se për një pjesë të plazhit (vazhdim lungomares), nga qeveria janë parashikuar investime për ndërhyrje dhe nuk duhej dhënë dhe miratuar plazhe 2 dhe 5 vjeçare.

Për asnjë rast nga Bashkia Vlorë (topografi), nuk janë ndarë me procesverbal në terren koordinatat për stacionet e plazhit, si dhe planvendosjen e miratuar.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 569, datë 17/07/2019 “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të AKB”, i ndryshuar, VKM nr. 1172, datë 24/12/2020 “për disa ndryshime në VKM nr. 171, datë 23/03/2019 për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së Stacionit të plazhit”, i ndryshuar, AKB ka vijuar me nënshkrimin e kontratave pas miratimit përfundimtar në Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve (GTSHA), sipas formatit të kontratës dhe në bazë të planvendosjen së parcelave të përgatitura nga vetë njësia vendore (Bashkia Vlorë), duhet të vijojë me nënshkrimin e kontratës në zbatim të nenit 14, pika 8/12/a/b e VKM nr. 1172/2020. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë, të marrë masa për:

- Ngritjen e Strukturës Përgjegjëse të Menaxhimit të Stacioneve të Plazhit dhe jo në dorë të një individi.
- Në bashkëpunim me Strukturën Përgjegjëse të Menaxhimit të Stacioneve të Plazhit, të mos lidhë ose japë me qira sipërfaqe më shumë se sa është miratuar nga AKB dhe GTSHA.
- Në bashkëpunim me Strukturën Përgjegjëse të Menaxhimit të Stacioneve të Plazhit, të mos lëshojë mandate pagesë dhe lidh kontratë për sipërfaqe plazhi ndajë subjekteve të cilat kanë parregullsi në dokumentacionin ligjorë të paraqitur dhe konflikt për sipërfaqet e plazhit.

13.2. Rekomandimi: Topografi i njësisë vendore në cdo rast të dhënies së hapësirave të plazhit të hartoj procesverbalin sipas koordinatave për cdo Stacion plazhi të shoqëruar kjo me planvendosjen të miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Në auditimin në dokumentacionin bashkëshoqërues të dhënies me qera

të hapësirave të plazhit, u krye kampionimi në të gjitha dosjet që disponon Drejtoria e Menaxhimit të Pronave Publike dhe Aseteve Bashkia Vlorë, të cilat kanë kryer pagesa hapësirë për stacion plazhi për vitet 2021-2022, nga ku konstatohet se:

- Të gjitha dosjet nuk kishin të depozituar kopjen e kontratës së lidhur ndërmjet AKB, subjektit posedues të plazhit dhe Bashkia Vlorë.

- Mos depozitimi në dosje i vërtetimit mbi pagesën e taksave lokale nga DTTV Bashkia Vlorë dhe detyrimeve fiskale nga DPTR Vlorë dhe jo vetëm, si dhe vërtetimi që nuk është në ndjekje penale, veprime në kundërshtim me shkronja (d, dh) të pikës 3 e nenit 5 të VKM nr. 171/2019, datë 27/03/2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë s sezonit turistik”, me ndryshime.

- Mos depozitimi në dosje planvendosjen, kjo për të mundësuar madhësinë e parcelës dhe pozicionimin e çadrave për largësinë ndërmjet tyre, bregut dhe pjesës së plazhit publik në raste ku ato janë pranë, veprime në kundërshtim me shkronjat (a, b,c) të pikës 1 e nenit 6 të VKM nr. 171/2019, datë 27/03/2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë s sezonit turistik”, me ndryshime.

- Mungon procesverbal i mbi dorëzimin e sipërfaqes së kontraktuar, në kundërshtim me VKM nr. 171/2019, datë 27/03/2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë sezonit turistik”, i ndryshuar me VKM nr. 1172, datë 24/12/2022.

- Mungojnë dokumenti mbi detyrimin për plotësimin e masave të sigurisë dhe të kushteve të higjienës, si dhe harta me treguesit kryesorë për sipërfaqen e kontraktuar.

- Për aktivitetin e vitit 2021, në asnjë rast, pjesë e dosjes nuk ishin aktet e kontrollit për verifikimin në terren nëse sipërfaqet që shfrytëzohen janë në përputhje me sipërfaqet e kontraktuara, si dhe nëse është ruajtur raporti 80% sipërfaqe e shfrytëzueshme dhe 20 % sipërfaqe në përdorim publik, si dhe mungonin procesverbalet e monitorimit të kontratave për plotësimin e kushteve të kontratave si dhe kriteret ligjore që duhet të plotësojnë stacionet e plazhit, kjo pasi dhe kontratat nuk ishin të nënshkuara.

Ndërsa për vitin 2022 kishte aktkontrolle, por ato ishin vetëm për verifikimin e sipërfaqes në shfrytëzim me atë të paguar por jo për element të tjerë që përmban VKM 171/2019 me ndryshime. Pra, ky dokumentacion mungonte, edhe pse qiramarrës ishin po të njëjtët subjekte në të njëjtat zona të plazhit, të cilët e kanë detyrim ligjor paraqitjen e akteve të Monitorimit të kryera nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe Inspektorati përgjegjës në momentin e rinovimit të kontratave. Po kështu edhe komisionet e ngritura me urdhër të Titullarit për çdo vit për verifikime në terren nuk kanë funksionuar.

- Në asnjë nga dosjet e audituara për vitin 2021-2022 nuk ishte e depozituar marrëveshja e noterizuar me vrojtuesit e plazhit e vlefshme kjo për gjithë kohën e shfrytëzimit, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 171/2019, datë 27/03/2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë sezonit turistik”, i ndryshuar me VKM nr. 1172, datë 24/12/2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

14.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Strukturën Përgjegjëse të Menaxhimit të Stacioneve të plazhit, të marri masa për:

- Nënshkrimin e të gjitha kontratave të miratuara nga AKB për sipërfaqen që subjektet kërkojnë, por gjithmonë sipërfaqja nuk duhet të jetë më e madhe se sipërfaqja e miratuar nga AKB.

- Në cdo dosje duhet të jenë të depozituara vërtetimi mbi pagesën e taksave (*vendore dhe të përgjithshme*), planvendosjen mbi madhësinë e parcelës dhe pozicionimin e çadrave me largësi të barazlaguara ndërmjet njëra tjetrës dhe bregur, aktkontrollet për verifikimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme dhe respektimin e

20% të plazheve publike, dokumenti mbi detyrimin për plotësimin e masave të sigurisë dhe të kushteve të higjienës, si dhe harta me treguesit kryesorë për sipërfaqen e kontraktuar, marrëveshja e noterizuar me vrojtuesit e plazhit e vlefshme kjo për gjithë kohën e shfrytëzimit, si dhe procesverbali mbi dorëzimin e sipërfaqes së kontraktuar.

- Plotësimin e dosjes me dokumentacionit e plotë ligjorë sipas kërkesave të VKM nr. 1172, datë 24.12.2020 ndryshuar me VKM nr. 827, datë 24/12/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 171, datë 27.3.2019, të këshillit të ministrave, “për miratimin e rregullores ‘për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit””.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 202 “*Studime kërkime*” sipas Formatit nr.7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*”, paraqiten në të njëjtën vlerë si në mbyllje dhe në çelje të vitit ushtrimorë 2022 për vlerën 115,857,512 lekë.

Konstatohet se për **52** projekt-studime për investime të kryera gjatë viteve, nuk është bërë shpërndarja e investimeve sipas llojit të aktiveve materiale, ku për projektet e vënë në zbatim pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme, për vlerat duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së projekteve si vlerë e shtuar e çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi, mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Gjithashtu vlera prej **9,812,760 lekë**, e emërtuar “*Të tjera*”, nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme” Aneksi 1. “*Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik*” pika 2, Klasa 2 “*Aktivet Afatgjata*”, Pika 3.3 “*Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci), nënpika 62. Nënpika “Aktivet afatgjata jo materiale*”, dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 183-205 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

15.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Vlorë të kryejë zbatimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite nga ish-Njësitë Vendore, që i janë bashkuar nga reforma territoriale për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare për vlerën **9,812,760 lekë** e emërtuar “*Të tjera*” dhe të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Për projektet e vëna në zbatim të llogarisë 202 “*Studime projekte*”, të bëhet sistemimet përkatëse duke debituar llogaritë e aktiveve dhe kredituar llogarinë 2022.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2023

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” sipas Formatit nr. 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*”, paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,419,596,938 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 1,450,591,607 lekë.

Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” konstatohet se, kjo llogari është e analizuar sipas vlerës së investimeve të kryer, duke mos ia shtuar vlerën e rikonstruksionit vlerës së ndërtesës dhe emetuar si artikuj kontabël më vete më vete vlerat e rikonstruksionit.

Gjithashtu në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 21 artikuj aktive materiale në vlerën 139,985,242 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit të llogarive 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në vlerën 83,080,542 lekë, llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” në vlerën 56,904,700 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” i ndryshuar me Udhëzimin nr.5 datë 21/02/2022, Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), “Klasifikimi kontabël”, me Nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 183-205 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Vlorë, të marrë masa për:

- Saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 212 “*Ndërtesa konstruksione*”, duke shtuar vlerën e shpenzimeve për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre.

- Të kryejë zbrëthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite të paanalizuara dhe për **21** artikuj kontabël në vlerën 139,985,242 lekë, si dhe të bëjë sistemimet duke pakësuar inventarin e kësaj llogarie dhe shtuar inventarin e llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në vlerën 83,080,542 lekë, llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” në vlerën 56,904,700 lekë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2023

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*” sipas Formatit nr.7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*”, paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,014,937,669 lekë. Ndërsa në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 4,237,830,859 lekë.

Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*”, konstatohet se kjo llogari është e analizuar sipas vlerës së investimeve të kryer, pra ndërtesave nuk i është shtuar vlera e rikonstruksionit, por janë trajtuar si artikuj kontabël më vete.

Gjithashtu në këtë llogari janë kontabilizuar gabim **31** artikuj aktive materiale në vlerën 76,464,190 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 202 “*Studime e kërkime*” në vlerën 887,760 lekë, llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” në vlerën 42,144,484 lekë, llog. 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” në vlerën 22,735,016 lekë, llog. 214 “*Instalime teknike makineri e paisje*” në vlerën 10,696,930 lekë.

Gjithashtu vlera prej **37,387,815** lekë e emërtuar “*Të tjera*”, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” i ndryshuar me Udhëzimin nr.5 datë 21/02/2022, Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), “Klasifikimi kontabël”, me Nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e

aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 183-205 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Vlorë, të marrë masa për:

- Saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, duke shtuar vlerën e shpenzime për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre.

- Të kryejë zbrërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite të paanalizuara dhe për **31** artikuj kontabël në vlerën 76,464,192 lekë, si dhe të bëjë sistemimet duke pakësuar inventarin e kësaj llogarie dhe shtuar inventarin e llog. 202 “Studime e kërkime” në vlerën 887,760 lekë, llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 42,144,484 lekë, llog. “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 22,735,016 lekë dhe llog. 214 “Instalime teknike makineri e paisje” në vlerën 10,696,930 lekë.

- Të kryejë zbrërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite nga ish-Njësitë Vendore, që i janë bashkuar nga reforma territoriale për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare për vlerën **37,387,815 lekë** e emërtuar “**Të tjera**” dhe të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2023

18. Gjetje nga auditimi: Nga analizimi i llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, rezulton se **33** objekte inventari të ujësjellës dhe KUZ me vlerë 561,707,469 lekë, të cilat aktualisht janë në inventarin e Bashkisë Vlorë, duhet të transferohen pranë shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Vlorë sha, pasi janë asete të këtyre të fundit, veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 05, datë 21/02/2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 183-205 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Vlorë, të marra masa për transferimin e **33** objekte inventari të ujësjellës me vlerë 561,707,469 lekë në sha UK Vlora, pasi nuk i përkasin inventarit të Bashkisë Vlorë.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) për vitin buxhetor 2022 paraqitet në vlerën 6,099,533,096 lekë, me të gjitha shtesat/pakësime për çdo lloj grup aktiv.

Inventari kontabël i aktiveve materiale gjendje në llogaritë 210 “Toka, Troje, Terrene” është në vlerën 111,833,518 lekë; llogaria 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 272 lekë, llogaria 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën 1,450,591,607 lekë, llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 4,273,830,858 lekë; llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 263,274,841 lekë.

Në këto llogari **nuk është i qartë përcaktimet e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për artikull**, duke mos përcaktuar vlerën e plotë të çdo aktiv, e cila duhet të përfshijë vlerën fillestare dhe shtesat gjatë viteve të secilit aktiv.

Në këto inventarë kontabël janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve, pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv.

Gjithashtu për këto aktive mungojnë kartelat kontabël apo regjistri historik me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur, veprime në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30 dhe me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21/02/2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar pika 2.1 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit të llogarive 21 “Aktive afatgjata materiale. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 183-205 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Vlorë të marr masa për:

- Analizimin e llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” është në vlerën 111,833,518 lekë; llog. 211 “*Pyje, Plantacione*” në vlerën 272 lekë, llog. 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” në vlerën 1,450,591,607 lekë, llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në vlerën 4,273,830,858 lekë; llog. 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në vlerën 263,274,841 lekë, në përcaktimin e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për artikull, të vlerës së plotë të çdo aktiviteti, nga vlera fillestare dhe shtesat gjatë viteve.

- Të hapen kartelat kontabël apo regjistri historik për çdo aktivitet me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2023

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se llogaria 466 “*Kreditorë për mjetet në ruajtje*” në pasqyrat financiare paraqitet në vlerën kontabël 65,660,528 lekë e rakorduar kjo dhe me Degën e Thesarit. Sipas analizës së kësaj llogarie, kjo llogari për vitin 2022 është shtuar për **22** objekte për vlerën 6,655,526 lekë, dhe është pakësuar në **16** objekte për vlerën 3,595,838 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë të ngurtësuar fonde për vlerën 62,600,940 lekë të cilat i përkasin ngurtësimeve të garancinë të punimeve për periudhën 2021 e para, të cilave u ka kaluar afati i garancisë. Bashkia Vlorë nga ana e saj nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për c’bllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre për interes publik.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21/02/2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 183-205 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim Drejtorinë e Planifikimit Zhvillim Territorit (*Spektori i Menaxhimit të Kontratave*), Drejtorinë Juridike Bashkia Vlorë, të marrin masa duke ndjekur të gjitha hapat e nevojshme që për punimet e përfunduara dhe marrë në dorëzim konformë përcaktimeve në kontratës, të bëjnë njoftimet e subjekteve për marrjen e garancive të punimeve.

Në rast mos plotësimi të kushteve ose refuzimit nga subjektet në zbatim të dispozitave ligjore të bashkëpunohet me Degën e Thesarit Vlorë për kalimin e këtyre fondeve në favor të autoritetit kontraktor si e ardhur për mospërbushje të kushteve të kontratës.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2023

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **10 (dhjetë) raste** nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë distancat urbane nga trupi i rrugës së propozuar, distancat urbane midis ndërtimeve, distancat urbane ndërtesë – kufi prone, lartësia maksimale e lejuar e matur me metra dhe numër katesh, përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapësira publike, aksesit për në pronë, lartësia minimale e lejuar për katin përdhe, mangësi në projektin arkitektonik, intensiteti i ndërtimit. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, më konkretisht me VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, Neni 14; Neni 34, pika 2; Neni 35; Neni 36, pika 3, nënpika b); Neni 37, pika 1, nënpika a) dhe c), pika 3, nënpika c); Ligji 107/2014, “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”, i ndryshuar, Neni 38; Neni 45; Rregullorja e Planit të Përgjithshëm, Bashkia Vlorë, e ndryshuar, Neni 42; Neni 46, pika 10; VKM nr. 283, datë 01.04.2015, “*Për përcaktimin e rregullave, tipave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore*”, paragrafi II.b, pika 1, nënpika a); pika 3, nënpika b). (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 261-288 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

21.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë të marrë masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në legjislacionin dhe rregulloret mbi të cilat ky institucion funksionon, të kërkohen të kryhen të gjitha ndryshimet e nevojshme mbi projektet ndërtimore deri në përputhjen e plotë sipas ligjit, në të kundërt, të mos miratohet asnjë leje ndërtimi që nuk i plotëson të gjitha kondicionet urbane të parashikuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **5 (pesë) raste** nuk janë respektuar përcaktimet ligjore në lidhje me kontributin që sektori privat duhet të ofrojë përkundrejt fondit publik të banesave sociale, me mungesën e kontratës midis palëve për evidentimin e sipërfaqes së përfiturar, si dhe me kontributin e përfiturar nga subjektet të cilat kanë përdorur të drejtën e ndërtimit me intensitet me kusht. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin 22/2018 “*Për strehim social*”, datë 03.05.2018, Neni 19, pika 1. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 261-288 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

22.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë të marrë masa për përfitimin e kontributit që sektori privat duhet të ofrojë përkundrejt fondit publik të banesave sociale sipas parashikimeve ligjore, hartimin e kontratave midis palëve përpara miratimit të lejes së ndërtimit, si dhe të marrë masat që ky përfitim të jetë i barabartë me vlerën e shitjes, për ato raste kur kontributi nuk përfitohet si sipërfaqe e banueshme, por si investim publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **12 (dymbëdhjetë) raste** të audituara, projekti ndërtimor nuk është i plotë, si dhe mungon dokumentacioni shoqërues, siç janë mangësi në rilevimin topografik, mangësi në projektet ndërtimore dhe relacionet teknike të tyre, oponenca teknike, licencat profesionale të hartuesve të projekteve, deklaratat e përgjegjësive profesionale, polica e sigurimit të përgjegjësive profesionale,

mangësi në dokumentacioni që vërteton statusin aktiv të subjekteve, projekti ndërtimor në formatin DWG. Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, më konkretisht me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 10, Neni 15, Neni 41; VKM-në nr. 1162, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi”, shtojca 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 261-288 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë të marrë të gjitha masat e duhura, që në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, të kërkohej prej saj i gjithë dokumentacioni i nevojshëm dhe të detyrueshëm, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi, si dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi me mangësi të tilla. DPKZHT dhe Bashkia Vlorë të marri masa për të kontrolluar të gjithë dokumentacionin e dorëzuar mbi saktësinë dhe plotësinë e tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **2 (dy) raste**, një pjesë e dokumentacionit të nevojshëm dhe të detyrueshëm për aplikim për pajisje me leje ndërtimi, nuk ka kaluar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, por është marrë dorazi. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 45/1, pika 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 261-288 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

24.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë të marrë masa për të mos marrë në konsideratë asnjë dokumentacion që nuk kalon nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve. Dokumentet që nuk kalojnë nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve duhet të konsiderohen të pavlefshme dhe të mos merren parasys.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **6 (gjashtë) raste**, DPKZHT dhe Bashkia Vlorë nuk kanë kërkuar mendimin e autoriteteve të tjera publike, që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, nuk janë respektuar vendimet që rregullojnë veprimtarinë ndërtimore pranë zonave të mbrojtura dhe zonave me përparësi zhvillimin e turizmit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 10/1 “Shqyrtimi i kërkesave për leje zhvillimi”, pika 6. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 261-288 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

25.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë të marrë të gjitha masat e duhura, që në çdo rast që aplikohet për t’u pajisur me leje ndërtimi, të kërkohej mendimi i autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, sipas rastit. Gjithashtu, DPKZHT Vlorë, si autoriteti i planifikimit në një zonë me përparësi zhvillimin e turizmit, duhet të respektojë të gjitha përcaktimet e kuadrit ligjor në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit në këto zona.

Menjëherë dhe në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **2 (dy) raste** të audituara, nuk janë respektuar përcaktimet ligjore në lidhje me përmbajtjen e

dokumentit të lejes së zhvillimit, më konkretisht, në dokumentin e lejes së zhvillimit për këto objekte, mungojnë të dhënat, si përdorimi i tokës dhe strukturat e lejueshme; intensiteti i ndërtimit; koeficienti i shfrytëzimit të tokës për ndërtim; lartësia maksimale në metra; distancat; gjelbërimin publik; parkimi; fragmenti i hartës në gjendjen ekzistuese (genplani i azhornuar); harta e infrastrukturës inxhinierike në zonë, këto në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 03.05.2015, *“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”*, i ndryshuar, Neni 9, pika 1; Neni 9, pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 261-288 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

26.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë të marrë masa për të përfshirë, në çdo rast, në dokumentin e lejes së zhvillimit të gjithë informacionin dhe parametrat urban të lejuar dhe të miratuar, sipas kuadrit rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1(një) rast**, zhvilluesi e ka filluar ndërtimin e objektit përpara se të pajiset me leje ndërtimi, më konkretisht:

Leje ndërtimi për objektin *“Objekt banimi dhe shërbimi me 3 dhe 10 kate mbi tokë dhe papafingo, me 1 kat nën tokë”* me adresë rr. “Gjergj Kastrioti”, Vlorë, me subjekt zhvillues “F. I.” ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

Leja e ndërtimit për objektin në fjalë është miratuar në datën 04.10.2022. Nga këqyrja e fotografimit satelitor të periudhës Gusht, 2021, vihet re se objekti ka qenë në fazë ndërtimi. Pra, subjekti zhvillues e ka filluar ndërtimin e objektit pa marrë miratimin e autoriteti përgjegjës, në këtë rast Bashkia Vlorë, kjo në shkelje të Nenit 39 të Ligjit 107/2014 *“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”*, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 261-288 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

27.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, në bashkëpunim me Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Vlorë, të marrin masa për të ushtruar aktivitetin e kontrollit të territorit në mënyrë periodike dhe sipas planeve të punës nga kryeinspektori i IMTV. Bashkia Vlorë dhe DPKZHT të marrin masa për të rritur bashkëpunimin me strukturën e IMTV dhe të kryejnë kontrolle mbi parcelën mbi të cilën aplikohet për të zhvilluar ndërtime. Bashkia Vlorë të mos miratojë asnjë leje ndërtimi kur konstatohet se ndërtimi ka filluar përpara miratimit të lejes së posaçme, si dhe të marrë masa ndëshkuese ndaj subjekteve për të cilat konstatohet kjo shkelje, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **2 (dy) raste** të audituara, nuk janë respektuar kriteret dhe përcaktimet e njëjësive strukturore në të cilat zhvillohet objekti, sipas përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Vlorë, më konkretisht, për rastin me objekt *“Stallë për mbarështimin e deleve për qumësht”* me subjekt zhvillues “S. F. G.” ShPK, ndërtimi i objekteve ndihmëse funksionale nuk është i lejuar në parcelën e marrë në shqyrtim, ndërsa për rastin *“Objekt me funksion agroturizmit 2 kat + 1 kat nënçati dhe 1 kat nëntokë”*, me adresë Kaninë, Vlorë, me subjekt zhvillues z. A. T., parcela në të cilën propozohet të ndërtohet objekti, nuk plotëson kriteret për t’u klasifikuar si Zonë Bujqësore me mundësi agroturizmit, këto në kundërshtim me Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor,

Bashkia Vlorë, Neni 33, pika 12. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 261-288 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

28.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, si autoriteti përgjegjës për zhvillimin e kontrolluar të territorit në juridiksionin e tij, të marrë masa për të mos shqyrtuar asnjë aplikim për leje ndërtimi që nuk plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Vlorë, sipas pasaportës së njësishë strukturore.

Menjëherë dhe në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit u konstatua se në **5 (pesë) raste** të audituara, nuk janë respektuar afatet kohore për shqyrtimin e aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi ose certifikata përdorimi. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në 408, datë 13.05.2015 “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, Neni 20 dhe Neni 21; Ligjin 107/2014 “*Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”, i ndryshuar, Neni 44, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 261-288 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

29.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, të marrë masa për të shqyrtuar të gjitha aplikimet që vijnë nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve brenda afateve të parashikuara në ligj, si dhe të merren të gjitha masat administrative ndaj personave përgjegjës për vonesat e konstatuara në shqyrtimin e aplikimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

30. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të certifikatave të përdorimit u konstatua se në **10 (dhjetë) raste** të audituara, ka mungesa në dokumentacionin e detyrueshëm për pajisje me certifikatë përdorimi, ose ky dokumentacion është i pasaktë, ose jo i plotë. Problematikat e konstatuara kanë të bëjnë me mungesën e kontratës së nënshkruar, ndërmjet zhvilluesit dhe mbikëqyrësit të punimeve, projekti “as built” (i zbatuar), aktet përkatëse (procesverbal, akt miratimi, akt kolaudimi, akt teknik etj.), të lëshuara nga shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime sh.a., Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, dhe ato për menaxhimin e mbetjeve urbane, problematika me fotot e objektit të përfunduar në të katërta drejtime, certifikata përfundimtare e eficiencës së energjisë, projekti arkitektonik nuk është i plotë, etj. Gjetjet e konstatuara më sipër janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, Neni 27/1, pika 1; Neni 27/2, pika 1, nënpika ë), g), j), l); Ligjin 124/2015 “*Për eficiencën e enrgjisë*”, i ndryshuar, Neni 16, pika 5, nënpika b). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 261-288 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

30.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, të marrë masa që të mos miratojnë asnjë certifikatë përdorimi, për ato raste kur dokumentacion i kërkuar në ligj dhe rregullore nuk është i plotë, i saktë ose me mangësi. Bashkia Vlorë të marrë masa për të kërkuar në çdo rast vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe vërtetimet se subjektet ndërtuese nuk kanë detyrime të papaguara ndaj autoriteteve rajonale dhe qendrore. Bashkia Vlorë të kërkojë projektin as-bulit, në çdo rast që evidentohen shmangie nga projekti i miratuar, për të bërë të mundur përllogaritjen e volumit të shmangies nga projekti i miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

31. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të certifikatave të përdorimit u konstatua se në **7 (shtatë) raste** të audituara, ka ndryshime midis projektit të miratuar dhe objektit të ndërtuar, më konkretisht, evidentohet se në një rast ka ndryshim tek dritarja sipër hyrjes së parkimit nëntokësor, duke shkelur përcaktimet e projektit të miratuar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*”, i ndryshuar, Neni 1 dhe Ligjin 107/2014 “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”, i ndryshuar, Neni 51, pika 1. Në një rast konstatohet se çarjet në fasada, si dyer dhe dritare nuk janë realizuar sipas projektit të miratuar; në një rast konstatohet se konstruksioni në fasadën veriore tek i cili, sipas projektit, mbështetet konsoli mbulues nuk është realizuar sipas projektit të miratuar; në një rast soleta e kafazit të shkallëve nuk është realizuar sipas projektit; shkallët dhe veranda që të çojnë te kafazi i shkalleve nuk është realizuar sipas projektit, këto në kundërshtim me Ligjin 107/2014, “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”, i ndryshuar, Neni 42, pika 1; Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “*Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme*”, i ndryshuar, Neni 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 261-288 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

31.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, në bashkëpunim me Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, të marrin masa për të mos lejuar asnjë objekt në zhvillim të devijojë nga projekti i miratuar, në kushtet e mungesës së lejeve të posaçme. Bashkia Vlorë të mos miratojnë asnjë certifikatë përdorimi kur konstatohet se ky objekt ka shmangie nga projekti i miratuar, pa proceduar paraprakisht me ndjekjen e hapave ligjor, deri në ndryshimin e objektit sipas projektit të miratuar, si dhe ndëshkimin e personave përgjegjës.

Menjëherë dhe në vijimësi

32. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se të gjitha inspektorët e strukturës së IMTV kanë formim arsimor juridik. Në këtë strukturë nuk ka inspektor me formim arsimor të inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit. Mungesa e inspektorëve më formimet e mësipërme arsimore, bënë që struktura e IMTV të ketë mangësi në njohjen e materialeve, strukturave, projekteve, si dhe evidentimit të gjendjes faktike të strukturave në raport me strukturat e miratuara me anë të vendimeve të organeve kompetent. Veprimet e mësipërme ulin eficientësinë dhe efektivitetin e kësaj strukture, si dhe nuk janë në përputhje të plotë me kërkesat e Nenit 11, të Ligjit nr. 9780, datë 16/07/2007, “*Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 288-297 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

32.1. Rekomandim: Me qëllim rritjen e eficientësisë dhe efektivitetit të strukturës së IMTV, Kryetari i Bashkisë Vlorë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për të shtuar në këtë strukturë punonjës me profil arsimor teknik dhe të profilizuar në degët që lidhen me njohjen e materialeve, strukturave, projekteve, si dhe evidentimit të gjendjes faktike të strukturave. Më konkretisht, inspektorët duhet të jenë me formim arsimor të inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.

Menjëherë dhe në vijimësi

33. Gjetje nga auditimi: Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Vlorë nuk ka kërkuar në asnjë rast heqjen e licencës profesionale për subjektet dhe mbikëqyrësit e punimeve, që kanë shkelur projektin e miratuar.

Referuar Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 52, IMTV ka detyrimin e kërimit të menjëhershëm për heqjen e licencës së subjektit ndërtues, projektuesit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, për të gjitha ato raste kur këto subjekte devijojnë nga projekti i miratuar. Edhe pse IMTV ka kryer konstatime të tilla, në asnjë rast nuk është kërkuar heqja e licencës për subjektin. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 77-183 të Projekt Raportit të Auditimit)

33.1. Rekomandim: Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Vlorë të marrë masa për të kërkuar në çdo rast që konstatohet shmangie nga projekti i miratuar, përveç ndëshkimit me masë administrative, heqjen e licencës profesionale për personat përgjegjës, sipas parashikimeve ligjore, me qëllim forcimin e masave për kontrollin e territorit dhe mbrojtjen e tij nga ndërhyrjet abuzive.

Menjëherë dhe në vijimësi

34. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndërmarra nga IMTV për shkeljet e konstatuara, rezulton se në **5 (pesë) raste** ka parregullsi në vendosjen e masës administrative në raport me shkeljen, më konkretisht, për akt-konstatimin me nr. serie 000435, datë 10.01.2022; për akt-konstatimin me nr. serie 000495, datë 17.01.2022; për akt-konstatimin me nr. serie 000533, datë 18.01.2022; për akt-konstatimin me nr. serie 000496, datë 31.01.2022; për akt-konstatimin me nr. serie 000717, datë 27.12.2022; shkelja e konstatuar është kategorizuar sipas Ligjit 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Neni 52, pika 1, nën-pika d), kur në fakt duhet të kategorizohet sipas nënpikës e), duke krijuar kështu rrethana lehtësuese për kundërvajtësin dhe duke marrë një masë administrative më të vogël se parashikimet ligjore (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 288-297 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

34.1. Rekomandim: Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Vlorë të marrë masa që për përcaktimin e shkeljes dhe ndëshkimin e kundërvajtësit sipas dispozitave ligjore, duke i bashkangjitur përcaktimet ligjore sipas rregulloreve të miratuara. Konstatimet e kundërvajtjeve nga ana e inspektoratit ndërtimor duhet të jenë në përputhje me ligjin, dhe si rrjedhojë, edhe masat administrative të vendosura duhet të jenë konform shkeljes së konstatuar dhe parashikimit ligjor për to.

Menjëherë dhe në vijimësi

35. Gjetje nga auditimi: Referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, rezulton se IMTV dhe DPKZHT, si dy strukturat përgjegjëse për zhvillimin e kontrolluar të territorit dhe mbrojtjen e tij, nuk kanë kryer detyrat e tyre funksionale duke lejuar fillimin e ndërtimit të një objekti banimi dhjetë kate përpara miratimit të lejes së ndërtimit, më konkretisht për objektin me leje ndërtimi të miratuar me vendim nr. 687, nr. 3293/1 prot; datë 04.10.2022 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për “Objekt banimi dhe shërbimi me 3 dhe 10 kate mbi tokë dhe papafingo, me 1 kat nën tokë” me adresë rr. “Gjergj Kastrioti”, Vlorë, me subjekt zhvillues “F. I.” ShPK. Nga auditimi u konstatua se ky objekt është pajisur me leje ndërtimi **pasi ka filluar ndërtimin**, më konkretisht, leja e ndërtimit për objektin në fjalë është miratuar në datën 04.10.2022. Nga këqyrja e fotografimit satelitor të periudhës Gusht 2021, si dhe nga verifikimi në terren, vihet re se objekti ka qenë në fazë ndërtimi. Pra, subjekti zhvillues e ka filluar ndërtimin e

objektit pa marrë miratimin e autoriteti përgjegjës, në këtë rast Bashkia Vlorë, kjo në shkelje të Nenit 39 të Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar. Zhvilluesi ka aplikuar për miratimin e njoftimit të fillimit të punimeve në datën 04.04.2023 dhe është miratuar në datën 13.04.2023. Nga kontrolli në terren, konstatohet se objekti është në ndërtim, në katin e 5 teknik, në fazën e karabinasë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 288-297 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

35.1. Rekomandim: Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Vlorë të marrë masa për të mos lejuar asnjë ndërtim të zhvillohet në kushtet e mungesës së lejes së ndërtimit të miratuar nga Autoriteti Kontraktor. IMTV duhet të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin nën juridiksionin e Bashkisë Vlorë në mënyrë periodike, sipas zonave të inspektimit të inspektorëve dhe planeve mujore të punës, të hartuara nga kryeinspektori, me qëllim parandalimin e zhvillimit të objekteve të kundërligjshëm, të papajisur me leje ndërtimi të miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

36. Gjetje nga auditimi: Bashkia Vlorë, DPKZHT dhe zyra juridike nuk kanë ndërmarrë të gjithë hapat dhe masat për mbrojtjen e tyre, si dhe mbrojtjen e territorit nën juridiksion e tyre, përpara gjykatës administrative dhe asaj të apelit, pasi nuk kanë evidentuar faktin se objekti i propozuar shkel çdo kondicion urban në lidhje me distancat me pallatin nr. 887, objekt i cili ka qenë i ndërtuara përpara se subjekti “H.” ShPK të aplikonte për herë të parë për pajisje me leje ndërtimi; nuk kanë evidentuar faktin se pallati nr. 887 është dëmtuar fillimisht nga ndërtimi i Ç. C., duke i reduktuar ¼ e objektit, pa asnjë projekt ose dokumentacion; nuk kanë evidentuar faktin se subjekti “H.” ShPK nuk ka pasur marrëveshje me të gjithë pronarët e pallatit nr. 887, (znj. T. H. pretendon se nuk ka firmos kurrë ndonjë marrëveshje me subjektin në fjalë), duke qenë se ky pallat nuk është marrë në konsideratë gjatë projektimit dhe procedurës së aplikimit për leje ndërtimi; nuk kanë evidentuar faktin se objekti i propozuar zhvillohet mbi një rrugë ekzistuese, duke krijuar një tunel për të lejuar kalimin e makinave, kjo në kundërshtim me legjislacionin e zhvillimit të territorit, atë të shfuqizuar dhe atë në fuqi. Edhe pse trualli ku pretendohet të zhvillohet objekti është në pronësi të zhvilluesit, Bashkia Vlorë duhet të kishte ndjekur procedurën e shpronësimit përkundrejt “H.” ShPK, si ka vepruar në rastin e pallatit nr. 887. Edhe në këtë rast është vepruar me dy standarte. Bashkia Vlorë dhe zyra juridike nuk e kanë ankimuar rastin në rekurs, pranë Gjykatës Kushtetuese, siç ligji e parashikon. (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 305-328 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

36.1 Rekomandimi: Bashkia Vlorë, për çdo rast të ngjashëm, kur miratimi i lejeve të ndërtimit kërkohet të kryhet me vendim të gjykatës administrative, të marrë masa për të evidentuar gjatë mbrojtjes së saj në gjykatë të gjitha ndryshimet e parametrave urban dhe të gjendjes ekzistuese, në funksion të miratimit të këtyre leje ndërtimi, sipas kondicioneve të reja urbane, në zbatim të kuadrit rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

37. Gjetje nga auditimi: Bashkia Vlorë ka Planin e Përgjithshëm Vendor, të miratuar me Vendim nr. 1, datë 16.10.2017, i ndryshuar. Ky plan parashikon edhe mënyrën e zhvillimit të shërbimeve dhe infrastrukturës së propozuar, më konkretisht “Rrjeti rrugor dhe vendparkime publike të propozuara”, sipas hartës 19-c. Zbatimi i projektit të infrastrukturë “Rikualifikimi i bllokut të banesave kufizuar nga bulevardi Çamëria, rr. Pelivan Leskaj, rr. Piro Sava”, ka sjellë si pasojë prishjen e pallatit nr. 887, si objekt që prekej nga ky projekt. Rruga e propozuar, e miratuar me

lejen e infrastrukturës, nuk bën pjesë në hartën 19-c, pra nuk është pjesë në projekteve të propozuara infrastrukturore sipas PPV-së. Nuk është e qartë se ku është mbështetur Bashkia Vlorë për vendimmarrjen e rikualifikimit të këtij blloku. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë, Paragrafi 3, si dhe Harta 19-c e PPV-së. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 305-328 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

37.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Vlorë, të marrë gjitha masat për të zbatuar me përpikmëri Planin e Përgjithshëm Vendor të saj, si dhe specifikisht, të gjitha direktivat mbi zhvillimin e shërbimeve dhe infrastrukturës së propozuar. Bashkia Vlorë duhet të vendosi fillimisht në zbatim të gjitha projektet referuar këtij plani, edhe nëse shikohet e nevojshme, të kërkojë pranë KKT-së, si autoriteti përgjegjës për hartimin e PPV-ve, ndryshimet e argumentuara të këtij plani.

Menjëherë dhe në vijimësi

38. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ankesave të bëra nga znj. T. H., protokolluar në KLSH me nr. 416 prot., datë 08.05.2023, vijuar nga ankesa e znj. V. H. (e bija e T. H.), protokolluar në KLSH me nr. 554 prot., datë 14.06.2023, vijuar nga ankesa e nga znj. T. H., protokolluar në KLSH me nr. 417/1 prot., datë 29.06.2023, është konstatuar se Bashkia Vlorë ka vepruar me dy standarte pasi, në vitin 2018 është ndërtuar një rrugë e cila kalon përmes pronës e cila pretendohet të zhvillohet, sipas Vendimit nr. 642, datë 21.05.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë. Bashkia Vlorë, në këtë rast nuk e ka kryer procesin e shpronësimit, si ka vepruar në rastin e prishjes së pallatit nr. 887. Një veprim i tillë do ndante pronën në dy pjesë, si rezultat përlogaritja e koeficienteve urban do të reduktohej. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999, *“Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”*, i ndryshuar, Neni 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 305-328 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

38.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të marrë masa për t'i trajtuar të gjitha rastet me të njëjtin standarte, specifikisht në lidhje me nisjen e procedurave të shpronësimit, për të gjitha ato pasuri të cilat preken ose janë prekur nga projekte infrastrukturore për interes publik. Bashkia Vlorë të marrë masa për evidentimin e këtyre rasteve dhe nisjen e menjëhershme të procedurave të shpronësimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

39. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ankesave të bëra nga znj. T. H., protokolluar në KLSH me nr. 416 prot., datë 08.05.2023, vijuar nga ankesa e znj. V. H. (e bija e T. H.), protokolluar në KLSH me nr. 554 prot., datë 14.06.2023, vijuar nga ankesa e nga znj. T. H., protokolluar në KLSH me nr. 417/1 prot., datë 29.06.2023, në lidhje me pronën e cila pretendohet të zhvillohet, sipas Vendimit nr. 642, datë 21.05.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë. Bashkia Vlorë, është konstatuar se pasuria nr. 27/57, ZK 8602, është përdorur si truall ku mbështetet objekti, si për objektin që pretendohet të zhvillohet, po ashtu edhe për një kompleks prej tre objektësh të ndërtuar nga “H.” ShPK, miratuar nga KRRT me Vendim nr. 4/47, datë 14.12.2007. Gjendur përpara këtij fakti, shprehemi se përdorimi i të njëjtës parcelë, si truall ku mbështeten dy objekte të ndryshme, të miratuar me leje të ndryshme, ndikon në uljen fiktive të koeficientit të shfrytëzimit të territorit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 722, datë 19.11.1998, *“Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave...”*, Neni 127 dhe Ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014, *“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”*, i ndryshuar, Neni

39. (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 305-328 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

39.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Vlorë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Aseteve, të verifikojnë situatën në lidhje me pasurinë nr. 27/57, ZK 8602, e cila shërben si truall ku mbështet objekti që pretendohet të zhvillohet, objekt për të cilin Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Vlorë, ka pranuar kërkesën e paditësit dhe ka nxjerrë vendimin nr. 642, datë 21.05.2019, ku ka vendosur detyrimin e palës së paditur, pra Bashkia Vlorë, për nxjerrjen e akteve administrative, formularët ligjore, etj., pra miratimin e lejes së ndërtimit. Nëse nga verifikimi rezulton se pasuria me nr. 27/57, ZK 8602 është përdorur si truall ku mbështetet objekti për më shumë se një rast, pra edhe për një kompleks prej 3 objektesh të ndërtuar nga “H. G.” ShPK, miratuar nga KRRT me vendim nr. 4/47, datë 14.12.2007, Bashkia Vlorë të marrë masa për t’u evidentuar këtë fakt, deri në vendosjen në dijeni të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë. Gjithashtu, Bashkia Vlorë të marrë masa për evidentimin e tjetërsimit të pasurisë mbi të cilën pretendohet të zhvillohet një ndërtim i ri, qoftë kjo shitje, blerje, ndarje ose bashkim pasurie, me qëllim shmangien e përdorimit disa herë të të njëjtës ngastër, si truall ku mbështet objekti në zhvillim, duke zvogëluar në mënyrë fiktive koeficientin e shfrytëzimit të territorit dhe intensitetit, por duke i rritur realisht këto parametra për njësinë strukturore ku parcela ndodhet.

Brenda datës 31.03.2024

40. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ankesave të bëra nga znj. T. H., protokolluar në KLSH me nr. 416 prot., datë 08.05.2023, vijuar nga ankesa e znj. V. H. (e bija e T. H.), protokolluar në KLSH me nr. 554 prot., datë 14.06.2023, vijuar nga ankesa e nga znj. T. H., protokolluar në KLSH me nr. 417/1 prot., datë 29.06.2023, është konstatuar se në dokumentin e projektit të lejes së infrastrukturës “*Rikualifikimi i bllokut të banesave...*”, vihet re se mbi objektin që pretendohet të zhvillohet, shkruhet: “*Objekt me leje të miratuar*”, informacion i cili nuk është i vërtetë, pasi ky objekt nuk ka aplikuar akoma për t’u pajisur me leje ndërtimi. Projekti i rikualifikimit është hartuar nga ing. D. H. dhe ing. J. Ç., si dhe është miratuar nga kryetari i Bashkisë Vlorë, z. D. L. Informacioni jo i saktë në dokumenta zyrtare është në kundërshtim me Ligjin nr. 8503, datë 30.06.1999 “*Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare*”, Neni 6 dhe Neni 9. (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 305-328 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

40.1 Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marrë masa për të mos përfshirë në asnjë rast në dokumentat zyrtarë të nxjerrë prej saj, informacion jo të saktë, kjo konform dispozitave ligjore në lidhje me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit. Informacioni dhe të dhënat në dokumentat zyrtar duhet të jenë të saktë, të plotë, të përshtatshme dhe të shpejtë.

Menjëherë dhe në vijimësi

41. Gjetje nga auditimi: Referuar ankesës së z. J. M., dërguar në KLSH Me anë të shkresës me Nr. 475 Prot., datë 23.05.2023, subjekti “A.-C.” ShPK, për të cilin Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Vlorë, në datën 23.12.2019, ka marrë vendimin nr. 1398, ku urdhëron Bashkinë Vlorë për pajisjen e paditësit me dokumentat, formularë ligjor për sheshin dhe lejen e ndërtimit, pra miratimin e lejes së ndërtimit, si dhe “A. K.” ShPK dhe z. F. H., subjekte për të cilat Bashkia Vlorë ka miratuar lejen e ndërtimit, sipas vendimit të gjykatës, nuk kanë statusin aktiv për ushtrimin e aktivitetit. Në vazhdim, i është kërkuar Bashkisë Vlorë dokumenti i çertifikatës së regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), si dhe ekstrakti historik për këto subjekte. Ky dokumentacion nuk është vendosur në dispozicion. Bazuar në dokumentacionin dorëzuar nga

ana e ankimuesit, z. J. M., shprehemi se, referuar ekstraktit të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “A. K.” ShPK, konstatohet se statusi i këtij subjekti ka qenë i pezulluar. Referuar këtyre të dhënave, shprehemi se Bashkia Vlorë ka miratuar një leje ndërtimi ndaj një subjekti i cili nuk ka dorëzuar vërtetimet e ushtrimit të aktivitetit, ose nuk e ka të drejtën e ushtrimit të aktivitetit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 15, pika 1, nënpika (ë). (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 305-328 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

41.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Vlorë, të marrë masa për të verifikuar statusin e ushtrimit të aktivitetit për subjektet “A. K.” ShPK dhe z. F. H. në periudhën kur këto subjekte kanë aplikuar për pajisje me lejen e ndërtimit të miratuar me vendim nr. 13, nr. 11060 prot; datë 26.07.2021 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë. Nëse vërtetohet se këto subjekte nuk kanë pasur të drejtën e ushtrimit të aktivitetit në periudhën e aplikimit, Bashkia Vlorë, DPKZHT dhe Drejtoria Juridike të marrin masat dhe të ndjekin procedurat për shpalljen e kësaj leje ndërtimi **nul dhe të pavlefshme**. Bashkia Vlorë dhe DPKZHT nuk duhet të miratojnë asnjë leje ndërtimi kur subjekti zhvillues nuk arrin të vërtetojë të drejtën e ushtrimit të aktivitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

42. Gjetje nga auditimi: Nga ballafaqimi i dokumentacionit të Vendimit nr. 1398, datë 23.12.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë, me dokumentacionin e miratimit të lejes së ndërtimit me Vendim për miratim nr. 13, nr. 11060 prot; datë 26.07.2021 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, konstatohet se pala paditëse ka qenë “A.-C.” ShPK, gjithashtu gjykata është shprehur në vendimin e saj në favor të kësaj shoqërie, ndërsa Bashkia Vlorë e ka miratuar këtë leje ndërtimi në favor të shoqërisë “A. K.” ShPK dhe z. F. H. Grupi i auditimit i kërkoi Bashkisë Vlorë, dokumentin e lejes për ndryshim të subjektit zhvillues, siç do të duhej të veprimej në kushte të tilla. Ky dokument nuk u vendos në dispozicion. Si përfundim, shprehemi se Bashkia Vlorë nuk ka zbatuar vendimin e gjykatës, duke miratuar lejen e ndërtimit në favor të dy subjekteve të tjera, dhe jo atij subjekti për të cilin është shprehur gjykata, gjithashtu nuk është dhënë asnjë shpjegim për këtë vendimmarrje. Edhe pse në këto kushte, grupi i auditimit i kërkoi Bashkisë Vlorë dokumentin e njoftimit të fillimit të punimeve. Ky dokument nuk u vendos në dispozicion, edhe pse, nga verifikimi në terren, këta zhvillues e kanë filluar ndërtimin. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 52, pika 1, nënpika dh). Referuar dokumentit të lejes së ndërtimit, ku citohet: “35. Afati i fillimit të punimeve është një vit nga data e miratimit të lejes së ndërtimit”, shprehemi se, edhe pse afati një vjeçar ka kaluar, DPKZHT dhe IMTV nuk kanë marrë asnjë masë sipas parashikimeve ligjore për këto subjekte, kjo në kundërshtim me Ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 40, pika 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 305-328 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

42.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, në bashkëpunim me Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, të marrin masa për të bërë të gjitha verifikimet e nevojshme nëse ky subjekt e ka filluar ndërtimin në mungesë të miratimit të njoftimit të fillimit të punimeve ose jo, dhe sipas rastit, të marrë masat administrative, sipas përcaktimeve ligjore.

42.2 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia

Vlorë, të verifikojnë situatën në lidhje me tejkalimin e afatit një vjeçar nga miratimi i lejes së ndërtimit, për fillimin e punimeve, siç parashikohet në dokumentin e lejes së ndërtimit. Në rast se ky afat është tejkaluar, Bashkia Vlorë të procedojë me marrjen e masave sipas parashikimeve ligjore, deri në shpalljen nuk dhe të pavlefshme të lejes së ndërtimit me vendim për miratim nr. 13, nr. 11060 prot; datë 26.07.2021 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë.

Menjëherë

43. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ankesës drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga inxhinieri z. L. B., përfaqësues i studios L.S.B, me anë të shkresës me nr. 453 prot; datë 06.05.2022, është konstatuar se nga këqyrja e fotografimit satelitor historik, më konkretisht ai i Qershor, 2020, i cili përkon me kohën e aplikimit (19.06.2020), rezulton se objekti ka qenë në ndërtim kur është bërë kërkesa për leje ndërtimi për ndryshim të projektit gjatë ndërtimit. Lejet për ndryshim të projektit gjatë ndërtimit, janë në vetvete leje ndërtimi, dhe si të tilla, duhet të miratohen në momentin e konstatimit të problematikës, më konkretisht, për rastin e marrë në shqyrtim, para ndërtimit të kateve nëntokë, edhe jo pasi zhvilluesi ka vazhduar me ndërtimin e projektit të ndryshuar, por pa marrë miratimet e nevojshme nga autoriteti vendor, duke qenë se argumenti i zhvilluesit për ndryshimin e projektit ka qenë *“bazament i fortë dhe vështirësi në gjermime”*. DPKZHT dhe IMTV Vlorë nuk kanë kryer detyrat e tyre funksionale konform ligjit, si dy struktura përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme, por edhe kontrollin e zbatimit të objekteve të ndërtuara me leje apo në shkelje të saj, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga Ligji nr.107/2014, datë 31.07.2014, *“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”*, të ndryshuar, Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007, *“Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”*, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015, *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, të ndryshuar. Gjithashtu, subjekti zhvillues “T.M.Z.B” ShPK dhe mbikëqyrësi i punimeve, kanë shkelur ligjin duke ndërtuar një objekt pa lejen e ndërtimit përkatëse. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 305-328 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

43.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, në bashkëpunim me Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, të marrin të gjitha masat për të kontrolluar gjendjen faktike të objektit në ndërtim për të dyja seksionet, përse i takon kateve nëntokësore dhe kuotave të gjermimit, nëse janë realizuar sipas projektit të ndryshuar të miratuar. Gjithashtu, DPKZHT duhet të analizojnë me kujdes dhe konform kuadrit rregullator argumentimin e të gjithë atyre subjekteve që aplikojnë për ndryshim të projektit gjatë zbatimit. Bashkia Vlorë dhe DPKZHT nuk duhet të japin asnjë leje ndërtimi për ndryshim të projektit gjatë zbatimit, pa kontrolluar paraprakisht gjendjen ekzistuese, si dhe të vërtetojnë që ky subjekt nuk i ka reflektuar ndryshimet e kërkuara, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

43.2 Rekomandimi: Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor të marrë masa për të ushtruar aktivitetin e tij mbi të gjithë territorin e Bashkisë Vlorë, sipas planeve mujor të punës të miratuara nga kryeinspektori dhe sipas ndarjes së zonave të kontrollit për secilin inspektor. Kryeinspektori dhe inspektorët duhet të ushtrojnë aktivitetin e tyre kontrollues me efektivitet të lartë dhe të evidentojnë shmangiet e objekteve të pajisur me leje ndërtimi gjatë procesit të ndërtimit, dhe jo pasi këto subjekte janë pajisur me leje për ndryshim projekti. IMTV dhe DPKZHT të rrisin bashkëpunimin midis tyre për të evidentuar në kohë të gjitha rastet e devijimit nga projekti i miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

44. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ankesës drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga inxhinieri z. L. B., përfaqësues i studios L.S.B, me anë të shkresës me nr. 453 prot; datë 06.05.2022, është konstatuar se Bashkia Vlorë dhe DPKZHT kanë shkelur përcaktimet ligjore dhe kanë dalë jashtë kompetencave të tyre, pasi kanë miratuar një leje ndërtimi për shtyrje afati të përfundimit të punimeve, kur për këtë objekt, leja e ndërtimit është miratuar me vendim të KRRT, nr. 5/95, datë 17.08.2010, ndërsa leja për shtyrje afati të përfundimit të punimeve është miratuar në datë 17.02.2023, pra në tejkalim të afatit dhjetë vjeçar të parashikuar në Nenin 40, pika 6 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 305-328 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

44.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, të marrin të gjitha masat për të evidentuar të gjithë ata subjekte zhvillues dhe ato objekte të pajisura me leje ndërtimi, të cilët e kanë filluar dhe nuk e kanë mbaruar procesin e ndërtimit brenda afatit dhjetë vjeçar, të parashikuar në ligj. Bashkia Vlorë nuk duhet të miratojë asnjë kërkesë nga këto subjekte, siç janë leje për ndryshim projekti ose leje për shtyrje të afatit të ndërtimit. Bashkia Vlorë të vazhdojë procedurat e parashikuara për të gjitha ato raste kur evidentohet tejkalimi i afatit dhjetë vjeçar për ndërtimin e objektit, sipas kuadrit ligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

45. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ankesës drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga inxhinieri z. L. B., përfaqësues i studios L.S.B, me anë të shkresës me nr. 453 prot; datë 06.05.2022, është konstatuar se Bashkia Vlorë dhe DPKZHT, me miratimin e lejes së ndërtimit me vendim nr. 4, nr. 874 prot; datë 23.01.2023, kanë shkelur përcaktimet ligjore dhe kanë dalë jashtë kompetencave të tyre, duke miratuar një leje për shtyrje afati të përfundimit të punimeve në kundërshtim me përcaktimet e Nenit 40, pika 6, nën-pika 2 të Ligjit nr.107/2014, datë 31.07.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar, pasi aplikanti ka ngarkuar në sistemin e-leje grafikun e ri të punimeve me një afat 36 mujor, ndërsa leja e miratuar është për një afat 45 mujor. Vlen të theksohet fakti se afati i lejes së ndërtimit të miratuar nga K.RR.T-ja ka qenë 39 mujor, pra shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve e datës 17.02.2023 është më e gjatë se vet afati i fillestar i lejes së ndërtimit, edhe pse nga fotot e gjendjes ekzistuese dallohet qartë se seksioni B është në fazën finale të përfundimit të punimeve, ndërsa seksioni A është në fazën e ndërtimit (3 katet e para kanë përfunduar fazën e karabinasë). (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 305-328 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

45.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, të marrin masa që, për çdo rast që aplikohet për shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve, të respektojnë grafikun e punimeve, të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, nga ana e subjektit zhvillues. Në asnjë rast, afati i përfundimit të punimeve, nuk duhet të jetë më i gjatë se afati i paraqitur nga subjekti zhvillues në grafikun e punimeve. Grafiku dhe preventivi i punimeve duhet të ballafaqohen në çdo rast me gjendjen ekzistuese të objektit në zhvillim, nga DPKZHT në bashkëpunim me IMTV.

Menjëherë dhe në vijimësi

46. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me bashkëpunimin ndërinstucional midis strukturave vendore dhe qendrore, IMTV, IKMT, Bashkia Vlorë dhe

DPKZHT, planet një mujore dhe tre mujore te miratuara nga kryeinspektori, raportimi periodik tre mujor drejtuar IKMT-së, si dhe kërkesat drejtuar DPKZHT për pajisjen me projektet e miratuara për ndërtimet objekt – kontrolli, të pajisura me leje zhvillimore / ndërtimi, rezulton se bashkëpunimi është në nivele të ulta, nuk janë përpiluar në mënyrë periodike planet mujore të punës për inspektorët, nga ana e kryeinspektorit, sipas zonave të kontrollit, si dhe nuk është kryer raportimi tre mujor drejtuar IKMT-së. Gjetjet e konstatuara nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, Neni 12, pika 10; Ligjin 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 50, pika 2; Neni 51, pika 3; VKM-në nr. 894, datë 04.11.2015, “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoriati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, pika 2; Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e administratës së Bashkisë Vlorë, Neni 180, germa b, neni 180, germa (i). (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 288-297 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

46.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, të merren masa për rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, të informojnë njëra-tjetrën mbi aktivitetin e tyre, si dhe të kërkojnë asistencë në rastet kur vlerësohet e nevojshme. Gjithashtu, IMTV në bashkëpunim me DPKZHT duhet të kryejnë kontrole periodike mbi objektet në zhvillimi, të pajisur me leje ndërtimi, për të verifikuar ecurinë sipas projektit të miratuar. Gjithashtu, kryeinspektori i IMTV të marrë masa për të hartuar në mënyrë periodike planet mujore të punës për inspektorët, sipas zonave të kontrollit.

46.2. Rekomandim: Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Vlorë, të marrë masa për të përgatitur informacion periodik tre mujor ndaj Inspektoriati Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) mbi aktivitetin e saj, procedurat e mbajtura gjatë kësaj kohe, vendimet e marra, si dhe informacion mbi rastet e trashëguara, për të cilat IKMT duhet të jetë në dijeni, sipas parashikimeve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

47. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të mbajtura nga IMTV, konstatohet se ka mangësi në dosjet individuale që IMTV duhet të mbajë për çdo procedurë të konstatuar. Informacioni nuk është mbajtur në dosje individuale për çdo rast. Gjithashtu, dokumentimi fotografik i konstatimit të shkeljeve, si dhe i procedurave të prishjes së objekteve të kundërligjshëm, informacion i cili është kërkuar dhe nuk është vendosur në dispozicion. Ky informacion duhet të ishte pjesë e relacioneve përkatëse, të cilat hartohen nga inspektorët, referuar përcaktimeve të Rregullores së Bashkisë Vlorë, Neni 182, pika b.3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 288-297 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

47.1. Rekomandim: Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Vlorë, të marrë masa për të mbajtur informacionin në dosje individuale për secilin rast të konstatuar, të bëjnë pjesë të dosjes dokumentimin fotografik të konstatimit, si dhe atë të konstatimit të kundërvajtjes dhe prishjes së objektit të kundërligjshëm, për ato raste kur procedura shoqërohet me vendim prishjeje.

Menjëherë dhe në vijimësi

48. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve dërguar me shkresën nr. 731/37 datë 2.6.2022, rezulton se:

Nga Bashkia Vlorë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 6562/1prot, datë 22.6.2022, brenda afatit ligjorë të **20 ditëve**.

Në lidhje me zbatimin e afatit **6 muajor**, në kushtet kur auditimi aktual korrespondon në periudhën që do të raportohet në KLSH, nuk është e nevojshme të bëhet raportimi pasi nga grupi i auditimit është pjesë e programit të auditimit.

Nga Bashkia Vlorë është hartuar “Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve”, me nr. 6562/2 prot datë 22.06.2022, duke përcaktuar edhe strukturat përgjegjëse sipas llojit të rekomandimit.

Nga Bashkia Vlorë nuk është raportuar në Këshillin Bashkiak, mbi rezultatet e auditimit të kryera nga KLSH dhe marrjen e masa për zbatimin e tyre, në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pika 5 e nenit 50-Auditimi i jashtëm.

Në mënyrë të përmbledhur situata e zbatimit të rekomandimeve paraqitet si vijon:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 46 masa organizative, të pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë zbatuar 18 masa, në proces auditimi janë 14 masa dhe **nuk janë zbatuar 14 masa.**

b. Për masa shpërblim dëmi janë rekomanduar 17 masa me vlerë 27,662,270 lekë, të pranuar nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 3 masa me vlerë 701,728 lekë, në proces zbatimi 7 masë me vlerë 19,863,398 lekë dhe **nuk janë zbatuar 17 masa me vlerë 7,097,144 lekë.**

c. Për masa mungesë të ardhurash janë rekomanduar 21 masë me vlerë 968,844 mijë lekë dhe 700 000 EU, të pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë zbatuar 2 masa pa vlerë, janë në proces zbatimi 4 masa me vlerë 315,897 mijë lekë, nga e cila likujduar vlera 484,000 lekë, **duke mbetur për likujdim vlera 315,413 mijë lekë. Nuk janë zbatuar 15 masa me vlerë 652,946 mijë lekë.**

d. Për masa disiplinore, janë rekomanduar gjithsej 33 masa të pranuar plotësisht dhe zbatuara nga subjekti.

e. Për masa administrative janë rekomanduar 15 masa të pranuar dhe zbatuara nga subjekti. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa (j). ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (Me hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 297-305 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

48.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

A. Masa organizative:

9.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë, të marrë masat e nevojshme që, të ngrejë një grup pune i cili të identifikojë institucionet ku janë nxjerrë jashtë përdorimit materialet me profil metalik (Administrata Bashkia Vlorë, Gjendje Civile, Qendra Ekonomike, Çerdhe, Kopshte, Njësi Administrative, etj), si dhe komisionet përkatëse, për vitet 2019-2020.

9.2. Rekomandimi: Në vijim nga grupi i punës të përlllogaritet vlera e shitjes me ankand (peshë¹²) vlera e tregut për 1 kg) të materialeve të mësipërme me profil metalik, që janë nxjerrë jashtë përdorimit në vitet 2019 dhe 2020.

¹² Specifikimet teknike të materialit, përmasa dhe peshë.

9.3. Rekomandimi: Në përfundim të procesit të identifikimit dhe vlerësimit, Titullari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjyqimit, për arkëtimin në mënyrë përpjesëtimore, të vlerës së shitjes me ankand të materialeve me profil metalik.

10.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “Ujësjellës Kanalizime Vlorë” SHA me vlerë kontabël 632,287,414 lekë dhe të pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “F. F. C. SHA” me vlerë 3,500,000 lekë, në debi të llogarisë nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

12.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, si dy struktura përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme, por edhe kontrollin e zbatimit të objekteve të ndërtuara me leje apo në shkelje të saj, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga ligji nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, dhe ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, si dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar, të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për ndëshkimin e subjektit zhvillues **A. S.**, mbikëqyrësi **D. Gj.** i pajisur me licencë nr. MK2629, Subjekti ndërtues “**T. C.**” ShPK, dhe kolaudatori **N. J.** dhe trajtimin e ndërtimit të kundërligjshëm sipas referimit ligjor të sipërcituar, deri në kthimin e ligjshmërisë në fazën fillestare.

13.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, si dy struktura përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme, por edhe kontrollin e zbatimit të objekteve të ndërtuara me leje apo në shkelje të saj, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga ligji nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, dhe ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, si dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar, të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për ndëshkimin e subjektit zhvillues “**A. P.**” ShPK, dhe mbikëqyrësin “**I. R.S.**” ShPK dhe trajtimin e ndërtimit të kundërligjshëm sipas referimit ligjor të sipërcituar, deri në kthimin e ligjshmërisë në fazën fillestare.

14.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marrë masa për trajnimin e stafit i cili angazhohet me realizimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe rishikimin e dokumentacionit të projekt preventivave të cilat përgatiten nga konsulentët e përzgjedhur, për të përshtatur dokumentacionin sipas kërkesave ligjore.

15.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve që angazhohen me zbatimin e procedurave të prokurimit

17.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marrë masa për analizimin e arsyeve të mos realizimit të shërbimit të pastrimit sipas kërkesave në kontratën përkatëse, duke i kërkuar kontraktorit realizimin e tyre, aplikimin e penalteteve për rastet e mos realizimit të kontratës dhe përlllogaritjen e dëmeve të shkaktuara si pasojë e mos realizimit të kontratës.

21.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Kontrollit dhe Planifikimit të Territorit në çdo rast përpara nxjerrjes së Çertifikatave të përdorimit dhe çdo dokumenti tjetër apo akti administrative të verifikohen rast pas rasti dokumentacioni i ngarkuar në sistemin E-Leje nëse janë në përputhje me

kërkesat e legjislacionin në fuqi. Të hartohen procesverbalet përkatëse dhe të informohen subjektet e interesuara.

Në çdo rast në momentin e paraqitjes së kërkesës për pajisjen me certifikatë përdorimi nga ana e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit të verifikohet situacionit përfundimtar me preventivin fillestar dhe të mbahen diferencat nëse dalin.

22.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, si dy struktura përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme, por edhe kontrollin e zbatimit të objekteve të ndërtuara me leje apo në shkelje të saj, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga ligji nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, dhe ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, si dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar, të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për vendosjen e penaliteteve ligjore ndaj subjektit zhvillues **T. Z.**, mbikëqyrësin, subjektin ndërtues dhe trajtimin e ndërtimit të kundërligjshëm sipas referimit ligjor të sipërcituar, deri në kthimin e ligjshmërisë në fazën fillestare.

23.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, të marrin masat për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme duke ushtruar kontroll në zbatimin e projekteve të objekteve të ndërtuara duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për vendosjen e penaliteteve ndaj subjektit zhvillues, mbikëqyrësit dhe subjektin ndërtues.

23.2. Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për subjektin zhvillues “T.M.Z.B” ShPK, dhe mbikëqyrësin A. M. dhe trajtimin e ndërtimit të kundërligjshëm deri në kthimin e ligjshmërisë në fazën fillestare në referim të ligjit nr. 107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, dhe ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, si dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar.

23.3. Rekomandimi: Referuar shkeljeve, parregullsive dhe zhvillimit të ndërtimit në mungesë të dokumentacionit tekniko-ligjor, Bashkia Vlorë, të paraqesë kopje të plotë të gjithë dosjes të subjektit (“I.” ShPK dhe “T.M.Z.B” ShPK) dhe akteve të mbajtura nga strukturat përgjegjëse, të cilat do jenë objekt shqyrtimi dhe verifikimi pas vënies në dispozicion të tyre nga KLSH.

25.1. Rekomandim: Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë, të marrë masa për eliminimin e praktikave të llogaritjes së fondit limit vetëm nëpërmjet një metode (*testimit të tregut*) dhe me dokumentacion jo të saktë ligjorë, si dhe të eliminohen rastet e zhvillimit të procedurave të prokurimit të mallrave dhe shërbimeve të të njëjtit lloj.

33.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë dhe Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore të marrë masa për vlerësimin dhe regjistrimin si Aset të sistemit TAIS dhe kodin në burim të tij.

44.1.Rekomandimi: Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve të bashkëpunojë me Drejtorinë e Taksave Vendore duke kryer verifikimet për çdo subjekt që aplikon për tu pajisur me leje për shfrytëzimin e hapësirave të plazhit dhe pasi të jetë marrë konfirmimi me shkrim të vazhdojë procedurat për kryerjen e pagesës dhe lidhjen e kontratës.

45.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë të marrë masa dhe të analizojnë në Bashki dhe Këshillin Bashkiak, mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën

1005/74, datë 20.12.2018 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Vlorë”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës. Të hartohet plan pune i veçantë e të marren të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre.

Menjëherë

C. Masa për shpërblim dëmi.

3.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marrë masa për zbritjen nga garancisë e punimeve të vlerës **370,000 lekë** përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “A.” ShPK, për punime të çertifikuara, por të pa realizuara.

3.2.Rekomandimi: Bashkia Vlorë, në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, përpara përfundimit të garancisë së punimeve, të analizojnë dhe të nxjerrin rezultatin e plotë të volumeve të shtresave asfaltike të realizuara, duke zbritur vlerat përkatëse nga garancia e punimeve, në rast të konstatimit të diferencave në sasi.

4.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për verifikimin e sasisë dhe cilësisë së punimeve për realizimin e konstruksioneve metalike. Në rast të mos përputhshmërisë me përcaktimet kontraktore, të merren masa për zbritjen nga garancia e punimeve të vlerës **381,981 lekë**, përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “A.” ShPK, për punime të certifikuar, por të pa realizuara.

5.1.Rekomandimi: Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë, me grup pune të analizojë situatën mbi gjendjen e karburantit të bërë hyrje-dalje dhe gjendje në magazinë dhe në përfundim të procesit të inventarizimit për diferencën e konstatuar të kërkohet shpërblimi i dëmit në shumën **804,530 lekë**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët në ngarkim të personave përgjegjës, konkretisht:

- vlera **211,887 lekë**, në ngarkim të punonjësës **znj. A. B.** me funksion magazinierë.
- vlera **592,643 lekë**, në ngarkim të punonjësit **ing. E. H.** me funksion Përgjegjës i Sektorit Teknik.

7.1.Rekomandimi: Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Përgjegjësën e Sektorit të Financës në NSHP, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **538,196 lekë** në ngarkim të shoqërisë “C.”, për mos zbatim në afat të punimeve sipas kontratës nr. 146, datë 11.06.2018.

9.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë, nëpërmjet Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit të marrë masa për kryerjen e kontabilizimit të detyrimeve në llogaritë debitore dhe nëpërmjet Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve e Drejtorisë Juridike të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës **prej 3,145,400 lekë**, nga subjektet e individ privatë.

13.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **125,844 lekë**, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti “A., P. dhe V. V.”.

14.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës

1,565,508 lekë, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti “H.-P.” ShPK.

Menjëherë

D. Masa për eliminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet.

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Taksave Vendore, të analizojë situatën e krijuar si pasojë e detyrimeve të krijuara nga UK SHA, Vlorë (në rolin e Agjentit tatimor), për Taksën e ndërtesës dhe tarifë pastrimi - gjelbërim-ndriçimi nga abonentët familjarë dhe të nënshkruajnë një akt- marrëveshje me këtë shoqëri, me qëllim marrjen e përgjegjësive ligjore nga palët dhe shmangien e veprimeve abuzive në mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

2.2.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Rajoneve dhe të Njësive Administrative, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore si edhe të hartohet regjistri i familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim rritjen e të ardhurave.

2.3.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë, të marrin masa duke bashkëpunuar me UK-Vlorë si dhe të ndjekin të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **148,587,530 lekë**.

- Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë të bashkëpunojnë me UK sha, për evidentimin e vlerës së patarifuar prej **196,996,337 lekë** dhe nëse ka shmangie në lidhje me ndjekjen dhe mos arkëtim të detyrimeve për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit të aplikohet masë administrative ndaj agjentit tatimor .

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, të kërkojë arkëtimin detyrimin të llogaritur si penalitet në vlerën **1,517,789 lekë** për pagesë me vonesë subjektit “D.” ShPK.

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të kërkojë arkëtimin e detyrimin të llogaritur si mos mbajtje e saktë e taksës në vlerën **79,145,441 lekë** subjektit “B.” ShPK.

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të kërkojë arkëtimin e detyrimin të llogaritur si mos mbajtje e saktë e taksës në vlerën **36,538,289 lekë** subjektit “B.” ShPK.

9.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë, të marrë masat për të bërë të mundur arkëtimin e shumës prej **700,000 Euro** nga T. P. në zbatim të vendimit të arbitrazhit. Të merret informacion nga pala e autorizuar S. B. M.K. për ecurinë e deritanishme të procedurave të ndjekura për arkëtimin e këtij detyrimi.

10.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë, nëpërmjet Drejtorisë së Investimeve Publike, Strehimit dhe Transportit, të marrë masa që të pajisë 17 subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të

karburanteve, duke arkëtuar shumën **prej 17,000,000 lekë** si edhe të arkëtojnë duke aplikuar tarifat e plota për 19 subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për diferencën debitore **prej 15,200,000 lekë**. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të tyre.

11.2.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të ndjekin procedurat e njoftimit të personave për detyrimet si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e kësaj takse nga të gjithë individët me status “debitorë” **në shumën 3,385,382 lekë**, bazuar në legjislacionin tatimor.

12.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë të ndjekin procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimit prej **347,040 lekë**, tarifë qiraje e pa paguar nga subjekti qiramarrës “**I. A.**”.

12.2.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë të analizojnë situatën e krijuar dhe të marrin masa për vënien në zbatim të VKB nr.101, datë 03.10.2019 “Për miratimin e dhënies së pasurisë së paluajtshme (Thertore) me qira në Njësinë administrative Novoselë”, miratuar me afat 5 vjet dhe vlerë qiraje 44,740 lekë/muaj, me qëllim shfrytëzimin e këtij ambienti dhe rritjen e të ardhurave të Bashkisë, pasi vetëm për periudhën 2 vjeçare është shkaktuar një e ardhur e munguar **në shumën 1,073,760 lekë**.

13.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë, Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, në bashkëpunim me MZHETT-s referuar VKB nr. 60, datë 27.10. 2016 të rishikojë dhe të amendojë kontratën e datës 04.06.2002 dhe aneks-kontratën e datës 03.07.2013, duke bërë ndryshimet përkatëse në objektin e kontratës dhe në përcaktimin e pagesës sipas sipërfaqes së re të konstatuar nga matjet faktike të kryera në terren prej 14,932 m² janë sipërfaqe trualli funksional dhe 28 m² sipërfaqe ndërtese, e konstatuar nga matjet faktike të kryera në terren në dakortësi me qiramarrësin, si dhe të aplikohen ndryshimet e tarifës së qirasë/m² truall funksional nga ndryshimi i legjislacionit, duke përcaktuar edhe periudhën e fillimit të detyrimit.

13.2.Rekomandimi: Strukturat drejtuese, të analizojnë situatën e krijuar dhe të nxjerrin përgjegjësitë administrative ndaj personave përgjegjës që kanë shkaktuar efekt negativ financiar **në shumën 10,198,440 lekë**, për mos përcaktimin e pagesës sipas sipërfaqes së re të konstatuar nga matjet faktike të kryera në terren si edhe mosaplikimin e tarifave të reja të qirasë/m² duke favorizuar subjektin “**I. I**” ShPK.

14.1.Rekomandimi: Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Financë Kontabilitetit, të marrë masa për kryerjen e rakordimeve në lidhje me subjektet të cilat nuk kanë kryer pagesat për shfrytëzimin e hapësirave të plazheve dhe kanë shfrytëzuar këto hapësira për vitet 2018-2021, duke kryer arkëtimin e vlerës prej **14,903,440 lekë**.

15. Gjetje nga auditimi: Sipas procedurës së prokurimit “Rikonstruksion i rrugës Panaja-Hoshtime”, kanë marrë pjesë 4 ofertues, nga të cilët janë skualifikuar 3 ofertuesit si më poshtë:Nga ana e KVO duhet të merrej në konsideratë se transporti në rrugën standarde, megjithëse distanca është pak mbi 30 kilometër, të konsiderohej si devijim i vogël. OE “Sh. 07” ShPK, ka paraqitur ofertë anomalish të ulët dhe nga ana e KVO duhet të kërkoheshin sqarime për zërat e preventivit, nëse argumentohej apo jo mundësia e realizimit të kontratës. Sa më sipër, duke marrë në konsideratë faktin se nga rruga standarde për të cilën është parashikuar realizimi i transportit, ka një distancë pak më të madhe se 30 kilometër, e cila mund të konsiderohej devijim i vogël, faktin se oferta është anomalish e ulët, për të cilën nuk janë kërkuar sqarime, si dhe faktin se nga OE përkatës nuk ka patur ankesë, **vlera 2,956,640 lekë**, e cila del nga diferenca e ofertës së OE

fitues “A.” ShPK me ofertën e paraqitur nga OE “Sh.” ShPK, konsiderohet efekt negativ financiar. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE fitues “A.” ShPK, rezulton se dokumentacioni për mekanizmin ekskavator me zinxhirë, i përket një mekanizmi me goma. Veprim në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik.

15.1 Rekomandim: Bashkia Vlorë të shqyrtojë vlerësimin e ofertave për këtë procedurë, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për mangësitë e përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit, nga KVO.

16.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë nëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Njësinë Prokurimit të saktësojë listat e bizneseve të ndërtimit që kanë qenë zbatuese të lejeve të ndërtimit dhe të projekteve të investimeve të prokuruarra për vitet 2018-2019-2020-2021, që kanë seli jashtë territorit të Bashkisë Vlorë dhe Njësi Administrative dhe që ushtrojnë aktivitetet me adresë dytësore në këtë territor, të nxjerrin njoftim detyrimin për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës së kësaj tarife prej **2,890,000 lekë** si edhe marrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve debitore në vlerën **2,280,000 lekë**.

17.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë nëpërmjet strukturave të NJA-ve, Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe Drejtoria Juridike të marrë masa për monitorimin dhe rishikimin e kontratave për subjektet private që janë debitore, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për anulimin e kontratave që nuk janë aktive si dhe ndjekjen e arkëtimin e detyrimeve debitore.

18.3.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë dhe Sektori Pyjeve dhe Kullotave të marrë masa për ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës debitore **prej 210,000 lekë, nga subjekti “N.” ShPK.**

F.2. Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit për mos zbatimin e kontratave në afat, përcaktuar në nenin 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar me Ligjin nr. 120/2020, datë 07.10.2020 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Vlorë t’i kërkojë **Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor**, Bashkia Vlorë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të bëjë propozimin për fillimin e procedurës disiplinore me gjobë, për:

1. znj. I. S. përfaqësues i shoqërisë “I.-18”, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për mos ndjekjen e kushteve të kontratës nr. 263, datë 25.7.2019 të lidhur midis institucionit NSHP Bashkia Vlorë ka lidhur me shoqërinë “L.” ShPK, për përfundimin në afat të punimeve, veprime me efekt negativ me dëm në vlerën **207,030 lekë**.

2. znj. R. N. përfaqësues i shoqërisë “R.-18” ShPK, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për mos ndjekjen e kushteve të kontratës nr. 400/1, datë 15.11.2019 të lidhur midis institucionit NSHP Bashkia Vlorë ka lidhur me shoqërinë “S.” ShPK, për përfundimin në afat të punimeve, veprime me efekt negativ me dëm në vlerën **827,777 lekë**.

3. Shoqëria “D.” ShPK, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin “Rikonstruksion i rrugës Panaja-Hoshtimë”, për çertifikim të punime me vlerë 370,000 lekë, të cilat nuk janë realizuar.

Menjëherë

49. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Vlorë asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë dhe Njësie Administrative që përmbledh kjo Bashki nuk janë inventarizuar si dhe nuk janë marrë në dorëzim, nga titullari institucionit dhe strukturat përkatëse, nuk është vepruar sipas VKM-së, nr.500 datë 14.8.2001“*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore*”, të pikave 9,10,11 dhe 22”, që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ku Bashkitë ishin të detyruara të paraqisnin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që kërkonin t’u transferoheshin. Për bashkinë Vlorë lista e pronave është miratuar me VKM nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” dhe VKM përkatëse. Në total Bashkisë Vlorë i janë transferuar 4,415 pasuri. Për asnjë prej tyre nuk është përgatitur dokumentacioni për tu regjistruar në ASHK (ish ZRPP).

-Nga Bashkia Vlorë, nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së Vlorë, mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të personat e tretë që kanë pësuar këto pasuri, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive.

Gjithashtu konstatohet se inventari i pasurive të paluajtshme të Bashkisë Vlorë është i pa përditësuar, në kundërshtim me nenin 37 të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore të pa përditësuara (*Me hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 305-328 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

49.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse, të marrin masat të ngrejë grupet e punës, për të përcaktuar në misionin dhe detyrat e saj mbi administrimin e asetëve, si dhe struktura e ngarkuar për ndjekjen e tyre dhe inventarizimin e pronave përkatëse, gjithashtu të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.

-Procedura e përditësimit mbështetet në verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren dhe verifikimit juridik, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

50. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me fondin pyjor, me VKM nr. 433 datë 08.06.2006 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit”, të ndryshuar janë transferuar në Bashkinë Vlorë 323 ekonomi pyjore/kullosore. Nga këto nuk janë regjistruar asnjë ekonomi pyjore në DVASHK Vlorë dhe nga ana e Bashkisë, sektori i pyjeve nuk janë marrë masa për të miratuar plane mbarështimi për menaxhimin e tyre me qëllim dhënien në përdorim, sipas parashikimeve të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet” dhe Udhëzimin nr.1 datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për rregullat, procedurat e kërkitimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”. Struktura përgjegjëse e pyjeve, nuk është e përditësuar me ndryshimet e reja të legjislacionit në fushën e pyjeve, dhe konkretisht me VKM-në nr.171, datë 18.03.2022, “Ngritjen e bazës së të dhënave për Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor dhe regjistrin e fondit kullosor si dhe manualët e përdorimit të programit ALFIS”, - nuk janë kryer verifikime në terren të pasurive që Bashkia ka në inventarë, **si dhe në kundërshtim me rregulloren e brendshme viti /2018 kreu IV neni 50 Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë, pika 14** «*Nxjerr urdhra dhe vendime në zbatim të detyrave që*

rrjedhin nga aktet e këshillit si dhe nga aktet ligjore e nënligjore ne fuqi». (Me hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 305-328 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

50.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me drejtorinë e pyjeve/kullota, të marri masa për ngritjen e grupeve të punës për marrjen në dorëzim dhe regjistrimin e ekonomive pyjore, të një numri të madhë të pronave të pa inventarizuara dhe të pa reregjistruara, çka bën të paqartë numrin e pronave sipas listave të inventarëve, pronë të Bashkisë, për verifikim në terren nëse këto prona janë të lira, të zaptuara, ose dhe të tjetërsuara nga palë të treta.

-Drejtoria e pyjeve të marri masa të hartohen planet e mbarështimit pasi, “Bashkitë janë pronarë të kullotave që gjenden brenda territorit administrativ të tyre dhe kanë për detyrë të a) të ruajnë, administrojnë dhe i përdorin kullotat dhe livadhet, b) të hartojnë, me shpenzimet e veta, planet e mbarështimit të kullotës apo livadhit, të cilat miratohen nga ministri përgjegjës për kullotat dhe livadhet”.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

51. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e drejtorisë së pronave publike dhe menaxhimit të aseteve si dhe njësive administrative, nga Bashkia Vlorë administrohen 266 kontrata të dhënies me qira me sipërfaqe 464.678 ha të tokave të pandara, të lidhura që para reformës territoriale nga Ish-Komunat Qendër, Shushicë dhe Novoselë.

-Së pari, nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se në dosjen përkatëse të kontratave të qirasë, e cila nuk ka inventar, mungon dokumentacioni i detyrueshëm, sipas VKM përkatëse;

-Së dyti, kontratat janë nënshkruar në vitin 2008 deri në vitin 2012, me bazën ligjore të asaj periudhe dhe mungojnë procesverbalet ku duhet të përshkruhen qartë gjendja fizike e pronës, vlera kontabël e objektit që jepet me qira ose enfiteozë, sipas germa d);

-Së treti, nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, si dhe NJA nuk është realizuar në asnjë rast monitorimi i kontratave, nëse individ apo subjekte private qiramarrës kanë realizuar investimin sipas objektit të kontratës apo janë në kushtet e moszbatimit të saj. Nuk është bërë mbikëqyrja e përdorimit të tokës bujqësore të marrë me qira mbi bazën e kartelës personale për çdo kontratë. Në kundërshtim me: **neni 826 të kodit civil, neni 827”Qiradhënësi me anë inventari i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme si tokën bujqësore, kullotat, si dhe neni 829 “Qiradhënësi ka të drejtë që në çdo kohë të ushtrojë kontroll mbi pasurinë e dhënë me qira për të përcaktuar nëse qiramarrësi respekton marrëveshjen sipas detyrimeve të vëna në kontratë, sipas natyrës dhe rregullave agroteknike;**

Gjithashtu nuk është vepruar sipas rregullores së brendshme viti /2018 neni 34,35 Misioni i Njësive Administrative “Mbikëqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e Bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të Bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin”.

Monitorimi bëhet nga njësitet monitoruese që janë institucionet shtetërore, ish-ndërmarrjet shtetërore që kanë në administrim objektet e dhëna me qira ose enfiteozë, si dhe nga degët pika 2, për çdo kontratë të lidhur, në fund të 6-mujorit të parë, brenda datës 15 korrik, dhe në fund të vitit, brenda datës 20 janar, njësia monitoruese dërgon në degën e shoqërive publike, pranë prefekturës përkatëse, një raport të hollësishëm për ecurinë e tyre, të konfirmuar për arkëtimet dhe nga degët e thesarit të rrethit përkatës. VKM-së, nr. 373, datë 20.6.2018, "Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore, në pronësi të shtetit", kreu VII “*Monitorimi i kontratave*”.

Sipas njësive administrative:

Nga ish-Komuna Qendër për periudhën vitet 2008 - 2015 në referim të VKM nr.3, datë 16.05.2007, "Për tokat bujqësore të pandara" janë lidhur 57 kontrata për qiradhënie të tokave bujqësore të pandara, me afat 99 vjet, 10 kontrata me afat 30 vjeçar dhe 1 kontratë me afat 50 vite, të dhënat e të cilave janë të paraqitura në tabelën bashkëlidhur këtij Akt-konstatimi. Nga verifikimi rezultoi se; nuk janë hartuar grupe pune për verifikimin e sipërfaqeve në terren.

Nga ish-Komuna Shushicë për periudhën Janar 2008 - Dhjetor 2013 në referim të VKM nr. 3, datë 16.05.2007, "Për tokat bujqësore të pandara" janë lidhur 161 kontrata për qiradhënie, ku 154 kontrata me afat 99 vjeçar nga fondi i tokave bujqësore të pandara dhe 7 kontrata nga fondi kullor me sipërfaqe prej 45,721 ha.

Nga ish-Komuna Novoselë, për periudhën vitet 2008 – 2015 janë lidhur 46 kontrata për qiradhënie, me afat 99 vjeçar.

-Për 266 kontrata që janë të nënshkuara që para ndarjes së re territoriale, nuk janë marrë masa për rishikimin e kushteve, nga Bashkia Vlorë nuk është bërë asnjë veprim për verifikimin për rishikimin e kushteve të kontratave apo anulimin e tyre, rimarrjen e parcelave që ato shfrytëzojnë si dhe nuk është kryer asnjë procedurë ligjore për zgjidhjen e këtyre kontratave. Sipas ligjeve dhe udhëzimeve të mësipërme (*Me hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 305-328 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

51.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse, të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës për monitorimin e kontratave, pas lidhjes së kontratës së qirasë ose të enfiteozës, të behët dorëzimi të qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi me procesverbal të objektit të përshkruar në kontratë, sipas genplanit përkatës. Në procesverbal të përshkruhen qartë gjendja fizike e pronës, vlera kontabël e objektit që jepet me qira ose enfiteozë, gërma d), Për çdo kontratë të lidhur, në fund të 6-mujorit të parë, brenda datës 15 korrik, dhe në fund të vitit, brenda datës 20 janar, ku njësia monitoruese dërgon në degën e shoqërive publike, pranë prefekturës përkatëse, një raport të hollësishëm për ecurinë e tyre, të konfirmuar për arkëtimet dhe nga degët e thesarit të rrethit përkatës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

52. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në të gjitha rastet kontrata e nënshkruar nga ish/Kryetarët e komunave, në kontrata tip nuk janë respektuar neni 3) të drejtat dhe detyrimet e palëve, pika a) planimetria e tokës së dhënë me qira, pika c) Të ushtrojë kontrolle periodike mbi gjendjen e fondit të tokës bujqësore, gjithashtu rezultojnë veprime jo në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 827 "Qiradhënësi me anë inventari i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme si tokën bujqësore, kullotat, e drejta e kundërshtimit të përmbajtjes së inventarit dhe prezumimi i saktësisë së tij rregullohet sipas dispozitave të këtij kreu si dhe neni 829 "Qiradhënësi ka të drejtë që në çdo kohë të ushtrojë kontroll mbi pasurinë e dhënë me qira për të përcaktuar nëse qiramarrësi respekton marrëveshjen sipas detyrimeve të vëna në kontratë, sipas natyrës dhe rregullave agroteknike (*Me hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 305-328 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

52.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimin të Aseteve dhe Drejtorinë Juridike nëpërmjet strukturave të Njësive Administrative, të marrë masa për rishikimin e kushteve të kontratave për subjektet private me afat 30 dhe 99 vjeçare nëse janë sipas kushteve të kontratave dhe të rishikohen për ndryshimin e tarifave sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

53. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në asnjë rast kontratat me qira për tokat bujqësore të pandara nuk janë regjistruar, sipas udhëzimit nr.3 datë 16.5.2007 për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara kundrejt tarifës së përcaktuar në vendimin nr.549,datë 26.8.1996 të Këshillit të Ministrave, në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP), **Ligjit 33/2012, neni 51** Regjistrimi i kontratës së qirasë pika 1, 2 si dhe neni 57, pika 1,2,3 e ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën” Regjistrimi i kontratës së qirasë dhe enfiteozës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 305-328 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

53.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Menaxhimit të Aseteve të marrin masa që çdo kontratë qeraje për një pasuri të paluajtshme, me zgjatje kohore më shumë se 9 vjet, duhet të regjistrohet në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë së paluajtshme të qiradhënësit. Kontrata e qirasë, e bërë me akt noterial, për një pasuri të paluajtshme, me një zgjatje kohore mbi një vit, mund të regjistrohet në regjistrin e pasurisë së paluajtshme.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

54. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se nuk është dërguar informacion me shkrim, nga Drejtoria e Menaxhimit të Aseteve në zyrën e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokave në Këshillin e Qarkut Vlorë, në lidhje me dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, në çdo vit, veprim në kundërshtim të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme, shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”; pika 66 dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pika 30,35/a; VKM nr.510, datë 10.06.2015, “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 305-328 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

54.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkërendim me Drejtorinë e Administrimit të Aseteve, të marrë masa dhe të bashkëpunojë me Drejtorinë e Mbrojtjes së Tokave për të dhënat për administrimin e pronave që ka në administrim Bashkia Vlorë, ku të evidentohet gjendja e tyre, pasi janë aktive që bashkia duhet të realizojë të ardhura.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

55. Gjetje nga auditimi: Nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, nuk kanë dalë urdhra për ngritjen e grupeve të punës për monitorimin e kontratave, veprime që bien në kundërshtim më pikën 4 të kontratave si dhe Vendimin nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, VI. Monitorimi i kontratave të qirasë dhe të enfiteozës drejtohet nga organi që ka lidhur kontratën e qirasë ose të enfiteozës. Monitorimi bëhet nga njësitë monitoruese që janë institucionet shtetërore, shoqëritë tregtare dhe ish-ndërmarrjet shtetërore që kanë në administrim objektet e dhëna me qira ose enfiteozë, si dhe nga degët e shoqërive publike pranë prefekturave pika 2) Njësia monitoruese e kontratave të qirasë ose të enfiteozës kryen këto detyra: germa a) Pas lidhjes së kontratës së qirasë ose të enfiteozës, bën dorëzimin të qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi me procesverbal të objektit të përshkruar në kontratë, sipas genplanit përkatës. Në procesverbal përshkruhen qartë gjendja fizike e pronës, vlera kontabël e objektit që jepet me qira ose enfiteozë, germa d) Për çdo kontratë të

lidhur, në fund të 6-mujorit të parë, brenda datës 15 korrik, dhe në fund të vitit, brenda datës 20 janar, njësia monitoruese dërgon në degën e shoqërive publike, pranë prefekturës përkatëse, një raport të hollësishëm për ecurinë e tyre, të konfirmuar për arkëtimet dhe nga degët e thesarit të rrethit përkatës. VKM-së, nr. 373, datë 20.6.2018 "Për përcaktimin e kriterëve, te rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira te tokave bujqësore, në pronësi të shtetit", kreu VII“ Monitorimi i kontratave. (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 305-328 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

55.1 Rekomandimi: Bashkia Vlorë nëpërmjet strukturave të NJA-ve, Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe Drejtoria Juridike të marrë masa për hartimin e grupeve të punës për monitorimin dhe rishikimin e kontratave për subjektet private që kanë të nënshkruara kontratat me afat 30 dhe 99 vjeçare, nëse janë sipas kushteve të kontratave dhe të rishikohen për ndryshimin e tarifave sipas legjislacionit në fuqi, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për anulimin e kontratave që nuk janë aktive si dhe ndjekjen e arkëtimin e detyrimeve debitore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

56. Gjetje nga auditimi: Në KLSH është paraqitur ankesa e disa mësuesve me arsim parashkollorë në lidhje me ndryshimin e nivelit të pagës së grupit nga 14,000 lekë në 11,000 lekë, konkretisht:

Në mënyrë të përmbledhur ankesa e 6 mësuesve parashkollorë është se atyre ju është ndryshuar niveli i pagës së grupit nga 14,000 lekë në 11,000 lekë, pavarësisht faktit se të gjithë zotërojnë diplomë të tipit DND dhe deri në muaj në shkurt 2023 janë paguar me pagë grupi 14,000 lekë. Pas kësaj periudhë ato janë njoftuar nga Qendra Ekonomike Bashkia Vlorë se referuar diplomës dhe librezës së punës, paga e grupit është 11,000 lekë, kjo në zbatim të VKM nr. 175, datë 8.3.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimor në arsimin parauniversitar”. Nga auditimi i dokumentacionit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore Bashkia Vlorë në lidhje me këto ankesa, rezulton se:

Nga Bashkia Vlorë me shkresën nr. 1024/2prot, datë 25.01.2023 kërkon nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve (Drejtoria Juridike), interpretim të VKM nr. 175, datë 8.3.2017 “Për trajtimin me paga dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar” për pikën 3/a, ku thuhet se: *“Punonjësit mësimorë/edukatore që fillojnë punë për herë të parë si punonjës mësimorë/edukator në lidhjen nr. 2të vendimit”, i ndryshuar me VKM nr. 351, datë 19.4.2017 dhe VKM nr. 265, datë 16.5.2018.*

Në këtë interpretim është kërkuar:

- Me cilin grup page do të paguhet një edukatore me diplomë Bachelor dega parashkollor 2006-2009, e cila ka qenë punësuar dhe siguruar në institucionit arsimore publike deri më 01.3.2017, ka shkëputur marrëdhëniet e punës dhe tashmë po punësohet në një institucioni arsimorë publik pas hyrje në fuqi të VKM nr. 175, datë 8.3.2017 “Për trajtimin me paga dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar.

- Me cilin grup page do të trajtohet një edukatore me diplomë Bachelor dega parashkollor 2006-2009 e cila ka qenë e punësuar dhe siguruar në institucionit arsimore publike deri më datë 01.3.2017, ka shkëputur marrëdhëniet e punës tashmë po punësohet në një institucioni arsimor publik dhe krahas diplomës Bachelor ka dhe master profesional.

- Me cilin grup page do të paguhet një edukatore me diplomë Bachelor dega parashkollor 2006-2009 e cila ka qenë e punësuar dhe siguruar në institucioni arsimore publike deri me datë 01.3.2017, ka shkëputur marrëdhëniet e punës tashmë po punësohet në një institucioni arsimor publike dhe krahas diplomës Bachelor ka kryer master shkencor.

- Me cilin grup të pagës do të paguhet një edukatore me diplomë Bachelor dega parashkollor 2006-2009 e cila ka qenë e punësuar dhe siguruar në institucioni arsimore publike p.sh Berat deri me datë 3.10.2022 dhe po me datë 3.10.2022 transferohet me portal dhe punësohet një institucioni arsimor publik Vlorë dhe ka kryer master profesionale në pedagogji me profil menaxhim arsimit.
- Mësues ndihmës me diplomë Bachelor me master profesionale paga grupi 11,000 lekë apo 14,000 lekë.

Ministria e Arsimit dhe Sporteve nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, me shkresën nr. 616/1prot, datë 8.2.2023 informon bashkinë Vlorë në lidhje me kërkesën nr. 1024prot, datë 25.01.2023 *“Kërkesë për interpretim”*, duke shpjeguar se:

- Në lidhje me pagën sipas diplomës, sqarohet se VKM nr. 251, datë 19.4.2017, i ndryshuar, është përcaktuar se: *“Punonjësit aktual të cilët zotërojnë diplomë cikli të parë të studimeve Bachelor, ose të barvlefshëm me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe deri para datës 01.3.2017 kanë përfituar pagë grupi 14,000 lekë, do të vazhdojnë ta përfitojnë të njëjtën masë page grupi deri në momentin e ndryshimit të nivelit të diplomës, apo ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me institucioni arsimor përkatës. Punonjësit që fillojnë punë rishtazi (për herë të parë), si punonjës mësues/edukator në arsimin parauniversitar pas datës 01.3.2017, do të trajtohen me pagë sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 2 të VKM nr. 175, datë 8.3.2017 *“Për trajtimin me paga dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësues në arsimin parauniversitar”*, i ndryshuar.*

- Në përgjigje të pikës (a) dhe (d), sqarohet se në zbatim të VKM nr. 351, datë 19.4.2017 është përcaktuar se: *“Punonjësit aktual mësues/edukator të cilët zotërojnë diplomë të ciklit të parë Bachelor, ose të barasvlershëm me të, sipas legjislacionit dhe deri para datës 01.3.2017 kanë përfituar pagën e grupit në masën 14,000 lekë, do të vijojnë të përfitojnë një njëjtën masë page grupi deri në momentin e ndryshimit të nivelit të diplomës, apo ndërprerjes së marrëdhënieve të punës në institucioni arsimor.*

- Në përgjigje të pikës (b,c), sqarohet se në zbatim të nenit 57, të Ligjit nr. 69/2012 i ndryshuar, përcaktohet se: *“Mësues për arsimin parashkollor duhet të ketë fituar diplomë e ciklit të parë Bachelor, që formon mësues të arsimit parashkollor”*. Pra në këtë program mësues nuk kërkohet kualifikim i nivelit të dytë master, pra punonjësit mësues në arsim parashkollor që fitojnë diploma të nivelit të dytë në *“Master profesional”* apo *“Master shkencor”*, nuk përfitojnë shtesë page në këto programe arsimore nuk kërkohet diplomë e nivelit të dytë *“Master shkencor”* apo *“Master profesional”*. Punonjësit mësues/edukator që fillojnë punë për herë të parë si punonjës mësues/edukator në arsimin parauniversitar pa datës 01.3.2017, do të trajtohen me pagë grupi sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 2 të këtij vendimi.

Sipas të dhënave në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore Bashkia Vlorë, nga auditimi i dosjeve të personave që kanë bërë ankesë në KLSH në lidhje me nivelin e pagë, rezulton se:

Znj. H. M., është emëruar si edukatorë kopshti me urdhër nr. 2, me datë 23.5.2018 e vazhdim;
Znj. D. B., është emëruar si edukatore kopshti me urdhër nr. 2 me datë 28.01.2019 e vazhdim;
Znj. S. H., emëruar si edukatore kopshti me urdhër nr. 2, me datë 9.6.2017 e vazhdim; **Znj. E. Xh.**, emëruar si edukatore kopshti me urdhër nr. 3 me datë 3.10.2017 e vazhdim; **Znj. T. K.**, emëruar si edukatore kopshti me urdhër nr. 5 me datë 2.2.2018 e vazhdim; **Znj. E. I.**, emëruar si edukatore kopshti 7 me datë 19.9.2022 e vazhdim; **Znj. M. H.**, emëruar si edukatore kopshti *“Musa Cakërri”* me datë 20.9.2017 e vazhdim; **Znj. J. H.**, emëruar si edukatore *“4 –Heronjtë”* me datë 7.10.2019 e vazhdim; **Znj. M. L.**, emëruar si edukatore në *“Radhimë”*, me datë 7.5.2021; **Znj. S. K.**, emëruar si edukatore në *“Babicë”* me datë 27.9.2017 e vazhdim; **Znj. K. M.**, emëruar si edukatore *“Kafil Mala Bishan”*, me datë 01.12.2017 e vazhdim dhe **Znj. A. R.**, emëruar si edukatore kopshti me urdhër nr. 9, me datë 8.11.2001 e vazhdim.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 175, datë 8.3.2017 “Për trajtimin me paga dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar” për pikën 3/a, ku thuhet se: “Punonjësit mësimorë/edukatore që fillojnë punë për herë të parë si punonjës mësimorë/edukator në lidhjen nr. 2 të vendimit”, i ndryshuar me VKM nr. 351, datë 19.4.2017 dhe VKM nr. 265, datë 16.5.2018. (Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqe 328-350 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

56.1 Rekomandimi: Drejtorja e Burimeve Njerëzore Bashkia Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe në korrespondencë me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, të analizojë me kujdes të gjitha dosjet e punonjësve të emëruar në sistemin parauniversitar për nivelin e diplomës, datën e emërimit në pozicionin e punës të punonjësit mësimorë/edukator që nga koha e daljes në punë dhe deri në momentin e punësimit në bashkinë Vlorë.

Në rast të konstatimit të parregullsive për ndryshimet që mund të ketë pësuar paga e grupit nga 14,000 lekë në 11,000 lekë, të bëhen rilogaritje për cdo punonjës që është në kushtet e VKM nr. 175, datë 8.3.2017 “Për trajtimin me paga dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar, duke kompensuar diferencat.

56.2. Rekomandimi: Drejtorja e Burimeve Njerëzore Bashkia Vlorë, në rast mos ndryshimi të kushteve sipas interpretimit të saj për pagesën 11,000 lekë dhe jo 14,000 lekë, t’i kërkohet interpretim pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve që për këto punonjës të cilat janë paguar për një periudhë 6 vjeçare me 14,000 lekë, pavarësisht datës së emërimit, si duhet vepruar në lidhje me pagën e grupi.

Brenda datës 31.01.2024

57. Gjetje nga auditimi: Në 2 (dy) raste nga auditimit i zbatimit të rregullave të prokurimit publik, respektivisht në tenderin me objekt “*Blerje Kompjuterë Desktop, Ëorkstation, Printer AIO, Laptop Praktik*” me fitues OE “PC. S.” ShPK me ofertë në vlerën 1,620,000 lekë dhe tenderin me objekt “*Pëmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara*” me fitues BOE “N. 1934” & “G.” ShPK me ofertë në vlerën 3,454,244 lekë, u konstatua parregullsi në vlerësimin e kualifikimit të operatorëve ekonomik nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), duke shpallur fitues OE “PC. S.” ShPK dhe BOE “N. 1934” & “G.” ShPK ” në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar dhe, ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4. faqe 205-249 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

57.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkia Vlorë, nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kriterëve të DT të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

58. Gjetje nga auditimi: Në 5 (pesë) procedura prokurimi nga auditimit i zbatimit të rregullave të prokurimit publik mbi zbatimin e Kriterëve të Përgjithshme dhe të veçanta në DST, respektivisht në prokurimin me objekt “*Blerje Kompjuterë Desktop, Workstation, Printer AIO, Laptop Praktik*” me fitues OE “PC. S.” ShPK me ofertë në vlerën 1,620,000 lekë, në prokurimin me objekt

“Ndërhyrje riparimi në çerdhe, kopshte dhe shkolla të Bashkisë Vlorë” me fitues BOE “L.” & “J.” ShPK me ofertë 2,281,625 lekë, në prokurimin me objekt “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara” me fitues BOE “N. 1934” & “G.” ShPK me ofertë 3,454,244 lekë, në prokurimin me objekt “Strukturë me pilota për përforsim skarpati pas Godinës së Bashkisë” me fitues OE “I.” ShPK me ofertë 8,395,118 lekë, në prokurimin me objekt “Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë” me fitues OE “Sh. 07” ShPK me ofertë 18,000,000 lekë, u konstatua se në 11 (njëmbëdhjetë) raste Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë dhe Njësia e Prokurimit, kanë kryer procedura prokurimi pa argumentuar kriteret për kualifikim (kapacitetet teknike) dhe pa respektuar rregullat e procedurave të prokurimit publik, hartimit të DST, të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, kriterëve teknike duke mos respektuar kërkesat e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar; ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4. faqe 205-249 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

58.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë, Njësia e Prokurimit, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e kriterëve të sakta teknikisht dhe ligjërish, duke i dokumentuar në një proces verbal, në përputhje me procedurën e zhvilluar, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikën e zhvillimit të procedurave me një OE, me qëllim përdorimin e fondeve publike me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

59. Gjetje nga auditimi: Në 7 (shtatë) procedura prokurimi nga auditimit i zbatimit të rregullave të prokurimit publik mbi hartimin e Projekteve të Zbatimit, respektivisht për prokurimet me objekt: “Ndërhyrje riparimi në çerdhe, kopshte dhe shkolla të Bashkisë Vlorë” me fitues BOE “L.” & “J.” ShPK me ofertë 2,281,625 lekë; “*Shërbimi i mirëmbajtjes të varrezave publike dhe të dëshmorëve të Bashkisë Vlorë*” me fitues OE “K.N.” ShPK me ofertë 7,936,312.75 lekë; “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara” me fitues BOE “N. 1934” & “G.” ShPK me ofertë 3,454,244 lekë; “Strukturë me pilota për përforsim skarpati pas Godinës së Bashkisë” me fitues OE “I.” ShPK me ofertë 8,395,118 lekë; “Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë” me fitues OE “Sh. 07” ShPK me ofertë 18,000,000 lekë; “*Furnizim vendosje pajisje për ndriçimin rrugor*” me fitues OE “S.” ShPK me ofertë 7,123,349 lekë; “*Rikonstruksion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë*” me fitues OE “B.X” ShPK me ofertë në vlerën 13,418,547.6 lekë me TVSH, u konstatua se Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë dhe DPKZHT, kanë Hartuar Projekte Zbatimi për investime publike pa licencë profesionale, duke mos respektuar kërkesat Ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4. faqe 205-249 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

59.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë dhe DPKZHT, për çdo rast të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik dhe zbatimit të kontratave për punë publike, të caktojë grupe pune projektuese me specialistë të fushës nga DPKZHT, të pajisur me licencë profesionale, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me lejen e ndërtimit, me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tyre si dhe jetëgjatësinë e investimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

60. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit dhe i dosjes teknike të zbatimit të punimeve të kontratës me objekt: *“Shërbimi i mirëmbajtjes të varrezave publike dhe të dëshmorëve të Bashkisë Vlorë”* fituar nga OE “K. & N.” ShPK me ofertë 7,936,312.75 lekë, u konstatua se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Vlorë, *nuk ka miratuar Leje Ndërtimi* për projektin e zbatimit, në mosrespektim ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 *“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”*, i ndryshuar dhe, VKM nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”*, i ndryshuar. Sa më sipër ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4. faqe 205-249 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

60.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë dhe DPZHKT të marrë masa që të pajisin me leje ndërtimi për çdo projekt zbatimi sipas legjislacionit në fuqi, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

61. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zhvillimit të procedurave të prokurimit me objekte: *“Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”* fituar nga shoqëria “G.” ShPK me ofertë 3,454,244 lekë, *“Strukturë me pilota për përfortim skarpati pas Godinës së Bashkisë Vlorë”* me fitues OE “I.” ShPK me ofertë 8,395,118 lekë, *“Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë”* me fitues OE “Sh. 07” ShPK me ofertë 18,000,000 lekë, *“Furnizim vendosje pajisje për ndriçimin rrugor”* me fitues OE “S.” ShPK me ofertë 7,123,349 lekë dhe, të kontratave të zbatimit të punimeve me objekte: *“Rikonstruksion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë”* me fitues OE “B. X” ShPK me nr. 8409 prot., 26.05.2021 dhe vlerë 13,418,547.6 lekë, *“Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + Sistem ngrohje”* me fitues OE “C.” ShPK me Nr. 1808 prot., 01.03.2019 dhe vlerë 44,489,454 lekë me TVSH, u konstatua se nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë nuk është kryer Oponenca Teknike, në mos respektim Ligji Nr. 120/2020 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 205-249 të Projekt raportit të Auditimit)*

61.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marrë masa që të pajisin me Oponencë Teknike për çdo projekt zbatimi, sipas legjislacionit në fuqi, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

62. Gjetje nga auditimi: Në 3 (tre) raste nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratave për punë publike, u konstatua se kolaudimi i punimeve është bërë me vonesë dhe konkretisht:

a) Për kontratën me objekt *“Rikonstruksion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë”*, me vlerë 13,418,547.6 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “B. X” ShPK, për kolaudimin e punimeve, është lidhur kontrata me nr. 14660 prot., datë 02.11.2021 ndërmjet Bashkisë Vlorë dhe shoqërisë “K. C.” ShPK. Ngritja e grupit të kolaudimit është bërë rreth 5 (pesë) muajt me vonesë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar, neni 12 ku citohet *“Emërimi i kolaudatorit apo grupit të kolaudimit... brenda 30 ditëve nga përfundimi i punimeve të ndërtimit”* dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e institucionit.

Gjithashtu nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë nuk është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit. Veprim ky në kundërshtim me nenin 38 (Mbarimi dhe marrja përsipër e ndërtimeve) të kontratës së sipërmarrjes me nr. 8409 prot, datë 26.05.2021.

b) Për kontratën me objekt “Ndërtim i ujësjellësit në rrugën Transballkanike Vlorë”, me vlerë 166,940,070 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “Sh. 07” ShPK, për kolaudimin e punimeve është lidhur kontrata me nr. 8437 prot., datë 26.07.2022 ndërmjet Bashkisë Vlorë dhe, shoqërisë “N. S.” ShPK, rreth **1(një) vit** me vonesë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 12 ku citohet “Emërimi i kolaudatorit apo grupit të kolaudimit... brenda 30 ditëve nga përfundimit i punimeve të ndërtimit” dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e institucionit”. Gjithashtu nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë nuk është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit. Veprim ky në kundërshtim me nenin 38 (Mbarimi dhe marrja përsipër e ndërtimeve) të kontratës së sipërmarrjes me nr. 9412 prot, datë 21.10.2020.

c) Për kontratën me objekt “Strukturë me pilota për përforsim skarpati pas godinës së Bashkia Vlorë”, me vlerë 10,074,142 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “I.” ShPK, për kolaudimin e punimeve është lëshuar urdhër nr 69 (nr. 2913 prot., datë 09.03.2023), rreth **1(një) vit** me vonesë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 12 ku citohet “Emërimi i kolaudatorit apo grupit të kolaudimit... brenda 30 ditëve nga përfundimit i punimeve të ndërtimit” dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e institucionit. Gjithashtu nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë nuk është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit, veprim ky në kundërshtim me nenin 38 (Mbarimi dhe marrja përsipër e ndërtimeve) të kontratës së sipërmarrjes me nr. 7619 prot., datë 04.07.2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 205-249 të Projekt raportit të Auditimit)*

62.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë për zbatimin e kontratave për punë publike, të bëjë emërimin e kolaudatorit apo grupit të kolaudimit, brenda 30 ditëve nga përfundimit i punimeve të ndërtimit për të hapur rrugën e periudhës së garancisë së defekteve të punimeve.

62.2 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë mbas përfundimit të punimeve në zbatim të kontratave për punë publike, të marrë masa për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të objektit sipas kushteve të kontratës.

Menjëherë

63. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 95 procedurave të prokurimeve për *periudhën 01.07.2021-31.12.2022*, nga ku: 90 procedura “Blerje me vlerë të vogël” dhe 5 procedura “Blerje nën vlerën 100,000 lekë” nga Autoriteti Kontraktor është kryer ndarja e procedurave të prokurimit duke sjellë si pasojë shmangien nga fusha e zbatimit të ligjit, për shkak të ndryshimit artificial të kufirit monetar, pa arsye objektive të cilat do të justifikonin veprimin konkret. Autoriteti Kontraktor, duke periodizuar momentin e planifikimit të nevojave të tij, ka përdorur procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës (copëzuar fondin) për shmangien nga procedurat standarde të prokurimit.

Nga auditimi rast pas rasti, rezulton se procedura e prokurimit duhet të kryhej në një procedure të vetme “e hapur e thjeshtuar” ose “të hapur”.

Për sa konstatuar më sipër, veprimet e AK-së bien në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e cila konkretisht në nenin 11 pika 5 të saj përcakton se: “Asnjë

kontratë publike nuk mund të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPP-ja”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4. faqe 205-249 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

63.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë, komisioni i prokurimit me vlera të vogëla si dhe personi përgjegjës për prokurimin publik, në asnjë rast, nuk duhet të pjesëtojë (ndajë) vlerën e kontratës me qëllim për të shmangur procedurat standarde të prokurimit publik. Gjithashtu AK, gjatë përlllogaritjes së vlerës limit të kontratës, duhet të ketë si qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Menjëherë

64. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i krimit të regjistrimit të planifikimit për *periudhën e auditimit 01.07.2021-31.12.2021, periudhë për të cilën presupozohet që duhet të kishte përfunduar hartimi i regjistrimit*, u konstatua se: AK Bashkia Vlorë ka shtuar në regjistrin e parashikimeve 91 zëra të rinj (duke përfshirë edhe blerjet me vlerë nën 100,000 lekë).

Në zërat e rinj të shtuar, pjesa më e madhe e zërave (objekteve të prokurimit) të evidentuara në tabelën e mësipërme nuk mund të konsiderohen si ndryshime të regjistrimit për pamundësi parashikimi, kjo pasi shumica e tyre janë objekte prokurimi për nevoja të cilat rezultojnë të përsëritura në të paktën 3-4 vitet e fundit nga Bashkia Vlorë, çka i bën ato lehtësisht të parashikueshme.

Pjesa më e madhe e zërave të objekteve të prokurimit, pavarësisht llojit apo vlerës për secilën procedurë, janë krijuar në regjistrin e parashikimeve “Sistemin e Prokurimit Publik (SPE)” në shkelje të afateve të përcaktuara në dispozitat e sipërcituara.

Konkretisht, në zbatim të LPP-së, AK në varësi të nevojave, gjatë periudhës shtator – dhjetor të çdo viti, përgatit regjistrin për vitin ushtrimor në vijim, bazuar në ligjin që miraton parashikimet buxhetore afatmesme. Në çdo rast, afati maksimal i hartimit të regjistrimit është jo më vonë se **10 (dhjetë) ditë** nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin ushtrimor pasardhës.

Sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe V.K.M nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 226-235 të Projekt raportit të Auditimit)

64.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë, si dhe strukturat përgjegjëse për Planifikimin e Regjistrimit të Prokurimit publik me blerje të vogël, gjatë periudhës shtator – dhjetor të çdo viti, në bazë të nevojave për punë, mallra ose shërbime, të hartojë regjistrin vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik, në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së, duke përjashtuar këtu rastet për nevoja urgjente apo në pamundësi parashikimi të Autoritetit Kontraktor.

Menjëherë

65. Gjetje nga auditimi: Në KLSH është paraqitur ankesa nga FSHF, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 531/2 prot., datë 07.06.2023 dhe nr. 531/14 prot., datë 07.06.2023, me kërkesat si vijon:

- FSHF, në shkresën me nr. 531/2 prot., datë datë 07.06.2023, drejtuar Kryetarit të Bashkisë Vlorë dhe, për dëjneni Kontrollit të Lartë të Shtetit, ku ndër të tjera, kërkon që: “Në kuadër të zhvillimeve

dhe ndryshimeve ligjore në veprimtarinë sportive, me datë 29.07.2020, kanë hyrë në fuqi ndryshimet në Ligjin nr. 79/2017 “Për sportin”. Ndër qëllimet e këtij ligji është edhe përcaktimi i kompetencave të autoriteteve qendrorë dhe vendorë në fushën sportive. Sipas nenit 22 të ligjit nr. 105/2020, datë 29.07.2020 të gjitha institucionet publike qendrore dhe vendorë, të cilat kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare sportive, **brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji i nxjerrin ato në shitje** në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Pas kalimit të këtij afati, institucionet publike qendrore dhe vendorë **nuk mund të zotërojnë aksione të shoqërive tregtare sportive...**”.

Aktualisht, edhe pse ka kaluar shumë nga data e hyrjes në fuqi të ndryshimeve në ligjin nr. 79/2017 “Për sportin”, miratuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.07.2020, në të dhënat e regjistrit tregtar të shoqërisë “**F. F. C.**” Sh.A rezulton se Bashkia Vlorë është zotëruese e 100 % të aksioneve të saj dhe nuk është nxjerrë në shitje këtë shoqëri.

- FSHF, në shkresën me nr. 531/14 prot., datë 07.06.2023, drejtuar Kryetarit të Bashkisë Vlorë dhe, për dijeni Kontrollit të Lartë të Shtetit, ndër të tjera, kërkon që: “*Në kuadër të zhvillimeve dhe ndryshimeve ligjore në veprimtarinë sportive, me datë 29.07.2020, kanë hyrë në fuqi ndryshimet në Ligjin nr. 79/2017 “Për sportin”. Ndër qëllimet e këtij ligji është edhe përcaktimi i kompetencave të autoriteteve qendrorë dhe vendorë në fushën sportive. Sipas nenit 22 të ligjit nr. 105/2020, datë 29.07.2020 të gjitha institucionet publike qendrore dhe vendorë, të cilat kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare sportive, **brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji i nxjerrin ato në shitje** në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Pas kalimit të këtij afati, institucionet publike qendrore dhe vendorë **nuk mund të zotërojnë aksione të shoqërive tregtare sportive...**”.*

Aktualisht, edhe pse ka kaluar shumë kohë nga data e hyrjes në fuqi të ndryshimeve në ligjin nr. 79/2017 “Për sportin”, miratuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.07.2020, në të dhënat e regjistrit tregtar të shoqërisë “**K.F. O.**” Sh.A rezulton se Bashkia Vlorë është zotëruese e 100 % të aksioneve të saj dhe nuk është nxjerrë në shitje këtë shoqëri.

Nga sa trajtuar më sipër, nga ana e Bashkisë Vlorë, në zbatim të Ligjin nr. 79/2017 “Për sportin” i miratuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.07.2020 si dhe shkresave të FSHF të trajtuara më sipër, duhet të ishte marrë masa për zbatimin e kërkesave të parashtruara nga FSHF, në zbatim të nenit 22 të ligjit nr. 105/2020, datë 29.07.2020, ku të gjitha institucionet publike qendrore dhe vendorë, të cilat kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare sportive, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji i nxjerrin ato në shitje në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, pasi pas kalimit të këtij afati, institucionet publike qendrore dhe vendorë nuk mund të zotërojnë aksione të shoqërive tregtare sportive.

Gjithashtu në dokumentet dhe materialet e paraqitur nga ana e Bashkisë Vlorë, nuk del e qartë, cili ka qenë shkaku i moszbatimit të këtij propozimi me shumë vonesë nga data e daljes dhe hyrjes në fuqi të ligjit për sportin. Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet, është vepruar në mospërputhje me Ligjin nr. 79/2017 “Për sportin” i miratuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.07.2020. (Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqe 328-350, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

65.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike Bashkia Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë DFBK dhe në korrespondencë me Federatën Shqiptare të Futbollit, të analizojë me kujdes kërkesat e parashtruara nga FSHF, ku të gjitha institucionet publike qendrore dhe vendorë, të cilat kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare sportive, t’i nxjerrin në shitje në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, sepse institucionet publike qendrore dhe

vendore nuk mund të zotërojnë aksione të shoqërive tregtare sportive.

Brenda datës 30.03.2024

B. MASA SHPËRBLIM DËMI.

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -*Të drejtat e KLSH*, si dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **nga Titullari i njësisë publike** në bashkëpunim me nëpunësin zbatues, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit **19,830,420 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Furnizim vendosje pajisje për ndriçimin rrugor”, me vlerë 8,548,019 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “S.” ShPK, rezultuan diferenca në volume për zërin e punimeve: “Gërmim themele e plinta b>2m, ekskavator me goma 0.25 m³, shkarkim tokë”, “FV Brez b/a C16/20, h=8m”, “Heqje dhe vendosje Pllaka betoni në trotuar për kanale të tublit të kabllit”, “Prishje shtresë betoni 20 cm në trotuar...” të zbatuara në rrugët “At Kristo Negovani”, “Janaq Kilica”, “Misto Mele”, “Pilo Begaj” dhe “Fiqirete Musta” në Bashkinë Vlorë, në vlerën **932,798** lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 8893 prot., 05.08.2022 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë dhe OE “S.” ShPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 249-261 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e dëmit në vlerën **932,798 lekë** pa TVSH nga “S.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 8893 prot., 05.08.2022, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.03.2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstrukcion i disa akseve rrugore të Bashkisë Vlorë”, me vlerë 13,418,547.6 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “B. X” ShPK, rezultuan diferenca në volume për zërin e punimeve: “Shtresë stabilizanti t=10cm”, “Shtresë binderi me granil gur kave, 4 cm, me makineri” dhe “Shtresë asfaltobeton me granil gur kave, 4 cm, me makineri”, në vlerën **500,000** lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 8409 prot., 26.05.2021 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë dhe OE “B. X” ShPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 249-261 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **500,000 lekë** pa TVSh nga “B. X” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 8409 prot., 26.05.2021, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.03.2024

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Ndërtim i ujësjellësit në rrugën Transballkanike Vlorë”, me vlerë 166,940,070 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “Sh. 07” ShPK, rezultuan diferenca në volume për zërin e punimeve: “Gërmim dhe me ekskavator goma 0.25 m³, në vlerën **190,050** lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 9412 prot., datë 21.10.2020 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë dhe shoqërisë “Sh. 07” ShPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 249-261 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **190,050 lekë** pa TVSh nga “Sh. 07” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 9412 prot., datë 21.10.2020, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.03.2024

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Strukturë me pilota për përforsim skarpati pas godinës së Bashkia Vlorë”, me vlerë 10,074,142 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “I.” ShPK, rezultuan diferenca në volume për zërat e punimeve: “Zëri 12 (An) Betonim Pilotash C/25/30”, “Zëri 3 (2.130/1) Mure b/a t=21-30 cm, h=4m C/25/30”, “Zëri 4 (An-01) Veshje pilotash me membranë beton”, si dhe penalitetete për punime jashtë afatit të kontratës, në vlerën **220,945** lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 7619 prot, datë 04.07.2022 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë dhe shoqërisë “I.” ShPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 249-261 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **220,945 lekë** pa TVSh nga “I.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7619 prot, datë 04.07.2022, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.03.2024

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + Sistem ngrohje”, me vlerë 44,489,454 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “C.” ShPK u konstatua se, nga AK Bashkia Vlorë nuk ka pasur pengesë për disponimin e kantierit dhe asnjë kërkesë të ligjshme të kontraktorit për të justifikuar mos zbatimin e afatit të përfundimit të punimeve sipas kontratës së sipërmarrjes. Duke qenë se ndërmjet kontraktorit shoqërisë “C.” ShPK dhe Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë nuk është miratuar asnjë shtyrje e afatit të kontratës, pra nuk është kryer asnjë Amendim i Kontratës bazë me nr. 1808 prot., datë 01.03.2019 për objektin “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + sistem ngrohje”, sipas pikës 33.2 të nenit 33 “Vonesa në zbatim dhe zgjatja e afatit”, Autoritetit Kontraktor i lind e drejta që të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim sipas klauzolave të nenit 34 “Dëmet e likujdueshme për vonesën në mbarimin e punimeve” të kontratës, pika 34.1, shkronja (c), ku theksohet: “Për kontratat me periudhë zbatimi mbi 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës korresponduake të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës”.

-Duke pasur parasysh se punimet e ndërtimit duhet të ishin përfunduar në datën 01.06.2019 dhe kanë kaluar 1,505 ditë nga data kur duhet të kishte përfunduar ndërtimi i investimit [214 ditë për

vitin 2019; 366 ditë për vitin 2020; 365 ditë për vitin 2021; 365 ditë për vitin 2022 dhe 195 ditë për vitin 2023] nga palët e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes me nr. 1808 prot., datë 01.03.2019, nuk janë përmbushur kushtet e kësaj kontrate.

Llogaritja e penalitetit:

Vlera e penalitetit nga llogaritja deri në momentin e dorëzimit të këtij akt-konstatimi, në datën 14.07.2023 për shoqërinë “C.” ShPK, rezulton **15,415,728 lekë me TVSH** = [(44,489,454 (vlera e kontratës) – 3,517,418) x 25% x 1,505 ditë vonesë x 1/1000.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1808 prot., datë 01.03.2019 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë dhe shoqërisë “C.” ShPK.

- Palët, sipërmarrësi i punimeve shoqëria “C.” ShPK dhe, investitori/zhvilluesi Bashkia Vlorë, si nënshkruesit e kontratës, **kanë dështuar në realizimin e kontratës me objekt:** “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + sistem ngrohje” me nr. 1808 prot., datë 01.03.2019.

Palët, duhej të kishin zbatuar:

- Pikën **46.2** të Nenin **46** (Zgjidhja e mosmarrëveshjeve) të kontratës me nr. 1808 prot., datë 01.03.2019, ku thuhet: “Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë”.

- Pikën **22** të kontratës për mbikëqyrje punimesh “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + Sistem ngrohje” me nr. 2110 prot., datë 21.03.2019, të lidhur ndërmjet Bashkisë Vlorë, përfaqësuar nga Kryetari Z. D. L. dhe shoqërisë “H. & S.K. 11” ShPK e përfaqësuar nga Ing. F. B., ku thuhet: “Për çdo mos marrëveshje palët duhet t’i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve”.

- Pikën **22** të kontratës për mbikëqyrje punimesh “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + Sistem ngrohje” me nr. 8341 prot., datë 25.07.2022, të lidhur ndërmjet Bashkisë Vlorë, përfaqësuar nga Kryetari Z. D. L. dhe shoqërisë “R. 95” ShPK e përfaqësuar nga znj. R. N., ku thuhet: “Për çdo mosmarrëveshje palët duhet t’i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 249-261 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë të kërkojë, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e shumë **15,415,728 lekë TVSH** nga shoqëria sipërmarrëse “C.” ShPK, si penalitete për punime të pakryera, parashikuar në afatet e kontratës nr. 1808 prot., datë 01.03.2019, me objekt “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + Sistem ngrohje”.

Brenda datës 30.03.2024

5.2. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë, të marrë masa që të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, që të vlerësojnë e të analizojnë arsyet dhe shkaqet e mosmarrëveshjeve ose konfliktit mes palëve mbi dështimin e realizimit të kontratës për punë publike me objekt: “Ndërtimi i sallës së Këshillit Bashkiak Vlorë + sistem ngrohje”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë dhe shoqërisë sipërmarrëse “C.” ShPK me nr. 1808 prot., datë 01.03.2019. Në rast të kundërt, Bashkia Vlorë t’i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, në kushtet ku kjo kontratë ka dështuar.

6. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të paraqitura në tabelat 1 dhe tabela 2 bashkëlidhur *Raportit Përfundimtar të Auditimit*, të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vlorë, rezultoi se tarifa e ujitjes për vitin 2021 dhe vitin 2022 është në vlerën 3,983 mijë lekë, ndërsa realizimi i saj është 0%. Duke iu referuar VKB-së nr. 88 prot., datë 24.12.2020 i ndryshuar me VKB nr. 79 prot., datë 02.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë” tarifa për shërbimin e ujitjes llogaritet në vlerën 2,500 lekë/ha për çdo ujitje dhe struktura përgjegjëse për llogaritjen dhe vjeljen e saj është Ndërmarrja e Shërbimeve Publike (NSHP), Sektori i Ujitjes dhe Kullimit.

Sipas dokumentacionit i vënë dispozicion pranë grupit të auditimit nga NSHP (*Spektori i Ujitjes dhe Kullimit*), rezulton së menaxhimi i kësaj tarife bëhet nga Organizatat e Përdorimit të Ujit (OPU). Aktualisht në territorin e Bashkisë Vlorë operojnë pesë OPU me vendndodhje në Llakatund, Babicë, Kallafet, Llogara dhe Panaja. Kryetarët e OPU-ve pajisen nga NSHP, Sektori i Ujitjes dhe Kullimit me mandat arkëtime me qëllim prerjen e faturave për fermerët në momentin e marrjes së shërbimit.

Nga shuma totale e mbledhur sipas librit të arkës i cili është administruar nga vetë OPU-të, rezulton se janë arkëtuar të ardhura nga tarifa e shërbimit të ujitjes në vlerën **847,600 lekë, vlerë e cila është e pa argumentuar duke marrë shkas nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga sektori i ujitjes i cili është jo bindës nga forma juridike**. Gjithashtu rezulton se nga krahasimi i mandateve të pagesës me librin e arkës në disa raste janë aplikuar tarifa për 2 shërbime për ujitje dhe pagesa është llogaritur për 1 shërbim ujitje në të gjitha rastet specifikohet lloji shërbimit ujitje, konkretisht janë aplikuar me faturim të gabuar **99** raste me vlerë **198,300 lekë** të paraqitura në *aneksin nr. 1*.

Nga të dhënat të që janë vënë në dispozicion pranë grupit të auditimit nga sektori i ujitjes konkretisht libri i arkës dhe mandatet e pagesës të dy këto dokumente të pa formatizuara, rezulton se vlera prej 847,600 lekë nuk ka kaluar në asnjë nga strukturat e kontabilitetit të Bashkisë Vlorë ose NSHP Bashkia Vlorë prej **1,045,900 lekë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Bashkisë Vlorë**.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Bordit të kullimit sektori i ujitjes, është mbajtur procesverbal me nr. 660 prot., datë 01.12.2021 nga NSHP bordi i kullimit mbajtur nga z. **F. Xh.** me detyrë ish - Përgjegjës i Sektorit të Ujitjes, ing. **A. L.**, dhe specialiste **M. Z.**, mbi rivlerësimin e sipërfaqeve të ujitura nga O.P.U-të në Bashkinë e Vlorës për vitin 2021. Sipas procesverbalit të mbajtur, sipërfaqe e planifikuar është për 750 hektar dhe sipërfaqe e ujitur e raportuar është 140 hektar, diferenca është 610 hektar ose në vlerën prej **1,525,000 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë**.

Gjithashtu nga dokumenti i vënë në dispozicion nga ana NSHP bordi i kullimit sektori i ujitjes rezulton se është lidhur akt- marrëveshje (kontratë përdorimi) me nr. 125 prot; datë 28.05.2018, akt - marrëveshje e lidhur nga drejtori i NSHP, z. **G. Sh.** dhe kryetari i OPU Kallafet, z. **L. Sh.**, rezulton se akt – marrëveshja konsiston në dokument e fotokopje, jo dokument origjinal i akt - marrëveshjes, nga ana formale e akt-marrëveshjes rezulton se është nënshkruar në fotokopjen e dokumentit nga Kryetari i OPU-së, z. **L. Sh.**, ndërsa nga ana e ish - Drejtorit të NSHP-së rezulton firmë dhe vulë fotokopje, gjë e cila nuk është në përputhje me kodin e procedurave administrative. Përsa i përket akt - marrëveshjes me nr. 125 prot., datë 28.05.2018 me OPU Panaja, rezulton se akt – marrëveshja është firmosur vetëm nga ana e ish - Drejtorit të NSHP, z. **G. Sh.** dhe jo nga

pala tjetër e kryetarit të OPU Panaja, **z. L. M.**, marrëveshje e cila duhet të jetë e nënshkruar nga të dyja palët.

Akt – marrëveshja me nr. 125 prot.;, datë 28.05.2018, e lidhur midis Kryetarit të OPU Babicë **z. S. M.** dhe ish - Drejtorit **z. G. Sh.**, rezulton të jetë firmosur nga ana e kryetarit OPU Babicë mbi fotokopjen e akt - marrëveshjes si në rastin e akt - marrëveshjes me OPU Kallafet. Ka funksionuar në të njëjtën mënyrë është ndjekur e njëjta metodologji edhe për akt - marrëveshjen me nr. 125 prot; datë 28.05.2018 e lidhur ndërmjet kryetarit të OPU Llogara, **z. H. I.** dhe ish - Drejtorit të NSHP **z. G. Sh.**, ku nënshkrimi nga ana e kryetarit të OPU Llogara **z. H. I.**, rezulton te jetë nënshkruar mbi fotokopje të akt - marrëveshjes dokument i cili nga ana formale nuk përputhet me përcaktimet e kodit të procedurave administrative. Përsa i përket OPU Llakatund duke iu referuar dokumenteve të vëna në dispozicion nuk rezulton të jetë lidhur akt - marrëveshje. Nga auditimi arrihet në konkluzion se akt - marrëveshjet e nënshkruara nga palët nuk i plotësojnë elementët e sigurisë të një akti administrativ pasi nënshkrimi në fotokopjen e tij nuk vërteton origjinalitetin e një akti administrativ.

Veprime në kundërshtim me VKB-së nr. 88 prot; datë 24.12.2020, i ndryshuar me VKB-në nr.79 prot; 02.12.2021, pika 5. Në kundërshtim me Ligjin nr. 24/2017, datë 09.03.2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”, Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 4 pika 26. “Dokument financiar” është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumenti elektronik rregullohet me Ligjin nr. 10273, datë 29.4.2010 “Për dokumentin elektronik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Vlorë nëpërmjet Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të inicojë në mision auditit në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë, mbi menaxhimin e tarifës së ujitjes për periudhën 2020 – 2023.

Të shtohen burimet njerëzore pranë sektorit të ujitjes me qëllim që menaxhimi i shërbimit të ujitjes dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës të kryhet nga vetë Ndërmarrja Shërbimeve Publike. Të kryhen rakordimet ndërmjet strukturave , për të ardhurat e vjela nga shërbimi i ujitjes, ndërmjet sektorit të ujitjes dhe Drejtorisë së Financës së NSHP Bashkia Vlorë.

Menjëherë

6.2. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Vlorë analizojnë situatën e krijuar dhe të nxjerrin përgjegjësitë administrative e ligjore ndaj personave përgjegjës që kanë shkaktuar efekt negativ financiar në shumën **19,830,420 lekë**, duke kërkuar arkëtimin e vlerës në buxhet për periudhën 2021-2022 dhe jo vetëm.

Brenda datës 30.03.2024

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se, qytetarët/individët që kanë përfituar legalizimin e sipërfaqeve të caktuara nuk kanë paguar rregullisht detyrimin ndaj Bashkisë Vlorë për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Përkatësisht për vitin 2021 nuk kanë paguar detyrimin 434 qytetarë me vlerë totale 13,284,459 lekë, ndërsa nuk kanë paguar ende detyrimin 1371 individë/qytetarë për sipërfaqet e legalizuara përpara vitit 2021 (2015-2020) me vlerë totale 41,994,742 lekë. Në total vlera e detyrimeve nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton në 66,356,042 lekë për 2185 objekte të legalizuara, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Vlorë. Rezulton se nga asnjë strukturë e Bashkisë Vlorë nuk është marrë asnjë masë për të rritur nivelin e pagesave lidhur me këtë taksë. Gjithashtu, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Urban nuk dërgon në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit informacion lidhur me detyrimet që kanë ndaj Bashkisë qytetarët që kanë përfituar nga procesi i legalizimit. Si rezultat këto detyrime nuk janë të kontabilizuara. Të dhëna lidhur me numrin e debitorëve nuk dërgohen as në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore Sektori i Borxhit i cili nuk ka informacion lidhur me numrin e debitorëve për taksën e ndikimit në infrastrukturë si dhe vlerën progresive të borxhit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5, si dhe VKB-së nr. 88, datë 24.12.2020 i ndryshuar me VKB nr. 79 datë 02.12.2021 “Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë nr. 1235/1 Prot., datë 31.12.2020. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e të Ardhurave mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **2185** personave në vlerën **66,356,042 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen.

Brenda datës 30.03.2024

1.2. Rekomandimi: Bashkia Vlorë nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të bashkëpunojë me Drejtorinë Rajonale të ASHK Dega Vlorë me qëllim përcaktimin e subjekte që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e legalizimit nga ndërtimet informale. Lisat e debitorve të përcillet drejtorisë së të ardhurave, me qëllim shpalljen e tyre si debitor dhe marrjen e masave për arkëtim.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se detyrimi që familjet kanë për taksën e tokës bujqësore në Bashkinë Vlorë është borxhe i krijuar gjatë vitit 2021 në vlerën 28,499,682 ndërsa borxhi progresiv më datë 31.12.2021 është 239,572,808 lekë. Borxhi i krijuar gjatë vitit 2022 është 27,574,416 dhe borxhi progresiv me datë , 31.12.2022 është **261,840,252 lekë**, e cila përbënë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë. Referuar të dhënave të tabelave të mësipërme rezulton se debitorët e taksës së tokës kanë ardhur duke u rritur, çka tregon se puna e Sektorit të Menaxhimit të Tokës dhe e NJA-ve nuk është në nivelet e duhura, pasi ka munguar përgjegjësia dhe vëmendja e duhur për vjeljen e taksës së tokës, gjë të cilën e tregon niveli i lartë i debitorëve nga viti në vit. Vlera e detyrimit për debitorët e tokës bujqësore në asnjë nga Njësitë Administrative

nuk është e kontabilizuar dhe e mbajtur sipas standardeve të kontabilitetit, duke mos pasqyruar situatën reale.

Veprime në kundërshtim me VKB-në nr. 88 prot., datë 24.12.2020 i ndryshuar VKB nr. 79 datë 02.12., me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 24, me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10. ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3, pikat 9 dhe 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Sektorin e Menaxhimit të Tokës në Drejtorinë e Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrimit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK dhe Qarku Vlorë), të nxjerrin njoftim detyrimet për familjet me sipërfaqe 15,666 ha lënë jashtë skemës së pagesës së taksës së tokës bujqësore për vitet 2021 dhe 2022, për vlerën **261,840,252 lekë**.

Brenda datës 30.03.2024

2.2. Rekomandimi: Të kryhet rakordimi i regjistrave të fermerëve që përdorin tokën bujqësore, midis Sektorin e Menaxhimit të Tokës në Drejtorinë e Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve dhe inspektorëve të Drejtorisë së të Ardhurave Vendore në Njësitë Administrative dhe këto regjistra që ndjekin agronomët e njësisive administrative, t’ju jepet forma ligjore duke u ndërtuar regjistri me detyrimet që nga momenti i lindjes së të drejtës për përdorimin e tokë bujqësore, përfshirë këtu edhe kamatëvonesat të llogaritura sipas Ligjit për procedurat tatimore. Drejtoria e të Ardhurave Vendore të njoftojë me njoftim vlerësimi të gjithë fermerët/individët debitorë për taksën e tokës bujqësore, mbasi këto të dhënë të jenë dorëzuar nga agronomët e DPPMA.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se deri më datë 31.12.2020 Ujësjiellësi ka patur detyrime ndaj Bashkisë në vlerën 111,321,816 lekë. Gjatë vitit 2021 niveli i arkëtimeve për taksën e banesës është 98,874,399 lekë ndërsa për tarifatat e pastrimit/gjelbërimit/ndriçimit është 102,767,072 lekë, në total 201,641,471 lekë. Në këto vlera arkëtimeve janë të përfshira edhe detyrime të familjeve për vitet përpara vitit 2021. Nga të dhënat që administron UK Vlorë nuk është e mundur të ndahet vlera e arkëtimeve që i përket vitit 2021, si rrjedhojë vlera e arkëtimeve është progresive. Detyrimet që Ujësjiellësi ka ndaj Bashkisë janë në vlerën 306,914,041 lekë (111,321,816 të mbartura + 195,592,225 viti 2021). Gjatë vitit 2021 shuma e kaluar nga Ujësjiellësi ndaj Bashkisë është 210,475,773 lekë dhe detyrimet progresive që Ujësjiellësi ka kundrejt Bashkisë Vlorë më datë 31.12.2021 janë 96,438,269 lekë.

Nga auditimi rezulton se deri më datë 31.12.2021 Ujësjiellësi ka patur detyrime ndaj Bashkisë në vlerën 96,438,269 lekë. Gjatë vitit 2022 niveli i arkëtimeve nga UK Vlorë për taksën e banesës është 107,345,721 lekë ndërsa për tarifatat e pastrimit/gjelbërimit/ndriçimit është 108,929,489 lekë, në total 216,275,210 lekë. Në këto vlera arkëtimeve janë të përfshira edhe detyrime të familjeve për vitet përpara vitit 2022. Nga të dhënat që administron UK Vlorë nuk është e mundur të ndahet vlera e arkëtimeve që i përket vitit 2022, si rrjedhojë vlera e arkëtimeve është progresive. Detyrimet që Ujësjiellësi ka ndaj Bashkisë janë në vlerën 306,225,416 lekë (96,438,269 të mbartura + 209,787,147 viti 2021). Gjatë vitit 2022 shuma e kaluar nga Ujësjiellësi ndaj Bashkisë është 208,702,033 lekë dhe detyrimet progresive që Ujësjiellësi ka kundrejt Bashkisë Vlorë më datë 31.12.2022 janë 97,523,383 lekë.

Veprime në kundërshtim me Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4 pika 7, ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 70 dhe 117, VKB nr.88 prot., datë 24.12.2020 pika 3/e dhe VKB nr. 79 prot., datë 02.12.2021 pika 2/e. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë të Ardhurave Vendore Bashkia Vlorë, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për rishikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me UK sha Vlorë për një menaxhim më të mirë të taksave e tarifave nga abonentët familjarë, si dhe të kërkojë në rrugë ligjore e administrative arkëtimin e vlerës së detyrimit të arkëtuar nga UK sha Vlorë por të palikujduara në llogarinë e Bashkisë për vlerën **97,523,383 lekë**.

Në cdo rast të mos derdhjes së detyrimeve të arkëtuara nga UK sha Vlorë apo të pa mbledhura *(të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj)*, të fillojë procedurat për gjobitjen e Agjentit Tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

3.2. Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Rajoneve dhe të Njësisive Administrative, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore si edhe të hartohet regjistri i familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim rritjen e të ardhurave.

Menjëherë dhe vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e të ardhurave dhe tarifave vendore Bashkia Vlorë, lidhur me subjektet që ushtrojnë aktivitet në transportin e mallrave , pasagjerëve , mjeteve të peshkimit dhe transportit detar për pasagjerët rezultoi se: Për vitin 2021 kanë ushtruar veprimtarin në territorin e Bashkisë Vlorë 974 subjekte në total, nga të cilat 144 subjekte janë debitorë dhe nuk kanë paguar tarifën për Pastrim, Ndriçim, Gjelbërim, në vlerën prej 924,583 lekë. Për vitin 2022 kanë ushtruar veprimtarinë në territorin e Bashkisë Vlorë 800 subjekte në total, nga të cilët 61 subjekte janë debitorë dhe nuk kanë paguar Tarifën për Pastrim, Gjelbërim , Ndriçim, në vlerën prej 555,250 lekë. Nga të dhënat e audituar rezultoi se për vitin 2021 dhe vitin 2022 janë debitorë një numër prej 205 subjektësh në vlerën prej **1,479,833 lekë** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë. Nga ana e Drejtorisë së të ardhurave dhe tarifave Vendore me shkresën nr.8189 Datë 19.07.2022 është kërkuar kërkesë për bashkëpunim Policisë Bashkiake dhe mbështetje për subjektet debitorë me aktivitet transporti. Nga auditimi arrihet në konkluzion se nuk janë marrë masat e duhura për vjeljen e kësaj tarife. Veprime në kundërshtim me VKB nr. 79 prot., Datë 02.12.2021 pikat (2.a,2.b,2.c,2.d) faqe 17. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Vlorë, të nxjerrjen njoftim-vlerësimin e detyrimeve për tarifën e shërbimit pastrim/ndriçim/gjelbërim për subjektet që ushtrojnë aktivitet në transportin e mallrave me vlerë debitorë **1,479,833 lekë**, si dhe të ndjek të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës.

Brenda datës 30.03.2024

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre dhe referuar evidencave të mbajtura në lidhje me arkëtimin e tarifave vendore,

konstatohet se në territorin e Bashkisë Vlorë operojnë 13 subjekte me stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në mungesë të autorizimit të liçencimit për ushtrim aktiviteti. Këto subjekte nuk kanë aplikuar në Bashki për pajisjen dhe përsëritjen e liçencave nga Bashkia Vlorë, rrjedhimisht **nuk është** bërë pagesa e detyrimit ligjor prej **11,800,000 lekë i cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë**. Subjekti “A. & B. 2018” ShPK ka bërë pagesë vetëm për vitin 2020-2021 në vlerën prej 200,000 lekë. Subjekti “Sh. O. 2017” ShPK ka bërë pagesë për vitin 2019-2020 në vlerën prej 200,000 lekë, Subjektin “E. – 88” ShPK ka bërë pagesë për vitin 2020-2021 në vlerën prej 200,000 lekë, ndërsa ka likuaduar vlerën prej 800,000 më datë 02.05.2023. Në total në bashkinë Vlorë ushtrojnë aktivitetin e tyre 43 (dyzet e tre) subjekte nga të cilat 22 (njëzet e dy) subjekte janë të pajisur me liçencat përkatëse dhe kanë paguar detyrimin për 5 (pesë) vite, 8 (tetë) subjekte kanë paguar tarifën prej 1,000,000 por nuk janë të pajisur me liçencë duke mos paraqitur dokumentacion pranë Bashkisë Vlorë, 13 (Trembëdhjetë) subjekte nuk kanë paguar detyrimin dhe nuk janë të pajisur me liçencë. Përsa i përket 8 (Tetë) subjekteve të cilët janë të pasqyruar në *aneksin nr.1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar me VKM nr. 344 datë 19.04.2017 kapitulli II, pika 1; germa “b”, pikat 9, 15.1 dhe 15.2 Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me Ligjin nr. 71/2014. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandim: Bashkia Vlorë, nëpërmjet Drejtorisë së Investimeve Publike, Strehimit dhe Transportit, të marrë masa që të pajisë subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajra lubrifikante dhe lëndë djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojë tarifën për **13** subjektet që nuk kanë bërë pagesa për pajisje me autorizime, për diferencën debitorë prej **11,800,000** lekë.

Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për liçencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së liçencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të tyre.

Brenda datës 30.03.2024

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DAV vërehet një mos koordinim ndërmjet strukturave apo drejtorive përkatëse në Bashkinë Vlorë përsa i përket raportimit pranë DAV-së. Lidhur me detyrimet që ka secila drejtori ku rezulton se, drejtorja e urbanistikës edhe pas kërkesave për informacion të DAV-së konkretisht shkresës nr.735 prot., datë 25.01.2022, shkresën nr.11712., prot datë 18.02.2022, shkresën nr.6394 prot., datë 03.06.2022 nuk ka raportuar detyrimet për vitet përkatëse. Drejtorja e të ardhurave vendore me shkresën nr.1147 prot., datë 10.10.2022 ka dërguar shkresën kërkesë për bashkëpunim dhe vëmendje nga drejtorja e urbanistikës, drejtorja Juridike dhe njësia e prokurimit në zbatim të VKB-së nr. 79 prot., për disa ndryshime në VKB nr.88 datë 24.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave Vendore në Bashkinë Vlorë”. Drejtorja Juridike, Njësia e prokurimit edhe pas shkresës nr. 735 prot., datë 25.01.2022 nuk ka dërguar listën për vitin 2022 pranë DAV-së Vlorë lidhur me operatorët ekonomik të cilët janë fitues të procedurave të prokurimit dhe kanë kryer punime ndërtimi, duke sjellë mungesë të dhënash lidhur me këtë veprimtari, si pasojë në vlerën debitorë prej **460,000 lekësh e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë**. Në bazë të

dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DPKZHT pranë grupit të auditimit i është kërkuar DAV-së informacion lidhur me subjekt të cilët janë pajisur me leje ndërtimi për vitin 2021 dhe për vitin 2022. Nga të dhënat që janë vënë në dispozicion pranë grupit të auditimit nga ana e DAV-së rezulton se për vitin 2021 janë pajisur me leje ndërtimi dhe kanë njoftuar për fillimin e punimeve 38 subjekte dhe kanë ushtruar veprimtarin e tyre pranë territorit të Bashkisë Vlorë, nga të cilët 33 subjekte nuk kanë paguar tarifën e pastrimit/gjelbërimit/ ndriçimit në vlerën 900,000 lekë . Për vitin 2022 janë pajisur me leje ndërtimi 44 (Dyzet e katër) subjekte dhe kanë ushtruar veprimtarinë e tyre pranë territorit të Bashkisë Vlorë, nga të cilët 44 (Dyzet e katër) subjekte nuk kanë paguar tarifën e Pastrimit, Gjelbërimit, Ndriçimit në vlerën 1,800,000 lekë. Për periudhën nën auditim konkretisht për vitet 2021 dhe vitin 2022 rezultojnë në total 82 subjekte debitorë në vlerën **2,700,000 e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë.**

Veprime në kundërshtim me Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreu VII, neni 35, V.K.B së nr.79 datë 02.12.2021 për disa ndryshime në V.K.B-në nr. 88 prot., datë 24.12.2020 “ Për taksat dhe tarifatat vendore Vlorë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandim: Strukturat drejtuese të Bashkisë nëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Njësine Prokurimit të saktësojë listat e bizneseve të ndërtimit që kanë qenë zbatuese të lejeve të ndërtimit dhe të projekteve të investimeve të prokuruar për vitet 2021-2022, që kanë seli jashtë territorit të Bashkisë Vlorë dhe Njësive Administrative dhe që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, të nxjerrin njoftim detyrimin për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës së kësaj tarife prej **2,700,000 lekë.**

Brenda datës 30.03.2024

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e financës qendra ekonomike rezulton se, për vitin 2021 dhe vitin 2022 janë vendosur 203 gjoba nga ana e Policisë Bashkiake në vlerën prej 604,000 lekë. Për vitin 2021 dhe vitin 2022 sipas korrespondencës së postës me drejtorinë e financës qendrën ekonomike rezulton të mos kenë paguar gjobat të vendosura nga policia Bashkiake 28 subjekte në vlerën 157,000 lekë. Nga verifikimi blloqeve rezulton se janë 50 subjekte të cilët nuk kanë paguar gjobat në vlerën 337,000 lekë vlerë e cila i shtohet vlerës së raportuar nga drejtoria e financës e cila në total është **490,700 lekë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë.** Një tjetër fakt vlen për tu theksuar është se nga ana e policisë Bashkiake kryesisht policët e policisë Bashkiake, në disa raste të konstatimeve për kundërvajtësit sipas shkeljeve apo marrjes së masës me gjobë, kundërvajtësi paguan gjobën në vend tek polici Bashkiak e më pas ky i fundit, kryen pagesën në qendrën ekonomike sipas rastit. Nuk ekziston dokumentacion, një rregullore, apo një urdhër që justifikon mënyrën e të vepruarit nga ana e punonjësve të policisë Bashkiak. Mënyra se si është vepruar për rastet e përmendura më lart, nuk garanton një proces transparent për sa kohë i gjithë procesi është i pa monitoruar në terren, dhe pagesa në disa raste është kryer dorazi. Gjobat e policisë Bashkiake të pasqyruara burimi i të dhënave sipas qendrës ekonomike, *Pasqyruar në Aneksin nr.5 bashkëlidhur Projektraport Auditimit.*

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar. Pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë

20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e DAV Bashkia Vlorë, të kryejnë rakordime me policinë Bashkiake për kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës së gjobave të Policisë Bashkiake në vlerën **490,700 lekë**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët.

Të mos kryen pagesa dorazi ndërmjet kundërvajtësit dhe punonjësve të policisë Bashkiake, por të bashkëpunohet me Filialin e Postës, me akt- marrëveshje si agjent tatimor për vjeljen e të ardhurave nga gjobat e policisë Bashkiake.

7.2. Rekomandimi: Drejtoria e Auditit Bashkia Vlorë, të marrë mision auditimi mbi veprimtarinë e Policisë Bashkiake për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2023, mbi inventarizimin e blloqeve të gjobave të marrë dhe dorëzuar në Drejtorinë e Financës, të krahasimit të gjobave të kontabilizuara, vlerës së arkëtuara dhe aplikuar në blloqet e gjobave për këtë periudhë auditimi.

Brenda datës 30.03.2024

8. Gjetje nga auditimi: Duke iu referuara VKB nr. 79 prot., datë 02,12,2021 për një ndryshimin në VKB nr.88 prot., datë 24,12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”, vërehet se në seksionin e tarifave vendore pika 6, nënpika 10, specifikohet se niveli i tarifës për pajisjen me autorizim të subjekteve me veprimtari lavash është 10,000 lekë. Për dhënien e këtyre autorizimeve ngarkohet Drejtoria e infrastrukturës dhe e zbatimit të projekteve. Nga komunikimi verbal me specialistët e Drejtorisë së infrastrukturës dhe e zbatimit të projekteve, të cilët janë shprehur lidhur me autorizimet për subjektet me veprimtari lavazh, se nuk është pajisur asnjë subjekt me autorizimet përkatëse . Nga të dhënat vëna në dispozicion nga drejtoria e të ardhurave specialisti i IT rezulton se për vitin 2021 ushtrojnë veprimtarin e tyre në territorin e Bashkisë Vlorë 15 subjekte me statusin aktiv me veprimtari lavazh nga të cilët nuk janë pajisur me autorizimin dhe nuk kanë paguar tarifën prej 10,000 lekësh , pra në një vlerë debitore prej 150,000 lekësh. Për vitin 2022 ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Bashkisë Vlorë 12 subjekte me veprimtari lavazh të cilat nuk janë pajisur me autorizimin nga ana e Drejtorisë e infrastrukturës dhe e zbatimit të projekteve, dhe pa paguar tarifën prej 10,000 lekësh, rezulton një vlerë debitore prej 120,000 lekë. Nga të dhënat e vëna në dispozicion pranë grupit të auditimit rezulton se për vitin 2021 dhe vitin 2022 nga mos pajisja me autorizim dhe mos pagesa e tarifës nga subjektet që ushtrojnë veprimtarinë lavazh kemi të bëjmë me një vlerë debitore prej **270,000 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë. Subjektet debitorë të pasqyruara në Anekset 6 dhe 7 bashkëlidhur Projektraport Auditimit.**

Veprime në kundërshtim me VKB nr. 79 prot., datë 02,12,2021 për një ndryshim në VKB nr.88 Datë 24.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”, pika 6, nënpika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.2. Rekomandimi: Drejtoria e Infrastrukturës dhe e Zbatimit të Projekteve, në bashkëpunim me IMTV Bashkia Vlorë, të marrë masa për të pajisur subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre si “Lavash”, pranë territorit të Bashkisë Vlorë me leje përkatëse, si dhe në bashkëpunim me strukturat e tjera të Bashkisë Vlorë të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **270,000 lekë**.

Brenda datës 30.03.2024

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konkretisht, VKB-së nr.79 prot., datë 02.12.2021 për një ndryshim në VKB nr. 88 prot., Datë 24.12.2021 për miratimin e paketës fiskale për taksat dhe tarifatat vendore, vërehet se në faqen 19, pika 6, nën-pika 5, është përcaktuar niveli tarifës për depozitimin e mbetjeve 100 lekë/m³, sipas nën-pikës 5 përcaktuar në VKB nr.79 prot., datë 02.12.2021, për dhënien e autorizimit për vend depozitimin e mbetjeve inerte ngarkohet Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, lidhur me Tarifën e depozitimit të mbetjeve urbane e të ngurta nga të tretët në vendgrumbullimin e mbetjeve rezultoi se, kanë njoftuar për fillimin e punimeve 33 subjekte të cilët janë të pajisur me leje ndërtimi ku 7 nga subjektet i përkasin zërit transport për depozitimit të mbajtjeve sipas preventivit. Nga llogaritja e grupit të auditimit lidhur me tarifën sipas VKB-së nr.79 prot., datë 02.12.2021 për një ndryshim në VKB nr. 88prot.,Datë. 24.12.2020 rezulton se janë 7 subjekte për vitin 2021 të cilët nuk kanë paguar tarifën në vlerën prej 1,755,800 lekë. Përsa i përket viti 2022 kanë njoftuar për fillimin e punimeve 44 subjekte të cilët janë të pajisur me leje ndërtimi ku 12 nga subjektet i përkasin zërit transport për depozitimit të mbajtjeve sipas preventivit të cilët nuk kanë paguar tarifën në vlerën prej 6,771,270 lekë. Nga auditimi arrihet në konkluzion se për vitin 2021 dhe vitin 2022 janë 77 subjekte të cilët kanë njoftuar për fillimin e punimeve, ku 19 prej tyre janë debitorë për zërin transport sipas preventivit m³. Sipas komunikimit verbal me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të cilat janë shprehur se subjektet nuk janë njoftuar për pagesën e tarifës dhe nuk kanë paguar tarifën sikurse përcaktohet në VKB nr.79 prot., datë 02.12.2021, duke sjellë kështu **të ardhura të munguara në vlerën 8,527,070 lekë**. Veprime në kundërshtim me VKB-së nr.79 prot., datë 02.12.2021 për një ndryshim në VKB nr. 88 prot.,datë. 24.12.2020. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë, në bashkëpunim me IMTV dhe Drejtorinë e të Ardhurave Bashkia Vlorë, të marrin masa për evidentimin dhe nxjerrjen e njoftim vlerësimeve në shumën **8,527,070 lekë, të 19 subjekteve** debitorë për tarifën e mbetjeve urbane, si dhe të ndiqen të gjitha rrugët administrative për arkëtimin.

Kryetari i Bashkisë të ngrejë urdhër pune për monitorimin në terren lidhur me këtë veprimtari.

Brenda datës 30.03.2024

10. Gjetje nga auditimi: Në hartimin dhe zbatimin e kontratës së dhënies me qira të objektit “Parku i lojërave të qytetit Vlorë”, u konstatuan shkelje ligjore si më poshtë:

Nga auditimi i mëparshëm, ka rezultuar si e ardhur e munguar mbi zbatimin e kontratave së dhënies me qira të objektit “Parku i lojërave të qytetit Vlorë” deri më datë 30.06.2021 në vlerën **10,198,440 lekë**. Për periudhën e auditimit 01.01 2021 – 31.12.2022 është arkëtuar më pak, **shuma 5,827,680 lekë, përbën të ardhur të munguar me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe MZHTETTS**, sipas përqindjeve, referuar procesverbalit të mbajtur nga administrata e Bashkisë Vlorë mbi saktësimin e sipërfaqes në shfrytëzim që subjekti ka si dhe tarifave të ndryshuara me VKM nr. 992, datë 9.12.2015 “Për disa ndryshime në VKM nr.54 datë 5.2.2014”. -Nuk është marrë parasysh ndryshimi i tarifës së qirasë me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, me ndryshime.

-Nuk është zbatuar pika 6.3 e kontratës, pasi vlera e garancisë së kontratës nuk është derdhur nga

qiramarrësi dhe nuk është ngurtësuar në emër të Bashkisë Vlorë, deri në përfundim të kontratës”. Nisur nga përcaktimet e kontratës fillestare në nenin 7 “Zgjidhja e kontratës” pika 7.2 germa “c” përcaktohet se kontrata mund të zgjidhet para afatit, kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate, veprim që nuk është kryer nga Bashkia Vlorë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se kontrata ka përfunduar në qershor të vitit 2022, pagesa mujore vazhdon të kryhet nga subjekti I. ShPK në vlerën 360,060 lekë për çdo muaj. Duke iu referuar VKB-së 60 datë 27.10.2016 pika 2 e VKB-së, ku specifikohet se të miratojë sipërfaqen prej 14960 m² në funksion të Parkut të Lojrave të qytetit të Vlorës , sipas matjeve faktike të kryera në terren, bashkëlidhur planvendosjen përkatëse. Gjithashtu po ti referohemi pikës 3 të këtij vendimi ku është shprehur se ky vendim ti dërgohet për kompetencë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik , Turizmit, Tregtisë dhe sipërmarrjes , për vijimin e mëtejshëm të procedurave ligjore . Duke iu referuar pikës 4 të VKB-së ku shkruhet se për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vlorë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion Nga Drejtoria e Aseteve rezulton se nuk është mbajtur korrespondenca sikurse përcaktohet në VKB-së nr.60 datë 27.10.2016.

Gjithashtu, Bashkia Vlorë nuk ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve sipas Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 205, datë 25.10.2022, përcjellë me shkresën nr. 462/10 prot., datë 31.10.2022, konkretisht për:

-Evidentimin e të gjitha arkëtimeve nga qiraja e kontratës për “Parkun e lojërave të qytetit Vlorë” nga momenti i lidhjes së kontratës deri më datë 31.12.2010;

-Lidhur me pasuritë nr. 28/611 dhe nr. 28/614, të cilat janë pjesë e “Parkut të lojërave të qytetit Vlorë”, dhe sipas certifikatave të pronësisë Bashkia Vlorë nuk është pronare, të evitohen veprimet juridike për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi to.

-Mos marrja në konsideratë e këtyre rekomandimeve, ka sjell vijimin e paligjshmërisë së kontratës ndërmjet Bashkisë Vlorë dhe subjektit “I.” ShPK, duke sjellë rritjen e të ardhurave të munguara shprehur më sipër.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiotezë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016, Kapitulli III, “Tarifat dhe vlera dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiotezë”, pikat 5 Kreu VI pika 2 dhe 6 aneks-kontrata e datës 04.06. 2002, ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” Pjesa V, Kreu I, neni 678. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të ngrejë një grup pune me specialist të fushës nga Drejtoria e të Ardhurave vendore, Drejtoria e Aseteve dhe Drejtoria Juridike Bashkia Vlorë, për analizimin e situatën e krijuar nga mos pagesa e qirasë së objektit “Parku i lojërave të qytetit Vlorë”, si dhe të ndiqen të gjitha rrugët administrative për arkëtimin e vlerës e cila përbën efekt negativ financiare progresive **në shumën 16,026,120 lekë**, për mos përcaktimin e pagesës sipas sipërfaqes së re të konstatuar nga matjet faktike të kryera në terren, si dhe mos aplikimin e tarifave të reja të qirasë/m² duke favorizuar subjektin “I. I” ShPK.

Të përllogaritet në vijimësi pagesa mujore për subjektin “I. I” ShPK referuar matjeve faktike 14.960 m² sipas përcaktimeve në VKB nr. 60, datë 27.10.2016.

Brenda datës 30.03.2024

10.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë, të marrë masa të menjëhershme për zbatimin rekomandimeve të dërguara më shkresën nr. 462 prot., datë 31.10.2022, që lidhen me kontratën ndërmjet Bashkisë Vlorë dhe subjektit “I.” ShPK.

11. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi dhe analizimi i raporteve të gjeneruara nga sistemi TAIS dhe të dhënave mbi aktkontrollat e ndryshme që inspektorët e terrenit kanë realizuar për periudhat ushtrimore 2021 dhe 2022, në subjekte të ndryshme për taksën e reklamës dhe hapësirat publike, sipërfaqen e ndërtimit, etj, u konstatua se jo të gjitha konstatimet e evidentuara nga inspektorët e kontrollit të terrenit janë të ngarkuara për pagesë në sistemin TAIS për detyrimin tatimorë të munguar dhe padeklaruar në fillim të vitit ushtrimorë.

Sipas dokumentacionit (*aktkontrolleve dhe sistemit TAIS*), rezulton se në **21** subjekte nga inspektorët e terrenit janë evidentuar sipërfaqe e pataksuar për një vlerë të munguar **838,200 lekë** (*sipas listave në faqen 160-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë nr. 79, datë 2.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në bashkinë Vlorë”, i ndryshuar dhe rregullores së Bashkisë Vlorë “Për organizimin dhe funksionimin e strukturave të Bashkisë Vlorë”, neni 106- në të cilin përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e Specialistit të vlerësimit të detyrimit tatimor për biznesin. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Vlorë (*sektori i vlerësimit*), të marrë të masat për kryerjen e ngarkesës fiskalë sipas aktkontrolleve të inspektorëve të kontrollit dhe jo vetëm, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **838,200 lekë**, konkretisht subjektet

NR	SUBJEKTI	Vlera pataksuar
1	Posta Sh.	34,000
2	R. Bank	70,000
3	A. N.	5,000
4	P. G.	10,000
5	Supermarket M.	5,000
6	A. M.	10,000
7	E. M.	15,750
8	G. L.	15,000
9	G. D.	101,250
10	E. Sh.	12,000
11	D. S.	12,000
12	H. H.	24,000
13	K. M.	19,200
14	H. A.	24,000
15	A. S.	12,000
16	H. L.	72,000
17	B. M.	153,600
18	A. C.	64,000
19	K. L.	72,000
20	S. M.	18,000
21	E. B.	90,000
SHUMA		838,200

Brenda datës 30.03.2024

12. Gjetje nga auditimi: Referuar strukturës së DAV Bashkia Vlorë, konstatohet se menaxhimi i borxhit bëhet nga Sektori i Menaxhimit të borxhit i përbërë nga **2** inspektor.

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se gjendja e debitorëve në fund të periudhës 31.12.2022 paraqitet në vlerën **768,711 mijë lekë kjo për 52767 subjekte**, sipas të dhënave të pasqyrës si vijon:

EMËRTIMI	2021		2022	
	Vlera	Nr/Subjekt	Vlera	Nr. Subjekt
Biznesi i madh	129,466,325	780	127,292,477	930
Biznesi i vogël	232,750,168	4213	257,759,154	5119
Individë	17,701,682	149	13,901,374	141
Abonent familjarë	272,235,054	26357	369,758,437	46577
Debitorë ne total	652,153,229	31,499	768,711,442	52,767

Referuar të dhënave të pasqyrës, konstatohet se niveli i borxhit nga një periudhë në tjetër vjen në rritje si në numër subjektësh po ashtu dhe në vlera, kështu nga viti 2021 në vitin 2022 ky nivel është rritur për vlerën **22,835,138 lekë**, si dhe numër i subjekteve **1056** subjekte.

Gjithashtu dhe niveli i arkëtimeve paraqitet me ulje në vlerën 11,616 mijë lekë. Ku për vitin 2021 është arkëtuar vlera 94,826 mijë lekë të debisë së vitit 2020 për vlerën 376,873 mijë lekë ose 25% dhe për vitin 2022 është arkëtuar vlera 83,210 mijë lekë të vlerës së detyrimeve të vitit 2021 ose 20.8%.

Ndërsa në total duke marrë në konsideratë dhe debitorët familjarë, kjo diferencë është akoma më e madhes për shumën 116,585 mijë lekë për 21268 subjekte/abonentët familjarë, për vitet 2021/2022.

Totali i debisë për bashkinë Vlorë është 59.1% e planit të taksave e tarifave vendore dhe 33.4% e planit të buxhetit. Pra këto të dhëna tregojnë se vlera e detyrimeve debitorë është në niveli shumë të larta, ku peshën kryesore e zënë debitorët familjar në shumën 369,758 mijë lekë ose 48% e totalit të detyrimeve.

Mosha e borxhit për subjektet e biznesit të madh, biznesit të vogël, paraqitet si më poshtë:

Mosha e Borxhit	2022	
	Vlera	Nr. Subjekte
Totali		
1 deri 3 vite	84,663,994	3297
Nga 3 deri 5 vite	96,440,053	1030
Mbi 5 vjet	222,551,380	1999
Debitor pa shpresë arkëtimi	123,506,372	1285

Referuar të dhënave të pasqyrës, vlerën më të lartë të borxhit e zënë debitorët e moshës mbi 5 vite për vlerën **222,551** mijë lekë ose **55.7%** e ndjekur nga **borxh i keq (pa shpresë arkëtimi)** për **1285** subjekte me vlerë 123,506 mijë lekë ose 30% e totalit të debitorëve për taksat/tarifat vendore. Gjithashtu, nga të dhënat e disponueshme, konstatohet se për periudhën objekt auditimi, ka dhe subjekte të cilat janë me status pasiv ose të çregjistruar nga QKB, por që nuk kanë bërë të mundur likuidimin e detyrimeve për taksat e tarifat vendore. Kështu për vitin 2021 janë **3541** subjekte me vlerë **264,443** mijë lekë ose **70.2%** totali të detyrimeve nga taksat/tarifat vendore dhe për vitin 2022 janë **3127** subjekte me vlerë **238,347** mijë lekë ose **59.7%** e totalit të detyrimeve nga taksat/tarifat vendore.

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga DAV Bashkia Vlorë për vitet 2021/2022 dhe kundërshtive të subjektit, rezulton se nga kjo administratë (Sektori i borxhit), janë ndërmarrë këto hapa për vjeljen e debitorëve, konkretisht:

Për vitin 2021 kemi patur objekt pune **5142 debitore** me shume **376,837,175 lekë**, nga këto subjekte:

Për 4323 debitore = 1230 debitore për vitin 2021 + 3093 debitore për periudhën 2011-2020 me shumë totale **307,045,135 lekë** janë kryer procedurat e borxhit, ndërsa **për 819 debitorë** me shumë **6,385,824 lekë** nuk janë bërë procedurat e borxhit, pasi janë debitore me vlere nën 1,000 lekë (*procedurë që nuk justifikon shpenzimet kancelarie, duke patur parasysish se për një subjekt duhen dërguar me poste rreth 16 praktika shkresore*).

Pra numri i masave të marrë nga sektori borxhit është në masën **84 %** të nr. total të debitorëve **Për vitin 2022** kemi patur objekt pune **6190 debitore** me shume 398,953,004 lekë, nga këto subjekte:

Për 5272 debitore = 1587 debitore për vitin 2022 + 3685 debitore për periudhën 2011-2021 me shumë **392,479,247 lekë**, janë kryer procedurat e borxhit, ndërsa **për 918 debitorë me shumë 6.473757 lekë**, nuk janë bërë procedurat e borxhit, pasi janë debitore me vlere nën 1000 lekë (*procedurë që nuk justifikon shpenzimet kancelarie, duke patur parasysish se për një subjekt duhen dërguar me poste rreth 16 praktika shkresore*).

Pra numri i masave të marre nga sektori ynë është në masën **85.2 %** të nr. total të debitorëve.

Duke vlerësuar riskun e praktikave të menaxhimit të borxhit u përzgjedhën disa raste për auditimin e procedurave që janë kryer, *rezultoi se:*

- Për Institucionet shtetërore, të identifikuar si debitorë është ndjekur vetëm procedura e nxjerrjes së Njoftimit për Pagesë të Detyrimeve Tatimore dhe nuk është vazhduar me asnjë procedurë tjetër.

- Nuk gjen zbatim ndryshimi ligjor i nenit 89¹³ i ligjit të procedurave tatimore.

- Nuk janë ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, **pasi** janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar **kallëzim penal** bazuar në nenin 181 “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar.

Këto veprime janë në kundërshtim me:

Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2018 “Për procedurat tatimore në RSH; i ndryshuar, respektivisht nenet:

- **neni 89**-Njoftimi dhe kërkesa për pagim të detyrimeve;

- **neni 90**-Urdhër bllokimet

- **neni 92**- Masa për sigurimin e detyrimit tatimor, nuk janë bërë për të gjithë subjektet debitorë; ;

- **neni 93**- Sekuestro dhe konfiskim i pasurisë

- **neni 94**- Urdhër sekuestrimi, nuk gjen zbatim në asnjë moment, duke parë që një pjesë e subjekteve janë debitorë nga njëra periudhë në tjetër;

¹³ ; “ Në funksion të mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit, administrata tatimore mund të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume **jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar**, por jo më shumë se detyrimi tatimor, për të cilin ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, për llogari të detyrimeve tatimore të pashlyera të tatimpaguesit”

-Për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, nuk është kërkuar nga DTTV që për të gjithë subjektet të cilat janë njoftuar për pagesën e detyrimeve dhe zbatuar një pjesë e procedurave të kërkohet *kallëzim penal*, bazuar në nenin 181-Mos pagimi i taksave dhe tatimeve, të Kodit Penal të RSH, miratuar me Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime.

Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35.

Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe VKB nr. 88, datë 24.12.2022. *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Vlorë në bashkëpunim me sektorët e tjerë të Bashkisë Vlorë, si Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit, Drejtorinë Juridike, Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit, të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve debitorë në vlerën **768,711,442 lekë** kjo për **52767** subjekte/abonent familjare, për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit të keq që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.

Brenda datës 30.03.2024

12.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë të marrë masa për rritjen e numrit të inspektorëve në sektorin e menaxhimit të borxhit si një sektorë shumë i rëndësishëm arkëtimin e të ardhurave në buxhetin e Bashkisë.

12.3 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrin masa për ndryshimin e Rregullores së brendshme të Bashkisë Vlorë, ku të përcaktohen qartë Drejtoritë/ Sektorët që do merren me menaxhimin e të ardhurave që rrjedhin nga subjektet fizik/juridike/abonentë familjarë (*nëpërmjet agjentëve*)/kontratat e qirave të asetëve, tokave bujqësore, subjekteve që shfrytëzojnë karriera, si dhe të gjitha aktivitetet që burojnë të ardhura për bashkinë.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të përcjellë nga AKB me posten elektronike zyrtare datë 7.7.2023 me të dhënat e disponuara dhe vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, rezulton se për vitin 2021 dhe vitin 2022 kanë ushtruar aktivitetet duke kryer dhe pagesat e sipërfaqeve të plazhit, disa subjekte të cilat nuk janë konfirmuar nga Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve (GTSHA) dhe AKB, pra janë lëshuar mandat pagesa për subjekte të pa miratuara në AKB, veprime këto në shkelje të VKM nr. 1172, datë 24/12/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 171, datë 27/03/2019 “Për miratimin e rregullores, për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së Stacioneve të Plazhit”, pika 5 dhe 10.

Konkretisht për vitin 2021 janë **51** persona të cilat kanë kryer pagesë për stacione plazhi, por të pamiratuara në AKB. Ndërsa për vitin 2022 janë **50** persona të cilat kanë kryer pagesë për stacione plazhi, por të pamiratuara në AKB.

Nga përpunimi i të dhënave është evidentuar se për **54** subjekte tarifa e qirasë së Stacionit të plazhit nuk është sipas mandatpagesave, kjo për vlerën **12,146,100 lekë**, e **ardhur e munguar**, ku për vitin 2021 janë 27 subjekte me vlerë 6,258,100 lekë dhe për vitin 2022 për 25 subjekte me vlerë 5,888,000 lekë (sipas pasqyrës në pikën 2.6 faqe 152 të Raportin Përfundimtar të Auditimit).

Për vitin 2021 janë **38** subjekte dhe në vitin 2022 janë **32** subjekt, janë lëshuar fatura pagesë për sipërfaqen së plazhit pa bërë me parë pagesën e taksave lokale dhe paraqitur vërtetim përkatës. Nga auditimi i dokumente të paraqitur, rezulton se sipas verifikimit në terren të kryer nga grupet e punës ngritur me urdhëron nr. 72, datë 02/04/2022 (*prot 3416*), të Kryetarit të Bashkisë është evidentuar se disa subjekte shfrytëzohim më shumë sipërfaqe se ajo e miratuar si nga AKB dhe nga Bashkia Vlorë, por që nga Bashkia Vlorë (personat përgjegjës), nuk është bërë i mundur llogaritja e tarifës për sipërfaqen shtesë të shfrytëzuar, kjo për 12 subjekte me vlerë 2,032,500 lekë e cila konsiderohet të ardhura të munguara për bashkinë Vlorë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbi procedura e dhënies në përdorim të hapësirave të plazhit në sezonin turistik 2021 – 2022, në kundërshtim me VKM nr. 1172, datë 24.12.2020 ndryshuar me VKM nr. 827, datë 24/12/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 171, datë 27.3.2019, të këshillit të ministrave, “për miratimin e rregullores ‘për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, të ndryshuar, përkatësisht nenet 5; 6; 7; 8; 12. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Strukturën Përgjegjëse të Menaxhimit të Stacioneve të Plazhit dhe Drejtorinë e të Ardhurave Vendore Bashkia Vlorë, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në arkëtimin e vlerës **14,178,600** lekë, si ardhur e munguar, nga e cila:

- **Vlera 6,258,100 lekë** për **27 subjekte** të vitit 2021, si diferencë midisi mandate pagesave të lëshuara nga bashkia dhe pagesave të kryera nga subjekti.
- **Vlera 5,888,000 lekë** për **25 subjekte** të vitit 2022, si diferencë midisi mandate pagesave të lëshuara nga bashkia dhe pagesave të kryera nga subjekti.
- **Vlera 2,032,500 lekë** për **12 subjekte**, si diferencë sipërfaqe midisi asaj të kontraktuar dhe sipërfaqes së konstatuar nga kontrolli në terren. (*Sipas listave në pikën 2.6 faqe 152 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*)

Brenda datës 30.06.2024

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në lidhje me nivelin e arkëtimit të masave administrative, rezulton se është në nivele të ulta, më konkretisht, në vitin 2021, janë vendosur në total 104 gjoba me vlerë 40,520,000 lekë nga të cilat janë paguar në mënyrë vullnetare 15 gjoba (14.3% të numrit total të gjobave) me vlerë 1,350,000 lekë (3.3% të vlerës totale të gjobave). Në vitin 2022, janë vendosur në total 151 gjoba me vlerë 91,630,000 lekë, nga të cilat janë paguar në mënyrë vullnetare 20 gjoba (13.2% të numrit total të gjobave) me vlerë 1,850,000 lekë (2.02% të vlerës totale të gjobave). Në total deri në fund të vitit 2022, janë paarkëtuar vlera **128,950,000 lekë për 220 persona, si mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë.**

Gjithashtu, nga auditimi i blloqeve të dënimit me gjobë dhe ballafaqimit të tyre me informacionin e vendosur në dispozicion nga DFB, rezulton se nuk është aplikuar kamat-vonesa 2%, e parashikuar në Ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Neni 9/Neni 22; Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, Kreu V, Neni 30, pika 3, për personat ose subjektet të cilat nuk i kanë paguar këto gjoba brenda afateve ligjore. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 288-297 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

14.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Drejtorinë Juridike dhe IMTV, të marrin masa për kryerjen e të gjitha procedurave administrative e ligjore në të gjitha shkallët, për të bërë të mundur arkëtimin e vlerës prej **128,950,000 lekë për 220 persona** në shkelje të ligjit të vendosura nga IMTV. Gjithashtu, të merren masat për përlllogaritjen e kamat-vonesës dhe vjeljen e saj në çdo rast që gjobat nuk paguhen brenda afateve të përcaktuara, të merren masa për vendosjen në dijeni dhe

rritjen e bashkëpunimit me Shërbimin Përmbartimor, si dhe Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, Bashkia Vlorë.

Brenda datës 30.06.2024

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në një rast nuk janë respektuar përcaktimet ligjore në lidhje me kontributin që sektori privat duhet të ofrojë përkundrejt fondit publik të banesave sociale, për ato raste kur subjekti zhvillues është përdorues i të drejtës së zhvillimit me Intensitet Ndërtimi me Kusht. Nga shfrytëzimi i kësaj të drejte nga ana e subjektit zhvillues “F. I.” ShPK, Bashkia Vlorë do të duhej të përfitonte një sipërfaqe prej 299.86 m² (me vlerë shitjeje 299.86 m² * 61.800 lekë/m² = 18.531.348 lekë). Palët kanë rënë dakort që ky përfitim të merret si investim publik, më konkretisht, si investim për rehabilitimin e rrugës “Xher Rashimi”. Sipas marrëveshjes midis Bashkisë Vlorë dhe subjektit zhvillues “F. I.” ShPK, datë 04.04.2022, nr. 2145/1 prot., DPKZHT ka përpiluar projektin për rehabilitimin e rrugës, duke e preventivuar atë me vlerë totale prej 8.633.559 lekë. Rezulton se vlera e shitjes së sipërfaqes së përfituar nga Bashkia Vlorë është më e madhe se vlera e preventivuar për rrugën “Xher Rashimi”, më konkretisht, diferenca është 9.897.789 lekë, vlerë e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Vlorë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 261-288 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

15.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, të marrë masa për të rivlerësuar kontratën me subjektin zhvillues “F. I.” ShPK, për "*Objekt banimi dhe shërbimi me 3 dhe 10 kate mbi tokë dhe papafingo, me 1 kat nën tokë*" me adresë rr. “Gjergj Kastrioti”, Vlorë, subjekt i cili ka përdorur të drejtën e ndërtimit me Intensitet me Kusht. Bashkia Vlorë të ballafaqojnë vlerën e shitjes së sipërfaqes së përfituar me vlerë tregu me preventivin e investimit për të cilin palët kanë rënë dakort ndërmjet tyre, si dhe të marrin të gjitha masat për të bërë të mundur arkëtimin e vlerës prej **9,897,789 lekë**.

Brenda datës 31.03.2024

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 3 (tre) raste të audituara, përllogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është kryer e saktë, si dhe një njërin prej këtyre rasteve, ka mangësi në dokumentacion. Në një rast, më konkretisht për objektin “Godinë banimi dhe shërbimi 8 kate + papafingo me 1 kat nëntokë, në rrugën ‘Ibrahim Avdullai’, Bashkia Vlorë” me subjekt zhvillues “A. K.” ShPK dhe z. F. H., taksa e ndikimit në infrastrukturë është përllogaritur me vlerë të munguar prej 12,670,221 lekë. Në një rast tjetër, për “Kompleks me funksion hoteleri dhe shtëpi të dyta, me 5 kate dhe 1 kat nën tokë”, me adresë Radhimë, Vlorë, me subjekt zhvillues “I. & AG C.” ShPK, taksa e ndikimit në infrastrukturë është përllogaritur me vlerë të munguar prej 446,758 lekë, gjithashtu në këtë rast nuk është ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve mandat-pagesa e TNI-së, sipas përllogaritjes së Bashkisë Vlorë, me vlerë prej 11,210,000 lekë. Në një rast tjetër, për “Objekt banimi dhe shërbimesh me hoteleri dhe pishina 6-8 kate, me 2 kate nën tokë”, me adresë rr. "Llambro Rexho", Vlorë, me subjekt zhvillues “T.M.Z.B” ShPK, taksa e ndikimit në infrastrukturë është përllogaritur për një objekt me funksion miks banim, shërbim dhe hoteleri, me vlerë 16,500,516 lekë, kur në këtë objekt nuk evidentohet pjesa takuese me funksion hoteleri, përllogaritje e cila jep një vlerë më të vogël të TNI-së. Nëse do të bëhet përllogaritja për këtë objekt, duke e konsideruar të gjithin me funksion banim dhe shërbime, vlera e saktë e TNI-së do të ishte 31.956.532,6 lekë. Diferenca prej 15.456.017,1 lekë përbën të ardhur të munguar institucionin e Bashkisë Vlorë.

Gjetjet e konstatuara më sipër janë në kundërshtim me Ligjin 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 46. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 77-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **12,670,221 lekë**, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti zhvillues “A. K.” ShPK dhe z. F. H.

16.2 Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **446,758 lekë**, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti zhvillues “I. & AG C.” ShPK. Gjithashtu, Bashkia Vlorë duhet të vendosi në dispozicion të grupit të auditimit mandat-pagesën e vlerës prej 11,210,000 lekë, vlerë të cilën Bashkia Vlorë pretendon se është paguar nga subjekti zhvillues, në të kundërt, edhe kjo vlerë do të konsiderohet e papaguar dhe e ardhur e munguar.

Brenda datës 31.03.2024

16.3. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të marrë të gjitha masat për të monitoruar zhvillimin e “Objekt banimi dhe shërbimesh me hoteleri dhe pishina 6-8 kate, me 2 kate nën tokë”, me adresë rr. " Llambro Rexho", Vlorë, me subjekt zhvillues “T.M.Z.B” ShPK, sipas funksioneve të përcaktuara në projektin ndërtimor, si dhe të informojë grupin e auditimit kur ky subjekt të aplikojë për pajisje me çertifikatë përdorimi. Në rast se ky subjekt nuk siguron përfshirjen e shërbimit hoteleri brenda objektit në zhvillim, Bashkia Vlorë të marrë të gjitha masat për arkëtimin e vlerës prej **15,456,017 lekë**, e cila do të konsiderohet e ardhur e munguar.

Brenda datës 31.03.2024

D. MASA DISIPLINORE

D/1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germet (b, c, ç) e nenit 58-“Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë Vlorë që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2022, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”, për **23 (njëzetre)** punonjës, si më poshtë:

1. z. D. Z., me detyrë ish - Drejtor Juridik, aëntar i Njësisë së Prokurimit, Drejtor i Financës për vitin 2022, Bashkia Vlorë.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos mbajtjen e korrespondencës me DAV-n lidhur me procedurat të kryera për arkëtimin e të ardhurave nga tarifës së pastrim-gjellbërimit-ndriçimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në bazë lejesh ndërtimi dhe investime me fonde publike në territorin e Bashkisë Vlorë, duke krijuar të ardhura të munguar në buxhetin e Bashkisë në vlerën 2,700 mijë lekë për 82 subjekte (viti 2021/2022). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
- Planit të shlyerjes së stokut të detyrimeve të prapambetura për vitin 2022, nuk është përcaktuar detyrimi i mbetur në fillim të vitit i mbartur nga viti 2021, dhe nuk është parashikuar shlyerja e detyrimit që duhet të shlyej gjatë vitit 2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
- Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
- Mos angazhimi sa duhet në marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në zbatim të urdhrat të Kryetarit të Bashkisë nr. 158, datë 13.6.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH përcjellë me shkresën nr. 731/37prot, datë 2.6.2022”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2. z. Z. S., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, Drejtori i Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Projekteve, Bashkia Vlorë.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos pajisjen me autorizim dhe mos pagesa e tarifës nga subjektet që ushtrojnë veprimtarinë lavazh kemi të bëjmë me një vlerë debitoare prej **270,000 lekë**, në mos zbatim të VKB nr. 79 prot., datë 02.12.2021 për një ndryshim në VKB nr. 88 Datë 24.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”, pika 6, nënpika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
- Për vitin 2021 dhe vitin 2022 janë 77 subjekte të cilët kanë njoftuar për fillimin e punimeve, ku 19 prej tyre janë debitorë për zërin transport sipas preventivit m³. Nga ana e DPZhT, rezulton se subjektet nuk janë njoftuar për pagesën e tarifës sikurse përcaktohet në VKB nr.79 prot., datë 02.12.2021 nënpika 5 e pikës 6, ku përcakton se niveli tarifës për depozitimin e mbetjeve 100 lekë/m³, duke sjellë të ardhura të munguara në vlerën **8,527,070 lekë**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
- Për procedurat e ndjekura për arkëtimin e të ardhurave nga taksa e infrastrukturës të ndërtimeve informale që ndodhen në territorin e Bashkisë Vlorë, në kundërshtim me VKB-së nr. 88, datë 24.12.2020 i ndryshuar me VKB nr. 79 datë 02.12.2021 “Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë nr. 1235/1 Prot., datë 31.12.2020. ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006. VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
- Për mosrespektimin e kondicioneve urbane (2 raste); Për miratimin e lejeve të ndërtimit me mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqëruar të tij, si dhe dokumentacionin e

kërkuar në ligj; Për mos-hartimin e kontratave me subjektet zhvilluese, mbi kontributit që sektori privat duhet të ofrojë përkundrejt fondit publik të banesave sociale, përpara miratimit të lejes së ndërtimit; Për miratimin e lejeve të ndërtimit, pa marrë dhe respektuar mendimin e autoriteteve të tjera publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit; Për miratimin e lejeve të ndërtimit në kushtet e përlllogaritjes së gabuar dhe me mungesë dokumentacioni të taksës së ndikimit në infrastrukturë; Për miratimin e çertifikatave të përdorimit me dokumentacion me mangësi ose të pasaktë; Për miratimin e çertifikatave të përdorimit kur është konstatuar se objekti i realizuar ka ndryshime nga objekti i miratuar; Për miratimin e lejes së ndërtimit për shtyrje të afatit të punimeve për një objekt i cili i ka nisur punimet dhe nuk i ka përfunduar ato brenda afatit dhjetë vjeçar; Për miratimin e lejes për shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve më të gjatë se afati fillestar i lejes së ndërtimit fillestare; (Ankesë z. L. B.); Për moskryerjen e detyrave funksionale për identifikimin e shmangieve nga projekti i miratuar në kohën kur këto devijime janë kryer, por i kanë evidentuar ato në një periudhë më të vonshme; (Ankesë z. L. B.) *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Mos angazhimi sa duhet në marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në zbatim të urdhrat të Kryetarit të Bashkisë nr. 158, datë 13.6.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH përcjellë me shkresën nr. 731/37prot, datë 2.6.2022”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, konkretisht: “Pëmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara” me fond limit 4,701 mijë lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3. znj. S. H., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Asetve.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Mos marrjen e masave shtrëngues për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore në vlerën 261,840 mijë lekë, në zbatim të VKB-në nr. 88 prot., datë 24.12.2020 i ndryshuar VKB nr. 79 datë 02.12.2021 pika (b) faqe 6, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920, për procedurat tatimore, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

- Mangësitë e konstatuara në menaxhimin e kontratave të stacioneve të plazheve për subjekteve private, nga ku rezulton se:

Për vitin 2021 dhe vitin 2022 kanë ushtruar aktivitet duke kryer dhe pagesat e sipërfaqeve të plazhit, disa subjekte të cilat nuk janë konfirmuar nga Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve (GTSHA) dhe AKB, pra janë lëshuar mandat pagesa për subjekte të pa miratuara në AKB, veprime

këto në shkelje të VKM nr. 1172, datë 24/12/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 171, datë 27/03/2019 “Për miratimin e rregullores, për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së Stacioneve të Plazhit”, pika 5 dhe 10.

Për **54** subjekte tarifa e qirasë së stacioni të plazhit nuk është sipas mandatpagesave, kjo për vlerën **12,146,100 lekë**, e ardhur e munguar, *ku për vitin 2021 janë 27 subjekte me vlerë 6,258,100 lekë dhe për vitin 2022 për 25 subjekte me vlerë 5,888,000 lekë.*

Për vitin 2021 janë **38** subjekte dhe në vitin 2022 janë **32** subjekt, janë lëshuar fatura pagesë për sipërfaqen së plazhit pa bërë me parë pagesën e taksave lokale dhe paraqitur vërtetim përkatës.

Nga verifikimit në terren të kryer nga grupet e punës ngritur me urdhëron nr. 72, datë 02/04/2022 (*prot 3416*), të Kryetarit të Bashkisë është evidentuar se disa subjekte shfrytëzohim më shumë sipërfaqe se ajo e miratuar si nga AKB dhe nga Bashkia Vlorë, por që nga Bashkia Vlorë (personat përgjegjës), nuk është bërë i mundur llogaritja e tarifës për sipërfaqen shtesë të shfrytëzuar, kjo për **12** subjekte me vlerë **2,032,500 lekë** e cila konsiderohet të ardhura të munguara për bashkinë Vlorë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 1172, datë 24.12.2020 ndryshuar me VKM nr. 827, datë 24/12/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 171, datë 27.3.2019, të këshillit të ministrave, “për miratimin e rregullores ‘për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, të ndryshuar, përkatësisht nenet 5; 6; 7; 8; 12. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

- Mos angazhimi sa duhet në marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në zbatim të urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr. 158, datë 13.6.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH përcjellë me shkresën nr. 731/37prot, datë 2.6.2022”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

-Në 266 kontrata të nënshkruara me afat 30-99 vjeçar, nuk janë marrë masa nga ana e drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve për rishikimin e kushteve të kontratave si dhe ndryshimet ligjore që janë ndër vite, nuk janë rishikuar sipas VKM Nr.54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” si dhe **udhëzimit nr.6756/2015**”, mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore.

-Kontratat e nënshkruar ndër vite janë në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve , të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016, Kapitullit III, “Tarifat dhe vlera dysHEME për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë”, pikat 5¹⁴.

-Nga Drejtoria e asetëve dhe Pronave nuk është iniciuar dhe nuk rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së Vlorë, mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm te personat e tretë që kanë pësuar këto pasuri, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive.

-Gjithashtu konstatohet se inventari i pasurive të paluajtshme të Bashkisë Vlorë është i pa përditësuar, në kundërshtim me nenin 37 të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e

mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore të pa përditësuara.

-Nuk është marrë parasysh ndryshimi i tarifës së qirasë me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, me ndryshime.

-Nuk është bërë mbikëqyrja e përdorimit të tokës bujqësore të marrë me qira mbi bazën e kartelës personale për çdo kontratë.

Nga auditimi i zbatimit të kontratave rezulton se në 97 raste të kontratave nuk janë respektuar kushtet e kontratës, në lidhje me pagesën e tarifës së qirasë.

-Nga të dhënat e drejtorisë së pronave publike dhe menaxhimit të aseteve si dhe njësive administrative, nga Bashkia Vlorë administrohen 266 kontrata të dhënies me qira me sipërfaqe 464.678 ha të tokave të pandara, të lidhura që para reformës territoriale nga Ish-Komunat Qendër, Shushicë dhe Novoselë.

-Së pari, nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se në dosjen përkatëse të kontratave të qirasë, e cila nuk ka inventar, mungon dokumentacioni i detyrueshëm, sipas VKM përkatëse,

-Së dyti, kontratat janë nënshkruar në vitin 2008 deri në vitin 2012, me bazën ligjore të asaj periudhe dhe mungojnë procesverbalet ku duhet të përshkruhen qartë gjendja fizike e pronës, vlera kontabël e objektit që jepet me qira ose enfiteozë, sipas germa d).

-Së treti, nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, si dhe NJA nuk është realizuar në asnjë rast monitorimi i kontratave, nëse individ apo subjekte private qiramarrës kanë realizuar investimin sipas objektit të kontratës apo janë në kushtet e moszbatimit të saj. Nuk është bërë mbikëqyrja e përdorimit të tokës bujqësore të marrë me qira mbi bazën e kartelës personale për çdo kontratë. Në kundërshtim me: **neni 826 të kodit civil, neni 827** “*Qiradhënësi me anë inventari i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme si tokën bujqësore, kullotat, si dhe neni 829* “*Qiradhënësi ka të drejtë që në çdo kohë të ushtrojë kontroll mbi pasurinë e dhënë me qira për të përcaktuar nëse qiramarrësi respekton marrëveshjen sipas detyrimeve të vëna në kontratë, sipas natyrës dhe rregullave agroteknike;*

-Mos menaxhimi dhe mos monitorimi i kontratave të qiradhënies së tokave të pandara dhe parcelave nga fondi pyjor-kullosor, nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, si dhe NJA nuk është realizuar në asnjë rast monitorimi i kontratave, nëse individ apo subjekte private qiramarrës kanë realizuar investimin sipas objektit të kontratës apo janë në kushtet e moszbatimit të saj. Nuk është bërë mbikëqyrja e përdorimit të tokës bujqësore të marrë me qira mbi bazën e kartelës personale për çdo kontratë.

- Në asnjë rast kontratat me qira për tokat bujqësore të pandara nuk janë regjistruar, sipas udhëzimit nr.3 datë 16.5.2007 për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara kundrejt tarifës së përcaktuar në vendimin nr.549,datë 26.8.1996 të Këshillit të Ministrave, në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP), **Ligjit 33/2012, neni 51** Regjistrimi i kontratës së qirasë pika 1, 2 si dhe neni 57, pika 1,2,3 e ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën” Regjistrimi i kontratës së qirasë dhe enfiteozës.

Në të gjitha rastet kontrata e nënshkruar nga ish/Kryetarët e komunave, në kontrata tip nuk janë respektuar neni 3) të drejtat dhe detyrimet e palëve, pika a) planimetria e tokës së dhënë me qira, pika c) Të ushtrojë kontrolle periodike mbi gjendjen e fondit të tokës bujqësore, gjithashtu rezultojnë veprime jo në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 827 ”Qiradhënësi me anë inventari i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme si tokën bujqësore, kullotat, e drejta e kundërshtimit të përmbajtjes së inventarit dhe prezumimi i saktësisë së tij

rregullohet sipas dispozitave të këtij kreu si dhe neni 829 “Qiradhënësi ka të drejtë që në çdo kohë të ushtrojë kontroll mbi pasurinë e dhënë me qira për të përcaktuar nëse qiramarrësi respekton marrëveshjen sipas detyrimeve të vëna në kontratë, sipas natyrës dhe rregullave agroteknike;

- Nuk janë zbatuar kriteret dhe përcaktimet ligjore të Kreut VI “*Monitorimi i Kontratave*” lidhur me monitorimin e kontratave të qirasë dhe enfiteozës procedurë e cila drejtohet nga organi që ka lidhur kontratën e qirasë ose të enfiteozës dhe konkretisht pikës 2.

- Nuk është plotësuar pika 7 e kontratës, ku përcaktohet se: “*Qiramarrësi kur nuk paguan qiranë sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 3 të kësaj kontrate për çdo ditë vonesë është i detyruar të paguajë 2% të vlerës së papaguar.* Nga Bashkia Vlorë nuk është marrë asnjë hap ligjor për mospërmbushje të kushteve të kontratës të përcaktuar në nenin 9 “Në rast mosmarrëveshjesh midis tyre, palët do t’i zgjidhin ato me konsensus dhe marrëveshje dhe vetëm kur një gjë e tillë është e pamundur ato do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*”

4. znj. E. Sh., me detyrë specialist pranim-vlerësimi.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Nga verifikimi i të dhënave në raportet e gjeneruara nga sistemi TAIS u konstatua se ekzistonin raste të veprimeve të kryera për ngarkesat me taksa dhe tarifave vendore jashtë periudhave ushtrimore dhe me vonesë në disa raste edhe mbi dy vjet, ndërkohë që këto ngarkesa dhe njoftim vlerësimet/faturimet sipas VKB-ve të miratimit të paketave fiskale, duhet të kryeshin deri në muajin prill të vitit ushtrimor. Për rrjedhojë kjo ka shkaktuar eliminimin e të drejtës së llogaritjes së kamatëvonesave për detyrimet e papaguara, Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni nr. 4 “Zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nr. 68 “Vlerësimi tatimor”, neni nr. 69 “Njoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën e detyrimit tatimor”, neni nr. 114 “Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit”, “Rregullore e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë”, neni 104 “Drejtori i Drejtorisë së Regjistrimit, vlerësimit tatimor, mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore”, neni 105 “Sektori i pranimit dhe kontabilitetit tatimor”, neni 106 “Detyrat dhe përgjegjësitë e Specialistit të vlerësimit të detyrimit tatimor për biznesin”.

- Mos veprimin ndaj të dhënave mbi aktkontrollin e ndryshme që inspektorët e terrenit kanë realizuar për periudhat ushtrimore 2021 dhe 2022, në subjekte të ndryshme për taksën e reklamës dhe hapësirat publike, sipërfaqen e ndërtimit, etj, u konstatua se jo të gjitha konstatimet e evidentuara nga inspektorët e kontrollit të terrenit janë të ngarkuara për pagesë në sistemin TAIS për detyrimin tatimorë të munguar dhe padeklaruar në fillim të vitit ushtrimorë, duke mos kontabilizuar vlerën **838 mijë lekë**, në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë nr. 79, datë 2.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në bashkinë Vlorë”, i ndryshuar dhe rregullores së Bashkisë Vlorë “Për organizimin dhe funksionimin e strukturave të Bashkisë Vlorë”, neni 106- në të cilin përcaktohen - Detyrat dhe përgjegjësitë e Specialistit të vlerësimit të detyrimit tatimor për biznesin. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5. znj. R. P., me detyrë specialiste pranim-vlerësimi.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Kryerjen e veprimeve të stornimeve në 10 raste me dokumentacion ligjorë (procesverbal), në kundërshtim me Urdhri i Brendshëm Nr.78 datë 08.04.2021 për ngritjen e Komisionit për miratimin e Stornimeve në Sistemin TAIS, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni nr. 4/26; Ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”, neni nr. 3; Udhëzimi e MF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 35 “Dokumente të kontabilitetit”, pika nr. 36.

-Nga verifikimi i të dhënave në raportet e gjeneruara nga sistemi TAIS u konstatua se ekzistonin raste të veprimeve të kryera për ngarkesat me taksa dhe tarifave vendore jashtë periudhave ushtrimore dhe me vonesë në disa raste edhe mbi dy vjet, ndërkohë që këto ngarkesa dhe njoftim vlerësimet/faturimet sipas VKB-ve të miratimit të paketave fiskale, duhet të kryheshin deri në muajin prill të vitit ushtrimor. Për rrjedhojë kjo ka shkaktuar eliminimin e të drejtës së llogaritjes së kamatëvonesave për detyrimet e papaguara, Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni nr. 4 “Zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nr. 68 “Vlerësimi tatimor”, neni nr. 69 “Njoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën e detyrimit tatimor”, neni nr. 114 “Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit”, “Rregullore e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë”, neni 104 “Drejtori i Drejtorisë së Regjistrimit, vlerësimit tatimor, mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore”, neni 105 “Sektori i pranimit dhe kontabilitetit tatimor”, neni 106 “Detyrat dhe përgjegjësitë e Specialistit të vlerësimit të detyrimit tatimor për biznesin”.

- Mos veprimin ndaj të dhënave mbi aktkontrollin e ndryshme që inspektorët e terrenit kanë realizuar për periudhat ushtrimore 2021 dhe 2022, në subjekte të ndryshme për taksën e reklamës dhe hapësirat publike, sipërfaqen e ndërtimit, etj, u konstatua se jo të gjitha konstatimet e evidentuara nga inspektorët e kontrollit të terrenit janë të ngarkuara për pagesë në sistemin TAIS për detyrimin tatimorë të munguar dhe padeklaruar në fillim të vitit ushtrimorë, duke mos kontabilizuar vlerën 838 mijë lekë, në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë nr. 79, datë 2.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në bashkinë Vlorë”, i ndryshuar dhe rregullores së Bashkisë Vlorë “Për organizimin dhe funksionimin e strukturave të Bashkisë Vlorë”, neni 106- në të cilin përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e Specialistit të vlerësimit të detyrimit tatimor për biznesin.

- Mungesa e dokumentacionit ligjorë në rivlerësimet tatimorë të kryera në subjekte private, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19/05/2008 “Për procedurat tatimore në RSH, i ndryshuar, nenet 68 dhe 71. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6. z. I. M., me detyrë Inspektor Terreni.

7. z. M. L., me detyrë Inspektor Terreni.

8. z. A. L., me detyrë Specialist Kontrolli në Terren.

9. z. E. P., me detyrë Inspektor Terreni NJA Qendër.

10. z. F. B., me detyrë Njësia Oriku.

11. zj. A. Sh., me detyrë Inspektore Terreni Rajoni 5.

12. z. G. S., me detyrë Inspektor Terreni NJA Qendër.

13. z. K. Sh., me detyrë Inspektor Terreni Rajoni 3.

14. z. E. A., me detyrë Inspektor Terreni Rajoni nr.(2).

15. z. A. B., me detyrë Inspektor Terreni Rajoni (1) dhe (4).

Për shkeljet e mëposhtme:

Për mos zbatim të urdhrimit të Kryetarit të Bashkisë nr. 316 prot., datë 10.12.2021, urdhër nr. 4 datë 14.01.2022 për një ndryshim në urdhrin nr. 316 datë 10.12.2021, Rregulloren së Brendshme nr. 101 datë 11.09.2018, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreu VII, neni 35, V.K.B së nr.79 datë 02.12.2021 për disa ndryshime në V.K.B-në nr. 88 prot., datë 24.12.2020 “ Për taksat dhe tarifën vendore Vlorë”, lidhur me procedurat e kryera për arkëtimin e të ardhurave nga tarifës së pastrim-gjelbërim-ndriçimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në bazë lejesh ndërtimi dhe investime me fonde publike në territorin e Bashkisë Vlorë, duke krijuar të ardhura të munguar në bashkinë Vlorë në shumën 2.700 mijë lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16. z. F. Ll., me detyrë Inspektor Borxhi pranë Drejtorisë së të Ardhurave Vendore (periudha nga viti 1999 e vijim), dhe

17. znj. A. Sh. me detyrë Inspektor Borxhi pranë Drejtorisë së të Ardhurave Vendore (periudha emëruar me 03/06/20022 e vijon).

Për shkeljet e mëposhtme:

Mos zbatimi i dispozitave ligjore në arkëtimin e debitorëve të të gjitha llojeve (fizik/juridik/abonentë familjarë etj), të cilat zënë rreth **59.1%** të planit vjetor të taksave/tarifave dhe **33.4%** të buxhetit të Bashkisë, bëjnë që bashkia të mund të mos realizojë projektet e investimeve dhe shërbimeve të ndryshme që bashkia planifikon në fillim të cdo vitit buxhetor, ku mungesa e mos realizimit të të ardhurave e bën të pamundur atë dhe njëkohësisht bëhet shkak për rritjen e faturave të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore (kreditorë). Kështu deri në fund të vitit 2022, si rezultat i punës së pamjaftueshëm të DAV Bashkia Vlorë dhe strukturave të tjera të ngarkuara sipas rregullores së brendshme të Bashkisë, niveli i borxhit është në vlerën 398,952 mijë lekë kjo për 6190 subjekte fizik/juridike. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18. znj. S. A., me detyrë specialiste pranë Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë.

Për shkeljet e mëposhtme:

Për mosrespektimin e kondicioneve urbane (2 raste); Për miratimin e lejeve të ndërtimit me mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj; Për mos-hartimin e kontratave me subjektet zhvilluese, mbi kontributit që sektori privat duhet të ofrojë përkundrejt fondit publik të banesave sociale, përpara miratimit të lejes së ndërtimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19. z. K. M., me detyrë specialist pranë Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë.

Për shkeljet e mëposhtme:

Mosrespektimi i kondicioneve urbane (1 rast); Për miratimin e lejeve të ndërtimit me mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj; Për shqyrtimin e dokumentacionit që nuk është dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, por dorazi. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20. z. R. H., me detyrë specialist pranë Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë.

Për shkeljet e mëposhtme:

Për përlogaritjen e gabuar dhe me mungesë dokumentacioni të taksës së ndikimit në infrastrukturë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

21. znj. N. R., me detyrë specialist pranë Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë.

Për shkeljet e mëposhtme:

Për përlogaritjen e gabuar dhe me mungesë dokumentacioni të taksës së ndikimit në infrastrukturë; Për miratimin e çertifikatave të përdorimit me dokumentacion me mangësi ose të pasaktë; Për miratimin e çertifikatave të përdorimit kur është konstatuar se objekti i realizuar ka ndryshime nga objekti i miratuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

22. znj. E. N., me detyrë specialist pranë Drejtorisë së Planifikimit Zhvillim Territorit bashkia Vlorë.

Për shkeljet e mëposhtme:

Për mosrespektimin e kondicioneve urbane (5 raste); Për miratimin e lejeve të ndërtimit me mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqëruar të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj; Për mos-hartimin e kontratave me subjektet zhvilluese, mbi kontributit që sektori privat duhet të ofrojë përkundrejt fondit publik të banesave sociale, përpara miratimit të lejes së ndërtimit; - Për miratimin e lejeve të ndërtimit, pa marrë dhe respektuar mendimin e autoriteteve të tjera publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit; - Për mosrespektimin e kriterëve dhe përcaktimeve të njëjësive strukturore sipas PPV-së *(Ndërtimi i objekteve ndihmëse funksionale nuk është i lejuar në parcelën e marrë në shqyrtim; Parcela në të cilën propozohet të ndërtohet objekti, nuk plotëson kriteret për t'u klasifikuar si Zonë Bujqësore me mundësi agrourtizmi)*; Për shqyrtimin e aplikimeve me afate të tejzgjata; Për miratimin e çertifikatave të përdorimit me dokumentacion me mangësi ose të pasaktë; Për miratimin e çertifikatave të përdorimit kur është konstatuar se objekti i realizuar ka ndryshime nga objekti i miratuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

23. z. D. H., me detyrë specialist pranë Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Për mosrespektimin e kondicioneve urbane (1 rast); Për miratimin e lejeve të ndërtimit me mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqëruar të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj; Për miratimin e lejeve të ndërtimit, pa marrë dhe respektuar mendimin e autoriteteve të tjera publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit; Për mosrespektimin e kriterëve dhe përcaktimeve të njëjësive strukturore sipas PPV-së *(Ndërtimi i objekteve ndihmëse funksionale nuk është i lejuar në parcelën e marrë në shqyrtim)*; Për hartimin e projektit të *“Rikualifikimi i bllokut të banesave...”* me informacion jo të saktë në përmbajtjen e tij *(objekt me leje të miratuar)*, (Ankesë nga znj. T. H. dhe V. H.). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

D/2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit të Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shkronja “k” e nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe kontratës individuale të punës, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë Vlorë**, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2022, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Zgjidhjen e kontratës së punës” për **23 (njëzetetre)** punonjës, si më poshtë:

1. z. R. L., me detyrë Inspektor NJA Orikum, pranë Drejtorisë së të Ardhurave Vendore.

Për shkeljet e mëposhtme:

1. Mos marrjen e masave shtrëngues për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore në vlerën 261,840 mijë lekë, në zbatim të

VKB-në nr. 88 prot., datë 24.12.2020 i ndryshuar VKB nr. 79 datë 02.12.2021 pika (b) faqe 6, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920, për procedurat tatimore, i ndryshuar, si dhe urdhrin të kryetarit me nr. 229 datë 17.09.2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2. z. A. C. (vitet 2021-2022), Rajoni nr. (1)

3. z. O. R. (viti 2021-2022) Rajonit nr. (2)

4. z. A. L. me detyrë Administrator Rajoni nr. 3,

5. znj. A. L. me detyrë Administrator Rajoni nr. (4),

6. znj. B. C. me detyrë Administrator Rajoni nr. (5),

7. z. S. H. me detyrë Administratore në NJA Orikum (per vitet 2021-2022),

Për shkeljet e mëposhtme:

Për mos angazhimin e tyre në miradministrimin për arkëtimin e detyrimeve për taksat/tarifat vendore të abonentëve familjarë në zbatim të VKB nr. 88 prot., datë 24.12.2020 dhe VKB nr. 79 prot., datë 02.12.2021 pika 8. *Për Njësitë Administrative të Bashkisë, Administratorët e njërive*, së bashku me kryetarët e fshatit, për banesat të cilat nuk janë të lidhura me rrjetin e Ujësjellësit, taksa e banesës do të faturohet dhe do të mbliidhet nga Shoqëria “Ujësjellës –Kanalizime” sha, Vlorë. Administratoret e Njërive Administrative, se bashku me Kryetarin e Fshatit të evidentojnë familjet që nuk janë të lidhur me rrjetin e Ujësjellësit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8. z. D. I., me detyrë Inspektor Terreni.

9. z. A. Rr., me detyrë Inspektor Terreni Rajoni (2) dhe (3).

10. z. E. F., me detyrë Inspektor Terreni NJA Shushicë.

11. z. A. A., me detyrë Inspektor Terreni Rajoni 3,

12. z.G. A., me detyrë inspektor Terreni Rajoni 2.

13. z. M. Ll., me detyrë Inspektor Rajoni nr. (1) dhe (4).

14. z. A. B., me detyrë Inspektor Terreni Rajoni (5).

15. z. K. C., me detyrë Inspektor Terreni Rajoni (3).

16. znj. R. L., me detyrë Inspektore Terreni Rajoni (3).

Për shkeljet e mëposhtme:

Për mos zbatim të urdhrin të Kryetarit të Bashkisë nr. 316 prot., datë 10.12.2021, urdher nr. 4 datë 14.01.2022 për një ndryshim në urdhrin nr. 316 datë 10.12.2021, Rregulloren së Brendshme nr. 101 datë 11.09.2018, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreu VII, neni 35, V.K.B së nr.79 datë 02.12.2021 për disa ndryshime në V.K.B-në nr. 88 prot., datë 24.12.2020 “ Për taksat dhe tarifatat vendore Vlorë”, lidhur me:

-Procedurat e kryera për arkëtimin e të ardhurave nga tarifës së pastrim-gjelbërim-ndriçimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në bazë lejesh ndërtimi dhe investime me fonde publike në territorin e Bashkisë Vlorë, duke krijuar të ardhura të munguar në bashkinë Vlorë në shumën 2.700 mijë lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17. znj. A. V., me detyrë ish - Zv/Kryetare, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Apelitimit tatimorë.

Për shkeljet e mëposhtme:

Mos marrja e masave për shqyrtimin në kohë të ankesave të subjekteve dhe delegim të procesin, në kundërshtim me VKB n nr. 108, datë 18/10/2018 “Rregullorja e funksionit të KAT”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18. znj. M. K., me detyrë Administratore e Njesisë Qendër Vlorë.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve si dhe NJA nuk është realizuar në asnjë rast monitorimi i kontratave, pra nëse individ apo subjekte private qiramarrës kanë realizuar investimin sipas objektit të kontratës apo janë në kushtet e moszbatimit të saj. Për rastet e subjekteve debitore nuk ka prishje të kontratës për mos përmbushje të kushteve të saj nga subjekti përfitues/qiramarrës. Nuk është bërë mbikëqyrja e përdorimit të tokës bujqësore të marrë me qira mbi bazën e kartelës personale për çdo kontratë.

Nuk janë evidentuar në terren mbikëqyrje për sipërfaqet e zëna me kontrata dhe përcjellë memo /informacioneve pranë Drejtorisë së Aseteve dhe të Pronave Publike pranë Bashkisë.

- Për periudhën vitet 2008 - 2015 në referim të UKM nr. 3, datë 16.05.2007, “Për tokat bujqësore të pandara” janë lidhur 57 kontrata për qiradhënie **të tokave bujqësore të pandara**, me afat 99 vjet, 10 kontrata me afat 30 vjeçar dhe 1 kontrate me afat 50 vite.

Gjithashtu nuk janë zbatuar kriteret dhe përcaktimet ligjore të Kreut VI “Monitorimi i Kontratave” lidhur me monitorimin e kontratave të qirasë dhe enfiteozës procedurë e cila drejtohet nga organi që ka lidhur kontratën e qirasë ose të enfiteozës dhe konkretisht pikës 2 .

- Në të gjitha rastet kontrata e nënshkruar nga ish/Kryetarët e komunave, në kontrata tip nuk janë respektuar neni 3) të drejtat dhe detyrimet e palëve, pika a) planimetria e tokës së dhënë me qira, pika c) Të ushtrijë kontrole periodike mbi gjendjen e fondit të tokës bujqësore, gjithashtu rezultojnë veprime jo në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 827 “Qiradhënësi me anë inventari i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme si tokën bujqësore, kullotat, e drejta e kundërshtimit të përmbajtjes së inventarit dhe prezumimi i saktësisë së tij rregullohet sipas dispozitave të këtij kreu si dhe neni 829 “Qiradhënësi ka të drejtë që në çdo kohë të ushtrijë kontroll mbi pasurinë e dhënë me qira për të përcaktuar nëse qiramarrësi respekton marrëveshjen sipas detyrimeve të vëna në kontratë, sipas natyrës dhe rregullave agroteknike;

Gjithashtu nuk është vepruar sipas rregullores së brendshme viti /2018 neni 34,35 Misioni i Njësive Administrative “Mbikëqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e Bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të Bashkisë në rast të konstatimit të

veprimeve në kundërshtim me ligjin.

- Për mos angazhimin e tyre në miradministrimin për arkëtimin e detyrimeve për taksat/tarifat vendore të abonentëve familjarë në zbatim të VKB nr. 88 prot., datë 24.12.2020 dhe VKB nr. 79 prot., datë 02.12.2021 pika 8. *Për Njësitë Administrative të Bashkisë, Administratorët e njësive, së bashku me kryetarët e fshatit, për banesat te cilat nuk janë te lidhura me rrjetin e Ujësjellësit, taksa e banesës do te faturohet dhe do te mblidhet nga Shoqëria “Ujësjellës –Kanalizime” sha, Vlorë.- Administratorët e Njësive Administrative, se bashku me Kryetarin e Fshatit te evidentojnë familjet që nuk janë te lidhur me rrjetin e Ujësjellësit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 dhe 8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

19. z. B. A., me detyrë Administrator i Njesisë Shushicë.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për periudhën Janar 2008 - Dhjetor 2013 në referim të UKM nr. 3, datë 16.05.2007, “Për tokat bujqësore të pandara” janë lidhur 161 kontrata për qiradhënie, ku 154 kontrata me afat 99 vjeçar nga fondi i tokave bujqësore të pandara dhe 7 kontrata nga fondi kullësor me sipërfaqe prej 45,721 ha. Nga 154 kontratat e qiradhënies të fondit të tokave të pandara në 13 raste kontratat janë anuluar nga Bashkia Vlorë, në 2 raste kontratash janë në tatime dhe në 3 raste subjektet nuk ekzistojnë.

-Nga NJA Shushicë, për periudhën vitet 2008 - 2015 në referim të UKM nr. 3, datë 16.05.2007, “Për tokat bujqësore të pandara” janë lidhur 57 kontrata për qiradhënie **të tokave bujqësore të pandara**, me afat 99 vjet, 10 kontrata me afat 30 vjeçar dhe 1 kontrate me afat 50 vite.

-Për periudhën Janar 2008 - Dhjetor 2013 në referim të UKM nr. 3, datë 16.05.2007, “Për tokat bujqësore të pandara” janë lidhur 161 kontrata për qiradhënie, ku 154 kontrata me afat 99 vjeçar nga fondi i tokave bujqësore të pandara dhe 7 kontrata nga fondi kullësor me sipërfaqe prej 45,721 ha. Nga 154 kontratat e qiradhënies të fondit të tokave të pandara në 13 raste kontratat janë anuluar nga Bashkia Vlorë, në 2 raste kontratash janë në tatime dhe në 3 raste subjektet nuk ekzistojnë.

-Nuk janë evidentuar në terren mbikëqyrje për sipërfaqet e zëna me kontrata dhe përcjellë memo /informacioneve pranë Drejtorisë së Aseteve dhe të Pronave Publike pranë Bashkisë.

në të gjitha rastet kontrata e nënshkruar nga ish/Kryetarët e komunave, në kontrata tip nuk janë respektuar neni 3) të drejtat dhe detyrimet e palëve, pika a) planimetria e tokës së dhënë me qira, pika c) Të ushtrijë kontrole periodike mbi gjendjen e fondit të tokës bujqësore, gjithashtu rezultojnë veprime jo në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 827 “Qiradhënësi me anë inventari i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme si tokën bujqësore, kullotat, e drejta e kundërshtimit të përmbajtjes së inventarit dhe prezumimi i saktësisë së tij rregullohet sipas dispozitave të këtij kreu si dhe neni 829 “Qiradhënësi ka të drejtë që në çdo kohë të ushtrijë kontroll mbi pasurinë e dhënë me qira për të përcaktuar nëse qiramarrësi respekton marrëveshjen sipas detyrimeve të vëna në kontratë, sipas natyrës dhe rregullave agroteknike Gjithashtu nuk është vepruar sipas rregullores së brendshme viti /2018 neni 34,35 Misioni i Njësive Administrative “Mbikëqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e Bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të Bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin.

- Për mos angazhimin e tyre në miradministrimin për arkëtimin e detyrimeve për taksat/tarifat vendore të abonentëve familjarë në zbatim të VKB nr. 88 prot., datë 24.12.2020 dhe VKB nr. 79 prot., datë 02.12.2021 pika 8. *Për Njësitë Administrative të Bashkisë, Administratorët e njësive,*

së bashku me kryetarët e fshatit, për banesat te cilat nuk janë te lidhura me rrjetin e Ujësjellësit, taksa e banesës do te faturohet dhe do te mblidhet nga Shoqëria “Ujësjellës –Kanalizime” sha, Vlorë.- Administratoret e Njësive Administrative, se bashku me Kryetarin e Fshatit te evidentojnë familjet që nuk janë te lidhur me rrjetin e Ujësjellësit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 dhe 8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

20. z. K. Sh., me detyrë Administrator i Njesisë Novoselë.

Për shkeljet e mëposhtme:

Për periudhën vitet 2008 - 2015 në referim të UKM nr. 3, datë 16.05.2007, “Për tokat bujqësore të pandara” janë lidhur 46 kontrata për qiradhënie, me afat 99 vjeçar. Nga verifikimi i pagesave deri më 30.12.2020 për kontratat e lidhura rezulton se nga 46 kontrata në 2 raste subjektet nuk ekzistojnë rezultuar nga verifikimi, ndërsa në 44 raste qiradhënësit janë debitorë, të cilët nuk kanë shlyer detyrimet kontraktore në të gjitha rastet kontrata e nënshkruar nga ish/Kryetarët e komunave, në kontrata tip nuk janë respektuar neni 3) të drejtat dhe detyrimet e palëve, pika a) planimetria e tokës së dhënë me qira, pika c) Të ushtrojë kontrole periodike mbi gjendjen e fondit të tokës bujqësore, gjithashtu rezultojnë veprime jo në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 827 ”Qiradhënësi me anë inventari i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme si tokën bujqësore, kullotat, e drejta e kundërshtimit të përmbajtjes së inventarit dhe prezumimi i saktësisë së tij rregullohet sipas dispozitave të këtij kreu si dhe neni 829 “Qiradhënësi ka të drejtë që në çdo kohë të ushtrojë kontroll mbi pasurinë e dhënë me qira për të përcaktuar nëse qiramarrësi respekton marrëveshjen sipas detyrimeve të vëna në kontratë, sipas natyrës dhe rregullave agroteknike.

-Për të gjitha rastet e kontratave ku subjektet qiramarrës që janë debitorë nga Bashkia Vlorë nuk është bërë asnjë veprim për verifikimin për rishikimin e kontratave dhe ndryshimin e kushteve të kontratave apo anulimin e tyre, rimarrjen e parcelave që ato shfrytëzojnë si edhe nuk është kryer asnjë procedurë ligjore për zgjidhjen e këtyre kontratave.

-Gjithashtu nuk janë zbatuar kriteret dhe përcaktimet ligjore të Kreut VI “*Monitorimi i Kontratave*” lidhur me monitorimin e kontratave të qirasë dhe enfiteozës procedurë e cila drejtohet nga organi që ka lidhur kontratën e qirasë ose të enfiteozës dhe konkretisht pikës 2 .

-Ulje në nivelin e të ardhurave, si dhe mos menaxhimi dhe mos monitorimi i kontratave të qiradhënies së tokave të pandara dhe parcelave nga fondi pyjor-kullor nga strukturat NJA.

Gjithashtu nuk është vepruar sipas rregullores së brendshme viti /2018 neni 34,35 Misioni i Njësive Administrative “Mbikëqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e Bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të Bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin.

- Për mos angazhimin e tyre në miradministrimin për arkëtimin e detyrimeve për taksat/tarifat vendore të abonentëve familjarë në zbatim të VKB nr. 88 prot., datë 24.12.2020 dhe VKB nr. 79 prot., datë 02.12.2021 pika 8. *Për Njësitë Administrative të Bashkisë, Administratoret e njësive,* së bashku me kryetarët e fshatit, për banesat te cilat nuk janë te lidhura me rrjetin e Ujësjellësit, taksa e banesës do te faturohet dhe do te mblidhet nga Shoqëria “Ujësjellës –Kanalizime” sha” Vlorë.- Administratoret e Njësive Administrative, se bashku me Kryetarin e Fshatit te evidentojnë familjet që nuk janë te lidhur me rrjetin e Ujësjellësit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 dhe 8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

21. z. A. A., me detyrë Agronom, pranë njesisë Administrative Novoselë.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në asnjë rast nuk ka kryer matjet pranë njësisë për verifikimin e terrenit për sipërfaqet e tokave bujqësore sipas pika a) planimetria e tokës së dhënë me qira, pika c) Të ushtrijë kontrole periodike mbi gjendjen e fondit të tokës bujqësore, gjithashtu rezultojnë veprime jo në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 827 "Qiradhënësi me anë inventari i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme si tokën bujqësore, kullotat, e drejta e kundërshtimit të përmbajtjes së inventarit dhe prezumimi i saktësisë së tij rregullohet sipas dispozitave të këtij kreu si dhe neni 829 "Qiradhënësi ka të drejtë që në çdo kohë të ushtrijë kontroll mbi pasurinë e dhënë me qira për të përcaktuar nëse qiramarrësi respekton marrëveshjen sipas detyrimeve të vëna në kontratë, sipas natyrës dhe rregullave agroteknike.

Gjithashtu nuk është vepruar sipas rregullores së brendshme viti 2018 neni 34,35,39 Misioni i Njësisë Administrative, "Mbikëqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e Bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të Bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

22. z. A. H., me detyrë Agronom, pranë njësisë Administrative Shushicë.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në asnjë rast nuk ka kryer matjet pranë njësisë për verifikimin e terrenit për sipërfaqet e tokave bujqësore sipas, pika a) planimetria e tokës së dhënë me qira, pika c) Të ushtrijë kontrole periodike mbi gjendjen e fondit të tokës bujqësore, gjithashtu rezultojnë veprime jo në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 827 "Qiradhënësi me anë inventari i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme si tokën bujqësore, kullotat, e drejta e kundërshtimit të përmbajtjes së inventarit dhe prezumimi i saktësisë së tij rregullohet sipas dispozitave të këtij kreu si dhe neni 829 "Qiradhënësi ka të drejtë që në çdo kohë të ushtrijë kontroll mbi pasurinë e dhënë me qira për të përcaktuar nëse qiramarrësi respekton marrëveshjen sipas detyrimeve të vëna në kontratë, sipas natyrës dhe rregullave agroteknike, mos menaxhimi dhe mos monitorimi i kontratave të qiradhënies së tokave të pandara dhe parcelave nga fondi pyjor-kullor nga strukturë NJA.

Gjithashtu nuk është vepruar sipas rregullores së brendshme viti 2018 neni 34,35,39, Misioni i Njësisë Administrative, "Mbikëqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e Bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të Bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

23. z. Th. Q., me detyrë Agronom, pranë njësisë Administrative Qendër.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në asnjë rast nuk ka kryer matjet pranë njësisë për verifikimin e terrenit për sipërfaqet e tokave bujqësore sipas, pika a) planimetria e tokës së dhënë me qira, pika c) Të ushtrijë kontrole periodike mbi gjendjen e fondit të tokës bujqësore, gjithashtu rezultojnë veprime jo në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 827 "Qiradhënësi me anë inventari i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme si tokën bujqësore, kullotat, e drejta e kundërshtimit të përmbajtjes së inventarit dhe prezumimi i saktësisë së tij rregullohet sipas dispozitave të këtij kreu

si dhe neni 829 “Qiradhënësi ka të drejtë që në çdo kohë të ushtrojë kontroll mbi pasurinë e dhënë me qira për të përcaktuar nëse qiramarrësi respekton marrëveshjen sipas detyrimeve të vëna në kontratë, sipas natyrës dhe rregullave agroteknike, mos menaxhimi dhe mos monitorimi i kontratave të qiradhënies së tokave të pandara dhe parcelave nga fondi pyjor-kullor nga strukturë NJA.

Gjithashtu nuk është vepruar sipas rregullores së brendshme viti 2018 neni 34,35,39 Misioni i Njësive Administrative, “Mbikëqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e Bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të Bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

D/3. Për të gjithë punonjësit e tjerë, të cilët janë trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të cilët nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i të auditimit, **lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Vlorë**, fillimin ose jo të procedurave disiplinore në referim të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës.

Shënim: Për punonjësit e larguar.

- Për **12 ish- punonjësit** e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë, nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara do të ishte kërkuar masë disiplinore, **“Largim nga shërbimi civil/ zgjidhje të kontratës së punës”**, si më poshtë vijon:

1. z. G. Sh., me detyrë ish - Drejtor i NSHP, Bashkia Vlorë.

2. z. E. J., me detyrë ish - Drejtor i NSHP, Bashkia Vlorë.

3. z. F. Xh., me detyrë ish - Përgjegjës i Sektorit të Ujitjes në NSHP, Bashkia Vlorë.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Ngarkohen për mos arkëtim nga të ardhurat e vjela nga shërbimi për tarifën e ujitjes, duke sjellë 1,045,900 lekë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Bashkisë Vlorë, dhe vlerën prej 1,525,000 lekë duke sjellë të ardhura të munguara. *(Më gjerësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4. z. J. Ç., me detyrë ish - Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Ngarkohet për mos pajisjen me autorizim dhe mos pagesa e tarifës nga subjektet që ushtrojnë veprimtarinë lavazh kemi të bëjmë me një vlerë debitoare prej **270,000 lekë** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë. Situata e sipër përmendur vjen si pasojë e mos zbatimit të VKB nr. 79 prot., datë 02,12,2021 për një ndryshim në VKB nr. 88 Datë 24.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”, pika 6, nënpika 10. *(Më gjerësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
- Për vitin 2021 dhe vitin 2022 janë 77 subjekte të cilët kanë njoftuar për fillimin e punimeve, ku 19 prej tyre janë debitorë për zërin transport sipas preventivit m³. Nga ana e Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit rezulton se subjektet nuk janë njoftuar për pagesën e tarifës dhe nuk kanë paguar tarifën sikurse përcaktohet në VKB nr.79 prot., datë 02.12.2021 nënpika 5 e pikës 6, duke sjellë kështu të ardhura të munguara në vlerën **8,527,070 lekë**. *(Më gjerësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
- Për procedurat e ndjekura për arkëtimin e të ardhurave nga taksa e infrastrukturës të ndërtimeve informale që ndodhen në territorin e Bashkisë Vlorë, në kundërshtim me VKB-së nr. 88, datë 24.12.2020 i ndryshuar me VKB nr. 79 datë 02.12.2021 “Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë nr. 1235/1 Prot., datë 31.12.2020. ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006. VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014. *(Më gjerësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
- Për mosrespektimin e kondicioneve urbane (9 raste); Për miratimin e lejeve të ndërtimit me mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqëruar të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj; Për shqyrtimin e dokumentacionit që nuk është dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, por dorazi; Për miratimin e lejeve të ndërtimit, pa marrë dhe respektuar mendimin e autoriteteve të tjera publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit; Për mos-hartimin e kontratave me subjektet zhvilluese, mbi kontributit që sektori privat duhet të ofrojë përkundëjt fondit publik të banesave sociale, përpara miratimit të lejes së ndërtimit; për hartimin e preventivit për rehabilitimin e rrugës “Xher Rashimi” me diferencë prej 9.897.789 lekë, krahasuar me vlerën e shitjes së sipërfaqes prej 299.86 m² (me vlerë shitjeje 299.86 m² * 61.800 lekë/m² = 18.531.348 lekë), të cilën Bashkia Vlorë do të duhej t’a përfitonte për shkak të përdorimit të Intensitetit të Ndërtimit me Kusht nga subjekti zhvillues “F. I.” ShPK; Për miratimin e lejeve të ndërtimit në kushtet e përlllogaritjes së gabuar dhe me mungesë dokumentacioni të taksës së ndikimit në infrastrukturë; Për miratimin e lejes së zhvillimit me mangësi të dhënash në përmbajtjen e saj; Për miratimin e lejes së ndërtimit për një objekt i cili ka filluar ndërtimin përpara miratimit të lejes; Për mosrespektimin e kritereve dhe përcaktimeve të njëjësive strukturore sipas PPV-së *(Ndërtimi i objekteve ndihmëse funksionale nuk është i lejuar në parcelën e marrë në shqyrtim; Parcela në të cilën propozohet të ndërtohet objekti, nuk plotëson kriteret për t’u klasifikuar si Zonë Bujqësore me mundësi agrourtizmi)*; Për shqyrtimin e aplikimeve me afate të tejzgjatura; Për miratimin e certifikatave të përdorimit me dokumentacion me mangësi ose të pasaktë; Për miratimin e certifikatave të përdorimit kur është konstatuar se objekti i realizuar ka ndryshime nga objekti i miratuar; Për hartimin e projektit të “*Rikualifikimi i bllokut të banesave...*” dhe miratimit të lejes së infrastrukturës, me informacion jo të saktë në përmbajtjen e tij *(objekt me leje të miratuar)*. (Ankesë nga znj. T. H. dhe V. H.). Për miratimin e lejes së ndërtimit në kushtet e mungesës së dokumentacionit të detyrueshëm, për miratimin e lejes së ndërtimit në favor të një subjekti që nuk gëzon të drejtën e ushtrimit të aktivitetit (status pasiv); për vendim-marrje në kundërshtim me vendimin e gjykatës, duke miratuar lejen e ndërtimit për

një bashkim subjektësh, të cilët nuk kanë lidhje të vërtetuar me subjektin për të cilin është shprehur gjykata, si dhe për mos-marrjen e masave ndaj subjektit ndërtues për shkelje të afatit të fillimit të punimeve; (Ankesë nga z. J. M.). (Më gjerësisht trajtuar në pikën 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5- z. M. M., me detyrë ish- Kryeinspektor i Policisë Bashkiake.

Për shkeljet e mëposhtme:

Për veprime në kundërshtim me nenin 13 në Ligjin nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar. Pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, si dhe mos marrjen e masave në arkëtimin e vlerës së gjobave për shumën 490 mijë lekë.

- Mos angazhimi sa duhet në marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në zbatim të urdhrat të Kryetarit të Bashkisë nr. 158, datë 13.6.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH përcjellë me shkresën nr. 731/37prot, datë 2.6.2022”. (Më gjerësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6- z. T. Z., me detyrë ish- Drejtor i Financës dhe anëtarë i KVO.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Lidhur me vlerën e stokut të detyrimeve të prapambetura dhe raportimi i tij në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë si dhe marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion. Fatura të pa likuiduara brenda afatit 30 ditor, duke krijuar në fund të vitit buxhetor detyrime të prapambetura, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”.

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura e cila duhej të ish anuluar (*Procedura 1*) dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurës tjetër me kushte më të favorshme dhe, kualifikim dhe shpallur fitues jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese (*Procedura 2*) veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, konkretisht për procedurën e prokurimit:

Procedura 1: “*Blerje Kompjutera Desktop, Workstation, Printer AIO, Laptop Praktik*” me fond limit 1,660 mijë lekë.

Procedura 2: “*Pëmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara*” me fond limit 4,701 mijë lekë. (Më gjerësisht trajtuar në pikën 4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7- z. R. H., me detyrë ish - specialist pranë Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë.

Për shkeljet e mëposhtme:

Për mosrespektimin e kondicioneve urbane (3 raste); - Për miratimin e lejeve të ndërtimit me mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj; Për shqyrtimin e dokumentacionit që nuk është dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, por dorazi; Për mos-hartimin e kontratave me subjektet zhvilluese, mbi kontributit që sektori privat duhet të ofrojë përkundrejt fondit publik të banesave sociale, përpara miratimit të lejes së ndërtimit; Për miratimin e çertifikatave të përdorimit me dokumentacion me mangësi ose të pasaktë; Për miratimin e çertifikatave të përdorimit kur është konstatuar se objekti i realizuar ka ndryshime nga objekti i miratuar. *(Më gjerësisht trajtuar në pikën 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8- z. M. K., me detyrë ish - specialist pranë Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Për mosrespektimin e kondicioneve urbane (4 raste); Për miratimin e lejeve të ndërtimit me mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj; Për miratimin e lejeve të ndërtimit, pa marrë dhe respektuar mendimin e autoriteteve të tjera publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit; Për mos-hartimin e kontratave me subjektet zhvilluese, mbi kontributit që sektori privat duhet të ofrojë përkundrejt fondit publik të banesave sociale, përpara miratimit të lejes së ndërtimit; Për mosrespektimin e kriterëve dhe përcaktimeve të njëjësive strukturore sipas PPV-së *(Parcela në të cilën propozohet të ndërtohet objekti, nuk plotëson kriteret për t'u klasifikuar si Zonë Bujqësore me mundësi agrourizmi)*; Për shqyrtimin e aplikimeve me afate të tejkzgjatura; Për miratimin e çertifikatave të përdorimit me dokumentacion me mangësi ose të pasaktë. *(Më gjerësisht trajtuar në pikën 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9- z. F. H., me detyrë ish - Kryeinspektor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), Bashkia Vlorë.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Për mungesën e bashkëpunimit me DPKZHT; Për mangësitë në hartimin e planeve mujore të punës; Për mangësitë në raportimin tre mujor ndaj IKMT; Për mangësitë në dosjet individuale që IMTV duhet të mbajë për çdo procedurë; Për mos-marrjen e hapave për heqjen e licencës profesionale për subjektet dhe mbikëqyrësit e punimeve, që kanë shkelur projektin e miratuar; Për parregullsitë e konstatuara në procedurat dhe vendimet e marra (ndëshkim jo-konform parashikimeve ligjore); Për mosrespektimin e detyrave funksionale duke lejuar ndërtimin e një objekti pa leje ndërtimi të miratuar; Për mos-ushtimin e aktivitetit inspektues ndaj subjektit i cili është konstatuar se ka filluar punimevet në mungesë të miratimit të njoftimit të fillimit të punimeve; (Ankesë nga z. J. M.). *(Më gjerësisht trajtuar në pikën 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

10- z. I. Z., me detyrë ish - Kryeinspektor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), Bashkia Vlorë.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Për mungesën e bashkëpunimit me DPKZHT; Për mangësitë në hartimin e planeve mujore të punës; Për mangësitë në raportimin tre mujor ndaj IKMT; Për mangësitë në dosjet individuale që IMTV duhet të mbajë për çdo procedurë; Për mos-marrjen e hapave për heqjen e licencës profesionale për subjektet dhe mbikëqyrësit e punimeve, që kanë shkelur projektin e miratuar; Për parregullsitë e konstatuara në procedurat dhe vendimet e marra (ndëshkim jo-konform parashikimeve ligjore); Për mosrespektimin e detyrave funksionale duke lejuar ndërtimin e një objekti pa leje ndërtimi të miratuar; Për mos-ushtimin e aktivitetit inspektues ndaj subjektit i cili është konstatuar se ka filluar punimevet në mungesë të miratimit të njoftimit të fillimit të punimeve; (Ankesë z. J. M.). *(Më gjerësisht trajtuar në pikën 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

11- z. M. M., me detyrë ish - Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Publike, në cilësinë e Kryetarit të KVO, dhe

12- z. V. Z., me detyrë ish - Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Publike, në cilësinë e Kryetarit të KVO.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura e cila duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurës tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, konkretisht për procedurën e prokurimit: “*Blerje Kompjuter Desktop, Ëorkstation, Printer AIO, Laptop Praktik*” me fond limit 1,660 mijë lekë. *(Më gjerësisht trajtuar në pikën 4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

E. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL.

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit) , pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTE I SHTETIT